
بسم الله الرحمن الرحیم

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i njëzeteshtatë)

Nga ajeti 31 i sures "Edh Dharijat" deri në fund të sures "El Hadid"

TIRANË, 2020

Titulli: ***KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT***

(Xhuzi i njëzeteshtatë)

Autori: ***Eruditi, juristi dhe komentuesi***

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga arabishtja: ***Valbona HOROZOVA***

E redaktoi: **Jerida KULLA**

E ballafaqoi: **Rajmonda FEZA**

Korrektura teknike: ***Vjollca KARAJ***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILO***

Ajetet 31 – 37

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قَالَ فَمَا خَطْبُكُمْ أَيُّهَا الْمُرْسَلُونَ٣١ قَالُوا إِنَّا أُرْسِلْنَا إِلَى قَوْمٍ مُجْرِمِينَ٣٢ لِنُرْسِلَ عَلَيْهِمْ حِجَارَةً مِنْ طِينٍ٣٣ مُسَوَّمَةً عِنْدَ رَبِّكَ لِلْمُسْرِفِينَ٣٤ فَأَخْرَجْنَا مَنْ كَانَ فِيهَا مِنَ الْمُؤْمِنِينَ٣٥ فَمَا وَجَدْنَا فِيهَا غَيْرَ بَيْتٍ مِنَ الْمُسْلِمِينَ٣٦ وَتَرَكْنَا فِيهَا آيَةً لِلَّذِينَ يَخَافُونَ الْعَذَابَ الْأَلِيمَ٣٧

"Ai i pyeti: 'Cili është qëllimi juaj, o të dërguar?'"

"Ata thanë: 'Ne jemi dërguar te një popull keqbërës.'"

"Për të hedhur mbi ta gurë prej balte."

"Të shënuar te Zoti yt, për ata që e kalojnë kufirin (në të këqija)**."**

"Ne i nxorëm të gjithë besimtarët që ishin në atë qytet."

"Ndonëse aty gjetëm vetëm një shtëpi myslimane."

"Dhe në të lamë shenjë për ata që i frikësohen dënimit të dhimbshëm."

Komentimi

Qytetet e shkatërruara të popullit të Lutit janë argumente dhe mësime të qarta për njerëzimin

Pasi u fol në ajetet e mësipërme për engjëjt që erdhën te Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, si vizitorë dhe për lajmin e mirë që ata i dhanë, lidhur me fëmijën e tij, Is'hakun, këto ajete tregojnë se ç'kanë biseduar ata me Ibrahimin dhe çfarë kanë thënë për popullin e Lutit.

Qartësim i kësaj çështjeje: Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, pasi u dëbua për në vendet e Shamit, vazhdoi t'i thërrasë njerëzit për në adhurimin e All'llahut, edhe pse u përball me të gjitha format e shirkut, të politeizmit dhe të adhurimit të putave. Nga të dhënat historike që kemi, Ibrahimi, *"el khalil" – "i dashuri i All'llahut"*, rezulton të ketë qenë bashkëkohës i Lutit, një prej Profetëve të mëdhenj. Mendohet, gjithashtu, se Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të jetë urdhëruar prej tij, që t'u përcjellë njerëzve fenë e drejtë të All'llahut dhe të bëhet udhërrëfyes për udhëzimin e njerëzve të humbur. Ai udhëtoi në disa zona të Shamit, qytete të Sodomit, derisa u përball dhe u ndal te një popull kriminel, i ndyrë në gjynahe të mëdha dhe politeizëm (shirk). Një prej gjynaheve më të mëdha, ishte përfshirja në deviacione të frikshme seksuale, siç ishte homoseksualizmi.

Së fundi, një grup engjëjsh u urdhëruan që t'i ndëshkojnë dhe t'i shkatërrojnë ata, por, para se engjëjt të kryenin detyrën e ngarkuar prej All'llahut të Madhëruar, u ndalën te Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, nga gjendja me të cilën shfaqeshin miqtë engjëj, e kuptoi se ata ishin ngarkuar për të kryer një detyrë të rëndësishme, përveç dhënies së lajmit të mirë, lidhur me ardhjen në jetë të djalit të tij, Is'hakut. Kjo shihej qartë, se po të ishte fjala vetëm për lajmin e mirë të Is'hakut, do të mjaftonte edhe një engjëll i vetëm.

Një tjetër arsye, që mund ta ketë shtyrë Profetin Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* t'i dallojë engjëjt, që ishin ngarkuar me një detyrë tjetër të rëndësishme, është fakti se ata nxitonin dhe nuk kishin shumë kohë.

Për këtë arsye, ajeti i parë prej ajeteve në fjalë, shpalos pjesën e parë të dialogut ndërmjet tyre: **"Ai i pyeti: 'Cili është qëllimi juaj, o të dërguar?'"**.[1]

Engjëjt ulën perden dhe shfaqën të vërtetën, duke i treguar urdhrin që kishin marrë prej All'llahut të Madhëruar. Ajeti kur'anor thotë: "**Ata thanë: 'Ne jemi dërguar te një popull keqbërës.'"**.

[1] Duhet të vëmë re se fjala *"khatbun"*, nuk përdoret për të nënkuptuar të gjitha llojet e punëve. Ajo është fjalë e posaçme, që përdoret për të nënkuptuar punët e rëndësishme, ndërkohë që fjalët e tjera, si për shembull: punë, detyrë, vepër, çështje, kanë kuptime të përgjithshme.

Ata ishin një popull i infektuar me vese të liga, pa marrë parasysh këtu edhe besimin e tyre të devijuar, me gjynahe nga më të ndryshmet, më të ulëtat, më të ndyrat.[1]

Më pas, engjëjt vijuan përgjigjen: **"Për të hedhur mbi ta gurë prej balte."**. Togfjalëshi: **"gurë prej balte"**, përmendet edhe në ajetin 82 të sures "Hud", duke i cilësuar ato gurë si *"sixhxhijl" - "baltë e pjekur"*. Fjala: *"sixhxhijl"*, e ka origjinën e saj në gjuhën perse. Origjina e saj në persisht është *"senekkel"***,** ndërsa në gjuhën arabe arriti si *"sixhxhijl"*. Ajo nuk e ka ngurtësinë e gurit dhe as butësinë e baltës, për këtë arsye mesazhi, në tërësinë e tij, përcjell, pikërisht, këtë kuptim, që tregon se, për shkatërrimin e popullit të inkriminuar të Lutit, nuk ishte e nevojshme të hidheshin prej qiellit gurë të përmasave të mëdha, por do të mjaftonin edhe gurë me përmasa të vogla, më të butë, të cilët do të derdheshin mbi ta në formën e pikave të shiut.

Më pas engjëjt, shtuan: **"Të shënuar te Zoti yt, për ata që e kalojnë kufirin** (në të këqija)**."**.

Fjala *"museuemetun"*, përdoret për të nënkuptuar *"një shenjë"*, *"një sinjal"* tregues. Komentuesit e Kur'anit kanë dhënë shumë variante për kuptimin e fjalës *"museuemetun"*, duke u përpjekur të shpjegojnë mënyrën se si shfaqet kjo fjalë:

Disa komentues kanë thënë se ata gurë kishin një formë të caktuar, çka i bënte të ndryshëm prej gurëve të zakonshëm, pra,

[1] Duhet të kemi parasysh se në suren "Hud", shprehja erdhi në këtë mënyrë: **"Ne kemi dërguar te populli i Lutit."**. Ky ndryshim ndërmjet shprehjeve të përdorura në suren "Hud" dhe ajeteve që po studiojmë, ndodh sepse secili ajet apo secila shprehje trajton një pjesë të caktuar të ngjarjes. E thënë ndryshe, të gjitha këto ngjarje kanë ndodhur, por një pjesë e tyre janë përmendur në suren "Hud" dhe një pjesë tjetër tek ajetet që po studiojmë.

ishin si armë e posaçme për ndëshkim. Komentues të tjerë mendojnë se secili gur kishte një shenjë të posaçme, kështu që secili gur ishte adresuar për një person të caktuar. Një pikë e veçantë ishte vendosur në secilin gur. Kjo shenjë kishte për qëllim të dëshmonte se ndëshkimi i All'llahut ishte me një saktësi të lartë. Saktësia ishte aq e madhe, sa secili gur ishte përcaktuar për një person të vetëm, derisa ta shkatërronte përfundimisht atë.

Fjala "*el musrifijne*", tregon për ata që kanë tejkaluar të gjithë kufijtë, madje duke grisur perden e turpit dhe të drojës. Nëse do të kishim një grup të caktuar studiuesish për të hulumtuar dhe për të analizuar gjendjen morale të popullit të Lutit, si dhe natyrën e gjynaheve të tyre, do të kuptonim se shprehja që përzgjodhi All'llahu, për t'i etiketuar ata, kishte qëllim të veçantë.[1]

Në fakt, të gjithë njerëzit mund të mëkatojnë. Askush nuk është i imunizuar prej gjynaheve, por, kur njeriu zgjohet shpejt, pendohet dhe reflekton në kohë për gjynahet e kryera, rreziku mund të shmanget. Ndryshe, ai bëhet i rrezikshëm, kur kthehet në zakon e rutinë, duke tejkaluar kështu të gjithë kufijtë.

Kjo shprehje, gjithashtu, zbulon një tjetër argument shumë të rëndësishëm, që konsiston në faktin se gurët qiellorë, të përgatitur për të ndëshkuar popullin e Lutit, nuk janë ekskluzivisht për atë popull, përkundrazi, kjo seri gurësh është e përgatitur për të gjithë ata popuj që tejkalojnë kufijtë, për të gjithë gjynahqarët dhe kriminelët.

[1] Kthehu te fundi i ajetit 81 i sures "Hud".

Në këtë rast, Kur'ani, zbulon ç'u ndodhi engjëjve të dërguar nga All'llahu te Profeti i Tij, Luti *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Ata ishin miq të Profetit të Zotit, kështu që u ndoqën prej anëtarëve të popullit të Lutit, pa pikën e turpit dhe të drojës, pasi hamendësuan se ishin djelmosha të rinj dhe synonin të kryenin marrëdhënie me ta. Por ata e kuptuan shumë shpejt gabimin e madh, pasi humbën shikimin dhe u shndërruan në njerëz të verbër.

All'llahu i Madhëruar, lidhur me këtë rast, thotë:[1] **"Ne i nxorëm të gjithë besimtarët që ishin në atë qytet- ndonëse aty gjetëm vetëm një shtëpi myslimane."**.

All'llahu i Madhëruar dëshmon se Ai është i butë dhe i drejtë, ndaj në këtë rast, Ai, nuk e djeg të njomin bashkë me të thatin, pasi drejtësia e Tij nuk mund të lejojë që të sprovohet besimtari, për shkak të devijimit të një gjynahqari. Kështu, duket se All'llahu i Madhëruar, synon të njoftojë se Ai do ta marrë në mbrojtjen e Tij besimtarin, qoftë edhe i vetëm, në mes të mijëra e mijëra mohuesve jobesimtarë.

Ky është saktësisht realiteti që përshkruajnë ajetet 59-60 të sures "El Hixhr": **"Përveç familjes së Lutit, Ne do t'i shpëtojmë**

[1] Vlen të përmendim se surja "Hud" e përshkruan këtë histori, por shprehjet e zgjedhura në të, tregojnë qartë se takimi i engjëjve me Ibrahimin ka ndodhur para ndëshkimit e shkatërrimit të popullit të Lutit. Ajetet, objekt i studimit tonë, tregojnë se ky takim ka ndodhur pas ndëshkimit të popullit të Lutit. E vetmja mënyrë për t'i dhënë zgjidhje kësaj kundërshtie, është të themi se ajetet e përmendura, deri te sifjalia: **"të shënuar te Zoti yt, për ata që kalojnë kufirin** (në të këqija)**"**, janë fjalët e engjëjve, ndërsa tri ajetet që i pasojnë ato, janë fjalët e All'llahut, nëpërmjet të cilave Ai i drejtohet Profetit të tij dhe myslimanëve, duke e treguar atë si një histori që ka ndodhur në të shkuarën. (Vini re me kujdes!)

të gjithë ata, përveç gruas së tij, për atë, Ne, kemi caktuar si dënim, që të mbetet pas me të tjerët!".

Në ajetin 81 të sures "Hud", gjithashtu, lexojmë një shembull të ngjashëm me këtë. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Nisu ti me familjen tënde në orët e para të natës dhe askush prej jush të mos këqyrë prapa, përveç gruas tënde. Atë do ta godasë, ajo që do t'i gjejë edhe ata!"**.

Kjo histori është përmendur edhe në ajetin 32 të sures "El Ankebut". All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ai, Ibrahimi, tha: 'Por atje banon edhe Luti!'. Ata thanë: 'Ne e dimë më mirë kush është atje! Ne do ta shpëtojmë atë dhe familjen e tij, përveç gruas së tij, ajo do të qëndrojë me ata që do të mbesin!'"**.

E njëjta çështje është përmendur edhe në ajetin 83 të sures "El A'araf". All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kështu, Ne e shpëtuam atë me gjithë familje, përveç gruas së tij. Ajo ishte nga ata që mbetën pas** (dhe u ndëshkuan)**."**.

Ashtu, si e keni vënë re, kjo pjesë e historisë së popullit të Lutit përmendet me shprehje të ndryshme në pesë sure. Secila prej tyre përshkruan të njëjtën të vërtetë, që, gjithsesi, mbetet një. Kur një histori apo ngjarje të caktuar, e shohim dhe e analizojmë në këndvështrime të ndryshme, vëmë re se çdo këndvështrim ka dimensionin e tij të veçantë. Është në traditën kur'anore dhe stilin e tij, që t'i trajtojë, përgjithësisht, në këtë mënyrë ngjarjet historike. Ndryshimi i shprehjeve të përmendura në ajetet e tjera, nga ato të përmendura në ajetin, objekt i studimit tonë, është tregues i qartë i kësaj metode dhe i këtij stili kur'anor në trajtimin e ngjarjeve historike.

Shtojmë këtu faktin se Kur'ani është një libër edukativ dhe njerëzor, prandaj është më se njerëzore dhe edukative, që një çështje e vlerësuar si e dorës së parë, të përmendet në mënyrë të përsëritur. Kjo përsëritje ka për qëllim të ndikojë thellë në mendjen e lexuesit, por, më i rëndësishëm se gjithçka, është fakti, se kjo përsëritje duhet të realizohet nëpërmjet shprehjeve të bukura, të ndryshme dhe ndikuese, me qëllim që të shmangë lodhjen dhe bezdinë e lexuesit. Duhet sigurisht, që mënyra e përzgjedhur të jetë e qartë dhe elokuente.

Për më shumë sqarime dhe detaje, lidhur me historinë e miqve të Ibrahimit dhe gjithçka kanë shkëmbyer mes tyre, për më shumë hollësi, lidhur me përfundimin e hidhur të popullit të Lutit, mund t'i kthehemi fundit të ajeteve: 83 të sures "El A'araf", 81 të sures "Hud", 59 60 të sures "El Hixhr", si dhe ajetit 32 të sures "El Ankebut".

Gjithsesi, All'llahu i Madhëruar i drodhi nga themelet qytetet e banuara të popullit të Lutit dhe i përmbyti plotësisht ato. Më pas, në formën e shiut që bie prej qiellit, Ai derdhi përmbi mbi ta gurë prej balte të pjekur, duke i shkatërruar përfundimisht ata dhe duke mos lënë asgjë në këmbë dhe askënd të gjallë. Madje, trupat e tyre mbetën të varrosur poshtë rrënojave, nën gurët me të cilët u dënuan. Kjo histori, vjen për t'i treguar popujve të nesërm, imoralëve dhe kriminelëve, se ky do të jetë ndëshkimi i tyre, ndaj duhet të nxjerrin mësim.

Për këtë arsye, në fund të ajeteve, objekt i studimit tonë, Kur'ani, thotë: **"Në të lamë shenjë për ata që i frikësohen dënimit të dhimbshëm."**.

Ky ajet tregon qartë, se të gjithë ata që marrin mësime prej këtyre historive e prej këtyre argumenteve, janë ata që e kanë gatishmërinë për të pranuar thellë qenies së tyre përgjegjësinë e madhe me të cilën këto Shpallje i ngarkojnë.

Hulumtim

Pozicioni gjeografik i qyteteve të popullit të Lutit

Nga çështjet e pranuara, që gëzojnë mirëkuptimin e të gjithëve, është fakti se i dashuri i All'llahut, Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u transferua duke emigruar prej Irakut, Babilonisë së atëhershme, për në vendet e Shamit. Thuhet se Luti ka banuar në një vend me të, por, pas një farë kohe, ai u nis në drejtim të Sodomit, për t'i thirrur njerëzit në Njësimin e All'llahut, për të luftuar atje imoralitetin, korrupsionin, shkatërrimin dhe perversitetin.

Sodomi është njëri prej qyteteve dhe lagjeve më të njohura të popullit të Lutit, që ndodhej në Jordaninë e sotme, pranë Detit të Vdekur. Atje kishte shumë toka pjellore, pemë të shumëllojshme, por, mbas dënimit të madh të All'llahut për zullumqarët e popullit të Lutit, ato toka e ato qytete u kthyen përmbys, duke u shkatërruar plotësisht. Nga ajo kohë, ato u quajtën "*el mu'tefikat*", që do të thotë, të përmbysurat.

Disa komentues, janë të mendimit se mbetjet dhe shenjat e shkatërrimit të këtyre qyteteve, mbetën të përmbytura nën ujë.

Ata pretendojnë se në një anë të Detit të Vdekur kanë parë shtylla të larta dhe kolona, bashkë me rrënoja të tjera nga shkatërrimi.

Në disa libra islame, për komentimin e Kur'anit, se fjalia: **"Dhe në të lamë shenjë për ata që i frikësohen dënimit të dhimbshëm."**, nënkupton ujërat e qelbura dhe kënetat që mbuluan tokat e përmbytura të këtyre qyteteve. Ekziston, gjithashtu, mundësia, të kuptojmë se pas tërmeteve të forta dhe çarjes së tokës, të jetë hapur një rrugë për në Detin e Vdekur. Kështu që mund të ngrihet hipoteza se ata janë mbytur aty, se ato fragmente kolonash të mbytura nën ujë, tregojnë për ekzistencën e dikurshme të qyteteve.

Ndërkohë, disa komentues theksojnë, se qytetet e popullit të Lutit nuk janë mbytur ende, ato vazhdojnë të jenë të pranishme në një zonë të mbuluar me gurë të zinj, fare pranë Detit të Vdekur. Pra, mendohet që këto të jenë qytetet e banuara prej popullit të Lutit.

Është thënë, gjithashtu, se qendra e Ibrahimit ka qenë në qytetin Habron, jo shumë larg Sodomit, prandaj, kur zbriti dënimi dhe erdhi goditja e madhe nga qielli, kur ndodhi tërmeti në tokë dhe qyteti i Sodomit u dogj tërësisht, Ibrahimi ka qenë duke shikuar në këmbë shumë pranë qytetit të Habronit, ai e pa më sytë e tij tymin e madh të djegieve që ngriheshin drejt qiellit.[1]

Duke iu referuar shpjegimeve të mësipërme, bëhet e qartë vendndodhja e përafërt e kufijve të këtyre qyteteve, edhe pse detajet e imtësitë vazhdojnë të mbeten të mbuluara prej perdes së të panjohurës.

[1] E marrë prej librit "El Kamus El Mukaddes".

Ajetet 38 - 46

وَفِي مُوسَى إِذْ أَرْسَلْنَاهُ إِلَى فِرْعَوْنَ بِسُلْطَانٍ مُبِينٍ٣٨ فَتَوَلَّى بِرُكْنِهِ وَقَالَ سَاحِرٌ أَوْ مَجْنُونٌ٣٩ فَأَخَذْنَاهُ وَجُنُودَهُ فَنَبَذْنَاهُمْ فِي الْيَمِّ وَهُوَ مُلِيمٌ٤٠ وَفِي عَادٍ إِذْ أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمُ الرِّيحَ الْعَقِيمَ٤١ مَا تَذَرُ مِنْ شَيْءٍ أَتَتْ عَلَيْهِ إِلَّا جَعَلَتْهُ كَالرَّمِيمِ٤٢ وَفِي ثَمُودَ إِذْ قِيلَ لَهُمْ تَمَتَّعُوا حَتَّى حِينٍ٤٣ فَعَتَوْا عَنْ أَمْرِ رَبِّهِمْ فَأَخَذَتْهُمُ الصَّاعِقَةُ وَهُمْ يَنْظُرُونَ٤٤ فَمَا اسْتَطَاعُوا مِنْ قِيَامٍ وَمَا كَانُوا مُنْتَصِرِينَ٤٥ وَقَوْمَ نُوحٍ مِنْ قَبْلُ إِنَّهُمْ كَانُوا قَوْمًا فَاسِقِينَ٤٦

"Edhe në historinë e Musait (ka mësim)**, kur ia dërguam Faraonit, me provë të qartë."**

"Ai (Faraoni) **u shmang** (nga besimi)**, së bashku me komandantët e vet dhe tha: 'Musai është magjistar ose i çmendur!'"**

"Ne e kapëm atë me ushtrinë e tij dhe e hodhëm në det; ai e meritoi."

"(Mësim ka edhe në historinë) **e fisit Ad, kur i dërguam erën sterile** (shkatërruese)**."**

"E cila, ngado që kaloi, nuk kurseu asgjë, duke i kthyer në kalbësira."

"Edhe te fisi Themud (ka mësim)**, kur iu tha anëtarëve të tij: 'Kënaquni njëfarë kohe!'"**

"Ata u treguan mendjemëdhenj ndaj urdhrave të All'llahut, pastaj i goditi rrufeja, ndërsa e shihnin."

"Por nuk mundën as të ngriheshin, as të mbroheshin prej dënimit."

"(Mësim ka) **edhe te populli i Nuhut,** (që e shkatërruam) **shumë kohë më parë. Me të vërtetë, ai ishte popull i pabindur."**

Komentimi

Mësime të marra nga ndodhitë e popujve të mëparshëm

Në këto ajete, 38-46, Kur'ani, vijon tregimin rreth historive të popujve të tjerë, të cilët kanë jetuar në kohë të hershme historike, fill pasi na ka shënuar historinë e popullit të Lutit dhe përfundimin e tmerrshëm të tyre.

All'llahu i Madhëruar, fillimisht thotë: **"Edhe në historinë e Musait** (ka mësim)**, kur ia dërguam Faraonit, me provë të qartë.".**

Fjala "*es sultan"*, është tërësia e aktiviteteve autoritare që garantojnë pushtetin, në këtë rast nënkuptohet *mrekullia*, ose *argumenti autoritar logjik i ofruar nga intelekti,* mbase dhe të dyja bashkë. Nëpërmjet tyre, Musai u përball me Faraonin.

Shprehja *"sultanin mubijn"*, përmendet në ajete të ndryshme kur'anore. Në më të shumtën e rasteve, përmes saj është nënkuptuar, përgjithësisht, *argument i qartë*, i pastër dhe i pakontestueshëm nga logjika. Ajo që ndodhi, ishte se Faraoni nuk iu dorëzua mrekullive të mëdha të Musait, që ishin një dëshmi e qartë, ku shpalosej lidhja e fortë me All'llahun. Megjithëkëtë, Faraoni nuk e uli kokën dhe hundën përballë argumenteve logjike, por, këmbënguli në arrogancën dhe mendjemadhësinë e tij. All'llahu i Madhëruar e përshkruan kështu reagimin e Faraonit: **"Ai** (Faraoni) **u shmang** (nga besimi)**, së bashku me komandantët e vet dhe tha: 'Musai është magjistar ose i çmendur!'"**.

Fjala *"err rrukn"*, në origjinën gjuhësore, përfaqëson *bazën themelore* ose atë që quhet *"el istiuaneh"* - *"cilindër"*, *"disk"*,[1] pra, pjesën më të rëndësishme të gjithçkaje. Në rastin konkret, kjo fjalë, mund të nënkuptojë bazat ose themelet e trupit të njeriut, që do të thotë se Faraoni ia ktheu plotësisht kurrizin Musait.

Disa të tjerë kanë thënë se fjala *"err rrukn"*, në këtë rast, nënkupton ushtrinë e Faraonit, që do të thotë se ai u mbështet në fuqinë e tij ushtarake, duke i kthyer shpinën të vërtetës. Ka mundësi, gjithashtu, të nënkuptojë se Faraoni, e shmangu veten me vetëdije të plotë nga urdhri i All'llahut, por e shmangu Atë, njëkohësisht, edhe nga njerëzit kryesorë në qeverinë e tij, ashtu si edhe për ushtrinë.[2]

---

[1] Fjala *"el istiuaneh"* është një fjalë arabe. Origjina e saj është fjala perse *"sutun"* – *"shtyllë"*.

[2] Kështu, shkronja *"ba'a"* te fjala *"bi ruknihi"* mund të konsiderohet *"lil musahabeh"* – *"shoqëruese"*, sipas komentimit të parë. Sipas komentimit të dytë,

Është me interes fakti, se si kryeneçët, diktatorët dhe mendjemëdhenjtë bien në kundërshtime të mëdha e të çuditshme, sa herë përpiqen të kundërshtojnë dhe të përgënjeshtrojnë Profetët e All'llahut. Herë i akuzojnë si magjistarë dhe herë si të çmendur. Kjo përbën një kontradiktë e kundërshti të madhe, se magjistarët mendohet të jenë të mençur e të aftë, që të luajnë me iluzionin dhe imtësitë që lidhen me mendjen e njerëzve, për qëllim të mashtrimit të tyre, ndërsa budallai dhe i çmenduri është e kundërta e kësaj gjendjeje.

All'llahu i Madhëruar, tregon në Kur'anin Famëlartë, rreth Faraonit diktator e kryeneç: **"Ne e kapëm atë me ushtrinë e tij dhe e hodhëm në det; ai e meritoi."**.

Fjala "*el jemm*" - "*deti*", përmendet jo vetëm në librat e gjuhës arabe, por edhe në hadithe, nënkupton detin. Është përdorur, gjithashtu, për të nënkuptuar lumenjtë e mëdhenj, siç është dhe lumi Nil.[1]

Fjalia "*fe nebedhnahum*" - "*e hodhëm*", ka për qëllim të tregojë, se Faraoni dhe ushtarët e tij, ishin inferiorë të mëdhenj karshi fuqisë së All'llahut, që e bëri hedhjen e tyre në det të lehtë dhe të papërfillshme, si të ishin diçka e parëndësishme dhe e pavlerë.

---

ajo luan rolin e "*es sebebijeh*" – "*shkaktares*", ndërsa sipas komentimit të tretë, ajo konsiderohet "*shumuese*".

[1] Fjala "*el mulijmu*" dhe "*dhul melameh*", është emër foljor me rrënjën te fjala "*el leum*". Kjo fjalë hyn te kategoria e foljeve "*elame-julimu*". Këto folje nënkuptojnë atë njëri që kryen një veprim, që, në vetvete, është i kritikuar, i papranueshëm. Shembulli i kësaj është një njeri i çuditshëm, i cili kryen veprime të çuditshme. Për më shumë informacion, sqarim dhe detaje, lidhur me historinë e Musait me Faraonin, mund t'i ktheheni fundit të ajetit 136 të sures "El A'araf".

Ndërsa fraza "*ue huve mulijmun*", tregon së ndëshkimi i All'llahut për Faraonin nuk u mjaftua vetëm me zhdukjen e tij, por mundësoi që historia e njerëzimit ta kujtojë atë për veprat e ulëta, kriminale dhe të poshtra. Ai përballet me mallkimin e All'llahut, me fëlliqjen, demaskimin e arrogancës dhe të mendjemadhësisë së tij, duke i zbuluar ato, për t'i bërë të prekshme, të qarta për të gjithë njerëzimin.

Më tej, Kur'ani, njofton për fundin e tmerrshëm që kanë përjetuar dhe disa popuj të tjerë, si për shembull, populli i Adit. All'llahu i Madhëruar thotë: **"**(Mësim ka edhe në historinë) **e fisit Ad, kur i dërguam erën shkatërruese."**.

Era sterile *"er rijhul akijm"*, siç përshkruhet tekstualisht në Kur'an, është ajo erë që nuk vjen e ngarkuar me re shiu, nuk vjen në funksion të pjalmimit të luleve, pra, ajo nuk sjell asnjë dobi në funksion të jetës. Në këtë rast, kemi të bëjmë me një erë që ka vetëm funksion shkatërrues.

Kur'ani përshkruan edhe shpejtësinë e erërave, me të cilat ndëshkoi popullin e Adit, duke thënë: **"E cila, ngado që kaloi, nuk kurseu asgjë, duke i kthyer në kalbësira."**.

Fjala "*err rremijmu"*, e ka origjinën nga fjala "*err rrimetu"*, e ngjashme në formë me fjalën "*el minnetu"*, që nënkupton "*kockat e kalbura"* dhe "*të shpërbëra"*. Ndërsa fjala "*err rrummetu"*, është e ngjashme në formë me fjalën "*el kubbetu",* që nënkupton "*një litar të kalbur"* dhe një fije të vjetruar. Fjala "*err rrimmu",*[1] e ngjashme në formë me fjalën "*el xhinn"*, nënkupton "*ashklat që dalin prej drurit"* apo diçka të ngjashme me "*tagjinë"*. Fjala "*et termijmu"*,

[1] Kthehu te libri "El Mufredat" i Ragibit. Lënda *"Err Rrimmu"*.

nënkupton *"rikonstruksionin"* apo *"restaurimin"* e diçkaje të vjetruar.[1]

Këto tregojnë se shpejtësia e erës, me të cilën All'llahu e ndëshkoi popullin e Adit, nuk ishte një shpejtësi normale, kështu, përveç shkatërrimit të shtëpive dhe rrënimit të vendbanimeve, ajo shkaktonte zjarr me tymra helmues, çka bëri që gjithçka të shkrumbohej plotësisht.

Vërtet! Kjo është fuqia e All'llahut, që i shkatërron zullumqarët dhe diktatorët, duke dërguar për ta erëra me shpejtësi të tmerrshme. Ajo erë mjaftoi për të shkatërruar gjithçka, për të mos lënë pas asgjë prej kujtimit të tyre, asgjë prej mendjemadhësisë, madhështisë së tyre. Asgjë, veç trupave të tyre, shndërruar në kalbësira.

Ajeti i mësipërm është tregues i përgjithshëm e kalimtar, që dëshmon përfundimin e popullit të fortë dhe të pasur të Adit, të këtij populli që banonte në Ahkaf, lokalitet gjeografik mes Amanit dhe Hadremeutit.

Më pas, kriza arriti te populli i Themudit dhe te populli i Salihut, të cilëve All'llahu ua shtyu dënimin për një kohë të dytë. Lidhur me këta popuj, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Edhe te fisi Themud** (ka mësim)**, kur iu tha anëtarëve të tij: 'Kënaquni njëfarë kohe!'"**.

Shprehja *"hatta hijn"*, nënkupton *tri ditët* e përmendura në ajetin 65 të sures "Hud", si kohë e lënë në dispozicion të tyre para ndëshkimit të madh. All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Por, ata e**

[1] Kthehu te libri "Lisanul Arab", ose "El Mufredat", Lënda *"Rrumun"*.

thirrën dhe ai tha: 'Jetoni në shtëpitë tuaja edhe tri ditë! Ky është premtimi i vërtetë!'".

Edhe pse All'llahu i kishte paralajmëruar vazhdimisht ata, me anë të Profetit të Tij, Salih *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, Ai u la në dispozicion edhe tri ditë të tjera, në mënyrë që argumenti i Tij të ishte akoma më i plotë dhe me shpresë se ata do të reflektonin, do të rikujtonin të shkuarën e tyre të zezë, do të bënin kthesë dhe do të pastronin ndryshkun e gjynaheve në shpirtrat dhe në zemrat e tyre, me ujin e kulluar të pendesës.

Disa komentues kanë thënë se gjatë atyre tri ditëve u shfaqën disa shenja të frikshme në trupat e tyre. Në fillim u dolën të verdha, më pas u bënë të kuqe dhe pastaj u shndërruan në ngjyrë të zezë. Këto shenja erdhën si paralajmërim për këta popuj kokëfortë, por fatkeqësisht, asgjë nuk ndikoi për t'i ndryshuar mendjet dhe sjelljet e tyre, ata nuk mundën të zbrisnin prej lartësisë së mendjemadhësisë së tyre.

All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ata u treguan mendjemëdhenj ndaj urdhrave të All'llahut, pastaj i goditi rrufeja, ndërsa e shihnin."**.

Fjala "*at'uen*", buron nga fjala "*el utuv*", e ngjashme në formë me fjalën "*guluvvu*", që nënkupton "*kundërshtinë në fytyrë*". Prej kuptimeve të saj është, gjithashtu, shmangia e adhurimit të All'llahut dhe kundërshtia ndaj Tij. Kështu, nga një vështrim i përgjithshëm i ajetit të mësipërm, kuptohet qartë se këta popuj kanë kundërshtuar sistematikisht thirrjen e Profetit të tyre, Salih, sikur dhe kanë qenë të zhytur në kundërvajtjen e rrezikshme të politeizmit, të adhurimit të putave dhe barërave të tjera të

padrejtësisë. Therja e devesë, që ishte dhe mrekullia më e madhe e Profetit, ishte një nga padrejtësitë dhe poshtërsitë e tyre të mëdha. Kështu, në vend që të reflektonin dhe të pendoheshin, ata ngulën këmbë te zullumi, padrejtësia dhe hutia e madhe.

Një dëshmi e qartë, që lidhet me këtë, është ajeti kur'anor në suren "El A'araf", ku, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Ata e therën devenë dhe i kundërshtuan udhëzimet e Zotit të tyre. Ata thanë: 'O Salih! Na i ofro gjithçka na ke premtuar, nëse pretendon se je prej të Dërguarve!'"**.

Kështu, fjala "*es saikah*" dhe fjala "*es sakiah*", kanë kuptime të përafërta, për të mos thënë të ngjashme. Kuptimi i tyre, në origjinë, me pak ndryshim nga njëra-tjetra, është "*vetëtima* e shoqëruar me *një zë të fortë dhe të frikshëm*". Ndryshimi kuptimor mes këtyre dy fjalëve, qëndron në faktin se fjala "*es saikah*", është ajo që ndodh me dukuritë qiellore, ndërsa fjala "*es sakiah*", është ajo që ndodh me dukuritë tokësore.

Gjuhëtarët arabë kanë thënë se fjala "*es saikah*", ndonjë herë nënkupton "*vdekjen*" dhe herë të tjera "*ndëshkimin*" ose "*zjarrin*". Kjo fjalë është përdorur zakonisht për të nënkuptuar "*zërin e fortë që buron nga qielli*", shoqëruar dhe prej një zjarri shkatërrimtar.

Ashtu si e kemi përmendur edhe më parë, kur retë e mbarsura me ngarkesa elektrike pozitive, afrohen me Tokën dhe bien në kontakt me ngarkesat e saj negative, ndodh një ndriçim madhështor në formën e një drite të fortë, që shoqërohet më një zë të frikshëm, bubullima, një flakë që ndez ç'të gjejë para dhe trondit nga themelet mbarë vendin.

Kjo fjalë është përmendur me të njëjtin kuptim edhe herë të tjera në Kur'anin Famëlartë, si për shembull në ajetin 19 të sures "El Bekare: **"I mbyllin veshët me gishtat e tyre, për të mos dëgjuar ushtimën nga frika e vdekjes. Kështu, All'llahu i ka nën kontroll mohuesit!"**.

Ajeti 45, prej ajeteve në fjalë, tregon realitetin e këtij populli kryeneç e të pabindur: **"Por nuk mundën as të ngriheshin, as të mbroheshin prej dënimit."**.

Vërtet, kjo është forma me të cilën vetëtima (rrufeja) shkatërron gjithçka, teksa bie në Tokë. Askush nuk ka mundur të ngrihet prej vendit, askush nuk mund të bëjë zë apo të kërkojë ndihmë. Kjo është mënyra me të cilën u shkatërrua populli i Salihut, duke u kthyer, kështu, në shembull edhe për popuj të tjerë.

Populli i Salihut (Themudit) ishte një prej fiseve arabe që kishin banuar në vendin e quajtur, El Hixhr, vendndodhja gjeografike e të cilës ishte veriu i Hixhazit. Kjo ka qenë një zonë shumë e fuqishme. Ajo zotëronte pasuri përrallore dhe mundësi të mëdha ekonomike. Pasuria u mundësoi atyre të ndërtonin pallate të bukura dhe kështjella të sofistikuara, por ata u shkatërruan vetëm për shkak të kokëfortësisë dhe mendjemadhësisë së tyre.

Ata refuzuan hapur Fjalën e All'llahut të Madhërishëm, duke bërë në Tokë zullume, padrejtësi e duke adhuruar zota të tjerë, përveç All'llahut. Rrënojat e shkatërrimit të tyre nuk janë asgjë më shumë se sa një mësim i madh dhe shembull për popujt e tjerë.

Në ajetin e fundit, prej ajeteve që po komentojmë, tregohet shkurtimisht edhe përfundimi i popullit të pestë, që është populli i Nuhut. All'llahu i Madhëruar thotë: **"**(Mësim ka) **edhe te populli i Nuhut,** (që e shkatërruam) **shumë kohë më parë. Me të vërtetë, ai ishte popull i pabindur!"**.[1]

Fjala "*fasik*" - "*i prishur*", "*i shthurur*", përdoret për të etiketuar atë njeri që tejkalon kufijtë e lejuar dhe Urdhrat e All'llahut. Atë njeri, që ciflohet dhe përlloçet prej pisllëkut të mohimit, padrejtësisë dhe të gjithë gjynaheve të tjera.

Togfjalëshi "*min kabl*" - "*kohë më parë*", tregon se populli i Faraonit, i Lutit, i Adit dhe i Themudit, ishte njoftuar më parë për përfundim e tmerrshëm që i kishte ndodhur popullit të Nuhut. Por ata nuk kishin nxjerrë mësime prej ngjarjeve që u kishin ndodhur paraardhësve të tyre, kështu që Zoti i ndëshkoi me të njëjtin ndëshkim dhe me të njëjtën formë si ata.

[1] Kemi një "fshirje" dhe një "fshehje" termash e fjalësh në ajetin e mësipërm, ashtu si thotë edhe Ez Zamakhsharij në tefsirin e tij "El Keshshaf". (Shumë kohë më parë ne e shkatërruam popullin e Nuhut). Edhe pse fjala *"ehlekna"* - *"shkatërruam"* nuk është përmendur tek ajetet e mëparshme, mund të themi se prej kësaj fjale mund të përftohet shumë.

Dy hulumtime

1- Format e dënimit të All'llahut

Është e nevojshme t'i kthehemi faktit se në ajetet e mëparshme tregohen historitë e pesë popujve, që kanë jetuar në kohë të hershme historike, siç janë: populli i Lutit, populli i Faraonit, populli i Adit, populli i Themudit dhe populli i Nuhut. Aty flitet për ndëshkimin që morën katër prej tyre, por nuk preket dhe ceket as së afërmi dhe as për së largu, mënyra si u ndëshkua populli i Nuhit.

Po të hulumtojmë me kujdes, vëmë re se secili prej këtyre katër popujve që përmenden në ajetet e mësipërme, është ndëshkuar përmes katër elementeve të mirënjohura nga të gjithë. Kështu, populli i Lutit u ndëshkua me *tërmet* dhe *gurë* të rënë prej qiellit, që do të thotë se u shkatërrua nëpërmjet dheut. Populli i Faraonit u ndëshkua me mbytje në det, pra, *në ujë*. Populli i Adit u ndëshkua nëpërmjet *erës së fortë* shkatërrimtare, ndërsa populli i Themudit u ndëshkua me *flakë vetëtimash*.

Është e vërtetë se të katër këto dukuri nuk konsiderohen elemente, trupa të thjeshtë, pasi secila prej tyre është i përbërë nga trupa të tjerë, megjithatë, askush nuk mund të mohojë se ato përbëjnë katër nga elementet kryesore më të rëndësishme për jetën. Mungesa e një elementi të vetëm prej tyre e bën të pamundur jetën e njeriut mbi tokë. Nisur nga ky fakt, çfarë mund të themi, nëse do t'i eliminonim të gjithë bashkë, këto elemente?!

Vërtet, All'llahu i Madhëruar i shkatërroi këta popuj me anë të elementeve bazë që garantonin jetën e tyre, pa praninë e të

cilave vazhdimësia e jetës mbi tokë do të ishte e pamundur. Ky fakt, është dëshmitari i rëndësishëm i kësaj fuqie të jashtëzakonshme.

Fakti që në rrjedhën e përshkrimeve të ajeteve të mësipërme, nuk gjejmë një sqarim që të përshkruajë mënyrën se si u ndëshkua populli i Nuhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, mund të jetë i lidhur me mundësinë që ata të kenë marrë ndëshkim të ngjashëm me atë të popullit të Faraonit, që do të thotë se mund të jenë goditur prej stuhisë e më pas janë mbytur në det. Nëpërmjet kësaj kuptojmë se Kur'ani, ka shmangur përsëritjen.

2- Erërat pjalmuese dhe erërat sterile

Në ajetet e mësipërme lexuam se populli i Adit u ndëshkua me anë të një ere të fortë, e cila u konsiderua *sterile,* ndërsa në ajetin 22 të sures "El Hixhr" lexojmë: **"Ne, i kemi dërguar erërat për të pjalmuar, për pllenim dhe kemi zbritur prej qiellit ujë!"**.

Edhe pse ajeti i sapopërmendur nënkupton shtyrjen e reve dhe bashkimin e tyre me njëra-tjetrën, me qëllimin e krijimit të shiut, roli i tyre i vërtetë është pllenimi dhe pjalmimi i bimëve. Madje ndodh që, në momente të caktuara, këto erëra nxisin lloje të caktuara kafshësh të pllenohen dhe të çiftëzohen.

Në fakt, kur këto erëra janë të ngarkuara prej All'llahut të Madhëruar me urdhrin për të ndëshkuar e dënuar, në vend që të sjellin gjallëri dhe jetë, ato gjenerojnë shkatërrim. Këtë e gjejmë të përmendur edhe në ajetin 20 të sures "El Kamer", që flet për popullin e Adit: **"e cila i nxirrte njerëzit, sikur të ishin trungje të shkulur hurmash!"**.

Ajetet 47 - 51

وَالسَّمَاءَ بَنَيْنَاهَا بِأَيْدٍ وَإِنَّا لَمُوسِعُونَ٤٧ وَالْأَرْضَ فَرَشْنَاهَا فَنِعْمَ الْمَاهِدُونَ٤٨ وَمِنْ كُلِّ شَيْءٍ خَلَقْنَا زَوْجَيْنِ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ٤٩ فَفِرُّوا إِلَى اللَّهِ إِنِّي لَكُمْ مِنْهُ نَذِيرٌ مُبِينٌ٥٠ وَلَا تَجْعَلُوا مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ إِنِّي لَكُمْ مِنْهُ نَذِيرٌ مُبِينٌ٥١

"Ne e kemi ndërtuar qiellin me fuqinë Tonë dhe Ne e zgjerojmë atë."

"Edhe Tokën e kemi shtruar! Sa shtrues të mrekullueshëm që jemi!"

"Dhe nga çdo gjë, Ne kemi krijuar dy palë, në mënyrë që ju të vini veshin!"

"Prandaj, ikni (prej dënimit) **drejt** (shpërblimit) **All'llahut, se unë vërtet që jam dërguar te ju prej Tij, si paralajmërues i qartë!"**

"Dhe mos adhuroni zot tjetër krahas All'llahut, se unë vërtet që jam dërguar te ju prej Tij, si paralajmërues i qartë!"

Komentimi

Ne e kemi ndërtuar qiellin me fuqinë Tonë dhe ne e zgjerojmë atë

Këto ajete trajtojnë argumentet e madhështisë së All'llahut, që lidhen me botën e krijesave. Në të vërtetë, këto ajete janë vazhdimësi e asaj që përmendëm në ajetet 20-21 të kësaj sureje, ku jepen fakte e argumente të ekzistencës së All'llahut në tokë dhe të vetë qenies njerëzore si krijim. Këto argumente janë, në thelb, dëshmi të qarta të mundësisë së All'llahut të Madhëruar, për të garantuar jetën dhe Ringjalljen. Për këtë arsye, All'llahu, thotë: **"Ne e kemi ndërtuar qiellin me fuqinë Tonë dhe Ne e zgjerojmë atë."**.

Fjala *"el ejdu"* e ngjashme në formë me fjalën *"es sajdu"*, nënkupton *"fuqinë"* dhe *"mundësinë"*. Këto kuptime i gjejmë të përsëritura shpesh në Kur'anin Famëlartë. Ato nënkuptojnë mundësinë dhe fuqinë absolute të All'llahut, për të krijuar qiejt.

Argumentet e kësaj fuqie të madhe janë të qarta dhe të prekshme, pasi madhështia e qiejve dhe mrekullia që përfaqëson Rregullorja Absolute e mirëfunksionimit të tyre, është, në vetvete, një tregues i pakontestueshëm për këtë.[1]

[1] Kanë ndodhur disa gabime prej disa komentuesve, jo vetëm lidhur me këtë rast, ndaj lipset që të ndalemi për një moment.

a- Disa komentues kanë thënë se fjala *"ejdin"* përfaqëson dy kuptime e jo një kuptim të vetëm. Këto dy kuptime janë: *"mundësia"* dhe *"mirësia"*. Edhe pse fjala *"ejd"* nënkupton, nga ana gjuhësore, *"mundësinë"*, shumësi i fjalës *"jed"* është *"ejdi"*, ndërsa shumësi i shumësit të saj është fjala *"ejadi"*, që nënkupton

Lidhur me kuptimin e shprehjes kur'anore: **"Ne e zgjerojmë atë"**, komentuesit kanë dhënë mendime të ndryshme:

Disa prej tyre kanë thënë se, nëpërmjet zgjerimit, gjerësisë, nënkuptohet risku (begatia) që vjen prej All'llahut të Madhëruar për robtë e Tij, me anë të shiut. Disa të tjerë pohojnë se ajo nënkupton zgjerimin e riskut, të begatisë, nga të gjitha anët, kurse disa të tjerë thonë se ajo nënkupton mungesën e nevojës së All'llahut dhe pasurisë së madhe, pasi natyra e gjerësisë së hambarëve të Tij është e tillë, saqë nuk shterojnë kurrë, sido dhe sado e madhe qoftë shpërndarja e sasive të saj.

Po t'i referohemi çështjes së krijimit të qiellit, në fjalinë e mësipërme, në të njëjtën kohë edhe duke marrë parasysh zbulimet e freskëta të shkencëtarëve dhe të astronomëve, që nëpërmjet studimeve dhe vëzhgimeve të tyre të gjata vërtetojnë zgjerimin e vazhdueshëm të ekzistencës, ndalemi në kuptime të mahnitshme të këtij ajeti. Një prej tyre mund të jetë se All'llahu i Madhëruar i ka krijuar qiejt dhe i zgjeron vazhdimisht ato.

Shkenca bashkëkohore moderne tregon se nuk është vetëm toka ajo që, e gjendur nën trysninë e forcave tërheqëse, ushtruar prej universit, zgjerohet vazhdimisht, por edhe qielli, gjithashtu, mbetet vazhdimisht në gjendje zgjerimi. Kjo do të thotë se disa

---

mundësinë dhe mirësinë. Këto dy kuptime i kemi përmendur, gjithashtu, në ajetin 17 të sures "Sad", sipas variantit të komentuesit të famshëm Et Tabrasij (All'llahu e mëshiroftë!), autori i librit "Mexhmaul Bejan", por po i korrigjojmë edhe njëherë këtu.

b- Në librin "El Mu'xhem El Mufehres", të autorit Muhammed Fuad, fjala *"ejd"* në ajetin, objekt i studimit tonë, është përmendur me dy *"j"*, pra *"ejjd"*. Duket që ky lloj iluzioni ka lindur prej disa lloje të shkrimeve të Kur'anit, përndryshe komentuesit e Kur'anit kanë thënë se fjala *"jed"* nënkupton *"mundësinë"*.

prej yjeve të përqendruar në galaktika, largohen me shpejtësi të madhe prej qendrave të galaktikave ku bëjnë pjesë. Ky proces ka ndikimin e tij në zgjerimin e pafundmë të galaktikave.

Në librin e titulluar "Hudud en Nexhum", të autorit Fird Houel thuhet: "Shpejtësia më e madhe, e matur deri tani, e yjeve që largohen nga qendra e galaktikës së tyre, është 66 mijë kilometra në sekondë, ndërsa galaktikat që qëndrojnë më larg saj, referuar mundësisë së shikimit tonë, drita e të cilave është aq e dobët, sa e bën të pamundur matjen e shpejtësisë së saj. Të gjitha fotot e regjistruara në qiell tregojnë rëndësinë e madhe të këtij zbulimi dhe se vija ndarëse mes këtyre galaktikave zgjerohet me më shumë shpejtësi se galaktikat që gjenden më pranë nesh.[1]

Më pas, autori flet rreth shpejtësisë së këtyre galaktikave, "*es sumbuletu, el eklijl*" dhe "*esh shuxha'a*", etj, duke përshkruar kështu në detaje shpejtësinë marramendëse të lëvizjes së tyre.[2]

Të dëgjojmë me vëmendje disa prej shprehjeve të Profesor Jean Eldor: "Përllogaritja më e imët dhe më e saktë e gjatësisë së dallgëzimeve të shkaktuara prej yjeve, ngre mbulesën prej fytyrës së një të vërtete të habitshme dhe njëkohësisht, të çuditshme. Ajo zbulon faktin se tërësia e yjeve që e popullojnë galaktikën tonë, largohen vazhdimisht prej qendrës së tyre me një shpejtësi të madhe. Sa më e madhe të jetë vija ndarëse ndërmjet tyre dhe qendrës, aq më shumë rritet edhe shpejtësia e tyre.

Duket se yjet kanë qenë mbledhur në këtë qendër, që në fillim të herës. Më pas, grupe të mëdha yjesh janë shkëputur prej qendrës, ku secili prej tyre është nisur në një drejtim të caktuar.".

[1] "Hudud en Nuxhum", f. 338-340.
[2] Burimi i mëparshëm.

Prej gjithë këtij procesi, kuptojmë qartësisht se ekzistenca e ka pasur një pikë nisje.[1]

Ndërsa, George Jamov, në librin e tij "Krijimi i botës", për këtë aspekt, thotë: "Në të vërtetë, hapësira e kësaj bote është e përbërë prej miliarda galaktikash, që shtrihen dhe zgjerohen me shpejtësi marramendëse. E vërteta është se bota jonë nuk është në gjendje të palëvizshme dhe çështja e zgjerimit të saj të vazhdueshëm është tashmë e vërtetuar botërisht. Në fakt, vërtetësia e këtij pohimi përgatit për ne çelësin e një depoje të madhe me të fshehta, të cilat ndihmojnë për ta njohur edhe më shumë botën tonë. Kjo paraqet për ne, një tjetër të vërtetë të madhe, që thotë se, nëse bota është në gjendje të vazhdueshme zgjerimi, do të vijë një moment, kur ajo do të jetë në gjendje tkurrjeje të fortë.".[2]

Shkencëtarët e sipërpërmendur, nuk janë të vetmit që e kanë pohuar këtë të vërtetë. Ka edhe shkencëtarë të tjerë, që i kanë përmendur në veprat e tyre këto koncepte. Por, le të mjaftohemi me citimet e përmendura, për të mos u zgjatur më shumë.

Një tjetër fakt që tërheq vëmendjen, është se shprehja kur'anore: **"Ne e zgjerojmë atë"**, tregon vazhdimësinë, pra, procesi i zgjerimit do të jetë proces i vazhdueshëm. Kjo fjali tregon se ky zgjerim ka ekzistuar në të kaluarën, është duke ndodhur tani dhe do të ndodhë edhe në të ardhmen. Këto kuptime janë në përputhje të plotë, edhe me përfundimet e arritura prej shkencës bashkëkohore sot, që thonë se të gjithë yjet

[1] "Bidajetul alem ue nihajetuhu", f. 74-77, e paraqitur shkurtimisht.
[2] "Bidajetul alem ue nihajetuhu", f. 74-77, e paraqitur shkurtimisht.

dhe galaktikat kanë qenë të mbledhura në një qendër të vetme nga fillimi i herës, se ato kanë pasur një peshë specifike dhe rëndesë të jashtëzakonshme. Më pas ndodhi shpërthimi i përmasave të mëdha e të frikshme, i quajtur Big Bang, ku në hapësirë u shpërndanë të gjitha pjesët përbërëse të ekzistencës, të cilat u shfaqën në forma sferike, të rrumbullakëta dhe largohen vazhdimisht me shpejtësi marramendëse prej qendrës nga ku kishin dhe pikënisjen.

Për sa i përket shprehjes së përdorur, për të treguar krijimin e Tokës, në të cilën All'llahu i Madhëruar thotë: **"Sa shtrues të mrekullueshëm që jemi!"**, vëmë re se fjala "*mahidun*" - "*shtrues*", shënon *urtësinë e madhe*, nëpërmjet të cilës, All'llahu i Madhëruar, ka qëllim të tregojë se e ka shtruar Tokën në mënyrën më të përshtatshme dhe komode, për të zhvilluar në të aktivitet jetësor.

Fjala "*el mahidu*", e ka origjinën te fjala "*el mehd*", që nënkupton "*dyshekun që i shtrohet fëmijës*", ose diçka tjetër, ku ai mund të pushojë. Një vend si ky, duhet të jetë shtruar me kujdes, mirë, butë, ngrohtë dhe qetësues. Të gjithë këto elemente, All'llahu i Madhëruar, ia ka garantuar Tokës, në shërbesë të jetës dhe gjallesave në të.

Nga një anë, vëmë re gurët e zbutur të shndërruar në dhè, (tokë), nga ana tjetër, vëmë re ngurtësinë e maleve dhe kores së Tokës. Parë sipas një këndvështrimi të tretë, vëmë re rezistencën e Tokës ndaj baticave dhe zbaticave. Kuptojmë, gjithashtu, se atmosfera që mbështjell Tokën, ul ndjeshëm nxehtësinë e rrezeve të diellit, duke e mbrojtur prej tyre. Kjo shtresë ka kuptimin e një jorgani që mbështjell Tokën dhe e mbron prej trupave qiellorë,

meteorëve jashtëtokësorë që bien vazhdimisht drejt saj. Kështu, ajo, atmosfera, i ndalon këta trupa të depërtojnë e të bien mbi tokë, duke i shpërbërë, sapo bien në kontakt me të, duke i shndërruar në pluhur dhe hi.

Duket qartë, pra, se All'llahu i Madhëruar, i ka krijuar të gjitha kushtet dhe mundësitë e duhura për të strehuar aty njeriun, që konsiderohet si miku i All'llahut të Madhëruar përmbi Tokë.

Pas krijimit të qiejve dhe Tokës, vjen radha e krijimit të krijesave të tjerave të ndryshme, të qiellit dhe të tokës. Vjen radha e krijimit të llojeve të ndryshme të bimëve, për të cilat, All'llahu i Madhëruar, thotë kështu, në ajetin që vijon: **"Dhe nga çdo gjë, Ne kemi krijuar dy palë, në mënyrë që ju të vini veshin!"**.

Shumë komentues besojnë se fjala "*ez zeuxhejn*", për këtë rast, nënkupton llojet e ndryshme të specieve dhe gjallesave. Ajeti është tregues i qartë në llojet e gjallesave që do të mbipopullojnë Tokën, që duken se janë krijuar prej gjithçkaje në çift: çifti i natës dhe i ditës, i dritës dhe i errësirës, i ujit dhe i steres, i diellit dhe i hënës, i mashkullit dhe i femrës, etj.

Ashtu si kemi përmendur dhe më parë, fundi i ajeteve të ngjashme me këto, tregon se palët në këtë rast, mund të mbartin kuptime më të sakta, pasi fjala "*ez zeuxh*" - "*çift*", zakonisht, përdoret për të nënkuptuar mashkullin me femrën, qoftë kjo kafshë apo edhe bimë. Nëse do ta zgjerojmë më tej kuptimin e kësaj fjale, vëmë re se ajo përfshin të gjitha fuqitë e pranishme, nga minusi në plus, nga negativi në pozitiv, thënë shkurt e qartë, nga minus infiniti në plus infinit. Nëse vëmë re më kujdes shprehjen kur'anore, konstatojmë se ajo përfshin të gjitha krijesat,

pa përjashtim, madje, jo vetëm krijesat e gjalla. Kështu, ajo mund të jetë zbuluesja e të vërtetesës, gjithçka krijuar në ekzistencë, në bashkimin e negatives me pozitiven, plusit me minusin, etj. Kjo është një prej çështjeve shkencore të pranuara, tashmë, botërisht, se atomet janë të përbëra prej pjesësh të ndryshme. E para është e ngarkuar me energji negative dhe quhet elektron, kurse e dyta është e ngarkuar me energji pozitive, që quhet proton.

Për këto arsye, fjalën "*esh shej'u'"* nuk mund ta komentojmë vetëm me kafshët dhe bimët, apo vetëm me palë ose lloje. Lidhur me këtë çështje, kemi dhënë një komentim më të detajuar, në fundin e ajetit 7 të sures "Esh Shuara". Vlen të theksojmë këtu, se bashkimi midis dy komenteve është plotësisht i mundur.

Sifjalia: **"në mënyrë që ju të vini veshin"**, tregon çiftëzimin dhe larminë në krijim, ndaj mbetet edhe tregues i qartë, se All'llahu është Një dhe i Vetëm, pasi larmia dhe dytësimi janë cilësi të krijesave, kështu që nuk mund të jenë, kurrsesi, edhe të Krijuesit.

Në hadithin e Imam Ali ibn Musa Riza *(Paqja qoftë mbi të!)* ka tregues të qartë që lidhen me këto kuptime. Ai thotë: *"Të qënit e All'llahut ndryshe nga gjithçka, tregon se Ai nuk ngjason me asgjë e me askënd! Krahasimi i All'llahut me gjithçka, tregon se asgjë nuk mund të krahasohet me Të. E kundërta e dritës është errësira, e kundërta e të thatës është e njoma, e kundërta e ashpërsisë është butësia. Krijimi i tyre dëshmon për Krijuesin!"*. Këtë e gjejmë të qartë në ajetin kur'anor:

"Dhe nga çdo gjë, Ne kemi krijuar dy palë, në mënyrë që ju të vini veshin!".[1]

Më pas, Kur'ani Famëlartë, afron ajkën, rezultanten e hulumtimeve monoteiste të mësipërme, duke thënë: **"Prandaj, ikni** (prej dënimit) **drejt** (shpërblimit të) **All'llahut, se unë vërtet që jam dërguar te ju prej Tij, si paralajmërues i qartë!"**.

Përdorimi i fjalës "*firar*", në këtë rast, është *shprehje e urtësisë dhe e elokuencës së lartë kur'anore*, pasi, në një anë, fjala "*firar*", përdoret për të nënkuptuar *ikjen*, *largimin me shpejtësi*, kur njeriu përballet me ngjarje të frikshme e ndodhi të tmerrshme, ndërsa, në anë tjetër, nënkupton *një vend të qetë* e të sigurt, që njeriu tenton për t'i shpëtuar tmerrit, apo fatkeqësisë, me të cilën përballet. Kështu që kuptimi i ajetit, është: Ata u larguan shpejt prej ashpërsisë dhe egërsisë së besëtytnive të tyre politeiste, prej adhurimit të putave e zotëve të kotë, për te besimi i pastër monoteist, i cili përfaqëson, në vetvete, një vend të qetë, të paqtë e të sigurt.

Ata u larguan shpejt, prej ndëshkimit të All'llahut për te shpëtimi i Tij! **"Prandaj, ikni** (prej dënimit) **drejt** (shpërblimit të) **All'llahut, se unë vërtet që jam dërguar te ju prej Tij, si paralajmërues i qartë!"**.

Ata hoqën dorë prej kundërshtisë ndaj All'llahut dhe kryeneçësisë së tyre, duke u kthyer tek Ai me përulje e pendesë.

Përfundimi është: U larguan shpejt prej punëve të ulëta dhe të ndyra. U larguan prej mosbesimit, mohimit, prej errësirës

[1] "Teuhid Es Saduk", f. 308, sipas versionit të përmendur te "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 49, f. 130.

së injorancës, prej dënimit të përjetshëm të All'llahut, duke u strehuar te Mëshira e të Vërtetit dhe lumturia e përjetshme që afron, Ai!

Për t'i theksuar më shumë këto kuptime, Kur'ani, mbështetet tek adhurimi i All'llahut, të Vetëm, pra, pa i bërë Atij, asnjë ortak në adhurim. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Dhe mos adhuroni zot tjetër krahas All'llahut..."**. Mendojmë, gjithashtu, se ajeti i mëparshëm fton për te besimi në All'llahun e Madhëruar. Kështu, ky ajet bën një ftesë të hapur për të adhuruar All'llahun e Vetëm dhe të Pashoq. Për këtë arsye, përsëritja e fjalisë kur'anore: **"...se unë vërtet që jam dërguar te ju prej Tij, si paralajmërues i qartë!"**, në rastin e parë vjen, si paralajmërim ndaj atyre që janë larguar prej besimit në All'llahun e Madhërishëm, ndërsa në rastin e dytë, është një paralajmërim, që lidhet me politeizmin dhe adhurimin e putave. Kështu që fjalia mbart, në vetvete, dy mesazhe te ndryshme, edhe pse në dukje shfaqet si përsëritje.

Lidhur me kuptimin e ajetit: **"Prandaj, ikni** (prej dënimit) **drejt** (shpërblimit të) **All'llahut"**, transmetohet se Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: *"Kuptimi i kësaj shprehje kur'anore është i lidhur me vizitën e Shtëpisë së All'llahut!" (Qabenë e Shenjtë)*.[1] Në këtë ajet duket qartë se synohet përmendja e një të vërtete të madhe, lidhur me tërësinë e të vërtetave që të çojnë për tek All'llahu. E vërteta është se vizita në *Shtëpinë e All'llahut dhe kryerja e Haxhit* e prezanton njeriun me të vërtetën e monoteizmit, me pendesën, kthimin dhe përuljen ndaj All'llahut të Madhëruar, duke i mundësuar atij strehën për te mirësitë e mëdha të All'llahut të Madhëruar.

[1] Në tefsirin "Nuruth Thekalejn" transmetohen disa hadithe prej dy imamëve, El Bakirit dhe Es Sadikut *(Paqja qoftë mbi ta!)*; vëll. 5, Hadithet 51-52, f. 130-131.

Ajete 52 – 55

كَذَلِكَ مَا أَتَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ مِنْ رَسُولٍ إِلَّا قَالُوا سَاحِرٌ أَوْ مَجْنُونٌ۝٥٢
أَتَوَاصَوْا بِهِ بَلْ هُمْ قَوْمٌ طَاغُونَ۝٥٣ فَتَوَلَّ عَنْهُمْ فَمَا أَنْتَ بِمَلُومٍ۝٥٤
وَذَكِّرْ فَإِنَّ الذِّكْرَى تَنْفَعُ الْمُؤْمِنِينَ۝٥٥

“Kështu, sa herë që një i Dërguar vinte te popujt para tyre (mekasve)**, ata thoshin: ‘Është magjistar’ ose “’Është i çmendur’!”**

“Vallë, a mos ia kanë pasuar këtë njëri-tjetrit? Jo, por ata vetë janë popull që e kanë tepruar!”

“Prandaj shmangu prej atyre; ti nuk do të qortohesh për këtë!”

“Por këshillo, se vërtet këshilla u bën dobi besimtarëve.”

Komentimi

Këshilla u bën dobi besimtarëve

Në ajetin 39 të kësaj sureje, lexojmë se, kur Musai *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* e thirri Faraonin të besojë në All’llah dhe të heqë dorë prej padrejtësive, Faraoni e quajti magjistar dhe të çmendur. Akuzat e Faraonit për Musain, u përdorën edhe prej

politeistëve mekas, për të akuzuar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Sa herë mekasit jobesimtarë, e akuzonin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me të njëjtat akuza që Faraoni akuzonte Musain *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, ata pak besimtarë që e donin, e mbronin dhe përkujdeseshin për të, ndienin dhimbje të madhe, madje, dhe vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndiente dhimbje, sa herë përballej me to.

Kështu, pra, ajetet që po komentojmë, kishin qëllim të qetësonin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe besimtarët. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kështu, sa herë që një i Dërguar vinte te popujt para tyre** (mekasve)**, ata thoshin: 'Është magjistar' ose 'Është i çmendur'!"**.

Në kohët e para, jobesimtarët i akuzonin Profetët si magjistarë, sepse e kishin të pamundur të jepnin përgjigje për mrekullitë madhështore që ata shfaqnin. Ata i cilësonin Profetët si njerëz të çmendur. Kjo ndodhte, sepse Profetët nuk ishin të poshtër si ata, nuk pranonin të merrnin ngjyrën e mjedisit që i rrethonte, nuk josheshin prej ofertave dhe të mirave materiale.

Nisur nga sa përmendëm më sipër, kuptojmë se besimtarët nuk duhet të demoralizohen, por duhet të vazhdojnë në Rrugën e Drejtë me durim dhe këmbëngulje, se me fjalë të tilla fyese dhe poshtëruese, janë etiketuar edhe të ngjashmit e tyre, Profetët, burra të drejtë, besimtarë dhe të ndershëm, si dhe i Dërguari i All'llahut.

Më tej, Kur'ani shton se popujt mohues, pra, jobesimtarë, ndoqën stilin e njëri-tjetrit, duke i akuzuar, Profetët, me të njëjtat

akuza përgjatë gjithë historisë. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Vallë, a mos ia kanë pasuar këtë njëri-tjetrit...?"**.

Është i çuditshëm fakti, që veprimet e këtyre popujve kanë qenë në një shkallë të lartë koordinimi dhe harmonie. Duket sikur ata janë mbledhur në një takim të fshehtë, prapa dyerve të historisë, janë këshilluar me njëri-tjetrin e kanë rënë dakord, që të fabrikojnë për Profetët e All'llahut të njëjtat akuza. Kanë rënë në ujdi t'i quajnë magjistarë e njerëz të çmendur, për t'ua ulur sado pak ndikimin e madh që ata kishin në zemrat e njerëzve.

Duket, pra, se të gjithë jobesimtarët kanë rënë dakord, që para se të largohen nga kjo botë, t'ua lenë amanet brezave pasues, akuzat me të cilat duhet të sulmojnë të Dërguarit e All'llahut.

Më pas, Kur'ani, shkon edhe më tej, teksa thotë **"...Jo, por ata vetë janë popull që e kanë tepruar!"**.[1]

Natyrshëm, këto janë sekrecione që çlirohen prej shpirtit të refuzimit, që kërkon mbështetje te mashtrimi, shpifjet dhe akuzat e ulëta. Qëllimi i tyre përfundimtar është zhdukja, mbytja e zërit dhe zhdukja e plotë e pranisë së tyre. Duke qenë se Profetët janë dërguar nga All'llahu i Madhëruar, për t'u prezantuar në popujt e tyre të armatosur gjer në dhëmbë me shenja të mëdha mrekullie, mënyra më e përshtatshme për t'i neutralizuar ndikimet e këtyre mrekullive, ishte akuza ndaj tyre si magjistarë dhe njerëz të çmendur. Referuar kësaj metode të përzgjedhur prej jobesimtarëve, shpaloset qartë uniteti i të keqes në veprim, që, në të njëjtën kohë, tregon edhe shpirtligësinë e tyre.

[1] Fjala *"bel"*, në ajetin e mëparshëm, është *"lil edrab"*.

Për të siguruar qetësi dhe më shumë lumturi në zemrën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Kur'ani shton: **"Prandaj shmangu prej atyre..."**.

Duhet të jesh i qetë dhe i sigurt, o i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi ti e ke përmbushur me sukses misionin me të cilin All'llahu i Madhëruar të ngarkoi. Për këtë arsye, vjen edhe shprehja në fund të ajetit, ku All'llahu i Madhëruar, thotë: **"...ti nuk do të qortohesh për këtë!"**.

Edhe nëse ata nuk i përgjigjen të vërtetës, ti mos u mërzit, o i Dërguari i All'llahut, sepse rrotull teje ka të tjera zemra që janë të etura për Rrugën e Drejtë. Janë ato zemra që do të mbajnë amanetin, janë ato zemra që po e presin atë.

Kjo fjali na kujton ajetet e mëparshme, që tregojnë qartë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndiente dhembshuri për popullin e tij e i digjej zemra, me qëllimin e vetëm që ata të besonin All'llahun. Mohimi dhe refuzimi i tyre ndikonte shumë keq tek ai, madje, deri në atë masë sa mund të dëmtonte edhe vetveten.

Në ajetin 6 të sures "El Kehf": **"A mos vallë do të shkatërrosh veten tënde nga pikëllimi, nëse ata, fatkeqësisht, nuk besojnë në këtë Fjalë** (Kur'anin)**?!"**

Natyrshëm, kjo përbën gjendjen normale të udhëheqësve të vërtetë, që e ndiejnë thellë fatin e popujve të tyre.

Komentuesit e Kur'anit kanë thënë se, kur ka zbritur ky ajet, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe besimtarët u trishtuan shumë, pasi kujtuan

se ky ishte mesazhi i fundit për jobesimtarët. Ata menduan se Shpallja e All'llahut do të ndërpritej këtu, me këtë ajet, prandaj dhe kjo i bëri të frikësohen, se ndëshkimi i ashpër i All'llahut të Madhëruar mund të ishte fare pranë.

Fatmirësisht, nuk ndodhi ashtu. Nuk kaloi shumë kohë dhe zbriti ajeti në vijim, ku All'llahu i Madhëruar i kërkon Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që t'i këshillojë ata: **"Por këshillo, se vërtet këshilla u bën dobi besimtarëve."**.[1] Kur zbriti ky ajet, zemrat e tyre u qetësuan.

Ajeti dëshmon se, në mesin e mohuesve jobesimtarë, ka zemra të hapura për besimin, të gatshme për ta pritur fjalën dhe mesazhin tënd, o i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Edhe nëse një pjesë e tyre kundërshtojnë dhe ngrihen përballë të vërtetës, duhet ta dish se mes tyre ka njerëz që mezi presin ta shpalosin përkatësinë prej thellësisë së zemrave dhe shpirtrave ndaj të vërtetës. Janë, pikërisht, ata njerëz që janë prekur dhe janë emocionuar prej butësisë së fjalëve të tua.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 161.

Hulumtim

Zemrat e gatshme për të pritur të vërtetën, janë të domosdoshme

Marrim, si shembull, fshatarin që hedh në tokën e tij farën. Disa fara do të bien nëpër gurë. Të gjithë e dimë se fara që bie mbi gurë, nuk mund të rritet, që më pas të lulëzojë.

Disa prej këtyre farërave, bien në shtresa të buta dheu që mbulojnë gurë. Ato lëshojnë rrënjët e tyre aty, por ngurtësia e shtresës nën të nuk i ndihmon aspak rrënjët të shtrihen. Në këtë rast, farërat thahen më shpejt dhe rrënjët "vdesin".

Një pjesë tjetër e farërave, bie në tokë të përshtatshme, por ferrat dhe gjembat që mbijnë përreth saj, nuk e lenë të rritet. Sapo nis të çelë e të lulëzojë, ferrat dhe gjembat e mbulojnë, derisa thahet përfundimisht.

Te vetmet farëra që kanë fatin e mirë, janë ato që bien në tokë të përshtatshme mbi dhè të butë dhe nuk pengohen prej bimëve të egra. Kështu që pas një kohe të caktuar, bima fillon të rritet, të çelë lule, të piqet dhe të japë frytet e saj.

Kështu, si këto farëra janë edhe fjalët që dalin prej gojës të Profetëve, të Dërguarve të All'llahut, këtyre krijesave të Tij të pagabueshme. Zemrat e ngurta nuk i pranojnë që në pikënisje fjalët e tyre. Zemrat e buta i pranojnë përkohësisht ato, kurse më pas dobësohen dhe heqin dorë. Janë edhe disa lloj zemrash që janë të dëshiruara për t'i pranuar ato fjalë, por dëshirat, epshet

dhe veset e tyre të liga, kanë mbirë në ato zemra. Kështu që e bëjnë të pamundur ndikimin e të vërtetës në to.

Të vetmet zemra që i pranojnë fjalët e këtyre Imamëve të mëdhenj, të vetmet zemra ku mbijnë dhe japin fryte fjalët e tyre, janë zemrat e vëna në kërkim të së vërtetës. Kjo është një cilësi e dukshme, që mbizotëron në aktivitetin e këtyre zemrave. Këto janë zemrat e qëruara prej veseve të këqija dhe qëllimeve të botës kalimtare. Këto, pra, janë zemrat e besimtarëve të vërtetë.

Nuk ka dyshim se All'llahu ka të drejtë kur, thotë: **"Por këshillo, se vërtet këshilla u bën dobi besimtarëve."**.

Ajetet 56 – 58

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ٥٦ مَا أُرِيدُ مِنْهُمْ مِنْ رِزْقٍ وَمَا أُرِيدُ أَنْ يُطْعِمُونِ٥٧ إِنَّ اللَّهَ هُوَ الرَّزَّاقُ ذُو الْقُوَّةِ الْمَتِينُ٥٨

"Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë."

"Unë nuk kërkoj prej tyre risk, as nuk dëshiroj që të Më ushqejnë."

"Vërtet, All'llahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi."

Komentimi

Qëllimi i krijimit të njeriut, nga pikëpamja e Kur'anit

Një prej pyetjeve më të rëndësishme, që lind në mendjen e çdo njeriu, është: Përse jemi krijuar?! Cili është qëllimi i krijimit të njeriut? Cila është arsyeja e ardhjes së tij në këtë botë?!

Nëpërmjet frazave të shkurtra që mbartin kuptime të mëdha, ajetet e sipërpërmendura ofrojnë përgjigje për këto pyetje të rëndësishme e të përgjithshme. Në fund të ajeteve të sipërpërmendura, hulumtimi vijon duke u kujtuar dhe duke u treguar besimtarëve se kjo ishte metoda që ndiqej edhe prej vetë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)***.** Aty, njëkohësisht, sqarohet edhe kuptimi i vërshimit për tek All'llahu i Madhëruar, që përmendet në ajetin e mësipërm.

Ajetet tregojnë atë që All'llahu i Madhëruar thotë: **"Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë."**.

Ato shpalosin një të vërtetë të madhe, që konsiston në faktin se All'llahu i Madhëruar nuk ka nevojë për asnjërin prej tyre, që të sigurojë ekzistencën e Tij, duke thënë: **"Unë nuk kërkoj prej tyre risk, as nuk dëshiroj që të Më ushqejnë."**.

Përkundrazi, është All'llahu i Madhëruar, Ai që i furnizon me risk krijesat e veta. Kjo duket, kur All'llahu, thotë: **"Vërtet, All'llahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi."**.

Kështu, këto ajete që paraqiten në formën e tyre më të shkurtër dhe më të thjeshtë, zbulojnë të vërtetën e madhe, në kërkim të së cilës janë të gjithë njerëzit. Ata duan të njihen me të, sepse ajo është e vetmja që mund t'i përballë me qëllimin madhor të ekzistencës.

Sqarim: Nuk ka dyshim se çdo individ që gëzon mendje të shëndoshë dhe urtësi, pas çdo vepre apo aktiviteti që kryen, ka

një qëllim të caktuar apo një pikësynim. Duke qenë se All'llahu i Madhëruar është zotëruesi i dijes dhe i urtësisë absolute, krahasimi i Tij, me këdo tjetër, është i paarsyeshëm. Këtu shfaqet një pyetje shumë e rëndësishme: Përse All'llahu i Madhëruar e krijoi njeriun?! Mos vallë, All'llahu, kishte ndonjë mangësi dhe duke krijuar njeriun, plotësoi boshllëkun që kishte?! Mos vallë, All'llahu kishte nevojë për diçka të caktuar dhe duke krijuar njeriun, e shmangu këtë nevojë?!

Në anën tjetër, ne e dimë dhe e pranojmë se ekzistenca e All'llahut është absolutisht e plotësuar në të gjitha aspektet dhe e zhveshur nga çdo mangësi dhe e metë. Ai është i pa Kufi, në pakufishmëri. Ai është i vetëplotësuar në Qenien e Tij.

Nëse i referohemi thënies së parë, duhet të pranojmë se All'llahu e kishte një qëllim, kur e krijoi njeriun, ndërsa po t'i referohemi thënies së dytë, duhet të pranojmë se qëllimi i krijimi të njeriut, nuk është diçka që lidhet dhe kthehet te Qenia e All'llahut të Madhëruar.

Përfundimisht, qëllimi i krijimit të njeriut duhet të kërkohet përtej Qenies së Tij, pasi ai lidhet me vetë krijesat. Qëllimi i krijimit, në vetvete, përfaqëson themelet e plotësimit si krijim. Ky është dhe një aspekt i rëndësishëm i çështjes.

Nga ana tjetër, në Kur'an janë përmendur shprehje të shumta dhe të ndryshme, që lidhen me krijimin e njeriut dhe qëllimin e krijimit.

Në njërin prej këtyre ajeteve, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Ai e ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'iu provuar se kush prej**

jush do të veprojë më mirë! Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh!".[1]

Pra, këtu paraqitet çështja e sprovës që njeriu kalon në këtë botë dhe veprat e tij të mira, si një nga qëllimet e krijimit të njeriut.

Në një ajet tjetër, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"All'llahu është Ai që ka krijuar shtatë qiej dhe po aq Toka. Urdhrat e Tij zbresin përmes tyre, që ju ta dini së All'llahu është i fuqishëm për çdo gjë, dhe Ai përfshin gjithçka me diturinë e Tij!"**.[2]

Në këtë ajet, duket qartë se dituria rreth diturisë së All'llahut dhe fuqisë së Tij, është qëllimi i krijimit të qiejve, Tokës dhe gjithçkaje që gjendet mes tyre.

Në një ajet tjetër, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t'i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdojnë të jenë të përçarë, përveç atyre, që i ka mëshiruar Zoti yt. Për këtë qëllim Ai i krijoi ata. Do të plotësohet Fjala e Zotit tënd: 'Me të vërtetë që do ta mbushë Xhehennemin me xhindë dhe njerëz bashkarish!'"**.[3]

Sipas këtyre dy ajeteve, rezulton se qëllimi i krijimit të njeriut është Mëshira e All'llahut.

Ajetet, objekt i studimit tonë, përqendrohen vetëm te çështja e adhurimit. Ato shprehen qartë, lidhur me këtë dhe e përcaktojnë po aq saktë që adhurimi është qëllimi final i krijimit të xhindëve dhe njerëzve.

---

[1] Sure "El Mulk", ajeti 2.
[2] Sure "Et Talak", ajeti 12.
[3] Sure "Hud", ajetet 118-119.

Me pak meditim në kuptimet e këtyre ajeteve dhe të ngjashmeve të tyre, vëmë re se nuk ka asnjë ndryshim dhe asnjë kundërshti mes tyre. Në të vërtetë, ato e klasifikojnë qëllimin e krijimit në katër pjesë. *Qëllim i parë, qëllim i mesëm, qëllim final* dhe disa prej tyre janë *përfundimi* apo *rezultantja*.

Kështu, qëllimi madhor i krijimit të njeriut është adhurimi i All'llahut. Ky fakt bëhet i qartë në ajetet që po studiojmë. Për sa i përket dijes së All'llahut, provës së përcaktuar për njeriun dhe aspekte të tjera të ngjashme me to, themi që këto janë qëllime të përfshira në rrugëtimin e adhurimit të All'llahut, ndërsa mëshira e madhe e All'llahut është rezultati i këtij rrugëtimi adhurues.

Në këtë mënyrë, bëhet e qartë se ne jemi krijuar për të adhuruar All'llahun e Madhërishëm, por më e rëndësishme se sa vetë kjo, është të arrijmë të perceptojmë e të kuptojmë thelbin dhe të vërtetën e adhurimit.

A mund të themi se qëllimi i adhurimit është thjesht kryerja e ritualeve ditore adhuruese dhe e të ngjashmeve me to, siç është *rukuja, sexhdja, falja e namazit* dhe *agjërimi*?! Apo duhet të shohim përtej këtyre formaliteteve adhuruese dhe të përqendrohemi në thelbin e tyre?! Kjo, sigurisht, që nuk e pakëson për asnjë moment rëndësinë e këtyre formaliteteve.

Për t'i dhënë një përgjigje kësaj pyetjeje, duhet më parë të kuptojmë dhe të analizojmë se çfarë nënkuptojnë fjalët: "*el abdu*" - "*robi*" dhe "*el ubudijetu*" - "*adhurim*".

Fjala "*el abdu*" - "*robi*", në gjuhën arabe, nënkupton "*një njeri të lidhur me pronarin e tij*" tërësisht nga koka deri te këmbët. Vullneti i tij lëviz në përputhje të plotë me vullnetin e pronarit të

tij. Gjithçka që kërkon dhe dëshiron, duhet të përputhet me dëshirat dhe qëllimet e zotërisë së tij, i cili e ka në pronësi. Ai nuk ka asnjë të drejtë ndaj tij dhe është i detyruar të zbatojë me përpikëri urdhrat e tij.

Thënë me fjalë të tjera, robëria, siç paraqitet në librat e gjuhës arabe, është forma më e lartë e shprehjes së nënshtrimit ndaj padronit apo të adhuruarit. Nisur nga ky përkufizim, themi se i vetmi i adhuruar, që i takon me të drejtë adhurimi, është Ai, që i ka furnizuar adhuruesit me të gjitha format e mirësisë dhe të begatisë. Kjo nuk vlen për askënd tjetër, përveç All'llahut të Madhëruar.

Për këtë arsye, mund të themi se adhurimi dhe nënshtrimi janë kulmi i plotësimit dhe shkalla më e lartë e afrimitetit të njeriut me All'llahun. Adhurimi është kulmi i dorëzimit ndaj Qenies së Tij të Shenjtë.

Adhurimi, në vetvete, është nënshtrim pa kushte, është dorëzim tërësor ndaj Urdhëresave të All'llahut, për të gjitha rastet.

Përfundimisht, forma më spektakolare dhe më e plotë e adhurimit është, kur njeriu nuk mendon për asgjë tjetër, përveçse për të Adhuruarin *(shkalla absolute)*, lëviz vazhdimisht sipas rregullave dhe dispozitave të Krijuesit, si dhe harron gjithçka tjetër përveç Tij, madje edhe veten.

Ky është qëllimi kryesor i krijimit të njeriut, për arritjen e të cilit All'llahu e ka përballur robin e Tij në sprova të ndryshme. Në funksion të këtij qëllimi, Ai i dhuroi njeriut dije dhe njohuri, dhe

vendosi që përfundimi i gjithë këtij adhurimi të jetë përfshirja në mëshirën e Tij të madhe.

Hulumtime

1- All'llahu është absolutisht i Vetëmjaftuar dhe i Pasur

Ajeti kur'anor në të cilin All'llahu i Madhëruar thotë: **"Unë nuk kërkoj prej tyre risk, as nuk dëshiroj që të më ushqejnë!"**, është, në vetvete, tregues i qartë, se All'llahu është i Vetëmjaftuar dhe i Pasur ndaj gjithçkaje, veç Tij. Prandaj, ftesa e Tij për adhurim, që ua drejton krijesave të Veta, nuk lidhet me ndonjë nevojë apo përfitim që Ai ka prej tyre, por dëshiron që adhurimi të bëhet shkak për ata, të përfitojnë nga mirësitë e Tij të pafundme. Ky lloj adhurimi është i ndryshëm nga robëria dhe skllavëria, që rëndom konsumohet mes njerëzve.

Njerëzit kanë nevojë për skllevër, sepse nëpërmjet tyre nxjerrin përfitime dhe sigurojnë jetesën e tyre. Ata mund t'i përdorin, gjithashtu, skllevërit, edhe për t'u shërbyer për punët e shtëpive të tyre, për t'u sjellë ushqim, ose pije, sa herë që urdhërojnë. Pra, në të dy rastet, përfitimi shkon për padronët e tyre. Kjo dukuri është e lidhur me nevojat që njeriu ka për shërbimet e tij, por, në anën tjetër, këto kuptime nuk kanë asnjë lidhje me raportin që adhuruesi ka me të Adhuruarin, në rastin konkret me All'llahun e Plotfuqishëm. All'llahu, jo vetëm që nuk ka nevojë për krijesat e Tij, por është pikërisht, Ai, që me bujarinë

e Tij i siguron dhe i furnizon ato pafundësisht me mirësi dhe risk. "Risku i të gjitha krijesave, është i siguruar prej All'llahut!"

2- All'llahu është zotëruesi i forcës së palëkundur

Fjala "*el metijnu*", përmendur në fund të ajeteve, objekt i studimit tonë, e ka origjinën te fjala "*metn*". Kjo fjalë nënkupton *sasinë e mishit* dhe të *nervave* që rrethojnë shtyllën kurrizore dhe e ndihmojnë atë të jetë e fortë, e qëndrueshme dhe e palëkundur. Ato i japin kurrizit mundësi që të mbajë ngarkesa të ndryshme. Për këtë arsye, fjala "*el metn*", përdoret për të nënkuptuar fuqinë e madhe, energjinë, aftësinë e plotë. Kështu që përmendja në ajet e fjalës "*el metijnu*", fill pas fjalës "*dhul kuveti*", ka për qëllim "*përforcimin*" dhe "*mbështetjen*", pasi fjala "*dhul kuveti*", tregon fuqinë e All'llahut, ndërsa fjala "*el metijnu*", nënkupton absolutizmin e asaj fuqie.

Kur shohim se kjo fjalë shoqërohet dhe prej fjalës "*err rrezaku*" - "*furnizues me risk*", që përmendet në shkallën sipërore, atëherë kuptojmë se ajo tregon një tjetër të vërtetë. Kjo e vërtetë, qëndron në faktin se All'llahu i Madhëruar është i Plotfuqishëm dhe zotërues i mundësisë së vetme, për të furnizuar me risk kë të dëshirojë prej krijesave të Tij. Ai ka mundësi të plotë për ta shpërndarë riskun dhe për ta dërguar atë në të gjitha anët, ku vullneti i Tij vendos për ta dërguar. Ai e shpërndan atë në thellësi të deteve, mbi majat e maleve, në brezaret e kodrave, brigjet e lumenjve, luginave, fushave dhe shkretëtirave, ku të gjitha krijesat që Ai krijoi, mblidhen në sofrën e Tij bujare. Kështu, All'llahu nuk i krijoi njerëzit dhe të gjitha krijesat e tjera, ngaqë

kishte ndonjë nevojë për to, por për t'i mbuluar ato me mirësitë e Tij të mëdha.

3- Përse xhindët u përmendën përpara njerëzve?!

Prej ajeteve të ndryshme kur'anore kuptohet qartë se njerëzit janë më të mirë se xhindët, por, në anën tjetër, vërejmë se xhindët janë përmendur para njerëzve. Nëse i referohemi një vështrimi sipërfaqësor, kuptojmë se xhindët janë krijuar në kohë para njerëzve, pra, para krijimit të Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Këtë e lexojmë në ajetin 27 të sures "El Hixhr". All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kurse para tij kemi krijuar xhindët nga zjarri pa tym!"**.

4- Urtësia e krijimit, në pikëpamjen e filozofisë

Ashtu si e kemi përmendur dhe më parë, është vështirë të gjesh një njeri, që të mos pyesë veten apo dikë tjetër, rreth qëllimit të krijimit të njeriut. Vazhdimisht lindin grupe njerëzish për të nisur jetën, ndërsa grupe të tjera shuhen e largohen përfundimisht nga kjo jetë. Atëherë, cili është qëllimi i këtyre ardhjeve dhe largimeve të pafundme?!

Nëse njerëzit, nuk do të kishin jetuar mbi këtë tokë, atëherë çfarë do të kishte ndodhur?! A është vërtet e nevojshme të dimë, cila është arsyeja pse kemi ardhur në këtë botë dhe përse do të largohemi sërish?! Nëse dëshirojmë ta mësojmë këtë të fshehtë, cila është mënyra për ta bërë këtë?! Këto dhe pyetje të tjera si këto, e vizitojnë dhe rrethojnë në vazhdimësi mendjen e njeriut.

Kur këto pyetje drejtohen nga materialistët, duket qartë se ata nuk e kanë ende një përgjigje për to. Mungesa e përgjigjes së tyre, lidhet me pamundësinë e materies apo natyrës për të dhënë përgjigje, pasi ato nuk janë pajisur me mendje dhe ndjenja. Kështu që është e pamundur për ata të kenë një qëllim. Pra, ata e kanë shkarkuar veten prej barrës së kësaj pyetjeje të madhe e të rëndë, pasi kanë folur për teorinë e rastësisë në krijim. Si e tillë, ajo nuk mund të ketë një qëllim të caktuar. Po ta mendosh këtë imtësisht, shikon se sa e frikshme dhe tronditëse është që gjithë aktiviteti jetësor i njeriut të lidhet vetëm me fraksione programesh jetësore, me qëllime dhe veprimtari që lidhen me punën, shëndetin, fitimin apo aktivitete sportive. Sa vështirë është të mendosh që njeriu beson se tërësia e aktivitetit të tij jetësor është thjesht rastësi apo lojë dhe argëtim?!

Për këtë arsye, nuk është habi, kur të shohësh materialistët, që, kur mendojnë për çështje të tilla, heqin dorë prej kësaj jete nëpërmjet vetëvrasjeve, pasi mendojnë se ekzistenca e njeriut nuk ka më asnjë qëllim.

Sa herë përballet me kësi pyetjesh, njeriu që beson All'llahun, nuk e gjen kurrë të mbyllur rrugën para tij. Ai e di mirë se Krijuesi i Gjithësisë është i pajisur me urtësi absolute, se ky krijim i mrekullueshëm ka urtësi, edhe pse ne e kemi të pamundur ta perceptojmë atë. Kjo është njëra anë e medaljes, ndërsa, ana tjetër, është kur njeriu mediton rreth organeve të tij, ku përballet me një pafundësi urtësish, filozofish dhe qëllimesh. Kjo nuk lidhet vetëm me organet e rëndësishme jetike, siç janë: zemra, gjuha, damarët dhe nervat, por edhe me thonjtë, vijat e dorës, harkun e tabanit të këmbës, formën e dorës dhe imtësi të tjera që lidhen me të. Të gjitha këto përfaqësojnë, në vetvete, një

filozofi të caktuar, të cilën sot e përcakton qartë shkenca bashkëkohore.

Atëherë, a nuk është naivitet të flasësh për urtësinë e krijimit të këtyre organeve të mrekullueshme dhe pastaj të deklarosh se tërësia e tyre nuk ka qëllim? Është gjykim i dobët të thuash se secila prej ndërtesave të qytetit e ka një filozofi, kurse i gjithë qyteti, marrë së bashku, nuk përfaqëson një filozofi dhe një qëllim.

A është e mundur vallë, që një inxhinier të ndërtojë një ndërtesë të lartë, shumëkatëshe, me dhoma, dyer, dritare, pishina, kopshte, dekore të ndryshme, shatërvanë, dhe secili prej këtyre detajeve të ketë një qëllim të caktuar në vetvete, kurse të gjithë bashkë nuk kanë ndonjë qëllim?!

Të gjitha këto e frymëzojnë atë që beson në All'llah, me lumturi shpirtërore dhe qetësi. Besimtari e ndien, se, pas krijimit të tij, ka një qëllim madhështor, se ai duhet të përpiqet pafundësisht për ta kuptuar atë qëllim, nëpërmjet fuqisë së dijes dhe mendjes.

Bën habi fakti, se si teoricienët e rastësisë në krijim, përpiqen me të gjitha mënyrat të gjejnë shpjegime dhe qëllime për dukuritë e ndryshme biologjike, me të cilat përballen. Ata nuk janë të gatshëm të pranojnë, se një gjëndër e vetme në trupin e njeriut nuk është funksionale, por ngulin këmbë, duke thënë se e ka një qëllim. Ata mund të shpenzojnë vite të tëra me punë kërkimore dhe shkencore, për të përcaktuar qëllimin e ekzistencës së një gjëndre të tillë në trupin e njeriut, por, kur përballen me krijimin e njeriut, me tërësinë e tij, deklarojnë hapur pretendimin absurd, se pas gjithë këtij krijimi të mahnitshëm nuk ka ndonjë

qëllim. Kjo përbën, në të vërtetë, një kontradiktë dhe paradoks të madh.

Në të gjitha rastet, besimi në ekzistencën e Urtësisë së All'llahut dhe, në anën tjetër, përqendrimi në filozofinë që përfaqëson secili prej segmenteve të krijimit të njeriut, na shtyn të besojmë, se pas aktit të krijimit të njeriut, ka një qëllim madhor dhe shumë të rëndësishëm.

Është detyra jonë të vihemi në kërkim të këtij qëllimi, ta identifikojmë atë sa më qartë dhe pastaj të lëvizim dhe të orientohemi sipas rregullave të legjislacionit të Tij perfekt.

Nëse do të vërejmë me kujdes disa të dhëna paraprake, ato mund të hedhin dritë mbi qëllimin tonë, për ta zbuluar këtë të panjohur të errët:

1- Ne kemi gjithmonë një qëllim të caktuar pas kryerjes së një vepre. Ky qëllim është zakonisht përmbushja e mungesave tona, ngopja e nevojave apo shërbimi i afruar një pale të dytë nevojtare, që është sprovuar me një fatkeqësi të caktuar. Në rast se kryejmë një shërbim human, madje duke i dhënë më shumë përparësi të tjerëve se sa vetes sonë, jemi duke përmbushur, kështu, një nevojë të shenjtë që gjendet brenda nesh.

Kur e përmbushim këtë nevojë, vetëplotësohemi më shumë, padyshim na rritet edhe morali. Në rast se heqim paralele për të krahasuar cilësitë tona me ato të All'llahut, mund të përfytyrojmë një moment dhe të pyesim, cila është ajo nevojë e All'llahut, që përfundoi menjëherë pas krijimit tonë?! Nëse do t'i referohemi ajetit, objekt i studimit tonë, në të cilin All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që**

të Më adhurojnë!", do të pyesim sërish: Ku qëndron nevoja që All'llahu ka për adhurimin tonë?

Ç'mund të themi në këtë rast, edhe pse jemi duke kryer një krahasim të pamundur, mes cilësive të Krijuesit dhe krijesave, mes të obliguarës dhe të mundurës?!

Duke qenë se ekzistenca jonë është e kufizuar, ne përpiqemi vazhdimisht t'i përmbushim dhe t'i ngopim nevojat tona, prandaj të gjitha punët dhe angazhimet i vëmë në funksion të tyre. Këto nevoja, kurrsesi nuk janë të pavarura në vetvete, prandaj, përtej ekzistencës, duhet të vihemi në kërkim të qëllimit të kryerjes së tyre. Nevojat përfaqësojnë pikënisjen e të gjitha mirësive, që krijesat i transferojnë për te mbrojtja dhe përkujdesja e All'llahut. Ato e transferojnë atë drejt zhvillimit, duke u orientuar nëpërmjet All'llahut, për plotësimin e përsosmërisë. Ky është edhe qëllimi real i adhurimit ndaj All'llahut. Kjo është filozofia e adhurimeve dhe e lutjeve tona të përulura. Të gjitha bashkë, përfaqësojnë mësime të mëdha edukative, që në një mënyrë a në një tjetër, na plotësojnë çdo herë e më shumë. Në fakt, krijimi, në vetvete, është një hap i madh drejt plotësimit. Ky hap përfaqëson ardhjen në ekzistencë të gjësë prej asgjësë. Ky hap përfaqëson kalimin prej zeros në numra. Pas këtij hapi të madh, nis një tjetër hap plotësues. Të gjitha platformat fetare dhe hyjnore e orientojnë njeriun drejt Tij.

2- Këtu lind, një tjetër, pyetje: Nëse qëllimi i krijimit të njeriut është i lidhur me planin e Krijuesit, për t'i mbështjellë robtë e Tij me mirësi, pa ndonjë qëllim përfitimi për vetë Krijuesin, e se kjo mirësi konsiston në përsosmërinë e njerëzve, atëherë pse All'llahu (Bamirësi i madh dhe Bujari) nuk i krijoi

njerëzit të plotë që në fillim të herës?! Përse All'llahu i Madhëruar nuk i vendosi njerëzit pranë Tij, që në fillesë të krijimit, në mënyrë që ata të shijonin mirësinë e afrimitetit me hapësirat pranë Qenies së Tij të Shenjtëruar?!

Përgjigjja e kësaj pyetjeje është shumë e qartë. Plotësimi i njeriut është një proces që nuk mund të kryhet nëpërmjet formave të ndryshme të imponimit. Plotësimi është një rrugë e gjatë dhe e gjerë, prandaj njerëzit duhet ta përshkojnë atë me dëshirë, vullnet dhe liri të plotë, për të zgjedhur veprat që do të kryejnë. Për shembull: Nëse dikush grabit nëpërmjet dhunës një sasi parash dhe nëpërmjet kësaj shume ndërton një spital, a mund të themi se një vepër si kjo mund të ketë efekte plotësuese shpirtërore dhe morale te njeriu?! Absolutisht, jo! Në anën tjetër, nëse ai i jep këto para për të njëjtin qëllim të shenjtë, me dëshirën dhe vullnetin e tij të plotë (qoftë dhe një dinar të vetëm) atëherë, a ka kryer një hap të rëndësishëm në rrugëtimin e tij drejt përsosmërisë morale dhe shpirtërore, në masën e kontributit të tij?

Nga sa përmendet më sipër, kuptojmë se All'llahu duhet të na e tregojë këtë rrugë, duke përcaktuar urdhëresat dhe ndalesat, duke na drejtuar nëpërmjet Profetëve të Tij, duke i ndriçuar mendjet tona me legjislacionin dhe platformën e Tij edukative, në mënyrë që aty të bashkohet edhe pjesa tjetër e njerëzve. Vetëm në këtë mënyrë, kemi mundësi të njihemi me rrugën drejt përsosmërisë, që pastaj të bëjmë zgjedhjen në liri dhe me vullnetin tonë të plotë.

3- Përsëri lind një pyetje, tjetër: Thamë më lart se qëllimi i krijimit është i lidhur me arritjen e përsosmërisë njerëzore. Thënë me fjalë të tjera, synohet afrimiteti me All'llahun e Madhëruar,

lëvizja e krijesës së mangët në drejtim të krijesës së plotë, që nuk ka fund dhe kufi. Atëherë, cili është qëllimi në arritjen e përsosmërisë?

Përgjigje: Nëpërmjet kësaj fjalie, bëhet i qartë fakti se arritja e përsosmërisë është qëllimi final. Me fjalë të tjera, ajo është qëllimi i qëllimeve, pra, është më i madhi qëllim.

Sqarim: Nëse pyesim një nxënës shkolle, se cili është qëllimi i mësimit? Nëse i thuhet, përse mëson ti? Ai do të përgjigjet se mëson, që të shkojë në universitet! Nëse e pyesim, sërish: "Ç'përfiton, nëse shkon në universitet?!", ai thotë se synon të bëhet inxhinier, ose një mjek i mirë. Po qe se e pyet: "Çfarë do të bësh me diplomën e mjekësisë apo të inxhinierisë?!", ai të thotë: "Kjo është mënyra nëpërmjet të cilës unë shpalos aktivitetin dhe ndikimet e mia në jetë, por që të kem edhe fitime të majme. Po ta pyesim më tej: "Ç'do të bësh me fitimet e majma?!", ai përgjigjet: "Do të jetoj bukur, në lumturi, në qetësi dhe luks."

Më pas i drejtojmë edhe pyetjen e fundit: "Për çfarë të duhet jeta e bukur?!" Përgjigjja e tij do të vishet me një tjetër rrobë e do të thotë: "Në rregull,[1] pra: "Që të jetoj bukur, në lumturi, në qetësi, në luks.". Ai përsërit të njëjtën përgjigje që dha për pyetjen e mëparshme. Ky është një argument i qartë, se kjo është dhe përgjigjja e tij e fundit. Duke qenë se ai konsiderohet qëllimi i qëllimeve e duke qenë se është përgjigjja e fundit, kuptojmë se kjo është dhe gjendja e njeriut dhe raporti i tij me jetën. Të gjitha këto

[1] Fjala *"hasenun" - "në rregull", "mirë",* në këtë rast, është përcaktor kallëzuesor i një kryefjale të padukshme, kuptimi i të cilës është: "Pyetja, apo fjalët tuaja janë në rregull, janë të mira, janë të pranueshme".

gjendje, janë të lidhura me aspekte materiale, por gjendja mbetet e njëjtë edhe për aspektet morale.

Po nëse njeriu pyetet: "Cili është qëllimi i dërgimit të Profetëve dhe i zbritjes se librave qiellorë?! Cili është qëllimi i platformave edukative hyjnore?!", përgjigjet: "Qëllimi i tyre është afrimi ynë me All'llahun dhe rrugëtimi ynë drejt përsosmërisë!". Ndodh që të pyesin sërish: "Cili është qëllimi i afrimit me All'llahun dhe i arritjes së përsosmërisë?!". Në këtë rast, përgjigjemi, kështu: "Qëllimi është afrimi për tek All'llahu, pasi ai është qëllimi ynë përfundimtar. Thënë ndryshe, gjithçka duam dhe nevojitet në këtë botë, e vënë në funksion të plotësimit të përsosmërisë dhe afrimitetit me All'llahun e Lartësuar. Ndërsa, afrimiteti me All'llahun, në vetvete, është një tjetër synim, është lumturia e të qenit pranë Tij.".

4- Po t'i referohemi kuptimeve të një hadithi kudsi, në të cilin All'llahu i Madhëruar thotë: "Kam qenë një thesar i fshehur dhe doja të njihesha! Për këtë arsye i krijova krijesat që të më njohin Mua!",[1] do të ndeshemi me një tjetër pyetje, e cila është: "Ç'lidhje ka ky hadith kudsi, me gjithçka është thënë më parë?!".

Kësaj pyetjeje i përgjigjemi, kështu: Ky hadith kudsi konsiderohet prej lajmeve të vetme, siç quhen për gjuhën e shkencës së haditheve, të tillë hadithe. Nga ana tjetër, lajmet e vetme nuk mund të përdoren si argument për çështje të besimit. Kuptimi i këtij hadithi është se njohja e All'llahut është mënyra nëpërmjet të cilës arrihet përsosmëria e krijesave. Pra, All'llahu i Madhëruar deshi, që të mbështjellë më mirësinë dhe mëshirën e Tij gjithçka, prandaj, për këtë arsye, krijoi krijesat dhe u mësoi

[1] "Biharul Anuar", vëll. 81, f. 198.

atyre Rrugën e Tij, mënyrën e njohjes së Tij, që ata të rrugëtojnë të sigurt drejt përsosmërisë së tyre. Në të vërtetë, njohja e All'llahut është simbolika e përsosmërisë së tyre.

E vërteta është që njerëzit duhet ta dinë se Qenia e All'llahut të Madhëruar është burimi i të gjitha llojeve të përsosmërive. Nëpërmjet njohjes së All'llahut, krijesat përvetësojnë pjesë të caktuara të përsosmërisë së Tij. Ato përthithin prej All'llahut mirësi dhe dritën për qenien e tyre. Marrin prej cilësive të Tij të plota e të përsosura, duke i bërë ato pjesë të qenieve të veta. Kështu, përsosmëria dhe afrimi tek All'llahu i Madhëruar nuk mund të arrihet përveçse duke u pajisur me cilësi, që ngjajnë me cilësitë e Tij. Ky moral, në vetvete, është vetëm një pjesë e procesit të njohjes së Tij.

5- Duke iu referuar gjithçkaje që përmendëm më sipër, i afrohemi përfundimit dhe themi: Adhurimi i All'llahut dhe nënshtrimi ndaj Tij, nënkuptojnë ndjekjen e rrugës që e kënaq Atë! T'i dorëzojmë atij shpirtrat tanë, ta duam Atë me gjithë fuqinë e zemrës dhe të kemi moral që Ai e dëshiron

Duke qenë se ajetet e mëparshme e paraqitën adhurimin si qëllimin përfundimtar, atëherë kuptimi kryesor është: Ai është plotësimi njerëzor! Njeri i përsosur është ai që i është dorëzuar me sinqeritet All'llahut!

5 - Transmetimet islame dhe filozofia e krijimit të njeriut

Më sipër folëm rreth qëllimit të krijimit të njeriut dhe e trajtuam këtë çështje në dy mënyra: **Mënyra e parë,** me komentimin e ajeteve kur'anore, ndërsa **mënyra e dytë,** nëpërmjet

trajtimit filozofik të çështjes, duke i takuar të dyja ato, në një pikë të vetme.

Tashmë duhet të vazhdojmë dhe ta ndjekim këtë çështje, duke e trajtuar nëpërmjet **një mënyre të tretë**. Ky është trajtimi nëpërmjet transmetimeve të ndryshme islame, për të parë ç'sjellin këto transmetime, lidhur me këto përfundime.

Nëpërmjet hulumtimit dhe meditimit rreth kuptimeve që ofrojnë transmetimet islame, të arrijmë që të hedhim një shikim akoma më të qartë për këtë çështje.

Në një hadith, transmetuar prej Imam Musa bin Xha'ferrit *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur është pyetur rreth kuptimit të hadithit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Punoni, sepse të gjithëve u është lehtësuar rruga për të vepruar atë për të cilën janë krijuar!"*, ai ka thënë: *"All'llahu i Lartësuar i krijoi xhindët dhe njerëzit për ta adhuruar dhe nuk i krijoi për ta mëkatuar Atë. Për këtë arsye, All'llahu, thotë në Kur'anin Famëlartë:* **'Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë!'**. *Kështu, Ai e bëri të lehtë rrugën e krijesave të Tij, me qëllimin për të cilën i ka krijuar. Mjerë ata që pëlqejnë verbërinë ndaj udhëzimit për në Rrugën e Drejtë!"*.[1]

Ky hadith mbart kuptime të mëdha, lidhur me këtë çështje, që do të thotë se All'llahu i krijoi njerëzit me qëllim të përsosmërisë. Ai, gjithashtu, e pajisi krijesën me mundësi, me legjislacionin përkatës e më pas i dha lirinë për të zgjedhur.

[1] "Teuhid Es Saduk", f. 356.

Në një hadith tjetër, transmetuar prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë se Imam Hysejni të ketë ligjëruar në prani të shokëve të tij: *"All'llahu i Madhëruar nuk i ka krijuar robtë e Tij, përveçse me qëllimin që ata ta njohin Atë. Kur ta njohin, do ta adhurojnë dhe, kur ta adhurojnë Atë, nuk do të kenë më nevojë të adhurojnë dikë tjetër përveç Tij!"*.[1]

6- Përgjigja e pyetjes

Ndeshemi këtu me një pyetje tjetër: Nëse All'llahu i ka krijuar robtë e Tij për ta adhuruar Atë, atëherë, përse disa prej tyre zgjedhin rrugën e mohimit?! A është e mundur që vullneti i All'llahut të mos përputhet me qëllimin e Tij?!

Në fakt, të gjithë ata që shtrojnë këtë problematikë, ngatërrohen mes vullnetit formues, krijues dhe vullnetit legjislativ. Qëllimi i adhurimit nuk është detyrimi, ai është krijesë binjake e vullnetit të lirë. Këtu del në pah qëllimi që shfaqet në formën e përgatitjes së terrenit, apo situatës. Për shembull, nëse dikush thotë: "E kam ndërtuar këtë xhami, që njerëzit të falen në të.", kjo do të thotë: "E kam përgatitur këtë objekt kulti dhe kam krijuar kushtet që njerëzit të falen në të.". Kjo nuk do të thotë se unë i detyroj njerëzit të falen në të. E ngjashme me këtë situatë është edhe ndërtimi i një shkolle për të mësuar, i një spitali për të kuruar dhe i një biblioteke për të lexuar.

Kështu, All'llahu i Madhëruar, e ka përgatitur krijesën njeri për adhurim dhe i ka krijuar kushtet e adhurimit kësaj krijese,

[1] "Ilelu Sherai' i Sadukut", vëll. 1, f. 9, sipas asaj që është transmetuar në tefsirin "El Mijzan", vëll. 18, f. 423

duke e pajisur me mendje, me ndjenja dhe me forca të tjera që "banojnë" në qenien e tij. Ai dërgoi për njerëzit Profetë, Librat qiellorë dhe udhëzimet hyjnore përkatëse.

Është pranuar, se këto kuptime janë të njëjta për besimtarin dhe mohuesin, me ndryshimin se besimtari përfiton prej këtyre mundësive, ndërsa mohuesit jo.

Kur Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për kuptimin e ajetit: **"Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë!",** ai është përgjigjur: *"I ka krijuar për adhurim!"*. Transmetuesi i hadithit thotë: E pyeta Imamin dhe i thashë: *"Në veçanti apo në përgjithësi?!"*. Ai u përgjigj: *"Në përgjithësi!"*.[1]

Në një hadith tjetër, transmetuar prej të njëjtit Imam, kur është pyetur me të njëjtën pyetje, ka thënë: *"All'llahu i ka krijuar, për t'i urdhëruar që ta adhurojnë!"*.[2]

Këtu kemi një shenjë të qartë që tregon se nuk kemi të bëjmë me detyrim për të adhuruar, por me përgatitjen e kushteve dhe terrenit shpirtëror për ta kryer adhurimin. Këto kuptime u shkojnë përshtat të gjithë njerëzve, pa përjashtim.[3]

---

[1] "Biharul Anuar", vëll. 5, Hadithi 7, f. 314.

[2] Burimi i mëparshëm, Hadithi 5.

[3] Në atë që është përmendur më parë, duket qartë se shkronja *"elif"* dhe shkronja *"lam"* janë për të përcaktuar gjininë, duke përfshirë kështu vetëm një pjesë të tyre, ashtu siç është përmendur te disa prej librave të tefsirit. All'llahu e di më së miri.

Ajetet 59 - 60

فَإِنَّ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا ذَنُوبًا مِثْلَ ذَنُوبِ أَصْحَابِهِمْ فَلَا يَسْتَعْجِلُونِ٥٩
فَوَيْلٌ لِلَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ يَوْمِهِمُ الَّذِى يُوعَدُونَ٦٠

"Pa dyshim, ata që kanë bërë të këqija, do të kenë pjesën e tyre të dënimit, të ngjashme me pjesën e shokëve të tyre (të mëparshëm) **që kanë qenë si ata. Prandaj të mos Më sfidojnë që ta shpejtoj atë."**

"Kështu, mjerë mohuesit prej Ditës që u është premtuar!"

Komentimi

Këta njerëz, do të shoqërojnë miqtë e tyre në zjarrin e Xhehennemit

Dy ajetet e mësipërme, shënojnë edhe fundin e sures "Edh Dharijat". Në një farë mënyre, ato janë rezultantja që nxirret prej kësaj sureje. Sidomos, në ajete që flasin për popujt e mëparshëm, siç është populli i Faraonit, populli i Lutit, i Themudit dhe i Adit dhe ajetet që kanë trajtuar qëllimin e krijimit e të gjetjes së njeriut prej asgjësë.

Ajeti 59, pasi ka njoftuar faktin se idhujtarët kanë devijuar prej misionit madhor e të vërtetë të krijimit, informon, gjithashtu, se kjo kategori njerëzish do të përjetojë sasi të konsiderueshme të dënimit të All'llahut, ashtu si ka ndodhur edhe me popujt e mëparshëm. **"Pa dyshim, ata që kanë bërë të këqija, do të kenë pjesën e tyre të dënimit, të ngjashme me pjesën e shokëve të tyre** (të mëparshëm) **që kanë qenë si ata. Prandaj të mos Më sfidojnë që ta shpejtoj atë."**.

Ata do të thonë: "Nëse dënimi i All'llahut është i vërtetë, atëherë përse nuk na prek ne?!".

Përdorimi i fjalës "*edh dhulmu*" për këtë kategori njerëzish, duke i cilësuar ata si të padrejtë, vjen për arsye se mohimi i All'llahut dhe idhujtaria konsiderohen prej padrejtësive më të mëdha. Arsye tjetër është se padrejtësia, në vetvete, është vendosja e diçkaje në një vend të papërshtatshëm. Natyrshëm, adhurimi i putave në vend të All'llahut të Madhëruar konsiderohet një prej padrejtësive më të mëdha, për këtë arsye ata meritojnë ndëshkimin më të rreptë, nga sa e morën paraardhësit e tyre idhujtarë.

Fjala "*edh dhunubu*" - "*gjynahet*", e ngjashme në formë me fjalën "*kabul*" - "*pranim*", nënkupton "*kalin me bisht të gjatë*". E njëjta fjalë përdoret për të nënkuptuar edhe "*një enë të madhe*", legenin, i cili ka një kapëse, mbajtëse, në fundin e saj.

Kohë më parë, arabët e nxirrnin ujin prej pusit, duke e tërhequr me anë të kafshëve. Ata përgatisnin enë të mëdha që i lidhnin nëpërmjet litarëve që i ndihmonin për t'i ngritur lart.

Uji që mbartnin këto enë, ndahej mes grupeve të njerëzve që qëndronin rreth e rrotull pusit. Kështu, secili grup merrte një enë të mbushur me ujë ose më shumë, sipas nevojave dhe gjendjes. Kjo fjalë është përdorur për të nënkuptuar pjesën apo hisen e secilit. Me të njëjtin kuptim, kjo shfaqet edhe në ajetin 59. Por, është më e rëndësishme, se në këtë ajet, ajo tregon pjesën apo hisen më të madhe.[1]

A mund të gjykojmë, vallë, se nëpërmjet kësaj fjale nënkuptohet paralajmërimi dhe kërcënimi me dënimin për këtë botë dhe në Botën Tjetër?! Disa komentues kanë pëlqyer të pranojnë mendimin e parë, ndërsa disa të tjerë mendimin e dytë.

Ka shumë argumente që na shtyjnë të besojmë, se bëhet fjalë për ndëshkimin në këtë botë, pasi disa prej mohuesve idhujtarë e kanë pyetur Profetin: "Kur do të jetë ky ndëshkim?! Ku është dënimi i All'llahut?! Përse nuk na dënon All'llahu?! Përse nuk na përfshin dënimi i All'llahut këtu, në këtë botë, etj.?!" Duket qartë se në këtë rast kemi të bëjmë më ndëshkimin e kësaj bote.[2] Ky është këndvështrimi i parë.

Këndvështrimi i dytë. Mund të themi se shprehja kur'anore: **"Të ngjashme me pjesën e shokëve të tyre** (të mëparshëm) **që kanë qenë si ata!"**, në kuptimin e saj sipërfaqësor, tregon për ndëshkimin që kanë marrë popujt e hershëm, të cilët janë përmendur në fillimet e kësaj sureje, siç janë: populli i Lutit,

[1] Disa poetë arabë kanë thënë se ne kemi enë dhe ju kemi enë, nëse refuzoni, ne kemi enën e zemrës. Tefsiri "El Mijzan", vëll. 9, fundi i ajeteve, objekt i studimit tonë.

[2] Kthehu te komentimi i ajeteve 57-58 të sures "El En'am" si dhe në komentimin e ajetit 72 të sures "En Neml" dhe tek ajete të tjera të ngjashme. Kështu, kjo shprehje është përdorur në Kur'an edhe për të nënkuptuar Ditën e Gjykimit.

populli i Faraonit, i Adit dhe i Themudit, që u prekën prej llojeve të ndryshme të ndëshkimit të madh të All'llahut për këtë botë, derisa u shkatërruan përfundimisht.

Këtu lind një pyetje shumë e rëndësishme: Nëse në këtë rast nënkuptohet ndëshkimi i All'llahut për këtë botë, atëherë, përse nuk u realizua premtimi i All'llahut?!

Ka dy përgjigje:

1- Premtimi i All'llahut u realizua dhe u ekzekutua në këtë botë për shumë prej armiqve të All'llahut dhe Islamit, siç ishte ndëshkimi i Ebu Xhehlit dhe ndëshkimi i një grupi tjetër prej të njëjtës "gjini" në Luftën e Bedrit dhe në beteja të tjera.

2- Zbritja e ndëshkimit për të gjithë ata, është e kushtëzuar me moskthimin e tyre tek All'llahu i Madhëruar dhe mungesën e pendesës së tyre ndaj idhujtarisë. Duke qenë se pjesa më e madhe e tyre besuan pas çlirimit të Mekës, kushti u eliminua, si rrjedhim edhe ndëshkimi i All'llahut nuk mund të ishte gjithëpërfshirës.

Në ajetin e fundit, kemi të bëjmë me ndëshkimin e Ahiretit, si vazhdimësi e ndëshkimit në këtë botë, për të cilën, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kështu, mjerë mohuesit prej Ditës që u është premtuar!"**.

Një konstatim i rëndësishëm është se surja filloi me trajtimin e çështjeve të Ringjalljes dhe Ditës së Gjykimit dhe u mbyll duke vënë theksin në po të njëjtat çështje.[1]

[1] Disa komentues të Kur'anit mendojnë se ky ajet flet për ndëshkimin në këtë botë, edhe pse shprehje të ngjashme me këtë të shprehur në ajet, janë përdorur kryesisht për të nënkuptuar ndëshkimin në Ahiret.

Fjala "*uejlun*", në gjuhën arabe, përdoret për të treguar një individ apo *një grup individësh që përballen me shkatërrimin*. Ajo nënkupton, gjithashtu, ndëshkimin dhe vuajtjen e madhe. Disa komentues kanë thënë se kjo fjalë mund të ketë ngarkesa kuptimore që e tejkalojnë fuqimisht ndëshkimin dhe vuajtjen. Kjo do të thotë se ajo përfaqëson diçka më të fuqishme dhe më të tmerrshme se këto kuptime.

Fjalët: "*el uejl*", "*el uejs*", "*el uejh*", në gjuhën arabe, përdoren për të shprehur dhe për të treguar "*keqardhjen*", ose ndikimin prej diçkaje. Në rastet më të rëndësishme, fjala "*el uejl*", përdoret për të etiketuar ata që *kryejnë vepra të shëmtuara*, *të pista dhe të ulëta*. Fjala "*el uejs* është përdorur për të treguar *poshtërimin e dikujt*, ndërsa fjala "*el uejh*, përdoret për të nënkuptuar *shprehjen e mëshirës* ndaj një personi të caktuar.

Disa komentues kanë thënë se "*uejl*" është një prej puseve të Xhehennemit, ose derë prej dyerve të tij. Pretenduesit e mësipërm nuk kanë për qëllim të tregojnë se kjo fjalë i mbart këto kuptime vetëm në aspektin gjuhësor, ajo është realisht përfaqësuese e denjë e kuptimeve të këtyre të vërtetave dhe realiteteve.

Kjo fjalë përmendet shpesh në Kur'anin Famëlartë. Në disa raste, ajo përshkruan realitetin e mohuesve, të idhujtarëve, të gënjeshtarëve, të përgënjeshtruesve, të kriminelëve, të hajdutëve në kandar dhe atyre që harrojnë dhe vonohen nga namazi i tyre, por, sigurisht, që ajo është përmendur më shpesh për të nënkuptuar gënjeshtarët. Ajeti që është përsëritur vazhdimisht, është: **"Mjerim, vuajtje e dhimbje do të ketë Atë ditë** (në Ditën e

Gjykimit) **për gënjeshtarët!"**. Ky ajet është përmendur vetëm në suren "El Murselat"dhjetë herë.

Zoti ynë! Të lutemi Ty, të na shpëtosh prej ndëshkimit dhe prej poshtërimit të asaj Dite të madhe!

O All'llah! Të lutemi Ty, na e mundëso, na e bëj risk të kryejmë adhurimet e plota ndaj Teje dhe të krenohemi përpara njerëzve, duke deklaruar robërinë tonë karshi Teje!

O All'llah! Të lutemi Ty, të mos na bësh pjesë të përfundimit të dhimbshëm të gënjeshtarëve, të cilët i përgënjeshtruan Profetët e Tu dhe bashkë me ta, përgënjeshtruan argumentet e Tua të qarta!

O All'llah! Të lutemi Ty, të na zgjosh prej gjumit të hutimit e të shpërqendrimit, me mëshirën tënde të madhe, o All'llah!

Amin, o Zot i botëve!

Sure "Et Tur"

Zbritur në Mekë, 49 ajete

Përmbajtja e sures

Hulumtimet e kësaj sureje përqendrohen, kryesisht, në çështjet e Rikthimit dhe të Ringjalljes. Nga njëra anë, ajo trajton të ardhmen dhe fundin e njerëzve të ndershëm dhe të devotshëm, kurse në anën tjetër, trajton fundin, të ardhmen e kriminelëve dhe të korruptuarve në Ditën e Madhe të Gjykimit. Sigurisht, në këtë sure trajtohen edhe çështje të tjera, që lidhen me tema të ndryshme, sikur është çështja e besimit.

Përgjithësisht, mund të themi se, për nga larmia e tematikave të trajtuara, këtë sure mund ta ndajmë në gjashtë pjesë:

1- Ajetet e para të sures, që nis me betim pas betimi, trajtojnë ndëshkimin e All'llahut, argumentet e Ditës së Gjykimit dhe shenjat e saj. Prej ajetit të parë deri në ajetin 16 trajtohet ndëshkimi i mohuesve dhe zjarri i Xhehennemit.

2- Në pjesën e dytë të kësaj sureje, përmenden në mënyrë të detajuar dhe të përsëritur mirësitë e mëdha të Xhennetit, dhuratat e surprizat e All'llahut, për të sajdisur njerëzit e devotshëm në Ditën e Gjykimit. Realisht, prej ajetit 17 deri në ajetin 28, kjo sure trajton kryesisht pjesën më të madhe të mirësive të Xhennetit.

3- Në pjesën e tretë të kësaj sureje, flitet rreth profetësisë së Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe akuzave që mohuesit dhe armiqtë e Islamit e kanë shënjestruar atë. Kur'ani u jep shkurtimisht përgjigje këtyre akuzave të ulëta, prej ajetit 29 deri në ajetin 34.

4- Në pjesën e katërt të sures, nëpërmjet një argumentimi të qartë, trajtohen çështje të Teuhidit *(të Njehsimit)* prej ajetit 35 deri në ajetin 43.

5- Në pjesën e pestë të sures, kemi një rikthim në çështjet Ringjalljes dhe trajtimin e disa veçorive të Ditës së Gjykimit, prej ajetit 44 e deri tek ajeti 48.

6- Në pjesën e fundit të kësaj sureje, e cila nuk i tejkalon dy ajetet, përmendet urdhri i All'llahut për Profetin e Tij, që të bëjë durim, të mos lëkundet nga Rruga e Drejtë, të lavdërojë All'llahun, ta kujtojë shpesh Atë, sikur na kujton premtimin e All'llahut dhënë Profetit, se Ai do ta mbrojë dhe do ta ndihmojë atë.

Surja, në tërësinë e saj, është një përmbledhje e harmonizuar logjike dhe emocionale, me anë të të cilës tërhiqen zemrat e dëgjuesve.

Emërtimi i kësaj sureje me emrin "Et Tur" vjen për t'u përshtatur me ajetin e parë të kësaj sureje, ku përmendet fjala "*et tur*".

Mirësia e leximit të sures "Et Tur"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Ai që e lexon suren 'Et Tur' (me mendje dhe me zemër), All'llahu e detyron Veten, ta mbrojë atë prej dënimit të Tij dhe ta begatojë atë në Xhennet.*".[1]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 162 dhe tefsiri "El Burhan", vëll. 4, f. 240.

Në një tjetër hadith, transmetuar prej Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)* citohet: *"Atyre, që lexojnë suren 'Et Tur', All'llahu ua bashkon të mirat e kësaj bote me të mirat e Ahiretit!"*.[1]

Vihet re qartë se i gjithë ky shpërblim dhe mirësi e madhe, për këtë botë dhe Botën Tjetër, janë për ata që lexojnë përmbajtjen e kësaj sureje, duke menduar dhe duke medituar mbi kuptimet e saj, duke e vënë mendimin dhe meditimin në funksion të përmirësimit të veprave të tyre.

[1] Burimi i mëparshëm.

Ajetet 1-8

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالطُّورِ١ وَكِتَابٍ مَسْطُورٍ٢ فِي رَقٍّ مَنْشُورٍ٣ وَالْبَيْتِ الْمَعْمُورِ٤ وَالسَّقْفِ
الْمَرْفُوعِ٥ وَالْبَحْرِ الْمَسْجُورِ٦ إِنَّ عَذَابَ رَبِّكَ لَوَاقِعٌ٧ مَا لَهُ مِنْ دَافِعٍ٨

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Betohem për malin Tur."

"Dhe Librin e shkruar në rreshta."

"Në pergamenë të shpalosur."

"Dhe Shtëpinë plot vizitorë."

"Dhe kupën e ngritur."

"Dhe detin e ndezur."

"Se, me të vërtetë, dënimi i Zotit tënd do të ndodhë."

"Dhe askush nuk mund ta pengojë."

Komentimi

Kjo është një tjetër sure, nga suret që nisin me betim, nisin me një betim që synon të paraqesë një të vërtetë të madhe. Kjo është çështja e Ringjalljes, e Rikthimit pas vdekjes dhe e llogaridhënies së njerëzve për veprat që kanë kryer në këtë botë.

Rëndësia e kësaj çështjeje lidhet me faktin se All'llahu i Madhëruar është betuar në ajete të ndryshme kur'anore, mbi lloje të ndryshme të krijesave të Tij madhështore e të shenjta. Kjo është një mënyrë që All'llahu e përzgjodhi, për të përçuar madhështinë e asaj Dite dhe, njëkohësisht, për të vërtetuar se ajo do të ndodhë në mënyrë të padiskutueshme.

Në fillim të sures, vijnë pesë ajete që nisin me betim. Këto ajete janë të mbushura me kuptime të mbyllura, që e ftojnë mendjen njerëzore për meditim dhe kthjellim. Kjo i frymëzoi komentuesit t'i hulumtojnë të gjitha aspektet dhe dimensionet kuptimore të këtyre ajeteve.

All'llahu i Madhëruar thotë: **"Betohem për malin Tur."**.

Fjala *"et tur"*, parë në kuptimin e saj gjuhësor, përfaqëson "*malin*", por, duhet mbajtur parasysh fakti se, kjo fjalë është përmendur në dhjetë ajete kur'anore. Nëntë herë është përdorur kur flitet për malin Tur, Sina. Ky është mali ku qëndronte Profeti i Zotit, Musai *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, kur i zbriti Zbulesa hyjnore. Thuhet, gjithashtu, se e njëjta fjalë që përmendet në ajetet 1-8, nënkupton të njëjtin mal. Ky fakt bëhet akoma me i qartë, kur shikojmë se shkronjat "*elif*" dhe "*lam*", te fjala *"et tur"*, nënkuptojnë "*premtimin*".

Mbështetur nga sa thamë, mund të themi se All'llahu i Madhëruar, betohet në fillim të sures me një prej vendeve të shenjta të tokës, mbi të cilat ka zbritur në fillim Shpallja hyjnore.

Në ajetin e dytë: **"Dhe Librin e shkruar në rreshta"**, kemi të bëjmë me disa mundësi potencialisht të vërteta. Disa komentues kanë thënë se, nëpërmjet këtij ajeti, nënkuptohet *Leuhi Mahfudhi - regjistri ku engjëjt regjistrojnë veprat e njerëzve*. Ndërsa komentues të tjerë thonë se ky ajet nënkupton Kur'anin Famëlartë. Të tjerë pohojnë se është libri i veprave të njeriut, ndërkohë që disa të tjerë mendojnë se ky ajet nënkupton Librin e Teuratit, që i zbriti Profetit Musa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Po t'i referohemi përshtatjes së betimit të përmendur më sipër, mund të themi, se ky ajet është tregues i qartë për Librin e Teuratit që i zbriti Musait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe për çdo Libër tjetër qiellor.

Ajeti që pason, është: **"Në pergamenë të shpalosur."**.

Fjala *"err rrik"*, buron nga fjala *"err rrikatu"***,** që në origjinën e saj nënkupton *"butësinë"*, *"delikatesën"* dhe *"bukurinë"*. Kjo fjalë është përdorur, gjithashtu, për të nënkuptuar *"letrën"* apo *"lëkurën e hollë"*, mbi të cilën shkruanin njerëzit në lashtësi.

Fjala *"el menshuru"*, nënkupton *"gjerësinë"*, ndërkohë që disa komentues mendojnë se një prej kuptimeve të kësaj fjale është, gjithashtu, *"shkëlqim"*. Nisur nga sa përmendëm më sipër, mund të themi se, në këtë rast, kemi të bëjmë me një betim që kryhet për një libër, në faqet e të cilit është shkruar më e mira dhe më e bukura përmbajtje. Në të njëjtën kohë, betimi është i hapur dhe përfaqëson kuptime edhe më të gjera.

Në ajetin: **“Dhe Shtëpinë plot vizitorë”,** hasim, gjithashtu, lloje të ndryshme komentesh. Disa komentues kanë thënë se, nëpërmjet këtij ajeti nënkuptohet *Shtëpia e ndodhur në Qiell*, që pozicionohet vertikalisht mbi Qabe. Kjo shtëpi vizitohet në mënyrë të pandërprerë prej engjëjve që kryejnë *tauaf (rrotullohen)* rreth saj. Ky kuptim, vihet re në disa prej transmetimeve islame.[1] Nëse do t’i referohemi disa prej transmetimeve islame, mësojmë se shtatëdhjetë mijë engjëj e vizitojnë çdo ditë këtë shtëpi për të mos iu kthyer më kurrë asaj.

Komentues të tjerë kanë thënë se, nëpërmjet këtij ajeti, nënkuptohet Qabeja, Shtëpia e All’llahut në tokë. Ajo është vazhdimisht e tejmbushur me vizitorë e pelegrinë dhe përfaqëson shtëpinë e parë mbi tokë, ndërtuar veç për adhurim.[2]

Disa komentues të tjerë kanë thënë se, nëpërmjet këtij ajeti “*el bejt el ma'amur*“ - **“Shtëpinë plot vizitorë”**, nënkuptohet zemra e besimtarit, që është e tejmbushur me besim dhe me kujtimin e All’llahut. Ajo që mund të themi me bindje, është se kuptimi sipërfaqësor i ajetit nënkupton njërin nga dy kuptimet që përmendëm më sipër. Duke iu referuar larmisë së emrave, me të cilët është përmendur Qabeja në Kur’anin Famëlartë, mund të themi se kuptimi i dytë shfaqet në harmoni më të plotë.

Ajeti: **“Dhe kupën e ngritur”,** nënkupton qiellin. Në ajetin 32 të sures “El Enbija” lexojmë: **“E kemi bërë qiellin, tavan mbrojtës për ju!”**.

---

[1] Tek libri “Biharul Anuar” ka më shumë se dhjetë transmetime të lidhura me këtë çështje; vëll. 58, f. 55 dhe pas saj.

[2] Në komentimin e fundit të ajetit të dytë të sures “Ed Dukhan”, është përmendur kjo çështje. Mund t’i riktheheni asaj.

Në ajetet 27-28 të sures "En Naziat", lexojmë: **"Cili është më i vështirë: krijimi juaj apo i qiellit, të cilin Ai e ndërtoi, ia ngriti lart kupën dhe e përsosi?!"**. Pra, All'llahu është Ai që e ngriti lart kupën e qiellit, e ndërtoi dhe e përsosi atë, me kujdes hyjnor.

Mund të themi se arsyeja e emërtimit "*kupë*" është, sepse sasia e yjeve dhe e galaktikave është aq e madhe, sa duket sikur e kanë mbuluar qiellin dhe kanë formuar një pamje të ngjashme me kupën apo tavanin. Ekziston një mundësi e dytë, që ajo kupë të nënkuptojë atmosferën që rrethon Tokën. Kështu, kjo atmosferë nënkupton kupën që ndalon kometat dhe çdo trup tjetër jashtëtokësor të depërtojë në Tokë. E njëjta atmosferë mbron Tokën prej rrezeve të dëmshme të diellit.

Në ajetin: **"Dhe detin e ndezur"**, fjala "*el mesxhur*", mbart dy kuptime në aspektin gjuhësor: *Kuptimi i parë* është i lidhur me *"flakën"* dhe *"ndezjen"*, ndërsa *kuptimi i dytë* është "*mbushja*". Në librin "El Mufredat", autori Err Rragib thotë: "Fjala "*sexhere*" e ngjashme në formë me fjalën "*fexhere*", nënkupton "*ndezjen e zjarrit*", prandaj ai beson se ajeti, në fjalë, përcjell këtë kuptim dhe hesht për kuptimin e dytë. Ndërkohë që El Al'lamah Et Tabrasij thotë se kuptimi i parë përmendet më sipër. Ka të tjerë libra në gjuhën arabe që afrojnë të njëjtin mendim.

Ekzistojnë të tjera ajete në Kur'an, që, gjithsesi, mbështesin kuptimin e parë. Për të sqaruar këtë mendim, na vijnë në ndihmë kuptimet e dy ajeteve 72 dhe 73 të sures "El Gafir", ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kur të sillen me zinxhirë, në ujë të valë, e pastaj të digjen në zjarr. Pastaj atyre do t'u thuhet: 'Ku janë ata që i adhuronit!?'"**.

Në librin "Nehxhul Belaga", transmetuar prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë që lidhur me hekurin e ndezur, t'i ketë thënë vëllait të tij, Akilit: *"Si trembesh prej një hekuri, të cilin e ka nxehur njeriu duke luajtur, e më tërheq mua për te zjarri që e ka ndezur Krijuesi i tij (zjarrit) autoritar, prej zemërimit të Tij?!"*.[1]

Pyetja që lind, është: "Ku gjendet, atëherë, ky det i ndezur?!".

Disa komentues thonë se ai është i njëjti det që rrethon tokën, (ose detet që rrethojnë tokën). Ata mendojnë se këto dete do të ndizen e do të marrin flakë përpara se të ndodhë Dita e Gjykimit. Më pas, këto dete do të ndizen e do të shpërthejnë, siç e lexojmë qartë në ajetin 6 të sures "Et Tekuir"**,** ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kur detet të ndizen!"**.

Në ajetin e tretë të sures "El Infitar" lexojmë, gjithashtu: **"Kur detet të shpërthejnë!"**.

Komentues të tjerë kanë thënë se me detin që ndizet, në ajetin e mësipërm, nënkuptohet deti i llavës së ndezur brenda barkut të tokës. Ai është i përbërë prej lëndësh dhe mineralesh të ndezura e të shkrira. Përmbajtja e hadithit të Imam Bakirit, transmetuar prej El Ajashit, është një tjetër dëshmi që e përforcon këtë kuptim. Në këtë hadith thuhet se Karuni do të ndëshkohet dhe do ta marrë dënimin e tij në detin e ndezur.[2] Lidhur me rastin

[1] "Nehxhul Belagah", Hytbe 224.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 138.

e tij, Kur'ani thotë: **"Ne bëmë që Karunin dhe shtëpinë e tij t'i gëlltiste toka!"**.[1]

Këto dy komente, nuk kanë kundërshti apo kontradiktë ndërmjet tyre, pasi betimi mund të ketë qenë i lidhur me të dy kuptimet e mësipërme. Natyrshëm, të dy këto kuptime janë prej argumenteve të All'llahut dhe mrekullive të mëdha të kësaj bote.

Bie në sy fakti që komentuesit e Kur'anit, nuk kanë provuar të gjejnë një lidhje të caktuar mes kuptimeve të pesë betimeve. Po t'i referohemi kuptimeve sipërfaqësore të ajeteve, vëmë re se ekziston një lidhje dhe një marrëdhënie e ngushtë kuptimore ndërmjet tri betimeve të para, pasi të tri këto betime flasin rreth Shpalljes dhe veçorive të saj. Kështu që mali "Et Tur" është vendi ku ka zbritur Shpallja. Në anën tjetër, libri i shkruar në rreshta, tregon qartë për librin e zbritur nga qielli, qoftë ky Kur'ani apo Teurati. Ndërsa, shtëpia plot vizitorë, është vendi ku shkojnë e vijnë engjëjt e Zotit, të cilët përfaqësojnë, njëkohësisht, ambasadorët e Shpalljes, që All'llahu i Madhëruar, dërgon prej Profetëve të përzgjedhur prej Tij.

Për sa u përket dy pjesëve që vijojnë, kemi të bëjmë me ajete që trajtojnë çështje të krijimit, në ndryshim nga tri pjesët e tjera që lidhen me ajetet e legjislativit.

Njëra prej këtyre dy pjesëve, flet rreth argumenteve dhe shenjave më të rëndësishme të Teuhidit, Njësimit, siç është qielli me madhështinë që përfaqëson, ndërsa pjesa tjetër flet rreth argumenteve dhe shenjave më të rëndësishme të Rikthimit,

[1] Sure "El Kasas", ajeti 81.

Ringjalljes. Aty trajtohen ngjarje dhe ndodhi përgjatë Ditës së Gjykimit.

Nisur nga sa përmendëm më sipër, mund të themi se Teuhidi (Njëhsimi), Profetësia dhe Ringjallja përfshihen në këto pesë pjesë.

Disa komentues janë të mendimit se të gjitha këto ajete, flasin rreth historisë së Profetit Musa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Këta komentues e kanë kryer një lidhje të tillë, nëpërmjet ajeteve të mësipërme:

"Et Tur", është mali ku zbriti Shpallja hyjnore mbi Profetin Musa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

"Dhe Librin e shkruar në rreshta", është Teurati (Tora).

"Dhe Shtëpinë plot vizitorë", përfaqëson qendrën prej nga vijnë e shkojnë engjëjt, sikurse nuk përjashtohet mundësia që të jetë "El Bejt e Makdis", Jeruzalemi.

"Dhe Kupën e ngritur", është e lidhur më historinë e bijve të Izraelit. All'llahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **"Ne e ngritëm sipër tyre malin, që dukej si hije!"**.

"Dhe detin e ndezur", është deti i ndezur, ku u dënua Karuni. Pasi kundërshtoi Musain, ai u hodh në të.

Ky komentim, sipas të gjitha gjasave, duket larg të vërtetës, pasi nuk është në harmoni me të dhënat e mbledhura prej transmetimeve të ndryshme islame. Ashtu si thamë dhe më parë, bazuar në dëshmitë e ajeteve të tjera kur'anore dhe në

transmetimet e ndryshme islame, kupa e ngritur e qiellit, e përmendur në ajet, nënkupton qiellin.

Një urtësi me interes shfaqet këtu, është ajo që përfaqëson pyetjen: Cila është lidhja mes këtyre betimeve dhe objekteve mbi të cilët ato bien?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje bëhet e qartë, duke marrë parasysh edhe ato që kemi thënë më parë, kur shohim se këto pjesë takohen në një pikë të përbashkët. Kjo konsiston në faktin se fuqia e All'llahut për të krijuar dhe për të vendosur ligje, është tregues i mundësisë së Tij, për ta rikthyer jetën, për të ringjallur të vdekurit prej varreve të tyre edhe njëherë tjetër. Ky është edhe qëllimi i betimeve të përmendura, ashtu si e lexojmë qartë në fundin e ajeteve 1-8. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Se, me të vërtetë, dënimi i Zotit tënd do të ndodhë dhe askush nuk mund ta pengojë."**.

Ajetet 9 – 16

يَوْمَ تَمُورُ السَّمَاءُ مَوْرًا٩ وَتَسِيرُ الْجِبَالُ سَيْرًا١٠ فَوَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ١١ الَّذِينَ هُمْ فِي خَوْضٍ يَلْعَبُونَ١٢ يَوْمَ يُدَعُّونَ إِلَى نَارِ جَهَنَّمَ دَعًّا١٣ هَذِهِ النَّارُ الَّتِي كُنْتُمْ بِهَا تُكَذِّبُونَ١٤ أَفَسِحْرٌ هَذَا أَمْ أَنْتُمْ لَا تُبْصِرُونَ١٥ اصْلَوْهَا فَاصْبِرُوا أَوْ لَا تَصْبِرُوا سَوَاءٌ عَلَيْكُمْ إِنَّمَا تُجْزَوْنَ مَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ١٦

“Atë Ditë qielli do të lëkundet fuqishëm.”

“E malet do të lëkunden me të madhe nga vendi!”

“Atë Ditë, mjerë për jobesimtarët.”

“Që, të zhytur në gënjeshtra, argëtoheshin!”

“Atë Ditë, ata do të hidhen me forcë në zjarrin e Xhehennemit.”

“(Do t’u thuhet)**: ‘Ky është zjarri që e keni mohuar.’”**

“A është kjo magji apo nuk shihni?”

“Përcëllohuni në të! E duroni apo nuk e duroni, njësoj është për ju. Në të vërtetë, ky është ‘shpërblimi’ i vetëm për atë që keni bërë.”

Komentimi

Në ajetet e mëparshme hasëm, në mënyrë të kufizuar, tregues e sinjalizues të dënimit të All'llahut në Ditën e Gjykimit. Ndërsa ajetet 9-16 përmbajnë sqarimin dhe komentimin e kuptimeve që përmendëm. Ajetet, në fillim, flasin rreth disa situatave të Ditës së Gjykimit dhe veçorive të saj. Më pas tregojnë për mënyrën e dënimit të gënjeshtarëve. All'llahu i Madhëruar thotë: "**Atë Ditë qielli do të lëkundet fuqishëm…"**.[1]

Fjala "*el meuru*"**,** e ngjashme në formë me fjalën "*el kaulu*", përfaqëson shumë kuptime leksikore. Në librin "El Mufredat", Ragibi thotë: "Fjala "*el meuru*" nënkupton "*lëvizjen me shpejtësi*". Ai ka thënë se e njëjta fjalë është përdorur, gjithashtu, për të emërtuar "*pluhurin që e merr era*" dhe me shpejtësi e përçon nga njëri vend në tjetrin në mënyrë të çrregullt.

Në librin "Lisanul Arab" lexojmë se fjala "*el meur*", nënkupton "*lëvizjen*". Pra, ajo përfaqëson kuptimet e të shkuarit diku dhe të kthimit prej diku. Ajo është përdorur, gjithashtu, për të nënkuptuar "*dallgën*". Disa të tjerë kanë thënë se fjala "*el meuru*" është *lëvizja në formë cilindrike*. Kështu, duke u bazuar në mendimet e gjuhëtarëve, arrijmë në përfundimin se fjala "*el meuru*", përfaqëson *lëvizjen e shpejtë në formë cilindrike* apo të *një cikloni*, koordinuar me lëvizje të dallgëzuar në ikje dhe ardhje. Nisur nga ky përkufizim, mund të themi se rregulli i përgjithshëm i ekzistencës dhe i galaktikave, do të përballet me

[1] Fjala "*jeumun*" - "*ditë*" vjen në rasën kallëzore dhe në funksion të rrethanorit të vendit. Ajo është e lidhur me emrin foljor "*uaki'i*", e përmendur tek ajetet e mëparshme.

turbulenca dhe tronditje të mëdha. Ato do të zhvendosen prej boshteve të tyre, duke ndjekur një trajektore të çrregullt në itinerarin vajtje-ardhje. Më pas, qielli dhe galaktikat shndërrohen me një qiell tjetër që do të krijojë All'llahu i Madhëruar. Këtë e gjejmë të shkruar edhe në ajetin 104 të sures "El Enbija", ku, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Atë Ditë, Ne do t'i palosim qiejt ashtu siç paloset letra e librit!"**.

Në ajetin 48 të sures "Ibrahim", gjithashtu, lexojmë: **"Atë Ditë, do ta ndërrojmë Tokën me një Tokë tjetër, edhe me qiejt do të bëjmë njësoj!".**

Në ajetin që vijon suren "Et Tur", All'llahu i Madhëruar pohon: **"E malet do të lëkunden me të madhe nga vendi!"**.

Nuk ka dyshim se malet do të lëkunden, do të shkunden, do të lëvizin prej vendit të tyre dhe do të thërrmohen, deri sa të bëhen, si i cilëson All'llahu i Madhëruar në suren "El Karia": **"Atë Ditë, malet do të jenë si lesh i shprishur!"**.[1] Më pas do të kemi një gropë të madhe, boshatisur prej gjithçkaje. All'llahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **"Ndërsa Toka do të bëhet fushë e shkretë!"**.[2]

Të gjitha këto, janë shenja të qarta se kjo botë dhe gjithçka gjendet mbi të dhe nën të, do të shkatërrohet dhe vendin e saj do ta zërë një botë e re, me rregulla të reja, ku njerëzit do të qëndrojnë përballë veprave të tyre.

---

[1] Sure "El Karia", ajeti 5.

[2] Për më shumë sqarim, kthehu komentimit të fundit të ajetit 106 të sures "Ta Ha", në këtë komentim.

Për këtë arsye, vjen ajeti tjetër i sures në të cilin All'llahu i Madhëruar thotë: **"Atë Ditë, mjerë për jobesimtarët."**.[1]

Nuk ka dyshim se, kur frika e hutia të mbretërojnë ngado, gënjeshtarët dhe mohuesit e fesë do të përfshihen nga një panik i tmerrshëm. Ai është pjesë e pandarë e dënimit të madh të All'llahut. Fjala "*el uejlu*", në vetvete, përfaqëson "*shfaqjen e keqardhjes*" dhe "*të trishtimit*" gjatë një ndodhie të papranueshme dhe të papëlqyer për njeriun.

Më pas, vijnë të tjera ajete, që sqarojnë natyrën e gënjeshtarëve. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Që, të zhytur në gënjeshtra, argëtoheshin!"**.

Janë pikërisht këta gënjeshtarë që kanë thënë se Kur'ani, është një gënjeshtër dhe shpifje e madhe. Janë këta, të njëjtët njerëz, që i kanë trajtuar mrekullitë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si gjini të caktuara të magjisë apo të çmendurisë. Të gjitha të vërtetat që solli Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ata i trajtuan padrejtësisht, duke luajtur, duke u tallur, duke i përqeshur. Janë ata që e kanë luftuar të vërtetën, me të gjitha mjetet që kanë pasur në dorë, duke filluar nga fjalët e ulëta, dëmtuese dhe të palogjikshme. Janë ata që nuk kanë lënë shpifje, akuzë e gënjeshtër pa sajuar, me qëllimin e vetëm, realizimin e planeve të tyre të fëlliqura.

[1] Shkronja "*fa'a-f*", në këtë rast, ka rolin e degëzimit, që do të thotë: Atë Ditë, kur toka do të jetë djerr dhe e zbrazët, askush nuk do të ketë mundësi t'i fshihet All'llahut. Kështu, mjerë gënjeshtarët në atë Ditë! Nuk do të gjejnë vend ku të fshihen.

Fjala "*khaudun*", e ngjashme në formë me fjalën "*haudun*", nënkupton *debatin shkatërrues* me replika të pavlera. Në origjinën e saj gjuhësore, kjo fjalë nënkupton *afrimin për tek uji* dhe *kapërcimin e tij*.

Më pas, vijnë të tjera ajete, për të paraqitur të tjera detaje të asaj Dite të Madhe, për të treguar edhe një herë përfundimin e tmerrshëm që do të kenë gënjeshtarët. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Atë Ditë, ata do të hidhen me forcë në zjarrin e Xhehennemit."**.[1] Ata do të hidhen me forcë në zjarrin e Xhehennemit, duke përdorur dhunë mbi ta.

Atë Ditë, do t'u thuhet: **"Ky është zjarri që e keni mohuar."**.

Atë Ditë, do t'u thuhet, gjithashtu: **"A është kjo magji apo nuk shihni?"**.

Ishit ju, ata që pretendonin në dynja se gjithçka që kishte sjellë, Muhammedi, ishte magji. Ishit ju, ata që pretendonit se, Muhammedi, e kishte mësuar magjinë prej dikujt tjetër, që u përpoq t'ju hedhë hi syve, për t'ju devijuar nga të vërtetat që keni trashëguar prej të parëve tuaj, si dhe për t'ju turbulluar mendjet. Ishit ju, ata që thatë se Muhammedi është duke i servirur fjalët e tij, si të ishin zbulesë hyjnore, ardhur nga All'llahu. Ishit ju, ata që thatë se e gjithë kjo histori është një mashtrim i madh, se nuk ka asnjë lidhje me të vërtetën.

---

[1] Fjala *"da'a"*, e ngjashme në formë me fjalën *"xhed"*, nënkupton shtyrjen e fortë dhe shoqërimin zvarrë, ndërsa fjala *"el jeum"*, në ajet, vjen kallëzues, e lidhur me rrethanorin e vendit, ose zëvendësuese e togfjalëshit *"jeume idhin"* - *"atë ditë"*, në ajetin e mëparshëm.

Për këtë arsye, gjatë kohës, kur do të tërhiqen zvarrë për ndëshkimin në zjarrin e Xhehennemit, do t'u thuhet, duke i mallkuar, duke i poshtëruar dhe duke ua ulur kokën: **"A është kjo magji apo nuk shihni?"**.

Atyre, gjithashtu, do t'u thuhet: **"Përcëllohuni në të! E duroni apo nuk e duroni, njësoj është për ju. Në të vërtetë, ky është 'shpërblimi' i vetëm për atë që keni bërë."**.

Nuk ka dyshim se këto janë punët tuaja, me të cilat po përballeni. Atë Ditë nuk vlen frika, as tmerri, as llahtaria, as ulërimat dhe as klithmat. Asgjë nuk do të mund të ndikojë dhe të ndryshojë përfundimin tuaj.

Ky ajet, është argument i qartë, se veprat e njeriut do të materializohen dhe do të marrin formë atë Ditë, për t'u kthyer e për t'u ballafaquar me vepruesit e tyre. Ky është një tjetër fakt i rëndësishëm që shpalos drejtësinë e madhe të All'llahut, sepse zjarri i Xhehennemit, sado i nxehtë e i fortë qoftë, nuk është tjetër gjë përveçse rezultati i veprave të vetë njerëzve. Ai është, në një farë mënyrë, dimensioni i zjarrtë dhe i flaktë i veprave të tyre të këqija.

Dy hulumtime

1- Si do të shoqërohen kriminelët për në zjarrin e Xhehennemit?

Nuk ka asnjë dyshim se kriminelët do të thirren njëri pas tjetrit e do të shoqërohen për në zjarrin e Xhehennemit, duke i poshtëruar, duke i ofenduar, duke i tërhequr zvarrë. Për këtë zhvillim të rëndësishëm të Ditës së Gjykimit, hasim në ajete të shumta, të cilët i paraqesin në mënyra të ndryshme përmasat e kësaj panorame tronditëse.

Shembull për këtë janë ajetet 30-31 të sures "El Hakka", ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Do të thuhet: 'Kapeni dhe lidheni në pranga!'. Pastaj: 'Digjeni në zjarrin përvëlues!'"**.

Më pas, në ajetin 47 të sures "Ed Dukhan", All'llahu i Madhëruar thotë: **"Engjëjve do t'u thuhet: 'Rrëmbejeni atë dhe çojeni në mes të zjarrit flakërues!'"**.

Krejtësisht e ndryshme do të jetë gjendja e besimtarëve të devotshëm dhe të ndershëm. Ata do të priten në dyert e Xhennetit me respekt e nderim. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kur t'i afrohen atij, dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t'u thonë atyre: 'Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, prandaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!'"**.

Nisur nga sa përmendëm me sipër, mund të themi se Xhenneti dhe Xhehennemi, nuk janë vetëm qendra të mëshirës apo të dënimit të All'llahut, por në to përcaktohet qartë, gjithashtu, edhe natyra protokollare me të cilën do të pritet secila nga kategoritë e thëna.

2- Përfshirja në debatet dhe replikat e gënjeshtrave

Edhe pse ajetet e mësipërme janë përqendruar kryesisht te idhujtarët dhe mohuesit që kanë jetuar në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mund të themi, pa të voglin dyshim, se ato janë të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse.

Ato i përfshijnë të gjitha kategoritë e gënjeshtarëve, madje edhe vetë filozofët materialistë, që janë zhytur në baltërat e imagjinatës dhe të mendimeve të tyre të mangëta. Është pikërisht, kjo kategori gënjeshtarësh, që luajnë dhe tallen me të vërtetat e rëndësishme të ekzistencës. Janë ata që nuk besojnë asgjë tjetër përveç asaj që prodhon mendja dhe logjika e tyre e mangët. Janë ata që presin të shohin gjithçka para syve në laboratorët e tyre, në lupat e mikroskopëve të tyre. Madje, shkojnë edhe më tej, duke kërkuar që të gjejnë aty edhe vetë All'llahun e Madhëruar.

Janë këta njerëz, për të cilët All'llahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: **"Që, të zhytur në gënjeshtra argëtoheshin!"**. Janë ata që janë mbytur në dallgët e imagjinatës dhe në përfytyrimet e tyre të pavërteta.

Sado e zhvilluar të jetë mendja njerëzore, ajo është sa një qiri përballë dritës ndriçuese të diellit që ndriçon botën. Ky qiri e ndihmon njeriun të dalë prej habitatit të errët të materializmit, sikur e ndihmon atë të hapë dyert e të mbinatyrshmes. Ai e ndihmon njeriun të fluturojë e me dritën e Zbulesës hyjnore të kërkojë të vërtetat e botës së gjerë, të njihet me të panjohurat, me të fshehtat dhe me sekretet e ekzistencës.

Ajetet 17 – 21

إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي جَنَّاتٍ وَنَعِيمٍ١٧ فَاكِهِينَ بِمَا آتَاهُمْ رَبُّهُمْ وَوَقَاهُمْ رَبُّهُمْ عَذَابَ الْجَحِيمِ١٨ كُلُوا وَاشْرَبُوا هَنِيئًا بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ١٩ مُتَّكِئِينَ عَلَى سُرُرٍ مَصْفُوفَةٍ وَزَوَّجْنَاهُمْ بِحُورٍ عِينٍ٢٠ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَاتَّبَعَتْهُمْ ذُرِّيَّتُهُمْ بِإِيمَانٍ أَلْحَقْنَا بِهِمْ ذُرِّيَّتَهُمْ وَمَا أَلَتْنَاهُمْ مِنْ عَمَلِهِمْ مِنْ شَيْءٍ كُلُّ امْرِئٍ بِمَا كَسَبَ رَهِينٌ٢١

“Vërtet, të devotshmit do të jenë në kopshtet e Xhennetit dhe në mirësi.”

“Duke u kënaqur me atë që u ka dhënë Zoti i tyre, sepse Ai i ka ruajtur prej dënimit të Zjarrit flakërues.”

“(Do t’u thuhet)**: ‘Hani e pini me kënaqësi, si shpërblim për atë që keni bërë!’”**

“Të mbështetur në divane të renditura, ata do të martohen me hyri sybukura.”

“Ne do t’i bashkojmë besimtarët e vërtetë me ata pasardhës të tyre që i ndjekin në besim dhe nuk do t’u pakësojmë asgjë nga shpërblimi për veprat e tyre. Çdo njeri është peng i veprave të veta.”

Komentimi

Mirësitë e All'llahut për të devotshmit

Pas hulumtimeve që lidhen me ajetet e mësipërme, rreth ndëshkimit të kriminelëve dhe dënimit të tyre të tmerrshëm, vijnë ajetet 17-21, për të paraqitur edhe anën tjetër të medaljes. Këto ajete shpalosin për lexuesin mrekullitë, mirësitë dhe shpërblimin e madh, që All'llahu i Madhëruar ka rezervuar për besimtarët e devotshëm, duke prezantuar kështu, një tablo të qartë, ku vihet re dallimi dhe ndryshimi i pozitës së secilës palë.

Në ajetin e parë prej ajeteve në fjalë, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Vërtet, të devotshmit do të jenë në kopshtet e Xhennetit dhe në mirësi."**.

Fjala "*el muttekine*", është përdorur në ajet në vend të shprehjes "*besimtarët*", pasi kjo fjalë mbart ngarkesën kuptimore *të besimit*. Por, ajo, në të njëjtën kohë, nënkupton edhe *veprat e mira*. Kjo ndodh për faktin se, në disa periudha kohore, "*tekvaja*" - "*devotshmëria*", i paraprinte ***besimit,*** që ishte themeli i tij. Këtë e gjejmë në ajetin 2 të sures "El Bekare", ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ai** (Kur'ani) **është Libri tek i cili nuk ka dyshim! Ai është udhërrëfyes për të devotshmit!"**.

Në këtë rast, kuptojmë se ka njerëz të papërgjegjshëm, të pandershëm, të pabesë e të painteresuar për të kërkuar të vërtetën. Kjo përbën një prej fazave (periudhave) më me shumë rëndësi në periudhat e përkushtimit. Këta njerëz nuk janë vënë kurrë në kërkim të njohjes së Fesë së vërtetë, në kërkim të besimit

të tyre, kështu, këta njerëz nuk janë aspak të gatshëm të pranojnë udhëzimin e Kur'anit Famëlartë.

Për sa i përket shprehjes: **"...në kopshtet e Xhennetit dhe në lumturi!"**, ku secila prej tyre shfaqet në shumës dhe në formë të pashquar, tregon qartë llojshmërinë e Xhenneteve, të mirësive dhe madhështitë e tyre.

Më pas, Kur'ani flet rreth ndikimit të mirësive të mëdha në gjendjen shpirtërore të banorëve të Xhennetit. Kështu, në ajetin në vijim, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Duke u kënaqur me atë që u ka dhënë Zoti i tyre..."**.[1]

Në të njëjtën kohë, All'llahu i Madhëruar ka dhënë siguri dhe i ka qetësuar, që të mos i tremben dënimit të Tij. Këtë e lexojmë në ajetin: **"...Ai i ka ruajtur ata prej dënimit të Zjarrit flakërues!"**.

Kjo fjali kur'anore mund të ketë dy kuptime:

Kuptimi i parë, mund të jetë paraqitja e mirësisë së All'llahut, tërësisht, e pavarur prej mirësive të tjera.

Ndërsa **kuptimi i dytë,** mund të jetë se ky ajet është vazhdimësi e fjalive para tij, që do të thotë se banorët e Xhennetit do të gëzohen për dy arsye. **Së pari,** për mirësitë dhe Xhennetin

[1] Fjala *"fakihijne"*, buron nga fjala *"fekehe"* dhe nënkupton lumturinë dhe gëzimin e njeriut. Ajo nënkupton, gjithashtu, ngacmimin e lumturisë te të tjerët, nëpërmjet fjalëve të bukura e të ëmbla. Tek libri i tij "El Mufredat", Ragibi thotë kështu: "Frutat janë nga çdo lloj bime, ndërsa fjala *"fukaheh"*, nënkupton bisedat e njerëzve të këndshëm. Disa komentues të tjerë kanë thënë se ajeti kur'anor, në të cilin All'llahu thotë: **"Duke u kënaqur me atë që u ka dhënë Zoti i tyre"**, tregon se banorët e Xhennetit do të konsumojnë lloje të ndryshme frutash. Ky mendim është shumë larg të vërtetës.

që All'llahu i Madhëruar u ka rezervuar. **Së dyti,** do të gëzohen dhe do të lumturohen për faktin se All'llahu i Madhëruar do t'i mbrojë prej zjarrit të Xhehennemit.

Togfjalëshi *"rabuhum"* - **"Zoti i tyre"**, përmendur në dy fjalitë e mësipërme, nënkupton shkallën sipërore *të mirësive të All'llahut*, përfaqësuar në vazhdimësinë e ushtrimit të mirësisë së Zotit dhe të qenit Zot i njerëzve, edhe përgjatë qëndrimit në Xhennet.

Ajeti që vijon, paraqet një tablo të përgjithshme rreth mirësive dhe begative që do të furnizojnë të devotshmit në Xhennet. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Do t'u thuhet: 'Hani e pini me kënaqësi, si shpërblim për atë që keni bërë!'"**.

Fjala *"henien"*, është tregues *"i ushqimeve dhe pijeve"* të shijshme e të lehta të Xhennetit. Ato ushqime nuk janë si ushqimet dhe pijet e kësaj bote, që e dëmtojnë rëndë njeriun, në rast se e tepron me përdorimin e tyre. Më i rëndësishëm se gjithçka, është fakti se, për t'i pasur këto ushqime dhe pije të Xhennetit, nuk shpenzohet asnjë mund e asnjë përpjekje. Në të njëjtën kohë, nuk ekziston frika se mund të shterojnë një ditë. Kjo është edhe arsyeja, pse këto ushqime e pije, në vetvete, përfaqësojnë lumturi.[1]

Është e pranuar se ushqimet e Xhennetit, në vetvete, janë kënaqësi, por dhe përshëndetja e engjëjve, kur u thuhet banorëve të Xhennetit: "Ju bëftë mirë dhe qoftë kënaqësi për ju ky ushqim!", përfaqëson një tjetër bukuri dhe kënaqësi të spikatur.

[1] Tek libri i tij "El Mufredat", Ragibi thotë: *"El heni'u"* - *"i lumturi"* është tërësia e proceseve të kënaqësisë dhe lumturisë, tërësisht të shkëputura prej vështirësisë dhe të papasuara prej lodhjes.

Një tjetër mirësi që i pret banorët e Xhennetit, është jeta e tyre: **"Të mbështetur në divane të renditura..."**.

Ata do të përjetojnë kënaqësinë e shoqërimit me miq të tjerë besimtarë, pikërisht, kjo lloj lumturie morale i tejkalon lumturitë që afrohen nga gjithçka tjetër.

Fjala "*surur*", përfaqëson shumësin e fjalës "*serir*", rrënja e saj buron prej fjalës "*es surur*" - "*lumturi*". Kjo fjalë është përdorur, gjithashtu, për të emërtuar karriget, apo llojet e ulëseve që përdoren nga njerëzit nëpër festa apo ditë të zakonshme.

Fjala "*mesfufetu*" - "*të renditura*", buron prej lëndës "*saf*" dhe tregon se këta divanë, shtretër apo kolltukë, janë të vendosur në krahë të njëri-tjetrit, në mënyrë të tillë që të krijohet një ambient shoqëror mahnitës, i lumtur dhe i gëzueshëm.

Në shumë ajete kur'anore lexojmë se banorët e Xhennetit do të ulen në kolltukë të rehatshëm, përballë njëri-tjetrit. (Sure "El Hixhr", ajeti 47 dhe sure "Es Safat", ajeti 44.)

Kjo shprehje nuk bie aspak në kundërshtim me përmbajtjen e ajetit, që po studiojmë, sepse edhe në festa të ndryshme që organizojnë njerëzit sot kudo në botë, divanet dhe kolltukët sistemohen në formë të harkuar, pranë njëri-tjetrit, madje edhe përballë njeri-tjetrit.

Fjala "*mutteki'ine*" - "*të mbështetur*", përfaqëson shkallën sipërore të qetësisë, pasi zakonisht njeriu mbështetet e pushon në kohë qetësie. Ndryshe ndodh me ata që janë të tronditur apo në gjendje ankthi. Ata nuk pëlqejnë të qetësohen, por qëndrojnë në gjendje shqetësimi lëvizjesh të vazhdueshme.

Më pas, Kur'ani vijon duke treguar mirësitë me të cilat begatohen banorët e Xhennetit, duke njoftuar se ata do të martohen me gra të bukura bardhoshe, me sy të bukur e të mëdhenj. All'llahu i Madhëruar thotë: **"...ata do të martohen me hyri sybukura."**.[1]

Këto janë disa prej epërsive morale dhe materiale të banorëve të Xhennetit, megjithatë, ata nuk mjaftohen vetëm me kaq, por do të begatohen me të tjera begati dhe të mira morale e materiale. All'llahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: **"Ne do t'i bashkojmë besimtarët e vërtetë me ata pasardhës të tyre që i ndjekin në besim dhe nuk do t'u pakësojmë asgjë nga shpërblimi për veprat e tyre. Çdo njeri është peng i veprave të veta."**.

Njeriu që sheh pasardhësit e tij në Parajsë, duke u kënaqur dhe duke u lumturuar me mirësitë e Xhennetit, pa humbur asgjë prej punëve dhe veprave të tyre, përbën në vetvete një mirësi e madhe.

Nga natyra e shprehjes kur'anore vërejmë se nëpërmjet pasardhësve, nënkuptohen fëmijët e rritur, të cilët ecin në gjurmët e prindërve të tyre besimtarë të devotshëm dhe ndjekin me përpikëri rrugën e tyre.

---

[1] Fjala *"hurun"* - *"hyri"* është shumësi i fjalës *"haurau"* apo *"ahueru"*. Ky është shumësi i mashkullores dhe i femërores në të njëjtën kohë. Kjo fjalë përzgjidhet për t'u cilësuar bebja e zezë e syrit dhe, kur e bardha e syrit është transparente. Ajo mund të jetë, gjithashtu, një fjalë që përfaqëson bukurinë, në përgjithësi, pasi bukuria shfaqet kryesisht te sytë e një njeriu. Fjala *"ajn"* - *"sy"*, është shumësi i fjalës *"a'ajun"*, ndërsa fjala *"ajna'a"* nënkupton syrin e gjerë. Kështu, fjala *"hurul ajn"* - *"hyritë e Xhennetit"*, përfaqëson një kuptim të gjerë, duke përmbledhur kështu të dyja gjinitë e bashkëshortëve të banorëve të Xhennetit, meshkuj dhe femra.

Pasardhës të tillë, të ngjashëm me këta që përmendëm më sipër, edhe nëse kanë ndonjë të metë apo tejkalim në veprat e tyre, All'llahu i Madhëruar do t'ua falë dhe do t'i mëshirojë për hatër të prindërve të tyre të ndershëm dhe besimtarë. Kështu që grada e tyre do të rritet, deri sa të arrijnë shkallën e shpërblimit të prindërve. Ky shpërblim fitohet edhe për shkak të prindërve, edhe për shkak të fëmijëve.[1]

Disa komentues të Kur'anit mendojnë se fjala *"dhurrijetun"* - *"pasardhësit"*, përfshin fëmijët e vegjël, bashkë me të rriturit, por ky mendim dhe komentim nuk është në harmoni me kuptimin sipërfaqësor të ajetit, sepse ndjekja me besim, është argument i qartë se ata e kanë arritur moshën e pubertetit, apo minimalisht i janë afruar shumë asaj.

Është edhe një mendim tjetër që thotë se fëmijët e arrijnë moshën e pubertetit në Ditën e Gjykimit. Ata do të sprovohen atje, sapo të mbushin moshën. Në rast se e kalojnë provën, do t'u bashkohen prindërve të tyre. Këtë kuptim e gjejmë edhe në tefsirin "El Kafij", ku transmetohet se, kur Imami *(Paqja qoftë mbi të!)* u pyet rreth fëmijëve të besimtarëve, tha: *"All'llahu do t'i mbledhë ata në Ditën e Gjykimit dhe më pas do të ndezë përpara tyre një zjarr të madh. Ai do t'i urdhërojë ata të hidhen brenda atij zjarri. Ai që e hedh veten në atë zjarr, do të shpëtojë, do të jetë prej të lumturve.*

[1] Në pamje të parë, fjalia *"uel ledhine amenu"* - **"ata që besuan",** është fjali e pavarur, ndërsa shkronja *"uau"* është filluese (ajo me të cilën fillohet fjalia). Këtë kuptim e kanë mbrojtur disa komentues të Kur'anit, siç janë: El Al'lame Et Tabatabai, El Meragij dhe Sejid Kutubi. Çudia më e madhe është kur lexojmë Zamakhshariun të thotë se kjo fjali është e lidhur me sifjalinë: **"ata do të martohen me hyri sybukura"**, edhe pse ajo nuk përshtatet me këtë kuptim dhe me kuptimin e tekstit. Ajo nuk është aspak në harmoni, gjithashtu, me elokuencën gjuhësore të Kur'anit.

All'llahu i Madhëruar do ta bëjë zjarrin për të, të paqtë dhe të freskët. Ndërsa, ata që nuk do të pranojnë të hidhen, do t'u ndalohet begatia e All'llahut!".[1]

Nga ana tjetër, mund të themi se ky hadith, përveç se e ka të dobët zinxhirin e transmetuesve të tij, ka, gjithashtu, probleme edhe me tekstin. Por nuk është ky vendi i përshtatshëm për të sqaruar këtë.

Natyrshëm, nuk mund të ketë pengesë që fëmijët t'u bashkohen prindërve të tyre në Xhennet, por diskutimi ynë përqendrohet në një tjetër bosht. A e trajton ajeti këtë çështje, apo jo?! Thamë se kuptimi sipërfaqësor i shprehjes kur'anore: **"Ne do t'i bashkojmë besimtarët e vërtetë me ata pasardhës të tyre që i ndjekin në besim..."**.

Gjithsesi, edhe pse ngritja e fëmijëve në gradën e prindërve të tyre mund të ngacmojë te disa njerëz idenë, se duke u ngritur në gradën e prindërve, fëmijët mund të marrin prej veprave të tyre, vjen fjalia pasuese e ajetit, për të qartësuar gjithçka, duke e thënë qartë e prerë: **"...nuk do t'u pakësojmë**[2] **asgjë nga shpërblimi për veprat e tyre..."**.

Ibn Abasi ka transmetuar prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Kur njeriu të hyjë në Xhennet, do të pyesë për prindërit, për bashkëshorten dhe për fëmijët e tij. Atij do t'i thuhet: 'Ata nuk kanë mbërritur gradën tënde dhe nivelin e veprave të tua!'". Më pas ai do të thotë: 'Zoti im! Unë kam*

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 139. (me shkurtim)

[2] Folja në gjuhën arabe *"eletnahum"* që ndodhet në këtë ajet, buron prej fjalës *"elete"*, e ngjashme në formë me fjalën *"thebete"*. Ajo nënkupton pakësimin.

punuar për vete dhe për ata'. Pas kësaj, Zoti urdhëron që ata t'i bashkohen atij!".[1]

Nuk duhet të harrojmë, gjithashtu, se në fund të ajetit, Kur'ani afron një tjetër shprehje: **"...Çdo njeri është peng i veprave të veta."**.

Nisur nga ky fakt, nuk duhet të habitemi, kur të mësojmë se veprat e njerëzve të devotshëm nuk pakësohen. Këto vepra do ta shoqërojnë njeriun kudo që gjendet. Kështu, nëse All'llahu vendos me begatinë dhe mëshirën e Tij, që fëmijët e besimtarëve të devotshëm t'u bashkëngjiten prindërve të tyre, kjo nuk do të thotë aspak se Ai do t'ua pakësojë atyre veprat që kanë kryer.

Disa komentues kanë thënë se fjala *"rehijnun" – "peng"*, në këtë rast, nënkupton *"absolutizmin"*. Kjo do të thotë se çdo njeri është peng i veprave të veta, të mira apo të këqija qofshin, prandaj nuk ka për t'iu pakësuar aspak shpërblimi i veprave të veta.

Në këtë rast duhet të tregohemi të kujdesshëm, pasi kjo shprehje nuk mund t'u përshtatet veprave të mira. Për këtë arsye, disa komentues kanë thënë se togfjalëshi **"çdo njeri"** në këtë rast, nënkupton vepruesit e punëve të këqija. Kështu, mund të themi se çdo njeri është peng i veprave të këqija, prandaj është peng dhe i burgosur brenda tyre.

Për ta mbështetur këtë pretendim, ata, ndonjëherë, argumentojnë me ajetet 38-39 të sures "El Muddeththir": **"Çdo njeri është peng i veprave të veta, përveç njerëzve të krahut të djathtë!"**.

[1] Tefsiri "El Meragij", vëll. 27, f. 26.

Mirëpo ky komentim, duke parë edhe kontekstin e ajeteve të mëprashme dhe të mëpasshme që flasin për të devotshmit dhe nuk flasin për mohuesit dhe idhujtarët, kështu që komenti i mësipërm rezulton i papërshtatshëm.

Krahas këtyre dy komenteve, që duken të papërshtatshme në disa aspekte, vjen komenti i tretë, që është në harmoni të plotë me fillimin e ajetit, ajetet pararendëse dhe ajetet që vijojnë. Ky koment thotë se prej kuptimeve të fjalës "*rehnun*" - "*peng*", është dhe ai i "*el mulazemeh*" - "*i qenësishëm*", që njihet si "*dokumenti në këmbim të borxhit*". Prej shpjegimeve të gjuhëtarëve, del se kuptimi i saj është "*vazhdimësia*" dhe "*qenësia*".[1]

Ka prej tyre që deklarojnë se kuptimi origjinal i fjalës "*rehn*" - "*peng*", është "*vazhdimësia*" dhe "*qëndrueshmëria*". Në terminologjinë e fukahave, juristët e Islamit, fjala "*rehnun*", ka kuptimin e dokumentit. Për këtë arsye, kur themi "*ni'metun rahinetun*", kuptojmë se "*nimeti*" - "*mirësia*", është e qëndrueshme dhe e vazhdueshme.[2]

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, në lidhje me popujt që kanë kaluar, ka thënë: *"Ja ku janë pengjet e varreve dhe përmbajtja e tyre!"*.[3]

Kështu, kuptimi i shprehjes kur'anore: **"Çdo njeri është peng i veprave të veta!"**, është se veprat e njeriut, qofshin të mirat apo të këqijat, rrugëtojnë bashkë me të, kurdoherë dhe në mënyrë të pandarë. Për këtë arsye, besimtarët e devotshëm do të jenë pengje të pandarë prej veprave të tyre në Xhennet, kështu, edhe

[1] "Lisanul Arab", Lënda e fjalës "*Rehnun*".
[2] "Mexhmaul Bahrejn", Lënda "*Rehnun*" - "*Pengut*".
[3] "Nehxhul Belagah", Letra 45.

nëse atyre u bashkohen fëmijët dhe pasardhësit e tyre, kjo nuk do të thotë se veprat e tyre pakësohen.

Për sa i përket çështjes së ajetit 39 të sures "El Muddeththir", përjashtimi i banorëve të krahut të djathtë prej atyre që kanë kaluar, mund të jetë një shenjë që tregon se ata do të përfshihen prej mirësive të mëdha, pa kufi, deri në atë mase sa veprat e tyre të mira nuk do të kenë asnjë lloj peshe, në krahasim me mirësinë dhe me begatitë që All'llahu ka përgatitur për ta në Xhennet.[1]

Në të gjitha rastet, kjo fjali mbështet një realitet dhe një të vërtetë të madhe, siç është: Veprat e njeriut nuk ndahen kurrë prej tij. Ato do ta shoqërojnë atë në të gjitha etapat e ekzistencës së tij.

[1] Janë disa komentime të tjera, lidhur me banorët e krahut të djathtë, të cilat do t'i trajtojmë në fund të ajetit në suren "El Muddeththir".

Ajetet 22 – 28

وَأَمْدَدْنَاهُمْ بِفَاكِهَةٍ وَلَحْمٍ مِمَّا يَشْتَهُونَ٢٢ يَتَنَازَعُونَ فِيهَا كَأْسًا لَا لَغْوٌ فِيهَا وَلَا تَأْثِيمٌ٢٣ وَيَطُوفُ عَلَيْهِمْ غِلْمَانٌ لَهُمْ كَأَنَّهُمْ لُؤْلُؤٌ مَكْنُونٌ٢٤ وَأَقْبَلَ بَعْضُهُمْ عَلَى بَعْضٍ يَتَسَاءَلُونَ٢٥ قَالُوا إِنَّا كُنَّا قَبْلُ فِي أَهْلِنَا مُشْفِقِينَ٢٦ فَمَنَّ اللَّهُ عَلَيْنَا وَوَقَانَا عَذَابَ السَّمُومِ٢٧ إِنَّا كُنَّا مِنْ قَبْلُ نَدْعُوهُ إِنَّهُ هُوَ الْبَرُّ الرَّحِيمُ٢٨

"Dhe do t'ua zgjerojmë dhuntitë atyre me fruta dhe mish, si ua ka ënda."

"Atje do t'ia kalojnë njëri-tjetrit gotat e mbushura e nuk do të ketë biseda të kota e as gjynahe."

"Rreth tyre do të sillen shërbyes, djelmosha si margaritarë të fshehur."

"Ata do të afrohen, duke biseduar me njëri-tjetrin."

"E duke thënë: 'Më parë, Ne kemi pasur frikë në familjet tona (nga gjykimi i All'llahut)**.'"**

"Por, All'llahu na ka dhuruar mëshirë dhe na ka ruajtur nga era përcëlluese (e Zjarrit)**."**

"Ne qysh më parë i jemi falur Atij. Ai është vërtet Bamirës dhe Mëshirëplotë."

Komentimi

Të tjera begati për banorët e Xhennetit

Ajetet e mëparshme na paraqitën nëntë pjesë të begative të banorëve të Xhennetit, ndërsa ajetet në fjalë, paraqitin pesë pjesë prej tyre. E gjithë kjo panoramë, në tërësinë e saj, është një lloj menyje, që i tregon besimtarit se gjithçka nevojitet në Xhennet për qetësinë e tij, për lumturinë e tij, për kënaqësinë e tij, është e siguruar.

Kështu, ajeti i parë prej ajeteve në fjalë, paraqet dy lloje ushqimesh prej ushqimeve të banorëve në Xhennet. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Dhe do t'ua zgjerojmë dhuntitë atyre me fruta dhe mish, si ua ka ënda."**.

Fjala "*emdednahum,* buron nga fjala "*imdad"*. Gjuhësisht, ajo nënkupton *dhënien me bollëk*, shtimin e saj dhe vazhdimësinë e atij furnizimi. Kjo do të thotë se ushqimi i Xhennetit, qofshin frutat apo gjithçka tjetër, nuk harxhohet dhe as nuk soset prej konsumit të tyre. Pra, në dallim nga ushqimet e kësaj bote, të cilat harxhohen dhe mbarojnë nga konsumimi, me ushqimet e Xhennetit, nuk ndodh kështu.

Shprehja "*mima jeshtehune"* - **"si ua ka ënda"**, dëshmon qartë se banorët e Xhennetit janë të lirë në përzgjedhjen e ushqimeve, si të llojit të tyre, të sasisë dhe formës së servirur. Gjithçka që të kërkojnë, do t'u jepet. Natyrshëm, që ushqimet e Xhennetit nuk mund të jenë të kufizuara vetëm në këto dy lloje, pra, mish dhe fruta, por këto janë përmendur, për të treguar se

janë dy llojet më të rëndësishme të ushqimeve. Nga ana tjetër, përmendja e frutave përpara mishit tregon se frutat kanë përparësi ndaj mishit dhe janë më të vlefshme, më të shijshme dhe më të dobishme.

Ajeti që vijon, tregon pijet e mrekullueshme të banorëve të Xhennetit. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Atje do t'ia kalojnë njëri-tjetrit gotat e mbushura e nuk do të ketë biseda të kota e as gjynahe."**.

Ky ajet tregon se banorët e Xhennetit do t'i servirin njëri-tjetrit, kupa të mbushura me pije të mrekullueshme. Pije të pastra prej çdo pisllëku, prej çdo të keqeje, prej çdo lloj dëmi. Ata do të pinë në Xhennet pije të freskëta, të shijshme, të cilat e mbushin njeriun me gjallëri, mbrojnë trurin e tij nga çdo e keqe dhe dëmtim, e mbrojnë atë nga çdo dehje dhe mpirje. Pasi të pinë ato pije të mrekullueshme, nuk do të ketë konflikte dhe shamatë mes tyre. Përkundrazi, pijet e Xhennetit do të shkaktojnë vetëm kënaqësi, mirësi dhe lumturi të veçantë, trupore dhe shpirtërore.

Fjala *"jetenazeune"* buron prej fjalës *"tenazu'un"*, që nënkupton *"marrjen e kupave"* prej njëri-tjetrit. Ajo fjalë përdoret, gjithashtu, për të treguar konfliktualitetin si lojë ndërmjet dy palëve, ose shtyrjen mes tyre. Për këtë arsye, disa komentues kanë thënë se banorët e Xhennetit do të luajnë mes tyre dhe do të gëzojnë duke i marrë njëri-tjetrit kupat e mbushura me pijet e bekuara.

Po t'i referohemi studimeve të gjuhëtarëve, vëmë re se, kur fjala *"et tenazu'u"* vjen e shoqëruar prej fjalës *"ke'sun"* - *"kupë"*, ose të një fjale të ngjashme me të, nënkupton *"transferimin e kupës"* nga njëra dorë në tjetrën. Ajo mund të nënkuptojë, në të njëjtën

kohë, konfliktin ndërmjet dy palëve. Është e nevojshme të ndalemi këtu, me një urtësi gjuhësore dhe gramatikore të Kur'anit, e cila thotë: "Fjala "*el ke'esu" - "kupa"*, përfaqëson "*një enë të mbushur"*, ndërsa, kur është e boshatisur, nuk i thuhet më "*ke'esu" – "kupë"*."."[1]

Gjithsesi, duke qenë se kupa është përdorur në traditën historike të kësaj bote, për të nënkuptuar pijet alkoolike dehëse, ajeti që vijon, vjen për të sjellë sqarimet e nevojshme. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Nuk do të ketë biseda të kota, as gjynahe!"**, çka do të thotë se, prej konsumimit të pijeve, nuk do të ketë pasoja negative, të ngjashme me ato që ndodhin rëndom sot, përgjatë konsumimit të pijeve dehëse. Ajeti dëshmon se pijet e Xhennetit do të jenë të pastra, të kulluara, përveç kënaqësisë që do t'i dhurojnë konsumatorëve, ato do të jenë një lloj pastrimi për vetë ato.

Mirësia e katërt që do të gëzojnë banorët e Xhennetit, janë shërbëtorët, djelmoshat e rinj, që përmenden në ajetin kur'anor: **"Rreth tyre do të sillen shërbyes, djelmosha si margaritarë të fshehur."**.

Fjala "*el lu'luu el meknun",* nënkupton margaritarin apo perlën brenda guaskës së saj. Në këtë gjendje, perla është shumë e bukur dhe transparente, por, kur nxirret prej guaskës, ajri dhe duart që e prekin ndikojnë mbi të, duke ia zbehur disi bukurinë e duke ia transformuar gjendjen fillestare. Nga ky ajet, kuptojmë se djelmoshat e rinj, të cilët do t'u shërbejnë banorëve të Xhennetit

[1] Te libri i tij "El Mufredat", Ragibi ka thënë: "Fjala *"el ke'su" - "kupa"* është ena bashkë me pijen, me të cilën është mbushur." Ai, te "Mexhmaul Bahrejn", gjithashtu, ka thënë: "Nëse ena është e boshatisur, ajo quhet *"kad" – "han"*.

janë të bukur, të pastër, të kulluar, ashtu si dhe deklarohet në Kur'an, të bukur si margaritarët e fshehur.

Edhe pse në Xhennet nuk ka nevojë për shërbime, sepse njeriu do të ketë shtruar para tij gjithçka që dëshiron, shërbëtorët rrezëllitës vijnë si pjesë e "paketës" së nderimeve shtesë, që All'llahu i Madhëruar ka rezervuar për banorët e Xhennetit.

Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është pyetur për banorët e Xhennetit: "O, i Dërguari i All'llahut! Nëse shërbëtorët e Xhennetit do të jenë si margaritarë të mbuluar, atëherë cila do të jetë gjendja e vetë banorëve të Xhennetit?!", ai u përgjigj: "*Betohem në Atë që ka në dorë shpirtin e Muhammedit. Superioriteti i atyre që do t'u afrohet shërbimi, ndaj atyre që do t'u shërbejnë, është si superioriteti i Hënës së Plotë ndaj yjeve të tjerë!*".[1]

Fjala "*lehum*" - "*i/e tyre*", tregon qartë se çdo besimtar do të ketë në Xhennet shërbëtorët e tij personalë dhe të veçantë. Duke qenë se Xhenneti nuk është vendi i dhimbjes dhe i dëshpërimit, djelmoshat e rinj do t'u shërbejnë me dëshirë dhe kënaqësi banorëve të Xhennetit.

Një mirësi tjetër, në vargun e mirësive dhe të begative të mëdha, që do të shijojnë banorët e Xhennetit, është dhe ajo e qetësisë mendore dhe shpirtërore. Ata nuk do të shqetësohen aty, për asnjë ndëshkim apo vuajtje të caktuar. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ata do të afrohen, duke biseduar me njëri-tjetrin e duke thënë: 'Më parë, Ne kemi pasur frikë në familjet tona** (nga gjykimi i All'llahut)**.'"**.

[1] Kthehu te tefsiret: "Mexhmaul Bejan", "El Keshaf", "Ruhul Bejan" dhe "Ruhul Xhinan".

Ata, pasi të kenë hyrë në Xhennet, do të thonë se, edhe pse ishim në dynja, pranë familjarëve tanë e duhej të ndienim qetësi dhe siguri, na kaplonte një gjendje ankthi, makthi, frike dhe pasigurie, që prishte lumturinë. Kishim frikë çdo moment, se mos përfshiheshim nga ndonjë dënim i befasishëm i All'llahut, për jetët tona, a ndonjë fatkeqësi tjetër e ardhur prej Tij.

Në dynja kemi qenë të trembur dhe vazhdimisht të frikësuar, se mos fëmijët tanë nisnin rrugën e humbjes dhe të shkatërrimit të jetës së tyre.

Në dynja kemi qenë të trembur dhe vazhdimisht të frikësuar, se mos sulmoheshim befasisht prej armiqve tanë që na i ngushtonin, kështu, hapësirat jetike. Por, All'llahu i Madhëruar na begatoi me mirësitë dhe begatitë e Tij. Në ajetin që vijon, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Por, All'llahu na ka dhuruar mëshirë dhe na ka ruajtur nga era përcëlluese** (e Zjarrit)**."**.

Vërtet! All'llahu është Ai që na shpëtoi prej burgut të dynjasë dhe egërsisë së saj. Falënderimi i Takon All'llahut, që na shpërbleu me mirësitë e pafundme të Xhennetit.

Kur banorët e Xhennetit do të kujtojnë të shkuarën e tyre, detajet dramatike të ngjarjeve të saj dhe ta krahasojnë me gjendjen në Xhennet, do t'i njohin dhe do t'i vlerësojnë akoma më shumë mirësitë dhe begatitë e All'llahut, mirësi dhe begati që shijojnë nëpër hapësirat e mahnitshme të Xhennetit. Ata do t'i ndiejnë edhe më shumë ato mirësi, kur të bëjnë krahasimin. Është normale, që, kur të bëjnë krahasimin ndërmjet mirësive të kësaj bote dhe mirësive të Xhennetit, do të vërejmë se këto të fundit janë më të shijshme dhe më të dashura për njeriun.

Deklaratat e banorëve të Xhennetit, që sjell Kur'ani Famëlartë, dëshmojnë qartë se banorët e Xhennetit pranojnë një të vërtetë të madhe, se në Xhennet, do të kuptojnë më shumë se kudo tjetër, të qenit e All'llahut të Madhëruar Bamirës dhe Mëshirues i Madh. Ata do të thonë: **"Ne qysh më parë i jemi falur Atij. Ai është vërtet Bamirës dhe Mëshirëplotë."**.

Ndryshimi qëndron se në Xhennet, mrekullitë e premtuara më parë, janë më të prekshme dhe reale nga ç'kishin imagjinuar në dynja, pasi aty gjenden të përfshirë në Mëshirën e Tij të Madhe, në shpërblimin për veprat e tyre, të atyre veprave që nuk mund të jenë asgjë në krahasim me gjynahet e shumtë.

Nuk ka dyshim se ndodhitë e Ditës së Gjykimit dhe mirësitë e mëdha të Xhennetit, nuk janë tjetër përveç se shfaqja në realitet e kuptimeve madhështore të Emrave të bukur të All'llahut dhe cilësive të Tij mahnitëse. Pra, në Ditën e Gjykimit, besimtarët do të njihen më nga afër me të vërtetat e këtyre Emrave të bukur, më shumë, më mirë, më qartë, më me cilësi se në çdo kohë tjetër.

Vetë Xhehennemi, do të shpalosë atë ditë cilësitë e tij, urtësitë e ekzistencës, drejtësinë dhe ashpërsinë e tij.

Hulumtime

1- Fjala "*jetesaelune*" - "*do të pyesin*", e ka origjinën te fjala "*es sual*" - "*pyetja*", që nënkupton "*pikëpyetjen*". Pra, ata, banorët e Xhennetit, do të pyesin njëri-tjetrin. Folja e përdorur këtu tregon qartë se banorët e Xhennetit do të pyesin njëri-tjetrin për të shkuarën e tyre. Në fakt, përmendja e të shkuarës dhe diskutimi i saj mes banorëve të Xhennetit, përfaqëson, në vetvete, një mirësi dhe shije të veçantë. Ky rast është tërësisht i ngjashëm me atë të njerëzve që kthehen pas një udhëtimi të gjatë, të mbushur me lodhje, dhimbje, rreziqe dhe vështirësi, në një vend të paqtë, të qetë dhe të sigurt. Këta njerëz kënaqen duke diskutuar me njëri-tjetrin vështirësitë dhe momentet e vështira të udhëtimit të tyre të gjatë. Ata gëzojnë lumturinë që i fal të qenit të shpëtuar dhe të gjendur pas një vështirësie të tejkaluar, e cila nuk do të kthehet më kurrë.

2- Fjala "*mushfikijne*" - "*kemi pasur frikë*", buron nga fjala "*el ishfaku*". Në librin "El Mufredat", Ragibi thotë se kuptimi i kësaj fjale është "*afrimi me frikë drejt një destinacioni të caktuar*". Në rastet kur fjala paraprihet prej shkronjës "*mim*", lëvizja dhe afrimi konsiderohet akoma më i kujdesshëm. Nëse i kthehemi origjinës, vërejmë se kjo fjalë buron prej fjalës "*esh shefek*", që nënkupton "*dritën e përzier me errësirë*" apo një formë të agut. Pra, duhet të qartësojmë se çfarë kishin frikë ato në dynja?! Cili, vallë, ishte vendi ku ata drejtoheshin me kujdes?!

Këtu, kemi të bëjmë me tri mundësi, mes të cilave nuk ka ndonjë kundërshti, të cilat i kemi përmendur te komentet e ajeteve:

a) *"Frika prej All'llahut dhe lëvizja e tyre kah Ai, për të fituar shpëtimin e Tij!"*

b) *"Frika prej devijimit të familjarëve dhe interesimi i vazhdueshëm për edukimin e tyre!"*

c) *"Frika prej armiqve dhe marrja e masave për të mbrojtur veten prej tyre!"*

Po t'u referohemi kuptimeve të ajetit, në të cilin All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Por, All'llahu na ka dhuruar mëshirë dhe na ka ruajtur nga era përcëlluese** (e Zjarrit)**"**, me të drejtë mund të themi se kuptimi i parë është më i arsyeshëm.

3- Togfjalëshi *"fi ehlina "* - *"te familjet tona"*, në tërësinë e kuptimeve të tij është shumë i gjerë. Ai mund të përfshijë fëmijët, bashkëshortët, miqtë dhe të dashurit. Ky togfjalësh tregon se njerëzit, përgjithësisht, kur gjenden në shoqërinë e të afërmve familjarë, ndihen të qetë e të sigurt më shumë se sa me këdo tjetër. Në qoftë se në praninë e këtyre familjarëve, ata janë të trembur, atëherë, kuptohet cila është gjendja e tyre dhe vendi ku ndodhen. Pra, ky togfjalësh nënkupton të gjithë ata që All'llahu i ka sprovuar me familjet që nuk besojnë në Zot, prandaj kanë pasur frikë edhe nga vetë familjarët e tyre. Megjithatë, ata janë treguar qëndrestarë, kanë mbrojtur pavarësinë dhe besimin e tyre, duke u mbështetur fuqishëm tek All'llahu i Madhëruar, te mirësia dhe mbrojtja e Tij e sigurt. Kështu, ata shpëtuan dhe nuk morën ngjyrën e familjes së tyre.

4- Fjala *"es sumum"*, nënkupton *"temperaturën"* që depërton në thellësi të trupit dhe dëmton njeriun. Ajo përdoret edhe për të emërtuar *"erën e nxehtë"*. Ndodh, gjithashtu, si në rastin konkret, që *"adhabus sumum"* të përdoret për të nënkuptuar këtë lloj dënimi, i cili e *fut nxehtësinë thellë* trupit të njeriut, duke e dëmtuar rëndë atë. Për sa i përket fjalës *"es semmu" - "helm"*, ajo nënkupton *"lëndët helmuese"*, sepse lëndët helmuese shpërndahen në të gjithë gjymtyrët e trupit.

5- Fjala *"el ber'rru"*, në origjinë, është përdorur për të nënkuptuar *"tokën e thatë"*, të boshatisur prej bimëve, zakonisht, bregun e detit. Kjo fjalë është përdorur, gjithashtu, për të nënkuptuar *"tërësinë e aktiviteteve me natyrë pozitive, bamirësie dhe humane"*. Në fakt, All'llahut të Madhëruar i shkon dhe e meriton më shumë se kushdo këtë emërtim dhe cilësim, pasi Ai i ka mbuluar me mirësinë, butësinë dhe mëshirën e Tij të gjitha botët.

Lidhja e ajeteve dhe përmbajtja e tyre

Kemi thënë më lart se këto ajete, bashkë me ajetet e mëparshme, përmendin katërmbëdhjetë prej llojeve të mirësive dhe shpërblimeve në Xhennet:

1. Kopshtet

2. Mirësitë

3. Gëzimi dhe lumturia

4. Siguria prej dënimit të zjarrit

5. Konsumi i ushqimeve dhe i pijeve të shijshme

6. Mbështetja dhe qëndrimi mbi shtretër e kolltukë të vendosur, e renditur mrekullisht

7. Martesa me hyritë e bukura të Xhennetit

8. Bashkimi i fëmijëve me baballarët e tyre të ndershëm dhe besimtarë

9. Llojet e ndryshme të frutave të shijshme

10. Llojet e mishrave

11. Gjithçka që e dëshiron zemra e njeriut

12. Kupat e mbushura me pije të shijshme, që nuk dëmtojnë mendjen e njeriut

13. Rreth tyre do të sillen shërbyes, djelmosha si margaritarë të fshehur

14. Bisedat rreth dynjasë dhe ngjarjeve të saj, nëpër takime miqsh në paqe, lumturi dhe qetësi.

Një pjesë e këtyre mirësive janë të mira materiale, ndërsa pjesa tjetër të mira morale. Mirësitë, sido qofshin, materiale apo morale, që do të përfitohen nga banorët e Xhennetit, nuk kufizohen vetëm me sa përmendëm më lart. Ato përbëjnë vetëm një pjesë të papërfillshme të mirësive të mëdha që, All'llahu i Madhëruar ka rezervuar për të begatuar banorët e Xhennetit.

Ajetet 29 – 34

فَذَكِّرْ فَمَا أَنْتَ بِنِعْمَتِ رَبِّكَ بِكَاهِنٍ وَلَا مَجْنُونٍ٢٩ أَمْ يَقُولُونَ شَاعِرٌ نَتَرَبَّصُ بِهِ رَيْبَ الْمَنُونِ٣٠ قُلْ تَرَبَّصُوا فَإِنِّي مَعَكُمْ مِنَ الْمُتَرَبِّصِينَ٣١ أَمْ تَأْمُرُهُمْ أَحْلَامُهُمْ بِهَذَا أَمْ هُمْ قَوْمٌ طَاغُونَ٣٢ أَمْ يَقُولُونَ تَقَوَّلَهُ بَلْ لَا يُؤْمِنُونَ٣٣ فَلْيَأْتُوا بِحَدِيثٍ مِثْلِهِ إِنْ كَانُوا صَادِقِينَ٣٤

“Pra, paralajmëro (o Muhammed), **sepse ti, për dhuntinë e Zotit tënd, nuk je as fallxhi, as i çmendur!”**

“Vërtet thonë ata: ‘Ai është vjershëtar, të presim derisa ta zhdukë vdekja’?!”

“Thuaju: ‘Prisni, se edhe unë po pres bashkë me ju!’”

“A mos u vjen kjo nga mendja e tyre apo ata janë popull i ndërkryer?”

“Vërtet thonë ata: ‘Ai e ka trilluar atë’?! Nuk është kështu, por ata nuk besojnë.”

“Atëherë le të sjellin një libër të ngjashëm me të, nëse ajo që thonë është e vërtetë.”

Shkaku i zbritjes

Në një prej transmetimeve, përmendet se kurejshët mekas, u mblodhën në shtëpinë e En Nedvetu,[1] për të menduar se ç'duhej të bënin për t'u përballur me thirrjen islame, që konsiderohej si një rrezik i madh për financat e tyre të mëdha dhe të paligjshme.

Një nga burrat e fisit Abdu Ed Daru, sugjeroi se ata duhet të prisnin, derisa të vdiste Muhammedi, pasi ai, nuk ishte asgjë tjetër më shumë se sa një poet. Si të gjithë poetët e tjerë, si: Zuhejri, En Nabigatu dhe El A'asha, poetë të shquar të kohës para Islamit, të cilët jetuan për një kohë të caktuar dhe më pas u ndanë nga kjo botë, pra, siç ka ndodhur dhe me ta, do të ndodhë edhe me Muhammedin. Kështu, ranë dakord për këtë formë dhe u shpërndanë secili për në shtëpinë e tij. Atëherë zbritën ajetet e lartpërmendura, për t'iu kundërpërgjigjur atyre.

[1] *Daru En Nedvetu* - shtëpia e Nedves, është shtëpia e një personi të quajtur Kusaj bin Kilab, ose siç njihej ndryshe, gjyshi i arabëve. Ata janë mbledhur në shtëpinë e tij, për të diskutuar çështjet më të rëndësishme me të cilat përballeshin. Kjo shtëpi ka qenë shumë ngjitur me Shtëpinë e Shenjtë të All'llahut. Po të hapej dera e asaj shtëpie, të ofronte një pamje nga Qabeja. Kjo Shtëpi ka pasur një simbolikë dhe një rëndësi të veçantë, gjatë kohës kur ka jetuar Kusej ib Kilabi. (Kthehu te Historia e Ibn Hishamit, vëll. 2, f. 124; si dhe vëll. 1, f. 132.)

Komentimi

Dëshirat e idhujtarëve dhe sfida e Kur'anit

Në ajetet e mësipërme trajtuan çështje shumë të rëndësishme të mirësive të Xhennetit dhe një pjesë e shpërblimit të besimtarëve të devotshëm, ndërsa tani i vjen radha ajetit 29, i cili, duke iu drejtuar Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thotë: **"Pra, paralajmëro"**.

Nuk ka dyshim se zemrat e të dashuruarve pas së vërtetës, janë të etura për të dëgjuar fjalë e mesazhe si këto, prandaj ka ardhur koha t'ua përcjellim këto dëshira zemrave të tyre.

Kjo shprehje qartëson, se qëllimi kryesor i përmendjes së mirësive të Xhennetit dhe përshkrimi i shpërblimit, që rezervohet për secilën prej kategorive, banorë të Xhennetit dhe të Xhehennemit, është përgatitja e terrenit dhe e infrastrukturës shpirtërore për të përballur dhe për të pranuar disa të vërteta të reja. Për këtë arsye, është e këshillueshme për ligjëruesit myslimanë që gjatë ligjëratave të tyre, të praktikojnë të njëjtën metodologji në komunikim me besimtarët, pasi është shumë efektive dhe ndikon thellë në zemrat e njerëzve.

Kur'ani kujton akuzat që mohuesit dhe idhujtarët kryeneçë mekas ia drejtuan Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. All'llahu i Madhëruar, thotë: **"...sepse ti, për dhuntinë e Zotit tënd, nuk je as fallxhi, as i çmendur!"**.

Fjala "*el kahinu*", përdoret për të etiketuar të gjithë ata njerëz që merren me parashikimin e të ardhmes dhe çështjeve të panjohura. Zakonisht ndodh që pjesa më e madhe e fallxhorëve të pretendojnë se janë lidhur me xhindë, se janë ata burimi i informacioneve të tyre rreth të panjohurave. Përgjatë periudhës së paditurisë, fallxhorët kanë qenë të shumtë. Më të rëndësishmit dhe më të njohurit kanë qenë: Satihi dhe Sheku. Në përgjithësi, fallxhorët, janë njerëz inteligjentë, por me intelektin e tyre nuk u shërbejnë njerëzve, për fat të keq i mashtrojnë ata me pretendime boshe e të pabaza.

Në Islam, falli është rreptësisht i ndaluar. Fjalët e fallxhorëve janë të papranueshme. Arsyeja është se e panjohura është vetëm në zotërimin e All'llahut. Vetëm Ai mund ta zbulojë atë për njerëzit që përzgjedh Vetë. Ata mund të jenë Profetë dhe Imamë, në varësi të nevojës ose situatës.

Gjithsesi, kjo ishte një strategji e përzgjedhur nga kurejshët. Ata sajonin akuza dhe shpifje nga më të ndryshmet, me qëllim që banorët e Mekës të largoheshin prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kështu që ata, herë e akuzonin si fallxhor, herë si magjistar dhe herë si të çmendur. Me interes është fakti se ata nuk i ndalën akuzat, me gjithë kontradiktën që qëndron mes dy cilësimeve. Kjo, se magjistarët janë njerëz të mençur e njëkohësisht, të çmendur. Bashkimi i këtyre shpifjeve në ajet, është treguesi i kontradiktave të paarsyeshme në natyrën e akuzave që ngrinin armiqtë e Islamit.

Në vijim, Kur'ani sjell akuzën e tretë, ku Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

tij!) thotë: **"Vërtet thonë ata: 'Ai është vjershëtar, të presim derisa ta zhdukë vdekja'?!"**.

Meqenëse është poet, atëherë duhet ta durojmë, se poezitë e tij kanë bukurinë dhe emocionin e tyre, kështu që nuk është e nevojshme të shqetësohemi. Kur Muhammedi të vdesë, mesazhet e poezive të tij do të shuhen një herë e përgjithmonë, ashtu siç u shuan edhe ditët e jetës së tij, atëherë, do të biem rehat prej tij dhe thirrjes së tij.

Nga librat e gjuhës kuptojmë, se fjala *"el menunu"*, buron nga fjala *"el mennu"*, që përfaqëson dy kuptime: *"mangësinë"* dhe *"këputjen"*. Nga ana e tyre, këto dy fjalë kanë ngjashmëri të plotë kuptimore.

Më pas, e njëjta fjalë është përdorur, gjithashtu, edhe për të nënkuptuar vdekjen, sepse është, pikërisht, vdekja ajo që ndërpret numërimin e ditëve dhe vazhdimësinë.

Nëpërmjet fjalës *"el menunu"*, nënkuptohet edhe *"kalimi i kohës"*, pasi ai e bën vdekjen të detyrueshme, ndërpret marrëdhëniet dhe lidhjet me këtë botë. Nëpërmjet kësaj fjale, ndonjëherë, nënkuptohet *"nata"* me *"ditën"*.[1]

Kjo shprehje përdoret, gjithashtu, për të nënkuptuar *"vdekjen"*, ndaj dhe thuhet *"rejbul menuni" - "vdekja e dyshimtë"*. Ajo quhet e tillë, ngaqë është e panjohur koha, në të cilën do të ndodhë.[2]

---

[1] Kthehu te librat: "Lisanul Arab", "El Mufredat" i Ragibit, "El Munexhid" dhe tefsiri "El Kurtubij".

[2] Kthehu te libri "El Mufredat" i Ragibit.

Disa komentues kanë thënë se shprehja kur'anore "*rejbul menuni*", përmendur në ajetin, objekt i studimit tonë, nënkupton "*ngjarjet më të rëndësishme të kohës*". Transmetohet prej Ibn Abasit: "Sa herë që përmendet fjala *"rejb"* në Kur'an, ajo nënkupton dyshimin dhe lëkundjen, përveç ajetit të sures "Et Tur", ku nënkupton ngjarjet!",[1]

Të tjerë shprehen se ajo nënkupton "*gjendjen e tronditur dhe të lëkundur*". Kështu, kuptimi i shprehjes "*rejbul menuni*", në rastin konkret, nënkupton "*gjendja e lëkundur dhe e tronditur*", që e mbërthen njeriun para vdekjes.

Mundet që komenti i fundit, të kthehet te kuptimi i mëparshëm, pasi *"dyshimi"* dhe *"lëkundja"* janë origjina e tronditjes dhe e trishtimit. Njëlloj ndodh edhe për ngjarjet që nuk jemi njoftuar më parë, ato shkaktojnë gjendje të tronditjes, të dyshimit dhe të lëkundjes. Si përfundim, mund të themi se të gjitha këto komente, përfaqësojnë kuptimet e origjinës, që janë: "*dyshimi"* dhe *"lëkundshmëria"*.

Thënë ndryshe, fjala "*rejbun"* ka tri kuptime: *dyshimin, lëkundjen* dhe *ngjarjen*, të cilat janë një formë e shprehjes së shkak-pasojës.

Gjithsesi, armiqtë e Islamit qetësonin veten dhe vetëkënaqeshin, duke menduar se koha dhe kalimi i saj, do të ishin siguria më e mirë për të shmangur praninë dhe projektin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata shpresonin se do të binin në qetësi, së bashku me anëtarët e tjerë të shoqërisë, prej shqetësimit të madh që kishte

[1] Tefsiri "El Kurtubij", vëll. 9, f. 6242.

shkaktuar thirrja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për këtë arsye, në Kur'an vjen kundërpërgjigjja, duke i kërcënuar drejtpërsëdrejti këta dritëshkurtër me një fjali të vetme, por që, në vetvete, përçon një kuptim të madh. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Thuaju: 'Prisni, se edhe unë po pres bashkë me ju!'"**.

Kështu, pra, thuaju atyre: Ju prisni që të realizohen ëndrrat dhe përfytyrimet tuaja utopike, ndërsa unë do të pres që ju të përfshiheni në dënimin e All'llahut. Duhet të prisni dhe të bëheni gati, o ju, mohues idhujtarë. Pas vdekjes sime, Islami do të përhapet edhe më shumë nga ç'e mendoni. Me ndihmën e All'llahut, do të pres ta shoh Islamin, që të përhapet në të gjithë botën për sa jam gjallë, kurse pas vdekjes sime, ai do të vazhdojë duke mbretëruar dhe duke sunduar botën.

Vërtet! Ka një ndryshim të madh mes nesh. Ju mbështeteni tek imagjinata dhe përfytyrimet tuaja absurde, ndërsa unë mbështetem te fuqia dhe urtësia e madhe e All'llahut.

Më pas vjen ajeti kur'anor, që i tall dhe i kritikon pamëshirshëm ata, duke thënë: **"A mos u vjen kjo nga mendja e tyre apo ata janë popull i ndërkryer?"**.[1]

[1] Komentuesit e Kur'anit, kanë dhënë shumë mendime, lidhur me kuptimin e fjalës *"em"*, nëse është pyetëse, apo shkëputëse. Pra, nëse i jep fjalisë kuptimin: (Vërtet! Të gjithë kanë mendimin e tyre lidhur me atë), edhe pse mendimi i dytë është më pranë mendimit të tyre. Në fakt, edhe pse rrjedha logjike e ajeteve përputhet me mendimin e parë, duhet të dimë se përmendja e fjalës *"em"*, në raste si këto, duhet të jetë e paraprirë nga një *"hemze"*, që ka funksion pyetës. Për këtë arsye, El Fakhru Err Rrazi e ka komentuar atë në këtë formë: (A u është zbritur atyre Shpallje, apo i kanë marrë urdhrat prej imagjinatave të

Në popullin e vet, paria e kurejshëve konsiderohej si padrone e urtësisë dhe e ëndrrave të mëdha. Ata mbaheshin për njerëz me mençuri të madhe e të mprehtë. Prandaj, vjen Kur'ani, për të sqaruar se ç'lloj mprehtësie dhe zgjuarsie mund të kishin ato mendje, kur nuk arrinin të bënin dot dallimin mes Zbulesës hyjnore, ku ka argumente të qarta për të vërtetën e të drejtën, e poezisë dhe fallit në anën tjetër.

Ç'mprehtësi dhe zgjuarsi mund të përfaqësojë një mendje që pretendon se përfaqësuesi i Islamit, Profeti Muhammed, *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që ka qenë i njohur gjatë gjithë jetës për besnikërinë dhe sinqeritetin e tij, paska qenë njëkohësisht edhe poet, edhe i çmendur?!

Nisur nga sa u tha më sipër, mendojmë se të gjitha shpifjet dhe akuzat e tyre në adresë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ishin frymëzim i mendjeve dhe i logjikës së tyre, por ishte urrejtja, xhelozia, shpirti i kundërshtimit dhe fanatizmi i tyre, nga ku vinin urdhrat dhe buronin akuzat. Kur vunë re se interesat e tyre të paligjshme ishin në rrezik, hoqën dorë fare prej logjikës, duke i kthyer përfundimisht kurrizin të vërtetës, shtyrë prej urrejtjes dhe kokëfortësisë së tyre.

Fjala "*el ahlam*", është shumësi i fjalës "*hulumun*", që nënkupton "*intelektin (el aklu)*". Ragibi, në librin "El Mufredat" ka thënë se fjala "*el hulumu*", nënkupton "*vetëpërmbajtjen*, *ruajtjen e qetësisë në rast hidhërimi*". Ai është në të njëjtën kohë një shenjë që

tyre?!) Ai shton, gjithashtu, se Islami duhet të ndjekë argumentin e shkruar dhe atë logjik.

tregon mençuri, urtësi dhe vetëdije. Kjo fjalë e ka rrënjën leksikore të ngjashme me fjalën *"el hilmu"* - *"urtësi"*.

Fjala *"el hulum"* nënkupton *"ëndrrën"*, por nuk përjashtohet, gjithashtu, mundësia të jetë përfaqësuese e të njëjtit kuptim edhe në ajetin, objekt i studimit tonë. Kuptimi, në këtë rast, është: Fjalët dhe akuzat kanë qenë rezultat i ëndrrave të tyre të pavlera.

Kur'ani, edhe njëherë, vjen për të shënuar një tjetër akuzë prej akuzave të tyre. Kjo konsiderohet edhe si akuza e katërt në listën e paradokseve të tyre. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Vërtet thonë ata: 'Ai e ka trilluar atë'?! Nuk është kështu, por ata nuk besojnë."**.

Fjala *"tekau'uelehu"*, buron prej lëndës *"tekau'uele"*, e ngjashme në formë me fjalën *"tekel'lefe"*, që nënkupton gjendjen e njeriut që flet me veten, fjalë pa lidhje, pa kuptim dhe pa vlerë.[1]

Ky është një tjetër pretekst prej pretekseve të idhujtarëve dhe mohuesve kryeneçë të fesë, për të mos u dorëzuar ndaj ftesës së Kur'anit në besim dhe thirrjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky fakt përmendet në mënyrë të përsëritur në Kur'anin Famëlartë.

Këtë herë, Kur'ani vjen sërish, për të kundërshtuar fuqishëm, për t'i sfiduar ata dhe pretendimet e tyre të pabaza. Kështu që All'llahu i Madhëruar thotë: **"Atëherë le të sjellin një libër të ngjashëm me të, nëse ajo që thonë është e vërtetë!"**.

[1] Shkruesi i librit "Mexhmaul Bejan" thotë: "Fjala *"et tekaul"* është si *"et tekeluf"* dhe ajo nuk përdoret përveçse për gënjeshtrën.".

All'llahu i Madhëruar i sfidon ata, duke u thënë: Duke qenë se edhe ju jeni njerëz si ai (Muhammedi) keni të njëjtat aftësi me të, keni të njëjtat mundësi me të, keni të njëjtat burime informimi me të, keni të njëjtën gjuhë me të, atëherë ftojini të mençurit tuaj, poetët, gjuhëtarët, mendimtarët, të krijojnë një gjini të shkruar, e ngjashme me atë që i është zbritur Muhammedit.

Fjalia "*fel je'tuu*" - "*le të sjellin*", ka për qëllim t'i sfidojë mohuesit dhe të tregojë pamundësinë, paaftësinë dhe pafuqinë e tyre për të konkurruar Kur'anin Famëlartë.

Kjo është mënyra, nëpërmjet të cilës ngrihet sfida, ashtu si përshkruhet në librat e besimit. Kjo sfidë konsiston në ftesën e kundërshtarit për të sjellë një provë të ngjashme në natyrë, në formë dhe përmbajtje me mrekullinë e Kur'anit.

Ky është ajeti, në të cilin, shpaloset qartë mrekullia e Kur'anit. Kuptimi i tij nuk kufizohet vetëm te bashkëkohësit e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por përfshin të gjithë ata që kanë pretenduar përgjatë shekujve, se Kur'ani Famëlartë është fjala e njeriut, nuk është Zbulesë hyjnore, zbritur nga All'llahu i Madhëruar, si dhe pretendohet. Thënë më qartë, kemi të bëjmë me një ftesë të hapur për këtë kategori mohuesish, duke u thënë: "Në rast se ju pretendoni se Kur'ani nuk është Fjala e All'llahut, por e njerëzve, atëherë sillni, formoni, krijoni, shkruani një të ngjashëm me të, po qe se keni mundësi.".

Siç është e njohur për të gjithë, thirrja e Kur'anit nëpërmjet këtij ajeti, por edhe nëpërmjet ajeteve të tjera të ngjashme, është e fuqishme, sfiduese, madje dhe e drejtpërdrejtë. Prej katërmbëdhjetë shekujsh, nga koha e Profetit Muhammed *(Paqja e*

bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) deri në ditët tona, askush nuk ka mundur t'i përgjigjet kësaj sfide. Ne jemi të mirinformuar se armiqtë e Islamit, veçanërisht të krishterët dhe çifutët, shpenzojnë sasi të mëdha parash për ta vënë Islamin në vështirësi. Duke qenë kështu, ç'do t'i ndalonte ata të caktonin një pjesë të pasurisë së tyre të madhe, për ta vënë në dispozicion të mendjeve të ndritura dhe shkencëtarëve, që të rrëzonin Kur'anin dhe përmbajtjen e tij? Të bëhen prej atyre njerëzve, që All'llahu i Madhëruar, i cilëson në Kur'an, kur thotë: **"Atëherë, le të sjellin një libër të ngjashëm me të."**. Kjo mungesë dhe paaftësi vërteton katërçipërisht origjinalitetin dhe pa konkurueshmërinë e Shpalljes së All'llahut.

Disa komentues të Kur'anit, shtojnë diçka interesante me këtë aspekt, ndaj është mirë t'i kthehemi. Ata thonë: "Vërtet, në këtë, Kur'an, ka një fshehtësi të veçantë, të cilën e ndiejnë të gjithë ata që përballen me tekstet e tij, para se të hulumtojnë mrekullitë e tjera që e ndriçojnë atë. Ata që e lexojnë atë me vetëdije të plotë, në praninë e zemrës dhe mendjes, ndihen të mbështjellë prej një fuqie të veçantë dhe shumë të ëmbël, sidomos kur dhe i dëgjojnë këto ajete. Ata ndiejnë se diçka madhështore fshihet pas kuptimeve, janë ato kuptime, që i percepton vetëm mendja e besimtarit. Këto janë ndjenja dhe përjetime të veçanta emocionale, që mbizotërojnë qenien e njeriut, sapo dëgjon këndimin e ajeteve kur'anore. Këto të vërteta janë të mëdha, përjetohen dhe perceptohen qartë, njëherësh, prej shumë njerëzve. Në të gjitha rastet, në ajete, është elementi i veçantë që e përvetësojnë mrekullisht shqisat, të cilat shpeshherë e kanë të pamundur ta përkufizojmë me fjalë, ngaqë e kanë të pamundur të përcaktojnë burimin apo vendndodhjen e tij të saktë. Është e vështirë ta

përcaktosh, nëse gjithë kjo ngarkesë e mrekullueshme emocionale buron nga teksti apo kuptimet e tij, nëse është vetë tabloja, apo hija e saj, nëse gjithë kjo është ritmi i veçantë i melodisë së fjalëve në një gjuhë të caktuar, në janë të gjitha elementet e mbledhura së bashku, apo është një produkt krejtësisht tjetër, që zbret prej kufijve të së jashtëzakonshmes?!".

Kjo është e fshehta që depozitohet në çdo fjalë kur'anore. Këtë e ndiejnë të gjithë ata që përballen me këto tekste. Më pas, vijnë të tjera të fshehta dhe mrekulli, që perceptohen nëpërmjet meditimit, mendimit të thellë dhe shtjellimit të hollësishëm të asaj që Kur'ani përfaqëson në tërësinë e tij.[1]

Për më shumë sqarime rreth mrekullive të Kur'anit dhe shumëdimensionalitetin e tyre, i kthehemi fundit të ajetit 23 të sures "El Bekare", ku kemi zhvilluar një hulumtim të plotë e një shtjellim të imtësishëm për këtë aspekt. Të njëjtën gjë mund të bëjmë, duke iu kthyer edhe fundit të ajetit 88 të sures "El Isra".

[1] Tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 7, f. 605.

Ajetet 35 – 43

أَمْ خُلِقُوا مِنْ غَيْرِ شَيْءٍ أَمْ هُمُ الْخَالِقُونَ٣٥ أَمْ خَلَقُوا السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ بَلْ لَا يُوقِنُونَ٣٦ أَمْ عِنْدَهُمْ خَزَائِنُ رَبِّكَ أَمْ هُمُ الْمُصَيْطِرُونَ٣٧ أَمْ لَهُمْ سُلَّمٌ يَسْتَمِعُونَ فِيهِ فَلْيَأْتِ مُسْتَمِعُهُمْ بِسُلْطَانٍ مُبِينٍ٣٨ أَمْ لَهُ الْبَنَاتُ وَلَكُمُ الْبَنُونَ٣٩ أَمْ تَسْأَلُهُمْ أَجْرًا فَهُمْ مِنْ مَغْرَمٍ مُثْقَلُونَ٤٠ أَمْ عِنْدَهُمُ الْغَيْبُ فَهُمْ يَكْتُبُونَ٤١ أَمْ يُرِيدُونَ كَيْدًا فَالَّذِينَ كَفَرُوا هُمُ الْمَكِيدُونَ٤٢ أَمْ لَهُمْ إِلَهٌ غَيْرُ اللَّهِ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ٤٣

"A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos janë ata krijues të vetvetes?!"

"A mos vallë ata kanë krijuar qiejt dhe Tokën?! Nuk është kështu, por ata nuk janë aspak të bindur."

"A mos zotërojnë depozitat e Zotit tënd?! Apo mos janë ata sunduesit?!"

"A mos kanë ndonjë shkallë (për në qiell) **që e përgjojnë Atë?! Atëherë, le të sjellë përgjuesi i tyre dëshmi të qartë!"**

"Vallë, për Atë janë vajzat e për ju djemtë?!"

"A mos po kërkon ti shpërblim prej tyre, që të kenë frikë se mos po ngarkohen me detyrim?!"

"A mos zotërojnë të padukshmen, kështu që mund ta përshkruajnë?!"

A mos duan të ngrenë kurthe kundër teje? Ta dinë se vetëm mohuesit do të bien në kurthe."

"A mos ata kanë zot tjetër, veç All'llahut?! All'llahu është i Lartësuar mbi gjithçka që ia veshin Atij!"

Komentimi

Cila është fjala juaj e vërtetë?

Këto ajete vazhdojnë në të njëjtën natyrë hulumtuese si ajetet e mëparshme. Ato replikojnë me mohuesit e Kur'anit, për profetësinë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe mundësinë e pakufizuar të All'llahut të Madhëruar.

Në përgjithësi, të gjithë këto ajete fillojnë me fjalën "*em*", që nënkupton *pikëpyetjen*, e cila përfaqëson një varg argumentesh me plot 11 pyetje që vijnë njëra pas tjetrës, në formën e pyetjeve mohuese. Thënë më qartë: Këto ajete ia mbyllin të gjitha shtigjet në fytyrë kundërshtarëve, duke mos u lënë asnjë mundësi për të devijuar dhe për ta dredhur. Këtë gjë e realizon lehtësisht Kur'ani

Famëlartë, përmes disa shprehjeve të shkurtra, por shumë domethënëse, para të cilave çdokush do të përulej me respekt, qoftë dhe në mënyrë të pavetëdijshme, vetëm e vetëm prej madhështisë së tyre. Çdokush nga besimtarët e pranon harmoninë dhe madhështinë e magjishme të këtyre ajeteve.

Çështja e parë që trajtojnë ajetet që po komentojmë, është çështja e Krijimit. All'llahu i Madhëruar thotë: **"A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos janë ata krijues të vetvetes?!"**.[1]

Kjo shprehje e përmbledhur shkurt, në vetvete, tregon argumentin e shkakut, ashtu siç njihet në fushën e filozofisë dhe në shkencën e logjikës, për të vërtetuar ekzistencën e All'llahut. Ky argument konsiston në faktin se nuk ka asnjë dyshim që bota ku jetojmë, ka ardhur prej asgjësë. Ajo është në gjendje transformimi të vazhdueshme, e gjithçka që është në gjendje transformimi të pandërprerë, bën pjesë në familjen e të krijuarve, e gjithçka që bën pjesë në familjen e të krijuarve, është e pamundur të jetë përjetësisht e vjetër.

Duke qenë se bota është e gjendur, ajo nuk mund të dalë jashtë këtyre pesë gjendjeve:

1. U krijua pa asnjë shkak.
2. Ajo është shkaku i vetvetes.

[1] Ekzistojnë këndvështrime dhe mënyra të ndryshme komentimi, të lidhura me këtë ajet, kuptimi i të cilave është: "A janë krijuar pa kurrfarë qëllimi dhe nuk kanë asnjë përgjegjësi përmbi ta?!". Edhe pse një pjesë e komentuesve e kanë përzgjedhur këtë komentim, po të vërejmë me kujdes pjesën tjetër të ajetit, ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Apo mos janë ata krijues të vetvetes?!"**, do të shohim qartë se nënkuptohet pikërisht ajo që është përmendur në tekst: **"A u krijuan pa shkak, apo ata janë shkaktarë të krijimit të vetvetes?!"**.

3. Shkaqet e formësimit të botës, janë edhe shkaqet e ekzistencës së saj.
4. Kjo botë është shkak i një bote tjetër dhe shkak i një bote tjetër, deri në pafundësi.
5. Kjo botë është krijuar prej Shkaktarit të ekzistencës, i Cili është edhe Shkaku i ekzistencës së Vetvetes.

Kotësia e katër mundësive të para, përmendur më lart, është e qartë, pasi ekzistenca e të shkaktuarës, në mungesë të shkakut, është e pamundur. Përndryshe, gjithçka mund të ekzistonte vetvetiu në të gjitha rrethanat, por kjo është një gjë krejtësisht e pamundur.

Mundësia e dytë, që presupozon se e gjendura është shkaktare e vetvetes, është gjithashtu e pamundur. Pamundësia qëndron në faktin se shkaku duhet të ekzistojë para të shkaktuarës së tij, ndaj, në këtë rast, kemi të bëjmë me bashkimin e dy të kundërtave.

Është e njëjta edhe në mundësinë e tretë, që shkaqet e formësimit të botës të jenë në të njëjtën kohë edhe shkaqe të ekzistencës së saj. Kjo është tërësisht e pamundur, sepse rrëzohet koncepti i radhës në krijim.

Pothuajse njëlloj është situata edhe me mundësinë e katërt, që nënkupton radhitjen e vargut të shkaqeve deri në pafundësi, pasi kjo është plotësisht e pamundur, sepse dhe vargu i pafund i shkaqeve, në vetvete, është i krijuar. Kështu që e krijuara mbetet e krijuar, pra, ajo ka nevojë për dikë që ta krijojë apo ta gjejë prej asgjësë. A është e mundur, vallë, që prej një pafundësie zerosh të lindë një numër?! A është e mundur të lindë drita prej një errësire

të pafundme?! A mund të lindë pasuria prej humnerës së varfërisë?!

Nisur nga sa u tha më lart, e vetmja mundësi që ka një lloj logjike të pranohet, është mundësia e pestë, që flet për krijimin e ekzistencës prej Shkaktarit të saj.

Duke qenë se shtylla kryesore e këtij argumenti është mohimi i dy mundësive të para, atëherë, pohojmë se vetëm Kur'ani e pranon këtë.

Kështu që, tani e kuptojmë më së miri argumentimin në këto shprehje të përmbledhura.

Ajeti në vijim, ngre një tjetër pyetje rreth pretendimit në fazën më të ulët të periudhës së shkuar, kur thotë: **"A mos vallë ata kanë krijuar qiejt dhe Tokën...?!"**.

Nëse ata nuk janë gjendur pa shkak dhe në të njëjtën kohë, nuk kanë qenë shkaku i vetvetes, a mundet, vallë, të jenë shkaku i ekzistencës e të kenë krijuar qiejt dhe Tokën?! Nëse ata nuk e kanë krijuar ekzistencën, a është e mundur që All'llahu i Madhëruar t'i ketë ngarkuar me detyrën e krijimit të qiejve dhe të tokës?! Nisur nga këto që përmendëm, arrijmë në përfundimin se ata janë të krijuar dhe, gjithashtu, janë të ngarkuar me krijimin.

Është e qartë se ata e kanë të pamundur të kenë një pretendim kaq të kotë sa ky. Për këtë arsye, edhe ajeti mbyllet: **"...Nuk është kështu, por ata nuk janë aspak të bindur."**.

Vërtet! Ata thjesht përpiqen të justifikohen me pretekste të kota, vetëm për t'iu larguar besimit.

Më pas, Kur'ani, ngre një pyetje: "Nëse nuk i kanë pasur pretendimet e mësipërme dhe, nëse nuk kanë krijuar asgjë, atëherë, a mund të thonë se kanë depot (thesaret) e All'llahut!?"- **"A mos zotërojnë depozitat e Zotit tënd...?!"**[1], që të kenë mundësi t'u lëshojnë njerëzve diploma a certifikata profetësie dhe dijeje, që të kenë mundësi t'i furnizojnë me risk, apo në të kundërt, të kenë mundësinë për t'ua ndaluar njerëzve ato të mira?!" Më pas ajeti thotë: **"...Apo mos janë ata sunduesit?!"**. Mos janë vallë ata sunduesit e botëve dhe në duart e tyre gjenden fatet e krijesave dhe e ardhmja e tyre?!

Ata nuk munden, kurrsesi, të pretendojnë se zotërojnë depozitat e All'llahut. Ata nuk janë kontrolluesit dhe kujdestarët e botës, sepse ata janë aq të dobët, sa e kanë të pamundur të përballojnë qoftë edhe një sëmundje të vogël. Madje, janë aq të dobët, sa nuk mund ta përballojnë edhe dëmin që mund t'u shkaktojë një mizë e vogël. Nga ana tjetër, nevoja e tyre për mjetet elementare të jetesës, është argumenti më i qartë i pafuqisë dhe i pamundësisë së tyre për të sunduar botën dhe ekzistencën.

Në të vërtetë, mohimi i tyre s'është tjetër përveç se rezultat i egos, i urrejtjes, i kryeneçësisë, i mendjemadhësisë, i fanatizmit dhe i dëshirës për t'u dukur.

---

[1] Fjala *"el khazainu,* është shumësi i fjalës *"el khazinetu"*-"thesar, depo, magazinë", që nënkupton një vend ku ruhet gjithçka dhe ku nuk mbërrin dora. Aty njerëzit ruajnë gjithçka që dëshirojnë. Lidhur me këtë rast, Kur'ani thotë: **"Nuk ka asnjë send, që depozitat e tij, të mos gjenden tek Ne; por prej tij ne japim me masë të caktuar."** (Surja "El Hixhr", ajeti 21).

Fjala "*musajtirune*" - "*zotërojnë*", është tregues i një besëtytnie arabe në lashtësi. Ajo quhej *besëtytnia e llojeve*. Arabët e lashtë besonin se të gjitha llojet që përbëjnë ekzistencën, qofshin njerëz, kafshë, sende apo bimë, kanë një mbikëqyrës, një kontrollues, një zotërues, një Zot më vete, të cilin ata e quanin Zoti i llojeve. Arabët e konsideronin All'llahun si Zotin e llojeve. Ky lloj besimi apo kjo lloj besëtytnie, konsiderohet *shirk, idhujtari* në moralin islam. Në Kur'an tregohet qartë se zotëruesi dhe kontrolluesi i gjithçkaje, është vetëm All'llahu i Madhëruar dhe Ai cilësohet si Zoti i botëve.

Origjina e kësaj fjale buron nga rrënja "*satare*", që nënkupton "*rreshtimin e fjalëve gjatë shkrimit*". Ndërsa fjala "*el musajtiru*", nënkupton "*një person që ka pushtet mbi dikë apo diçka tjetër*", kështu me autoritetin e tij e udhëzon dhe orienton sipas vullnetit dhe dëshirës së vet. Shkrimtari është zotëruesi i fjalëve që shkruan. Duhet të kemi kujdes se kjo fjalë, njëkohësisht, mund të shkruhet me shkronjën "*sin*" dhe me shkronjën "*sad*", por në të dy rastet përcjell të njëjtin kuptim, edhe pse mënyra e përzgjedhur në Kur'an shkruhet me "*sad*".

Është e ditur tashmë se as mohuesit e profetësisë, as idhujtarët në kohën e paditurisë e askush tjetër nuk ka pretenduar kurrë ndonjë prej çështjeve që përmend Kur'ani. Kështu, Kur'ani hedh dritë mbi një tjetër çështje, në ajetin që vijon ku, thotë: Lidhur me këtë, All'llahu i Madhëruar, shton: **"A mos kanë ndonjë shkallë** (për në qiell) **dhe e përgjojnë Atë?!..."**

Vërtet, këta dritëshkurtër, pretendojnë se u zbret Shpallja e All'llahut?! Vërtet, që këta gënjeshtarë, pretendojnë se kanë

shkallë aq të lartë, sa mund të ngjiten deri në qiell dhe të dëgjojnë atje të fshehtat e Zbulesës hyjnore?!

Meqenëse ekzistonte mundësia, që ata të pretendonin se kishin informacion e dijeni rreth të fshehtave të qiellit, vjen Kur'ani Famëlartë për t'u kërkuar një argument, duke thënë: **"...Atëherë, le të sjellë përgjuesi i tyre dëshmi të qartë!"**.

Është plotësisht e kuptueshme, se, edhe nëse ata do të pretendonin diçka të tillë, nuk do të kishin mundësi dhe fuqi t'i vërtetonin pohimet dhe deklaratat e tyre, pasi nuk kishin ndonjë argument bindës për këtë.[1]

Më pas, Kur'ani, thotë: **"Vallë, për Atë janë vajzat e për ju djemtë?!"**. Vërtet, që këta të marrosur, thonë se engjëjt janë femra dhe se ato janë vajzat e All'llahut?!

Ky ajet vjen për të hedhur dritë mbi një tjetër pretendim, prej absurditeteve të tyre të kota, lidhur me trishtimin dhe hidhërimin që u shkaktonte gjinia femërore e femra në përgjithësi.

---

[1] Fjala "*sul'lemun*", në gjuhën arabe, nënkupton "*el mis'adu*" -"*ashensor*". Mund të nënkuptojë, në të njëjtën kohë, çdo lloj objekti që e ngre njeriun nga poshtë lart. Komentuesit e Kur'anit kanë dhënë mendime të ndryshme lidhur me atë që është nënkuptuar nëpërmjet kësaj fjale, në rastin konkret. Pra, cili ka qenë pretendimi i mohuesve dhe i idhujtarëve? Disa komentues kanë thënë se ata kanë pretenduar se prej Zotit u vinte Zbulesë hyjnore, ndërsa disa të tjerë kanë thënë se ata kanë pretenduar se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka qenë poet dhe i çmendur. Disa të tjerë pretendojnë se ata kanë thirrur për ndihmë dhe u janë lutur zotave, përveç All'llahut të Madhëruar. Disa e kanë komentuar këtë, me mohimin e profetësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahu qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Përfundimisht, është plotësisht e mundur të bashkojmë dy mendimet e mësipërme, edhe pse ajo që duket, është fakti se mendimi apo komentimi i parë duket më pranë së vërtetës.

Kur mësonin se gratë e tyre kishin sjellë në jetë vajza, ata sterroheshin në fytyrë nga turpi dhe droja, megjithatë, pretendonin se engjëjt janë vajzat e All'llahut. Atëherë, pyetja që lind natyrshëm, është: Në rast se ata do të kishin lidhje (si dhe pretendonin) me lartësitë prej nga zbriste Zbulesa hyjnore, si është e mundur, që, në të njëjtën kohë, të pretendonin mendime qesharake kotësish dhe iluzionesh? Si është e mundur të deklaronin si fe e besim, rituale e mendime qesharake, boshe dhe të pavlera si këto?

Natyrisht që mashkulli dhe femra nuk kanë asnjë ndryshim mes njëri-tjetrit nga pikëpamja e vlerës njerëzore. Kështu që shprehja e përdorur në ajetin e mësipërm, ka për qëllim të vërtetojë dhe të argumentojë pavërtetësinë dhe kotësinë e besëtytnive të tyre.

Në shumë ajete kur'anore lexojmë qëndrime të qarta të All'llahut të Madhëruar për këtë çështje, ku Ai i ka denoncuar dhe demaskuar ashpër këto besëtytni, preferenca gjinore dhe pretendime të ulëta.[1]

Më pas, Kur'ani trajton një tjetër etapë të rëndësishme, kështu që ajetet vijnë për të treguar njërën prej çështjeve, të cilën ata mund ta marrin si pretekst për të refuzuar. All'llahu i

[1] Kemi kryer hulumtime të gjata lidhur me shkaqet se përse arabët i konsideronin engjëjt vajzat e All'llahut dhe në të njëjtën kohë, kishin urrejtje dhe e shihnin me përçmim gjininë femërore. Lidhur me këtë çështje, kemi sjellë dhe kemi ofruar për lexuesin argumentet e gjalla, të cilat i solli Kur'ani kundër pretendimeve të tyre. Për më shumë sqarim, mund të ktheheni te fundi i ajetit 57 i sures "En Nahl" dhe te fundi i ajetit 149 i sures "Es Saffat".

Madhëruar thotë: **"A mos po kërkon ti shpërblim prej tyre, që të kenë frikë se mos po ngarkohen me detyrim?"**.

Fjala "*el megremu*", është e ngjashme në formë më fjalën "*magnem*", që ka kuptim të kundërt me të parën. Fjala nënkupton humbjet dhe dëmtimet që i vijnë njeriut nga të gjitha anët. Ndërsa fjala "*el garijmu*", përdoret si për atë që "*jep borxh*", ashtu edhe për atë që "*merr borxhin*".

Fjala "*el muthkalu*", buron nga fjala "*el ethkal*", që nënkupton "*mbajtjen, durimin e vështirësisë dhe vuajtjes*". Nisur nga ky sqarim, mund të themi se kuptimi i ajetit është: A mos vallë (o Muhammed) u ke vënë atyre ndonjë gjobë, apo u ke kërkuar një shpërblim në këmbim të përcjelljes së Mesazhit të All'llahut, e ata nuk janë në gjendje ta përballojnë dhe paguajnë, e për këtë arsye refuzojnë të besojnë?!

Përmendet vazhdimisht në Kur'an, jo vetëm në lidhje me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por edhe te Profetët e tjerë fakti, se fjala e parë që ata u kanë përcjellë popujve të tyre, kur kanë bërë thirrjen për të besuar në All'llahu, ka qenë: "Ne nuk presim prej jush asnjë shpërblim për thirrjen tonë dhe për udhëzimin që kemi sjellë për ju!". Këto sqarime kanë qenë intensivisht të pranishme në Kur'an, për t'u treguar të gjithë kryeneçëve, se pas thirrjes së Profetëve për besim e udhëzim, nuk qëndrojnë interesa personale, gjë që mjafton për të zhvlerësuar pretendimet e tyre dhe të gjithkujt tjetër që mendon si ata.

Edhe njëherë vjen ajeti kur'anor, për të ngritur një pyetje tjetër, ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"A mos zotërojnë të**

padukshmen, kështu që mund ta përshkruajnë?!". Ky ajet vjen për të treguar se mohuesit dhe idhujtarët kanë pretenduar se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka qenë vetëm një poet dhe njeri i prekur prej simptomave të çmendurisë. Kështu që me vdekjen e tij, gjithçka do të merrte fund. Së bashku me vdekjen, do të shuhej misioni, thirrja dhe vepra e tij, që do të përfundonin në koshin e plehrave të historisë. Këtë pretendim e kemi hasur edhe në ajetin e mësipërm, në të cilin, All'llahu i Madhëruar, pohon: **"Vërtet thonë ata: 'Ai është vjershëtar. Të presim derisa ta zhdukë vdekja'?!"**.

Pyetja në këtë rast, është: Ku e dinin ata se do të jetonin pas vdekjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të shihnin ç'do të ndodhte me fenë e tij më vonë? Kush ua tregoi atyre të panjohurën?

Është plotësisht e mundur që Kur'ani t'u përgjigjet atyre, kështu: "Nëse vërtet, ju pretendoni njohjen e të fshehtave (e të panjohurave) dhe dispozitat e vendosura prej All'llahut, e se nuk keni nevojë për Kur'anin dhe për fenë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, atëherë kjo është një gënjeshtër e madhe!".[1]

[1] Disa komentues kanë thënë se nëpërmjet fjalës *"el gajbu"* - *"e fshehta"* nënkuptohet *"Leuhi Mahfudhi"* – *"Libri"*, regjistri ku shënohen veprat e njerëzve. Disa komentues të tjerë kanë thënë se ajo fjalë vjen për të treguar pretendimet e idhujtarëve dhe veçanërisht pretendimin e tyre kur thonë: "Kur të bëhet Dita e Gjykimit, ne do të kemi një pozitë të rëndësishme dhe të veçantë tek All'llahu i Madhëruar.". Këto komentime nuk i përshtaten ajetit dhe nuk kanë lidhje mes njëri-tjetrit.

Më pas, Kur'ani trajton një tjetër mundësi hipotetike, që nënkupton këtë: Po të mos kishin ekzistuar pretendimet e mësipërme, atëherë, detyrimisht ata do të kishin bërë plane për të vrarë Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në mënyrë që dhe thirrja e tij të dështonte. Por, ata e dinin mirë, se planet dhe kurthet e All'llahut ishin më të forta, më të menduara dhe më të sofistikuara se planet e tyre djallëzore. Prandaj, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"A mos duan të ngrenë kurthe kundër teje? Ta dinë se vetëm mohuesit do të bien në kurthe!"**.[1]

Komenti i ajetit që vijon, përputhet tërësisht me ajetin 54 të sures "Ali Imran", në të cilin All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Dhe ata i përgatitën një kurth, por edhe All'llahu u përgatiti kurth** (dënim)**, se All'llahu është Strategu më i mirë!"**.

Disa komentues kanë ngritur edhe një tjetër hipotezë, lidhur me qëllimin e ajetit, objekt i studimit tonë, duke thënë se kurthi që ata kishin ngritur për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, do t'u kthehet atyre dhe do të jenë ata vetë viktimat dhe vuajtësit e kurtheve që kanë ngritur. Ky kuptim është i ngjashëm me kuptimin e ajetit 43 të sures "El Fatir", ku, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Ata u sollën me mendjemadhësi në tokë dhe me dredhi të shëmtuara, të cilat godasin vetëm atë që i bën!"**.

[1] Fjala *"el kejdu"* - *"kurth"* është e ngjashme në formë me fjalën *"sajdun"* - *"gjueti"* dhe ajo nënkupton *"dredhinë"*. Kjo fjalë është përdorur, gjithashtu, për të nënkuptuar devijimin e rrugës, por përgjithësisht në kuptimin negativ. Kjo fjalë, në më të shumtën e rasteve, nënkupton hiletë, dredhitë, kurthet, por ndonjëherë ndodh që ajo të nënkuptojë luftën.

Bashkimi mes dy komenteve të mësipërme është i mundur plotësisht dhe nuk ka ndonjë pengesë lidhur me këtë.

Ky ajet mund të këtë edhe lidhje të tjera me ajetin e mëparshëm. Njëra qëndron në faktin se armiqtë e Islamit thoshin: "Presim të vdesë Muhammedi!". Kështu që, Kur'ani, sjell kundërpërgjigjen, duke u thënë atyre, se:

1- Në rast se pretendonin me bindje të plotë se Muhammedi do të vdiste para tyre, me apo pa dëshirën e tij, kjo do të thoshte se ata kishin informacion mbi të panjohurën *(gajbin)*.

2- Mundësia e dytë nënkupton, se Muhammedi, do të ishte viktimë e kurtheve dhe e intrigave të tyre. Në këtë rast, ata duhet ta dinin fare mirë se kurthet dhe planet e All'llahut ishin shumë më të forta se kurthet e tyre. Ai e ka mundësinë që t'i bënte ata viktima të kurtheve dhe të intrigave, që vetë kishin thurur për Muhammedin.

Në anën tjetër, nëse ata imagjinonin se, nëpërmjet takimit të tyre në Shtëpinë e Nedves dhe nëpërmjet fabrikimit të akuzave ndaj tij, duke e cilësuar si fallxhor, të çmendur e poet, do të mund të triumfonin ndaj Profetit, atëherë, duhet ta kuptonin mirë se ishin duke sajuar një situatë budallallëku, verbërie, injorance dhe idiotësie ekstreme, pasi planet, fuqia dhe mundësitë e All'llahut janë përmbi çdo plan, fuqi dhe mundësi tjetër. All'llahu i Madhëruar ka dhënë garanci të plotë për mbrojtjen e jetës së Profetit të Tij, derisa feja të kalonte kufijtë e Mekës dhe të arrinte përbotshmërinë e saj.

Pyetja e fundit që ngre Kur'ani, lidhur me këtë aspekt, është: **"A mos ata kanë zot tjetër, veç All'llahut?..."**. Më pas vijon duke e ndarë veten prej gjithçkaje që nuk i takon madhështisë së Tij: **"...All'llahu është i Lartësuar mbi gjithçka që ia veshim Atij!"**.

Nisur nga sa thamë më lart, askush nuk mund t'i mbronte ata prej All'llahut dhe askush nuk mund ta ndalte ndëshkimin e Tij për ta. Kështu, po t'i kthehemi edhe njëherë tablosë së ajeteve të mësipërme, objekt i studimit tonë, vërejmë se All'llahu i ka marrë mohuesit dhe idhujtarët në pyetje, përmes një vargu të madh dhe të mirërenditur pyetjesh. Janë njëmbëdhjetë pyetje, që vijnë njëra pas tjetrës, duke i detyruar mohuesit hap pas hap të tërhiqen nga pretendimet e tyre. Këto pyetje vijnë për t'i detyruar ata të hiqnin dorë njëherë e përgjithmonë prej pretendimeve të kota, duke mbyllur për ta të gjitha shtigjet e largimit. Këto pyetje vijnë, që t'i zënë ata ngushtë, duke ua mbyllur të gjitha mundësitë dhe hapësirat, duke i lënë kështu, të pafjalë.

E bukur, e mrekullueshme dhe madhështore është metoda e përzgjedhur nga Kur'ani për të argumentuar, madje, mahnitëse janë edhe pyetjet hetuese të Kur'anit. Nëse secili prej tyre do të përjetonte sado pak nevojën dhe dëshirën për të njohur të vërtetën, padyshim do të dorëzohej me të gjithë qenien e tij përpara këtyre pyetjeve, me një logjikë të ftohtë e të përsosur.

Bukuria qëndron në faktin se në ajetin 43, nuk përmendet asnjë argument që ka për qëllim të rrëzojë gjithçka që mohuesit dhe idhujtarët adhurojnë pa të drejtë. Ai mjaftohet thjesht e vetëm duke e lartësuar All'llahun dhe duke e zhveshur Atë nga çdo e

metë. All'llahu i Madhëruar thotë: **"All'llahu është i Lartësuar mbi gjithçka që ia veshim Atij!"**.

Kjo ndodh sepse kotësia e hyjnizimit të putave dhe zotave të tyre të pavlerë, krijuar prej gurit, drurit, etj. - me gjithë dobësitë e tjera që kanë, bëjnë të pavlerë çdo lloj sqarimi dhe shpjegimi tjetër lidhur me to. Nga ana tjetër, janë shumë ajete kur'anore, nëpërmjet të cilave, All'llahu, ka vërtetuar kotësinë e zotave të tyre.

Ajetet 44 – 49

وَإِنْ يَرَوْا كِسْفًا مِنَ السَّمَاءِ سَاقِطًا يَقُولُوا سَحَابٌ مَرْكُومٌ٤٤ فَذَرْهُمْ
حَتَّى يُلَاقُوا يَوْمَهُمُ الَّذِى فِيهِ يُصْعَقُونَ٤٥ يَوْمَ لَا يُغْنِى عَنْهُمْ كَيْدُهُمْ
شَيْئًا وَلَا هُمْ يُنْصَرُونَ٤٦ وَإِنَّ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا عَذَابًا دُونَ ذَلِكَ وَلَكِنَّ
أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ٤٧ وَاصْبِرْ لِحُكْمِ رَبِّكَ فَإِنَّكَ بِأَعْيُنِنَا وَسَبِّحْ
بِحَمْدِ رَبِّكَ حِينَ تَقُومُ٤٨ وَمِنَ اللَّيْلِ فَسَبِّحْهُ وَإِدْبَارَ النُّجُومِ٤٩

"Edhe sikur të shihnin se po bie një copë nga qielli, ata do të thoshin: 'Është veç një grumbull resh.'"

"Prandaj, lëri ata të vazhdojnë kështu, derisa të takohen me Ditën, në të cilën, do të zalisen (nga frika)**."**

"Me Ditën, në të cilën, dinakëritë tyre nuk do t'u bëjnë asnjë dobi dhe kur ata nuk do t'i ndihmojë askush."

"Në të vërtetë, për të padrejtët ka edhe një dënim tjetër para këtij; por shumica e tyre nuk e dinë.

"Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd se, me të vërtetë, ti je nën Sytë Tanë! Lavdëroje duke e falënderuar Zotin tënd kur të ngrihesh."

"Edhe gjatë natës lavdëroje Atë, si dhe pas perëndimit të yjeve!"

Komentimi

Ti je nën mbikëqyrjen dhe kujdesin Tonë!

Në vijim të hulumtimeve nga ajetet e mëparshme, ku shpaloset diskutimi me idhujtarët dhe mohuesit kryeneçë, vijnë këto ajete, ku shpërfaqet qartë përpjekja për të gjithë ata njerëz, që janë vënë sinqerisht në kërkim të së vërtetës. Këto ajete, vijnë për të zbuluar edhe njëherë natyrën e mendjemadhësisë dhe të kryeneçësisë së tyre: **"Edhe sikur të shihnin se po bie një copë nga qielli, ata do të thoshin: 'Është veç një grumbull resh.'"**.[1]

Vërtet, këta mohues e idhujtarë ishin aq mendjemëdhenj e kryeneçë, sa ishin të gatshëm të komentonin edhe gurët e rënë prej qiellit, duke i quajtur re, edhe pse dallohet lehtësisht që retë nuk janë gjë tjetër veçse masa të buta avujsh. Atëherë, cila logjikë e shëndoshë i çoi ata deri aty, sa të deklaronin se bashkimi dhe rritja e dendësisë së reve i shndërronte ato në gurë?!

Kështu, shpaloset edhe njëherë gjendja e këtyre njerëzve dhe qëndrimi i tyre ndaj të vërtetave morale. Vërtet! Errësira e gjynaheve, adhurimi i egos dhe mendjemadhësia, bëhen pengesë e madhe, që qëndron mes horizontit të mendimeve të kthjellëta dhe të vërtetës. Janë pikërisht këto elemente dhe cilësi, që e

[1] Fjala "*el kisfu*" - "*copë*", e ngjashme në formë më fjalën "*el fisku*" nënkupton një copëz prej trupit të së tërës. Kështu, duke iu referuar vazhdimit të ajetit në të cilin All'llahu thotë: (*nga qielli*), duket qartë se nënkuptohet një copë prej gurëve të qiellit. Këto kuptime janë përmendur, gjithashtu, edhe në libra të tjerë të gjuhës dhe gramatikës. Shumësi i kësaj fjale është "*kisef*", e ngjashme në formë me fjalën "*inebun*" - "*rrush*". Pjesa më e madhe e komentuesve të Kur'anit mendojnë se kjo fjalë, në rastin konkret, është në njëjës. Kuptimi sipërfaqësor i ajetit tregon, gjithashtu, të njëjtën gjë, sepse e ka cilësuar si njëjës.

shtyjnë mendjen e njeriut të zhytet drejt mohimit të së vërtetave kaq të dukshme, duke humbur përfundimisht shpresën për udhëzimin e Tij.

Fjala "*el merkumu*", nënkupton grumbullin, dendësinë dhe mbledhjen. Pra, gjëra të vendosura njëra mbi tjetrën.

Për këtë arsye, në ajetin që vijon, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Prandaj, lëri ata të vazhdojnë kështu, derisa të takohen me Ditën, në të cilën, do të zalisen** (nga frika)**."**.

Fjala "*jus'akune*", buron nga fjala "*saaka*", *goditje, ndezje*, origjina e të cilës vjen nga fjala "*es saikatu*" - "*rrufe*", "*goditës*". Duke qenë se "*es saikatu*" - "*rrufeja*" e shkatërron atë mbi të cilën bie, kjo fjalë është përdorur për të dhënë edhe këtë kuptim.

Disa komentues kanë thënë se kjo fjali nënkupton vdekjen e përgjithshme, e cila do të përfshijë të gjitha gjallesat, para fundit të botës, si hap që paraprin Ditën e Gjykimit.

Në fakt, komenti i mësipërm duket larg të vërtetës, pasi ata nuk do të jetojnë deri në Ditën e Gjykimit. Në pamje të parë, duket se komenti i parë është më pranë të vërtetës, që do të thotë: lëri ata në mohimin e tyre, derisa t'u vijë vdekja, e cila do të shënojë, në të njëjtën kohë, edhe pikënisjen e shpërblimit dhe të dënimit të tyre në Botën Tjetër.

Nga sa u tha më lart, duket qartë se fjalia "*dher hum*" **- "lëri ata të vazhdojnë kështu"**, përfaqëson një urdhër, që mbart në vetvete një kërcënim, që do të thotë se, sado e madhe qoftë këmbëngulja për t'i udhëzuar ata në Rrugën e Drejtë, ata nuk

kanë për t'u udhëzuar. Prandaj edhe përpjekja e pandërprerë, në këto raste, është e pavlerë, nuk jep asnjë rezultat.

Sqarojmë se ajeti, në tërësinë e tij, nuk ka për qëllim të kufizojë kohën e thirrjes së njerëzve nga ana e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajeti nuk ka si qëllim të ndërpresë urdhrin për xhihad. Të gjitha pretendimet e disa komentuesve të Kur'anit, se ky ajet erdhi për të zëvendësuar me kuptimet e tij ajetet e xhihadit, është tërësisht i pabazë dhe i pavlerë.

Më pas, vjen ajeti kur'anor, në të cilin All'llahu përshkruan realitetin e asaj Dite, duke thënë: **"Me Ditën, në të cilën, dinakëritë tyre nuk do t'u bëjnë asnjë dobi dhe kur ata nuk do t'i ndihmojë askush."**.

Kiameti, Ringjallja e njeriut ndodh në ditën kur ndahet nga kjo jetë, sepse vdekja shënon dhe nisjen e shpërblimit apo ndëshkimit, një pjesë e të cilit ndodh në jetën e Berzahut (Jetën e Ndërmjetme), ndërsa pjesa tjetër në Kiametin e Madh, pra, Ringjalljen e përgjithshme. Gjatë këtyre dy periudhave, nuk vlen më asnjë lloj justifikimi për askënd. Askush tjetër veç Krijuesit të Gjithësisë, nuk mund të marrë përsipër t'i mbrojë e t'i shpëtojë.

Më pas vjen ajeti që u tregon atyre që mund të kenë kujtuar se dënimi do të jetë vetëm në jetën e Berzakhut (Jetën e Ndërmjetme) apo vetëm në Ditën e Gjykimit, se për ata do të ketë ndëshkim edhe në këtë botë. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Në të vërtetë, për të padrejtët ka edhe një dënim tjetër para këtij; por shumica e tyre nuk e dinë."**.

Nuk duhet të ketë dyshim se zullumqarët duhet të presin një ndëshkim të madh në këtë botë, ashtu si dhe janë ndëshkuar popujt e tjerë zullumqarë përgjatë historisë. All'llahu i ka ndëshkuar ata nëpërmjet goditjes me rrufe, i ka ndëshkuar me tërmete shkatërrimtare, me kepa gurësh të rënë prej qiellit, me thatësira të mëdha. I ka ndëshkuar duke i shndërruar në viktima të ushtrisë së Islamit, ashtu si ndodhi në Luftën e Bedrit. Të gjithë janë të mirinformuar se çfarë u ndodhi krerëve të idhujtarëve gjatë kësaj lufte, përveç rasteve kur janë zgjuar, janë kthjelluar, janë penduar dhe janë kthyer tek All'llahu me përulje e ndjesë.

Një pjesë e tyre u sprovua dhe u ndëshkua me thatësirë të madhe, disa të tjerë u vranë në Luftën e Bedrit, si e kemi përmendur dhe më parë. Por, një grup i madh u pendua, u kthye tek All'llahu, duke iu bashkangjitur radhëve të myslimanëve të ndershëm e të devotshëm. Këtë kategori njerëzish, All'llahu i Madhëruar, e përfshiu në faljen e Tij të madhe.[1]

Fjalia kur'anore: **"por shumica e tyre nuk e dinë"**, ka për qëllim të tregojë se pjesa më e madhe e atyre, që i pret ndëshkimi në këtë botë dhe në Ahiret (në Botën Tjetër), janë injorantë dhe të paditur. Kjo nënkupton, gjithashtu, se vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre ka fuqi ta perceptojë këtë, e megjithatë, ata ngulin këmbë të kundërshtojnë, pasi kundërshtimi përfaqëson urrejtjen dhe rebelimin e tyre ndaj së vërtetës.

[1] Ata që kanë thënë se fjalia "*fihi jusakune*", tregon Ditën e Gjykimit, e kanë komentuar ndëshkimin në ajetet, që po studiojmë, duke thënë se bëhet fjalë për ndëshkimin në Jetën e Ndërmjetme (Berzakhut), ndërmjet varrit dhe Ditës së Gjykimit. Por, duke qenë se komentimi i saj ka qenë i dobët, atëherë edhe kjo mundësi mund të konsiderohet e dobët.

Në ajetin që vijon, Kur'ani i drejtohet Profetit të Tij, duke e ftuar të bëjë durim dhe të qëndrojë i palëkundur përballë këtyre akuzave të ulëta. Ai e fton atë, gjithashtu, të vazhdojë qëndresën e tij në Rrugën e Drejtë. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd!..."**.[1]

Kështu, edhe nëse të akuzojnë, o i Dërguari i All'llahut, duke thënë se je poet, magjistar apo i çmendur, ti mos u dëshpëro, por duro! Edhe nëse të thonë se Kur'ani është i gjithi një sajesë, sërish duro! Edhe nëse ngulin këmbë te mendjemadhësia e tyre, te kryeneçësia e tyre, tek inati i tyre, tek urrejtja e tyre dhe vazhdojnë të refuzojnë hapur thirrjen tënde (me gjithë argumentet logjike që Ne u kemi sjellë), ti duhet të durosh, o Muhammed, të vazhdosh rrugën tënde me këmbëngulje e vendosmëri, pa u demoralizuar. Arsyen e gjithçkaje që lexuam më lart, e gjejmë tek ajeti që vijon, ku, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"...ti je nën Sytë Tanë..."**.

Ne e shohim dhe e vëzhgojmë gjithçka. Çdo gjë që ndodh me ty, o Muhammed, është nën vëzhgimin Tonë të plotë, ndaj

[1] Shprehja kur'anore: **"gjykimin e Zotit tënd"**, mund të nënkuptojë përcjelljen e gjykimit të Zotit, i cili i është dërguar Profetit. Kështu që Profeti duhet të durojë gjatë përcjelljes së mesazhit të Zotit. Mundësi tjetër është që shprehja **"gjykimin e Zotit tënd"** të nënkuptojë ndëshkimin që All'llahu ka premtuar për armiqtë e Tij: "O i Dërguari i All'llahut, duro derisa All'llahu t'i ndëshkojë ata!". Prej kuptimeve të tjera të kësaj shprehjeje mund të jetë edhe: "O i Dërguari i All'llahut, duke qenë se ky është gjykimi i Zotit tënd, atëherë ti duhet të durosh.". Edhe pse bashkimi ndërmjet kuptimeve të komentimeve të mësipërme është i mundur, mund të themi se komentimi i parë duket më pranë të vërtetës, veçanërisht po t'i referohemi detajit tjetër të rëndësishëm që vijon më pas, e në të cilin All'llahu i Madhëruar thotë: **"ti je nën Sytë Tanë."**.

duhet të jesh i qetë, sepse All'llahu nuk ka për të të lënë të vetëm në duart e tyre!

Fjalia kur'anore: **"...ti je nën Sytë Tanë..."**, është një shprehje mrekullisht e bukur, është një gjetje gjuhësore e mahnitshme, që tregon qartë dijeninë e plotë të All'llahut rreth ngjarjeve që i ndodhin Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajo tregon, gjithashtu, faktin se, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte tërësisht i përfshirë dhe i mbështjellë prej një përkujdesjeje të veçantë hyjnore, që e shoqëron në çdo çast të lëvizjeve dhe aktivitetit të tij jetësor.

Nuk ka dyshim se njeriu, sapo të ndiejë se ndodhet nën përkujdesjen dhe mbrojtjen e një fuqie me natyrë absolute, të ndiejë se veprat, përpjekjet dhe angazhimet e tij janë nën mbrojtjen e plotë të një fuqie superiore përkundrejt armiqve. Këto ndjesi dhe perceptime e mbushin me më shumë forcë e energji, sikur e vënë nën trysninë e madhe që ushtron ndjenja e përgjegjësisë.

Paraqitja e nevojës për All'llahun e Madhëruar, adhurimi i Tij, lartësimi i Tij, shenjtërimi i Tij, zhveshja e Tij prej çdo të mete, orientimi i mendjes dhe i shpirtit kah Qenia e Tij e Shenjtëruar, janë gjendje shpirtërore dhe mendore, që e mbushin njeriun me qetësi, bindje, vendosmëri dhe forcë. Menjëherë pas kësaj, vjen Kur'ani, duke dhënë urdhër të qartë për durim: **"...Lartësoje duke e falënderuar Zotin tënd kur të ngrihesh."**.

Lartësoje All'llahun, kur ngrihesh natën për të falur namazin e natës!

Lartësoje All'llahun, kur ngrihesh prej gjumit, për të falur namazin e detyruar!

Lartësoje All'llahun, sa herë ngrihesh prej një takimi a kuvendi me njerëzit, duke e falënderuar dhe duke e lartësuar Atë!

Komentuesit e Kur'anit kanë dhënë mendime të ndryshme, lidhur me këtë ajet. Mund të themi se bashkimi mes mendimeve të lartpërmendura është i mundur, edhe nëse bëhet fjalë për lavdërimin dhe përkujtimin e All'llahut natën, edhe nëse bëhet fjalë për namazin e detyruar *(farz)*, edhe nëse bëhet fjalë për lavdërimin dhe kujtimin e All'llahut, kur ngrihemi e largohemi nga një mbledhje a tubim i caktuar.

E vetmja mënyrë për ta ndriçuar zemrën dhe shpirtin dhe për t'u afruar atyre qetësinë e përhershme, është lavdërimi, lartësimi dhe adhurimi i All'llahut të Madhëruar, është parfumosja e gjuhës me përmendjen e Emrit të Tij. Është kjo mënyra më e mirë për të fituar mbështetjen dhe ndihmën e Tij, e për të triumfuar ndaj armiqve.

Në shumë prej transmetimeve që vijnë nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përmendet se ai e ka falënderuar dhe e ka lartësuar All'llahun, sa herë është ngritur prej kuvendeve të ndryshme, duke thënë: *"Në të vërtetë, kjo që unë bëj, bëhet shkak për faljen e gjynaheve të ndodhura në këtë kuvend!"*.[1]

[1] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 19, f. 24.

Transmetohet prej Profetit të Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "Subhaneke All'llahume, ue bi hamdike, esh'hedu en laa ilahe ila ente, nestagfiruke ue netubu ilejk" - *"I Lartësuar qofsh, All'llahu ynë! Të gjitha falënderimet të takojnë Ty, Zoti ynë. Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër të adhuruar me të drejtë, përveç Teje! Vetëm Ty të kërkoj të më falësh dhe vetëm për Ty është pendesa ime!"*.

Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është pyetur për këto fjalë, ai ka thënë: *"Ato janë fjalë që m'i ka mësuar engjëlli Xhibril dhe ato bëhen shkak për faljen e gjynaheve të kuvendit!"*.[1]

Më pas, në fund të ajeteve, objekt i studimit tonë, Kur'ani, thotë: **"Edhe gjatë natës lavdëroje Atë, si dhe pas perëndimit të yjeve!"**.

Lidhur me fjalinë kur'anore: **"Edhe gjatë natës, lavdëroje Atë!"**, shumë komentues të Kur'anit kanë thënë se kemi një tregues të qartë, që nënkupton namazin e natës. Sifjalia: "**si dhe pas perëndimit të yjeve",** nënkupton rekatet nafile të namazit të sabahut, që falen në të hyrë të mëngjesit, kur humbin yjet, aty ku fillojnë kufijtë e agut.

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, për kuptimin e sifjalisë: "**'si dhe pas perëndimit të yjeve'**, ka thënë se nënkuptohen dy rekatet nafile para dy rekateve farz të sabahut. Janë ato rekate që kryhen para se të kryhet falja e dy rekateve të detyruara. Kjo ndodh, pikërisht atëherë, kur nata është zhvendosur për t'i lënë vendin

[1] Tefsiri "Ed Durrul Menthur", vëll. 6, f. 120.

agimit dhe yjet kanë perënduar, kështu që nuk mund të shihen me sy të lirë.”.

Fjalia kur’anore: **“Edhe gjatë kryerjes së sexhdes lavdëroje Atë!”**, të cilën All’llahu i Madhëruar e ka përmendur në ajetin 40 të sures “Kaf”, nënkupton dy rekatet nafile që i falim pas tre rekateve të detyruara të akshamit. Natyrshëm, rekatet nafile të akshamit janë katër, mirëpo ky hadith kufizohet duke përmendur vetëm dy prej tyre.[1]

Në të gjitha rastet dhe pavarësisht gjithçkaje, nuk ka dyshim se adhurimi, përmendja, kujtimi dhe falënderimi i All’llahut në zemër të natës dhe gjatë agimit të mëngjesit, prodhojnë qetësi, kthjelltësi dhe qartësi të veçantë shpirtërore. Kjo natyrë adhurimi është më pak e ekspozuar ndaj shtirjes, të kryesh një vepër të caktuar, jo për të fituar kënaqësinë e All’llahut, por, që të të shohin njerëzit dhe të fitosh kënaqësinë e tyre. Janë këto lloje adhurimesh, në shërbim të të cilave vjen një shpirt më i përgatitur, më i qetë dhe më i kthjellët, sepse është i shkëputur prej halleve të ditës dhe problemeve të saj.

Nuk ka dyshim se nata e mbush njeriun me paqe, me qetësi shpirtërore dhe me gatishmërinë e plotë të qenies për t’iu dorëzuar Krijuesit të saj. Është një kohë pa zhurma, pa ngacmime dhe pa shqetësimet normale të ditës. Është një kohë që mund ta krahasojmë lehtësisht me momentin kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ngrit për një vizitë qiellore dhe të shenjtë, me anë të procesit të mahnitshëm hyjnor, që u quajt Miraxh. Janë këto çaste të

[1] Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 150, fundi i ajetit 40 i sures “Kaf”.

ngjashme me ato kur, Profeti iu afrua aq pranë Qenies Hyjnore e ashtu, i veçuar, iu lut plot përulje e modesti All'llahut.

Vëmë re se Kur'ani i ka dhënë një rëndësi shumë të madhe këtyre stacioneve kohore. Në një hadith të transmetuar prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* citohet: *"Dy rekatet e sabahut (mëngjesit) janë më të vlefshme se e gjithë bota dhe gjithçka që gjendet mbi të!"*.[1]

"O All'llahu ynë! Të lutemi Ty të na e mundësosh të ngrihemi netëve të jetës sonë, duke u falur dhe duke t'u lutur Ty!

O All'llahu ynë! Qetësoji zemrat tona me pushtetin që ka dashuria Jote! Të lutemi Ty t'i ndriçosh ato me dritën e dashurisë Tënde të madhe dhe t'i mbushësh plot e përplot me besim!

O All'llahu ynë! Na furnizo ne me durim dhe me qëndrueshmëri në Rrugën Tënde të Drejtë! Na mbush me fuqinë për t'u përballur me ushtritë e të keqes dhe të shejtanit të mallkuar. Të lutemi Ty, të na mbrosh prej kurtheve dhe planeve të tyre djallëzore! Të lutemi Ty, o All'llah, t'i bësh jetët tona si jetën e Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), që të jetojmë sipas udhëzimit të tij dhe të vdesim sipas traditës së tij!"

Amin, o Zot i botëve!

Fundi i sures "Et Tur"

[1] Tefsiri "El Kurtubij", vëll. 9, f. 6251, fundi i ajeteve objekt i studimit tonë.

Sure ″En Nexhm″

Zbritur në Mekë, 62 ajete

Përmbajtja e sures “En Nexhm″

Disa komentues të Kur'anit, mendojnë se kjo është surja e parë që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e këndoi me zë të lartë para publikut të gjerë të qytetit të Mekës. Sapo e dëgjuan këndimin e kësaj sureje, të gjithë idhujtarët dhe besimtarët e asaj kohe ranë në sexhde.[1]

Shumë komentues të Kur'anit mendojnë se kjo sure ka zbritur në Muajin e Bekuar të Ramazanit, në vitin e pestë të Profetësisë.[2]

Komentues të tjerë kanë shprehur mendimin se kjo është surja e parë, përmes së cilës ka zbritur Ajeti i sexhdes së detyruar.[3] Por nëse kemi parasysh pikëpamjen e njohur se surja "Ikra" ka zbritur para saj dhe në fund të asaj sureje është dhe Ajeti i sexhdes së detyruar, ky mendim nuk duhet të merret në konsideratë.

Sidoqoftë, kjo sure, për shkak se është mekase, trajton çështje themelore të fesë, veçanërisht të Profetësisë, eskatologjisë dhe të Ringjalljes. Me anë të kërcënimeve dhe paralajmërimeve të njëpasnjëshme, kjo sure u tërheq vëmendjen politeistëve.

Përmbajtjen e kësaj sureje mund të ndajmë në shtatë pjesë:

1- Në fillim të sures, pas betimit kuptimplotë dhe domethënës, diskutohet lidhur me vërtetësinë e Shpalljes. Kjo sure, që në fillim, e bën të qartë lidhjen e drejtpërdrejtë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me engjëllin e Shpalljes hyjnore, Xhebrailin. Kjo sure e

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 208.
[2] Po aty.
[3] Tefsiri "El Meragij" vëll. 27, f. 41.

madhëron pozitën e shenjtë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe thekson se çdo gjë që komunikon Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është Shpallje gna All'llahu.

2- Në pjesën tjetër të kësaj sureje flitet për Miraxhin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Me shprehje të shkurtra, por domethënëse dhe kuptimplote, kjo pjesë ilustron një pjesë të atij udhëtimi. Kjo sure, në vetvete, ka një lidhje të drejtpërdrejtë me Shpalljen e All'llahut.

3- Më pas, kjo sure diskuton edhe në lidhje me besëtytnitë e idhujtarëve në fushën e idhujve, diskuton në lidhje me adhurimin e engjëjve dhe çështje të tjera. Këto çështje buronin nga egoja dhe epshi. Kjo sure i qorton ashpër për këto besëtytni dhe i fton që të heqin dorë nga adhurimi i tyre. Këtë nocion e argumenton me anë të një logjike të fortë dhe të fuqishme.

4- Në pjesën tjetër, kjo sure mundëson pendimin e këtyre mëkatarëve dhe u afron atyre "faljen e gjerë", duke theksuar se çdokush është përgjegjës i veprave të veta dhe asnjëri nuk mbart barrën e mëkatit të tjetrit.

5- Për plotësimin e këtyre synimeve, në pjesën tjetër të kësaj sureje, reflektohet rreth një pjese nga çështja e Ringjalljes. Kjo sure sjell një arsye të qartë se çështja e Ringjalljes ekziston dhe është ndër më të rëndësishmet për besimtarët e kësaj bote.

6- Kjo sure përmend fatin e dhimbshëm të popujve të kaluar, që u treguan kryeneçë, inatçorë dhe këmbëngulës në udhën e armiqësisë (si populli i Adit, i Themudit, i Nuhit dhe i

Lutit) me synimin që t'i zgjojë e t'i paralajmërojë të pandërgjegjshmit dhe të painformuarit.

7- Surja përfundon me urdhrin për të bërë sexhde dhe për të adhuruar Zotin e Madhëruar.

Kjo sure dallohet për ajetet e shkurtra dhe tonin e prerë e të veçantë të tyre, të cilat u japin vlera tejet ndikuese, tejet depërtuese për zemrat dhe shpirtrat e përgjumur.

Kjo sure është quajtur "En Nexhm", për shkak të ajetit të parë të saj.

Mirësitë e leximit të sures "En Nexhm"

Në disa hadithe janë transmetuar mirësi të rëndësishme në lidhje me leximin e kësaj sureje:

Në një hadith nga Profeti i Islamit, lexojmë: *"Çdokush që e lexon suren "En Nexhm", Zoti i Madhëruar do t'i shkruajë atij dhjetë të mira në emër të çdo besimtari që i ka besuar Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe çdo mosbesimtari që e ka mohuar atë."*.[1]

Kurse në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Xhafer bin Muhammed Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Ai që lexon vazhdimisht, çdo ditë, ose çdo natë suren "En Nexhm", do të gëzojë respektin e njerëzve, Zoti do ta fali atë dhe ai do të jetë i dashur në mesin e njerëzve."*.[2]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 170.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 92, f. 305.

Një shpërblim i tillë madhështor u përket atyre njerëzve, të cilët e lexojnë këtë sure me përqendrim e meditim dhe më pas, jo vetëm e praktikojnë atë, por njohuritë e ndryshme të saj i përcjellin edhe te të tjerët.

Ajetet 1- 4

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالنَّجْمِ إِذَا هَوَى١ مَا ضَلَّ صَاحِبُكُمْ وَمَا غَوَى٢ وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَى٣ إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَى٤

Me emrin e All'llahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

"**Betohem në yllin kur perëndon."**

"**Se shoku juaj** (Muhammedi)**, nuk ka humbur e nuk ka devijuar."**

"**Ai nuk flet sipas qejfit të vet."**

"**Por ajo** (që thotë) **është vetëm Shpallje hyjnore, që i vjen atij."**

Komentimi

Interesant është fakti se surja paraardhëse, sureja "Et Tur" përfundoi me fjalën *"en nuxhum" - "yjet"*, kurse kjo sure fillon me fjalën *"en nexhmu"* – *"ylli"*, në të cilin All'llahu është betuar: **"Betohem në yllin kur perëndon."**.

Po çfarë synohet me fjalën "*nexhm*" në këtë ajet?

Komentuesit e Kur'anit kanë dhënë shumë mendime për këtë çështje. Disa komentues, fjalën "*nexhm*" e konsiderojnë si aludim për Kur'anin Fisnik, sepse përshtatet me ajetet në vijim, në lidhje me shpalljen. Përdorimi i fjalës "*nexhm*" bëhet për shkak se arabët, fjalën "*nuxhumen*" e përdorin në lidhje me një gjë që kryhet gradualisht dhe në faza të ndryshme. (Fjala përdoret gjerësisht për kreditin me këste dhe çështje të tjera të ngjashme me këtë.)

Përdorimi i fjalës "*nexhmun*" është më i pranueshëm, duke pasur parasysh faktin se Kur'ani i ka zbritur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përgjatë një periudhe njëzet e tre vjeçare dhe në etapa të ndryshme. Fjala "*idha heua*" përdoret për të treguar zbritjen e Kur'anit në zemrën e pastër të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Një grup tjetër, fjalën "*nexhm*" e konsiderojnë si aludim për njërin prej yjeve në qiell, për shembull për yllin "Thurejja"[1] ose yllin "Shaara"[2], sepse këta yje konsiderohen si yje me një rëndësi të madhe në vetvete.

[1] "*Therja*" është një tërësi yjesh. Pjesa dërmuese e tyre janë të qartë, kurse njëri është shumë pak i shndritshëm. Zakonisht i sprovojnë njerëzit me anë të saj, për të identifikuar forcën e shikimit. Betimi në këtë yll, ka gjasa të jetë për shkak të largësisë së madhe që ka me ne.

[2] "*Shaara*" është një prej yjeve më të shndritshme të qiellit, që me vullnetin e Zotit, në ajetin 49, të po kësaj sureje, do të flasim më shumë në lidhje me të. Sekreti i betimit në atë ka gjasa të jetë për shkak të ndriçimit të jashtëzakonshëm dhe dritës ultra të fortë, si dhe karakteristikave dhe veçorive që mbart në vete.

Disa komentues të tjerë kanë pohuar se me fjalën *"nexhm"* synohen meteorët, me anën e të cilëve djajtë dëbohen nga hapësira e qiellit. Prandaj arabët këto meteorë i quajnë *"nexhm"*.

Mirëpo asnjë prej këtyre komentimeve nuk është i argumentuar plotësisht dhe në mënyrë të qartë.

Ajeti, në pamje të parë, ashtu siç e kërkon edhe përdorimi i fjalës *"nexhm"*, është betim për të gjithë yjet në qiell. Yjet e qiellit janë prej shenjave të qarta të Zotit të Madhëruar, janë enigma të mëdha të universit, si dhe janë prej krijesave jashtëzakonisht madhështore të Zotit.

Kjo nuk është hera e parë që Zoti betohet për krijesat madhështore të botës së krijuar. Edhe në ajete të tjera kur'anore, Zoti është betuar për diellin, për hënën dhe për të ngjashme me to.

Më shumë merret për bazë perëndimi i tyre, megjithëse lindja apo shfaqja e tyre tërheq më shumë vëmendjen. Kjo bëhet për arsye se perëndimi i yjeve është tregues i përkohshmërisë së tyre, është sugjeruar si argument për mohimin e bindjes së adhuruesve të yjeve. Prandaj thuhet dhe në tregimin e Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi të!)*: **"E kur atë e mbuloi nata, ai e pa një yll e tha: 'Ky është Zoti im!'. Kur u zhduk ai** (perëndoi)**, tha: 'Unë nuk i dua ata që humbën.'"**.[1]

Gjithashtu, është e rëndësishme të dimë se *koncepti i lindjes* është në rrënjën e fjalës *"nexhm"*, sepse, siç thotë dhe Ragibi në veprën "Mufredat", origjina e fjalës *"nexhm"* përdoret për të emërtuar "yllin e lindur". Me këtë konotacion kuptimor,

[1] Sure "El En'am", ajeti 76.

përfshihet edhe *"rritja e bimëve në tokë"*, *"dalja e dhëmbëve në gojë"* dhe *"shfaqja e një teorie në mendje"*.

Në këtë mënyrë, Zoti është betuar edhe në lindjen e yjeve, edhe në perëndimin e tyre. Betimi në perëndimin e tyre bëhet për të treguar, se edhe ato janë të përkohshëm dhe u nënshtrohen rregullave dhe normave të krijimit.[1]

Por, le të shohim se për çfarë është përmendur ky betim. Këtë synim e sqaron ajeti që vijon: **"Se shoku juaj** (Profeti)**, nuk ka humbur e nuk ka devijuar!"**.

Ajeti sqaron se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* gjithnjë ecën në Rrugën e Drejtë dhe të vërtetë. Në fjalët dhe sjelljet e tij, nuk ekziston as devijimi më i vogël.

Fjala *"sahib"* është përdorur për të treguar mikun dhe shoqëruesin. Kjo fjalë mund të jetë aludim për të treguar se çdo gjë që ai (Profeti) e thotë, e thotë duke u nisur nga dashuria dhe dhembshuria që ka për ne.

Shumë komentues të Kur'anit nuk kanë bërë ndonjë dallim mes fjalës ضَلَّ *"dhal'le"* dhe fjalës غَوَىٰ *"gaua"*. Ata i konsiderojnë këto fjalë si plotësuese të njëra–tjetrës, por disa të tjerë janë të mendimit se midis këtyre dy fjalëve ekziston një dallim. Fjala ضلالة*"dhalaletu"* nënkupton njeriun që asnjëherë nuk gjen ndonjë

[1] Nëse në disa transmetime, fjala *"nexhm"* është komentuar për vetë Profetin *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse fjala *"heua"* në kuptimin e zbritjes së tij nga qielli në natën e "Mi'raxhit". Në fakt, është pjesë e brendshme e ajetit dhe jo anën e jashtme të tij.

rrugë që e çon në vendin e caktuar, kurse fjala غواية"*gavajet*" tregon atë njeri që ecën në një rrugë të drejtë, por me shumë probleme. E para krahasohet me politeizmin, kurse e dyta me besimin e mangët, ose siç thuhet ndryshe, me besimin që shoqërohet me "shthurje morale dhe mëkate."

Ragibi, në veprën "Mufredat", për kuptimin e fjalës غى "*gaj*", thotë: "Është një injorancë e shoqëruar me besim të devijuar", si rrjedhojë, fjala "*dhalaletu*", në kuptimin absolut të saj, është injorancë, mosdije dhe mos informim, kurse fjala "*gavajetu*" është një injorancë e shoqëruar me një besim të mangët dhe të korruptuar.

Sidoqoftë, Zoti i Madhëruar, nëpërmjet kësaj shprehjeje, dëshiron të mohojë çdo lloj devijimi, çdo lloj injorance, çdo lloj lajthitjeje dhe gabimi që mund të ketë lidhje me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Zoti i Madhëruar synon të neutralizojë të gjitha shpifjet, që janë ngritur ndaj tij, prej armiqve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Më pas, nënvizon këtë çështje dhe argumenton faktin se çdo gjë që e thotë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e thotë duke qenë i udhëzuar nga Zoti i Madhëruar: **"Ai nuk flet sipas qejfit të vet."**.

Kjo shprehje është e ngjashme me argumentin që u përmend më sipër, në lidhje me mohimin e gabimit dhe të humbjes së tij, sepse, zakonisht, ndjekja e dëshirave inferiore dhe epshi janë tregues dhe burim i humbjes.

Në suren "Sad", në ajetin 26, lexojmë: **"Mos shko pas dëshirave, se ato të shmangin prej Rrugës së All'llahut..."**.

Në hadithin e njohur të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të Imam Aliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* thuhet: *"Shkuarja pas epsheve dhe dëshirave inferiore, e pengon njeriun nga Rruga e Zotit."*.[1]

Disa komentues të Kur'anit janë të mendimit se fjalia *"ma dhal'le sahibukum"* - **"shoku juaj** (Muhammedi) **nuk ka humbur..."** është përdorur për të hedhur poshtë nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* "çmendurinë".

Gjithashtu, këta komentues thonë se folja *"ue ma gava"* - **"nuk ka devijuar"** është përdorur për mohimin e "të qenit poet", apo të çdo lloj lidhjeje me poezinë, sepse në ajetin 224 të sures "Esh Shuara" lexojmë: **"E për sa u përket poetëve** (që Muhammedi nuk është i tillë) **ata i ndjekin të humburit** (nga e vërteta)**."**.

Fjalia: **"Ai nuk flet sipas qejfit të vet",** është mohim ndaj "të qenët parashikues", sepse njerëz të tillë janë dhënë pas epsheve dhe pas qejfeve.

Më pas, në mënyrën më të qartë, thotë: **"Por ajo** (që thotë) **është vetëm Shpallje hyjnore, që i vjen atij."**.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk thotë asgjë nga vetja e tij. As Kur'ani nuk është pjellë e mendjes së tij. Të gjitha janë udhëzime të Zotit

[1] "Nehxhul Belaga", fjalimi 42.

të Madhëruar. Ky arsyetim mbështetet në shqyrtimet dhe analizat e ajeteve të Kur'anit, të cilat dëshmojnë se një njeri, sado i ditur dhe mendimtar qoftë, asnjëherë nuk është i aftë të sjellë fjalë dhe argumente të tilla, me përmbajtje skajshmërisht të thellë, sa t'u rezistojë kohëve dhe me kalimin e gjithë atyre shekujve, ato argumente të mbeten frymëzime për mendjet e ndritura dhe të mund të jetë një bazë për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë, të drejtë, besimtare dhe progresive. Ato janë Shpallje hyjnore dhe udhëzime nga Zoti i Madhëruar: **"Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo** (që thotë) **është vetëm Shpallje hyjnore, që i vjen atij."**.

Transmetimi mbresëlënës i poshtëpërmendur, është një dëshmi tjetër ndaj këtyre pretendimeve:

Dijetari i famshëm i Ehli Synetit, Sujutiu në tefsirin e tij "Durr'rrul Menthur", thotë: "Një ditë, i Dërguari i Zotit dha urdhër që të mbyllen të gjitha dyert e shtëpive që hapeshin drejtpërdrejt brenda xhamisë së Profetit (përpos derës së Aliut). Ky urdhër, i shqetësoi pa masë myslimanët. Hamzai, xhaxhai i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ankua, duke i thënë se si është e mundur që mbylle derën e xhaxhait tënd, Ebu Bekrit, Omerit dhe Abasit, kurse derën e djalit të xhaxhait e ke lënë hapur. Atij i dhe përparësi ndaj të tjerëve.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kuptoi që ky urdhër kishte krijuar shqetësime, prandaj i ftoi njerëzit në xhami dhe mbajti një fjalim të pashembullt në lidhje me madhërimin dhe monoteizmin. Më pas shtoi: 'O njerëz! Unë personalisht nuk i kam hapur dhe nuk i kam mbyllur dyert dhe juve nuk ju kam dëbuar nga xhamia.

Aliun nuk e përjashtova. Gjithë çfarë bëra, ishte Shpallje dhe urdhër nga Zoti. Më pas i këndoi këto ajete: **'Betohem në yllin kur perëndon, se shoku juaj** (Muhammedi)**, nuk ka humbur e nuk ka devijuar! Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo** (që thotë) **është vetëm Shpallje hyjnore, që i vjen atij.'"**.[1]

Ky hadith tregon pozitën e lartë të Imam Aliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ndaj të gjithë besimtarëve në Islam, sigurisht, pas personalitetit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky tregon se jo vetëm thëniet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* bazohen në Shpalljen hyjnore, por edhe veprat dhe sjelljet e tij janë të mbështetura në atë Shpallje.

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 122. (me pak shkurtim).

Ajetet 5 – 12

عَلَّمَهُ شَدِيدُ الْقُوَىٰ ۝٥ ذُو مِرَّةٍ فَاسْتَوَىٰ ۝٦ وَهُوَ بِالْأُفُقِ الْأَعْلَىٰ ۝٧ ثُمَّ دَنَا فَتَدَلَّىٰ ۝٨ فَكَانَ قَابَ قَوْسَيْنِ أَوْ أَدْنَىٰ ۝٩ فَأَوْحَىٰ إِلَىٰ عَبْدِهِ مَا أَوْحَىٰ ۝١٠ مَا كَذَبَ الْفُؤَادُ مَا رَأَىٰ ۝١١ أَفَتُمَارُونَهُ عَلَىٰ مَا يَرَىٰ ۝١٢

"Atë ia ka mësuar atij një (engjëll) **shumë i fuqishëm** (Xhebraili)**."**

"Mendjelartë, që iu paraqit qartë."

"Në horizontin më të lartë."

"Pastaj iu afrua e iu lëshua."

"Sa largësia midis dy harqeve ose edhe më afër."

"E i shpalli robit të All'llahut, atë që i shpalli."

"Zemra (e Muhammedit) **nuk gënjen për atë që ka parë."**

"Vallë, a do ta kundërshtonit atë për çfarë ka parë…"

Komentimi

Vizita e parë e mikut

Në ajetet e kaluara u diskutua për zbritjen e Shpalljes hyjnore te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në këto ajete flitet për mësuesin e Shpalljes.

Por duhet të kemi parasysh se këto ajete duket sikur janë të rrethuara nga një mister. Prandaj ato duhet të analizohen me kujdes dhe me përpikërinë më të plotë për zhdukjen e këtyre paqartësive. Në fillim do t'u hedhim një vështrim të përgjithshëm këtyre ajeteve dhe më pas do t'i analizojmë ato në mënyrë të detajuar.

Ajeti 5 thotë: **"Atë ia ka mësuar atij një** (engjëll) **shumë i fuqishëm** (Xhebraili)**."**.

Për ta saktësuar edhe më mirë këtë kuptim, ajeti 6 shton: **"Mendjelartë, që iu paraqit qartë"**.

Ndërkohë që ishte: **"Në horizontin më të lartë. Pastaj iu afrua e iu lëshua."**.

Deri **"Sa largësia midis dy harqeve ose edhe më afër..."**.

Këtu ishte Zoti që: **"...i shpalli robit të All'llahut, atë që i shpalli."**.

Ajeti 11 thotë: **"Zemra** (e Muhammedit) **nuk gënjen për atë që ka parë."**.

Ajeti 12 u drejtohet të tjerëve me një pyetje: **"Vallë, a do ta kundërshtonit atë për çfarë ka parë?"**.

Në komentin e këtyre ajeteve janë shtruar dy teza: njëra, e njohur dhe tjetra, e panjohur. Para se t'i trajtojmë këto dy teza, duhet të sqarohet kuptimi leksikor i disa fjalëve të ajeteve.

Nga leksikografët, është pranuar se fjala *"mir're"* përcjell kuptimin *"të përdredhurit"*. Konotacioni kuptimor i kësaj fjale lidhet me dukurinë e përdredhjes së litarit. Dihet se, sa më shumë të përdridhet litari, aq më i fortë dhe më i fuqishëm bëhet. Këtë kuptim sjell kjo fjalë. Pra, kjo fjalë përdoret për të treguar forcë, fuqi dhe qëndrueshmëri materiale dhe shpirtërore. Komentues të tjerë, fjalën *"mir're"*, e kanë konsideruar si fjalën *"murur"* dhe pranojnë se ajo përdoret në kuptimin e *"kalimit"*. Por kjo fjalë nuk ka një përputhje të plotë, me atë që kanë shpjeguar dhe kanë përshkruar leksikografët.

Fjala *"tedel'la"* rrjedh nga rrënja *"tedel'li"* dhe sipas Ragibit, në veprën "Mufredat" përdoret me kuptimin e afrimit. Kësaj fjale i bashkohet edhe fjala *"dena"*. Të dyja mbartin të njëjtin kuptim, atë të afrimit. Leksikografë të tjerë janë të mendimit se mes këtyre dy fjalëve ekzistojnë dallime. Ata kanë pranuar që fjala *"tedel'li"*përdoret me kuptimin e "varësisë", "të përkatësisë" dhe "të ndërvarjes", njësoj si varësia e frytit ndaj pemës. Prandaj dhe frutat që janë të varura në pemë, i quajnë *"devali"*.[1]

Fjala *"kab"* është përdorur në kuptimin e *"masës"*, kurse fjala *"kaus"* është përdorur në kuptimin e *"harkut"*, prandaj grupi emëror *"kabe keusejn"* nënkupton *"masën e gjatësisë së dy harqeve"*

[1] Huazuar nga tefsiri "Ruhul Bejan", ajeti në fjalë.

(harku ka qenë një prej armëve të vjetra që përdorej për qitje, për gjueti, etj).

Leksikografë të tjerë, fjalën *"kaus"* e konsiderojnë si rrënjë të fjalës *"kijas"*, që përdoret në kuptimin *"njësia matëse"*. Arabët, si njësi matëse, kishin dhirajën, pra, krahun, (d.m.th. largësinë mes majës së gishtave dhe bërrylit). Si rrjedhim, edhe fjala *"kabe kausejn"* është pranuar se përdoret me kuptimin e largësisë mes "dy krahëve".

Në disa fjalorë, fjala *"kab"* është sqaruar edhe në një mënyrë tjetër. Në këta fjalorë, kjo fjalë është pranuar si largësia midis vendit të kapjes së harkut me dorë dhe pikës së kthyer të harkut (harqet ishin në formë të thyer, të dy fundet e saj ishin të kthyer).

Si rrjedhojë, grupi emëror *"kabe kausejn"* është pranuar se përdoret në kuptimin e tërësisë së kthyer të harkut.[1]

Tani le t'u rikthehemi dy tezave, dy pikëpamjeve të komentimit të mësipërm:

Teza e njohur e komentuesve, është se mësuesi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është Xhebraili besnik, engjëlli i Shpalljes së Zotit, i cili shquhej për një forcë të jashtëzakonshme.

Ai zakonisht i shfaqej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në formën e një njeriu të pashëm dhe ia komunikonte atij Mesazhin e Zotit përgjatë gjithë

[1] Kanë pohuar se në këtë rast është përdorur në fjalën *"kalb"* (zemër) dhe në thelb ka qenë *"kabi keus"*.

jetës së tij. Vetëm dy herë i është shfaqur me formën dhe fytyrën e vet të vërtetë.

Hera e parë ishte ajo që u përmend në ajetet e mësipërme, ku tregohet se ai u shfaq në horizontin më të lartë (i cili kishte mbuluar të gjithë Lindjen dhe Perëndimin. Ishte aq madhështor, saqë edhe Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kishte pushtuar emocioni. Ky engjëll iu afrua aq shumë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sa mes tyre nuk kishte ndonjë largësi. Prandaj grupi emëror *"kabe kausejn"* tregon afërsinë e madhe.

Hera e dytë ishte gjatë ngjarjes së Miraxhit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Këtë do ta diskutojmë më gjerësisht në ajetet që vijojnë.

Disa komentues që kanë përkrahur këtë tezë, kanë nënvizuar se takimi i parë i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me engjëllin e Shpalljes, në formën e tij të vërtetë, ka ndodhur pranë shpellës Hira në Malin e Dritës.[1]

Por ky komentim, me gjithë mbështetësit që ka, nuk iu shmanget disa pasaktësive, sepse:

[1] Një grup i madh komentuesish, si për shembull: Tebrasi në "Mexhmaul Bejan", Bejdavij në "Enuarul Tenzil", Zemekhsheri në "Keshaf", Kurtubi në komentimin e tij, "Ruhul Bejan", Fakhr Razi në "El Kebijr", Sejjid Kutub në "Fi dhelalil Kur'an" dhe Muragij, në komentimin e tij, edhe shprehjet e Tabatabiut në "El Mizan", janë të mendimit se me togfjalëshin *"shedidul kuva" - "fuqia e rëndë"* synohet Xhebraili.

1- Në ajetin: **"E i shpalli robit të All'llahut, atë që i shpalli",** referim i përemrave (sidomos i përemrit *"abdi-hi"*) është Zoti. Por, në qoftë se *"shedidul kuva"* do të ishte cilësi e Xhebrailit, atëherë do të kuptohej se të gjithë përemrat do t'i referoheshin atij. Këtej mund të kuptohet që ky ajet është i ndarë nga ajetet e tjera. Mirëpo prishja e kohezionit të ajeteve dhe referencës së përemrave, është në kundërshtim me strukturën e natyrshme të fjalisë.

2- Grupi emëror *"shedidul kuva"* përdoret me kuptimin e dikujt me fuqi të jashtëzakonshme, përshtatet vetëm me Qenien e Stërpastër të Zotit. Është e drejtë që në ajetin 20 të sures ''Et Tekuir'', Xhebraili është përmendur si: "**është i fortë dhe që ka vend të lartë te Zoti i Arshit"**. Por duhet thënë se ekziston një dallim shumë i madh mes grupit emëror *"shedidul kuva"*, që ka një kuptim të përgjithshëm dhe të gjerë dhe fjalës *"dhil kuvve"*, ku *"kuvve"* - *"forca"* është përmendur në numrin njëjës dhe në trajtën e pashquar.

3- Në ajetet vijuese, thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka parë Xhebrailin në afërsi të Sidretul Munteha, (e ka parë mbi qiejt). Dihet se Xhebraili, gjatë Miraxhit, që prej fillimit të nisjes nga toka, ishte bashkudhëtar i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Këtej kuptohet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk e ka parë Xhebrailin vetëm në kulmin e qiellit. Kjo mund të supozohet vetëm nëse pranojmë se në fillim e pa atë në formën e një njeriu, kurse në qiej, në formën e tij origjinale, pra, në formën e vërtetë të Xhebrailit. Por, për këto çështje nuk ka asnjë dëshmi në ajetet që ta vërtetojnë këtë.

4- Përdorimi i shprehjes *"al lemehu"* në Kur'anin Fisnik tregon se Xhebraili nuk ishte mësuesi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por ishte ndërmjetësuesi i Shpalljes. Mësuesi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është vetëm Zoti dhe askush tjetër.

5- Është e vërtetë se Xhebraili është një engjëll me pozitë të lartë, por Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka një pozitë edhe më të lartë. Kështu thuhet edhe në ngjarjen e Miraxhit: Pra, Xhebraili ishte shoqërues i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* gjatë udhëtimit të Miraxhit dhe, kur arriti në një pikë, ndaloi dhe tha: "Nëse ngjitem edhe pak më lart, do të më digjen pendët dhe krahu!", ndërkohë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e vazhdoi më tutje rrugëtimin e vet.

Megjithëkëtë, paraqitja e jashtme e Xhebrailit, në formën e tij reale dhe origjinale, nuk përshtatet dhe aq shumë me rëndësinë që i është dhënë në këto ajete. Kjo kuptohet nga fakti se, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përgatitej për t'u takuar me Xhebrailin, nuk e shihte këtë takim dhe aq të rëndësishëm, ndërkohë që në ajetet në fjalë i është kushtuar një rëndësi jashtëzakonisht e madhe këtij takimi.

6- Fjalia: "**Zemra** (e Muhammedit) **nuk gënjen për atë që ka parë."**, është argument për një ndjeshmëri të brendshme të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe jo një shikim ndijor i Xhebrailit me anë të syrit.

7- Së fundi, duhet thënë se në hadithe të shumta, që janë transmetuar nga burimet e Ehli Bejtit, nuk flasin për Xhebrailin. Këto hadithe përputhem me komentimin e dytë, ku thuhet: Synimi i këtyre ajeteve është njohje intuitive e brendshme dhe e veçantë në lidhje me esencën e pastër të Zotit, që iu mundësua Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në këtë çast, dhe më pas u përsërit edhe në rrugëtimin e Miraxhit. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mbeti tejet i impresionuar nga përjetimi shpirtëror i këtij takimi.[1]

I ndjeri Shejkh Tusi, në veprën "Amali" transmeton nga Ibn Abasi, se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Në kohën që u ngjita në Qiell, iu afrova aq shumë Zotit, sa largësia mes meje dhe Atij ishte më pak se një hark."*.[2]

I ndjeri Saduk, në veprën "Ilelul Shera'iu", të njëjtën përmbajtje e ka transmetuar nga Hisham bin Hakemi, nga Imam Musa ibn Xhaferi, në një hadith shumë të gjatë. Midis të tjerash, thotë: *"Në kohën që Profeti Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) u dërgua në qiell dhe largësia e tij me madhërinë e Shenjtë të Zotit ishte në masën e një harku ose më e vogël se harku, u hoq një mbulesë prej mbulesave para shikimit të tij."*.[3]

---

[1] Edhe në lutjen "En Nudbetu", gjithashtu, ekziston një shprehje, e cila përputhet me këtë kuptim. Aty thuhet: "O fëmija i atij që u afrua dhe u afrua, deri sa largësia mes tyre ishte sa dy harqe apo më pak. Ky afrimitet ishte me Zotin e Lartësuar.". Në po këtë lutje, gjithashtu, është përmendur edhe një prej Emrave të Zotit, si *"shedidul kuva"*: *"ue erihi sejjidehu ja shedidel keua"*.

[2] "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 149.

[3] Po aty.

Në tefsirin e Ali bin Ibrahimit, gjithashtu, thuhet: *"Më pas Profeti iu afrua Zotit të Madhëruar!"*.[1]

Këto përdorime kuptimore i hasim edhe në shumë hadithe të tjera, prandaj nuk mund të mos merren parasysh.

Ehli Syneti, gjithashtu, në tefsirin "Durr'rrul Menthur" transmeton një hadith, me po këtë kuptim. Ky kuptim është transmetuar nga Ibn Abasi në dy mënyra: [2]

Tërësia e këtyre argumenteve dhe e dëshmive, tregon se interpretimi i dytë është më i saktë. Aty thuhet: "Grupi emëror *"shadidul kuva"* ka për synim Zotin e Madhëruar dhe afrimin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me esencën e Tij të pastër.''.

Por, kjo mund të jetë shkaku që shumica e komentuesve të mos e marrin në konsideratë këtë koment dhe të zgjedhin komentin e parë. Kjo ndodh, sepse komentimi në fjalë, përmend vendin me synimin e personifikimit të Zoti.

Ndërkohë që është e qartë se All'llahu nuk ka as vend, as trup: **"Të parët** (e njerëzve) **nuk mund ta përfshinë Atë, e Ai i përfshin të parët..."**.[3]

"të All'llahut janë edhe lindja edhe perëndimi dhe kudo që të ktheheni, aty është anë e All'llahut. Vërtetë All'llahu është Gjithëpërfshirës dhe i Gjithëdijshëm."[4]

---

[1] Po aty, vëll. 16, f. 148.
[2] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6 f. 123.
[3] Sure "El En'am" , ajeti 103.
[4] Sure "El Bekare", ajeti 115.

"...dhe Ai është me ju kudo që të jeni..."[1]

Kur një dijetar e kanë pyetur për komentimin e këtyre ajeteve, ai ka dhënë këtë përgjigje: "Aty ku Xhebraili nuk ka fuqi, kush jam unë që të komentoj këtë kuptim?!".[2]

Dimë se Kur'ani është Libër udhëzues, që ka zbritur për meditim, për reflektim dhe për këshillimin e njerëzve. Pranimi i këtij qëndrimi është i vështirë, sepse ajetet kanë zbritur nga ana e Zotit të Madhëruar, por njerëzit nuk arrijnë t'i perceptojnë ato.

Në qoftë se ajetet i komentojmë në kuptimin e dytë të tyre, pra, si një lloj vëzhgim intuitiv, si një afrim i veçantë shpirtëror, të gjitha këto probleme do të asgjësohen. Ky shpjegim saktëson se Zotin e Madhëruar nuk mund ta shikojmë as në këtë botë e as në Botën Tjetër, sepse Zoti nuk është trupor dhe material.

Por Zotin mund ta shohim me anë të zemrës dhe mendjes. Këtë e ka përmendur edhe Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, kur i është përgjigjur Dhu'leb el Jemanit: *"Sytë Atë nuk e shohin me shikim të drejtpërdrejtë, por zemrat e njohin Atë përmes të vërtetave të besimit."*.[3]

Duhet të kemi parasysh se ajo që e quajtëm "shikimi i brendshëm (intuita)", klasifikohet në dy lloje. Njëra është "shikimi mendor", që përftohet me anë të argumentimit spekulativ dhe tjetra grada e "evidentimit me zemër", që është një konceptim imagjinar, mendor dhe një shikim përtej shikimit ndijor.

---

[1] Sure "El Hadid", ajeti 4.
[2] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 219.
[3] Tefsiri "Nehxhul Belaga", Fjalimi 179.

Kjo është një gradë që nuk duhet ta quajmë grada e "argumentit", por grada e "evidentimit, e intuitës". Evidentimi me anë të zemrës është një gradë, një fazë njohjeje, e cila u mundësohet njerëzve të dashur të Zotit me ndryshime stadesh dhe nivelesh të supozuara. Të konceptohet në këtë mënyrë e vërteta, është e vështirë për njerëzit, të cilët nuk e kanë aq të zhvilluar aftësinë intuitive.

Duke marrë në konsideratë dëshmitë që u përmendën nga ajetet më lart, mund të themi se Profeti i Islamit, zotëronte një aftësi të lartë të intuitës së brendshme. Ai, gjatë jetës së tij të bekuar, u lartësua aq shumë, saqë e përjetoi edhe gradën e "intuitës së plotë".

Ka gjasa që përjetimi i parë të ketë ndodhur në fillim të profetësisë dhe përjetimi tjetër apo njohja e plotë intuitive, në kohën e Miraxhit. Në këtë mënyrë, Ai kapërceu shumë prej perdeve dhe iu afrua shumë Zotit të Madhëruar. Këtë pozitë, Xhebraili e kishte të pamundur ta arrinte.

Ajeti: "**Sa largësia midis dy harqeve ose edhe më afër"**, aludon për afërsinë e madhe. Zoti i Madhëruar, me robtë e Vet, nuk ka largësi hapësinore, që të matet me hark apo krahë.

Me fjalën *"rujjiet" - "shikmi"*, në këto ajete, nuk nënkuptohet shikimi me anë të syrit, por nënkuptohet intuita e brendshme.

Në diskutimet e kaluara, në tefsirin *"Likaullah" - "Takimi i Zotit"*, në shumë ajete kur'anore, është përcaktuar si një prej veçorive të Ditës së Gjykimit. Në këtë tefsir thuhet se takimi i Ditës së Gjykimit (në kundërshtim me mendimin e disa

mendjeshkurtërve) nuk është një takim shqisor dhe as ndijor, por është një lloj intuite e brendshme. Kjo intuitë është disa gradë më e ulët dhe as që mund të krahasohet me nivelin e "të parit" të njerëzve të Zotit dhe të të Dërguarve. Ajo nuk krahasohet as me nivelin e "njohjes së plotë intuitive" të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në natën e Miraxhit.

Me këtë shpjegim hidhen poshtë kritikat e mundshme ndaj këtij interpretimi. Disa komentues thonë se ka disa mospërputhje në strukturën e jashtme të ajeteve. Këto mospërputhje, më së shumti, burojnë ngaqë nuk janë shpjeguar saktë dhe qartë këto çështje. Gjithsesi, këto vërejtje janë të vogla dhe nuk krahasohen me vërejtjet që u ngritën ndaj interpretimit të parë.

Mbështetur në këtë logjikë interpretimi, do t'i rishohim përsëri ajetet që po diskutojmë dhe do të analizojmë sërish përmbajtjen e tyre.

Kur'ani, zbritjen e Shpalljes hyjnore për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e përshkruan në këtë mënyrë: "Zoti i Plotfuqishëm, i Cili është "*shadidul kuva*" e mësoi Profetin kur arriti cakun e përsosmërisë e të ballancës në në horizontin më të lartë.[1]

Më pas u afrua edhe më shumë, aq sa mes tij dhe Zotit kishte mbetur hapësirë sa e dy harqeve. Këtu ishte Ai që i shpalli robit të vet **"atë që i shpalli"**.

---

[1] Përemri te fjala *"festua"* dhe po ashtu përemri te *"huue bil ufukil eala"*, ka gjasa t'i përkasë Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* apo Zotit.

Këto supozime mund të duken të pabesueshme, por Zoti thekson se zemra e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* atë që e ka parë, e ka parë me të vërtetë, e ka parë realisht dhe nuk duhet të bëni polemika lidhur me këtë çështje.

Mbështetur në interpretimet e mësipërme, mund të themi se njohja intuitive e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Zotin e tij është më e përshtatshme. Kjo tregohet në transmetimet islame si një epërsi dhe virtyt i madh i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si një kuptim i thellë dhe delikat: *"UAll'llahu a'alemu bi hakaikil umur."*[1]

Këtë diskutim do ta mbyllim me një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe një nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

E pyetën Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "A e keni parë ndonjëherë Zotin?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përgjigj: *"Unë e kam parë Atë me syrin e zemrës."*.[2]

[1] Këtu duhet të keni parasysh edhe këtë çështje, në lidhje me Miraxhin e Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, se sa herë ka ndodhur gjatë jetës së tij, një herë apo dy herë. Në mesin e dijetarëve kjo gjë është çështje diskutimi. Ka gjasa që ajeti të jetë aludim për dy intuita të brendshme në dy Miraxhe.

[2] "Biharul Enuar", vëll. 18, f. 276.

Edhe në "Nehxhul Belaga", në fillim të fjalimit të Dhu'leb Jemaniut thuhet: "E pyetën Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të)*: 'O Imam (Ali), a keni parë ndonjëherë Zotin në jetën tuaj?'

Ai u përgjigj: 'A mund ta adhuroj një gjë që nuk e kam parë?!'"

Më pas vazhdoi me përshkrimin e sipërpërmendur, lidhur me njohjen intuitive.[1]

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 179.

Ajetet 13 – 18

وَلَقَدْ رَآهُ نَزْلَةً أُخْرَى١٣ عِنْدَ سِدْرَةِ الْمُنْتَهَى١٤ عِنْدَهَا جَنَّةُ الْمَأْوَى١٥ إِذْ يَغْشَى السِّدْرَةَ مَا يَغْشَى١٦ مَا زَاغَ الْبَصَرُ وَمَا طَغَى١٧ لَقَدْ رَأَى مِنْ آيَاتِ رَبِّهِ الْكُبْرَى١٨

"Ndërkohë që ai e ka parë atë edhe një herë tjetër",

"te Sidretul Munteha-ja",

"ku ndodhet Xhenneti i Strehimit."

"Kur Sidrën çfarë nuk e mbulonte?!"

"Shikimi i tij nuk u shmang dhe as nuk e kaloi masën",

"por ai pa disa nga mrekullitë më madhështore të Zotit të tij!"

Komentimi

Takimi i dytë

Këto ajete janë vazhdimësi e diskutimeve të ajeteve të kaluara. Në këto ajete diskutohet për çështjen e Shpalljes dhe të kontaktit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Zotin, si dhe njohjen intuitive të tij.

Ajeti 13 thotë: **"Ndërkohë që ai e ka parë atë edhe një herë tjetër."**.

Ajeti 14 jep vendin kur ka ndodhur kjo gjë: **"Te Sidretul Munteha-ja."**.

Po çfarë është *Sidretul Munteha-ja*? Këtë e shpejgon ajeti 15: "**Ku ndodhet Xhenneti i Strehimit."**.

Ajeti 16 pyet: **"Kur Sidrën çfarë nuk e mbulonte?!"**.

Këto ishin fakte që vërtetojnë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ka parë. **"Shikimi i tij nuk u shmang dhe as nuk e kaloi masën, por ai pa disa nga mrekullitë më madhështore të Zotit të tij!"**.

Siç shihet, po ato paqartësi që i kishin hasur edhe në ajetet e kaluara, i gjejmë edhe në këto ajete. Për të qartësuar kuptimin e këtyre ajeteve, së pari, duhet të sqarojmë kuptimet e veçanta të secilës fjalë, veç e veç dhe më pas t'i analizojmë ajetet në tërësi:

Fjala *"en nezletu"* është përdorur me kuptimin e *zbritjes së njëhershme*, kurse fjala *"nezleten ukhra"* do të thotë *"në një zbritje tjetër"*.[1]

Pra, është më se e qartë se zbritja ka ndodhur dy herë. Kjo ngjarje që po diskutojmë, ka të bëjë me zbritjen e dytë.

[1] Disa leksikologë dhe komentuesi, fjalën *"nezletun"* e kanë komentuar në kuptimin *"mere"*, si rrjedhojë, në të nuk ekziston kuptimi i zbritjes, kurse fjalia *"nezletun ukhra"* nënkupton vetëm një zbritje tjetër, por nuk është e qartë se përse e kanë anashkaluar kuptimin thelbësor të saj, ndërkohë që të tjerët e kanë marrë parasysh këtë dhe e kanë komentuar në kuptimin që e përmendëm më lart. (Kini kujdes!)

Fjala *"sidretun"*, sipas shumë leksikografëve dhe komentuesve, përdoret me kuptimin e një peme plot gjethe dhe hije, kurse shprehja *"sidretul munteha"* përdoret për të treguar pemën plot gjethe dhe hije, e cila ndodhet në lartësinë më të madhe të qiejve, në pikën kulmore dhe të fundit të ngritjes së engjëjve, të ngritjes së shpirtrave, të dëshmorëve, të dijes së Profetëve dhe të veprave të njerëzve. Tregon vendin plot pemë, plot gjethe e hije, ku ngjiten dhe qëndrojnë engjëjt e Zotit. Engjëjt nuk ngjiten më lart se ai vend. Madje edhe Xhebraili, në Udhëtimin e Miraxhit, kur e arriti këtë pikë, u ndal aty.

Për kuptimin e togfjalëshit **"Sidretul Munteha"** nuk është dhënë ndonjë shpjegim i plotë dhe i prerë. Rreth kuptimit të saj ka lloj-lloj përshkrimesh. Të gjitha përshkrimet dëshmojnë një realitet për të cilin fuqia e përshkrimeve tona është e dobët. Fjalët tona përshkruese nuk arrijnë dot të përcjellin ato imazhe, ato pamje madhështore.

Në një hadith nga Profeti i Islamit është transmetuar: *"Unë pashë nga një engjëll në secilën gjethe të asaj peme, që ishte ulur në të, duke e lartësuar Zotin e Madhëruar."*[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* tregohet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Unë arrita në Sidretul Munteha dhe pashë që secila prej gjetheve të saj, mund të hedhë hije mbi një popull të tërë!"*.[2]

Këto shprehje tregojnë se imazhi i kësaj peme asnjëherë nuk mund të krahasohet me asnjë pemë që hasim mbi tokë. Këtu

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", ajeti në fjalë.
[2] Tefsiri "Nuruth Thakalejn" , vëll. 5, Hadithi 40, f. 155.

bëhet fjalë për një vendqëndrim madhështor, që ndodhet në prag të vendit të mëshirës së Zotit të Madhëruar. Engjëjt që qëndrojnë mbi gjethet e saj, e Madhërojnë Zotin e Madhëruar. Nën hijen e saj ndodhen popujt e mirë dhe të pastër.

Fjala *"xhennetul me'ua"* tregon Xhennetin si vend i banimit.[1] Po për cilin Xhennet bëhet fjalë? Komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme, lidhur me këtë çështje. Disa komentues e konsiderojnë si Xhennetin e përhershëm (Xhennetil khuld), Xhennetin që pret të gjithë besimtarët e devotshëm. Vendin e tij e përcaktojnë në qiell. Dëshmi për këtë, konsiderojnë ajetin 19 të sures "Es Sexhde": "**Për sa u përket atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, ata, për hir të veprave që i bënë, vend pritje e kanë Xhennetin** (me'ua)**"**, sepse ky ajet plotësohet me ajetin që vjen më pas, në lidhje me Xhennetin e përhershëm.

Por ajeti, në një vend tjetër, thotë: **"Dhe ngutuni në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për një Xhennet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe tokës, i përgatitur për të devotshmit."**.[2]

Këtë thënie, disa komentues, e kanë konsideruar si të papranueshme, sepse ajetet që po diskutojmë, tregojnë se *"xhenentul me'ua"* është në qiell. Pra, bëhet fjalë për një Xhennet tjetër e jo Xhennetin e përhershëm, gjerësia e të cilit është më e madhe se sa gjerësia e qiejve dhe e tokës.

---

[1] Fjala *"me'ua*, në thelb, është në kuptimin e një vendi të bashkimit. Duke pasur parasysh faktin se qetësia e njerëzve në një vend bëhet shkak i bashkimit të tyre me njëri–tjetrin, kjo fjalë është përdorur në kuptimin e vendit të qetësisë.

[2] Sure "Ali Imran", ajeti 133.

Këtë Xhennet, ndonjëherë, e kanë interpretuar si një gradë të veçantë në Xhennet, që ndodhet në afërsi të Sidretul Munteha dhe është një vend i veçantë për të sinqertët dhe të përzgjedhurit.

Ndonjëherë, është pranuar se tregon një Xhennet në Berzakh (në Botën e Ndërmjetme), ku shpirtrat e dëshmorëve dhe të besimtarëve qëndrojnë përkohësisht.

Komentimi i fundit, në krahasim me komentet e tjera, duket më i përshtatshëm dhe më i plotë. Edhe në hadithe të tjera, që diskutojnë rreth Miraxhit, është përmendur se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka parë disa persona në këtë Xhennet, të cilët shfrytëzonin begatitë e tij, ndërkohë që dimë se para Ditës së Gjykimit askush nuk do futet në Xhennetin e përhershëm. Ajetet kur'anore e dëshmojnë më së miri faktin se në Kiamet, të devotshmit do të futen në Xhennet, pas dhënies së llogarisë dhe jo sapo të vdesin. Shpirtrat e dëshmorëve, gjithashtu, ndodhen në Xhennetin e Botës së Ndërmjetme, sepse as ata nuk do të futen në Xhennetin e përhershëm para ndodhisë së Kiametit.

Ajeti: **"Shikimi i tij nuk u shmang dhe as nuk e kaloi masën"**, nënkupton që shikimi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk u anua as në të majtë e as në të djathtë dhe as e tejkaloi kufirin dhe masën, por gjithë çfarë pa, ishte realitet. Ky kuptim mbështetet edhe në faktet e tjera leksikore: fjala *"zaga"* rrjedh nga rrënja *"zejg"* dhe tregon animin nga e majta dhe nga e djathta, kurse fjala *"taga"* rrjedh nga rrënja *"tug'jan"* dhe është përdorur me kuptimin e kapërcimit të masës.

Shprehur ndryshe, njeriu mund të gabojë në perceptimin e diçkaje, në qoftë se nuk e përqendron plotësisht shikimin mbi të', por mund ta ketë shpërndarë shikimin lart e poshtë, më pranë apo më afër objektit.[1]

Tani që përfunduam me komentimin e fjalëve veç e veç, le t'i kthehemi komentimit të përgjithshëm të ajeteve.

Një grup i madh komentuesish i kanë parë ajetet në kontekstin e takimit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Xhebrailin, për të dytën herë. Komentuesit kanë pohuar se "'me shikimin për të dytën herë" bëhet fjalë për kohën kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po zbriste nga Miraxhi. Gjatë zbritjes, në afërsi të Sidretul Munteha, Profeti i Islamit e ka parë Xhebrailin në formën e vet origjinale dhe shikimi i tij nuk ishte i gabuar.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në këtë moment, pa disa nga shenjat e mëdha të Zotit. Këto shenja nënkuptojnë, ose fytyrën e vërtetë të Xhebrailit, ose disa nga shenjat madhështore të qiejve dhe aspektet e mrekullueshme të tyre. Por është pranuar se këto shenja mund të nënkuptojnë që të dy mesazhet e mësipërme.

Tani do të shohim se vërejtjet që u përmenden më lart, lidhur me këto komente, jo vetëm që nuk u sqaruan, por atyre u

[1] Në tefsirin "El Mijzan", fjala e parë është komentuar në kuptimin e "gabimit gjatë shikimit të një gjëje", kurse fjala e dytë është "gabimi në thelbin e shikimit". Nuk është përmendur ndonjë arsye për dallimin mes këtyre dyjave. Ajo që gjendet në fjalor, është po ai komentim që e përmendëm më lart.

janë bashkëngjitur edhe vërejtje të tjera, si p.sh: Disa komentues thonë se togfjalëshi "*nezleten ukhra*" - "*në një zbritje tjetër*", nuk ka një domethënie të veçantë. Por, në bazë të komentimit të dytë, mësuam se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, gjatë Miraxhit, në horizontet e qiejve, përmes një "njohje tjetër intuitive ezoterike" pa qartë Esencën e Stërpastër të Zotit.

Thënë ndryshe, Zoti, për të dytën herë, zbriti në zemrën e pastër të tij. Kjo zbritje i dha mundësinë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të realizonte evidentimin e plotë. Kjo ndodhi pikërisht në vendin ku është caku i fundit i afrimit të robëve me Zotin, në afërsi të Sidretul Munteha, aty ku ndodhet "Xhennetul me'ua", ndërkohë që Sidretul Muntehanë e kishin mbuluar perde të ndritshme.

Syri i zemrës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në këtë shikim, në këtë njohje shpirtërore u përqendrua ekskluzivisht mbi të Vërtetën dhe nuk e pa askënd tjetër, përveç Zotit të Madhëruar. Pikërisht në këtë vend, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pa edhe Shenjat e Madhështisë së Zotit në qiej dhe në shpirtra.

Çështja e njohjes intuitive ezoterike, siç e trajtuam edhe më parë, është një lloj konceptimi dhe shikimi që nuk ngjason me perceptimet reale, me perceptimet ndijore e shqisore, përmes të cilave njeriu realizon njohjen në tërësi dhe, mbi këto informacione të grumbulluara në këtë rrugë, ndërton edhe imagjinatën, edhe mendimet, edhe përfytyrimet e tij.

Kjo do të thotë se ne besojmë në ekzistencën tonë, realizojmë perceptimet dhe mendimet tona, jemi të vetëdijshëm për vullnetin tonë, për dëshirat dhe prirjet tona. Kjo vetëdije nuk është përftuar, nuk është realizuar përmes informacioneve të pabaza e të pambështetura. Kjo vetëdije është një lloj intuite e brendshme, përmes së cilës marrim informacione, vihemi në dijeni për veten tonë, për ndjesitë tona dhe për botën që na rrethon.

Dituria që përftohet me anë të intuitës së brendshme, nuk mund të gabojë, sepse nuk është rezultat i argumentimeve të paplota e spekulative, nuk mbështetet vetëm në informacionet shqisore të pavërtetuara.

Ne nuk jemi në gjendje të kuptojmë të vërtetën e asaj intuite, që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përjetoi Natën e Miraxhit në lidhje me Zotin, por shembulli që sollëm, na mundëson t'i afrohemi më shumë synimit tonë, sigurisht, të ndriçuar nga transmetimet islame që lidhen me këtë çështje.

Hulumtime

1- Miraxhi është një realitet i padiskutueshëm

Vërtetësia e Miraxhit nuk është vënë asnjëherë në diskutim nga dijetarët islamë. Dëshmi për këtë janë ajetet në fjalë dhe ajetet e para të sures "El Isra", janë edhe transmetimet e shumta islame. Mirëpo disa prej tyre, për shkak të paragjykimeve, nuk kanë qenë në gjendje të pranojnë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është ngjitur në qiell me trup dhe me shpirt. Ngjitjen e tij e kanë interpretuar si "Miraxh shpirtëror", si diçka të ngjashme me gjumin.

Ngritja në qiell e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk mbart ndonjë problem as në aspektin real, as në aspektin shkencor. Një përshkim më të detajuar për këtë, e kemi dhënë në suren "El Isra".[1]

Prandaj themi se nuk ekziston ndonjë arsye që ne, për shkak se diçka na duket tepër e koklavitur, të heqim dorë prej tekstit të dukshëm të ajeteve dhe shprehjeve të qarta të transmetimeve.

Përveç kësaj, shprehjet e ajeteve të lartpërmendura tregojnë se një grup kishte debatuar në lidhje me këtë çështje. Edhe historia tregon se çështja e Miraxhit nxiti një polemikë mes kundërshtarëve.

[1] Tefsiri në fjalë, vëll. 12, f. 17 e tutje.

Nëse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do të pretendonte një Miraxh shpirtëror, apo diçka të ngjashme me gjumin, nuk do të ngjallte debate, as habinë e disave.

2- Qëllimi i Miraxhit

Arritja e Profetit në njohjen intuitive ezoterike, nga një anë dhe vrojtimi i madhështisë së Zotit në hapësirën e qiejve me syrin e zakonshëm, nga ana tjetër, ishin disa prej qëllimeve të Miraxhit. Kjo përmendet në ajetin e fundit të diskutimit tonë: **"Por ai pa disa nga Mrekullitë më Madhështore të Zotit të tij!"**. Në ajetin e parë të sures "El Isra" thuhet: **"për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona."**. Ai, gjithashtu, u informua për çështje të shumta dhe të rëndësishme rreth engjëjve, rreth banorëve të Xhennetit dhe të Xhehennemit, si dhe rreth shpirtrave të Profetëve, të cilët, gjatë jetës së tyre të bekuar, ishin frymëzuesit e tij në punën e predikimit dhe në edukimin e krijesave të Zotit.

3- Miraxhi dhe Xhenneti

Nga ajetet dhe diskutimet e tyre, mësojmë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* Natën e Miraxhit ka kaluar afër Xhennetit, ose është futur brenda në të.

Në këtë Xhennet, qoftë Xhenneti i përhershëm *"xhennetul khuld"*, ashtu siç kanë supozuar një pjesë e komentuesve, qoftë "Xhenneti i Berzakhut", sipas nesh, ai ka parë çështje të rëndësishme nga e ardhmja e njerëzimit. Në transmetimet islame

është bërë përshkrimi i plotë i tyre. Ne, një pjesë të atyre, me dëshirën e Zotit, do t'i përmendim në vijim.

4- Miraxhi në transmetimet islame

Rreth çështjes së Miraxhit, sipas disa dijetarëve, janë sajuar edhe transmetime të dobëta. Ne do të mbështetemi te komentuesi i njohur Tabersi, në veprën "Mexhmaul Bejan". Sipas tij, transmetimet e Miraxhit mund të klasifikohen në katër pjesë:

a) Transmetime që klasifikohen si të sigurta, për arsye se mbështeten në një narracion të gjerë (si p.sh. vet ndodhia e Miraxhit).

b) Transmetime që janë transmetuar nga burime të besueshme dhe trajtojnë çështje, për të cilat nuk ekziston asnjë pengesë esenciale për pranimin e tyre, (si për shembull, transmetime që flasin në lidhje me vrojtimin e shumë prej argumenteve të madhështisë së Zotit në qiej).

c) Transmetime, paraqitja apo kuptimi kryesor i të cilave bie ndesh me parimet që disponojmë nga ajetet e Kur'anit apo nga transmetimet e besueshme dhe të sigurta, megjithatë mund të justifikohen, si për shembull, transmetimet që pohojnë se Profeti i Islamit pa një grup prej banorëve të Xhennetit në Xhennet dhe një grup prej banorëve të Xhehennemit në Xhehennem, ndërkohë që duhet të themi: me Xhennet dhe Xhehennem, synohet Xhenneti dhe Xhehennemi i Botës së Ndërmjetme. Në njërin ndodhen

shpirtrat e besimtarëve dhe të dëshmorëve dhe në tjetrin shpirtrat e politeistëve dhe të kriminelëve.[1]

d) Transmetime që përbëhen nga çështje të pavërteta dhe të pa baza, të cilat, në asnjë mënyrë, nuk janë të pranueshme, sepse përmbajtja e tyre dëshmon për falsitetin dhe sajimin e tyre, siç thotë edhe hadithi i mëposhtëm: "Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka parë Zotin me 'syrin e dukshëm', ose ka folur me Atë dhe e ka parë." Transmetime të tilla dhe të ngjashme me këtë, pa dyshim që janë të sajuara dhe të rreme (përveçse nëse komentohet me "intuitën e brendshme.").

Duke pasur parasysh këtë klasifikim, do të bëjmë një analizë të shkurtër të transmetimeve rreth çështjes së Miraxhit.

Nga tërësia e transmetimeve, mësojmë se Profeti i Islamit këtë udhëtim qiellor e përshkoi në disa faza:

Faza e parë është faza mes Mesxhidul Haramit dhe Mesxhidul Aksas. Për këtë fazë flitet në fillim të sures "El Isra": **"Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit** (prej Qabes) **gjer në Mesxhidi Aksa** (Bejti Mukaddes)**."**.

Sipas disa transmetimeve të verifikuara, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

[1] Në disa ajetet kur'anore, thuhet se të devotshmit, në Ditën e Kiametit do të futen në Xhennet grupe-grupe dhe politeistët grupe–grupe do të futen në Xhehennem (sure "Ez Zumer", ajetet 71-73. Këtë fakt e dëshmojnë edhe ajete të tjera, si për shembull ajeti 70 i sures "Ez Zukhruf", ajetet 85–86 të sures "Merjem" dhe ajeti 74 i sures "Ed Dukhan".

tij!) gjatë rrugës, së bashku me Xhebrailin, zbritën në tokën e Medines dhe aty fali namazin.[1]

Në Mesxhidul Aksa fali namazin me praninë e shpirtrave të të Dërguarve të mëdhenj, si: Ibrahimi, Musai dhe Isai *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*. Imami i xhematit ishte Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Që këtu filloi udhëtimi qiellor i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai i kaloi njëri pas tjetrit qiejt shtatëllojeshe.[2] Në secilin qiell, u përball me një skenë të re. Në disa qiej u përball me Profetët dhe engjëjt, në disa qiej të tjerë u përball me Xhehennemin dhe banorët e tij dhe në qiej të tjerë, me Xhennetin dhe banorët e tij. Në secilin prej tyre, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ruajti në shpirtin e vet të pastër mbresa të pashlyeshme, shumë të çmueshme dhe domethënëse. Ai pa me sytë e tij mrekulli. Secila nga ato mrekulli ishte një enigmë, ishte një mister prej enigmave dhe mistereve të universit. Pasi u kthye, ai i shpjegonte këto në momente të përshtatshme, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose tërthorazi, duke i ilustruar me shembuj, me qëllim që të informojë njerëzit. Ato mrekulli, mistere dhe enigma i përdori në shumë nga predikimet që bëri.

Kjo çështje tregon se një prej qëllimeve kryesore të këtij udhëtimi qiellor është shfrytëzimi i përvojave, i ndikimeve mistike dhe edukuese të këtyre pamjeve dhe vrojtimeve me tepër

[1] "Biharul Enuar", vëll. 18, f. 319.

[2] Sipas disa ajeteve kur'anore, si për shembull: **"Vërtet Ne e kemi stolisur qiellin më të afërt** (të dynjasë) **me bukurinë e yjeve. Atë që ne shohim nga bota e sipërme dhe të gjitha yjet, që të gjitha janë pjesë e qiellit të parë, si rrjedhojë, qiejt e tjerë gjashtëllojeshe, a janë botët sipër tyre?"**.

vlerë. Shprehja shumë domethënëse e Kur'anit: **"Por ai pa disa nga mrekullitë më madhështore të Zotit të tij!"**, e ajeteve që po i diskutojmë, mund të jetë si një përmbledhje për të gjitha këto çështje.

Siç u trajtua edhe më sipër, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, gjatë udhëtimit të Miraxhit, pa në Xhennet dhe Xhehennem disa njerëz në mundime dhe disa të tjerë në kënaqësi.

Në realitet, ai Xhennet dhe Xhehennem nuk është Xhenneti dhe Xhehennemi i Kiametit, por këtu bëhet fjalë për Xhennetin dhe Xhehennemin në Botën e Ndërmjetme, pra, të Berzahut, sepse në bazë të disa ajeteve që i cituam më lart, Kur'ani Fisnik thotë: "Xhenneti dhe Xhehennemi i Ngjalljes, do t'u përkasë të mirëve dhe mëkatarëve, pas ndodhisë së Kiametit dhe përfundimit të llogaridhënies.''.

Në fazën e fundit, ai arriti në qiellin e shtatë. Aty pa mbulesa prej drite. Atje ndodhej Sidretul Muntehaja dhe Xhennetel Me'uaja. Aty, në atë botë plot dritë dhe ndriçim, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* arriti në kulmin e intuitës ezoterike dhe të afërsisë me Zotin, arriti në gradën e *"kabe keusejni eu edna"* (ishte afër sa dy harqe). Aty, Zoti i Madhëruar, iu drejtua atij, duke i kumtuar shumë dispozita të rëndësishme dhe thënie të vyera, pjesa dërmuese e të cilave kanë mbetur si kujtim për ne, përmes transmetimeve islame, në formën e "haditheve kudsi sakrale". Me vullnetin e Zotit, një pjesë të tyre, do t'i përmendim në kapitullin e ardhshëm.

Sipas shumë haditheve që flasin për këtë udhëtim madhështor, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në disa raste të ndryshme, kishte parë Imam Aliun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* pranë vetes. Në këto transmetime, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, dëshmon madhështinë e jashtëzakonshme të pozitës së Imam Aliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Hadithet e Miraxhit përmbajnë shprehje të ndërlikuara dhe misterioze, të cilat e vështirësojnë zbërthimin e kuptimit të tyre. Terminologjikisht bëjnë pjesë në tekstet (hadithet) alegorike. Kjo do të thotë se përshkrimi dhe interpretimi i tyre duhet të bëhet vetëm nga Imamë të pagabueshëm.[1]

Edhe në librat e Ehli Synetit është diskutuar shumë në lidhje me Miraxhin. Janë afro 30 transmetues që kanë rrëfyer hadihte në lidhje me ndodhitë e Miraxhit.[2]

Mund të shtrohet pyetja: Ky udhëtim i gjatë, vrojtimi i gjithë këtyre ngjarjeve të çuditshme dhe të larmishme, gjithë ato biseda të hollësishme dhe ato pamje, si mund të kenë ndodhur në një natë, apo më pak se një natë?!

Duhet të kemi parasysh se udhëtimi i Miraxhit nuk ka qenë një udhëtim i zakonshëm, prandaj edhe nuk mund ta vlerësojmë, ta matim me kritere të zakonshme. As mjeti i udhëtimit nuk ishte i zakonshëm, as pamjet (vrojtimet) e tij, as bisedimet, as

[1] Për më shumë informacion në lidhje me transmetimet e Miraxhit, shih vëllimin 18 të tefsirit "Biharul Enuar", nga faqet 282-410.
[2] Tefsire "El Mijzan", vëll. 13, f. 29 (ajetet e para të sures "El Isra", tema e transmetimit).

dimensionet që e karakterizojnë nuk ishin të zakonshme dhe as që krahasohen me dimensionet e kufizuara, të njohura në jetën tokësore, as ngjasimet e as ilustrimet që e shoqërojnë, nuk shprehin madhështinë e pamjeve dhe të dukurive që pa Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Çdo gjë që ka ndodhur, ka qenë e jashtëzakonshme edhe në formë, edhe në dimensione, përtej hapësirës dhe kohës që i njohim dhe i kemi mësuar ne.

Si përfundim, nuk ka vend për asnjë dyshim për ndodhitë e përshkruara në atë udhëtim. Këto çështje kanë ndodhur brenda një nate, ose më pak se një natë, matur sipas treguesve kohorë dhe hapësinorë të jetës tokësore.

5- Disa fragmente nga bashkëbisedimet e Zotit me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Natën e Miraxhit

Në librat e hadithit, në lidhje me këtë çështje, ekziston një hadith që Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e ka transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky hadith është shumë i detajuar dhe i gjatë, por ne këtu do të përmendim një pjesë të tij. Do të flasim për temat e trajtuara në atë hadith, të cilat tregojnë se cili ka qenë boshti apo thelbi i diskutimeve rreth asaj nate historike dhe sa sublime kanë qenë ata, sa ngjajnë me kulmet sublime të qiejve.

Në fillim të hadithit thuhet: Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në Natën e

Miraxhit e pyeti Zotin e Madhëruar: *"O Zoti im! Cila është vepra më e mirë?"*

Zoti i Madhëruar u përgjigj: *"Asnjë gjë tek Unë nuk vlen më shumë se sa mbështetja ndaj Meje dhe pëlqimi i asaj që Unë e kam përcaktuar; O Muhammed! Ata që e duan njëri–tjetrin për hirin Tim, dashuria Ime do t'i kaplojë ata; ata që për hirin Tim, janë të dashur dhe për hirin Tim lidhin miqësinë, i dua ata; gjithashtu, dashuria Ime është e obligueshme dhe e domosdoshme për ata që më mbështeten Mua dhe për dashurinë Time nuk ekziston kufizim dhe përfundim!"*

Kështu që bisedimet fillojnë me dashurinë, me një dashuri të pafundme dhe gjithëpërfshirëse. Parimisht, universi sillet rreth po këtij boshti, boshtit të dashurisë.

Në fragmentin tjetër, thuhet: *"O Ahmed! Mos ji i ngjashëm me fëmijët, të cilët magjepsen pas të gjelbrës dhe të verdhës (gjërave që kanë shkëlqim në dukje, por janë pa vlerë). Në kohën që u ofrohet një ushqim i shijshëm dhe i ëmbël, bëhen arrogantë dhe çdo gjë e lënë në harresë."*.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* këtu shtoi: *"O Zoti im! Më udhëzo mua në një vepër, e cila bëhet shkak për afrimin ndaj Teje."*

Zoti iu përgjigj: *"Natën bëje ditë, ditën bëje natë!"*

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pyeti: *"Si? Në ç'mënyrë?"'*

Zoti iu përgjigj: *"Vepro në atë mënyrë që gjumi yt të jetë namaz (falje) dhe asnjëherë mos e mbush stomakun plot!"*.

Në një fragment tjetër, thuhet: *"O Muhammed! Dashuria Ime është dashuria e të varfërve dhe e nevojtarëve. Qëndro afër tyre dhe merr pjesë në tubimet e tyre. Në mënyrë që Unë të të afrohem ty, qëndro larg pasanikëve, të dhënë pas botës materiale, si dhe mos merr pjesë në tubimet e tyre!"*

Më tej, Zoti i Madhëruar thotë: *"O Muhammed! Urreji shkëlqimet e botës dhe të dashuruarit pas saj, duaje Ahiretin dhe njerëzit e Ahiretit (Botës së Përtejme)."*.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shtoi: *"O Zoti im! Kush janë njerëzit e kësaj bote dhe njerëzit e Botës së Përtejme?"*

Zoti iu përgjigj: *"Njerëzit e kësaj bote janë ata që hanë shumë, flenë shumë dhe qeshin shumë, zemërohen dhe janë më pak të kënaqur, që nuk kërkojnë ndjesë për të këqijat e tyre dhe nuk e pranojnë faljen, nëse ndokush ua kërkon atë. Janë dembelë në adhurimin e Zotit dhe trima në ndonjë mëkat, kanë dëshira të gjera dhe të gjata dhe, në kohën që u afrohet çasti i vdekjes, asnjëherë nuk bëjnë llogarinë e veprave të tyre. Janë ata njerëz, dobia e të cilëve për njerëzit e tjerë është e paktë, janë njerëzit llafazanë, të papërgjegjshëm dhe të pasionuar pas veshmbathjes dhe ushqimit.*

Njerëzit e kësaj bote as që e falënderojnë Zotin për begatitë dhe mirësitë. Ata as që janë të durueshëm përballë fatkeqësive.

Shërbimet e shumta ndaj tyre u duken të pakta, kurse shërbimet e pakta që kryejnë ata ndaj të tjerëve, u duken të shumta. Janë ata njerëz që përpiqen të lavdërohen me një pune që nuk e kanë kryer, si dhe kërkojnë diçka që nuk është e drejtë e tyre.

Janë ata njerëz që gjithnjë flasin për dëshirat e tyre, përmendin të metat e të tjerëve, kurse të mirat e tyre i fshehin!"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"O Zoti im! Vallë, përveç kësaj, a kanë ndonjë të metë tjetër adhuruesit e kësaj bote?"*

Zoti i Madhëruar u përgjigj: *"O Muhammed! E meta e tyre është se ata janë shumë të paditur. Ata nuk tregohen të përulur karshi mësuesit, prej të cilit kanë mësuar dije dhe e konsiderojnë veten të zgjuar, ndërkohë që ndaj të diturve janë budallenj dhe të paditur."*

Më pas, Zoti përshkruan karakteristikat e njerëzve të Botës Tjetër, të banorëve të Xhennetit: *"Ata janë njerëz të ditur, janë shumë të dobishëm për të tjerët. Njerëzit ndihen të qetë pranë tyre, janë të matur në çdo fjalë. Gjithnjë bëjnë llogarinë e veprave të tyre, ndaj dhe e mundojnë veten. Sytë e tyre mbyllen për të fjetur, por zemra e tyre është zgjuar, sytë e tyre qajnë dhe zemra e tyre gjithnjë është në përkujtim të Zotit.*

Në kohën që njerëzit harrojnë dhe shpërfillin, ata kujtojnë dhe falënderojnë Zotin. Në fillim të çdo begatie, e lavdërojnë Zotin e Madhëruar, kurse në mbarim të tyre, e falënderojnë përsëri Atë. Lutja e tyre është e pranuar te Zoti, kërkesa e tyre është dëgjuar dhe engjëjt janë të gëzuar për ata. Njerëzit që nuk falënderojnë Zotin, konsiderohen të vdekur, të harruar, kurse Zoti i Madhëruar është "i Gjallë" (Hajj), është "Veprues" (Kajjum) dhe "Bujar" (Kerim). Përqendrimi i tyre është aq i madh, saqë përveç Tij nuk kanë tjetër në fokusin e tyre. Njerëzit gjatë jetës së tyre vdesin një herë, kurse ata, për hir të xhihadit me egon dhe kundërshtimit me epshin, vdesin çdo ditë shtatëdhjetë herë.

Kur rrinë përballë Meje për të më adhuruar, ngjasojnë si një kala e fortë dhe digë prej çeliku. Në zemrat e tyre nuk ka fare vend për krijesat.

Betohem në krenarinë dhe lavdinë Time, që Unë do t'u dhuroj atyre jetë të bekuar dhe në fund të jetës, Vetë do t'ua marr shpirtin, do t'ua hap dyert e qiellit për fluturimin e shpirtit të tyre, do të heq mënjanë të gjitha mbulesat dhe do të urdhëroj që Xhenneti të stoliset për ta!

O Ahmed! Adhurimi ka dhjetë pjesë. Nëntë pjesët e tij janë kërkimi i hallallit. Sa kohë që ushqimi dhe pirja jote është hallall, ti je nën mbrojtjen dhe mbështetjen Time.".

Në një fragment tjetër, thuhet: *"O Ahmed! A e di se cila jetë është më e ëmbël dhe më e qëndrueshme?"*

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: *"O Zoti im, jo!"*

Zoti i tha: *"Bën jetë të ëmbël ai që për asnjë çast nuk më harron Mua, nuk harron begatinë Time dhe natë e ditë kërkon kënaqësinë Time.*

Bën jetë të ëmbël ai që punon për shpëtimin e vetes nga kjo botë e pavlerë, kurse Ahiretin e quan të vyer. Ai që preferon kënaqësinë Time ndaj kënaqësisë së vet dhe gjithnjë kërkon kënaqjen Time, të drejtën Time e zmadhon dhe është i ndërgjegjshëm për monitorimin Tim ndaj tij.

Bën jetë të ëmbël ai që karshi çdo mëkati dhe fatkeqësie, më kujton Mua dhe pastron zemrën nga ajo që Unë nuk e pëlqej, urren djallin dhe nxitjet djallëzore të tij dhe nuk e lejon Iblisin (Satanin) të përfshijë zemrën e tij.

Sa herë që vepron në këtë mënyrë, Unë në zemrën e tij do të vë një dashuri të veçantë, në mënyrë të atillë që e gjithë zemra e tij do të jetë

në dispozicionin Tim dhe liria, angazhimi, brenga, shqetësimi dhe thëniet e tij janë prej begative që Unë ua dhuroj njerëzve të Mi të dashur!

Pra, unë hap syrin dhe veshin e zemrës së tij, në mënyrë që me veshin e zemrës së tij të dëgjojë të Vërtetat e fshehtësisë dhe me anë të zemrës të shohë Lavdinë dhe Madhështinë Time!".

Ky hadith i shndritshëm përfundon me këto fjali: *"O Ahmed! Edhe nëse një njeri e fal namazin e të gjithë banorëve të qiellit dhe të tokës dhe agjëron agjërimin e të gjithë banorëve të qiejve dhe të tokës, nuk ha ashtu siç nuk hanë engjëjt dhe nuk vishet me rroba të bukura (pra, jeton në cakun e fundit të virtytshmërisë dhe të devotshmërisë), por në zemrën e tij ekziston një grimcë dashuri për këtë botë, dëshirë për pozitë, apo pasion për bukurinë dhe stolinë e kësaj bote, ai nuk do të jetë pranë Meje në strehën Time të përhershme! Si dhe dashurinë Time do ta heq nga zemra e tij! Falënderimi i takon vetëm All'llahut, Zotit të botëve!"*[1]

Këto thënie qiellore që e marrin me vete shpirtin e njeriut dhe e çojnë në kulmin e qiejve, e bëjnë të udhëtojë në Miraxhin hyjnor dhe e shpien në pragun e dashurisë dhe njohjes intuitive-gnostike, janë vetëm një pjesë e hadithit kudsi.

Përveç kësaj, ne jemi të mendimit se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përveçse na ka rrëfyer ne gjithçka pa, në thëniet e tij, gjenden shumë sekrete dhe biseda misterioze, shumë simbolika dhe iluzione të tjera të ndodhura mes tij dhe të dashurit e tij atë natë, në natën e dashurisë dhe të ngazëllimit, në natën e magnetizmit dhe të bashkimit, në mënyrë të tillë që as veshët nuk e kanë

[1] "Biharul Enuar", vëll. 77, f. 21-30 (i përmbledhur).

kapacitetin e dëgjimit, as mendjet e zakonshme nuk e kanë fuqinë e perceptimit të tyre. Pikërisht, për këto arsye, ato kanë mbetur të fshehura përgjithmonë brenda shpirtit të dëlirë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe përveç "të përzgjedhurve", askush tjetër nuk është i informuar rreth tyre.

Ajetet 19 – 23

أَفَرَأَيْتُمُ اللَّاتَ وَالْعُزَّى١٩ وَمَنَاةَ الثَّالِثَةَ الْأُخْرَى٢٠ أَلَكُمُ الذَّكَرُ وَلَهُ الْأُنْثَى٢١ تِلْكَ إِذًا قِسْمَةٌ ضِيزَى٢٢ إِنْ هِيَ إِلَّا أَسْمَاءٌ سَمَّيْتُمُوهَا أَنْتُمْ وَآبَاؤُكُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ بِهَا مِنْ سُلْطَانٍ إِنْ يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَمَا تَهْوَى الْأَنْفُسُ وَلَقَدْ جَاءَهُمْ مِنْ رَبِّهِمُ الْهُدَى٢٣

"A e keni parë Latën dhe Uzzën?"

"Po Menatën, të tretën, të fundit?"

"Vallë, për ju janë djemtë, ndërsa për Atë vajzat?!"

"Kjo ndarje është e padrejtë."

"Këta janë vetëm emra që ua keni ngjitur (idhujve) **ju dhe të parët tuaj, kurse All'llahu nuk ju ka dërguar për ata asnjë provë. Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi, ndonëse u ka ardhur prej Zotit të tyre udhëzimi** (për Rrugën e Drejtë)**.**

Komentimi

Këta idhuj, janë produkt i epshit tuaj

Pas diskutimeve rreth çështjeve që lidhen me monoteizmin, me Shpalljen dhe Miraxhin, si dhe me argumentet madhështore të Zotit, që është Një dhe i Vetëm, surja vazhdon me qartësimin e absurditetit të idhujtarisë dhe të besimeve të politeistëve ndaj idhujve.

Ajeti 19 thotë: **"A e keni parë Latën dhe Uzzën?"**.

Vallë, këta janë imazh i vajzave të Zotit, apo janë burim i humbjes dhe i dobisë suaj?! **"Po Menatën, të tretën, të fundit?"**[1]

"Vallë, për ju janë djemtë, ndërsa për Atë vajzat?!".

Sipas mendimit tuaj, vajzat vlejnë më pak se djemtë? Madje, kur dëgjoni që bashkëshortja juaj ka lindur vajzë, ju nxihet fytyra nga hidhërimi dhe zemërimi i tepërt.

Nëse është kështu: **"Kjo ndarje është e padrejtë."**, sepse hisen e Zotit e konsideroni më ulët se sa hisen tuaj.

---

[1] Në lidhje me këta tri lloje idhujsh, me dëshirën e Zotit, do të flasim më gjerësisht në të ardhmen. Ajo çfarë vlen të theksohet këtu, është se fjala *"thelathe"* - *"i treti"* dhe fjala *"ukhra"* - *"i fundit"*, është përdorur për idhullin e Menatit. Për këto dy shprehje kanë përmendur komentime të shumta, që zakonisht janë pretendime të pabaza. Ajo që duket më e përshtatshme, është se rëndësia e këtyre idhujve tek idhujtarët arabë, është sipas renditjes që u tha edhe në ajet, si rrjedhojë, Menatë ishte në fazën e tretë. Përshkrimi i tij si i fundit, është për hir të vonimit të radhës dhe pozitës.

Në këtë mënyrë, Kur'ani, idetë e devijuara dhe besëtytnitë përkatëse të tyre, i merr si objekt talljeje, duke i sqaruar se është e padrejtë që ju, vajzat tuaja i varrosni të gjalla dhe i konsideroni si përulësi dhe turp, kurse, nga ana tjetër, engjëjt i konsideroni si vajza të Zotit. Jo vetëm që i adhuroni ato, por keni edhe një respekt të jashtëzakonshëm edhe për skulpturat e tyre jofrymore, në formën e idhujve, bini në sexhde karshi tyre, kërkoni ndihmë dhe strehim tek ato për zgjidhjen e problemeve, si dhe kërkoni ndihmë nga ato.

Me të vërtetë është qesharake dhe e turpshme!

Prej këtej bëhet e qartë se, së paku, shumica e idhujve prej guri dhe druri, që ishin objekt adhurimi tek arabët, sipas mendimit të tyre, ishin skulptura të engjëjve, që i konsideronin si "hyjnesha", si drejtuese dhe dirigjuese të universit. Marrëdhënien e tyre me Zotin e konsideronin si marrëdhënia e vajzës me të atin.

Pra, këto besëtytni vetëdemaskohen, kur tregojnë për mbajtjen e dy qëndrimeve ndaj vajzave. Ky qëndrim dyfytyrësh, është dëshmia më e madhe për kotësinë e besimeve të tyre dhe privimin në themel të bindjeve të tyre.

Vetëm me disa fjali të shkurtra, Zoti e vendos vizën e kuqe mbi të gjithë ata, nxjerr në pah falsitetin e tyre dhe bën të qartë se sa qesharake janë.

Prej këtej bëhet e qartë se Kur'ani, në asnjë rast, nuk pranon bindjet e injorancës arabe, në lidhje me dallimin mes vajzës dhe djalit. Bindjen e krijuar te pala tjetër ua përplasi në fytyrë. Këtë gjë, në terminologjinë e logjikës, e quajnë "xhedel" (polemikë). Sipas besimit islam, mes vajzës dhe djalit nuk ekziton

asnjë dallim, për nga aspekti i vlerave njerëzore. As engjëjt nuk janë as djalë e as vajzë, nuk kanë gjini. Sigurisht ata nuk janë fëmijët e Zotit, sepse Zoti nuk ka ndonjë fëmijë. Por këto janë supozime pa themel, që bazohen në supozime të tjera, po ashtu të pabaza. Demaskimi i këtyre qëndrimeve është përgjigjja e duhur, për ta provuar dobësinë e logjikës së adhuruesve të besëtytnive.

Në ajetin 23, Kur'ani, në mënyrë të prerë dhe kategorike, thotë: **"Këta janë vetëm emra që ua keni ngjitur** (idhujve) **ju dhe të parët tuaj, kurse All'llahu nuk ju ka dërguar për ata asnjë provë."**.[1]

Adhuruesit e besëtytnive nuk kanë asnjë argument racional, për të vërtetuar drejtësinë e qëndrimeve të tyre. Ata nuk kanë as edhe një Shpallja hyjnore, ku të mbështesnin sjelljet e tyre. Prandaj gjithçka e tyre është një sjellje e qëndrim i mbështetur në besëtytni, në iluzione dhe shprehje boshe.

Në fund, ajeti shton: **"Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi, ndonëse u ka ardhur prej Zotit të tyre udhëzimi** (për Rrugën e Drejtë)**."**.

Ata i mbyllin sytë, kthejnë kurrizin dhe zhyten në errësirën e këtyre iluzioneve.

[1] Fjala *"sultan"* është në kuptimin e sundimit. Quhet *"sultan"*, sepse është i gjallë dhe i fortë, si dhe për shkak të dominimit mbi armikun.

Hulumtime

1- Tri idhujt e njohur të arabëve

Idhujtarët arabë kishin shumë idhuj, por idhujt më të rëndësishëm të tyre ishin: Lat, Uzza dhe Menatë.

Emërtimi i idhujve të tyre me këto emra, si dhe me krijuesin e parë të këtyre idhujve, vendi dhe fiset që i adhuronin, është çështje bisedimi. Ne do të mjaftohemi vetëm me përmendjen e asaj që është trajtuar në librin "Bulugul ireb fi marifeti ahval-il arab" - " Idhulli i Menatit ishte idhulli i parë i njohur që arabët e kishin zgjedhur për vete. Ai u krijua, pasi Amr bin Lehiji e solli idhujtarinë nga Shami në Hixhaz. Ky idhull gjendej në afërsi të Detit të Kuq, mes Medines dhe Mekës. Të gjithë arabët kishin respekt të veçantë për të, bënin kurban pranë tij. Më shumë se kushdo tjetër, dy fiset, Ous dhe Khazrexh, i jepnin rëndësi më të madhe atij, derisa në vitin e tetë të Hixhretit, viti i çlirimit të Mekës, në kohën kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po shkonte nga Medina në drejtim të Mekës, dërgoi Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)* për ta thyer atë.

Arabët e paditur dhe injorantë, pasi kishin ndërtuar idhullin e Menatit, filluan ndërtimin e idhullit të Latit, i cili ishte në formën e një guri me katër cepa dhe ndodhej në Taif, aty ku sot gjendet minarja e anës së majtë të xhamisë Taif. Adhurues i këtij idhulli, më së shumti ishte fisi Thakif. Pasi ata u bënë myslimanë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

familjen e tij!) e dërgoi Mugejren për ta thyer atë dhe më pas e dogji.

Idhulli i tretë, të cilin e kishin përzgjedhur injorantët arabë, quhej Uzza. Ai ndodhej pranë rrugës që e lidhte Mekën me Irakun, në afërsi të Dhate Irak. Fisi kurejsh i kushtonte një rëndësi të veçantë.

Ata kishin një konsideratë kaq të madhe për këta idhuj, saqë në momentin e bërjes tauaf rreth Qabes, thoshin: "Lat, Uzzat dhe Menatt, janë zogj të bukur, me një pozitë të lartë dhe tek ata ekziston shpresa e ndërmjetësimit!".

Ata i konsideronin si vajzat e Zotit (me sa duket ata i konsideronin imazh të engjëjve, për të cilët mendonin se janë të bijat e Zotit).[1]

Është për t'u çuditur fakti se edhe për emërtimin e tyre, ata kishin përdorur emrat, cilësitë e Zotit, por në gjininë femërore, në mënyrë që të shprehnin besimin e lartpërmendur. Kështu që *"el lat''*, në thelb, ka qenë *"el lahe"*, më pas shkronja *"ha"* është hequr dhe ka marrë trajtën *"el lat"*, kurse fjala *"uzza"* është gjinia femërore e fjalës *"a'azz"*. Fjala *"menat"* është marrë nga shprehja *"menall'llahu shejen"*, që do të thotë *"përcaktimi i një gjëje nga ana e Zotit"*.

Sipas disa të tjerëve, ajo fjalë rrjedh nga rrënja *"ne'u"*, që tregonte një *plejadë yjesh*. Arabët besonin se, kur shfaqen ato yje, sillnin shi me vete. Disa të tjerë, atë fjalë e konsiderojnë si derivat

[1] "Bulugul ireb fi mearife ehvalul arab", vëll. 2, f. 220-203.

të fjalës *"menj"*, që përdoret me kuptimin e rrjedhjes së gjakut, sepse gjaku i kurbaneve rridhte pranë tij.[1]

Sidoqoftë, arabët kishin një konsideratë të madhe dhe i respektonin aq shumë këta idhuj, saqë për disa njerëz, apo edhe për disa fise, përzgjidhnin emra, si: Abdul Uzza dhe Abdul Menat.[2]

2- Emërtime të pabaza

Një prej burimeve më të vjetra të idhujtarisë, të dualizmit apo të pluralizmit në adhurim, është diversiteti i krijesave të botës.

Duke u nisur nga fakti se njerëzit mendjelehtë nuk mund të besonin që të gjitha këto krijesa të shumëllojshme, që ndodhen në tokë dhe në qiej, janë krijesa të Një Zoti që është Një dhe i Vetëm. Ata e quanin veten e tyre të vetëm, (sepse si rregull, ata e përcaktonin veten si mjaft të zotë, që përherë kishin aftësi mbi një apo më shumë veprash), ndaj për çdo lloj prej krijesave, caktonin një hyjni, që e quanin si *"rabbun-nou"* (arketip apo hyjni të llojit), si për shembull, hyjnia e detit, e shkretëtirës, e shiut, e diellit, e luftës, e paqes.

Këto hyjni apo perëndi imagjinare, që ndonjëherë i kujtonin edhe si engjëj, sipas bindjeve të tyre, ishin sundimtarë të kësaj bote dhe, sa herë që përballeshin me ndonjë problem, kërkonin mbrojtje te këto hyjni. Më pas, për t'i imituar hyjnitë e

[1] Mundësia e parë është përmendur në "El Keshshaf" dhe mundësia e dytë në "Bulugul Ireb".
[2] "Bulugul Arab", vëll. 2, f. 202-203.

tyre, që nuk ishin krijesa materiale, krijuan skulptura që t'i adhuronin ato në vend të tyre.

Këto besime dhe besëtytni u transferuan nga Greqia në zonat e tjera, dhe, më në fund, në zonën e Hixhazit. Arabët që kishin mbetur në monoteizm ibrahimik, nuk mund të mohonin ekzistencën e All'llahut, prandaj këto ide dhe besime u përzien së bashku. Arabët pranonin ekzistencën e Zotit, besuan edhe në engjëjt, por besonin se marrëdhënia e engjëjve me Zotin ishte marrëdhënia mes vajzës dhe babait, kurse idhujt prej guri dhe druri i konsideronin si simbole dhe imazhe të tyre.

Kur'ani, me anë të një shprehjeje lakonike, tronditëse, shumë domethënëse dhe të qëlluar, që e lexuam në ajetin më lart, e përmend këtë fakt: **"Këta janë vetëm emra që ua keni ngjitur** (idhujve) **ju dhe të parët tuaj, kurse All'llahu nuk ju ka dërguar për ata asnjë provë."**.

Asnjë nga hyjnitë e shumta të tyre, as hyjnia e shiut, as perëndia imagjinare e diellit, e detit, e luftës dhe e paqes nuk ju sjellin dot asnjë dobi dhe mbrojtjeje.

Çdo gjë është krijuar nga Zoti i Gjithëdijshëm dhe i gjithë universi i nënshtrohet urdhrit të Tij. Harmonia e këtyre krijesave të shumëllojshme, mes njëra–tjetrës, është argumenti më i fortë për unitetin e krijuesit të tyre. Në qoftë se ne do të supozonim se ekzistonin shumë zota, jo vetëm që nuk do të ekzistonte kjo harmoni, por gjithçka do të rezultonte antagoniste dhe universi

do të zhdukej**: "Sikur të kishte në to'** (në qiej e në tokë) **zota pos All'llahut, ato të dyja do të shkatërroheshin..."**.1

3- Filli psikologjik i idhujtarisë

Gjatë këtyre analizave, u njohëm me burimet historike të adhurimit të idhujve, por idhujtaria, nga pikëpamja ideore dhe psikologjike, ka burime tërësisht të ndryshme. Këto burime u përmendën në ajetet që sapo cituam dhe janë vijim i supozimeve të pavërteta.

Idhujtaria është një supozim i mbështetur në imagjinatë. Idhujtaria shfaqet te njerëzit e padijshëm. Dishepujt apo pasuesit e huazojnë qorrazi nga njëri–tjetri dhe, në këtë mënyrë, transmetohen brez pas brezi.

Të adhurosh një objekt, siç bëjnë idhujtarët, do të thotë të adhurosh një objekt që nuk ka asnjë lidhje me presupozimin e ndonjë ringjalljeje, kontrolli apo mbikëqyrjeje të adhuruesve të vet, nuk ka asnjë lloj ndikimi a ndërmjetësimi në llogaridhënie, i lë ata të lirë në pranimin ose jo në Xhennet dhe Xhehennem. Idhujtarët i drejtohen objektit të tyre të adhurimit vetëm kur përballen me probleme dhe vështirësi dhe, sipas pandehjes së tyre, kërkojnë ndihmë nga ai. Kjo sjellje përputhet me qejfet dhe dëshirat e ulëta dhe u lë hapësirë të bollshme pasioneve dhe epsheve të tyre.

[1] Sure "El Enbija", ajeti 22.

Në parim, dëshira inferiore është idhulli më i madh dhe më i rrezikshëm, është filli i shfaqjes së idhujve të tjerë, si dhe faktori që nxit tregun e idhujtarisë.

4- Sërish miti Garanik

Në diskutimet që bëmë në lidhje me tre idhujt kryesore të arabëve, Lat, Uzza dhe Menat, u përmend fakti se ata i konsideronin këta idhuj si Garanik, me pozitë të lartë. Shpresonin në ndërmjetësimin e tyre. Fjala *"garanik"* është shumësi i fjalës *"gurnuk"* dhe përdoret për të treguar një lloj shpendi ujor me ngjyrë të bardhë ose të zezë. Prandaj ata, ndonjëherë, pas përmendjes së emrave të këtyre idhujve, i shoqëronin ato me shprehjen: **"tilkel garanikul ula ue inne shefaetehune le turtexha"**.

Në disa libra është transmetuar një tregim supersticioz. Sipas këtij tregimi, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur arriti në ajetin që po diskutojmë, pyeti: **"A e keni parë Latën dhe Uzzën?"**.

Vetë ai u bashkëngjiti këto dy shprehje: **"tilkel garanikul ula ue inne shefaetehunne leturtexhi"**. Kjo u bë shkak që politeistët të gëzoheshin dhe këtë ta konsiderojnë si një lloj tolerimi ndaj idhujtarisë nga ana e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Prandaj, në fund të kësaj sureje, tregohet se, kur i fton myslimanët të bien në sexhde, edhe ata, përkrah myslimanëve, ranë në sexhde. Ky lajm u përhap kudo, si pranimi i Islamit nga ana e politeistëve. Këtë lajm e dëgjuan edhe emigrantët myslimanë në Habeshe, një pjesë e të cilëve u

ndjenë aq të gëzuar dhe të sigurt, saqë u nisën nga vendmigrimi (vendqëndrimi) i tyre, Habeshe, për t'u rikthyer në Mekë.[1]

Siç u shprehëm qartë dhe në mënyrë të detajuar, në komentimin e ajetit 52 të sures "El Haxhxh", ky është një përshkrim i padrejtë dhe një gënjeshtër e madhe. Këto mashtrime i provojnë shumë arsye dhe fakte, duke bërë të qartë falsitetin e saj. Ata që e kanë trilluar këtë gënjeshtër, as që kanë menduar se Kur'ani, në ajetin në fjalë, godet qartë idhujtarinë dhe e konsideron pasim të pandehjes primitive dhe epshit.

Në ajetin vijues, me ashpërsi të plotë, i dënon bindjet e idhujtarëve dhe i konsideron si shenjë të mosbesimit, të mos dijes dhe të mos njohjes së tyre, si dhe urdhëron hapur Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të ndajë llogarinë me ata dhe të largohet prej tyre.

Po si është e mundur që ato dy shprehje të jenë nga ana e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe politeistët të jenë aq të trashë dhe budallenj, sa t'i dëgjojnë ato fjalë dhe të mos marrin në konsideratë ajetet vijuese, që e ndalojnë në mënyrë kategorike adhurimin e idhujve dhe, madje, të ndihen të gëzuar në fund dhe pas përfundimit të sures të bien në sexhde me besimtarët?!

Kjo situatë tregon, se sajuesit e këtij miti e kanë trilluar atë në mënyrë jo profesionale dhe pa u menduar.

Ka gjasa që gjatë leximit të ajetit: **"A e keni parë Latën dhe Uzzën?"**, nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë*

[1] Kjo histori supersticioze është transmetuar nga Taberiu në formë të detajuar, në historinë e vet, vëll. 2, f. 75 e tutje.

mbi të dhe mbi familjen e tij!), djalli apo një njeri me cilësi djallëzore nga turma e pranishme politeiste t'i ketë shtuar ato dy fjali, sepse këto dy fjali për ata, pothuaj ishin marrë në formën e një slogani, që përcillte emrat e tre idhujve dhe disa prej tyre të kenë rënë përkohësisht në gabim.

Por as rënia e tyre në sexhde, në fund të kësaj sureje, nuk mbart ndonjë kuptim, as ndjeshmëri të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në lidhje me adhurimin e idhujve. Të gjitha ajetet kur'anore dhe historia e jetës së tij, dëshmojnë faktin se ai asnjëherë nuk ka treguar as tolerancën me të vogël në luftën me idhujtarinë.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* asnjëherë nuk ka pranuar asnjë propozim në lidhje me këtë çështje, sepse Islami ka, në thelbin e tij, parimin e shenjtë: "Nuk ka Zot tjetër përveç, All'llahut". Atëherë, si është e mundur që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të bëjë pazare në lidhje me përmbajtjen kryesore dhe thelbësore të Islamit?!

Për këtë çështje kemi përmendur shumë argumente dhe prova në ajetin 52 të sures "El Haxhxh". (vëllimi 14, faqe 141-145)

Ajetet 24 – 26

أَمْ لِلْإِنْسَانِ مَا تَمَنَّىٰ ﴿٢٤﴾ فَلِلَّهِ الْآخِرَةُ وَالْأُولَىٰ ﴿٢٥﴾ وَكَمْ مِنْ مَلَكٍ فِي السَّمَاوَاتِ لَا تُغْنِي شَفَاعَتُهُمْ شَيْئًا إِلَّا مِنْ بَعْدِ أَنْ يَأْذَنَ اللَّهُ لِمَنْ يَشَاءُ وَيَرْضَىٰ ﴿٢٦﴾

"A do të ketë njeriu gjithçka që dëshiron?"

"Vetëm All'llahut i përkasin Bota Tjetër dhe kjo botë!"

"Sa engjëj ka në qiej, ndërmjetësimi i të cilëve nuk bën asnjë dobi, veçse pasi të japë leje All'llahu, për kë të dojë e të pëlqejë Vetë!"

Komentimi

Edhe ndërmjetësimi është vetëm me lejen e Zotit

Edhe këto ajete trajtojnë dhe dënojnë besëtytninë e idhujtarisë. Këto ajete janë një vazhdimësi e ajeteve të mëparshme.

Në fillim, Zoti i Madhëruar parashtron dëshirat e pathemelta dhe të pabaza të idhujtarëve, parashtron edhe

pretendimet që kanë ndaj idhujve dhe thotë: **"A do të ketë njeriu gjithçka që dëshiron?"**.

A është e mundur që këto objekte jofrymore të mund të shërbejnë për ndërmjetësimin e idhujtarëve përpara Zotit? A mund të kërkohet mbrojtje nga ai, për vështirësitë dhe fatkeqësitë që kanë apo do të kenë në këtë botë dhe në Botën Tjetër, kur dihet se **"Vetëm All'llahut i përkasin Bota Tjetër dhe kjo botë!"**.

Gjithë bota sillet rreth boshtit të vullnetit të All'llahut. Çdo krijesë, çdo qenie, çdo gjë që ka dikush, e ka nga begatia e ekzistencës së Zotit. Jo vetëm ndërmjetësimi është nga ana e All'llahut, por edhe zgjidhja e problemeve është në dorën e fuqisë së Tij.

Duhet të mbajmë mirë parasysh faktin se në fillim flitet për Ahiretin, pra, jetën pas vdekjes dhe më pas për jetën e kësaj bote, sepse shqetësimi më i madh i mendjes njerëzore është shpëtimi në Botën Tjetër. Pushteti i Zotit bëhet më i qartë në Botën Tjetër, sesa në këtë botë.

Në këtë mënyrë Kur'ani, në tërësi, ua shuan shpresat politeistëve se idhujt e tyre mund të ndërmjetësojnë dhe mund t'i zgjidhin problemet e tyre, se do mund të jenë ndërmjetësuesit e tyre te Zoti: **"...këta janë ndërmjetësuesit tanë tek All'llahu..."**.[1]

Në komentin e dy ajeteve të lartpërmendura, ekziston, gjithashtu, një mundësi tjetër. Ajo është orientimi drejt Zotit. Vetëm duke iu drejtuar Zotit të Madhëruar mund të plotësohen kërkesat dhe dëshirat, sepse njeriu nuk ka mundësi t'i realizojë

[1] Sure "Junus", ajeti 18.

kërkesat dhe dëshirat e tij, pa mbështetjen dhe ndihmën e Tij. Prandaj në ajetin 24 thuhet: **"A do të ketë njeriu gjithçka që dëshiron?"**.

Përgjigjja e kësaj pyetjeje është kategorikisht negative. Njeriu asnjëherë nuk i arrin shumë prej dëshirave të tij. Kjo tregon se drejtimi i kësaj bote është në dorën e një Tjetri dhe vullneti i Tij është mbizotërues në këtë botë, ndaj në ajetin 25 thotë: **"Vetëm All'llahut i përkasin Bota Tjetër dhe kjo botë!"**.

Ky kuptim është i ngjashëm me thënien e Imam Aliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*: *"E kam njohur All'llahun e Madhëruar përmes përhumbjes së vendimeve (synimeve), zgjidhjes së lidhjeve dhe cenimit të dëshirave."*[1]

Por është i mundur edhe bashkimi i të dy interpretimeve të lartpërmendura.

Për ta theksuar më shumë këtë çështje, ajeti 25 thotë: **"Sa engjëj ka në qiej, ndërmjetësimi i të cilëve nuk bën asnjë dobi, veçse pasi të japë leje All'llahu, për kë të dojë e të pëlqejë Vetë!"**.

Kur edhe engjëjt e Zotit, që kanë gjithë atë madhështi, madje edhe në grup, nuk janë në gjendje të ndërmjetësojnë, përveçse me lejen dhe pëlqimin e Zotit, atëherë ç'janë ato pretendime të idhujtarëve, që idhujt e tyre të pandërgjegjshëm dhe pa asnjë lloj vlere, të mund të ndërmjetësojnë?!

Fjala *"kem"* - *"sa shumë"* këtu është përdorur në kuptimin e përgjithshëm dhe të gjerë, dhe tregon se asnjë prej engjëjve nuk

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalët e zgjedhura , Fjala 250.

mund të ndërmjetësojë pa lejen dhe kënaqësinë e All'llahut, sepse kjo shprehet në fjalorin arab. Ai fjalor e përdor ndonjëherë këtë fjalë në kuptimin gjithëpërfshirës, ashtu si fjala *"kethir"* në suren "El Isra", në ajetin 70, që është përdorur në kuptimin *"të gjithë"*.

Aty thuhet: **"...i vlerësuam ata** (i lartësuam) **ndaj shumicës së krijesave që Ne krijuam."**. Gjithashtu, në ajetin 223 të sures "Esh Shuara", në lidhje me djajtë, lexojmë: **"...e hedhin dëgjimin, shumica e tyre gënjeu..."**. Ndërkohë që e dimë se ata, që të gjithë, janë gënjeshtarë.[1]

Dallimi mes fjalës *"idhn" - "leje"* dhe *"ridha" - "pëlqim"*, qëndron në faktin se fjala *"idhn"* përdoret kur personi nxjerr në pah kënaqësinë e vet të brendshme, kurse fjala *"redhajet"* është më e përgjithshme se ajo dhe është në kuptimin e përputhjes së natyrës me kryerjen e një pune apo të një gjëje. Ndodh që njeriu, ndonjëherë, e lejon një gjë, ndërkohë që nuk është i kënaqur në zemër me atë lejim. Prandaj, në ajetin e lartpërmendur, për ta nënvizuar kuptimin, pas fjalës *"idhn"*, Zoti ka përmendur fjalën *"ridha" - "pëlqim"*, edhe pse te Zoti i Madhëruar *"idhn" - "lejimi"* nuk është i ndarë nga *"ridha" - "kënaqësia"*. Fshehja e qëllimit për interesa në lidhje me Zotin, nuk ka kuptim.

[1] Përemri, në fjalinë: *"shefaetuhum"*, edhe pse fjala *"melek"* është në njëjës, është në shumës, për shkak të zbatimit të konceptit të fjalës që ka një kuptim në shumës.

Hulumtim

Zgjerimi i rrethit të shpresave

Shpresat dhe dëshirat burojnë nga forca e kufizuar e njeriut, si dhe nga pafuqia e tij. Sa herë që njeriu dëshiron ndonjë gjë dhe nuk ia arrin asaj, fillon të shpresojë. Në qoftë se dëshirat njerëzore do të realizoheshin brenda çastit, atëherë shpresa nuk do të kishte as kuptim, as domethënie.

Kur dëshirat e njeriut janë të drejta dhe burojnë nga shpirti i tij i pastër, bëhen faktorë për lëvizje, përpjekje për frymëzim dhe zhvillim.

Si shembull mund të merret rasti kur njeriu dëshiron të jetë më i përsosuri prej qenieve njerëzore në dije, shkencë, devotshmëri, virtyt, karakter dhe nder.

Por ndodh shpesh që këto shpresa dhe dëshira të jenë të rreme, përkundër dëshirave që bazohen te të vërtetat. Atëherë ato bëhen shkak i shpërfilljes, i mosndërgjegjësimit, i tymnajës mendore dhe i prapambetjes. Si shembull mund të merret dëshira për të realizuar Jetën e Amshuar dhe qëndrimin përherë në këtë botë, pasjen e të gjithë pasurive dhe mallrave, sundimin mbi të gjithë njerëzit dhe iluzione të tjera të ngjashme me këto.

Për këtë arsye, në transmetimet islame njerëzit orientohen të shkojnë pas dëshirave të dobishme. Në një hadith, të transmetuar nga Profeti i Islamit, lexojmë: "*Ai që dëshiron ndonjë gjë që është objekt pëlqimi i Zotit, nuk do të largohet nga kjo botë pa e realizuar atë.*".

Nga disa transmetime të tjera, tregohet se sa herë që në këtë botë nuk e realizon një dëshirë, shpërblimi i saj në Botën Tjetër do të arrijë.[2]

Bisedë rreth ndërmjetësimit

Ajeti i fundit lajmëron në mënyrë të qartë për mundësinë e ndërmjetësimit të engjëjve, vetëm atëherë kur ata kanë lejen dhe pëlqimin e Zotit të Madhëruar. Prandaj Profetët dhe Imamët e pagabueshëm kanë përparësi ndaj engjëjve në ndërmjetësim. Mirëpo nuk duhet harruar që ajeti i lartpërmendur thotë qartë: "ky ndërmjetësim nuk është i pakushtëzuar". Përkundrazi, kushtëzohet me lejen dhe pëlqimin e Zotit dhe, duke u nisur nga fakti që lejimi dhe pëlqimi i Tij nuk është pa llogari, mes Tij dhe njeriut duhet të ekzistojë një marrëdhënie. Atëherë Zoti i Madhëruar mund të lejojë ndërmjetësimin e të afërmve të Tij. Në këtë mënyrë, shpresa e ndërmjetësimit transformohet në një shkollë të frytshme edukative për njeriun dhe pengon prishjen e të gjitha marrëdhënieve të tij me Zotin e Madhëruar.[1]

[1] Shprehja *"men jeshau"*, në ajet, ka gjasa të jetë aludim për njerëzit që Zoti do t'i lejojë për ndërmjetësimin e tyre, ose mund të jetë aludim për engjëjt që do t'u japë lejen e ndërmjetësimit. Mundësia e parë duket më e përshtatshme.

Ajetet 27 – 30

إِنَّ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ لَيُسَمُّونَ الْمَلَائِكَةَ تَسْمِيَةَ الْأُنْثَىٰ ٢٧ وَمَا لَهُمْ بِهِ مِنْ عِلْمٍ إِنْ يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَإِنَّ الظَّنَّ لَا يُغْنِي مِنَ الْحَقِّ شَيْئًا ٢٨ فَأَعْرِضْ عَنْ مَنْ تَوَلَّىٰ عَنْ ذِكْرِنَا وَلَمْ يُرِدْ إِلَّا الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ٢٩ ذَٰلِكَ مَبْلَغُهُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنْ ضَلَّ عَنْ سَبِيلِهِ وَهُوَ أَعْلَمُ بِمَنِ اهْتَدَىٰ ٣٠

"Vërtet, ata që nuk besojnë në Jetën Tjetër, u japin engjëjve emra femërorë."

"Ata nuk kanë asnjë njohuri për këtë, por ndjekin vetëm hamendjen, ndonëse hamendja nuk mund ta zëvendësojë aspak të vërtetën."

"Andaj, ti (o Muhammed) **largohu prej atij, që i kthen kurrizin Kur'anit dhe, që dëshiron vetëm jetën e kësaj bote!"**

"Kaq arrin gjithë dija e tyre! Në të vërtetë, Zoti yt i njeh më së miri ata që janë shmangur nga Rruga e Tij dhe ata që ndjekin Rrugën e Drejtë."

Komentimi

Pandehja dhe hamendësimi kurrë nuk e çon njeriun drejt të vërtetës

Ajetet në vijim trajtojnë bindjet e politeistëve. Politeistët nuk besonin në Botën Tjetër, nuk besonin në llogaridhënien, etj. Doktrina e tyre ishte doktrina e mohimit për disa nga çështjet themelore të Islamit.

Ajeti 27 fillon duke i sqaruar këto çështje: **"Vërtet, ata që nuk besojnë në Jetën Tjetër, u japin engjëjve emra femërorë."**.

Kjo thënie e shëmtuar rrjedh vetëm nga goja e njerëzve që nuk besojnë në llogaridhënien dhe përgjegjësinë e veprave. Në qoftë se do të ishin besimtarë, nuk do të flisnin me kaq guxim për një çështje që nuk kanë as argumentin më të vogël. Ndërkohë që fakte të pamohueshme tregojnë se as Zoti nuk ka ndonjë fëmijë, as engjëjt nuk janë femra.

Përdorimi i shprehjes *"tesmijel untha"* tregon se edhe në ajetet që do vijnë, fjalët e politeistëve janë emërtime pa përmbajtje, janë fjalë boshe dhe nuk kanë asnjë lidhje me realitetin.

Më pas, Kur'ani sjell një argument tjetër të qartë, lidhur me këto emërtime: **"Ata nuk kanë asnjë njohuri për këtë, por ndjekin vetëm hamendjen, ndonëse hamendja nuk mund ta zëvendësojë aspak të vërtetën."**.

Besimtarët asnjëherë nuk thonë asnjë fjalë, pa pasur njohuri të plota. Besimtarët nuk bëjnë krahasime, pa pasur arsye.

Mbështetja në dyshim, në pandehma dhe hamendësime është vepër e djallit, është vepër e njerëzve me tipare djallëzore. Vepra me tipare djallëzore, janë, p.sh: pranimi i besëtytnive dhe i iluzioneve, të cilat njëherazi, janë shenjë e devijimit dhe e paditurisë.

Fjala *"dhann"* - *"hamendësim"* mbart dy kuptime të ndryshme. Ndonjëherë është përdorur me kuptimin e hamendësimeve, pa bazë, si p.sh. "epshi, iluzionet dhe besëtytnitë".

Kuptimi tjetër pranon se hamendësimet e arsyeshme dhe të justifikuara, zakonisht përputhen me realitetin. Ato shërbejnë si bazë për veprimtarinë e njerëzve racionalë në jetën e përditshme, si për shembull, dëshmitë në proceset penale në gjykatë, ose "ekspertiza e ekspertëve" apo të tjera të ngjashme me këto. Nëse këto hamendësime nuk i marrim parasysh në veprimtarinë e jetës njerëzore dhe mbështetemi vetëm në bindje definitive, jeta do të prishej dhe do të shkatërrohej.

Por ky lloj hamendësimi dhe kjo pandehje nuk është pjesë e përmbajtjes së këtyre ajateve. Për këtë fakt kemi dëshmi të shumta brenda vetë këtyre ajeteve. Thënë ndryshe, lloji i dytë, në fakt, është një farë dije kolektive, e përbashkët dhe jo hamendësim.

Si rrjedhim, ajeti: **"Por ndjekin vetëm hamendjen, ndonëse hamendja nuk mund ta zëvendësojë aspak të vërtetën.",** nuk duhet të kuptohet dhe të argumentohet si mohim i hamendësimit në tërësi.

Po ashtu, duhet të theksohet se fjala *"dhann" - "hamendësim"*, në terminologjinë e jurisprudencës islame, është përdorur në kuptimin e bindjes, se vetëm njëra nga dy anët e mundshme ka përparësi. Por kuptimi leksikor i kësaj fjale ka një kuptim më të gjerë. Ai përfshin edhe dyshimet e ndryshme, të dobëta. Hamendësimi i idhujtarëve ishte i këtij lloji. Në trurin e idhujtarëve përvijohen besëtytni në formën e një mundësie të dobët. Më pas, pranojnë veprime epshi, të cilat edhe i zbukuronin. Qëndrimin që duhej t'i kundërshtonte këto sjellje, e linin në harresë dhe gradualisht kujdeseshin që të shndërrohej në një bindje të fortë, ndërkohë që nuk kishte asnjë themel apo bazë të asnjë lloji kuptimi a interpretimi.

Për ta bërë edhe më të qartë, mund të themi se idhujtarët nuk janë njerëz të arsyetimit dhe të logjikës, por janë njerëz që dashurinë më të madhe të kësaj bote, përmendjen dhe adhurimin e Zotit të Madhëruar e lënë në harresë. Dhe kjo i zhyt ata në moçalin e fantazive dhe të iluzioneve. Për ta qartësuar më mirë këtë, ajeti shton: **"Andaj, ti** (o Muhammed) **largohu prej atij, që i kthen kurrizin Kur'anit dhe, që dëshiron vetëm jetën e kësaj bote!"**.

Sipas mendimit të disa komentuesve, togfjalëshi *"përmendja e Zotit"* nënkupton Kur'anin. Komentues të tjerë kanë shprehur mendimin se me atë togfjalësh synohen "argumentet logjike dhe racionale", që e çojnë njeriun te Zoti. Por është thënë edhe se me atë synohet po "përmendja e Zotit", pra, e kundërta e harresës së kujtimit të Zotit, siç bëjnë idhujtarët.

Në pamje të parë, duket se kjo shprehje ka një kuptim të gjerë, i cili përfshin çdo lloj kushtimi të vëmendjes ndaj Zotit,

qoftë nëpërmjet Kur'anit dhe arsyes, qoftë me anë të respektimit të traditës dhe kujtimit të Kiametit.

Ajeti tregon se ekziston një marrëdhënie mes indiferencës, harresës së përkujtimit të Zotit dhe dhënies pas gjërave materiale të kësaj bote mashtruese. Duhet theksuar se midis këtyre të dyjave, ka një lidhje të ndërsjellë: harresa e përkujtimit të Zotit e çon njeriun drejt materializimit dhe anasjelltas. Këto të dyja, janë të shoqëruara me egoizmin, (vetë adhurimin). Në këtë mënyrë krijohet terreni për shfaqjen e besëtytnive në mendjen e njeriut, të cilat, gradualisht shndërrohen në bindje.

Është më se e kuptueshme se urdhri për largimin nga ky grup, nuk ka asnjë mospërputhje me misionin e profetësisë. Harmonia me misionin e profecisë është përgjegjësia kryesore e Profetit të Islamit.

Përhapja e fesë, predikimi, paralajmërimi dhe përgëzimi bëhet atje ku ekziston mundësia për ndikim. Aty ku jemi të sigurt se predikimi i fesë së Islamit nuk do të ketë ndikim, edhe pasi kemi paraqitur argumentet tona, fuqitë nuk duhet të shpenzohen, por duhet të largoheni.

Duhet të kihet parasysh edhe fakti, se ky urdhër nuk i përket vetëm Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por përfshin të gjithë thirrësit në Rrugën e Drejtë, të cilët nuk duhet t'i harxhojnë fuqitë e tyre propagandistike aty ku e shohin se nuk do të kenë sukses. Njerëzit idhujtarë, të cilët, edhe pas paraqitjes së argumenteve, nuk e ndryshojnë gjendjen e tyre, duhen të lihen të lirë, derisa Zoti të gjykojë rreth tyre.

Në ajetin e fundit të diskutimit, për ta vërtetuar këtë lajthitje mendore të këtij grupi, theksohet: **"Kaq arrin gjithë dija e tyre!"**.

Në kulmin e këtyre përpjekjeve mendore, idhujtarët arrijnë fundin e vet, kur trillojnë mitin se engjëjt janë vajzat e Zotit. Kështu ata zhyten kokë e këmbë në errësirën e iluzioneve dhe të besëtytnive. Pika e fundit e ambicies së tyre arrin kur ata harrojnë Zotin dhe shkojnë pas kësaj bote materiale.

Më në fund, ajeti thotë: **"Në të vërtetë, Zoti yt i njeh më së miri ata që janë shmangur nga Rruga e Tij dhe ata që ndjekin Rrugën e Drejtë."**.

Fjalia: **"Kaq arrin gjithë dija e tyre!"** mund të jetë edhe aludim për besëtytni të tilla, si idhujtaria dhe pohimi që engjëjt janë vajza të Zotit. Kjo do të thotë që caku përfundimtar i dijes së këtij grupi janë po këto iluzione.

Kjo fjali mund edhe të aludojë se "adhurimi i kësaj bote dhe dorëzimi i tyre në kthetrat e materializmit", që do të thotë kulmi i inteligjencës dhe i të kuptuarit të tyre, është gjendja e gjumit, e rehatisë, larmia e ushqimeve, pasuritë kalimtare dhe shkëlqimet boshe të kësaj bote.

Në një lutje të njohur, që është transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në lidhje me veprimet e muajit Shaban, lexojmë: *"O Zoti Im!*

Mos na e bëj botën shqetësimin tonë më të madh dhe cakun përfundimtar të dijes dhe njohurisë sonë."[1]

Fundi i ajetit tregon qartë se Zoti i Madhëruar i njeh më së miri edhe të devijuarit, edhe të udhëzuarit. Njërin do ta dënojë, kurse tjetrin do ta përfshijë në Mëshirën e Vet dhe në Kiamet secili do të gjykohet në bazë të veprave të tij.

Hulumtim

Kapitali i adhuruesve të kësaj bote

Vlen për t'u theksuar fakti se në ajetet e lartpërmendura, edhe pse për njerëzit të dhënë pas kësaj bote, pranojnë një fare dije, prapë i konsideron si të devijuar. Ky është argument që e pranon edhe Kur'ani, se dijet dhe dituritë që kanë për synim përfundimtar, është arritja (përfitimi) e dobive materiale, nuk janë dije. Janë humbje dhe devijim.

Të gjitha fatkeqësitë që ekzistojnë në botën e sotme, të gjitha luftërat dhe gjakderdhjet, shtypjet dhe agresionet, rastet e korrupsionit dhe të përlyerjes, rrjedhin nga këto dituri, të cilat sjellin devijim. Këto fatkeqësi vijnë nga njerëzit, që cakun e njohurive të tyre kanë jetën e kësaj bote. Synimi më i madh i jetës

[1] Kjo lutje, gjithashtu, është përmendur edhe në veprën "Mexhmaul Bejan" dhe në disa tefsire të tjera.

së tyre është vetëm jeta e kësaj bote dhe horizonti i vrojtimit të tyre nuk shtrihet përtej nevojave shtazarake të tyre.

Përderisa dija nuk bëhet një mjet për qëllime më sublime, ajo është injorancë. Derisa dija të mos jetë burim i dritës së besimit dhe të mos shndërrohet në një mjet në rrugën e saj, është humbje.

Ajetet 31 – 32

وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ لِيَجْزِيَ الَّذِينَ أَسَاءُوا بِمَا عَمِلُوا وَيَجْزِيَ الَّذِينَ أَحْسَنُوا بِالْحُسْنَىٰ ٣١ الَّذِينَ يَجْتَنِبُونَ كَبَائِرَ الْإِثْمِ وَالْفَوَاحِشَ إِلَّا اللَّمَمَ إِنَّ رَبَّكَ وَاسِعُ الْمَغْفِرَةِ هُوَ أَعْلَمُ بِكُمْ إِذْ أَنْشَأَكُمْ مِنَ الْأَرْضِ وَإِذْ أَنْتُمْ أَجِنَّةٌ فِي بُطُونِ أُمَّهَاتِكُمْ فَلَا تُزَكُّوا أَنْفُسَكُمْ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنِ اتَّقَىٰ ٣٢

"All'llahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, për t'i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta e, për t'i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë."

"Për ata që ruhen prej gjynaheve të mëdha dhe veprave imorale, përveç gjynaheve të vogla, me të vërtetë, Zoti yt është i Gjerë në falje. Ai ju njeh mjaft mirë, qysh se ju krijoi nga dheu dhe qysh se keni qenë embrion në barkun e nënave tuaja. Prandaj, mos u lavdëroni me pafajësinë tuaj! Ai i njeh më së miri ata që ruhen nga gjynahet."

Komentimi

Mos e lavdëroni veten, Ai ju njeh më së miri!

Në ajetet e kaluara u diskutua për dijen e Zotit, për të devijuarit dhe të udhëzuarit. Në ajetet që po diskutojmë, vijon i njëjti diskutim: **"All'llahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë…"**.

Pronësia absolute në univers i përket All'llahut. Sovrani absolut është vetëm Ai, prandaj drejtimi, menaxhimi dhe udhëheqja e këtij universi është vetëm në dorën e Tij. Përveç All'llahut, askush nuk e meriton adhurimin dhe ndërmjetësimin.

Synimi i Tij madhështor, krijimi i këtij universi është bërë vetëm për krijesën më të bukur, pra, për njeriun. Synimi madhështor i All'llahut është që ta çojë njeriun përpara, në rrugën e përsosmërisë, jo vetëm me anë të programeve në krijim dhe legjislacionit, por edhe përmes mësimeve dhe edukimit të Profetëve.

Prandaj, në fund të ajetit 31, si rezultat i kësaj "pronësie" thuhet: **"...për t'i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta e, për t'i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë."**.

Më pas Kur'ani, e bën në këtë mënyrë përshkrimin e grupit të "vepërmirëve": **"Për ata që ruhen prej gjynaheve të mëdha dhe veprave imorale, përveç gjynaheve të vogla…"**.

Fjala *"kebair"*, është shumësi i fjalës *"kebire"*, kurse fjala *"ithm"* përdoret për të treguar sjelljen që e largon njeriun nga e mira dhe shpërblimi, prandaj zakonisht përdoret në lidhje me mëkatet.

Fjala *"lemem"* përdoret për të treguar *"afrimin ndaj mëkatit"*, si ndaj mëkateve të mëdha, ashtu edhe ndaj mëkateve të vogla. Por kjo fjalë përdoret edhe për të treguar afrimin ndaj gjërave që nuk të takojnë, edhe pse nuk i përvetëson ato.

Komentuesit e Kur'anit kanë përmendur edhe interpretime të tjera të kuptimeve që përcjell kjo fjalë. Disa prej tyre e kanë komentuar si "mëkati i vogël", disa të tjerë në kuptimin e "synimit të mëkatit, por pa e kryer atë" dhe disa të tjerë në kuptimin e "mëkateve të parëndësishme".

Ndonjëherë është thënë se fjala *"lemem"* përdoret me kuptimin e çdo lloj mëkati, i madh qoftë apo i vogël, vetëm me kushtin që kryerja e atyre sjelljeve mëkatare të mos jetë kthyer në sjellje të zakonshme për njeriun. Edhe kryerja e veprimeve të tilla të vogla apo edhe të paqëllimshme, gjithmonë është e dënueshme dhe e qortueshme, derisa njeriu të pendohet.

Në transmetimet islame, janë bërë komentime të llojllojshme rreth kuptimit të kësaj fjale. Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë komentimin e këtij ajeti. Ai ka deklaruar se kjo fjalë përdoret për të treguar mëkatin që njeriu e kryen për një farë

kohe, më pas heq dorë prej tij, por ndodh që sërish përlyhet me të. (ky veprim nuk është vepër e tij e përhershme).[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar po prej Imam Sadikut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: Fjala *"lemem"* tregon sjelljen e njeriut që kryen mëkat, por më pas pendohet.[2]

Janë transmetuar edhe hadithe të tjera me të njëjtën përmbajtje.

Në këto ajete gjenden edhe dëshmi të tjera, që vërtetojnë se fjala *"limem"* është përdorur edhe në kuptimin e kryerjes së mëkateve pa dashje nga njeriu. Pasi i kryen mëkatet, njeriu e kupton sjelljen e tij dhe heq dorë prej tyre.

Përveç kësaj, në fjalinë që vijon, Kur'ani thotë: **"me të vërtetë, Zoti yt është i Gjerë në falje."**.

Edhe ky është një argument që tregon se njeriu që e ka kryer një mëkat, por pa e pasur synim atë, ka nevojë për faljen e Zotit.

Duhet të sqarohet rasti kur vepërmirët mund të kenë kryer pa dashje ndonjë mëkat, por shpirti i tyre është i pastër. Ata, sapo e kuptojnë se ç'mëkat kanë bërë, kërkojnë falje nga Zoti. Kjo sqarohet në ajetin 201 të sures "Al A'raf": **"Vërtet, ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga djalli, ata përkujtojnë** (All'llahun)**, dhe atëherë shohin** (të vërtetën)**,** (dhe pendohen)**."**.

E njëjta logjikë sqarohet përsëri në ajetin 135 të sures "Ali Imran". Aty, kur përshkruhen të devotshmit, thuhet: **"Edhe ata të**

[1] "Usulul Kafij", vëll. 2, Libri "El imam uel kufr", K. "Limem", f. 320, Hadithi 1 dhe 3.
[2] Po aty.

cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) **të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetes së tyre, e përmendin All'llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre."**.

Këto janë të gjitha, dëshmi për interpretimin e përdorimit të fjalës *"lemem"*.

Këtë diskutim do ta mbyllim me një thënie nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Ai, kur është pyetur për kuptimin e këtij ajeti, është përgjigjur: *"Kryesi i 'lememëve' është robi, i cili ndonjëherë kryen ndonjë mëkat, por kjo nuk është në natyrën e tij."*.[1]

Në vazhdim, ajeti nënvizon Drejtësinë e Zotit, lidhur me çështjen e Shpërblimit dhe të Ndëshkimit. Ajeti flet për Dijen e pafund të All'llahut, që përfshin të gjithë robtë dhe veprat e tyre. Ajeti thotë: **"Ai ju njeh mjaft mirë, qysh se ju krijoi nga dheu dhe qysh se keni qenë embrion në barkun e nënave tuaja."**.[2]

Është pranuar se njeriu i parë u krijua prej dheut. Ai është Profeti Adem *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Krijimi i njeriut të parë nga dheu mund të jetë pranuar edhe nga fakti se të gjitha lëndët formuese të trupit të tij janë marrë nga toka, të gjitha ushqimet që e furnizojnë atë, që kur është në mitrën e nënës, janë marrë nga toka, nga dheu. Për të gjitha këto, Zoti ishte në dijeni deri në detaje. Atëherë mund të pyesim, se si është e mundur që të mos jetë në dijeni për veprat tuaja?!

[1] "Usulul Kafij", vëll. 2, K. "Limem", Hadithi 5, f. 321.
[2] Fjala *"el exhxhinetun"* është shumësi i fjalës *"xhenin"* dhe është në kuptimin e një fëmije që ndodhet në barkun e nënës.

Ndërkaq kjo shprehje është një premisë për fjalën në vijim: **"Prandaj, mos u lavdëroni me pafajësinë tuaj! Ai i njeh më së miri ata që ruhen nga gjynahet."**.

Ai nuk ka nevojë për prezantimin tuaj, as për përshkrimin e veprave tuaja të mira. Ai është në dijeni për gjithçka, edhe për veprat tuaja, edhe për sinqeritetin dhe pastërtinë e synimit tuaj. Ai ju njeh ju më mirë se sa ju njihni veten tuaj.

Disa komentues kanë thënë se ky ajet ka zbritur për të sqaruar një grup njerëzish, të cilët, pas faljes së namazit dhe agjërimit, filluan të lavdëronin veten e tyre, duke thënë se namazi i tyre ishte i tillë dhe agjërimi i tyre i atillë! Ndërkohë zbriti ajeti dhe i ndaloi ata nga një vepër e tillë.[1]

Hulumtim

1- Dija e pafund e Zotit

Edhe në këto ajete është diskutuar rreth dijes së Zotit dhe gjerësisë së pafund të saj. Por këtu u trajtuan dy prej çështjeve më të ndërlikuara, lidhur me njeriun.

Së pari: Krijimi i njeriut nga balta

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 7, f. 55.

Për këtë fakt, mendjet e shkencëtarëve akoma janë të çoroditura. Ata pyesin se si është e mundur që një krijesë e gjallë të krijohet nga një materie jo e gjallë. Është tepër e sigurt që krijimi i njeriut dhe i gjallesave të tjera nga dheu ka ndodhur në të kaluarën. Por se në çfarë kushtesh dhe rrethanash ka ndodhur krijimi, nuk është e njohur. Kjo çështje është shumë e koklavitur dhe misterioze. Deri më sot, enigma e saj ka mbetur sekret dhe e pa zbuluar nga shkenca dhe nga dituria njerëzore.

Çështja e dytë, është transformimi i embrionit njerëzor në njeri. Edhe kjo çështje mbetet një prej enigmave më të mëdha të krijimit të njeriut. Edhe pse diçka rreth kësaj çështjeje, është e zbuluar nga shkenca, akoma ka mjaft pyetje pa përgjigje në këtë fushë.

Ai që ka dijeni të plotë për këto dy çështje tepër të ndërlikuara, Ai që ka dijeni të plotë për të gjitha sekretet e qenies njerëzore, për të gjitha etapat e zhvillimit dhe shndërrimet që ndodhin, Ai që udhëzon, Ai që udhëheq dhe edukon, është vetëm Një! Ai është Zoti i Madhëruar! Ai është në dijeni për të gjitha veprimet e qenieve dhe ua kthen shpërblimin, ose dënimin sipas meritës.
Në këtë dituri të pafundme mbështetet drejtësia e Tij!

2- Çfarë nënkuptojmë me fjalën "kebairul ithm"?

Komentuesit e Kur'anit, juristët dhe hadithologët, kanë diskutuar gjerësisht për kuptimin e togfjalëshit "mëkatet e mëdha".

Disa prej tyre, të gjitha mëkatet i konsiderojnë të mëdha, sepse karshi Zotit, çdo mëkat konsiderohet i madh.

Ndërkohë që disa të tjerë, fjalët *"kebire"* dhe *"sagire"* i kanë konsideruar si çështje relative. Një mëkat e vlerësojnë në raport me një mëkat tjetër. Në raport me një mëkat më të madh e konsiderojnë *"satire"* - *"i vogël"* dhe në raport me një mëkat më të vogël e quajnë *"kebire"* - *"i madh"*.

Një grup, kriterin që përcakton mëkatin "e madh", konsiderojnë përmendjen e paralajmërimit për dënimin hyjnor, për të cilin flitet në Kur'an.

Ndonjëherë, është thënë që "mëkat i madh" konsiderohet çdo mëkat që ndëshkohet nga Sheriati.

Por më e udhës është të thuhet se fjala *"kebire"* përdoret për të treguar madhështinë e mëkatit. Por me fjalën *"kebire"* emërtohet çdo mëkat që plotëson një prej kushteve të mëposhtme:

a) Mëkati për të cilin ka paralajmërim për dënim.

b) Mëkati që në mendimin e dijetarëve të fesë dhe të transmetimeve islame, konsiderohet i madh.

c) Mëkati që në burimet fetare, është quajtur më i rëndi se mëkatet që bëjnë pjesë te mëkatet e mëdha.

d) Së fundi, mëkati që në hadithet e vlefshme, është paraqitur si mëkat i madh.

Në transmetimet islame, numri i mëkateve të mëdha është përmendur ndryshe për raste të ndryshme. Në disa raste, numri i tyre është shtatë: vrasja e njeriut, mallkimi i prindërve, kamata, rikthimi në tokën e politeistëve pas migrimit, akuzimi i grave të ndershme për imoralitet, konsumimi i ushqimit të jetimit dhe arratisja nga lufta.[1]

Në disa të tjera, numri i tyre është shtatë, por me ndryshimin që në vend të mallkimit të prindërve, të jetë përmendur shprehja "atë që Zoti e ka bërë obligim, zjarrin e Xhehennemit për shkak të tij".

Në disa transmetime të tjera, numri i mëkateve të mëdha, arrin në dhjetë. Te disa të tjerë, numri i mëkateve të mëdha, shkon në nëntëmbëdhjetë mëkate, madje te disa të tjerë numri i tyre është shumë më i madh.[2]

Ky ndryshim, lidhur me numrin e mëkateve të mëdha, është për shkak se edhe mëkatet e mëdha nuk janë të njëjta. Disa prej tyre kanë një peshë më të madhe, pra, janë "mëkatet më të mëdha". Për këtë çështje, nuk ka kundërshtime mes transmetuesve.

[1] "Uesailu Shiiati", vëll. 11, K. "Xhihadu nefs", kreu 46, Hadithi 1.

[2] Për më shumë informacion, shih adresën e lartpërmendur. Këtu janë përmendur 37 hadithe, në lidhje me përcaktimin e mëkateve të mëdha.

Vetëlavdërimi dhe vetëpëlqimi

Lavdërimi dhe pëlqimi i vetes janë të papëlqyeshme. Kjo është shprehur edhe në një fjalë të urtë: "Lavdërimi i vetvetes është i shëmtuar".

Kjo vepër e papëlqyer rrjedh nga mos njohja e vetes. Kur njeriu e njeh realisht veten e tij, e kupton se sa i vogël është para Zotit të Gjithësisë, e kupton vlerën e papërfillshme të veprave të tij përballë përgjegjësive, e kupton se të gjitha begatitë ia ka dhënë Zoti i Madhëruar, e kupton se, në asnjë mënyrë, nuk duhet të lavdërojë veten e tij, por vetëm Zotin që i ka mundësuar gjithçka.

Sjellje të tjera të dënueshme janë edhe: mburrja, neglizhenca, arroganca, injoranca dhe mendimet e prapambetura.

Vetëlavdërimi është tregues i besimit të njeriut në përsosmërinë e vetes, është tregues i prapambetjes së tij. Të jesh afër përsosmërisë, do të thotë të pranosh gabimet, mangësitë dhe të metat.

Për këtë arsye, të dashurit e Zotit gjithnjë e kanë pranuar fajësinë e tyre karshi përgjegjësive hyjnore, si dhe i kanë ndaluar njerëzit të vetëlavdërohen, të pëlqejnë veten dhe të zmadhojnë veprat e tyre.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në lidhje me ajetin në fjalë, thuhet se asnjë nuk duhet të krenohet me shtimin e namazit, me shtimin e

agjërimit, të zekatit, dhe të kryerjes së Haxhit, sepse Zoti i njeh më së miri të devotshmit ndër ju."[1]

Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në njërën prej letrave dërguar Muavijes, citoi çështje shumë të rëndësishme. Ai thotë: *"Sikur All'llahu të mos e ndalonte që njeriu ta lëvdojë veten, autori i kësaj shkrese do të listonte virtyte të shumta, të cilat zemrat e besimtarëve i njohin fort mirë dhe veshët e dëgjuesve nuk do t'i harrojnë."*.[2]

Lidhur me këtë çështje, kemi diskutuar në mënyrë të detajuar, në vëllimin e tretë, ajeti 49 i sures "En Nisa".

Vetëlavdërimi nuk duhet të ngatërrohet me rastet kur njeriut i duhet të paraqesë veten me të gjitha cilësitë që zotëron, sepse ndryshe mund të nëpërkëmbej. Mes vetëparaqitjes dhe vetëlavdërimit, ekziston një dallim shumë i madh.

Shembull i këtij dallimi, është fjalimi i Imam Sexhadit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, të cilin e mbajti në xhaminë e Shamit. Në këtë fjalim, ai paraqiti veten dhe familjen e tij para popullit të Shamit, me qëllim që të mosrealizohej plani i Beni Umejes, që dëshmorët e Qerbelasë t'i quante havarixh, si dhe planet e tyre djallëzore dhe ogurzeza të dështonin.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, kur u pyet për çështjen e lavdërimit të vetes, u përgjigj: *"Ndonjëherë, për shkak të kushteve dhe rrethanave, është e nevojshme."*. Më pas e argumentoi përgjigjen, duke sjellë dy

[1] Tefsiri "Nuruth Thakalejn", vëll. 5, Hadithi 77, f. 165.
[2] "Nehxhul Belaga", Letra 28.

shembuj nga fjalimet e të Dërguarve, të përmendura në Kur'an. Në fillim citon thënien e Jusufit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, që i propozoi Azizit të Egjiptit, që ta emërojë përgjegjës të thesarit të shtetit të Egjiptit. Në atë rast, Jusufi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kishte thënë: "*Unë jam ruajtës i dijshëm.*".

Shembulli tjetër, lidhet me Profetin e madh, Hudin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, i cili iu drejtua popullit të tij me fjalët: "*Unë për ju do të jem një dashamirës i besueshëm.*".

Ajetet 33 – 41

أَفَرَأَيْتَ الَّذِى تَوَلَّى٣٣ وَأَعْطَى قَلِيلًا وَأَكْدَى٣٤ أَعِنْدَهُ عِلْمُ الْغَيْبِ
فَهُوَ يَرَى٣٥ أَمْ لَمْ يُنَبَّأْ بِمَا فِى صُحُفِ مُوسَى٣٦ وَإِبْرَاهِيمَ الَّذِى وَفَّى٣٧
أَلَّا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَى٣٨ وَأَنْ لَيْسَ لِلْإِنْسَانِ إِلَّا مَا سَعَى٣٩ وَأَنَّ
سَعْيَهُ سَوْفَ يُرَى٤٠ ثُمَّ يُجْزَاهُ الْجَزَاءَ الْأَوْفَى٤١

"A e ke vënë re atë që shmanget (nga e vërteta**)."**

"Dhe jep pak e pa qejf?"

"A i di ai vallë gjërat e padukshme, a i sheh ato?"

"Vallë, a nuk ka dëgjuar ai për atë që thuhet në Shkrimet e Musait?"

"Dhe të Ibrahimit - i cili i plotësoi detyrimet:"

"Se askush nuk do t'i mbartë gjynahet e tjetrit".

"Dhe se njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar;"

"Se përpjekjet e tij do të shihen."

"Dhe se do të shpërblehet me shpërblim të plotë."

Shkaku i zbritjes

Pjesa dërmuese e komentuesve të Kur'anit, në lidhje me ajetet e lartpërmendura, kanë transmetuar disa shkaqe për zbritjen e këtyre ajeteve. Këto shkaqe, në përgjithësi, nuk përputhen me njëra–tjetrën, por dy shkaqe u pranuan mes komentuesve:

1- Këto ajete lidhen me ngjarjen e Osmanit. Ai kishte një pasuri të madhe, prej së cilës u jepte të tjerëve. Njëri nga të afërmit të tij, i quajtur Abdullah bin Seadi i tha: "Në qoftë se vazhdon në këtë mënyrë, nuk do të të mbetet asgjë për veten tënde.".

Osmani tha: "Unë kam shumë gjynahe. Në këtë mënyrë dua të përfitoj kënaqësinë dhe faljen hyjnore.".

Abdullahu i tha: "Nëse ma jep mua devenë tënde për shalim, me të gjithë pajisjet përkatëse, unë do t'i mbart në supe të gjitha mëkatet tua!".

Osmani pranoi dhe për këtë ujdi solli dëshmitarë dhe që nga kjo kohë, hoqi dorë nga dhënia e pasurisë. Hoqi dorë nga bamirësia. Në këtë kohë zbritën ajetet e lartpërmendura, përmes të cilave ai u qortua ashpër. Përmes këtyre ajateve, atij iu bë e qartë se askush nuk mund të marrë mbi supe mëkatet e tjetrit.

Çdonjërit do t'i rikthehet dënimi apo shpërblimi sipas veprave të tij.[1]

2- Ajeti flet për Velijd ibn Mugijretu. Ai erdhi drejt Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ishte afër pranimit të Islamit. Disa politeistë e qortuan atë dhe i thoshin se braktiste fenë e të parëve të tyre. Ai i konsideroi ata si të devijuar dhe i imagjinoi në zjarrin e Xhehennemit! U kthye nga ata dhe u tha: "Me të vërtetë, unë i frikësohem dënimit të Zotit.".

Njëri nga qortuesit, i tha: "Nëse më jep diçka nga pasuria jote dhe rikthehesh në politeizëm, unë do të marr mbi supe dënimin tënd!".

Velid bin Mugijretu i dha vetëm një pjesë të vogël të pasurisë së tij. Në këtë kohë zbriti ajeti i lartpërmendur, që e qortoi Velidin për heqjen dorë prej besimit.[2]

[1] Këtë shkak zbritjeje e ka cituar Tabrasij në veprën "Mexhmaul Bejan" dhe komentues të tjerë, si: Zamakhsherij në "Keshshaf" dhe Fakhru Rrazij në tefsirin "El Kebijr". Tabrasij, pasi e transmeton atë, shprehet: "Këtë shkak zbritjeje e kanë përmendur edhe Ibn Abas es Sudij dhe Kelbij, si dhe një grup komentuesish.".

[2] Edhe ky shkak zbritje, gjithashtu, është cituar në "Mexhmaul Bejan", "Kurtubij", "Ruhul Bejan" dhe "Ruhul Meanij", si dhe në disa tefsire të tjera. Fjala *"ekdi"*, rrjedh nga fjala *"kodje"* dhe ka kuptimin e tokës së fortë dhe të ashpër. Më pas është përdorur për personat dorështrënguar dhe koprracë.

Komentimi

Çdokush është përgjegjës për veprat e veta

Në ajetet e kaluara u diskutua për ndëshkimin e mëkatarëve për veprat e këqija të kryera dhe për shpërblimin e punëmirëve nga Zoti i Madhëruar. Mund të krijohet iluzioni që për mëkatin e njërit, të ndëshkohet ndonjë tjetër, ose dikush të mund ta marrë përsipër mëkatin e tjetrit. Këto ajete e kanë mohuar një gjë të tillë. Ajetet vënë në dukje parimin e rëndësishëm të Islamit, i cili saktëson se rezultati i veprave të çdo njeriu i rikthehet vetëm atij.

Ajeti 33 thotë: **"A e ke vënë re atë që shmanget** (nga e vërteta)**."**.

Sipas shkakut të zbritjes, ata dhanë nga pasuria e tyre dhe më pas u shmangën nga dhënia e pasurisë, duke supozuar që tjetri mund të mbartë mbi supe barrën e mëkateve të tyre: **"dhe jep pak e pa qejf"**.

Ajeti 35, thotë: **"A i di ai vallë gjërat e padukshme, a i sheh ato?"**.

Kush ka qenë dhe është kthyer nga Kiameti dhe u ka sjellë atyre lajmin që njerëzit mund të marrin ryshfet dhe të mbartin mbi supe mëkatet e tjetrit?!

Kush ka ardhur i dërguar nga ana e Zotit dhe i ka informuar ata që Zoti është i kënaqur me një marrëveshje të tillë?!

Këto janë iluzione të thurura nga vetë politeistët, për ta çliruar veten e tyre nga barra e këtyre përgjegjësive.

Pas këtij kërcënimi të ashpër, Kur'ani citon dhe një parim thelbësor, që ka ekzistuar edhe te fetë e tjera qiellore. Kur'ani thotë: Vallë, a nuk është në dijeni ai, që, me anë të këtyre premtimeve imagjinare, ka hequr dorë nga dhënia e pasurisë në Rrugën e Zotit dhe dëshiron të shpëtojë veten nga ndëshkimi hyjnor, duke dhënë vetëm një pjesë të paktë nga pasuria e tij? A nuk është në dijeni për atë që është zbritur në librin e Musait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*?!

"Vallë, a nuk ka dëgjuar ai për atë që thuhet në Shkrimet e Musait dhe të Ibrahimit - i cili i plotësoi detyrimet?"

Profeti i respektoi të gjitha premtimet dhe përgjegjësitë hyjnore, e përmbushi më së miri misionin e Zotit, për përhapjen e fesë së Tij, nuk u frikësua nga asnjë problem, kërcënim apo ngacmim. Ai u vu në sprova të ndryshme. Me urdhrin e Zotit, pranoi që ta bënte kurban edhe fëmijën e vet, t'ia vinte thikën në fyt, por të gjitha këto sprova i tejkaloi me sukses dhe doli kryelartë, prandaj Zoti atij i dhuroi një pozitë të lartë të udhëheqjes (imamatit) së krijesave. Në ajetin 124 të sures "El Bekare", ndër të tjera, lexojmë: **"Kur All'llahu e provoi Ibrahimin me disa urdhërime, të cilat ai i plotësoi, All'llahu i tha: 'Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!'"**.

Disa komentues të Kur'anit në përshkrimin e ajetit, kanë thënë se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në Rrugën e Zotit,

ia dorëzoi trupin zjarrit, zemrën Zotit, fëmijën flijimit, kurse pasurinë (ua shpërndau) vëllezërve dhe miqve.[1]

Vallë, a nuk janë në dijeni, që në të gjithë Librat qiellorë, ka zbritur urdhri: **"Askush nuk do t'i mbartë gjynahet e tjetrit"?**.

Fjala *"uizrun"* rrjedh nga fjala *"uezere"*. Fillimisht u përdor për të treguar vendstrehime malore. Më pas, kjo fjalë është përdorur për të treguar ngarkesa të rënda, figurativisht, si barra që i vihet njeriut mbi supe, sipas veprave të kryera.

Fjala *"uazire"* tregon njeriun që mbart barrën.[2]

Për ta sqaruar edhe më tepër kontekstin e përdorimit kuptimor, ajeti 39 thotë: **"Dhe se njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar."**.

Fjala *"sa'ijun"* tregon *"ecjen e shpejtë"*, por zakonisht përdoret në kuptimin e përpjekjes, të kryerjes së lëvizjeve të shpejta, gjatë kryerjes së një pune, qoftë punë e dobishme apo e dëmshme.

Duhet të theksohet fakti se nuk flitet për përfitimin e njeriut nga kryerja e veprës së mirë, por flitet për përpjekjen që ka bërë ai për ta kryer atë vepër. Kjo tregon se sa e rëndësishme është përpjekja që bën njeriu për kryerjen e një vepre. Edhe pse mund të mos ia ketë arritur qëllimit, rëndësi të madhe ka pastërtia e nijetit të tij. Nijeti i drejtë dhe i pastër, do të ketë shpërblimin e

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 246.

[2] Fjala *"uezere"* është në gjininë femërore, sepse është përshkrim për shpirtin që është hequr. Po ashtu edhe fjala *"ukhra"* është në gjinin femërore.

Zotit, sepse Zoti është Blerës i synimeve dhe i vullneteve dhe jo vetëm i veprave të kryera!

Ajeti 40 thotë: **"Se përpjekjet e tij do të shihen."**.

Jo vetëm rezultatet e përpjekjeve të tij, qofshin të dobishme apo të dëmshme, do të shënohen, por edhe vetë veprat e tij do të shfaqen para tij, në atë Ditë të Madhe. Në një rast tjetër, Kur'ani thotë: **"Ditën kur çdo njeri e gjen pranë vete atë që veproi mirë ose keq..."**.[1]

Për shikimin e veprave të mira dhe të këqija, në Ditën e Kiametit, tregohet në suren "Zelzele"në ajetet 7-8: **"E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë."**.

Më pas, sipas veprës së vet, ***do të shpërblehet me shpërblim të plotë***.

Fjala *"xhezael eufa"* tregon shpërblim që i korrespondon masës së veprës. Kjo nuk bie ndesh me mirësinë hyjnore që, për kryerjen e veprave të mira, do të ketë shpërblim dhjetëfish, njëqindfish apo njëmijëfishin e tyre. Nuk duket i drejtë vlerësimi i disa komentuesve të Kur'anit që fjalën *"xhezael eufa"* e kanë interpretuar si shpërblimi më i madh karshi veprave të mira, sepse ky ajet përfshin, në vetvete, edhe mëkatet. Madje, diskutimi kryesor i ajetit është rreth ngarkesës dhe mëkatit.

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 30.

Hulumtim

1- Tri parime të rëndësishme islame

Në ajetet e mësipërme, janë përmendur tri prej parimeve kryesore të Islamit, që i kanë njohur si të tillë, edhe Librat e mëparshëm qiellorë.

a) Çdo njeri është përgjegjës i veprave të tij.

b) Përfitimi i çdo njeriu, në Ditën e Kiametit, është përpjekja e tij.

c) Zoti i Madhëruar do ta shpërblejë plotësisht çdo njeri, sipas veprës së tij.

Në këtë mënyrë, Kur'ani ka refuzuar dhe ka konsideruar si të pavlefshme shumë prej iluzioneve dhe besëtytnive apo bindjeve që kanë njerëzit e thjeshtë.

Kur'ani, me këtë qëndrim, jo vetëm që mohon bindjen e politeistëve arabë të kohës së injorancës, se njeriu mund të mbartë mbi supe mëkatet e tjetrit, por godet edhe një doktrinë të njohur, që ishte e përhapur mes të krishterëve, sipas së cilës Zoti i Madhëruar ka dërguar në këtë botë djalin e tij, Mesiun, që të varet, të torturohet, të vuajë dhe të mbartë mbi supe barrën e mëkateve të të tjerëve!

Kur'ani dënon edhe veprimet e shëmtuara të një grupi priftërinjsh. Këta priftërinj, në Mesjetë, shisnin fletë-falje dhe dëshmi që tregonin se njeriu e meriton Xhennetin. Akoma edhe sot, vazhdojnë me pretendimin e faljes së mëkateve përmes fletushkave.

Logjika e shëndoshë pranon aksiomën: "Çdokush është përgjegjës dhe përfitues prej veprave të tij.".

Kjo doktrinë islame e udhëzon njeriun, që të mos kërkojë mbrojtje dhe mbështetje tek besëtytnitë apo t'ia kalojë mëkatin e vet një personi tjetër, por të përpiqet të kryejë vepra të mira, të qëndrojë larg mëkateve, dhe, sa herë që të kryejë ndonjë gabim apo mëkat, të stepet dhe të kërkojë falje dhe ta kompensojë atë.

Kjo doktrinë ka pasur një ndikim të madh në edukimin e njerëzve, në kohën kur ata ishin nën presionin shkatërrues të bindjeve të kohës së paganimizit.

Këto ajete jo vetëm janë filozofia kryesore e kësaj jete, por flasin edhe për përpjekjet e Ahiretit, edhe për shpërblimet në Botën Tjetër. Kjo do të thotë që njerëzit besimtarë nuk duhet të qëndrojnë në pritje të të tjerëve, që të kryejnë ndonjë punë për ta, apo të zgjidhin problemet e shoqërisë së tyre, por vetë t'i përvishen punës, të bëjnë përpjekjet e tyre për të kryer sa më shumë vepra të mira.

Nga këto ajete, rrjedh edhe një parim ligjor, lidhur me penalitetet. Ky parim tregon qartë se gjithnjë ndëshkimet përfshijnë "mëkatarët", pra, ligjshkelësit e vërtetë dhe askush nuk mund të marrë përsipër mëkatin e as krimin e tjetrit.

2- Keqpërdorimi i kuptimit të ajetit

Këto ajete, siç e pamë, u dedikohen përpjekjeve të njeriut për çështjet e Ahiretit. Nëse do ta shtrinim diskutimin e këtyre ajeteve edhe më gjerë, nëse do ta përgjithësonim diskutimin, këto ajete, në kontekstin e tyre të përgjithshëm, do të përfshinin edhe përpjekjet që i kushtohen kësaj bote dhe shpërblimet përkatëse respektive.

Por kjo nuk do të thotë se njerëz që janë nën ndikimin e shkollave socialiste të bazohen në të dhe të deklarojnë se kuptimisht, ajeti konfirmon se prona përfitohet vetëm me anë të punës, duke hedhur poshtë ligjin e trashëgimisë, të dhënies me qira, etj.

Por këtu duhet të sqarohet diçka. Këta njerëz, edhe pretendojnë që janë ndjekës të Islamit, edhe u referohen ajeteve kur'anore, ndërkohë që çështjen e trashëgimisë e mënjanojnë. Trashëgimia është një prej parimeve të sigurta të Islamit, siç janë edhe zekati, edhe khumsi (një e pesta e pasurisë vjetore). Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pronën e njeriut, me trashëgiminë, me zekatin, me testamentin, me mehrin, janë përmendur në Kur'anin e Madhëruar. Atëherë, si mund të mënjanohen ato?

Thënë ndryshe, ky është një parim, por zakonisht, çdo parim shoqërohet me përjashtime. Për shembull, trashëgimia e fëmijës nga i ati është një parim. Por, në qoftë se djali është vrasës i babait të vet, ose heq dorë nga Islami, atij i ndalohet që të trashëgojë pasurinë e babait të tij.

3- Përgjigjja ndaj disa pyetjeve

Këtu janë parashtruar disa pyetje, që u duhet dhënë përgjigje:

Pyetja e parë: Çfarë kuptimi ka "ndërmjetësimi", nëse përfitimi i gjithsecilit në Kiamet është vetëm rezultati i përpjekjeve të tij?

Së dyti: Si duhet kuptuar ajo që përcjell surja "Et Tur", në ajetin 21, në lidhje me banorët e Xhennetit: **"Ne atyre do t'ua shoqërojmë pasardhësit e tyre,"** ndërkohë që ata nuk kanë bërë as përpjekjen më të vogël në këtë rrugë.

Përgjigjen e kemi sërish në transmetimet islame, ku thuhet: "*Sa herë që ndokush kryen një vepër të mirë, mirësia e saj do të përfshijë edhe fëmijët e tij.*".

Përgjigjen e të gjitha këtyre pyetjeve, mund ta japim në një fjali: Kur'ani thotë se njeriu nuk ka të drejtë më shumë se sa përpjekja e tij, por kjo nuk është pengesë, që me anë të mëshirës dhe mirësisë së Zotit, njerëzve të denjë t'u jepen begati. "Merita" është një çështje më vete; "mirësia dhe shumëfishimi i shpërblimit" janë një çështje tjetër, ashtu sikurse veprat e mira, ndonjëherë, shpërblehen me dhjetëfishin, njëqindfishin apo njëmijëfishin e tyre.

Gjithashtu, vlen për t'u theksuar se "ndërmjetësimi", ashtu siç e kemi diskutuar më parë, nuk është pa llogari. Edhe ai ka nevojë për një lloj përpjekje dhe për krijimin e një marrëdhënie shpirtërore me ndërmjetësuesin. Përveç kësaj, edhe bashkimi i

banorëve të Parajsës me fëmijët, sqarohet nga Kur'ani, i cili, në të njëjtin ajet, thotë: **"...edhe pasardhësit e tyre ishin me besim."**.

Fletushkat e Ibrahimit dhe të Musait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*

Fjala *"suhuf"* është shumësi i fjalës *"sahife"* dhe në thelb është përdorur me kuptimin e çdo gjëje të gjerë. Prandaj fytyrën, faqen e quajnë *"sehifetul uexhh"*, por që këtu e më pas, është përdorur edhe në kuptimin e faqeve të Librit.

Shprehja *"Suhufi Musa"*, në ajetet e lartpërmendura, është përdorur për të treguar Teuratin, kurse *"Suhufi Ibrahim"*, është për Librin e tij qiellor.

Dijetari i shquar Tabersiu, në veprën "Mexhmaul Bejan", në komentimin e sures "A'ala", ka transmetuar një hadith nga Profeti i Islamit, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Po e përmendim shkurtimisht: Ebu Dheri pyeti: *"Sa ishin Profetët hyjnorë?"*

I Dërguari i All'llahut u përgjigj: *"Njëqind e njëzet e katër mijë veta."*

Sërish pyeti: *"Sa prej tyre ishin të Dërguar?"*

I Dërguari i All'llahut ia ktheu: *"Treqind e trembëdhjetë veta, pjesa tjetër ishin "nebij", apo lajmëtarë* ("i Dërguar" është ai Profet, që është përgjegjës për komunikimin dhe paralajmërimin, ndërkohë që kuptimi i fjalës *"nebij"* është më gjithëpërfshirës).

Ebu Dheri sërish pyeti: *"A ishte Profet Ademi (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)?"*

I Dërguari i All'llahut u përgjigj: *"Po, Zoti foli me atë dhe e krijoi me dorën e Vet të fuqishme."*

Ebu Dheri pyeti: *"Sa Libra ka zbritur Zoti?"*

I Dërguari i All'llahut u përgjigj: *"Njëqind e katër Libra: Dhjetë broshura Ademit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!), pesëdhjetë broshura Shitit, tridhjetë broshura Idrizit, dhjetë broshura Ibrahimit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!). Në total bëhen njëqind broshura dhe Teuratin, Inxhilin, Zeburin dhe Kur'anin."*.[1]

4- Parimi i përgjegjësisë, karshi veprave në Librat paraardhës

Vlen të theksohet fakti se në Teuratin e sotshëm, në librin "Hazkill" është përmendur përmbajtja e disa ajeteve që po diskutojmë. Aty lexojmë: "Shpirti që kryen mëkate, do të vdesë, djali nuk do të mbartë mbi supe mëkatin e të atit. Gjithashtu, babai nuk do të mbartë mbi supe mëkatin e djalit.".[2]

E njëjta domethënie, është përmendur edhe në kapitullin "Dualitet" të Teuratit, kur flitet për vrasjet. Aty thuhet: "Baballarët të mos vriten në vend të fëmijëve, gjithashtu, as fëmijët të mos vriten në vend të baballarëve. Çdokush të vritet për shkak të mëkatit të tij.".[3]

---

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 476. Ky hadith, gjithashtu, është transmetuar edhe në tefsirin "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 246.
[2] Libri i Haskellit, K. 18-20.
[3] "Teurati, sefer tethnije", kreu 24, Numri 16.

Ajetet 42 – 49

وَأَنَّ إِلَى رَبِّكَ الْمُنْتَهَى٤٢ وَأَنَّهُ هُوَ أَضْحَكَ وَأَبْكَى٤٣ وَأَنَّهُ هُوَ أَمَاتَ وَأَحْيَا٤٤ وَأَنَّهُ خَلَقَ الزَّوْجَيْنِ الذَّكَرَ وَالْأُنْثَى٤٥ مِنْ نُطْفَةٍ إِذَا تُمْنَى٤٦ وَأَنَّ عَلَيْهِ النَّشْأَةَ الْأُخْرَى٤٧ وَأَنَّهُ هُوَ أَغْنَى وَأَقْنَى٤٨ وَأَنَّهُ هُوَ رَبُّ الشِّعْرَى٤٩

"Se te Zoti yt do të jetë kthimi;"

"Se Ai jep gazin dhe vajin."

"Dhe se Ai jep vdekjen dhe jetën;"

"Se Ai krijon çiftet, mashkull e femër,"

"Prej një pike fare kur derdhet,"

"Dhe se Atij i takon krijimi tjetër;"

"Se Ai jep pasuri dhe kënaqësi të mjaftueshme,"

"Ai, që është Zoti i Siriusit;"[1]

[1] Siriusi është yll që adhurohej nga arabët paganë.

Komentimi

Të gjithë vektorët do të përfundojnë tek Ai!

Këto ajete janë manifestim i cilësive të Zotit. Në këto ajete bëhet e qartë çështja e monoteizmit dhe e Ringjalljes.

Në vazhdimësi të çështjeve të kaluara, në lidhje me çështjen e shpërblimit të veprave, këto ajete thonë se njeriu është në dijeni, që në Librat e Musait dhe të Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*, thuhet që të gjitha çështjet, kthimin e kanë te Zoti: **"Se te Zoti yt do të jetë kthimi."**.

Jo vetëm llogaria, dënimi, shpërblimi dhe ndëshkimi në Kiamet është përjashtimisht në dorën e forcës së All'llahut, por edhe në këtë botë, gjithashtu, zinxhiri i shkaqeve dhe i pasojave përfundon te Esenca e Stërpastër të Tij. Të gjitha veprimtaritë e kësaj bote rrjedhin prej Tij, gjithë universi, me fillimin dhe fundin e tij, janë prej Zotit të Madhëruar.

Në një transmetim, lidhur me komentin e këtij ajeti nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Nëse fjala përfundon me Zotin heshtni!"*,[1] domethënë, mos diskutoni në lidhje me Qënësinë e Tij. Njeriu e ka të kufizuar meditimin, e ka të kufizuar reflektimin. Prandaj nuk ka asnjë mundësi që mendja e kufizuar të diskutojë për aftësinë e pakufizuar të Zotit të Madhëruar. Është e pamundur të kufizohet Zoti i Madhëruar.

[1] Tefsiri "Ali bin Ibrahim", vëll. 2, f. 338, në bazë të transmetimit të veprës "Nuru Thakalejn", vëll. 5, f. 170.

Ky interpretim shpreh një konceptim tjetër ndaj këtij ajeti, por që nuk bie ndesh me atë që e trajtuam dhe e përmendëm më lart. Të dy këto konceptime mund t'i afrojmë në një kuptim më përgjithësues të ajetit.

Për ta qartësuar edhe më tej sundimin e pakufizuar të All'llahut, ajeti shton: **"Ai jep gazin dhe vajin dhe se Ai jep vdekjen dhe jetën; se Ai krijon çiftet, mashkull e femër, prej një pike fare kur derdhet."**.

Këto seri ajetesh, janë shprehje gjithëpërfshirëse dhe shpjegim impresionues për të gjitha çështjet që marrin kuptim, vetëm kur kthehen te Zoti. Këto ajete thonë se jeta dhe vdekja juaj është në dorë të All'llahut, vazhdimësia e brezave, krijimi i çifteve është nën drejtimin e Tij. Të gjitha ngjarjet dhe ndodhitë, që shfaqen në jetën e njeriut, janë prej Tij. Ai ose jep të qeshurën, ose jep qarjen, ose jep jetën, ose vdekjen. Në këtë mënyrë, zinxhiri i jetës, që nga fillimi deri te fundi, përfundon në Esencën, Qenien e Stërpastër të Tij.

Në një hadith, është sqaruar kuptimi i "të qarit dhe i të qeshurit". Në komentimin e këtij ajeti, thuhet: Zoti i Madhëruar i bën të qajnë qiejt me anë të shiut, kurse tokën e bën të qeshë me anë të bimëve.[1]

Disa poetë, këtë përmbajtje e kanë përshkruar kështu në poemat e tyre:

"Stina e pranverës është një stinë e bukur,

sepse toka qesh nga e qara e qiejve."

[1] "Nuru Thakalejn", vëll. 5, Hadithi 102, f. 172.

Po të vëzhgohet me kujdes, bie në sy se nga të gjitha veprimet e njeriut, Kur'ani e vë fokusin te çështja e të qarit dhe e të qeshurit, sepse këto dy cilësi i përkasin vetëm njeriut dhe nuk hasen te gjallesat e tjera, me fare pak përjashtime.

E gjithë gjendja emocionale që e shoqëron njeriun kur qesh, ose qan, është tejet e ndërlikuar dhe mahnitëse. Si përfundim, të gjitha çështjet dirigjohen nga Zotit i Madhëruar. Prandaj asgjë nuk bie ndesh me parimin e lirisë dhe vullnetit të lirë të njeriut, sepse edhe vullneti i lirë, edhe liria janë nga ana e All'llahut dhe kthimi i tyre është tek Ai.

Pasi përmend çështje që lidhen me menaxhimin dhe drejtimin e Zotit të Madhëruar, Kur'ani flet për Ringjalljen. Ai thotë se njeriu duhet të jetë në dijeni, që në Librat e hershëm thuhet: **"Atij i takon krijimi tjetër."**.

Fjala *"nesh'e"* përdoret me kuptimin e krijimit dhe rritjes së një gjëje, kurse fjala *"nesh'etul ukhra"* përdoret me kuptimin e Ringjalljes.

Fjala *"alejhi"* përdoret me kuptimin se Zoti i Madhëruar është i nevojshëm, i domosdoshëm. Pushteti dhe gjykimi i Tij i duhet botës së gjallesave. Zoti i Gjithëdijshëm dhe i Urtë i krijoi njerëzit dhe i ngarkoi me përgjegjësi dhe detyra, u dhuroi liri, edhe pse mes tyre kishte njerëz të bindur dhe të pabindur, të nënshtruar dhe të panënshtruar, shtypës dhe të drejtë. Por asnjë prej tyre nuk ka arritur të realizojë në këtë botë shpërblimin dhe ndëshkimin e merituar. Vetëm urtësia e All'llahut, gjykimi i Tij mund t'i realizojë këto. Prandaj duhet të ekzistojë edhe një Botë Tjetër, në mënyrë që të realizohet drejtësia e Tij.

Zoti i Madhëruar, një premtim të tillë, ua ka dhënë robëve të Vet, si një premtim të patjetërsueshëm. Sinqeriteti i Fjalës së All'llahut kërkon që premtimet e Tij të jenë të pashmangshme.

Më pas po shton: **"Ai jep pasuri dhe kënaqësi të mjaftueshme…"**.

Zoti i Madhëruar, në sajë të Mëshirës së Vet të pafundme, jo vetëm që ua ka plotësuar të gjitha nevojat njerëzore, por ka vënë në dispozicion të tyre edhe fonde të pashtershme, që të përballojë edhe nevojat e jetës shpirtërore, si: nxënien e diturisë, të edukimit dhe të përsosjes. Këto i ka realizuar përmes dërgimit të Profetëve, zbritjes së Librave qiellorë dhe dhurimit të të mirave shpirtërore.

Fjala *"agna"* rrjedh nga rrënja *"gina"* dhe nënkupton *panevojshmërinë*, kurse fjala *"ekna"* rrjedh nga fjala *"kin'jetun"* dhe është në kuptimin e pasurive dhe kapitaleve që njeriu i mbledh.[1]

Ndërsa fjala *"egna"* është në kuptimin e plotësimit të nevojave të tanishme, fjala *"ekna"* është në kuptimin e dhënies së të mirave (begative) rezervë, e cila, në çështjet materiale, përkthehet në kopshte, prona dhe të ngjashme me to, kurse në çështjet shpirtërore, në pëlqimin dhe kënaqësinë e Zotit të Madhëruar, e cila konsiderohet si kapitali më i madh i amshueshëm.

Një komentim tjetër, fjalën *"ekna"* e vënë përballë fjalës *"egna"*, me kuptimin që edhe varfëria, edhe skamja është në dorën e All'llahut. Ky shembull ilustrohet në ajetin 26 të sures "Er

[1] "Mufredat Ragib", lënda *"kenije"*.

Rra'd": **"All'llahu i ofron furnizimin me bollëk atij që do dhe ia kufizon** (atij që do)**...."**.

Por ky komentim nuk përputhet me shpjegimet në fjalorët burimorë, prandaj ajeti i lartpërmendur nuk mund të jetë një dëshmi për këtë domethënie.

Ajeti 49 thotë: **"Ai, që është Zoti i Siriusit..."**.[1]

Referimi dhe mbështetja në yllin e Siriusit, që është ylli më i shndritshëm i të gjithë yjeve që ndodhen në qiej, që zakonisht shfaqet në kohën e agimit, në afërsi të plejadës Xhuza dhe tërheq plotësisht vëmendjen, është për shkak se një grup politeistësh arabë e adhuronin atë. Prandaj Kur'ani u thotë: "Përse e adhuroni Siriusin? Adhuroni krijuesin dhe Zotin e tij."

Duhet të theksojmë se në qiell ka dy yje, që quhen Sirius. Njëri shfaqet në anën e Lindjes dhe për këtë arsye atë e quajnë Siriusi Jemenas (sepse Jemeni është në pjesën jugore të Gadishullit Arabik), kurse tjetrin e quajnë Siriusi i Shamit, që është në veri, prandaj njihet si Siriusi Jemenas.

Për veçoritë interesante të këtij ylli, ekzistojnë edhe fakte të tjera. Për ato do të flasim te hulumtimet.

[1] Siriusi është yll që adhurohej nga arabët paganë.

Hulumtime

1- Të gjithë këta tinguj janë nga ana e All'llahut

Kuptimi i këtyre ajeteve argumenton se çdo lloj veprimtarie dhe drejtimi në këtë botë, fillin e ka tek Esenca, tek Qenia e Stërpastër e Zotit. Gjithçka, që nga çështja e jetës dhe e vdekjes, deri te krijimi i ndërlikuar i njeriut nga një farë shumë e vogël, që nga ngjarjet e ndryshme dhe të llojllojshme që ndodhin gjatë jetës së njeriut dhe që e bëjnë atë të qajë, ose të qeshë, janë dëshira dhe vullneti i All'llahut.

Me urdhrin e Tij, në qiej ndodhen yjet më të shndritshme. Në tokë, ngopja dhe panevojshmëria e njerëzve, e kanë kthimin tek Esenca, te Qenia e Stërpastër e Zotit dhe, natyrisht, edhe Bota Tjetër është nën Urdhrin e Tij, sepse edhe ajo, gjithashtu, është një jetë e re, është vazhdimësi e jetës së kësaj bote.

Ky argumentim tregon vlerën e monoteizmit dhe, nga ana tjetër, atë të Ringjalljes, sepse krijuesi i njeriut, përmes një fare shumë të vogël, të hedhur në mitër, është në gjendje të lindë një krijesë që vjen në një botë tjetër. (sigurisht, në çdo rast, me dëshirën dhe bekimin e Zotit).

Shprehur ndryshe, të gjitha këto janë shenjë e "monoteizmit praktik" të Zotit të Madhëruar.

2- Faktet të mrekullueshme për yllin Sirius

Ylli Sirius, ashtu siç e cekëm edhe më lart, është ylli më ndriçues në qiell dhe është i njohur (ndër arabët) si Ylli Jemenas, sepse ndodhet në pjesën jugore (të Gadishullit Arabik).

Fisi arab Khuzzae e shenjtëronte dhe e adhuronte këtë yll dhe besonte se është burim i krijesave mbi tokë. Kur'ani këmbëngul dhe sqaron se Perëndia e Siriusit është Zoti i Madhëruar. Mos ngatërroni Krijuesin me të krijuarin.

Ky yll, me cilësi të çuditshme, që quhej mbreti i yjeve, karakterizohet me mrekulli. Disa prej mrekullive po i përmendim në vijim. Deri atë ditë asnjë prej këtyre fakteve, në lidhje me yllin Sirius, nuk ishte e njohur për njerëzit, prandaj mbështetja e Kur'anit mbi ta është edhe më kuptimplote dhe domethënëse.

a) Në bazë të hulumtimeve që janë kryer nga observatorët e njohur të botës, nxehtësia e stërmadhe që mbizotëron në sipërfaqen e Siriusit, arrin deri në 120 mijë centigradë.

Ndërkohë që nxehtësia e sipërfaqes së Diellit tonë mendohet se është vetëm 6000 gradë. Kjo tregon dallimin e madh të ngrohtësisë së Siriusit, në krahasim me Diellin.

b) Masa specifike e këtij ylli, është pothuajse pesëdhjetë mijë herë më e rëndë se uji, që do të thotë se rëndesa e një litri uji atje është e barabartë me pesëdhjetë ton ujë në rruzullin tokësor. Ndërsa Mërkuri, planeti me dendësinë më të rëndë në mesin e planeteve të Sistemit tonë diellor, e ka rëndesën jo më shumë se gjashtëfishin e ujit.

Atëherë, mund të pyesim, se nga ç'elemente është përbërja e këtij ylli, që qenka kaq i ngjeshur?

c) Ylli Sirius, në shekullin tonë, shfaqet në stinën e dimrit, por në epokën e astronomëve të lashtë të Egjiptit, shfaqja e tij përkonte me fillimin e verës. Ky yll, është një sferë gjigante, përmasa e të cilit arrin 20 herë më shumë se sa përmasa e Diellit. Largësia e tij me ne, është shumë më e madhe, krahasuar me largësinë mes Diellit dhe Tokës. Është llogaritur se kjo largësi është sa një milion herë më shumë se largësia e Diellit me Tokën.

Dimë që shpejtësia e dritës në sekonda është 300 mijë kilometër dhe drita e Diellit arrin tek ne për një interval kohor prej tetë minutash dhe 13 sekondash. Duke pasur parasysh që largësia e tij me ne është 150 milionë kilometra, rrezja e parë e yllit Sirius mbërrin te ne pas afro 10 vitesh. Tani llogarisni se sa është largësia e tij.

d) Siriusin Jemenas e shoqëron një yll, që është prej yjeve misterioze të qiellit. Këtë yll, për herë të parë, e zbuloi një shkencëtar, i njohur me emrin Besel. Kjo ka ndodhur në vitin 1844, por vetëm në vitin 1862 u bë i mundur vrojtimi i tij me anë të teleskopit. Koha e rrotullimit të yllit shoqërues rreth yllit kryesor është 50 vjet.[1]

Të gjitha këto dëshmojnë se deri në ç'masë janë domethënëse shprehjet kur'anore, të cilat, edhe në detajet më të vogla, mbajnë të fshehura realitete, që, nëse nuk kanë qenë të qarta ditën e zbritjes, me kalimin e kohës janë zbuluar dhe janë nxjerrë në pah.

[1] "Dairetul Mearif El Islamije, Made "Shara" dhe " Ferheng Name" Made " Setare" dhe " Dairetul Mearif Farsi Mesahib, Made " Shara".

3- Një hadith shumë domethënës nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Në një hadith thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po kalonte pranë një grupi njerëzish, të cilët ishin duke qeshur. Ai u tha: "*Nëse do të dinit atë që e di unë, do të qanit më shumë dhe do të qeshnit më pak!*".

Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u largua prej këtij grupi, atij i zbriti Xhebraili dhe i tha: *"E qara dhe e qeshura, që të dyja janë nga ana e Zotit."*.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u kthye përsëri pranë tyre dhe u tha: *"Nuk bëra më shumë se dyzet hapa dhe m'u shfaq Xhebraili dhe më tha: 'Kthehu tek ata dhe thuaju: "E qara dhe e qeshura janë nga Zoti.'"*.[1]

Me këtë hadith, tregohet se njeriu besimtar nuk duhet të rrijë vetëm duke qarë. Aq sa është e nevojshme e qara nga frika e dënimit të Zotit për gabimet që ka bërë, po aq është e nevojshme, edhe e qeshura në raste gëzimesh. Të dyja janë nga Zoti i Madhëruar.

Sidoqoftë, kjo nuk kundërshton përzgjedhjen dhe vullnetin e lirë të njeriut. E qeshura dhe e qara janë shprehje e gjendjeve emocionale të krijuara nga Krijuesi.

Në suren "Et Teube", në ajetin 82 thuhet: **"Le të qeshin pak e le të qajnë shumë. Ai është shpërblim i asaj që fituan..."**.

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 130.

Kjo ka të bëjë me hipokritët, për të cilët kemi sjellë dëshmi në ajetet paraardhëse, si dhe do të sjellim sërish në ajetet që vijojnë.

Duhet të na tërheqë vëmendjen një fakt. Në fillim të sures është bërë betimi për yllin kur perëndon, kurse këtu flitet për Zotin e Siriusit. Krahasimi i këtyre dy dëshmive tregon se Siriusi nuk është objekt adhurimi, sepse edhe ai, ka edhe lindje, edhe perëndim dhe u është nënshtruar ligjeve të krijimit.

Ajetet 50 – 55

وَأَنَّهُ أَهْلَكَ عَادًا الْأُولَىٰ ۝٥٠ وَثَمُودَ فَمَا أَبْقَىٰ ۝٥١ وَقَوْمَ نُوحٍ مِنْ قَبْلُ ۖ إِنَّهُمْ كَانُوا هُمْ أَظْلَمَ وَأَطْغَىٰ ۝٥٢ وَالْمُؤْتَفِكَةَ أَهْوَىٰ ۝٥٣ فَغَشَّاهَا مَا غَشَّىٰ ۝٥٤ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكَ تَتَمَارَىٰ ۝٥٥

"Se Ai i ka shkatërruar fiset e lashta Ad."

"E Themud, duke mos lënë askënd prej tyre."

"Si dhe popullin e Nuhut më parë, sepse qe më i padrejtë dhe rebel."

"Se Ai i asgjësoi edhe qytetet e përmbysura (të popullit të Lutit)**."**

"Të cilat i mbuloi ajo që i mbuloi?!"

"Atëherë, në çfarë dhuntie të Zotit tënd dyshon ti?"

Komentimi

A nuk mjafton gjithë ky mësim këshillëdhënës?!

Këto ajete janë vazhdimësi e çështjeve të cituara nga Librat e lashtë, si broshurat e Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe Libri i Musait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Në ajetet e kaluara u komentuan dhjetë çështje.

Komentimin e këtyre ajeteve mund ta përmbledhim në dy fjali.

Fjalia e parë tregon përgjegjësisë që duhet të mbajë çdo njeri për veprat që ka kryer vetë, kurse fjalia e dytë tregon se gjithçka përfundon te Zoti.

Ajetet që do të diskutojmë tani, flasin vetëm për një çështje, flasin për dënimet dhe asgjësimin e katër popujve. Ata popuj të hershëm ishin shtypës dhe mosmirënjohës. Dënimi i tyre ishte njëherësh edhe një paralajmërim për ata që nuk përfillin urdhrat dhe nuk besojnë në zanafillën monoteiste dhe Ringjalljen.[1]

Ajeti 50 thotë: **"Ai i ka shkatërruar fiset e lashta Ad…"**.

Emërtimi i atij populli të hershëm si populli i Adit (të parët, të hershmit), mund të jetë bërë, ose është për shkak të lashtësisë së këtij populli, (sepse te arabët është traditë që çdo gjë

[1] Kini vëmendjen se këto çështje, njëmbëdhjetë llojesh, fillojnë me *"inne"*. Çështja e parë e tyre është përmendur në ajetin 38 dhe çështja e fundit është përmendur në ajetin 50.

të vjetër ta quajnë "adi"), ose për shkak se gjatë historisë kanë ekzistuar dy popuj të Adit. Më i njohuri prej tyre ishte populli që lindi Profeti i tyre, që ishte Profeti Hud *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Po, ai është Adi i parë. [1]

Më pas, shton se Zoti i Madhëruar e shkatërroi edhe popullin e Themudit, për shkak të rebelimit të tyre: **"e Themud, duke mos lënë askënd prej tyre."**.

Për popullin e Nuhit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* thotë: **"si dhe popullin e Nuhut më parë, sepse qe më i padrejtë dhe rebel"**, sepse Profeti i tyre, Nuh *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kishte qenë pranë popullit të tij më gjatë se të gjithë Profetët e tjerë. Edhe pse Ai qëndroi mes popullit të tij për një periudhë kohore më të gjatë se të gjithë Profetët e tjerë, përsëri atij nuk i besuan shumë njerëz nga populli i vet. Populi i tij këmbëngulnin shumë në lëndimin e Nuhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në politeizëm, në idhujtari dhe në përgënjeshtrim.

Ne, me Vullnetin e Zotit të Madhëruar, gjatë komentimit të sures "Nuh" do të japim më shumë detaje lidhur me këtë situatë.

Populli i Lutit është populli i katërt i përmendur në Librat e lashtë. Për këtë popull, ajeti 53 thotë: **"Ai i asgjësoi edhe qytetet e përmbysura** (të popullit të Lutit)**."**.

Mendohet se ishte një tërmet i fuqishëm që i përmbyti dhe i asgjësoi këto toka të banuara. Transmetimet tregojnë se ishte Xhebraili, që, me forcën e dhënë nga Zoti, i çoi në ajër, i përmbyti dhe më pas i hodhi mbi tokë: **"të cilat i mbuloi ajo që i mbuloi."**.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan" dhe "Ruhul Meanij", si dhe tefsiri "Fekhru Rrazij".

Mbi ta zbriti edhe një shi nga gurët qiellorë. Të gjithë qytetet u shkatërruan dhe u kthyen në rrënoja prej guri.

Në këtë ajet dhe në ajetin e mëparshëm, nuk është përmendur sërish emri i popullit të Lutit. Komentuesit kanë shprehur mendimin se në ajetin 70 të sures "Et Teube" dhe në ajetin 9 të sures "Hakka", ky popull është përmendur me fjalën *"mu'tefikat"*. Komentues të tjerë supozojnë se ky emërtim përfshin të gjitha qytetet e rrënuara dhe të përmbytura, por ajete të tjera kur'anore e vërtetojnë atë që është e njohur dhe e pranuar nga komentuesit.

Në ajetin 82 të sures "Hud" thuhet: **"Kur erdhi urdhri Ynë, Ne e përmbysëm çdo gjë, - ato që ishin lart, i kthyem poshtë dhe mbi ata lëshuam gurë nga balta e pjekur, duke rënë vazhdimisht, si shiu."**.

Në tefsirin e Ali bin Ibrahimit, thuhet: "*Mutefike*" (qyteti i rrënuar dhe i përmbytur) është qyteti i Basrës. Kjo vërtetohet nga një hadith i Imam Aliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Midis të tjerash, ai u ka thënë banorëve të Basras: "*O banorë të Basras! O banorë të tokës së rrënuar dhe të përmbytur! O ushtri e gruas! O pasues të devesë! (duke aluduar për luftën e Xhemelit, ku udhëheqëse ishte Aishja dhe populli i Basras e ndiqte nga pas devenë e saj).*".[1]

Ky fjalim i Imam Aliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, është një lloj përputhje jo komentim, ndoshta, në atë kohë, populli i këtij qyteti kishte ngjashmëri me popullin e Lutit, si nga ana morale, ashtu edhe në llojet e dënimeve hyjnore.

[1] Tefsiri "Safij", ajeti në fjalë.

Në përfundim të këtij diskutimi, duke pranuar madhështinë dhe drejtësinë e Gjykatësit në çdo gjë, shtrohet një pyetje retorike: **"Atëherë, në çfarë dhuntie të Zotit tënd dyshon ti?"**.

Vallë, mos dyshoni në ato që u cituan nga Librat e mëparshëm dhe u theksuan edhe nga Kur'ani?

A mos dyshoni se Zoti i Madhëruar ju ka përjashtuar nga dënimet e popujve të hershëm dhe ju ka përfshirë në Mëshirën dhe Mirësinë e Vet?

Apo mos dyshoni në begatinë e zbritjes së Kur'anit dhe në çështjen e profetësisë, të besimit dhe të udhëzimit?!

Është e vërtetë që ajeti i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, mirëpo kuptimi i ajetit i përfshin të gjithë, por synimi kryesor i tij janë njerëzit e tjerë.

Fjala *"tetemara"* rrjedh nga fjala *"temara"*. Përdoret me kuptimin e polemikës së shoqëruar me dyshim dhe hamendësim.

Fjala *"alaa"* është shumësi i fjalës *"ilaa"*. Kuptimisht tregon *"begatinë"*. Në disa çështje të ajeteve të përmendura më parë, dënimet dhe asgjësimi i popujve të tjerë nuk quhet begati. Por, kur dënimet shërbejnë edhe si një mësim i mirë për të tjerët, përdorimi i saj është i drejtë, pra, është një begati e madhe.

Ajetet 56 – 62

هَذَا نَذِيرٌ مِنَ النُّذُرِ الْأُولَى٥٦ أَزِفَتِ الْآزِفَةُ٥٧ لَيْسَ لَهَا مِنْ دُونِ اللَّهِ كَاشِفَةٌ٥٨ أَفَمِنْ هَذَا الْحَدِيثِ تَعْجَبُونَ٥٩ وَتَضْحَكُونَ وَلَا تَبْكُونَ٦٠ وَأَنْتُمْ سَامِدُونَ٦١ فَاسْجُدُوا لِلَّهِ وَاعْبُدُوا ٦٢

“Ky (Profet) **është paralajmërues si ata të mëparshmit.”**

“Ora e Kiametit po afrohet.”

“Dhe askush, përveç All’llahut, nuk mund ta zbulojë atë!”

“Vallë, prej kësaj fjale po çuditeni”

“dhe po qeshni e nuk po qani?”

“Madje, jeni edhe të shkujdesur!”

“Më mirë përuluni në sexhde për All’llahun dhe adhurojeni Atë!”

Komentimi

Përuluni të gjithë në sexhde për Zotin!

Në ajetet e kaluara, u diskutua për asgjësimin e popujve të hershëm, se ishin shtypës dhe rebelë. Ajetet që po diskutojmë, u drejtohen politeistëve, idhujtarëve dhe mohuesve të thirrjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Zoti deklaron: **"Ky** (Profet) **është paralajmërues si ata të mëparshmit."**.

Ky ajet, përmes të cilit Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* quhet paralajmërues si të mëparshmit, tregon se misioni i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është paralajmërimi përmes Librit të tij qiellor. Pra, përse ju duket e çuditshme që Kur'ani është burimi i paralajmërimeve të Profetit të Islamit?!

Më pas, me qëllim që politeistët dhe idhujtarët të tregohen më të kujdesshëm ndaj rrezikut që i pret, shton: **"Ora e Kiametit po afrohet…"**.

Po, Kiameti është afër, përgatiteni veten për pyetje-përgjigjet, për shpërblimin dhe për dënimin e merituar.

Fjala *"el azifetu"* përdoret për të treguar se Kiameti është afër. Kjo fjalë rrjedh nga fjala *"ezef"* dhe përdoret me kuptimin e *"kohës së ngjeshur"*, por, njëherësh, mbart në vetvete edhe kuptimin e afrimit.

Emërtimi i Kiametit me këtë fjalë, përveç se nga ky ajet, është bërë edhe në ajetin 18 të sures "El Gafir". Këtu, kjo fjalë mbart edhe konotacione që shënojnë ndikim dhe tërheqje vëmendje. Po këtë kuptim, por në një formë tjetër, shpreh edhe ajeti i parë i sures "El Kamer". Aty thotë: **"Kiameti është afruar..."**. Sidoqoftë, afrimi i Kiametit është i perceptueshëm, duke pasur parasysh jetën e shkurtër të kësaj bote, sidomos faktin se për këdo që vdes, ka ndodhur Kiameti i vogël.

Më pas ajeti shton: **"Askush, përveç All'llahut, nuk mund ta zbulojë atë!"**.

Fjala *"el kashifetu"* tregon eliminimin e torturave.

Një grup komentuesish, fjalën *"el kashifetu"* e kanë interpretuar si një faktor për vonimin e Kiametit. Disa të tjerë, e kanë interpretuar në kuptimin e "zbulimit të datës së ndodhisë së Kiametit". Me gjithë komentet, kuptimi i parë duket më i përafërt se të gjithë kuptimet e tjera.

Sidoqoftë, mbizotëruesi, sunduesi i fuqisë në Atë Ditë (dhe përgjithnjë) është Zoti i Madhëruar.

Nëse kërkoni shpëtim, kërkoni strehim te Mëshira e Tij, nëse kërkoni qetësi, hyni nën hijen e besimit ndaj Tij.

Ajeti 59 thotë: **"Vallë, prej kësaj fjale po çuditeni…"**.

Kjo fjali, ose mund të aludojë për çështjen e Ringjalljes, e cila është përmendur në ajetet e mëparshme, ose mund të jetë aludim për Kur'anin (sepse në ajetet e tjera kur'anore, ai është

përmendur me fjalën "hadith"),[1] ose është aludim për fjalët që u thanë në lidhje me shkatërrimin e popujve të mëparshëm, ose mund të përfshijë të gjitha këto aludime së bashku.

Ajeti 60 thotë: **"dhe po qeshni e nuk po qani?"**.

Gjithnjë e kaloni kohën në argëtim, në injorancë, **"madje, jeni edhe të shkujdesur!"**.

Por këtu nuk është as vendi për të qeshur e as vendi për t'u shkujdesur. Këtu është vendi për të qarë, për mundësitë që keni humbur, për adhurimet e lëna pas dore, si dhe për mëkatet që keni kryer. Këtu është vendi i ndërgjegjësimit dhe i kompensimit të çështjeve që ju shkuan huq. Këtu është vendi i pendimit, i të kërkuarit falje dhe i rikthimit nën hijen (mbulimin) e Mirësisë së Zotit.

Fjala *"samidun"* rrjedh nga rrënja *"semudun"*. Ajo është përdorur me kuptimin e argëtimit, të qejfit dhe të ngritjes lart të kokës, si pasojë e arrogancës dhe e mendjemadhësisë. Kjo fjalë përdoret për devenë që ecën duke e ngritur kokën lart në shenjë mospërfilljeje.

Edhe individët mendjemëdhenj dhe arrogantë ngjasojnë me shtazët. Gjithnjë janë ose në gjumë, ose duke ngrënë e duke dëfryer. Janë të papërgjegjshëm për veprimet e tyre dhe të pavetëdijshëm për ngjarjet e dhimbshme, dhe ndëshkimet e ashpra që i presin, e që shpejt do të ndeshen me to.

[1] Sure "Et Tur", ajeti 34.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje, që trajtoi vërtetimin e monoteizmit dhe mohimin e politeizmit, thuhet: **"Më mirë përuluni në sexhde për All'llahun dhe adhurojeni Atë!"**.

Nëse doni të ecni në Rrugën e Drejtë dhe të vërtetë, përuluni në sexhde vetëm për All'llahun! Gjithçka që është në tokë dhe në univers, e ka kthimin në Esencën e Stërpastër të All'llahut. Nëse nuk doni të keni fatin e dhimbshëm të popujve të kaluar, të cilët ranë në kthetrat e dënimit hyjnor, sepse ishin nën ndikimin e politeizmit, të idhujtarisë, të shtypjes dhe të dhunës, atëherë adhurojeni vetëm Zotin.

Mbresëlënës është fakti që është transmetuar në shumë hadithe se, në momentin kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, gjatë leximit të kësaj sureje, arriti tek ajeti në fjalë, të gjithë besimtarët dhe politeistët që e dëgjuan, ranë në sexhde.

Sipas një transmetimi, i vetmi person që nuk ra në sexhde, ishte Velid bin Mugijre, (mbase nuk e kishte të mundur të përkulej të bënte sexhde), por edhe ai mori një grusht dhè nga toka dhe e vuri ballin në të. Në këtë mënyrë, bëri sexhde!

Edhe idhujtarët ranë në sexhde.

Kjo ndodhi mes të tjerash, sepse: toni i ajeteve të kësaj sureje ishte ndikues dhe emocionues; përmbajtja e sures ishte e mrekullueshme; kërcënimet për politeistët ishin tejet të rrezikshme; artikulimi, këndimi i këtyre ajeteve u bë nga goja e bekuar e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*; u këndua në momentin e zbritjes së parë të Shpalljes; ndoshta edhe me pavetëdije, depërtoi në zemrat e

gjithsecilit dhe hoqi mënjanë perdet e ligësisë, të kryeneçësisë, të fanatizmit dhe të egoizmit, edhe pse përkohësisht; rrezatoi dritën e monoteizmit në zemrat e tyre.

Nëse ne e lexojmë vetë këtë sure, me vëmendje dhe përqendrim dhe e imagjinojmë veten përballë Profetit të dashur të Islamit, në momentin e zbritjes së ajeteve, do të vërejmë se, pavarësisht nga bindjet karakteristike të Islamit, nuk kemi zgjidhje tjetër. Zgjidhja e vetme është se, kur të arrijmë tek ajeti i fundit, të përkulemi në sexhde dhe të përulemi përpara Zotit të Madhëruar.

Kjo nuk është hera e parë që Kur'ani ndikon në zemrat e politeistëve dhe të idhujtarëve dhe i magjeps ata, edhe duke qenë të pavetëdijshëm. Por, ashtu siç është thënë edhe në tregimin e Velid ibn Mugijretu, në kohën që i dëgjoi ajetin 31 të sures "Fussilet" nga goja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Në qoftë se ata nuk përgjigjen, ti thuaj: Unë ju tërhoqa vërejtjen e një rrufeje,** (dënimi)**, si rrufeja e Adit dhe e Themudit",** u ngrit nga vendi, duke i rrëqethur trupi, u tensionua, filloi të dridhej dhe u kthye në shtëpi në këtë gjendje, saqë politeistët menduan se ai ra plotësisht nën ndikimin e fesë së Muhammedit.

Si rrjedhojë, nuk është fare e nevojshme të pohojmë se ata ishin disa xhindë, apo njerëz të djallëzuar në momentin e këndimit të ajetit: **"E ju, a e shihni Laten e Uzanë..."**, ku flitet për idhujt e njohur arabë, që tentuan lavdërimin e këtyre idhujve dhe deklaruan: ***"Tilkel garanijkul ula"***, apo **"Këta janë të parët e lartësuar"** dhe me këtë e tërhoqën vëmendjen e politeistëve dhe si pasojë e kësaj, ata ranë në sexhde.

Por, ashtu siç u shprehëm më lart, në komentimin e këtyre ajeteve, në ajetet vijuese, sepse i përmendën emrat e këtyre idhujve, ata janë qortuar ashpër. Për askënd nuk mbetet asnjë vend për dyshim, gabim apo devijim. (Për më shumë informacion shih ajetet 19-20 të po kësaj sureje.)

Është e nevojshme të përmendim edhe faktin se, kur lexohet ajeti i lartpërmendur, rënia në sexhde është e obligueshme për të gjithë. Toni i ajetit është urdhërues dhe urdhri është detyrim. Pas sures "Elif lam sexhde" dhe "Ha mim sexhde", kjo është surja e tretë, ku sexhdja është e detyrueshme, edhe pse, në bazë të disa transmetimeve, për nga pikëpamje e kohës së zbritjes, surja e parë, në të cilën ka zbritur ajeti i sexhdes së detyrueshme, është kjo sure që ne po diskutojmë.

O Zoti im! Të lutemi, që dritën e njohjes Tënde ta vendosësh në zemrat tona, që të mos adhurojmë asnjë tjetër përveç Teje dhe të mos përulemi në sexhde ndaj askujt, përpos Teje.

O Zot! Çelësat e të gjitha begative janë në dorën Tënde të fortë, të lutemi, na dhuro neve mirësitë dhe dhuntitë e Tua më madhështore, që janë pëlqimi dhe kënaqësia Jote!

O Zoti im! Të lutemi, na bëj vrojtues, këshillëmarrës, në mënyrë që të marrim mësim nga e kaluara e popujve të hershëm dhe të qëndrojmë larg rrugës së ndjekur prej tyre!

Amin ja rabbel alemin

Sure "El Kamer"

Zbritur në Mekë, 55 ajete

Përmbajtja e sures "El Kamer"

Kjo sure mbart karakteristikat dhe veçoritë e sureve mekase. Suret mekase kanë diskutime të "nxehta". Në to diskutohet lidhur me zanafillën monoteiste dhe Ringjalljen. Suret mekase, në mënyrë të veçantë, tregojnë për dënimet e popujve të hershëm, të cilët u shkatërruan dhe u asgjësuan njëri pas tjetrit, për shkak të kryeneçësisë, të mendjemadhësisë dhe të rrugës së gabuar, për shkak të devijimit, të politeizmit, të shtypjes dhe të korrupsionit që kishin ndërmarrë. Për këto arsye, ata u ndëshkuan nga dënimi i dhembshëm hyjnor.

Pas secilës nga këto histori, Kur'ani përsërit këtë fjali: **"Vërtet, Ne e kemi bërë Kur'anin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!"**.

Përsëritja e kësaj fjalie tregon këmbënguljen e Kur'anit, që kjo të jetë një mësim për myslimanët dhe politeistët.

Përmbajtjen e kësaj sureje, mund ta përmbledhin në shtatë pika:

1- Fillimi i sures diskuton për afrimin e Kiametit, për "çarjen e hënës", për këmbënguljen e kundërshtarëve, për të mohuar ajetet hyjnore.
2- Në pjesën tjetër, surja diskuton, në mënyrë të detajuar, për popullin e Nuhit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, që ishte populli i parë kryeneç, rebel dhe i pabindur, si dhe për çështjen e stuhisë, por në mënyrë të shkurtër.
3- Në pjesën e tretë, përshkruan tregimin e popullit të Adit dhe dënimin e dhembshëm të tyre.
4- Në pjesën e katërt, diskuton për popullin e Themudit dhe kundërshtimin e tyre, për Profetin e tyre, Salih *(Paqja e*

All'llahut qoftë mbi të!), për "mrekullinë e devesë", si dhe për fundin e tyre përmes "britmës qiellore".

5- Më pas diskuton për popullin e Lutit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, duke aluduar për politeizmin dhe degjenerimin e tyre etik. Aty tregohet një pjesë nga dënimet e tyre rrëqethëse.

6- Në këtë pikë të sures, diskutohet përmbledhtazi për dishepujt e Faraonit dhe dënimet e tyre.

7- Në pjesën e fundit të sures, bëhet krahasimi mes këtij populli dhe politeistëve të Mekës, si dhe kundërshtarëve të Profetit të Islamit. Diskutohet e ardhmja e tyre e frikshme, në rast se ndjekin rrugën e politeistëve. Surja përfundon me përshkrimin e disa dënimeve të keqbërësve në Kiamet dhe për shpërblimet madhështore për njerëzit e devotshëm.

Ajetet e sures janë të shkurtra, por shumë të "nxehta" dhe tronditëse.

Emërtimi i kësaj sureje, me fjalën *"kamer"*, është bërë për shkak të ajetit të parë të saj, i cili diskuton për "çarjen e hënës".

Mirësitë e leximit të sures "El Kamer"

Në një hadith të transmetuar nga Profeti i Islamit, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Kush e lexon suren 'Ikterebet', çdo dy ditë, në Ditën e Gjykimit do të ringjallet me fytyrë të shndritshme si hëna e plotë dhe kush e lexon atë çdo natë, është më i lartësuari dhe në Ditën e Gjykimit,*

rrezatimi dhe drita e fytyrës së tij do të ndriçojë më shumë se çdo krijesë tjetër.”.[1]

Ky ndriçim i fytyrës në Ditën e Kiametit është tregues i besimit të fortë dhe të drejtë, që personi e ka fituar nga leximi i kësaj sureje, nga përsëritja e saj, nga veprimit sipas saj, dhe jo nga leximi i pavëmendshëm dhe i pazbatuar në praktikë.

[1] “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, fillimi i sures “El Kamer”.

Ajetet 1-3

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اقْتَرَبَتِ السَّاعَةُ وَانْشَقَّ الْقَمَرُ ١ وَإِنْ يَرَوْا آيَةً يُعْرِضُوا وَيَقُولُوا سِحْرٌ مُسْتَمِرٌّ ٢ وَكَذَّبُوا وَاتَّبَعُوا أَهْوَاءَهُمْ وَكُلُّ أَمْرٍ مُسْتَقِرٌّ ٣

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit

"U afrua Ora dhe u ça Hëna!"

"E megjithatë, sa herë që shohin ndonjë mrekulli, ata kthejnë kurrizin dhe thonë: 'Kjo është në vazhdën e magjive të tij!'"

"Ata e mohojnë (të vërtetën) **dhe pasojnë dëshirat dhe tekat e tyre, por çdo gjë është e caktuar."**

Komentimi

U ça Hëna!

Në ajetin e parë është diskutuar për dy ndodhi të rëndësishme. Njëra prej tyre është afrimi i kohës së Kiametit, që shoqërohet me transformimet më të mëdha në univers. Dita e Kiametit shënon fillimin e një jete të re në Botën Tjetër,

madhështia dhe gjerësia e të cilës është e paperceptueshme dhe e papërshkrueshme për ne, "të burgosurit" e kësaj bote.

Ndodhia tjetër është mrekullia e madhe e çarjes së Hënës. Çarja e Hënës tregon se Zoti ka fuqi mbi çdo gjë, si dhe është shenjë e sinqeritetit të thirrjes së Profetit të Tij të dashur.

Ajeti i parë thotë: **"U afrua Ora dhe u ça Hëna!"**.

Duhet të kemi parasysh se surja e kaluar (surja "Nexhm") përfundoi me fjalinë që fliste për afrimin e Kiametit: **" ... është afruar** (Kiameti)**..."**, kurse kjo sure fillon me po këtë çështje. Kjo tregon se afrimi i Kiametit duhet të theksohet. Duhet theksuar se Kiameti është afruar. Edhe pse, krahasuar me jetën e kësaj bote, Kiameti mund të zgjasë me mijëra vite, sërish, në kontekstin e tërësisë së jetës së kësaj bote, nga njëra anë dhe me faktin se e gjithë jeta e kësaj bote, karshi Kiametit, nuk është veçse një moment kalimtar, bëhet i qartë edhe kuptimi i këtij theksimi.

Disa komentues mendojnë se përmendja e këtyre dy ndodhive së bashku, është bërë, sepse shfaqja e Profetit të Islamit, që ishte Profeti i fundit hyjnor, është njëkohësisht njëra prej shenjave të afrimit të Kiametit. Prandaj në një hadith të transmetuar nga vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë*: "Dërgimi im, si dhe Kiameti, janë ngjashëm me këto të dyja."*[1] (duke treguar dy gishtat e bekuar të tij, që ishin pranë njëri–tjetrit).

Edhe çarja e Hënës është një dëshmi për mundësinë e ngjarjeve madhështore, që do të ndodhin në këtë botë në prag të

[1] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 29, f. 29.

Kiametit, sepse të gjithë planetet, bashkë me yjet dhe me Tokën, do të shkatërrohen dhe do të asgjësohen dhe në vend të tyre do të krijohet një botë e re.

Në bazë të një transmetimi të njohur, thuhet: "Idhujtarët erdhën pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe thanë: 'Nëse thua të vërtetën dhe je i Dërguari i Zotit të Madhëruar, çaje hënën në dy pjesë për ne!'

Profeti tha: *'Nëse e realizoj këtë vepër, a do të besoni?'*

Ata pohuan: 'Po.'

Ndërkohë ishte nata e katërmbëdhjetë e muajit dhe Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kërkoi nga Zoti që t'ia plotësonte kërkesën që e kishin parashtruar. Papritmas Hëna u ça në dy pjesë dhe i Dërguari i thërriste ata një nga një duke u thënë: *'Shikoje!'"*.[1]

Lidhur me çështjet: Si është e mundur, që të çahet kjo sfere qiellore madhështore?

Ç'ndikime do të ketë për rruzullin tokësor dhe në Sistemin Diellor?

Cila do të ishte mënyra e bashkimit të dy copave të Hënës pas çarjes?

Si është e mundur, që të ndodhë një ngjarje e tillë?

Pse librat e historitë nuk e përmendin aspak atë?

[1] "Mexhmaul Bejan" dhe libra tjerë të tefsirit, ajeti në fjalë.

Për këto pyetje dhe për pyetje të tjera rreth kësaj ngjarje, ne, me vullnetin e Zotit të Madhëruar, do të flasim më gjerësisht te pjesa e hulumtimeve.

Duhet të sqarohet se një pjesë e komentuesve, të ndikuar nga sugjerime dashakeqe, kanë mohuar çdo lloj vepre të jashtëzakonshme të kryer nga ana e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përveç Kur'anit. Por, duke parë qartësinë e ajetit të lartpërmendur dhe hadithet e shumta që janë transmetuar rreth kësaj teme, në librat e dijetarëve islamë, e kishin të pamundur të gjenin një justifikim për këtë vepër mbinatyrore. Atyre nuk u mbeti rrugë tjetër, vetëm të mohojnë aspektin e mrekullisë së saj.

Por e vërteta është se çështja e "çarjes së Hënës" është prej mrekullive të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajetet vijuese sjellin dëshmi të qarta mbi këtë çështje. Sa mirë do të ishte, që ata të reflektonin në lidhje me këtë bindje të gabuar të tyre dhe ta kuptonin se edhe Profeti i Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka bërë mrekulli dhe vepra të jashtëzakonshme. Por ata vijojnë të mos e pranojnë atë, edhe pse disa ajete kur'anore e mohojnë sërish, duke thënë se bëhet fjalë për "mrekulli të sugjeruara", që një grup mohuesish mashtrues ia propozonin atij. Ata as që kishin ndërmend pranimin e të vërtetës e as që do të dorëzoheshin pas kryerjes së saj. Por mrekullitë kërkohen të kryhen për të verifikuar të vërtetën. Ato i kreu Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për këtë ekzistojnë shumë dëshmi në jetëshkrimin e të Dërguarit të Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Më pas, Kur'ani shton: **"E megjithatë, sa herë që shohin ndonjë mrekulli, ata kthejnë kurrizin dhe thonë: 'Kjo është në vazhdën e magjive të tij!'"**.

Fjala *"mustemir"* tregon ata politeistë që kishin parë mrekulli të njëpasnjëshme te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Edhe "çarja e Hënës" ishte vazhdimësi e atyre mrekullive, por ata, të gjitha mrekullitë, i trajtonin si magji, si "magji e vazhdueshme". Edhe kjo akuzë ishte një pretekst për të mos iu dorëzuar atij.

Disa komentues, fjalën *"mustemir"* e kanë interpretuar si "i fortë, i qëndrueshëm" (siç thuhet *"hablun mirir"*, pra, litar i fortë), kurse disa të tjerë, e kanë interpretuar si "*i përkohshëm dhe i paqëndrueshëm*". Por më i plotë është komentimi i parë.

Në ajetin vijues, vihet në dukje kundërshtimi i tyre dhe përfundimi ogurzi i këtij kundërshtimi: **"Ata e mohojnë** (të vërtetën) **dhe pasojnë dëshirat dhe tekat e tyre, por çdo gjë është e caktuar."**.

Burimi i kundërshtimit të tyre, i përgënjeshtrimit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i përgënjeshtrimit të mrekullive dhe argumenteve të tij, i përgënjeshtrimit të Ringjalljes dhe i Kiametit, ishte vijimi i dëshirave primitive dhe i tekave të tyre. Paragjykimet, kokëfortësitë dhe egoizmi, nuk i lejonin ata që të dorëzoheshin përballë të vërtetës. Pasioni i zjarrtë ndaj epshit dhe ndaj shthurjes, për plotësimin pa kusht dhe pa kufizim të kënaqësive, përlyerja në çdo lloj mëkati dhe dhune ishin pengesat për pranimin e thirrjes së të vërtetës. Pranimi i thirrjes të së vërtetës do të sillte përgjegjësi për ta.

Po, gjithnjë kështu ka qenë dhe kështu do të jetë. Pasimi i dëshirave dhe i tekave, do të jetë një pengesë e madhe në Rrugën e Drejtë.

Sifjalia: **"por çdo gjë është e caktuar"**, përcjell kuptimin se çdo njeri do të arrijë tek dënimi apo shpërblimi përkatës, sipas veprës që ka kryer. Caku i mirësisë është për të mirët dhe caku i ligësisë është për të këqijtë.

Kjo fjali tregon se asgjë në këtë botë nuk shuhet e asgjësohet, se çdo punë e mirë dhe e keqe mbetet dhe do të ruhet, derisa njeriu të marrë shpërblimin e merituar.

Nga komentimin i ajetit të lartpërmendur, rrjedh edhe mesazhi se përgënjeshtrimet dhe akuzimet nuk mund të mbulojnë përgjithnjë fytyrën e të vërtetës, përkundrazi, çdo gjë do të lëvizë në drejtim të vendit të vet të përcaktuar dhe jo shumë vonë do të shfaqet fytyra e bukur e të vërtetës, ashtu siç do të shfaqet edhe fytyra e shëmtuar dhe e urryer e të pavërtetës (falsitetit). Kjo është normë ekzistenciale dhe një prej traditave hyjnore në këtë botë.

Hulumtime

1- "Çarja e Hënës", një mrekulli e madhe e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Disa mendjeshkurtër këmbëngulin që këtë mrekulli ta paraqesin në mënyrë të atillë, që të mos njihet si një vepër e jashtëzakonshme. Për t'i kundërshtuar këta, ajeti njofton për "shenjat e çastit të Kiametit", për ndodhitë që do të shoqërojnë ardhjen e Kiametit.

Në ajet ekzistojnë shumë dëshmi, që theksojnë realizimin e një mrekullie, si për shembull, *çarja e hënës* tregohet me një folje në kohën e shkuar. Folja në kohën e shkuar tregon një veprim që ka ndodhur me siguri në të shkuarën. Pra, "çarja e Hënës" ka ndodhur, ashtu siç ka ndodhur edhe ardhja e Profetit të fundit, që shënon afrimin e kohës së Kiametit dhe të Ringjalljes.

Nëse nuk do të bëhej fjalë për mrekulli, atëherë nuk do të kishte asnjë lloj ngjashmërie me të ashtuquajturat "magji" të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky fakt, i cili është përmendur në ajetin vijues, nuk përputhet fare as me fjalinë: **"Ata e mohojnë** (të vërtetën) **dhe pasojnë dëshirat dhe tekat e tyre"**, e cila nxjerr në pah përgënjeshtrimin e tyre.

Në disa libra të hadithit janë transmetuar shumë hadithe për këtë mrekulli. Ajo arrin nivelin më të lartë të transmetimeve, prandaj është e pamundur të mohohet dhe të anashkalohet.

Shumica e komentuesve pranojnë se ky ajet tregon çarjen e Hënës. Këtë e argumentojnë edhe transmetimet autentike. Kjo çështje është brenda logjikës. Profeti i Islamit, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e ka dhënë vetë këtë lajm. Prandaj ai duhet pranuar, kurse teoria e mosndarjes dhe e bashkimit të planeteve (sipas opinionit të gabuar të Ptolemeut) është e pabazuar shkencërisht.

Dijetari i shquar, Tabersiu në veprën "Mexhmaul Bejan" shprehet: "Komentuesit e Kur'anit, këtë ajet e interpretojnë si mrekullia e çarjes së Hënës, në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Të vetmit persona që i përmend si kundërshtarë të kësaj pikëpamje, janë: Atau, Hasani dhe Balkhiu, por tregohet indiferent ndaj thënieve të tyre.".

Disa kanë transmetuar se Hudhejfeja, ngjarjen e "çarjes së Hënës", e rrëfeu në prani të një grupi të madh njerëzish në xhaminë e qytetit Medain. Askush nuk e kundërshtoi atë, edhe pse shumë prej të pranishmëve e kishin përjetuar kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Dëshmitë për vërtetësinë e këtij ajeti, si nga transmetimet, ashtu edhe nga komentuesit, për "çarjen e Hënës", janë të pamohueshme. Kanë mbetur pa u sqaruar edhe disa çështje të tjera, të cilat do t'i shtjellojmë në vijim.

2- "Çarja e Hënës" për nga pikëpamja e shkencave të sotshme

Për këtë çështje kaq të rëndësishme, mund të shtrohet kjo pyetje: A është e mundur që të ndodhë çarje apo ndarje në objektet qiellore? Po shkenca i pohon apo i mohon këto dukuri?

Sot, pas shumë arritjeve dhe zbulimeve në fushën e astronomisë, përgjigjja për këto pyetje, nuk është aq e ndërlikuar. Këto zbulime tregojnë se një gjë e tillë është plotësisht e mundur.

Në sistemin tonë diellor, shpeshherë, kanë ndodhur çarje dhe shpërthime të shumta. Në vijim do të sjellim disa shembuj:

a) Shfaqja e Sistemit Diellor

Kjo teori është pranuar nga gjithë shkencëtarët. Ata kanë pranuar se të gjitha planetet e Sistemit Diellor, në fillim, kanë qenë pjesë e Diellit dhe më pas janë ndarë nga ai dhe secila nga ato rrotullohet rreth orbitës së vet.

Lidhur me shkakun e kësaj ndarjeje, ka diskutime:

La Plase është i mendimit se shkak i kësaj ndarjeje, ka qenë "forca e largimit nga qendra", në zonën ekuatoriale të Diellit. Kjo, në kuptimin se në atë kohë Dielli ishte në formën e një grumbulli të nxehtë prej gazi (edhe tani është i tillë) dhe rrotullohej rreth vetes, shpejtësia e këtij rrotullimi në zonën ekuatoriale u bë shkak që nga ai të ndahen disa pjesë, të shpërndahen në hapësirë dhe të rrotullohen rreth qendrës kryesore, pra, Diellit.

Por, kërkimet e reja të disa shkencëtarëve të tjerë, pas La Plasit, kanë rezultuar në një teori tjetër. Sipas saj: "Si shkak të kësaj ndarjeje kanë konsideruar dukurinë e baticave dhe zbaticave të forta në sipërfaqen e Diellit, që kanë ndodhur nën efektin e kalimit të një ylli të madh në afërsi të tij.".

Përkrahësit dhe ithtarët e kësaj teorie, të cilët rrotullimin e Diellit në ato kohëra nuk e konsiderojnë si të mjaftueshme për të justifikuar ndarjen e copëzave prej tij, kanë përqafuar këtë teori, duke pretenduar se këto batica dhe zbatica kanë krijuar valë të mëdha në sipërfaqen e Diellit, të ngjashme me rënin e një shkëmbi masiv dhe tejet të madh në oqean.

Si rrjedhim, copëza prej Diellit u hodhën jashtë tij njëra pas tjetrës dhe filluan të sillen rreth "sferës nënë" (Diellit).

Pavarësisht shkakut të ndarjes, nuk zbehet fakti se të gjithë janë të mendimit që shfaqja e sistemit diellor ka ndodhur me anë të ndarjes dhe çarjes.

b) Asteroidet

Asteroidet janë copa shkëmbinjsh të mëdhenj qiellorë, të cilët sillen rreth sistemit diellor. Ato i quajnë edhe "sfera të vogla", ose si gjysmë planete. Përmasat e diametrit të tyre arrin në 25 kilometër, por janë edhe me përmasa më të vogla.

Shkencëtarët janë të mendimit se asteroidet janë pjesë të mbetura të një planeti masiv, që ka qenë në lëvizje në një orbitë midis orbitës së Marsit dhe orbitës së Mërkurit. Më pas, nën

ndikimin e faktorëve të panjohur, kanë shpërthyer dhe janë shpërndarë.

Deri më sot janë zbuluar dhe janë vërejtur më shumë se pesë mijë asteroide. Një pjesë e madhe e tyre, në fillim, janë më të mëdha në vëllim. Ata janë emëruar dhe u është përllogaritur vëllimi, përmasa dhe koha e lëvizjes rreth Diellit. Disa astronomë u kushtojnë një rëndësi të veçantë asteroideve dhe janë të mendimit se mbase ato mund t'i përdorim si një bazë për të udhëtuar larg, në hapësirë.

Ky është një shembull tjetër, në lidhje me ndarjen e trupave qiellorë.

c) Meteorët

Meteorët janë gurë shumë të vegjël qiellorë, sa ndonjëherë arrijnë përmasën e një lajthie. Ata lëvizin në një orbitë të veçantë, me një shpejtësi të madhe rreth Diellit dhe, kur rruga e tyre ndërthuret me orbitën e rruzullit tokësor, tërhiqen në drejtim të tokës.

Këta gurë të vegjël, nën ndikimin e ashpërsisë së madhe të përplasjes me ajrin (atmosferën) që ka rrethuar Tokën, si dhe për shkak të shpejtësisë së tyre mahnitëse, nxehen, ndizen dhe shndërrohen në flakë. Ne i shohim ata në formën e një vije të hijshme ndriçuese në atmosferën e Tokës dhe i quajmë si "shigjeta e meteorit".

Ndonjëherë imagjinojmë që është një yll i largët që bie, ndërkohë që ai është një meteor i vogël, i cili është ndezur në një largësi shumë të përafërt e më pas është bërë pluhur.

Orbita e meteorëve dhe orbita e Tokës kanë kontakt në dy pika. Për këtë arsye, në muajin gusht dhe në muajin nëntor shihen më shumë meteorë, kur bëhet edhe "kryqëzimi" i dy orbitave.

Shkencëtarët pohojnë se këta meteorë janë mbetje kometash që kanë shpërthyer nën efektin e ndodhive të panjohura dhe janë ndarë në copëra meteorike.

Edhe ky ishte një shembull tjetër i çarjeve në sferat qiellore.

Siç shihet, ndarja dhe shpërthimi i trupave qiellorë nuk është një dukuri e pamundur, edhe nga ana shkencore, prandaj, me të drejtë, thuhet se edhe mrekullitë nuk i përkasin të pamundurës.

Të gjitha këto, kishin të bënin me shpërthimin e trupave qiellorë. Tani le të diskutomë për rikthimin e tyre në gjendjen e mëparshme. Bashkimi i dy pjesëve, nën presionin e një force tërheqëse, është krejtësisht i mundur.

Astrologjia e vjetër bazohej mbi pikëpamjet e Ptolemeut dhe nëntë sferat "lakore". Ato sfera ishin të kristalta dhe të ndërlidhura me njëra–tjetrën në mënyrë të tillë, që çarja dhe ribashkimi i tyre, sipas Ptolemeut dhe disa mbështetësve të tij, ishte e pamundur. Mbështetësit e kësaj teorie mohonin edhe Miraxhin fizik, edhe çarjen e Hënës, sepse Miraxhi dhe çarja e Hënës nënkuptonin ndarje dhe më pas ribashkim të sferave. Sot, teoria përkatëse e Ptolemeut ka mbetur mit, një trillim. Në ditët

tona, nuk ka më asnjë gjurmë nga ato nëntë sferat e supozuara, prandaj ne nuk kemi pse të merremi me to.

3- "Çarja e Hënës nga pikëpamja historike

Çështja tjetër e ngritur për "çarjen e Hënës" është kjo: Nëse kjo dukuri ka ndodhur, pse nuk është dokumentuar?
Për ta qartësuar këtë, duhet të bëhet një analizë e plotë.

a) Dihet se Hëna është e dukshme në gjysmën e planetit të Tokës, prandaj njerëzit që ndodhen aty, nuk e shikojnë të plotë, por shikojnë vetëm gjysmën e saj.

b) Gjysma e njerëzve që mund ta shikonin, janë duke fjetur, pra, vetëm një e katërta e njerëzve të kësaj bote mund të jetë dëshmitare për një ndodhi të tillë.

c) Një pjesë e Hënës mund të ndodhë që të jetë e mbuluar nga retë dhe të mos shihet edhe ajo pjesë e shikueshme e saj.

d) Ndodh që dukuritë qiellore të shoqërohen me zhurma të forta, rrufe, etj. Ndodh që edhe drita të ndërpritet plotësisht, siç janë eklipset. Këto mund të zgjasin në kohë.

Shpeshherë ndodh që eklipset e pjesshme, për arsye se zgjasin pak kohë, të mos vihen re nga njerëzit. Por edhe eklipseve të plota, nëse nuk u kushtohet vëmendje, kalojnë pa u parë nga njerëzit. Pra, për këto dukuri dhe të tjera të ngjashme me to, njerëzit mund të mos kenë informacion.

Vetëm shkencëtarët që monitorojnë trupat qiellorë dhe Hënën, apo ata që rastësisht shohin nga qielli, kanë mundësi të

marrin informacion apo edhe të informojnë të tjerët për këto dukuri.

Si rrjedhim, dukuri të tilla që zgjasin pak kohë, nuk janë dhe aq tërheqëse për njerëzimin, sidomos për njerëzit e asaj kohe, që u kushtonin më pak rëndësi trupave qiellorë.

a) Përveç kësaj, në atë kohë nuk kishte shumë mjete dhe mënyra për regjistrimin dhe publikimin e tyre. Njerëzit e shkolluar ishin shumë të paktë, librat shkruheshin me dorë, etj. Të gjitha këto përbënin kufizime të mëdha për kohën. Asgjë nuk mund të krahasohet me ditët tona, kur madiet audiovizive kanë pushtuar çdo cep të botës. Duke pasur parasysh gjithë këtë kontekst, kuptohet fare mirë mospërmendja e këtyre çështjeve në historiografinë islame. Prandaj kjo mospërmendje nuk duhet të konsiderohet si argument për mohimin e këtyre dukurive.

4- Data e ndodhisë së kësaj ngjarjeje të madhe

"Çarja e Hënës" ka ndodhur në Mekë, para hixhretit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Komentuesit dhe hadithologët, nuk kanë dyshime për këtë. Por nga disa transmetime, përftohet se kjo dukuri ka ndodhur në fillim të misionit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[1]

Disa të tjerë mendojnë se ndodhia në fjalë, ka ndodhur afër hixhretit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe në fund të periudhës së Mekës.

[1] "Biharul Enuar", vëll. 17, Hadithi 2, f. 543.

Në transmetime të tjera, lexojmë se Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu propozua "çarja e Hënës" prej profetit që ata besonin, sepse idhujtarët mendonin se, meqë "magjia" ndikon në çështjet tokësore, ata dëshironin të siguroheshin se mrekullitë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk janë magji.".[1]

Madje edhe një grup fanatikësh kokëfortë, pasi panë me sytë e tyre këtë mrekulli të madhe, deklaruan se nuk do ta pranonin këtë mrekulli, pa i pyetur njerëzit e karvanëve të Shamit dhe të Jemenit, pasi ata të mbërrinin. Edhe pse udhëtarët e karvanëve pohuan se e kishin parë çarjen e Hënës, fanatikët sërish nuk e pranuan.[2]

Këtu nuk u trajtua fakti se kjo mrekulli e madhe, ashtu si shumë mrekulli të tjera, të përmendura në librat e historisë dhe transmetimet e dobëta, është përzier me besëtytni dhe trillime. Këto e kanë zbehur vërtetësinë e saj. Por këto sajesa duhet t'i pastrojmë dhe të lëmë të shkëlqejë e vërteta e mrekullisë.

[1] "Biharul Enuar", vëll. 17, Hadithi 10, f. 355.
[2] "Ed Drrr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 133.

Ajetet 4 – 8

وَلَقَدْ جَاءَهُمْ مِنَ الْأَنْبَاءِ مَا فِيهِ مُزْدَجَرٌ، حِكْمَةٌ بَالِغَةٌ فَمَا تُغْنِ النُّذُرُ، فَتَوَلَّ عَنْهُمْ يَوْمَ يَدْعُ الدَّاعِ إِلَى شَيْءٍ نُكُرٍ، خُشَّعًا أَبْصَارُهُمْ يَخْرُجُونَ مِنَ الْأَجْدَاثِ كَأَنَّهُمْ جَرَادٌ مُنْتَشِرٌ، مُهْطِعِينَ إِلَى الدَّاعِ يَقُولُ الْكَافِرُونَ هَذَا يَوْمٌ عَسِرٌ،

“Sigurisht që atyre u kanë ardhur histori për t’i prapësuar (nga e keqja)**”,**

“një urtësi e përsosur, por paralajmërimi nuk u bën dobi.”

“Prandaj, largohu nga ata (o Profet)**, deri Ditën, kur do t’i thërrasë Lajmëtari në diçka të tmerrshme.”**

“Me sy të përulur do të dalin nga varret, sikur të ishin karkaleca të shpërndarë”,

“duke shpejtuar drejt Lajmëtarit. Atëherë, mohuesit do të thonë: ‘Kjo është ditë e vështirë!’”

Komentimi

Atë ditë, të gjithë do të dalin nga varret

Ajetet e mëparshme flisnin për një grup politeistësh, që kishin përgënjeshtruar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe nuk u përulën kundrejt asnjë mrekullie.

Ajetet 4-8, do të diskutojnë për një grup politeistësh që kishin përgënjeshtruar profecinë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Përmes këtij diskutimi, tregohet fati i tyre i frikshëm në Ditën e Kiametit.

Ajeti 4 thotë: **"Sigurisht që atyre u kanë ardhur histori për t'i prapësuar** (nga e keqja)**."**.

Thirrësit hyjnorë nuk kanë reshtur së sqaruari këta politeistë, por ata nuk kanë treguar asnjë interes për të dëgjuar të vërtetën. Politeistët nuk i kanë pranuar dhe nuk i kanë vlerësuar këto sqarime hyjnore.

Kuptimi i fjalës *"enbaa"* - *"lajmet"*, përdoret për të treguar historitë e popujve të hershëm, të cilët u shkatërruan nga dënime të ndryshme. Në një kontekst më të gjerë kuptimor, këto lajme përfshijnë edhe ngjarjet që do të ndodhin në Ditën e Kiametit: dënimet e despotëve, të dhunuesve dhe të politeistëve. Këto Kur'ani i ka treguar mjaft qartë.

Ajeti 5 thotë se këto Shpallje janë një Urtësi e lartë hyjnore dhe paralajmërime të thella dhe të qarta, por këto paralajmërime

nuk janë të dobishme për këta njerëz kokëfortë dhe kryeneçë dhe nuk do t'u sjellin atyre ndonjë dobi: **"një urtësi e përsosur, por paralajmërimi nuk u bën dobi."**.[1]

Thënë shkurt: Të gjitha udhëzimet që përcillen nga ajetet hyjnore, nga Profetët e mëdhenj, lajmërimet në lidhje me popujt e mëparshëm, si dhe informacionet që u jepen atyre në lidhje me Kiametin, nuk kanë asnjë mangësi, sepse ato burojnë nga Pranuesi i tyre. Secila prej tyre përmban një urtësi të përsosur, që mund të depërtojë në shpirtin dhe zemrën e njerëzve, nëse janë sadopak të përgatitur shpirtërisht.

Në ajetin 6 thuhet se tani që këta të "devijuar", asnjëherë nuk janë të gatshëm të pranojnë të vërtetën, lërini në rehatin e tyre: **"Prandaj, largohu nga ata** (o Profet)**, deri Ditën, kur do t'i thërrasë Lajmëtari në diçka të tmerrshme."**.[2]

Fjalia : **"deri Ditën, kur do t'i thërrasë Lajmëtari"**, është ndarë nga fjalia: **"prandaj, largohu nga ata** (o Profet)**"**. Disa komentues e kanë konsideruar atë si fjali vazhdimësi të fjalisë pararendëse. Kuptimi i saj do të jetë: Në Ditën e Kiametit, kur do t'i thërrasë Lajmëtari dhe ata do të përulen përpara teje për ndërmjetësim, largohu nga ata. Ky komentim duket i papërshtatshëm.

---

[1] Fjala *"nudhur"* është shumësi i fjalës *"nedhir"*, që do të thotë *"paralajmëruesit"*, duke përfshirë Shpalljet hyjnore, historitë e rëndësishme të popujve të hershëm dhe Profetët, zëri i të cilëve kishte arritur te populli. Disa të tjerë kanë supozuar se fjala *"nudhur"* është paskajore dhe është në kuptimin e "paralajmërimit". Kuptimi i parë është më i përshtatshëm. Pjesëza *"ma"* te fjala *"ma tugni nudhur"*, është mohuese dhe jo pyetëse.

[2] Fjala *"jeumun"*, në ajetin e lartpërmendur, që i përket *"përmendjes"*, është lënë pa përmendur. Disa kanë supozuar se i përket fjalës *"jekhrixhun"*, por kjo duket e pamundur.

Vallë, ky "lajmëtar" është Zoti? Apo janë engjëjt e Tij? Apo është engjëlli Israfil, i cili, me anë të "fyerjes së Surit", i fton njerëzit në Ringjallje? Apo përfshihen të gjitha këto?

Komentuesit e Kur'anit kanë dhënë mendime të ndryshme, por, duke pasur parasysh ajetin 52 të sures "El Isra", që thotë: **"**(Ringjallja është) **Atë ditë kur Ai ju thërret, kurse ju i përgjigjeni të përulur dhe duke lavdëruar Atë, e ju duket se nuk qëndruat** (në dynja) **vetëm për pak kohë"**, kuptimi i parë duket më i përshtatshëm, edhe pse ajetet vijuese përputhen më shumë me kuptimin e dytë, që i pranon engjëjt si lajmëtarë dhe përgjegjësit e llogarisë dhe të shpërblimit.

Togfjalëshi *"shej'in nukur"* është përdorur me kuptimin e një çështjeje të panjohur, ose me kuptimin e kërkimit të saktë të llogarisë nga ana e Zotit deri në Ditën e Kiametit. Konteksti më i gjerë i kuptimit pranon se flitet edhe për dënime të panjohura për ta, flitet edhe se politeistët nuk i kishin besuar kurrë ato dënime. Kuptimi i përgjithshëm i pranon që të gjitha këto, sepse Kiameti është i panjohur për njerëzit.[1]

Ajeti vijues ka dhënë një shpjegim më të detajuar për këtë çështje: **"Me sy të përulur do të dalin nga varret, sikur të ishin karkaleca të shpërndarë…"**.

Togfjalëshi **"sy të përulur"**, ka kuptim metaforik dhe synon të tregojë se skena do të jetë aq e tmerrshme, saqë nuk do të kenë guxim dhe fuqi për ta shikuar atë, prandaj ata do t'i mbyllin sytë.

[1] Fjala *"nukurun"* është në njëjës dhe rrjedh nga fjala *"nekare"*. Kuptimi i saj, është: çështje e trishtueshme dhe e panjohur.

Krahasimi i tyre me karkalecat e shpërndarë bëhet, sepse karkalecat, kur fluturojnë, asnjëherë nuk sinkronizohen, nuk bëjnë lëvizje sipas rregullave të caktuara, siç bëjnë të gjithë zogjtë e tjerë. Prandaj thuhet se ata, ashtu si karkalecat, në atë Ditë, do të jenë gjallesa të dobëta, të pafuqishme dhe të çoroditura.

Këta symbyllur dhe të përhumbur në atë Ditë, do të frikësohen aq shumë, sa do të përplasen me nëri-tjetrin, njësoj si njerëzit e dehur. Ata do të shkojnë sa në një anë, në tjetrën, duke u përplasur me njëri–tjetrin, pothuaj se nuk janë vetvetja. Për këtë situatë flet ajeti 2 i sures "El Haxhxh": **"ndërsa njerëzit duken të dehur, por ata nuk janë të dehur."**.

Ky krahasim është i ngjashëm me atë që është përmendur në ajetin 4 të sures "El Karia": **"Ajo është Ditë, kur njerëzit bëhen si insekte të shpërndara."**.

Më pas po ai ajet, shton: **"…duke shpejtuar drejt Lajmëtarit."**.

Fjala *"muhti'ine"* rrjedh nga rrënja *"ihta'a"* dhe është përdorur me kuptimin e shpejtimit. Disa komentues e kanë interpretuar si shikim i ngulitur, ose vrapim me nxitim drejt një gjëje. Secili kuptim është i pranueshëm në komentimin e ajetit. Por kuptimi i parë duket më i përshtatshëm, sepse konteksti kuptimor i tij shpjegon se të njëjtën gjendje provojnë njerëzit, kur dëgjojnë zëra të frikshëm dhe trishtues. Ata nxitojnë rrëmujshëm, me vëmendjen e kthyer nga vijnë zërat. Për analogji, themi se edhe politeistët, sapo do të dëgjojnë zërin e Lajmëtarit të Zotit, do të shpejtojnë drejt tij. Më pas, shikojnë me vështrim të ngulitur, drejtohen drejt tij me nxitim dhe paraqiten përpara Gjyqit Hyjnor.

Ata janë të kapluar nga frika e ngjarjeve të vështira të asaj Dite, prandaj ajeti 8 vijon: **"Atëherë, mohuesit do të thonë: 'Kjo është ditë e vështirë!'"**.

Vërtet që është Ditë e Vështirë. Vështirësinë e asaj Dite, Zoti e ka treguar në ajetin 26 të sures "El Furkan": **"Atë ditë sundimi i vërtetë është i të Gjithëmëshirshmit, e ajo ditë për jobesimtarët do të jetë Ditë e Vështirë."**.

Por kjo Ditë, nuk do të jetë Ditë e vështirë për besimtarët!

Hulumtim

Pse Kiameti është një ditë shumë e vështirë?

Po, ajo do të jetë një Ditë e vështirë, sepse politeistët do të gjykohen për gjithçka kanë bërë. Atyre do t'u jepet në duart e tyre Libri i veprave që kanë kryer. Ata do të ngrenë zërin duke pohuar: **" Të mjerët ne, ç'është puna e këtij Libri që nuk na ka lënë as** (mëkat) **të vogël e as të madh pa e përfshirë?"**.[1]

Për çdo vepër të mirë apo të keqe që kanë kryer, sado e vogël qoftë ajo, do të japin llogari në mënyrë të detajuar dhe tejet të përpiktë: **"...s'ka dyshim se edhe nëse ajo** (vepra) **peshon sa kokrra e lirit, e të jetë e fshehur në rrasë guri, ose në qiej apo në**

[1] Sure "El Kehf", ajeti 49.

tokë, All'llahu do ta sjellë atë, se All'llahu është depërtues dhe hollësisht i informuar.".[1]

Së treti, atje nuk pranohet asnjë kërkim falje, asnjë kompensim dhe rruga e rikthimit është plotësisht e mbyllur. Këtë e tregon Kur'ani: **"Dhe ruajuni një Ditë kur askush askujt nuk do të mund t'i kryejë asgjë, kur nuk pranohet për të** (jobesimtarin) **ndonjë ndërmjetësim dhe nuk pranohet për të kompensim, e as që do të ndihmohen ata** (fajtorët)**."**.[2]

Në një koment tjetër, lexojmë: "E sikur t'i shihje ata, kur janë ndalur pranë Zjarrit e thonë: **'Ah sikur të ktheheshim** (në dynja)**, të mos gënjejmë faktet e Zotit tonë e të bëhemi nga besimtarët.'"**.[3]

Së katërti, dënimi hyjnor është aq i ashpër, saqë edhe nënat do të harrojnë fëmijët e tyre, shtatzanat do të abortojnë dhe njerëzit do të duken të dehur dhe të trullosur, nga ashpërsia e Dënimit të Zotit: **"Atë Ditë, kur ta përjetoni atë, secila gjidhënëse braktis atë që e ka për gjini dhe secila shtatzanë e hedh para kohe barrën e vet, ndërsa njerëzit duken të dehur, sado që nuk janë të dehur, por Dënimi i All'llahut është i ashpër."**.[4]

Për këtë arsye, mëkatarët do t'i ketë kapluar aq shumë ankthi dhe frika, saqë do të dëshirojnë të japin çdo gjë që ndodhet në këtë botë, vetëm e vetëm të shpëtojnë nga Dënimi Hyjnor. **"Edhe pse ata shihen ndërmjet vete** (edhe njihen, por ikin prej

[1] Sure "Lukman", ajeti 16.
[2] Sure "EL Bekare", ajeti 48.
[3] Sure "El En'am", ajeti 27.
[4] Sure "El Haxhxh", ajeti 2.

njëri–tjetrit)**. Krimineli dëshiron sikur të kishte paguar Dënimin e Asaj Dite me bijtë e vet. Dhe me gruan e vet dhe me vëllanë e vet. Edhe me të afërmit e tij që ai te ata mbështetej. Edhe me krejt çka ka në tokë, e vetëm të kishte shpëtuar! Jo, kurrsesi, ajo** (para) **është Ledhdha – Flaka** (emër i Xhehennemit)**. Është që heq kapakët e kokës."**.[1]

Me gjithë këto detaje kaq tronditëse, të treguara me saktësi në ajetet kur'anore, a është e mundur që ajo Ditë të mos jetë një ditë e vështirë e tejet e mundimshme dhe hidhëruese?

O Zot, të lutem, na mbro me Mëshirën Tënde në atë Ditë!

[1] Sure "El Mearixh", ajetet 11–16.

Ajetet 9 – 17

كَذَّبَتْ قَبْلَهُمْ قَوْمُ نُوحٍ فَكَذَّبُوا عَبْدَنَا وَقَالُوا مَجْنُونٌ وَازْدُجِرَ٩ فَدَعَا رَبَّهُ أَنِّي مَغْلُوبٌ فَانْتَصِرْ١٠ فَفَتَحْنَا أَبْوَابَ السَّمَاءِ بِمَاءٍ مُنْهَمِرٍ١١ وَفَجَّرْنَا الْأَرْضَ عُيُونًا فَالْتَقَى الْمَاءُ عَلَى أَمْرٍ قَدْ قُدِرَ١٢ وَحَمَلْنَاهُ عَلَى ذَاتِ أَلْوَاحٍ وَدُسُرٍ١٣ تَجْرِي بِأَعْيُنِنَا جَزَاءً لِمَنْ كَانَ كُفِرَ١٤ وَلَقَدْ تَرَكْنَاهَا آيَةً فَهَلْ مِنْ مُدَّكِرٍ١٥ فَكَيْفَ كَانَ عَذَابِي وَنُذُرِ١٦ وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ مُدَّكِرٍ١٧

“Para tyre (i) **ka përgënjeshtëruar** (shenjat Tona) **populli i Nuhut. Ata e quanin gënjeshtar robin Tonë** (Nuhun), **i thoshin ‘i çmendur’, e pengonin dhe e kërcënonin.”**

“Kështu, ai iu lut Zotit të vet: ‘Unë jam i mundur, andaj më ndihmo!’”

“Dhe Ne i hapëm dyert e qiellit me ujë të rrëmbyeshëm.”

“Dhe i shpërthyem burimet e tokës, e u takuan ujërat për një qëllim të paracaktuar.”

“Ndërsa Nuhun e bartëm në një barkë (të ndërtuar) **prej dërrasash dhe gozhdësh”,**

"e cila lundronte nën Sytë Tanë: si shpërblim për atë *(Nuhun/ Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* **i cili u mohua."**

"Ne e kemi bërë atë si shenjë, por a ka kush që ia vë veshin?"

"Eh, sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia!"

"Vërtet, Ne e kemi bërë Kur'anin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!"

Komentimi

Ndodhia e popullit të Nuhit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte një mësim këshillëdhënës

Kur'ani e ka në traditë që, së pari, të paralajmëron. Edhe politeistët e kriminelët i paralajmëroi, që të mos ndiqnin rrugën e devijuar. Nëse do të ndiqnin atë rrugë, do të ndëshkoheshin në mënyrë të frikshme. Pasi i paralajmëron, bën edhe një përshkrim të historive të popujve të kaluar dhe fatit të tyre ogurzi dhe të dhimbshëm, të cilët kishin ndjekur udhën e devijuar. Paralajmërimin e bën në mënyrë që nëpërmjet tij, njerëzit të kuptojnë se, nëse e pasojnë rrugën e tyre të devijuar, as ata nuk do të kenë fat më të mirë se të tjerët.

Në këtë sure tregohet se populli i parë rebel (nga të pesë popujt) që u dënua, ishte populli i Nuhut *(Paqja e All'llahut qoftë*

mbi të!). Ajeti 9 thotë: **"Para tyre** (i) **ka përgënjeshtëruar** (shenjat Tona) **populli i Nuhut."**.

Populli i Nuhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* përgënjeshtroi robin tonë, Nuhun dhe thanë: "Ai është një burrë i çmendur!" Më pas, me lloj-lloj torturash dhe sjelljesh të dhunshme, e penguan atë që të vazhdojë misionin e tij: **"Ata e quanin gënjeshtar robin Tonë** (Nuhun)**, i thoshin 'i çmendur', e pengonin dhe e kërcënonin."**.

Ndonjëherë atij i thoshin: **"O Nuh! Në se nuk heq dorë nga ajo që mëson, do të gurëzohesh!"**.[1]

Herë të tjera ia shtrëngonin aq shumë fytin, sa binte pa ndjenja për tokë, por sa bëhej i vetëdijshëm, përsëri ai thoshte: **"O Zot, fale popullin tim, se ai nuk di!"**.[2]

Thënë shkurt, atë e torturonin dhe e ngacmonin me çdo mënyrë, por ai kurrë nuk hoqi dorë nga misioni i vet.

Në këtë ajet, dy herë është përmendur fjala "përgënjeshtrim". Kjo mbase për faktin se herën e parë është përmendur përmbledhtazi, kurse herën e dytë me një përshkrim më të plotë.

Fjala *"abdena"* – **"robin Tonë"**, përdoret për të treguar se ky popull arrogant dhe rebel kundërshtitë i kishin me Zotin e jo me Profetin Nuh *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

[1] Sure "Esh Shuara", ajeti 116.
[2] Tefsiri "Keshshaf" dhe "Ebul Fetuh Razi", ajetet në fjalë.

Folja *"uezduxhir"* rrjedh nga fjala *"zexhr"* dhe tregon largimin e një personi nga vetja me anë të bërtitjes. Por përdoret edhe për çdo lloj vepre që ka për synim ndalimin e një personi nga vazhdimi i kryerjes së një pune. Këtu përdoret në kontekstin e përpjekjeve për të larguar Profetin Nuhi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, përmes torturave dhe të bërtiturave, aq sa Zoti i Madhëruar nuk e përmend as emrin e këtij grupi dhe ata nuk i konsideron si të denjë për t'u përmendur.

Më pas shton se kur Profeti Nuh *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i humbi shpresat për udhëzimin e tyre, iu drejtua Zotit: **"Unë jam i mundur, andaj më ndihmo!"**.

Ata asnjëherë nuk më mposhtën mua përmes arsyes, argumenteve dhe dëshmive, por më kanë mposhtur vetëm me anë të dhunës, krimit, përgënjeshtrimit, mohimit, torturave dhe presioneve. Ky popull nuk e meriton më jetën, hakmerru ndaj tyre dhe më bëj që të dominoj mbi ta.[1]

Po, ky i Dërguar i madh, përsëri nuk i kishte humbur shpresat se ata mund të ndryshonin, prandaj kërkonte nga Zoti që t'i falte ata. Por, në fund i humbi shpresat dhe i mallkoi ata, duke përshkruar edhe mënyrën e dënimit të tyre: **"Dhe Ne i hapëm dyert e qiellit me ujë të rrëmbyeshëm"**.

Fjalia : **"i hapëm dyert e qiellit"** përdoret për të treguar rënien e shiut të rrëmbyeshëm.

[1] Fjala *"intesir"* është në kuptimin e kërkimit të ndihmës (ashtu siç është thënë edhe në ajetin 41 të sures "Esh Shuara"), por këtu është komentuar në kuptimin e hakmarrjes, hakmarrje mbi llogarinë e drejtësisë dhe urtësisë. Disa kanë pohuar se kështu ka qenë: *"intesir li"*, që do të thotë, *"më ndihmo mua"*.

Fjala *"munhemirun"* rrjedh nga fjala *"hemr"* dhe përdoret për të treguar rënien e rrëmbyeshme të ujit, apo të lotëve. Kjo shprehje përdoret edhe për mjeljen e gjirit të kafshëve, deri në pikën e fundit.

Në disa thënie të komentuesve, është deklaruar se ata kishin pritur me vite të tëra të binte shi, që të largonte thatësirën që i kishte kapluar. Papritur u erdhi një shi aq i rrëmbyer, saqë shkaktoi vdekje dhe nuk solli jetë.[1]

Jo vetëm nga qielli zbriti shi i përmasave të paimagjinueshme, por edhe nga toka shpërtheu uji. Në ajet thuhet: **"...dhe i shpërthyem burimet e tokës, e u takuan ujërat për një qëllim të paracaktuar."**.

Komentuesit e Kur'anit togfjalëshin: **"për një qëllim të paracaktuar"**, e kanë përdorur edhe për të treguar se këto dy ujëra ishin në masë të njëjtë me njëri–tjetrin. Komentimi i parë duket më i përshtatshëm.

Thënë shkurt, uji filloi të rrjedhë nga qielli dhe nga toka dhe u formua një det dhe një stuhi përpirëse.

Këtu Kur'ani e ndërpret "rrëfimin" për stuhinë dhe tufanin e madh, sepse u tha gjithçka që kishte lidhje për të. Më tej diskutohet për anijen e shpëtimit të Nuhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Ajeti thotë: **"Ndërsa Nuhun e bartëm në një barkë** (të ndërtuar) **prej dërrasash dhe gozhdësh."**.

[1] "Ruhul Meanij", ajeti në fjalë.

Fjala "*dusur*" është shumësi i fjalës "*disaar*" dhe, siç është shprehur Ragibi, në veprën "Mufredat", fjala, në thelb, tregon kuptimin e dëbimit të ashpër, të shoqëruar me hidhërim.

Sidoqoftë, Kur'ani, në mënyrë tepër interesante dhe domethënëse, thotë se në dallgët e asaj stuhie të madhe dhe të gjithanshme, që kishte përfshirë çdo gjë, shpëtimin e Nuhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe të ndjekësve të tij, e lamë në dorë të një grushti gozhdësh dhe dërrasash. Ata e kryen më së miri dhe me mjaft përgjegjësi detyrën e tyre.

Ky është një tregues i Fuqisë së Madhërishme.

Megjithëse për anijen që shpëtoi Nuhun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* flitet me modesti, për ndërtimin e saj, Nuhu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* harxhoi shumë kohë. E bëri aq të madhe, sa të fuste brenda saj nga një çift nga secila kafshë.

Më pas, Zoti i Madhëruar tregon se anija që po shpëtonte Profetin Nuh *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte nën kujdesin e Tij. Për këtë ajeti thotë: **"lundronte nën Sytë**[1] **Tanë"**. Togfjalëshi "*bia'ajunina*" - **"nën sytë Tanë"**, përdoret për të treguar vëmendjen e veçantë dhe kujdesin e plotë ndaj një gjëje. Në ajetin 37 të sures "Hud", në një pjesë tjetër të po këtij tregimi, lexojmë: **"E, mbroje anijen nën mbikëqyrjen Tonë dhe me Shpalljen Tonë...."**.

[1] Pra, nën mbikëqyrjen dhe kujdesin Tonë.

Disa komentues, këtë shprehje e lidhin me përpjekjet për të shpëtuar disa personalitete, të cilët kishin hipur në anije.[1] Fjalia *"texhri bia'ajunina"* do të thotë se ajo anije do të mbartte me vete robtë Tanë të sinqertë dhe të pastër. Por duke pasur parasysh përdorimet e kësaj shprehjeje, në ajetet e tjera kur'anore, komentimi i parë duket më i saktë.

Është supozuar se fjala *"bia'ajunina"* të aludojë për engjëjt, të cilët ishin të përfshirë në çështjen e drejtimit të anijes së Profetit Nuh *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Edhe ky interpretim, për po atë arsye që u tha më lart, është i papërfillshëm.

Më pas, ajeti shton se të gjitha këto ishin: **"si shpërblim për atë** (Nuhun/*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) **i cili u mohua."**.[2]

Po, Profeti Nuh *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, si të gjithë të Dërguarit e tjerë, ishte një prej dhuntive të mëdha të Zotit dhe begati madhore për njerëzit, por njerëzit e përhumbur u treguan mosmirënjohës ndaj tij dhe mohuan fenë e tij.

Më pas, si përfundim nga kjo ngjarjeje madhështore, ajeti thotë se e kemi lënë në mesin e popullit, që të jetë mësim dhe një shenjë për ta: **"Ne e kemi bërë atë si shenjë, por a ka kush që ia vë veshin?"**.

---

[1] Fjala *"eajejn"* është shumësi i fjalës *"ajn"*. Njëra prej kuptimeve të tij, është syri. Kuptimi tjetër i tij, është njeriu me personalitet. Sigurisht që ka edhe kuptime të tjera.

[2] Duhet të kemi parasysh faktin se këtu fjala *"kufr"* është në formën e foljes së pashquar dhe është shenjë për Profetin Nuh *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, që ndaj tij u bënë politeist. Nuk është folje e shquar, që të jetë shenjë për jobesimtarët.

Në bazë të këtij komentimi, që përputhet me ajetet pararendëse dhe pasrendëse, përemri në "*tereknaha*" përdoret me kuptimin "*i rikthehet historisë së stuhisë*" dhe të kaluarës së Profetit Nuh *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe kundërshtarëve të tij. Disa komentues të tjerë janë të mendimit se përemri i referohet "barkës së shpëtimit", sepse kjo anije, për një kohë të gjatë, ishte ekspozuar për të gjithë njerëzit në këtë botë, që të hipnin në të. Gjithë ngjarja e Profetit Nuh *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* zhvillohet para syve, sidomos nëse e pranojmë transmetimin, sipas së cilit pjesët e mbetura të kësaj anijeje vazhdonin të qëndronin deri në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Disa njerëz pretendojnë se mbetjet e saj, i kanë parë në majën Ararat të Kaukazit.

Gjithashtu, mund të supozohet se ajeti pranon të dy kuptimet, pra, si tregimin e Nuhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, ashtu edhe mendimin se mbetjet e anijes së tij në mesin e popullit janë shenjë këshillëdhënëse.[1]

Në ajetin vijues, politeistët pyeten me një pyetje kërcënuese dhe domethënëse: **"Eh, sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia!"**.

Në ajetin 17 theksohet: **"Vërtet, Ne e kemi bërë Kur'anin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!"**.

Kur'ani nuk ka asnjë lloj shtrembërimi. Kur'ani është i përsosur për të qenë ndikues. Fjalët e tij janë të ëmbla dhe tërheqëse, shprehjet e tij janë të gjalla dhe domethënëse,

[1] Në lidhje me ndodhinë e popullit të Nuhit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kemi diskutuar më gjerësisht në ajetet 25–49 të sures "Hud", f. 68–125.

paralajmërimet dhe përgëzimet janë të qarta dhe të kuptueshme, tregimet e tij janë të vërteta dhe kuptimplota, argumentet e tij janë të forta dhe të qëndrueshme, logjika e tij është e bukur dhe e qetë. Thënë shkurt, te Kur'ani, çdo gjë që mbartet aty, është e përsosur për t'u marrë shembull dhe për të ndikuar të lexuesit e Tij. Për këtë arsye, sa herë që zemrat e përgatitura krijojnë lidhje me të, magjepsen pas tij. Gjatë historisë islame janë vërejtur shumë shembuj mbresëlënës dhe surprizues nga ndikimi i thellë i Kur'anit në zemrat e përgatitura, të cilat janë dëshmi vitale të kësaj çështjeje.

Por a mund të ngjizet fara e vdekur? Edhe nëse e mbjellim atë në tokat më të kultivuara dhe për të kujdeset kopshtari më i mirë e ujitet nga burimi i Keutherit, sërish nuk do të mbinte dhe nuk do të çelte lule dhe bimë prej saj.

Ajetet 18 – 22

كَذَّبَتْ عَادٌ فَكَيْفَ كَانَ عَذَابِي وَنُذُرِ ١٨ إِنَّا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ رِيحًا صَرْصَرًا فِي يَوْمِ نَحْسٍ مُسْتَمِرٍّ ١٩ تَنْزِعُ النَّاسَ كَأَنَّهُمْ أَعْجَازُ نَخْلٍ مُنْقَعِرٍ ٢٠ فَكَيْفَ كَانَ عَذَابِي وَنُذُرِ ٢١ وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ مُدَّكِرٍ ٢٢

"Edhe fisi Ad e quajti gënjeshtar (të Dërguarin Tonë)**, por sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia!"**

"Ne u dërguam atyre në një ditë fatkeqe një erë të stuhishme të pandërprerë",

" e cila i nxirrte njerëzit, sikur të ishin trungje të shkulura hurmash."

"Eh, sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia!"

"Vërtet, Ne e kemi bërë Kur'anin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!"

Komentimi

I tillë ishte edhe fati i popullit të Adit

Pas rrëfimeve për historinë e popullit të Profetit Nuh *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në këtë sure flitet edhe për një popull tjetër. Flitet për popullin e Adit. Këtë popull, Kur'ani, në këto ajete që po i diskutojmë, e përmend kalimthi. Përmendja e historisë së atij populli, shërben edhe si një paralajmërim ndaj politeistëve e keqbërësve. Kur'ani thotë: **"Edhe fisi Ad e quajti gënjeshtar** (të Dërguarin Tonë)**."**. Megjithëse Profeti i tyre, Hudi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, i ftonte ata në Rrugën e Drejtë dhe në mënyra të ndryshme përpiqej për zgjimin e tyre, ata i shtonin edhe më shumë marrëzitë dhe kokëfortësinë e tyre. Arroganca e tyre, e lindur nga pasuria dhe bollëku, si dhe neglizhenca që buronte nga zhytja totale në epshe dhe dëfrime të ulëta, ua kishin verbuar sytë dhe ua kishin shurdhuar veshët.

Në fund, Zoti i Madhëruar i dënoi ata me një dënim të dhimbshëm, prandaj, në vazhdimësi të po këtij ajeti, në mënyrë lakonike, ajeti thotë: **"...por sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia!"**.

Në ajetin vijues, Zoti e ka qartësuar më tej këtë çështjeje**:** **"Ne u dërguam atyre në një ditë fatkeqe një erë të stuhishme të pandërprerë..."**.

Fjala *"sarsara"* rrjedh nga rrënja *"sar"* dhe është përdorur me kuptimin e mbylljes dhe të forcimit, kurse përsëritja e saj në formën *"sar sara"* është përdorur me kuptimin e theksimit, ngaqë

kjo stuhi ishte edhe e fuqishme, edhe e akullt, si edhe shumë djegëse dhe e zhurmshme. Prandaj kjo fjalë është përdorur me ato kuptime.

Fjala *"nehs"* përdoret me kuptimin e ngjyrës së kuqe të ndezur, e cila ndonjëherë shfaqet në horizont si flaka e zjarrit pa tym. Këtë arabët e quajnë *"nahas"*. Më pas, kjo fjalë është përdorur për çdo gjë të shëmtuar (famëkeqe) karshi "lumturisë".

Fjala *"mustemir"* është një tipar për fjalën *"jeum"* ose për fjalën *"nahs"*. Në rastin e parë, kuptimi i saj do të ishte: "ngjarjet e asaj dite, po ashtu vazhduan" siç thuhet edhe në ajetin 7 të sures "El Hakka": **"Atë Ai e lëshoi kundër tyre shtatë net e tetë ditë rresht, kur i shihje njerëzit në to të rrëzuar si të ishin trupa hurmash të zgavruara."**.

Në rastin e dytë, kuptimi i saj do të ishte: "fatkeqësia e kësaj dite vazhdoi, derisa i asgjësoi të gjithë."

Komentues të tjerë, fjalën *"nehs"* e kanë interpretuar në kuptimin e "vorbullës së plotë të pluhurit", sepse era e stuhishme ishte tejet e pluhurosur, saqë nuk mund të shihnin njëri-tjetrin. Kur e panë atë erë nga larg, menduan se drejt tyre po vinte një re e mbarsur me shi, por shpejt e kuptuan që ishte një erë e stuhishme, që kishte për synim dënimin dhe asgjësimin e tyre. Kjo sqarohet që në ajeitn 24 të sures "El Ahkaf": **"E kur e panë të paraqitur** (renë) **të drejtuar kah luginat e tyre, thanë: 'Kjo re do të na sjellë shi!'. Jo, kjo është ajo që ju e kërkuat sa më shpejtë, një erë** (shtrëngatë) **me një dënim të dhembshëm."**.

Këto dy interpretime nuk bien ndesh me njëra–tjetrën dhe është e mundur që të dy këto interpretime të afrohen me kuptimin e ajetit.

Në përshkrimin e mëtejshëm të kësaj ere të stuhishme, ajeti shton: **"E cila i nxirrte njerëzit, sikur të ishin trungje të shkulura hurmash."**.

Fjala *"munkair"* rrjedh nga rrënja *"ka'ar"*. Ajo tregon pjesën më të ulët të një objekti, prandaj përdoret edhe me kuptimin e shkuljes.

Ky përdorim lidhej me faktin se populli i Adit kishte gjymtyrë të forta dhe trup të madh. Disa komentues të Kur'anit kanë thënë se ata (populli i Adit), për t'u mbrojtur nga stuhia, kishin ndërtuar gropa dhe strehimore nëntokësore, por fuqia e shtrëngatës atë ditë ishte aq e fuqishme, sa i shkuli nga strehimet e tyre dhe i hidhte sa këndej sa andej. Komentuesit kanë pohuar se stuhia ishte aq e fortë sa i hidhte fuqishëm mbi tokë dhe koka e tyre ndahej nga trupi.

Fjala *"a'xhaz"* është shumësi i fjalës *"ixhz"*. Kjo fjalë është përdorur me kuptimin e anës së prapme, apo pjesës së fundit të një gjëje. Trupat e popullit të Adit mbetën të sakatosur nga ajo stuhi. Era e fuqishme i ndau trupat e tyre nga duart dhe koka, të cilat ua mori me vete. Trupat e copëtuar ngjanin me pjesën e fundme të hurmave, kur ngelen pa degë e gjethe nga erërat dimërore.

Më pas, Kur'ani, në shenjë paralajmërimi, thotë: **"Eh, sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia!"**.

Ne kështu vepruam edhe me popujt e tjerë, të cilët kishin ndërmarrë rrugën e përgënjeshtrimit, të arrogancës, të mendjemadhësisë, të mëkatit dhe të rebelimit. Tani çfarë mendoni për veten tuaj, ju që ndiqni rrugën e tyre?

Në fund të kësaj ngjarjeje, shton: **"Vërtet, Ne e kemi bërë Kur'anin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!"**.

Fjalia: **"Eh, sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia!"**, është përsëritur dy herë. Të dy herët në lidhje me popullin e Adit. Një herë në fillim të shtjellimit të kësaj historie dhe një herë tjetër në fund të saj. Ky theksim mund të jetë bërë për arsye se dënimi i këtij grupi ishte më i rëndë dhe më i ashpër se i të tjerëve dhe dënimet e Zotit janë të ashpra dhe të rënda.

Hulumtim

Ditët e "bekuara" dhe "fatkeqe"

Në jetën njerëzore ndodh shpesh, që disa ditë të jenë të veçanta. Disa prej tyre të jenë të mbushura me bekime e begati, ditë fatlume, kurse ditë të tjera të jenë plot dhimbje e fatkeqësi, ditë ogurzeza. Mes tyre ka shumë ndryshime. Por ato, edhe Islami i ka pranuar. Mund të pyesim, se ku e kanë origjinën. A e kanë origjinën në Islam?!

Një përgjigje e pranueshme, e mbështetur në logjikë dhe arsye, se në jetën njerëzore ndodhin të gjitha, do të ishte: Sigurisht, është e mundur, por nuk është e provuar.

Nëse këtë e argumentojmë me fakte fetare përmes Shpalljes hyjnore, pranimi i saj jo vetëm nuk pengohet, por do të ishte i nevojshëm.

Në ajete kur'anore, vetëm në dy raste është diskutuar për "ditët fatzeza".

Njëri rast janë në ajetet që diskutuam dhe rasti tjetër në ajetin 16 të sures "Fussilet", i cili diskuton për popullin e Adit. Ajeti thotë: **"Andaj Ne kundër tyre lëshuam një erë të ftohtë gjatë disa Ditëve fatzeza për t'u dhënë të përjetojnë Dënimin nënçmues në Jetën e Kësaj Bote..."**.[1]

Në ajete të tjera kur'anore diskutohet për "ditët e bekuara dhe fatlume". Kjo pohohet për Natën e Kadrit. Ajeti thotë: **"Ne e zbritëm Atë në Një Natë të Bekuar** (në Natën e Begatshme të Kadrit)**."**.[2]

E trajtuam edhe më sipër se fjala *"nehs"* është përdorur me kuptimin e skuqjes së jashtëzakonshme të horizontit. Kur horizonti merr ngjyrën e kuqe, thuhet se mori ngjyrën e *"nehasit"*, pra, "të flakës së zjarrit të spastruar nga tymi". Për këtë arsye, pse

[1] Duhet të kemi parasysh se fjala *"nehesat"*, në këtë ajet, është cilësi për "ditët". Kjo do të thotë se ditët e përmendura, janë përshkruar si fatzeza, ndërkohë që në ajetet që po diskutojmë, te fjalia *"fi jemumi nehsi mustemir"*, fjala *"jeum"* i është shtuar fjalës *"nehs"* dhe nuk është në kuptimin e përshkrimit. Megjithatë nëse e marrim si simetri të ajetit të lartpërmendur, duhet të pohojmë që këtu është në kuptimin e shtimit të emrit ndaj mbiemrit.

[2] Sure "Ed Dukhan", ajeti 3.

përdor kuptimin e flakës së pastër, thuhet se i ra zjarri i kulluar, e mbuloi fatkeqësia dhe tersllëku.

Kur'ani është mjaftuar vetëm me përmendjen lakonike të kësaj shprehje. Por, në transmetimet islame, hasim raste të shumta të lidhura me frazat "ditët fatzeza" dhe "ditët fatlume". Pjesa dërmuese e atyre transmetimeve mund të jenë transmetime të dobëta, ose të përziera me besëtytni dhe transmetime të rreme. Por nuk janë kësisoj të gjitha transmetimet. Mes tyre ekzistojnë edhe transmetime të vlefshme dhe të pranueshme. Këtë qëndrim e kanë miratuar edhe komentuesit e Kur'anit.

Hadithologu i njohur, Al'lame Mexhlisij, në veprën "Biharul Enuar", ka përmendur shumë hadithe në lidhje me këtë çështje.[1]

Lidhur me këtë, mund të themi:

a) Në shumë hadithe "ditët fatlume" dhe "ditët fatzeza" janë interpretuar të lidhura me ngjarjet që kanë ndodhur atë ditë. P.sh: në një hadith të transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* lexojmë: "Një person kërkoi nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, që t'i jepte ndonjë sqarim në lidhje me negativitetin e "ditës së martë" dhe cila e martë identifikohet me të.

Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* tha: "*Synimi është e marta e fundit e muajit. Në atë të martë është mehaku (tri netët e fundit të muajit hënor, kur hëna është e padukshme). Në po këtë ditë,*

[1] "Biharul Enuar", vëll. 59, "Kitabus semauel alem", f. 1-91 dhe një pjesë pas saj.

Kabili e vrau vëllanë e vet, Habilin. Zoti i Madhëruar, në këtë ditë të martë dërgoi stuhi të fuqishme mbi popullin e Adit.”.[1]

Prandaj pjesa dërmuese e komentuesve të Kur’anit, duke pasur parasysh shumë transmetime, të martën e fundit të çdo muaji e konsiderojnë si një ditë ters, si një ditë të pa fat. Këtë e përmendin me shprehjen “erbeau la teduur”, që do të thotë (dita e martë që nuk përsëritet tjetër).

Në disa transmetime të tjera, lexojmë se dita e parë e muajit, është një ditë e bekuar dhe fatlume, sepse në këtë ditë ka lindur Ademi *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)*. Ditë e bekuar është edhe dita e 26-të e muajit, sepse atë ditë Zoti i Madhëruar e çau detin përgjysmë për Profetin Musa *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)*.[2]

Dita e tretë e muajit, është ditë tersi dhe e pafat, sepse në këtë ditë Ademi dhe Havaja u dëbuan nga Xhenneti dhe ua hoqën rrobat e Parajsës nga trupi i tyre.[3]

Dita e shtatë e muajit është ditë e bekuar, sepse atë ditë Nuhu *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* hipi në anije dhe shpëtoi nga përmbytja.[4]

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)*, që bën fjalë për Nevruzin, lexojmë: “Nevruzi është një ditë e Bekuar, sepse atë ditë, anija e Nuhut *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* filloi nisjen dhe Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në po

[1] Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 5, f. 182.
[2] Po aty, f. 105–106.
[3] Po aty, f. 58.
[4] Po aty, f. 61.

këtë ditë, iu shfaq Xhebraili. Është kjo dita, kur Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* hipi mbi supet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe theu idhujt e Qabes. Në këtë ditë ndodhi edhe ngjarja e Gardir Khumit, që, gjithashtu, përkon me Nevruzin.".[1]

Shprehje të tilla i hasim në shumë transmetime, ku bekimi dhe fatkeqësia e ndodhur në ditë të zakonshme, lidhet me disa nga ngjarjet pozitive apo negative të jetës shoqërore, p.sh: në Ditën e Hashures, supozohet se Beni Umeje dominoi mbi Ehli Bejtin, prandaj këtë ditë e konsiderojnë si një ditë gëzimi, ndërkohë që në transmetimet islame është ndaluar rreptësisht emërimi i kësaj dite si e bekuar. Madje, kanë urdhëruar që në këtë ditë të mos punohet për sigurimin e ushqimit dhe të pasurisë, por të hiqet dorë nga puna dhe tregtia dhe njerëzit të distancohen nga programi i Beni Umejes.

Tërësia e këtyre haditheve, është bërë shkak që disa dijetarë, çështjen e "ditëve fatlume" dhe "të ditëve fatkeqe" ta komentojnë në këtë mënyrë: "Synimi i Islamit është të tërheqë vëmendjen e myslimanëve ndaj këtyre ngjarjeve dhe ta vënë veten e tyre përballë tyre, të përfitojnë mesazhet edukative që përcjellin ato dhe të distancohen nga ngjarjet e padëshiruara dhe negative.

Ky komentim pranohet si i saktë, në lidhje me një pjesë të këtyre transmetimeve, por jo në lidhje me të gjithë ato. Ky diskutim nuk është shterues, sepse mund të mos jemi në dijeni të të gjithë informacioneve që lidhen me to.

[1] "Biharul Enuar", vëll. 59, vëll. 1, kreu "Jeume nuruz", f. 92.

a) Në ditët tona, çdo vepër që duan të kryejnë njerëzit, e paramendojnë se si rakordon ajo me "ditët e zeza" dhe "ditët fatlume". Mbështetur në këto paramendime, njerëzit heqin dorë nga shumë veprimtari të përditshme.

b) Në vend që të analizojnë faktorët e humbjes apo të fitores së tyre, të shfrytëzojnë përvojat e jetës, fajin e humbjeve ua hedhin ditëve fatkeqe, po ashtu edhe fitoret i lidhin me ditët fatlume.

Kjo logjikë është një lloj arratie nga realiteti dhe çuarje në ekstrem të çështjes. Përshkrimi i mbështetur në të tilla besëtytni, për veprimet jetësore, nuk është i drejtë. Njerëzit duhet të qëndrojnë larg këtyre mendimeve, të mos marrin në konsideratë thashethemet, as fjalët e astronomëve, as parashikimet e fallxhorëve. Vetëm nëse në ndonjë hadith autentik dhe të saktë është thënë ndonjë gjë në lidhje me këtë çështje, atëherë e pranojmë atë, në të kundërt, jo! Njeriu duhet të kërkojë ndihmë dhe mbështetje vetëm te All'llahu i Madhëruar, te Mëshira dhe Mirësia e Tij.

c) Diskutimi rreth ditëve fatkeqe dhe të bekuara, duhet ta ndërgjegjësojë njeriun ta kthejë vëmendjen te Zoti i Gjithëdijshëm dhe të kërkojë ndihmë nga Ai. Si rrjedhim, në shumë transmetime lexojmë: "Edhe në ditët që janë emëruar si ditë "fatkeqe" mund të fitoni mbi to duke kërkuar ndihmë nga Zoti, duke lexuar Kur'an, duke dhënë lëmoshë, duke thënë ndonjë lutje dhe duke u mbështetur në esencën, në Qenien e Stërpastër të Zotit."

Në një hadith lexojmë se njëri nga shokët e Imam Hasan Askariut i erdhi për vizitë ditën e martë. Imami i tha: "*Dje nuk të pashë."*

Ai ia ktheu: "Ishte e hënë dhe unë këtë ditë e konsideroj si të pafat!"

Imami tha: "*Ai që dëshiron të jetë i mbrojtur nga ligësia e ditës së hënë, në rekatin e parë të namazit të sabahut, të këndojë suren "Hel eta"*.[1]

Më pas, Imami e këndoi këtë ajet (që përputhet me largimin e së keqes) dhe tha: **"Po All'llahu i ruajti ata prej sherrit të Asaj Dite dhe u Dhuroi shkëlqimin në fytyra e gëzim të madh."**.[2]

Në një hadith tjetër lexojmë se njëri nga shokët e Imamit të gjashtë e pyeti atë: "Vallë, a është i përshtatshëm udhëtimi në ditët ters?"

Imami u përgjigj*: "Udhëtimin filloje me dhënien e lëmoshës dhe këndimin e Ajetit Kursij dhe shko ku të duash."*.[3]

Në një hadith tjetër, thuhet se njëri nga shokët e Imamit të dhjetë, Imam Hadit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, rrëfen: "Shkova pranë Imamit, ndërkohë që gjatë rrugës kisha vrarë gishtin. Një kalorës më vrau shpatullën dhe më pas u rrethova në mesin e turmës njerëzore dhe m'u grisën rrobat. Unë thashë me vete: 'Të më mbrojë Zoti nga sherri i kësaj dite, çfarë dite e tmerrshme që je!'"

[1] Sure "Insan"
[2] "Biharul Enuar", vëll. 59, Hadithi 7, f. 49.
[3] Po aty, Hadithi 11, f. 28.

Imami më tha: "*Ke lidhje me ne dhe po thua gjëra të tilla. E konsideron fajtor ditën që nuk ka asnjë faj.*"

Burri, sapo dëgjoi këto fjalë, u bind dhe e kuptoi gabimin që kishte bërë dhe tha: "O Prijësi im! Unë pendohem dhe do të kërkoj falje nga Zoti i Madhëruar."

Imami shtoi: "*Ç'faj kanë ditët? I konsideroni si fatzeza, në kohën që në këto ditë ndesheni me ndëshkimin e mëkateve (veprave) tuaja.*"

Transmetuesi tregoi se dëgjuesi tha se përgjithnjë do të kërkoj falje nga Zoti dhe ky është pendimi im, o djali i të Dërguarit të Zotit!

Imami tha: "*Kjo nuk sjell ndonjë dobi. Zoti do t'ju ndëshkojë ju për qortimin e asaj që nuk meriton qortim. A nuk e di ti, që Zoti shpërblen dhe ndëshkon dhe jep shpërblimin dhe dënimin e merituar sipas veprave që ke kryer jo vetëm në këtë botë, por edhe në Botën Tjetër? Mos e përsërit tjetër herë një gjë të tillë dhe mos u jep ditëve ndonjë punë apo ndikim përballë gjykimit të Zotit.*".[1]

Ky hadith tregon se ditët do të kishin ndonjë ndikim, vetëm nëse ajo është Urdhri i Zotit. Asnjëherë nuk duhet ta konsiderojmë si të panevojshme Mirësinë e Zotit. Asnjëherë nuk duhet t'i kërkojmë humbjet apo fitoret tona te ditët.

Ky përfundim është me i drejti dhe afron hadithet e ndryshme në këtë kapitull.

[1] "Tuheful Ukul", f. 482; "Biharul Enuar", vëll. 59, Hadithi 6, f. 2 (me pak ndryshim).

Ajetet 23 – 32

كَذَّبَتْ ثَمُودُ بِالنُّذُرِ٢٣ فَقَالُوا أَبَشَرًا مِنَّا وَاحِدًا نَتَّبِعُهُ إِنَّا إِذًا لَفِي
ضَلَالٍ وَسُعُرٍ٢٤ أَأُلْقِيَ الذِّكْرُ عَلَيْهِ مِنْ بَيْنِنَا بَلْ هُوَ كَذَّابٌ أَشِرٌ٢٥
سَيَعْلَمُونَ غَدًا مَنِ الْكَذَّابُ الْأَشِرُ٢٦ إِنَّا مُرْسِلُو النَّاقَةِ فِتْنَةً لَهُمْ
فَارْتَقِبْهُمْ وَاصْطَبِرْ٢٧ وَنَبِّئْهُمْ أَنَّ الْمَاءَ قِسْمَةٌ بَيْنَهُمْ كُلُّ شِرْبٍ
مُحْتَضَرٌ٢٨ فَنَادَوْا صَاحِبَهُمْ فَتَعَاطَى فَعَقَرَ٢٩ فَكَيْفَ كَانَ عَذَابِي
وَنُذُرِ٣٠ إِنَّا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ صَيْحَةً وَاحِدَةً فَكَانُوا كَهَشِيمِ الْمُحْتَظِرِ٣١
وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ مُدَّكِرٍ٣٢

"Edhe fisi Themud i përgënjeshtroi paralajmërimet Tona."

"Ata (themudasit) **thanë: 'Vallë, a të ndjekim një njeri nga mesi ynë? Atëherë do të ishim vërtet në rrugë të humbur dhe të çmendur.'"**

"Vallë, vetëm atij mes nesh t'i dërgohet Shpallja? Jo, ai është gënjeshtar mendjemadh!"

"(Të Dërguarit iu tha)**: 'Nesër do ta marrin vesh ata se, kush është gënjeshtari mendjemadh!'"**

"Ne po u dërgojmë devenë për t'i sprovuar, andaj ti (o Salih) **priti ata dhe bëhu i durueshëm!"**

"Dhe lajmëroji ata se uji do të ndahet ndërmjet tyre e devesë dhe çdo vakt do të shihet me rend!"

"Por ata thirrën shokun e tyre, i cili e mori dhe e theri."

"Eh, sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia!"

"Ne dërguam mbi ta një ulurimë të vetme e ata u bënë si sana e copëtuar në pleme."

" Vërtet, Ne e kemi bërë Kur'anin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!"

Komentimi

Fundi i dhimbshëm i popullit të Themudit

Populli i Themudit është populli i tretë që është përmendur në këtë sure, në vazhdim të diskutimeve tona, të cilat u sollën edhe si mësim për njerëzit. Populli i Themudit jetonte në tokën e quajtur Haxher, që ndodhet në pjesën Veriore të Hixhazit. Profeti i tyre, Salih *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, bëri përpjekjet më të skajshme për udhëzimin e tyre, por nuk pati sukses.

Ajeti 23 thotë: **"Edhe fisi Themud i përgënjeshtroi paralajmërimet Tona."**.

Disa komentues kanë thënë, se fjala *"nudhur"*, e përdorur në këtë ajet, është me kuptimin e "Profetëve paralajmërues" dhe përgënjeshtrimin e popullit të Themudit në lidhje me Salihin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e kanë konsideruar si përgënjeshtrimin e të gjithë Profetëve, sepse thirrja e të gjithë të Dërguarve ishte në sintoni dhe pajtueshmëri të plotë. Por kjo është vetë dukja. Kjo dukje tregon se fjala *"nudhur"* këtu është shumësi i fjalës *"indhar"*. Ajo është përdorur me kuptimin e deklarimeve që janë shoqëruar me frikësim, që ka ekzistuar në fjalën e secilit Profet.[1]

Më pas, ajeti 24 përmend arsyen e përgënjeshtrimit të tyre: **"Ata** (themudasit) **thanë: 'Vallë, a të ndjekim një njeri nga mesi ynë? Atëherë do të ishim vërtet në rrugë të humbur dhe të çmendur.'"**.

Mendjemadhësia, arroganca, egoizmi, që karakterizonin këtë popull, ishin pengesat e mëdha ndaj ftesës së të Dërguarve. Ata thoshin se Salihu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte një njeri i ngjashëm si ata. Nuk ka ndonjë arsye që ata ta pasonin atë, se ai nuk ka ndonjë epërsi, që të ishte udhëheqësi i tyre.

Kjo është po ajo vërejtje që zakonisht të gjithë popujt e devijuar ua parashtronin të Dërguarve, të cilët i konsideronin si njerëz nga lloji i tyre. Për këtë arsye, sipas tyre, ata nuk mund të jenë të Dërguar të Zotit.

Një grup komentuesish fjalën *"vahidan"* e ka interpretuar në këtë mënyrë: "Armiqtë e Salihit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* këmbëngulnin se ai është një njeri i zakonshëm, se nuk kishte

[1] Më shumë informacion për këtë çështje, është dhënë në komentimin e ajetit 41 dhe në fusnotën e po kësaj sureje.

ndonjë pasuri të madhe e as prejardhje të jashtëzakonshme prej aristokrati. Disa të tjerë e kanë përdorur komentin me kuptimin se ai është një individ i vetëm dhe nuk ka përreth përkrahës.". Ndërkohë që një udhëheqës duhet të ketë mbështetje në shoqëri dhe me këtë epërsi t'i ftojë të tjerët që ta pasojnë atë.

Ekziston edhe një komentim i tretë. Sipas tij, ata nuk mbështeteshin te i pari i tyre. Synimi i tyre ishte që ai është një njeri nga lloji dhe gjinia e tyre dhe lloji i njerëzimit nuk mund të mbartë mbi supe misionin hyjnor. Për rrjedhim, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duhet të jetë nga lloji i engjëjve. Kjo logjikë bën të mundur edhe afrimin e të tri komentimeve.

Por këto ishin pretendime të rreme dhe të pabaza.

Fjala "*suur*" është shumësi i fjalës "*sair*". Është përdorur me kuptimin e zjarrit të ndezur. Ndonjëherë është përdorur edhe në kuptimin e "çmendurisë", sepse në një gjendje çmendurie njeriun e kaplon një emocion i veçantë, prandaj "devenë e çmendur" e quajnë "*deve mesura*".

Ekziston edhe mundësia që populli i Themudit, këtë shprehje ta ketë marrë nga Profeti i tyre Salih *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, i cili u thoshte atyre: "*Nëse ju nuk hiqni dorë nga adhurimi i idhujve dhe nuk i përgjigjeni thirrjes sime, do të jeni në devijim dhe në flakët e Xhehennemit.*".

Ata iu përgjigjën: "*Në qoftë se pasojmë një njeri që ngjason me ne, do të jemi në humbje, pra, në zjarr!*".

Sidoqoftë, përmendja e fjalës *"suur"*, në trajtën e shumësit, është bërë për të theksuar vazhdimësinë, qoftë në kuptimin e çmendurisë, qoftë në kuptimin e zjarrit flakërues.

Nëse Shpallja hyjnore i zbret një njeriu, ose disa njerëzve, atëherë ata do të thoshin: **"Pse vetëm atij, midis gjithë atyre njerëzve, t'i dërgohet Shpallja, kur mes nesh ka njerëz më të njohur, më të pasur dhe më të shquar?"**.

Në fakt, thëniet e popullit të Themudit ngjasojnë shumë me thëniet e politeistëve mekas, që ndonjëherë kritikonin: **"Ç'është me këtë të Dërguar i cili ha ushqim dhe ec nëpër tregje? Përse të mos jetë i Dërguar një engjëll së bashku me të, e të jetë qortues e të vërtetojë fjalët e tij?"**.[1]

Ndonjëherë tjetër thoshin: **"Përse të mos i ketë zbritur ky Kur'an një njeriu të madh nga dy qytete?"**.[2] Meqenëse është caktuar që i dërguar hyjnor të jetë një prej njerëzve, atëherë përse të jetë një njeri i mjerë, pa përkrahës dhe i papunë?!

Këta të pandjeshëm, që thuajse përgjatë historisë i pështpëritnin në vesh njëri-tjetrit fjalë të ngjashme, mendonin se, nëse ndonjëri ka pasuri, etni apo fis, pozitë dhe prejardhje të shquar, kjo është arsye për të qenë i përzgjedhur për Shpallje, ndërkohë që njerëzit më mizorë, zakonisht, ishin nga mesi i këtyre njerëzve.

Gjithashtu, disa komentues të Kur'anit kanë komentuar: "Ata deklaronin, se si ka mundësi që vetëm atij i është Shpallur

[1] Sure "El Furkan", ajeti 7.
[2] Sure "El Zukhruf", ajeti 31.

Shpallja. **‘Vallë, vetëm atij mes nesh t’i dërgohet Shpallja?’**. Përse nuk na ka zbritur edhe neve? Nga dallojmë ne me të?”.

Në ajetin 52 të sures “El Muddeththir” thuhet: **“Veç kësaj, secili prej tyre dëshironte t’i jepej Libër i posaçëm, i qartë.”**.

Në fund të ajetit 25 thuhet se ata, këtë çështje, e konsideruan si argument për përgënjeshtrimin e Profetit të tyre, Salih *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* dhe deklaruan: **“Jo, ai është gënjeshtar mendjemadh!”**.

Ai dëshiron që të na qeverisë ne, të marrë çdo gjë nën kontroll dhe të sillet në përputhje me lakmitë dhe epshet e veta.

Fjala *“eshir”* është mbiemër që rrjedh nga rrënja *“esher”* dhe është në kuptimin e *“gëzimit të madh të shoqëruar me mendjemadhësi”*.

Por Kur’ani, në përgjigje të tyre, i thotë të Dërguarit: **“**(Të dërguarit iu tha)**: ‘Nesër do ta marrin vesh ata se, kush është gënjeshtari mendjemadh!’”**.

Në kohën kur do t’u arrijë dënimi hyjnor, do t’i shtypë ata dhe më pas do t’i shndërrojë në një grusht dhè e pluhur. Më në fund, ata do t’i kaplojë edhe dënimi pas vdekjes, atëherë do ta kuptojnë se cili ishte i denjë për raporte dhe lidhje të tilla. Ky dënim është një mantel për shtatin e secilit person.

Është e qartë se fjala *“gaden”* - *“nesër”* është përdorur për të ardhmen e afërt.

Këtu mund të shtrohet një pyetje: A i kishin parë qartë dënimet e tyre në momentin e zbritjes së këtyre ajeteve? A e

kishin mësuar se nuk do të kishin vend për t'u shprehur dhe që të nesërmen do ta kuptonin se kush do të jetë gënjeshtar mendjemadh?"

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, mund të japim dy përgjigje: së pari; kjo fjali i është thënë të Dërguarit të Zotit, pra, Saliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe është thënë në ato ditë dhe në ato kushte. Pa dyshim që në atë ditë akoma nuk kishte zbritur dënimi hyjnor.

Së dyti, synimi i fjalës *"nesër"* është e nesërmja e Kiametit, kur do të bëhet e qartë çdo gjë. Përgjigjja e parë duket më e përshtatshme dhe përputhet më shumë me ajetet vijuese.

Këtu lind një pyetje tjetër: A e kishin kuptuar të vërtetën e thirrjes së Profetit të tyre, Saliut, lidhur me Dënimin Hyjnor dhe a e kishin parë mrekullinë e tij të pamohueshme? Atëherë përse thonë: "Nesër do ta kuptojnë!"?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje, gjithashtu, bëhet e qartë, duke pasur parasysh që dija gjithnjë ka shkallë dhe nivele. Në disa nivele, është e mundur që pala e kundërt ta mohojë atë, por ndonjëherë arrin në një fazë, që nuk ka më vend për mohim dhe çdo gjë shihet qartë. Këtu, për këtë fazë bëhet fjalë.

Më pas aludon në tregimin e devesë, e cila ishte dërguar si mrekullia dhe dëshmia e gjallë e vërtetësisë së thirrjes së Profetit Salih *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe thotë: **"Ne po u dërgojmë devenë për t'i sprovuar, andaj ti** (o Salih) **priti ata dhe bëhu i durueshëm!"**.

"Naka", deveja që iu dërgua si mrekullia e Saliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, pa dyshim që nuk ishte një deve e

zakonshme, por kishte karakteristika të jashtëzakonshme, si për shembull, në bazë të haditheve të njohura kjo *"naka"* u shfaq nga zemra e një shkëmbi, në mënyrë që të jetë një mrekulli e qartë kundrejt mohuesve kokëfortë dhe kryeneçë.

Fjala *"fitne,"* ashtu siç e kemi cekur edhe më herët, është në kuptimin e hedhjes së floririt në zjarr, për ta bërë të qartë nivelin e pastërtisë, pra, karatit të tij. Më pas është përdorur për çdo lloj sprove.

Është e qartë se kjo ishte një provë e madhe për popullin e Themudit, prandaj, në ajetin vijues, shton: **"Dhe lajmëroji ata se uji do të ndahet ndërmjet tyre e devesë dhe çdo vakt do të shihet me rend!"**.[1]

Edhe pse Kur'ani, në lidhje me këtë, nuk ka dhënë përshkrim shtesë, shumë komentues kanë deklaruar se kur i vinte radha devesë së tij, e pinte të gjithë ujin, kurse disa të tjerë kanë deklaruar se trajta dhe forma e saj ishte e atillë, që kur ajo i afrohej ujit, largoheshin shtazët e tjera, prandaj nuk kishte ndonjë alternativë tjetër përveç kësaj, që një ditë të gjithë ujin ta vinin në dispozicion të *nakasë* dhe ditën tjetër ta mbanin për veten e tyre.

Sidoqoftë, ky popull kishte mungesë uji dhe njerëzit nuk duronin që gjatë një dite i gjithë uji të ishte në dispozicion të devesë dhe një ditë në dispozicion të tyre, sidomos, siç janë shprehur disa komentues, kur dihej që në fshatrat dhe

[1] Fjala *"mukhtedher"* është emër i pjesores së kaluar dhe rrjedh nga rrënja *"hudhur"*. Fjala *"shirb"* është në kuptimin e pjesës dhe radhës së ujit, si rrjedhojë, fjalia: **"dhe çdo vakt do të shihet me rend"**, ka këtë kuptim: Për secilin vakt, pronari i tij do të jetë i pranishëm dhe tjetri nuk ka të drejtë të jetë i pranishëm dhe ta shqetësojë.

vendbanimet e tyre, në përgjithësi, kishte mungesë uji (edhe pse kjo domethënie nuk përputhe me ajetet 146–148 të sures "Esh Shuara", sepse nga këto ajete përftohet që ky popull jetonte në një tokë plot me kopshte dhe me burime.

Sidoqoftë, ky popull kryeneç, egocentrik dhe kokëfortë vendosi që t'ia thyente këmbën "*nakasë*", ndërkohë që Profeti Sali *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i kishte paralajmëruar ata që, nëse i shkaktojnë dëm devesë, së shpejti do t'i kaplojë Dënimi Hyjnor, por ata, duke mos i kushtuar rëndësi këtij paralajmërimi nga ana e të Dërguarit, thirrën njërin prej shokëve të tyre dhe ai e theri devenë.

Fjala "*sahib*", këtu, aludon për njërin nga prijësit e popullit të Themudit dhe njërin prej keqbërësve të tyre të famshëm, që në histori është njohur si Kedare bin Salif.[1]

Fjala "*teata*" është në kuptimin e marrjes së një gjëje apo ndjekjes së ndonjë çështjeje, si dhe është përdorur edhe për kryerjen e veprave të rëndësishme dhe të rrezikshme, apo kryerjen e veprave të mundimshme dhe tejet të vështira, ose të ndonjë vepre që, karshi saj, është përcaktuar ndonjë shpërblim ose pagë.

Të gjitha këto interpretime mund të merren parasysh në kontekstin e ajetit për tregimin e devesë, sepse vendimi për therjen e saj kishte nevojë për një kurajë dhe guxim të madh, pasi ishte një vepër e mundimshme dhe, si rregull, patjetër kundrejt këtij veprimi, kishin caktuar një pagë dhe shpërblim.

[1] Kedare ishte një burrë me pamje të shëmtuar dhe karakter të dobët. Njihet si njeriu më i lig në histori.

Fjala *"akar"* rrjedh nga *"ukr"* dhe përdoret me kuptimin e rrënjës, e bazës dhe në rastin e tregimit të devesë, nënkupton vrasjen apo therjen.

Për t'u nënvizuar është fakti se Kur'ani, këtu, therjen e devesë ia ka atribuuar një personi, ndërkohë që në suren "Esh Shems" i atribuohet të gjithëve dhe thotë: **"populli i Themudit e mbytin nakanë"**. Kjo është për shkak se ai person e kreu këtë vepër në emër të të gjithëve dhe me pëlqimin e tyre. Siç e dimë, ai e kreu therjen e devesë në emër të të gjithë atyre. [1]

Në disa hadithe thuhet se Kedare, në fillim, konsumoi alkool dhe më pas, në gjendje të dehur, e kreu këtë vepër të shëmtuar dhe krim të madh.

Në lidhje me mënyrën e therjes së devesë, gjithashtu, kanë shprehur mendime të ndryshme. Disa kanë thënë që e therën me shpatë, disa të tjerë kanë deklaruar se personi i doli asaj në pritë pas një shkëmbi dhe në fillim e qëlloi me shigjetë më pas e sulmoi me shpatë.

Ajeti në vijim, si paralajmërim për Dënimin Hyjnor për këtë populli rebel, thotë: **"Eh, sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia!"**.

Më pas thotë: **"Ne dërguam mbi ta një ulurimë të vetme e ata u bënë si sana e copëtuar në pleme."**.

Fjala *"sajhatun"*, këtu, është në kuptimin e një zëri të fuqishëm që ngrihet nga qielli. Kjo mund të aludojë për rrufenë e

[1] Përshkimin e kësaj çështjeje e kemi dhënë nën titullin "Lidhja e një doktrine", në komentimin e ajetit 65 të sures "Hud".

frikshme, që ra mbi qytetin e tyre, ashtu siç e lexojmë edhe në ajetin 13 të sures "Fussilet": **"Në qoftë se ata nuk përgjigjen, ti thuaj: 'Unë u tërhoqa vërejtjen e një rrufeje** (dënimi)**, si rrufeja e Adit dhe e Themudit."**.

Fjala *"heshijm"* rrjedh nga fjala *"heshm"* dhe përdoret me kuptimin e thyerjes së gjërave të dobëta dhe delikate, si për shembull, bimët e vogla që pronarët e deleve i thyejnë dhe i përgatisin për to, i quajnë "heshim". Ndonjëherë është interpretuar edhe si bimë të thata, të cilat thyhen dhe grimcohen nën këmbët e kafshëve në hambar.

Fjala *"muhtedh'ir"*, rrjedh nga fjala *"hedhr"* dhe është përdorur në kuptimin e ndalimit, prandaj kasollen ku fusin delet që t'i mbrojnë nga sulmet e kafshëve të egra, e quajnë *"hudhejre"*, kurse *"muhtedhir"* quhet personi që ka në pronësi një vend të këtillë, pra, ai që ndalon sulmet e egërsirave mbi bagëtitë e veta.

Shprehja që është përdorur në këtë ajet, në lidhje me dënimin e popullit të Themudit, është shumë e çuditshme dhe domethënëse, sepse Zoti i Madhëruar, për asgjësimin e këtij populli rebel, asnjëherë nuk dërgoi ndonjë ushtri nga qielli apo toka, por dënimin e tyre e realizoi vetëm me anë të një rrufeje qiellore, një rrufe të vrullshme, një valë të madhe shpërthimesh që çau dhe e copëtoi në një rreze të gjerë gjithçka!

Kështjellat dhe shtëpitë e tyre u bënë mbrojtëse si kasollja e deleve dhe trupat pa frymë dhe të copëtuar të tyre u shndërruan në formën e një bime të thatë, të shtypur që e hedhin poshtë deleve.

Konceptimi i këtij kuptimi ishte i vështirë për njerëzit e hershëm, por për njerëzit e sotëm që kanë dijeni për efektin e valëve që shkatërrojnë dhe copëtojnë çdo gjë, është i lehtë. Sigurisht, rrufeja e dënimit hyjnor është e pakrahasueshme me shpërthimet që shkaktohen prej njeriut. Prej këtej bëhet e qartë se çfarë fatkeqësie dhe tragjedie e madhe solli me vete kjo rrufe e madhe këtij populli kokëfortë.

Në ajetin 32, në mbarim të kësaj historie të dhimbshme dhe mësimdhënëse, sërish thuhet: **"Vërtet, Ne e kemi bërë Kur'anin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!"**.

Shprehjet e tij janë të gjalla dhe të qarta, tregimet e tij domethënëse, kërcënimet dhe paralajmërimet tronditëse dhe vigjiluese.

Ajetet 33 – 40

كَذَّبَتْ قَوْمُ لُوطٍ بِالنُّذُرِ٣٣ إِنَّا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ حَاصِبًا إِلَّا آلَ لُوطٍ
نَجَّيْنَاهُمْ بِسَحَرٍ٣٤ نِعْمَةً مِنْ عِنْدِنَا كَذَلِكَ نَجْزِى مَنْ شَكَرَ٣٥ وَلَقَدْ
أَنْذَرَهُمْ بَطْشَتَنَا فَتَمَارَوْا بِالنُّذُرِ٣٦ وَلَقَدْ رَاوَدُوهُ عَنْ ضَيْفِهِ فَطَمَسْنَا
أَعْيُنَهُمْ فَذُوقُوا عَذَابِى وَنُذُرِ٣٧ وَلَقَدْ صَبَّحَهُمْ بُكْرَةً عَذَابٌ
مُسْتَقِرٌّ٣٨ فَذُوقُوا عَذَابِى وَنُذُرِ٣٩ وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ
مُدَّكِرٍ٤٠

"Edhe populli i Lutit nuk i besoi paralajmërimet."

"Ne dërguam një stuhi gurësh mbi ta, duke hequr familjen e Lutit, që e shpëtuam në agim",

"falë mëshirës Sonë. Ja, kështu Ne i shpërblejmë ata që falënderojnë."

"Në fakt, Luti i paralajmëroi ata për fuqinë e dënimit Tonë, por ata i vunë në dyshim paralajmërimet."

"Ata i kërkuan t'ua dorëzonte mysafirët e tij. Por Ne ua verbuam sytë (e u thamë)**: 'Shijoni dënimin Tim, tani që e dëgjuat paralajmërimin Tim!'"**

“Dhe të nesërmen në mëngjes, ata i goditi dënimi i përhershëm.”

“Shijoni dënimin Tim, tani që e dëgjuat paralajmërimin Tim!”

“Vërtet, Ne e kemi bërë Kur’anin të lehtë për t’u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!”

Komentimi

Popullin e Lutit e preku një fat edhe më ogurzi

Në këto ajete është bërë një përshkrim i shkurtër, por tronditës në lidhje me popullin e Lutit dhe dënimin e dhimbshëm të këtij komuniteti mashtrues. Kjo është pjesa e katërt prej historisë së popujve të kaluar.

Ajeti 33 thotë: **“Edhe populli i Lutit nuk i besoi paralajmërimet.”**.

Fjala *“nudhur”*, ashtu siç e kemi cekur edhe më parë, është shumësi i fjalës *“indhar”* dhe është përdorur në kuptimin e kërcënimit dhe tërheqjes së vëmendjes. Përmendja e saj në numrin shumës ka gjasa të jetë për shkak të paralajmërimeve të njëpasnjëshme të këtij të Dërguari të madh. Ky popull kryeneç dhe kokëfortë, i përgënjeshtroi ata; ose mund të aludojë për paralajmërimin e Profetit Lut *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* dhe të

Dërguarve të tjerë përpara tij, sepse thirrjet e të gjithë të Dërguarve bazohen tek i njëjti realitet.

Më pas, me anë të një fjalie të shkurtër, kujton një pjesë të dënimit të tyre dhe shpëtimin e familjes së Profetit Lut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*: **"Ne dërguam një stuhi gurësh mbi ta…"**.

Të gjithë i varrosëm në këtë stuhi gurësh, **"duke hequr familjen e Lutit, që e shpëtuam në agim…"**.

Fjala *"hásibun"* është në kuptimin e një stuhie të fortë, sepse fjala *"husba"* do të thotë *"e vë në lëvizje gurin dhe rërën"*.

Në ajete të tjera kur'anore, që flasin për kohën që u dënua populli i Lutit, përveç tërmeteve që shkatërruan qytetet e tyre, flitet edhe për stuhi me gurë. Për këtë stuhi lexojmë edhe në ajetin 82 të sures "Hud": **"Kur erdhi Urdhri Ynë Ne përmbysëm të gjitha fshatrat e tyre duke kthyer çdo gjë përmbys dhe mbi ta lëshuam gurë të fortë pareshtur."**.

A ishin këto dy lloj dënimesh? Njëri dënim ishte stuhia e fortë, e cila mori me vete gurët dhe rërën nga shkretëtira dhe ua hodhi atyre, kurse dënimi tjetër ishte shiu i gurëve qiellorë apo që të dyja kanë të njëjtin kuptim? Ndonjëherë uraganet e mëdha nëpër shkretëtira ngrenë nga toka gurë dhe rërë dhe i çojnë në qiell dhe kur trysnia e stuhisë bie, i hedh ato në një vend tjetër.

Ka gjasa që edhe këtu, me urdhrin e Zotit, një vorbull e fortë të ketë ngritur në qiell copëza të mëdha guri dhe rëre nga toka dhe, pas tërmetit shkatërrimtar, t'i ketë lëshuar ato mbi vendbanimet e popullit të Lutit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, duke varrosur nën vete kufomat e tyre të përlyera, madje të ketë

hequr nga faqja e dheut rrënojat e qyteteve të tyre, në mënyrë që kjo të shërbejë përgjithmonë si mësim për të tjerët.[1]

Ndërkaq, ajeti i lartpërmendur thotë se shpëtimi i familjes së Profetit Lut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u bë në agim, sepse ishin paralajmëruar për dënimin e këtij populli shtypës në kohën e agimit, prandaj, me urdhrin e Zotit, kjo familje besimtare, përveç bashkëshortes, e cila ishte larguar nga rruga e Profetit Lut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në pjesën e tretë të natës, doli nga qyteti dhe, pa kaluar shumë kohë, filloi tërmeti e më pas rënia e stuhisë së gurëve, ashtu siç tregohet në ajetin 81 të sures "Hud": **"...e ti nga fundi i natës udhëto me familjen tënde dhe askush prej jush të mos vështrojë prapa. Familja do të shpëtojë, përveç gruas së Lutit, e cila do të dënohet si mosbesimtarët e tjerë. Afati i tyre është mëngjesi, a nuk është mëngjesi afër?"**.

Në ajetin 35 theksohet: **"falë mëshirës Sonë. Ja, kështu Ne i shpërblejmë ata që falënderojnë."**.

Edhe ajeti 36 e ripërsërit këtë: **"Në fakt, Luti i paralajmëroi ata për fuqinë e dënimit Tonë, por ata i vunë në dyshim paralajmërimet."**.

Në të kaluarën, Profeti Lut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i kishte paralajmëruar ata për dënimin e Zotit. Fjala *"batsh"* është përdorur në kuptimin e marrjes së një gjëje me forcë. Duke u nisur nga fakti, që edhe kriminelin e marrin me forcë, edhe kjo fjalë është përdorur për dënimet.

[1] Në lidhje me këtë fushë, kemi diskutuar edhe në komentimin e ajetit 82 i sures "Hud".

Fjala *"temarau"* rrjedh nga rrënja *"temari"* dhe është përdorur në kuptimin e bashkëbisedimeve të dyshimta dhe polemika për të vërtetën. Në fakt, ata ia dhanë dorën njëri–tjetrit, por nisur nga rrugë të ndryshme, u përpoqën të krijonin dyshime dhe iluzione në opinionin publik, në mënyrë që të neutralizojnë paralajmërimet e këtij të Dërguari të madh.

Ata nuk u mjaftuan vetëm me nxitjen e dyshimeve ideologjike te njerëzit, por u zhytën në shumë vepra imorale, gjëra të turpshme dhe shthurje morale, bile engjëjt përgjegjës të dënimit u futën në shtëpinë e Profetit Lut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* si mysafirë dhe ky popull i pacipë u shkoi pas tyre. Siç thuhet në ajetin 37: **"Ata i kërkuan t'ua dorëzonte mysafirët e tij."**.

Profeti Lut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u zemërua shumë nga kjo çështje dhe kërkoi nga ata që të hiqnin dorë prej këtij turpi dhe çnderimi. Madje, sipas ajetit 71 të sures "El Hixhr", u premtoi atyre që vajzat e veta, në rast se pendohen, t'i martojë me ta. Kjo tregon sa të shtypur e ndiente veten ky i Dërguar i madh në mesin e atij grupi njerëzish të paturpshëm e mosbesimtar.

Por nuk kaloi shumë kohë dhe ky grup sulmues u përball me dënimet e para. Kjo dëshmohet në vazhdimësi të këtij ajeti, ku Zoti, pasi ua ka verbuar sytë, u thotë: **"Por Ne ua verbuam sytë** (e u thamë)**: 'Shijoni dënimin Tim, tani që e dëgjuat paralajmërimin Tim!'"**.

Zoti i Madhëruar, me drejtësinë e Tij, e urdhëroi Xhebrailin që t'ua godasë sytë me një pjesë të mantelit të vet. Që të gjithë u verbuan, madje është thënë që vendi i syve të tyre u rrafshua me fytyrën.

Edhe pse në ajet nuk është diskutuar se cilët njerëz shkuan pas engjëjve, është e kuptueshme se ishte pjesa imorale, e cila u kishte paraprirë në këtë poshtërsi. Fati i tyre, me gjendjen e tyre të mjerueshme, shërbeu si një mësim për të tjerët, në mënyrë që të marrin mësime nga ky dënim.

Komentuesit deklarojnë se dënimi u shty për në mëngjes, me qëllim që t'u jepej edhe një mundësi për të reflektuar dhe për t'u penduar gjatë asaj nate. Por fatkeqësisht, nuk nxorën mësim. Madje, kur u kthyen në shtëpi, u betuan se të nesërmen në mëngjes nuk do të linin të gjallë asnjë person nga familja e Profetit Lut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.[1]

Më në fund, arriti koha e dënimit final. Herët në mëngjes, një tërmet shkatërrues lëkundi tokën e tyre, i përmbyti fshatrat e tyre, trupat e tyre i bëri copa-copa, i shkatërroi dhe i futi poshtë rrënojave. Mbi ta lëshoi një shi të rrëmbyeshëm gurësh dhe asgjësoi edhe gjurmët e rrënojave të tyre.

Kjo thuhet përmbledhtazi në ajetin vijues: **"Dhe të nesërmen në mëngjes, ata i goditi dënimi i përhershëm."**.

Çdo gjë përfundoi vetëm për pak çaste dhe nuk mbeti asnjë gjurmë nga ata.

Fjala *"bukren"* - **"fillimi i ditës"** përdoret me kuptimin e fillimit të mëngjesit, kurse fjala *"sabbahahum"* ka një kuptim të gjerë, që përfshin të gjithë periudhën e mëngjesit.

Vallë, a ka ndodhur kjo ngjarje në fillim të agimit? Apo në fillim të lindjes së diellit? Nuk është e njohur në mënyrë të saktë,

[1] Tefsire "Nuruth Thakalejn", vëll. 5, f. 185.

por mbase fjala *"bukreten"* përshtatet më shumë me fillimin e lindjes së diellit.

Fjala *"mustekir"* është në kuptimin e qëndrueshmërisë. Këtu ka gjasa që të aludojë për dënimin e fortë dhe të fuqishëm, të cilin nuk mund ta përballonte askush.

Gjithashtu, është thënë edhe se, meqenëse dënimi i kësaj bote u bashkua me dënimin e tyre në Botën e Ndërmjetme, është përdorur fjala *"mustekir"*.

Më pas shton se atyre sërish u është thënë: **"Shijoni dënimin Tim, tani që e dëgjuat paralajmërimin Tim!"**, në mënyrë që të mos dyshoni më dhe të mos tregoheni të pavëmendshëm ndaj paralajmërimeve të të Dërguarve.

Kjo fjali është përmendur dy herë në këtë ngjarje. Fjalia e parë aludon "dënimin paraprak", që do të thotë verbërimi i grupit që sulmoi shtëpinë e Profetit Lut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, kurse hera e dytë aludon për "dënimin final dhe përfundimtar", domethënë tërmetin shkatërrues dhe shiun e gurëve.

Më në fund, në ajetin 40, për të katërtën herë në këtë sure, përsëritet fjalia shumë këshilluese dhe paralajmëruese: **"Vërtet, Ne e kemi bërë Kur'anin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!"**.

Populli i Profetit Lut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* nuk mori ndonjë këshillë, as nga paralajmërimet, as nga dënimet fillestare dhe paralajmëruese. Vallë, a do të ndërgjegjësohen të tjerët që kanë bërë të njëjtat mëkate, pasi të dëgjojnë këto ajete kur'anore? A do të pendohen?!

Ajetet 41 - 46

وَلَقَدْ جَاءَ آلَ فِرْعَوْنَ النُّذُرُ١، كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا كُلِّهَا فَأَخَذْنَاهُمْ أَخْذَ عَزِيزٍ مُقْتَدِرٍ٢، أَكُفَّارُكُمْ خَيْرٌ مِنْ أُولَئِكُمْ أَمْ لَكُمْ بَرَاءَةٌ فِي الزُّبُرِ٣، أَمْ يَقُولُونَ نَحْنُ جَمِيعٌ مُنْتَصِرٌ٤، سَيُهْزَمُ الْجَمْعُ وَيُوَلُّونَ الدُّبُرَ٥، بَلِ السَّاعَةُ مَوْعِدُهُمْ وَالسَّاعَةُ أَدْهَى وَأَمَرُّ٦،

“Edhe njerëzve të Faraonit u patën ardhur paralajmërimet”,

“por ata i mohuan të gjitha shenjat Tona, andaj Ne i mbërthyem ata, ashtu siç dënon i Plotfuqishmi dhe i Plotpushtetshmi.”

“Vallë, jobesimtarët tuaj janë më të mirë se këta (popuj të shkatërruar më parë)**, apo ju keni ndonjë paprekshmëri në librat e shpallur?”**

“Vërtet thonë ata: ‘Ne jemi grup i pathyeshëm’?!”

“Së shpejti do të thyhet grupi dhe (secili prej tyre) **do t’ia mbathë.”**

“Madje, Ora (e Kiametit) **do të jetë takimi i tyre dhe Ora do të jetë më e tmerrshme dhe më e hidhët.”**

Komentimi

Vallë, a jeni ju më lart se popujt e tjerë?!

Populli i pestë dhe i fundit, që do të trajtohet në këtë seri diskutimesh, është populli i Faraonit. Por, duke pasur parasysh faktin se për këtë popull kemi diskutuar gjerësisht dhe në mënyrë të detajuar në shumë raste në Kur'an, këtu do të mjaftohemi me përmendjen, në mënyrë të shkurtuar dhe kalimthi, të historisë së tyre, prej të cilit duhet të nxirrnin mësime.

Ajeti 41 thotë: **"Edhe njerëzve të Faraonit u patën ardhur paralajmërimet..."**.

Me fjalën *"ali firaun"* nuk synohet vetëm familja dhe farefisi i tij, por përfshihen pasuesit dhe ithtarët e tij në përgjithësi, sepse fjala *"ali"*, edhe pse zakonisht përdoret për Ehli Bejtin, pra, "familjen", këtu përdoret në një kuptim më të gjerë.

Fjala *"nudhur"* është shumësi i fjalës *"nedhir"*[1] dhe është përdorur në kuptimin e paralajmëruesit për njerëz apo ngjarje, që tërheq vëmendjen për pasojat e mundshme, nëse nuk zbatohen ato paralajmërime. Në rastin e parë, është e mundur që ajeti i lartpërmendur, përmend Profetët Musa dhe Harun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*, kurse në rastin e dytë, përmend nëntë

[1] Duhet të kemi parasysh se shumësi i fjalës *"nudhur"*, që është *"nadhir"*, ka kuptimin e paskajores ose sinonim të saj. Duke u nisur nga fakti që edhe paskajorja, gjithashtu, përdoret në kuptimin e mbiemrit, që të dyja mund t'i rikthehen të njëjtit kuptim.

mrekullitë e Profetit Musa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Ajeti vijues sqaron se kuptimi i dytë është më i përshtatshëm.[1]

Ajeti në vijim nxjerr në pah reagimin e njerëzve të Faraonit kundrejt këtyre dy të Dërguarve dhe paralajmërimeve të tyre: **"por ata i mohuan të gjitha shenjat Tona…"**.

Këta mendjemëdhenj egoist, këta tiranë despotikë dhe të padrejtë, i mohuan të gjitha shenjat e Zotit, pa përjashtim dhe të gjitha i konsideruan gënjeshtra, magji apo ngjarje rastësore!.

Fjala *"ajatun"* ka një përdorim të gjerë kuptimor. Ajo përfshin edhe arsyet racionale, mrekullitë dhe argumentet e transmetuara. Por në bazë të kontekstit të ajetit 101 të sures "El Isra": **"Ne ia dhamë Profetit Musa nëntë mrekulli të qarta."**, bëhet e qartë, që edhe këtu flitet po për ato mrekulli nëntëllojeshe.[2]

Nëse njeriu këmbëngul për të vërtetën, i mjafton vetëm njëra prej këtyre mrekullive, që paralajmëron për fatkeqësi. Besimtari, duke iu bindur të Dërguarit të Zotit dhe duke iu lutur Zotit, mund të fitojë faljen. Por kur njeriu, edhe pse

---

[1] Duke pasur parasysh ajetin 39, faqe 75, ka gjasa që fjala *"nudhur"*, gjithashtu, të jetë në kuptimin e dënimeve.

[2] Sipas ajeteve kur'anore mrekullitë nëntëllojeshe të Profetit Musa përbëhen, nga: 1- shndërrimi i shkopit të tij në një gjarpër të madh, (sure "Ta Ha", ajeti 20); 2- *"jed bejdha"* ndriçimi i dorës së Profetit Musa si një burim drite, (sure "Ta Ha", ajeti 22); 3- vërshimi, (sure "El A'raf", ajeti 133); 4-5-6-7- karkaleci që shkatërroi bujqësinë, rriqrat (insekte dëmtuese), bretkosat që u ngritën nga lumi Nil dhe për një periudhë të shkurtër kohe e mbuluan nivelin e jetesës së tyre), gjaku në lumin Nil, i cili u shndërrua tërësisht në ngjyrë të kuqe, (sure "El A'raf", ajeti 133); 8–9, thatësira dhe mungesa e frutave, (sure "El A'raf", ajeti 130). Përshkrimi i secilës mrekulli, është dhënë tek ajetet përkatëse.

paralajmërohet, është kryeneç e nuk bindet, atë e përfshin dënimi hyjnor.

Në vazhdim të ajetit që po e diskutojmë, thuhet: **"Andaj Ne i mbërthyem ata, ashtu siç dënon i Plotfuqishmi dhe i Plotpushtetshmi."**.

Fjala *"ahdh"* përdoret me kuptimin e marrjes, por, duke pasur parasysh faktin që për ta dënuar kriminelin, në fillim e arrestojnë atë, edhe kjo fjalë përdoret si aluzion për dënimet.

Shprehja që është përdorur në këtë tregim, nuk ka ngjashmëri me historitë e popujve të tjerë të hershëm, sepse faraonët ishin të fortë dhe të pushtetshëm. Por Zoti i Madhëruar thotë: **"Ne i dënuam ata"**, në mënyrë që të bëhet e qartë se fuqia dhe krenaria pompoze e faraonëve nuk është asgjë para fuqisë së Zotit. Dhe pikërisht, lumin e madh të Nilit, i cili ishte burimi i të gjitha pasurive, i fuqisë, i jetesës dhe i qytetërimit të faraonëve Zoti e caktoi si mjet për asgjësimin e tyre. Edhe më i çuditshëm se ky, është fakti se edhe gjallesat e vogla, si për shembull, karkaleci, bretkosa, rriqrat dominuan mbi ata që deri atëherë hiqeshin si mjaft të fuqishëm.

Pasi shpaloset historia e popujve të kaluar, dënimet e ndëshkimet e popujve rebelë, në ajetin 43 u drejtohet politeistëve të Mekës dhe u thotë: **"Vallë, jobesimtarët tuaj janë më të mirë se këta** (popuj të shkatërruar më parë)**, apo ju keni ndonjë paprekshmëri në librat e shpallur?"**.[1]

[1] Në dukje, përemri te fjala *"keffarekum"* u kthehet politeistëve arabë, në bazë të kontekstit të fjalës *"em lekum beraehu fizzubu"*.

Ç'dallim ka mes popullit të Faraonit, popullit të Lutit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, popullit të Nuhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe Themudit? Nëse ata i goditën stuhitë, tërmetet dhe rrufetë, për shkak të politeizmit, të rebelimit, të dhunës dhe të mëkatit, për çfarë arsye të mos prekeni edhe ju nga një fat i tillë?!

Vallë, a mos jeni ju më të mirë se të tjerët?

Apo, mos vallë rebelimi, kryeneçësia dhe politeizmi juaj është më i paktë se sa i atyre?

Atëherë, si e konsideroni veten të mbrojtur nga Dënimi Hyjnor? Vetëm nëse Librat tuaj qiellorë, kanë rezervuar ndonjë imunitet për ju. Por, një pretendim i tillë, është trillim dhe gënjeshtër. Nuk keni asnjë lloj argumenti për këtë. Edhe pse deklarojnë se janë një shoqëri e bashkuar dhe e fortë, që hakmerren ndaj kundërshtarëve, Ne triumfojmë mbi ta. **"Vërtet thonë ata: 'Ne jemi grup i pathyeshëm'?!"**.[1]

Fjala *"xhem'un"* përdoret me kuptimin e tërësisë, të grupit, i cili ka fuqi dhe qëllim për të vepruar, kurse fjala *"muntasirun"* përcjell një theksim mbi këtë kuptim, sepse rrjedh nga fjala *"intisarun"*, e cila ka kuptimin e hakmarrjes dhe të fitores.

Interesant është fakti se ajeti i mësipërm u drejtohet drejtpërsëdrejti atyre, kurse ajeti që po diskutojmë dhe ajetet në vijim, diskutojnë në largësi me politeistët. Ky është një lloj përçmimi, që do të thotë se ata nuk mund të jenë më shumë se kaq.

---

[1] Edhe pse fjala *"nahnu"* është përemër në shumës, kallëzuesi i tij, *"xhemiiun"*, është në numrin njëjës. Kjo është për shkak se fjala *"xhemiiun"*, edhe pse si fjalë është në numrin njëjës, por për nga pikëpamja e kuptimit, është në shumës.

Edhe në qoftë se ata pretendojnë për një fuqi të tillë, është një pretendim i pabazë, sepse "njerëzit e Faraonit", populli i Adit dhe i Themudit dhe të ngjashmit me ta, të cilët ishin më të fortë se këta, nuk treguan as rezistencën më të vogël karshi dënimit hyjnor. Atëherë çfarë të mendojmë për këtë grup të vogël, që u mungonte çdo gjë?!

Më pas, si një parashikim i patjetërsueshëm e bindës dhe për të refuzuar fjalët e tyre, ajeti shton: **"Së shpejti do të thyhet grupi dhe** (secili prej tyre) **do t'ia mbathë."**.

Interesant është fakti se fjala *"se juhzem"* rrjedh nga rrënja *"hezmun"* dhe përdoret me kuptimin e shtypjes së trupit të thatë, deri në atë masë sa shpartallohet. Pikërisht, këtë nuancë kuptimore do të theksojë, për disfatën e ushtrisë dhe shpartallimin e saj. Ata u shkërmoqën krejtësisht!

Kjo mënyrë të shprehuri, thekson faktin se edhe ata, në dukje, ishin të bashkuar, por u shkërmoqën si krijesa të thata. Krejt e kundërta ndodh me besimtarët, të cilët kanë një forcë të madhe e të qëndrueshme dhe bëjnë rezistencë përballë çdo vështirësie.

Fjala *"dubur"* përdoret për të treguar anën e pasme, kurse fjala *"kubul"* tregon pjesën e përparme. Fjala *"dubur"*, këtu, përdoret për të treguar se dikush i ka kthyer kurrizin sheshit të luftës.

Ky parashikim u vërtetua në Luftën e Bedrit dhe në luftërat e tjera islame, grupi i fortë i politeistëve u shkatërrua dhe u shpartallua përfundimisht.

Në ajetin 46, thuhet se politeistët jo vetëm që humbën, por: **"Ora** (e Kiametit) **do të jetë takimi i tyre dhe Ora do të jetë më e tmerrshme dhe më e hidhët."**.

Kështu, ata do të jenë edhe në pritje të dënimit të hidhur të kësaj bote, edhe në pritje të dënimit të hidhur në Ditën e frikshme të Kiametit.

Fjala *"edha"* rrjedh nga rrënja *"dehv"* dhe *"deha"* përdoret në kuptimin e fatkeqësisë së madhe, që nuk ka shërim. Ka raste që përdoret edhe në kuptimin e zgjuarsisë së tepërt. Por në ajetin në fjalë, është në kuptimin e parë.

Por, ata në Kiamet, do t'i presë fatkeqësia e madhe, për ata nuk ekziston asnjë rrugëdalje.

Hulumtim

Një paralajmërim i qartë dhe i mrekullueshëm

Kur këto ajete kanë zbritur në Mekë, myslimanët përbënin pakicën absolute, por kudo mbizotëronte forca e armikut, prandaj, kurrë nuk besohej e as parashikohej fitorja e myslimanëve. Pa kaluar shumë kohë, myslimanët shkuan në mërgim dhe gjetën aq shumë forcë, saqë në përleshjen e parë të armatosur me armiqtë në Luftën e Bedrit, i goditën shumë rëndë. Ky ishte një zhvillim i papritur. Ata asnjëherë nuk e kishin besuar

dhe nuk e prisnin një gjë të tillë. Akoma pa kaluar shumë kohë nga Lufta e Bedrit, jo vetëm politeistët e Mekës, por i gjithë Gadishulli Arabik u dorëzua te myslimanët.

Vallë, a nuk është një mrekulli e vërtetë, që tregon se duhet të jesh besimtar i vendosur?

Një nga aspektet e mrekullisë së Kur'anit, është se fshehtësinë e di vetëm Zoti yt. Shembulli i mësipërm, i fitores së myslimanëve, e vërteton më së miri këtë.

Ajetet 47 – 55

إِنَّ الْمُجْرِمِينَ فِي ضَلَالٍ وَسُعُرٍ ٤٧ يَوْمَ يُسْحَبُونَ فِي النَّارِ عَلَى وُجُوهِهِمْ ذُوقُوا مَسَّ سَقَرَ ٤٨ إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ ٤٩ وَمَا أَمْرُنَا إِلَّا وَاحِدَةٌ كَلَمْحٍ بِالْبَصَرِ ٥٠ وَلَقَدْ أَهْلَكْنَا أَشْيَاعَكُمْ فَهَلْ مِنْ مُدَّكِرٍ ٥١ وَكُلُّ شَيْءٍ فَعَلُوهُ فِي الزُّبُرِ ٥٢ وَكُلُّ صَغِيرٍ وَكَبِيرٍ مُسْتَطَرٌ ٥٣ إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي جَنَّاتٍ وَنَهَرٍ ٥٤ فِي مَقْعَدِ صِدْقٍ عِنْدَ مَلِيكٍ مُقْتَدِرٍ ٥٥

“Pa dyshim, keqbërësit janë të humbur (në këtë jetë) **dhe do të digjen në zjarr** (në Jetën Tjetër)**.”**

“Ditën e Gjykimit ata do të tërhiqen me fytyrat e tyre në zjarr (e do t’u thuhet)**: ‘Shijoni zjarrin e Xhehennemit!’”**

“Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar.”

“Ne urdhërojmë vetëm një herë dhe vullneti Ynë përmbushet sa çel e mbyll sytë.”

“Ne tashmë i kemi shkatërruar të ngjashmit me ju (në mosbesim)**. Prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!”**

“Çdo bëmë e tyre është shënuar në librat (e engjëjve që regjistrojnë veprat)**.”**

"Çdo gjë, e madhe a e vogël qoftë, është shënuar (në Leuhi Mahfudh)**."**

"Vërtet, besimtarët e devotshëm do të jenë në kopshtet e Xhennetit, ku rrjedhin lumenj."

"Në kuvendin e së vërtetës (në Xhennet)**, tek një Sundues i Plotfuqishëm."**

Komentimi

Në gradën e vërtetësisë së Një Sunduesi të Plotfuqishëm

Këto ajete janë vazhdimësi e diskutimit të ajeteve të kaluara, rreth gjendjes së politeistëve dhe kriminelëve në Kiamet. Ajeti 46, vuri në pah të vërtetën, se Dita e Kiametit është afati kohor i tyre dhe ajo është Ditë fatkeqe dhe e hidhur, më e hidhura nga të gjitha fatkeqësitë dhe dënimet e kësaj bote.

Në ajetin 47, tregohet arsyeja e kësaj çështjeje. Ajeti thotë: **"Pa dyshim, keqbërësit janë të humbur** (në këtë jetë) **dhe do të digjen në zjarr** (në Jetën Tjetër)**."**[1]

[1] Fjala *"suur"*, ashtu siç e kemi përmendur edhe në ajetin 24 të po kësaj sureje, mbart dy kuptime: së pari, është shumësi i fjalës *"seir"* dhe është në kuptimin e zjarrit flakërues; së dyti, është në kuptimin e çmendurisë, të zemërimit dhe të nervozizmit, të shoqëruar me humbjen e ekuilibrit mendor. Në ajetin në fjalë, ka mundësi të jetë në kuptimin e parë, ose në kuptimin e dytë. Në këtë rast, ajeti mbart këtë kuptim: Ata thoshin se, nëse do të pasonin një njeri të ngjashëm me veten e tyre, ishin të devijuar dhe të çmendur. Kur'ani thotë se në

"Ditën e Gjykimit ata do të tërhiqen me fytyrat e tyre në zjarr (e do t'u thuhet)**: 'Shijoni zjarrin e Xhehennemit!'"** .

Fjala *"sekar"* përdoret me kuptimin e ndryshimit të ngjyrës së trupit nga rrezet e diellit e të ngjashme me këto. Duke pasur parasysh faktin që Xhehennemi këtë transformim e bën shumë më intensiv, njëri nga emërtimet e këtij procesi është *"sekar"*. Me fjalën *"mess"* synohet prekja dhe krijimi i kontaktit, pësimi i asaj gjendjeje, prandaj banorëve të Xhehennemit do t'u thuhet: "Shijojeni! Shijojeni nxehtësinë e madhe dhe djegëse, që do t'ju vijë nga kontakti me zjarrin e Xhehennemit, shijojeni dhe mos thoni që këto janë gënjeshtra, besëtytni dhe trillime.".

Disa janë të mendimit se ky përdorim kuptimor i fjalës *"sekar"* nuk përfshin gjithë Xhehennemin, por emërton vetëm atë pjesë të veçantë të tij, që djeg jashtëzakonisht shumë. Kjo thuhet në një transmetim të Imam Sadikut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*: *"Në Xhehennem ekziston një luginë me emrin Sekar, që është vendi ku futen mendjemëdhenjtë, të cilët, sa herë që marrin frymë, i djeg zjarri i Xhehennemit!"*.[1]

Duke u bazuar nga imagjinata, se këto dënime nuk përputhen me mëkatet respektive, ajeti vijues shton: **"Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar."**.[2]

Siç janë të llogaritura dënimet për veprat përkatëse në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër, dënimet do të merren në bazë të

Ditën e Gjykimit, kanë devijuar dhe janë çmendur, duke mohuar dhe duke përgënjeshtruar të Dërguarit!

[1] Tefsiri "Safi", ajeti në fjalë.

[2] Pra, All'llahu i Madhëruar e ka krijuar gjithçka, sipas paracaktimit të Tij, të shënuar në Librin e ruajtur hyjnor "Leuhi Mahfûdh".

një llogarie të mirëfilltë dhe rendi të saktë, të bëra nga Llogaritësi më i Mirë, Zoti i Gjithësisë. Toka dhe qielli, gjallesat frymore dhe jo frymore, gjymtyrët e trupit të njeriut, mjetet e jetesës, etj., janë krijuar në bazë të një llogarie dhe mase të duhur. Në këtë botë nuk ekziston asnjë gjë, që të mos jetë e matur dhe e llogaritur, sepse Krijuesi i Gjithësisë është Një i Urtë dhe i Shumëditur.

Më pas, ajeti thotë se veprat tona bazohen në urtësi dhe bindje të padiskutueshme, sepse: **"Ne urdhërojmë vetëm një herë dhe vullneti Ynë përmbushet sa çel e mbyll sytë."**.

Për çdo gjë që duam të bëhet, themi: "Bëhu!" dhe ajo bëhet menjëherë. Vullneti i Zotit të Plotpushtetshëm është i padiskutueshëm!

Si rrjedhojë, atë ditë që do të urdhërojmë për Kiametin, sa çel e mbyll sytë, çdo gjë do të vihet në rrugën e Ringjalljes dhe në trupat e vdekur do të lulëzojë një jetë e re.

Atë ditë, Ne, po të do dëshirojmë, i dënojmë kriminelët me anë të rrufeve, ushtimave qiellore, apo tërmeteve, stuhive dhe erërave të forta. Pra, në qoftë se dëshirojmë dënimin e tyre, mjafton të japim vetëm një urdhër dhe menjëherë të gjitha këto realizohen.

Këto shembuj që sjellin ajetet, janë paralajmërime për mëkatarët, që të dinë se Zoti i Madhëruar, ndërkohë që është i urtë, është edhe i rreptë, prandaj le të ruhen dhe të kenë kujdes nga kundërshtimi i urdhrit të Tij.

Ajeti 51, sërish u drejtohet kriminelëve dhe mëkatarëve dhe u tërheq vërejtjen, me anë të përkujtimit të popujve të kaluar:

"Ne tashmë i kemi shkatërruar të ngjashmit me ju (në mosbesim)**. Prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!"**.

Fjala *"eshja'un"* është shumësi i fjalës *"shiatun"*. Kjo fjalë përdoret për të treguar personat që delegohen nga një person dhe shkojnë kudo, duke përhapur idetë dhe çështjet që i përkasin atij dhe i përforcojnë ato. Delegimi i personave është arsyeja, që Shi'izmi përdoret në kuptimin e pasimit dhe ndjekjes së përforcimit të një ideje.

Popujt e kaluar nuk ishin ithtarë të politeistëve të Mekës dhe të ngjashëm me ta, por, duke pasur parasysh që ndjekësit e dikujt janë "të ngjashëm", atëherë fjala "të ngjashëm" përdoret edhe në kuptimin "i përafërt."

Grupi i politeistëve të Mekës frymëzohej nga programet e popujve të kaluar dhe përdorte edhe ideologjitë e tyre, prandaj popujt e hershëm janë quajtur edhe ndjekës, (shi'iat).

Sidoqoftë, ajeti e thekson edhe një herë tjetër këtë realitet, se, në kohën që veprat tuaja, ideologjitë tuaja, besimet dhe sjelljet tuaja janë të ngjashme me ta, nuk ekziston ndonjë arsye që të keni fat të ndryshëm nga fati i tyre. Zgjohuni dhe jini të vëmendshëm!

Ky parim thelbësor tregon se popujt e mëparshëm janë dënuar sipas veprave që kanë kryer, të cilat janë të shënuara me përpikëri në Librin e shënimeve. Ajeti thotë: **"Çdo bëmë e tyre është shënuar në librat** (e engjëjve që regjistrojnë veprat)**."**.

E njëjta gjë ndodh edhe me veprat tuaja, të cilat regjistrohen dhe ruhen të gjitha për Ditën e Llogaridhënies.

Fjala *"zubur"* është shumësi i fjalës *"zebur"* dhe përdoret për të treguar *"librin ku shënohen veprat e njerëzve"*. Disa komentues të tjerë, kanë supozuar se kuptimi i kësaj fjale është *"levhi mahfudhi"*, por ky kuptim nuk përputhet me numrin shumës.

Më pas, për ta theksuar edhe më shumë këtë kuptim, ajeti thotë: **"Çdo gjë, e madhe a e vogël qoftë, është shënuar** (në Leuhi Mahfudh)**."**.

Prandaj është e sigurt se llogaria e veprave atë ditë është një llogari e plotë dhe gjithëpërfshirëse. Kur ky Libër do t'u jepet kriminelëve, ata do të thërrasin me zë të lartë: "Të mjerët ne! Çfarë Libri është ky që nuk paska lënë pa shënuar as gjënë më të vogël?! **"Të mjerët ne, ç'është puna e këtij libri që nuk na ka lënë as mëkat të vogël e as të madh pa e përfshirë?"**.[1]

Fjala *"mustetar"* rrjedh nga fjala *"setr"* dhe përdoret për të treguar *"njerëzit, pemët, apo fjalët, të cilat janë të renditura në një rresht"*.

Edhe ky është një paralajmërim tjetër për politeistët neglizhentë dhe të painformuar.

Tradita e Kur'anit Fisnik është e drejtë, e virtytshme dhe e sinqertë, i paraqet politeistët dhe besimtarët, duke i krahasuar me njëri-tjetrin, sepse nëpërmjet krahasimeve vërehen dallime më të theksuara dhe më të qarta. Prandaj, pasi përmend fatin e politeistëve kriminelë, i bën një përshkrim të shkurtër fatit ngazëllimtar dhe lumturisë shpirtërore të të devotshmëve:

[1] Sure "El Kahf", ajeti 49.

"Vërtet, besimtarët e devotshëm do të jenë në kopshtet e Xhennetit, ku rrjedhin lumenj…".

Fjala *"neher"* dhe fjala *"nehr"* kanë kuptimin: *"kanal me ujë të bollshëm"*. Në këtë kontekst, edhe hapësira e gjerë, mirësia e madhe apo drita e gjerë është quajtur *"neher"*.

Kjo fjalë, në ajetin që po diskutojmë, (pa marrë parasysh hadithin që do ta transmetojmë në vijim), ka mundësi të jetë përdorur për të shënuar ujin e lumit.

Kuptimi i kësaj fjale, në këtë kontekst, mund të përfshijë edhe mirësinë e gjerë të Zotit, dritën dhe ndriçimin e gjerë të Xhennetit, ose dhe të dy kuptimet. Por në një hadith të transmetuar në "Durrul Menthur" nga vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ndër të tjera, thuhet: "Fjala *'neher'* është në kuptimin e hapësirës dhe të gjerësisë dhe jo në kuptimin e ujit që rrjedh.".[1]

Ajeti i fundit që po diskutojmë, që është njëkohësisht edhe ajeti i fundit i sures "El Kamer" i ka bërë një përshkrim më të detajuar pozitës së të devotshmëve: **"...në kuvendin e së vërtetës** (në Xhennet)**, tek një Sundues i Plotfuqishëm."**.

Sa përshkrim mbresëlënës i është bërë pozitës së të devotshmëve! Në të vërehen dy karakteristika, të cilat përfshijnë të gjitha epërsitë:

Së pari, atje është vendi i të vërtetës dhe aty nuk ekziston asnjë lloj falsiteti dhe zbrazëtire. E gjitha është e Vërteta dhe të

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 139.

gjitha premtimet e Zotit në lidhje me Xhennetin, atje do të materializohen plotësisht.

Së dyti, ndodhet në afërsi dhe pranë Zotit, gjë që përftohet nga fjala *"i'nd" - "afër", "tek"*, e cila është shenjë për afërsinë e skajshme, praninë shpirtërore, jo fizike, trupore me Zotin. Ai është i Plotfuqishmi i çdo lloj Begatie dhe Mirësie. Nën urdhrin, administrimin dhe sundimin e Tij është çdo gjë! Ndaj nuk do të kursehet fare nga gostitja e këtyre mysafirëve të nderuar. Vetëm Ai e di se çfarë begatish ka përgatitur për ata!

Në këto dy ajete është interesant fakti se, kur flitet rreth mirësive dhe shpërblimeve të banorëve të Xhennetit, në fillim trajton mirësitë e tyre materiale, që përbëhen nga kopshte të gjera dhe lumenj të rrjedhshëm. Pas asaj diskuton për shpërblimin e tyre të madh shpirtëror, me praninë e Zotit, Sunduesit të Plotfuqishëm. Kjo bëhet me qëllim që njeriun ta parapërgatitë hap pas hapi dhe shpirtin e tij ta lartësojë dhe ta bëjë të fluturojë sa më lart, sidomos përmes përdorimit të shprehjeve të tilla si: "Sunduesi", "i Plotfuqishmi", si dhe "në Kuvendin e të Vërtetës". Të gjitha dëshmojnë se Zoti i do besimtarët dhe kujdeset për ta.

Hulumtime

1- Çdo gjë e universit është e mirëllogaritur

Fjalia: **"Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar."**, zbulon një fakt të rëndësishëm për universin, masa e saktë dhe e paracaktuar në çdo gjë të krijuar në univers.

Sa më shumë që të përparojë dija dhe shkenca njerëzore, aq më shumë njihen dijetarët me këtë harmonizim të paracaktuar dhe të mirëllogaritur, jo vetëm te mikroorganizmat, por edhe në sferat e mëdha qiellore. Për shembull, kemi dëgjuar se astronautët kanë arritur që, me anë të llogaritjeve të sakta shkencore, të cilat kryhen nga qindra specialistë dhe ekspertë nëpërmjet "trurit" elektronik, të ulen në zonën paraprakisht të caktuar të Hënës, edhe pse gjatë kohës që anija kozmike udhëton nga Toka në Hënë, çdo gjë është në lëvizje dhe ndryshim. Hëna rrotullohet rreth vetes dhe rreth Tokës dhe pozita e saj ndryshon në tërësi, madje në momentin e hedhjes së anijes kozmike, Toka lëviz rreth vetes dhe rreth Diellit me një shpejtësi jashtëzakonisht të madhe. Por duke pasur parasysh që të gjitha këto lëvizje të ndryshme dhe të llojllojshme janë të mirëllogaritura dhe të sakta, që absolutisht nuk pësojnë devijim, astronautët arrijnë të ulen pikërisht në zonën e parashikuar dhe të dëshiruar. Astronomët munden të parashikojnë në mënyrë të saktë dhe të përpiktë eklipset e pjesshme dhe të plota që shfaqen në zona të ndryshme të tokës. Të gjitha këto janë shenjë e harmonizimit dhe saktësisë në matjet dhe përmasat e universit të madh.

Te gjallesat e vogla, te milingonat e vogla me ato organe të ndërlikuara dhe të ndryshme, me enët e gjakut dhe nervat, shihet finesa e këtij harmonizimi mahnitës dhe, kur bëhet fjalë për gjallesa edhe më të vogla, që do të thotë organizmat mikroskopike, mikrobet, viruset dhe ameba, finesa në fjalë dhe përmasat e mirëllogaritura, arrijnë kulmin. Këtu llogaritet edhe një e mijëta e milimetrit, madje dhe më të vogël se aq dhe përtej kësaj, në kohën që futemi brenda atomit, duhet t'i flakim tutje të gjitha këto përllogaritje dhe përmasa dhe njësitë matëse arrijnë në një masë aq të vogël, saqë nuk mund të përfytyrohet nga mendja e njeriut.

Kjo përllogaritje nuk qëndron vetëm në çështjen e sasisë, por edhe në cilësinë e kombinimeve të këtyre përmasave dhe matjeve. Sistemi që mbizotëron mbi shpirtin dhe aspektin mental të njeriut, dëshirat dhe instinktet e tij, gjithashtu, ka një përllogaritje të saktë dhe të përpiktë në udhën e dëshirave individuale dhe shoqërore të njeriut, në mënyrë që, nëse tek ai shfaqet ndryshimi më i vogël, atëherë do të kishim shpërbërjen e sistemit të jetës individuale dhe shoqërore.

Në botën e natyrës ekzistojnë gjallesa që janë dëmtuese për njëra–tjetrën.

Zogjtë grabitqarë ushqehen me mishin e zogjve të vegjël, në mënyrë që ata të mos e kalojnë cakun dhe të mos dëmtojnë të gjitha prodhimet, pra, i parandalojnë ato, prandaj kanë edhe jetë të gjatë.

Por, po këta shpendë grabitqarë bëjnë shumë pak vezë, si dhe sjellin shumë pak zogj dhe jetojnë vetëm në kushte të veçanta. Nëse do të ishte parashikuar, që me këtë jetë të gjatë të tyre, ato të

sillnin shumë zogj, atëherë të gjithë zogjtë e vegjël do të zhdukeshin.

Kjo çështje zë një vend shumë të madh në botën e shtazëve dhe të bimëve dhe studimi i saj e informon shumë njeriun në lidhje me thellësinë e fjalisë: **"Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar."**.

2- Paracaktimi i Zotit dhe vullneti i lirë i njeriut

Ka gjasa që ajeti në diskutim dhe të ngjashëm me të, të na japin përshtypjen e iluzionit, sikur çdo gjë që ekziston, është krijuar në bazë të një llogaritjeje dhe përmase të caktuar. Sipas këtij iluzioni të pavërtetë, edhe veprat që kryhen nga njerëzit, janë të krijuara nga All'llahu e për pasojë, ne nuk kemi ndonjë liri.

Por, ashtu siç e kemi trajtuar edhe më parë, veprat tona janë në bazë të paracaktimit dhe vullnetit të Zotit të Madhëruar dhe asnjëherë nuk janë jashtë dëshirës dhe fuqisë së Tij. Por Ai ka përcaktuar, që ne të jemi të lirë në veprimet tona, prandaj për ne ka përcaktuar detyra dhe përgjegjësi, në mënyrë që, nëse nuk do të kishim liri, kjo do të ishte në kundërshtim me paracaktimin e Zotit.

Përkundër ekstremizmit të fatalistëve, dikush tregohet mospërfillës dhe qëndron ekstremisht në anën e kundërt. Këta grupe ata i quajnë "kaderitët" dhe "el mufaudhatu". Ata qartazi thonë: "Veprat tona janë në duart tona dhe Zoti në mënyrë absolute nuk ka punë me punët tona.". Në këtë mënyrë kanë

kufizuar arealin e sundimit të Zotit, veten e kanë konsideruar si të pavarur dhe kanë ndërmarrë rrugën e politeizmit.

E vërteta është se këto dy parime (Monoteizmi në Veprueshmëri dhe Drejtësia) të bashkohen me një kujdes dhe vëmendje të posaçme. Nëse Monoteizmin e komentojmë me kuptimin që Krijuesi i çdo gjëje, madje edhe i veprave tona është vetë Zoti dhe ne nuk kemi asnjë lloj lirie, në këtë rast, kemi mohuar drejtësinë e Zotit, sepse mëkatarët i detyron të kryejnë mëkate dhe gabime e më pas i ndëshkon ata.

Nëse drejtësinë e komentojmë me kuptimin që Zoti nuk ka asnjë lloj ndërhyrje në veprat tona, në këtë rast, Atë e kemi përjashtuar nga sundimi i Tij dhe kemi rënë në rrafshin e politeizmit.

Shprehja "*al emru bejnul emrejn*" është besimi i sinqertë, Rruga e Drejtë dhe linja e mesme, që të besojmë se ne jemi të lirë, por liria jonë, gjithashtu, është me vullnetin dhe mëshirën e Zotit të Madhëruar. Sa herë që All'llahu dëshiron, mund të na privojë nga kjo liri. Kjo është shkolla dhe doktrina e Ehli Bejtit.

Impresionues është fakti se tek ajetet që sapo diskutuam, janë transmetuar hadithe të shumta në librat e komentimit të Ehli Synetit dhe Shi'ave, në lidhje me qortimin e këtyre dy grupeve.

Për shembull, në një hadith të transmetuar nga Profeti i Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "Në mesin e ymetit tim ekzistojnë dy grupe njerëzish, të cilët nuk kanë ndonjë hise në Islam! Ata janë fatalistët dhe

paracaktuesit. Për ta ka zbritur ajeti: **"keqbërësit janë të humbur** (në këtë jetë) **dhe do të digjen në zjarr** (në Jetën Tjetër)**."**.[1]

Fjala *"merxhie"* rrjedh nga rrënja *"irxha"* dhe përdoret me kuptimin e vonimit. Kjo është një shprehje që përdoret për *"fatalistët"* - *"xhebrijjun"*. Këta nuk i kanë marrë parasysh urdhëresat hyjnore dhe janë të përlyer në mëkate, me pretendimin që janë të detyruar, ose besojnë se nuk i dihet dhe nuk është i qartë fati i mëkatarëve, të cilët janë përlyer në mëkate të mëdha. Këtë çështje ia lënë Ditës së Kiametit.[2]

Në një hadith tjetër nga Imam Bakiri *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: "Këto ajete kanë zbritur për Kaderijtë. Në Kiamet, atyre do t'u thuhet: 'Shijojeni Zjarrin e Xhehennemit! Ne çdo gjë e kemi krijuar në bazë të llogarisë dhe matjes.'".[3] (Duke aluduar se, sipas mëkatit, është llogaritur e përcaktuar edhe dënimi i saktë dhe i përpiktë.)

Ky është një tjetër interpretim i këtij ajeti. Ju që ishit mohues të përcaktimit hyjnor, e konsideronit veten si të fuqishëm për çdo gjë dhe Zotin e kishit përjashtuar nga areali i veprave tuaja, tani shikoni fuqinë e Zotit dhe shijojini Dënimin e devijimit tuaj.

---

[1] Ky hadith është transmetuar në "Ruhul Meanij", nga Buhariu, Tirmidhiu, Ibn Maxhah, Ibn Udej, Ibn Merdevije, nga Ibn Abasi, vëll. 27, f. 81. Ngjashëm me këtë hadith, ka përmendur edhe Kurtubiu në tefsrin e tij, vëll. 9, f. 6318.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bahrejn", Made *"Rexha"*.
[3] Tefsire "Nuruth Thakajen", vëll. 5, f. 182.

3- Urdhri i Zotit është vetëm një fjalë e vetme!

E dimë se në mes *"shakut të plotë"* dhe *"pasojës"* nuk ekziston asnjë lloj largësi kohore, prandaj në terminologjinë e filozofëve përparësinë e shkakut ndaj pasojës e konsiderojnë "përparësi në gradë", edhe në lidhje me vullnetin e Zotit të Madhëruar, në raport me çështjen e urdhrit dhe krijimit, që është edhe shembulli më i qartë i shkakut të plotë, apo i vetmi shembull për shkakun e plotë, ku ky koncept është më i qartë.

Prandaj, në qoftë se ajetin: **"Ne urdhërojmë vetëm një herë dhe vullneti Ynë përmbushet sa çel e mbyll sytë."**, e kanë komentuar me fjalën *"bëhu"*, për shkak të pamundësisë së fjalëve për ta qartësuar domethënien tepër të saktë e të prerë. Në fakt, fjala *"kun"* - *"bëhu"* është një fjalë e përbërë nga shkronjat *"k-a-f"* dhe *"n-u-n"* dhe ka nevojë për kohë dhe artikulim. Madje edhe pjesëza *"fa"* te fjala *"fejekun"*, që zakonisht shpreh një lloj kohe, është për shkakun e lartpërmendur dhe ngjason me shprehjen *"kelemhil beser"*[1] (sa hap e mbyll sytë).

Prandaj ajeti 77 i sures "En Nahl", kur flet për urdhrin e Zotit të Madhëruar dhe për Ringjalljen, ngjason me *"lemhil beser"* - *"sa hap e mbyll sytë"*. Ajeti, për ta saktësuar më mirë këtë, shton: **"Çështja e katastrofës** (e Kiametit) **është** (në shpejtësi) **vetëm sa hedh një shikim, ose ajo është edhe më afër..."**.

Sidoqoftë, këtu diskutimi, në lidhje me kohën, bëhet sipas shprehjeve tona të përditshme, që situata të jetë sa më e kuptueshme. Po për këtë arsye, edhe Kur'ani flet me ne, me të njëjtat shprehje të zakonshme. Kurse urdhrat e Zotit të Madhëruar

[1] Fjala *"lemh"* është në kuptimin e ndriçimit të rrymës më pas është përdorur në kuptimin e shikimit të shpejtë.

janë përtej kohës, prandaj përdorimi i fjalës *"vahide"* mund të aludojë se bëhet fjalë për një urdhër që është i mjaftueshëm dhe nuk ka nevojë për përsëritje, ose që Urdhri i Tij, kundrejt të voglit dhe të madhit, të imtës dhe madhështores, madje krijimi i tërë qiejve të mëdhenj nuk ndryshon me krijimin e një grimcë dheu.

Parimisht, e vogla dhe e madhja, e dobëta dhe e forta, e lehta dhe e vështira, ekziston në mendjen tonë si mjaft e kufizuar. Krahasuar me fuqinë e pafund të Zotit, këto koncepte asgjësohen në tërësi dhe çdo gjë merr një formë dhe një ngjyrë.

Por mund të pyesim, lidhur me kuptimin fjalisë: **"me Urdhrin e Tij krijohet çdo gjë"**, a nuk u përputhka kjo me ndodhitë reale të kësaj bote?

Përgjigjja për këtë pyetje bëhet e qartë, duke marrë në konsideratë faktin se urdhri i All'llahut zbatohet kudo dhe vetëm një fjalë e vetme mjafton që të thuhet se edhe realizimi është më i shpejtë se hedhja e një shikimi. Por ajo që ndryshon, është përmbajtja e urdhrit. Në qoftë se fetusin e urdhëron që për nëntë muaj të përfundojë periudhën e vet, këtij urdhri nuk do t'i shtohet asnjë çast dhe as nuk do t'i pakësohet asnjë çast, kurse zbatimi i menjëhershëm i urdhrit konsiston në këtë, që cikli të përmbushet pikërisht në çastin e paracaktuar. Pra, nëse i ka dhënë urdhër rruzullit tokësor, që për njëzet e katër orë të sillet një herë rreth vetes, ky urdhër i Tij është i patjetërsueshëm. Shprehur ndryshe, për urdhrin e Zotit nuk është e nevojshme asnjë periudhë kohore. Është vetë përmbajtja e Urdhrit, e cila paraprakisht ka pasur parasysh ligjin e gravidualitetit të botës materiale, si dhe veçorinë e natyrën e lëvizjes.

4- Fillimi dhe fundi i sures "El Kamer"

Interesant është fakti se surja "El Kamer" fillon me frikën, ankthin dhe paralajmërimin e afrimit të Kiametit dhe mbyllet me lajmin për qetësinë absolute të besimtarëve të drejtë në vendin e të vërtetës dhe te Sunduesi i Plotfuqishëm. E tillë është edhe metoda dhe tradita e edukimit, e cila fillon me ankth dhe frikë dhe përfundon me qetësi të plotë. Pra, i mbledh mendimet e trazuara, i zbut epshet e instinktet rebele, shmang frikën dhe ankthin e brendshëm prej faktorëve të përkohshmërisë, zhdukjes dhe devijimit dhe e zhyt besimtarin në qetësi, prehje, siguri dhe besim në altarin e Mëshirës dhe pranisë së Tij. Vërtet, përqendrimi mbi faktin që Zoti është Pronari pa rival dhe Sundues i papenguar në të gjithë ekzistencën, si dhe faktit që Ai është Dominues dhe i Gjithëfuqishëm, i dhuron njeriut një qetësi të pashembullt.

Disa komentues të Kur'anit, kanë transmetuar se këto dy emërtime të shenjta (Sunduesi dhe Dominuesi) kanë një ndikim të thellë në pranimin e lutjes. Për ta qartësuar këtë, njëri nga transmetuesit sjell shembullin e personit që hyri herët në xhami, duke kujtuar se ishte koha e mëngjesit. Por në xhami pa se nuk kishte njeri tjetër, veç tij, sepse ishte mjaft herët dhe u frikësua. Papritur dëgjon një zë që i thotë të mos ketë frikë, por të thotë këtë lutje: "All'llahume inneke melikun muktedir" dhe më pas të kërkojë çfarë të dojë. Ai pohon se e lexoi atë lutje të shkurtër dhe çdo gjë që kërkoi nga Zoti, u realizua.[1]

O Zoti im! Ti je Sunduesi dhe Dominuesi, të lutem, na dhuro neve një mirësi të atillë, që në saje të besimit, veprës dhe devotshmërisë,

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 27, f. 83.

të gjejmë vendin tonë në kuvendin e të vërtetës, pranë afërsisë dhe mëshirës Tënde madhështore!

O Zot! Ne besojmë se Dita e Gjykimit është tejet e tmerrshme, e hidhur dhe e frikshme për mëkatarët! Atë Ditë, e vetmja shpresë është Mirësia dhe Bujaria Jote!

Zoti ynë! Na jep shpirt të zgjuar dhe mendje vigjilente, për të marrë mësim nga fati i të hershmëve, që të mos ndjekim udhën që i çoi në zhdukje dhe asgjësim!

Sure "Er Rrahman"

Zbritur në Mekë, 75 ajete

Përmbajtja e sures "Er Rrahman"

Surja, në tërësi, shpalos begatitë e ndryshme shpirtërore dhe materiale që Zoti ua ka dhuruar besimtarëve, prandaj edhe vetë kjo sure mund të quhet "Surja e Mëshirës", ose "Surja e Begatisë." Për këtë arsye, kjo sure fillon me emrin e bekuar "Er Rrahman", që tregon mëshirën e gjerë të Zotit dhe përfundon me madhërimin dhe lartësimin e Zotit. Në këtë sure është përmendur 31 herë fjalia: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**. Nëpërmjet saj, ua rrëfen robëve të vet begatitë e shumta.

Nga njëra anë, tërësia e sures është një strukturë organikisht e ndërlidhur dhe flet rreth begative të Zotit të Lartësuar, por në një këndvështrim tjetër, përmbajtjen e saj mund ta ndajmë në pesë pjesë:

Pjesa e parë, që është pjesa hyrëse e sures, diskuton për begatitë e ndryshme të krijimit, edukimin dhe arsimimin, llogarinë dhe matjen, mjetet e mirëqenies njerëzore, si dhe "ushqimet" shpirtërore dhe fizike të njeriut.

Pjesa e dytë, jep një përshkrim mbi çështjen e mënyrës së krijimit të njeriut dhe xhindit.

Pjesa e tretë, vë në pah shenjat dhe ajetet e Zotit të Madhëruar në tokë dhe në qiell.

Pjesa e katërt, diskuton përtej begative tokësore dhe është përqendruar mbi begatitë e Botës së Përtejme dhe shpalos detajet e begative të Xhennetit, përfshirë këtu kopshtet, burimet, frutat, bashkëshortet e bukura dhe besnike dhe llojet e veshjeve.

Në **pjesën e pestë** të kësaj sureje, flitet shkurt , lidhur me fatin e kriminelëve dhe të një pjese të dënimeve të tyre të shimbshme. Por duke pasur parasysh faktin, që thelbi i sures është trajtimi i mëshirës së Zotit, kjo pjesë është lënë jashtë fokusimit të imët dhe Kur'ani nuk ka dhënë shumë sqarime. Përkundrazi, lidhur me begatitë e Xhennetit, ka diskutuar gjerësisht dhe me detaje, në mënyrë që zemrat e besimtarëve t'i mbushë plot me shpresë dhe besim.

Përsëritja e fjalisë: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**, në intervale të shkurtra, i ka dhënë sures një melodi tërheqëse dhe të bukur, duke fituar një elokuencë mahnitëse, prandaj duhet vlerësuar si një gjetje stilistike mjaft e goditur nga Profeti i dashur i Islamit, i cili e përdor në transmetimin e tij: *"Për çdo gjë, është një nuse dhe nusja e Kur'anit është surja 'Er Rahman'!"*.[1]

Fjala *"arus"* - *"nuse"*, në gjuhën perse, përdoret vetëm për gruan, por në kulturën arabe përdoret edhe për burrin, edhe për gruan, pra, si për dhëndrin, edhe për nusen, në momentin që ndodhen të pranishëm në ceremoninë e dasmës.[2]

Duke e ditur që dhëndri dhe nusja, në një ceremoni të tillë, janë në qendër të vëmendjes dhe marrin vlerësimet më të larta, kjo fjalë përdoret metaforikisht edhe për krijesa të tjera shumë të bukura dhe tejet të nderuara.

Nga kjo kuptohet edhe arsyeja se përse për këtë sure është zgjedhur emri "Er Rrahman."

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fillimi i sures "Er Rrahman". Ky hadith është cituar, gjithashtu, edhe në tefsirin "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 140; "Mustedrek", vëll. 4, f. 351.

[2] "Lisanul Arab", tefsiri "Mexhmaul Bejan" dhe "Sihahul Lugat".

Mirësitë e leximit të sures "Er Rrahman"

Duke u nisur nga fakti që kjo sure përcjell ndjenjën e falënderimit te njeriu, si dhe begatitë shpirtërore dhe materiale në këtë botë dhe në Botën Tjetër, në disa transmetime janë përmendur mirësi të shumta për ata që e lexojnë. Leximi i saj ndikon në shpirtin e njeriut dhe bëhet frymëzim për të kryer vepra të mira.

Për shembull, në një hadith, të transmetuar nga i Dërguari i Zotit, lexojmë: "*Kushdo që e lexon suren 'Er Rrahman', Zoti e mëshiron atë dobësinë e tij, e ka kryer falenderimin e Tij dhe Allahu e begaton atë.*"[1]

Në një transmetim tjetër, në "Thevabul A'amal" nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Asnjëherë mos e braktisni leximin e sures 'Er Rrahman' dhe veprimin në bazë të saj, sepse kjo sure kurrë nuk përqendrohet në zemrat e hipokritëve. Zoti i Madhëruar, në Ditën e Kiametit, atë do ta shfaqë në formën e njeriut, me pamjen më të bukur, që mban aromën më të këndshme. Më pas do ta vendosë në një vend që është më pranë Zotit, më afër se kushdo tjetër! Zoti do të thotë për këtë sure: 'Cili person në jetën tokësore i është përmbajtur tematikës tënde dhe ka vijuar me leximin tënd?'*"

Në përgjigje do të thuhet: "*'O Zoti im! Filani dhe filani', ndërkohë fytyrat e tyre do të ndriçojnë dhe Zoti do t'u drejtohet atyre: 'Tani mund të ndërmjetësoni për këdo që dëshironi.'*

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 187.

Ata do të ndërmjetësojnë për të gjithë ata që dëshirojnë dhe nuk do të ndërmjetësojnë për askënd tjetër, përveç atyre që do t'u thuhet: 'Hyni në Xhennet dhe qëndroni aty ku të dëshironi!'".[1]

Në një hadith tjetër, po nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, thuhet se çdo njeri që e lexon suren "Er Rahman", kur arrin në ajetin ku shtrohet pyetja se **"Cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?"**, thotë: *"Zot i Madhëruar, nuk mohoj asnjë nga begatitë e Tua!"*.

Në qoftë se ky lexim është kryer natën dhe personi ka vdekur, do të jetë prej dëshmorëve. Në qoftë se ky lexim është kryer gjatë ditës dhe ka vdekur po atë ditë, po ashtu do të jetë prej dëshmorëve![2]

[1] "Biharul Enuar", vëll. 92, hadithet 1-2, f. 306.
[2] Po aty.

Ajetet 1 - 6

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الرَّحْمَنُ۝١ عَلَّمَ الْقُرْآنَ۝٢ خَلَقَ الْإِنْسَانَ۝٣ عَلَّمَهُ الْبَيَانَ۝٤ الشَّمْسُ وَالْقَمَرُ بِحُسْبَانٍ۝٥ وَالنَّجْمُ وَالشَّجَرُ يَسْجُدَانِ۝٦

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

"I Gjithëmëshirshmi!"

"Ua ka mësuar Kur'anin (robëve të Tij)**",**

"Ka krijuar njeriun",

"Dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë."

"Dielli dhe Hëna ndjekin rrugën e caktuar",

"Bimët dhe pemët i përulen (All'llahut)**."**

Komentimi

Zanafilla e begative Hyjnore

Kjo sure, siç e treguam edhe më parë, shpalos begati dhe mirësi të mëdha të Zotit të Madhëruar. Ajo fillon me emrin e shenjtë "Rrahman", që është simboli i Mëshirës së gjerë të All'llahut. Mëshira është cilësia e All'llahut si *"Rrahman" - "i Gjithëmëshirshëm"* dhe nuk do të shtronte në mënyrë të tillë sofrën e begative për dashamirët dhe për armiqtë.

Prandaj ajetet 1-2 thonë: **"I Gjithëmëshirshmi**[1] **ua ka mësuar Kur'anin** (robëve të Tij)**."**.

Në këtë mënyrë, "mësimin e Kur'anit" e trajton si begatinë e parë dhe më të rëndësishmen. Sa shprehje interesante dhe sa domethënëse! Nëse reflektojmë dhe mendojmë në mënyrë të denjë, Kur'ani Fisnik është burim i të gjitha begative dhe i mundësive për të përfituar prej tyre. Interesant është fakti që begatia e "mësimit të Kur'anit" është përmendur para çështjes së "krijimit të njeriut" dhe "mësimit të të folurit të tij të qartë", ndërkohë që, sipas renditjes natyrore, në fillim duhet të ishte përmendur krijimi i njeriut, pastaj të përmendeshin: begatia e të folurit të tij të qartë dhe e mësimit të Kur'anit.

[1] Fjala "Er Rrahman" është kryefjalë, kurse fjala "alemel Kur'an" është kallëzuesi i tij dhe *"khalekel insan"* është kallëzues i dyfishtë. Për formimin e kësaj fjalie, gjithashtu, kanë dhënë mendime të shumta, por, meqenëse ishin të parëndësishme, kemi hequr dorë nga përmendja e tyre.

Por Madhështia e Kur'anit kërkon që Kur'ani të përmendet i pari, edhe pse kapërcehet renditja natyrore: **"Ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë."**.

Ky ajet u përgjigjet politeistëve arabë të kohës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përmendi emrin "Er Rrahman" dhe i ftoi t'i përuleshin Zotit në sexhde, ata, duke u justifikuar, thanë: "E çfarë është Rrahmani, Mëshiruesi?".[1]

Kur'ani thotë se Zoti i Mëshirshëm është Ai që ia ka mësuar Kur'anin, ka krijuar njeriun dhe ia ka mësuar atij mënyrën e të folurit qartë.

Sidoqoftë, emri "Rrahman", pas emrit "All'llah", në mesin e të gjithë Emrave të Zotit, ka kuptimin më të gjerë; sepse e dimë që Zoti i Madhëruar ka dy mëshira: mëshirën e përgjithshme dhe mëshirën e veçantë. Emri "Rrahman" është tregues për "mëshirën e përgjithshme të All'llahut", e cila përfshin çdo gjë (krijesë), kurse emri "Rrahim" është tregues për një "mëshirë të veçantë të Tij", që u përket vetëm besimtarëve, të devotshmëve dhe të bindurve. Ndoshta, është kjo arsyeja që emri "Rrahman", përveç Zotit, nuk përdoret për ndonjë gjë tjetër, vetëm nëse shoqërohet me fjalën "abd", kurse tipari "Rrahim" u referohet edhe të tjerëve, sepse "mëshira e veçantë", edhe pse mund të jetë e dobët, ekziston edhe në mesin e njerëzve dhe të krijesave të tjera.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të)*, lexojmë: "Rrahman është emër i përveçëm, por

[1] Sure "El Furkan", ajeti 60.

tipar i përgjithshëm, që do të thotë se është një emër, i cili i përket vetëm Zotit, por mëshira e Tij u përket të gjithëve. Ndërsa emri "Rrahim" është një emër i përgjithshëm, por tipar i veçantë, që do të thotë se përdoret edhe për Zotin, edhe për krijesat, ashtu si Kur'ani e prezanton Profetin e Islamit si të mëshirshëm.[1] Por kuptimi i konceptit të mëshirës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është një mëshirë e veçantë dhe e caktuar).".[2]

Prandaj Zoti i Madhëruar e zgjodhi njeriun dhe ia mësoi Kur'anin. Komentuesit kanë shprehur mendime të ndryshme lidhur me këtë dukuri. Disa prej tyre kanë pohuar se Zoti i Madhëruar ia ka mësuar Kur'anin Xhebrailit dhe engjëjve. Komentues të tjerë kanë thënë se ia ka mësuar vetë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Një grup i tretë komentuesish, kanë thënë se ua ka mësuar të gjithë njerëzve, madje edhe xhindëve.

Meqenëse kjo sure vë në pah mëshirën e pafundme të Zotit ndaj njeriut dhe xhindit, në ajetin 31, pas diskutimeve të këtyre begative, i pyet ata: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Në këtë kontekst, shihet përshtatja me komentimin e fundit, që Zoti, këtë Kur'an ia mësoi njerëzimit dhe xhindëve, nëpërmjet Profetit të madh, Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[3]

---

[1] Sure "Et Teube", ajeti 128.

[2] "Misbah Kef'ami", f. 317.

[3] Në lidhje me atë që a është përjashtuar pësorja e parë apo e dytë e fjalës *"al leme"*, komentuesit kanë mendime të ndryshme. Mendimi më i përshtatshëm

Pas begatisë së pashembullt të Kur'anit, Zoti ka përmendur begatinë tjetër më të rëndësishme, kur thotë se **"ka krijuar njeriun"**.

Pa dyshim që synimi i krijimit të njeriut këtu, është lloji i tij e jo Profeti Adem *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, sepse në disa ajete vijuese, ka diskutime lidhur me këtë çështje.

Begatia e të shprehurit, është një dëshmi tjetër që vërteton se me termin "krijimi i njeriut" nënkuptohet lloji njerëzor. Prandaj komentimet e tjera nuk duken të sakta.

Me të vërtetë, krijimi i llojit njerëzor është një mrekulli mahnitëse në univers, ku ndërthuren makrokozmosi (bota e madhe) dhe mikrokozmosi (bota e vogël). Një mrekulli tjetër, bashkërenditur kësaj, është edhe harmonia e përsosur e universit, me të gjitha dimensionet e ekzistencës së tij.

Zanafilla e tij nuk është gjë tjetër veçse një mikroorganizëm që lundron brenda një fare të pavlefshme, por në saje të orientimit të Zotit, i tejkalon etapat e përsosjes në mënyrë të atillë, që arrin pozitën e krijesës më fisnike.

Përmendja e emrit të njeriut, pas Kur'anit, tërheq vëmendje dhe është e rëndësishme, sepse Kur'ani është tërësia e sekreteve të universit, në formë të shkruar, kurse njeriu është përmbledhja e këtyre sekreteve dhe enigmave, në formën e krijimit. Secila nga këto është një variant i kësaj bote të madhe dhe të gjerë.

është: Përsorja e parë është përjashtuar. Në thelb, ka qenë e tillë: **"al'lemel insane uel xhinnel kur'an"**. Ndërsa mendimi se fjala *"al leme"* nuk ka marrë më shumë se një objekt dhe është në kuptimin e vendosjes së shenjës, duket i papranueshëm.

Ajeti vijues përmend një nga begatitë më të rëndësishme, pas begatisë së **"krijimit të njeriut"**, kur thotë: **"i ka mësuar atij të folurit e qartë"**.

Kuptimi leksikor i fjalës *"bejan"* është mjaft i gjerë dhe përdoret për çdo gjë që është e shpjeguar qartë. Ky kuptim nuk përfshin vetëm të shprehurit dhe të folurit, por përfshin edhe të shkruarit, edhe llojet e ndryshme të argumenteve racionale dhe logjike, të cilat japin sqarime për çështjet e ndërlikuara. Që të gjitha këto, përmblidhen në kuptimin e fjalës "*bejan*", edhe pse më e shquara e tërësisë së kuptimeve, është "*të folurit*".

Edhe pse të folurin tonë të përditshëm ne e mendojmë si një çështje të rëndomtë, në realitet, "procesi i të folurit" përbën veprën më të ndërlikuar dhe më delikate të njeriut, madje mund të themi që asnjë vepër e njeriut nuk është kaq e ndërlikuar dhe delikate sa "procesi i të folurit".

Ky është një proces i ndërlikuar, se kërkon një botë të përsosur të shumë organeve që shërbejnë për të krijuar shqiptimin e tingujve zanorë. Disa prej tyre, si dhe funksionet përkatëse, po i përmendim shkurt: mushkëritë që mbledhin brenda vetes ajrin dhe në mënyrë graduale e nxjerrin atë nëpërmjet trakesë, kordat vokale me dridhjet e tyre i japin formë zërit dhe krijojnë zëra krejtësisht të ndryshëm, si zëra pohues, mohues, miratues, kundërshtues; që shprehin zemërim, gëzim; që kërkojnë ndihmë;, që shprehin dashuri, armiqësi etj, etj.

Më pas, këto zëra vokalë, me anë të buzëve, gjuhës, dhëmbëve dhe hapësirës së gojës krijojnë tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të alfabetit, me një shpejtësi dhe finesë të veçantë. Shprehur ndryshe, ai zë i vazhdueshëm dhe monoton që

del nga gryka, kalon përmes "pengesash" të ndryshme dhe formon tingujt përkatës.

Nga ana tjetër, lind çështja e krijimit të fjalëve të reja, si nevojë e përshtatjes dhe e ndjekjes së zhvillimit të shpejtë ekonomiko-social-kulturor-shoqëror-shpirtëror, etj. Për njeriun, nuk ekziston asnjë lloj kufiri në krijimin e fjalëve të reja. Po të mendosh se numri i gjuhëve ekzistuese në këtë botë është i madh, është tejet e vështirë të llogarisësh se sa fjalë dhe gjuhë krijohen kohë pas kohe.

Pranohet se janë tri mijë gjuhë të gjalla sot në botë, megjithëse disa studiues mendojnë se ekzistojnë më shumë se ky numër.[1] Por pranimi i tri mijë gjuhëve, lidhet me faktin e gjuhëve kryesore aktive dhe të gjalla, pra, që shkruhen e fliten.

Së treti, lind çështja sintaksore, e rendit të fjalëve në fjali dhe e strukturës së fjalisë, të cilat janë vendimtare për të ndërtuar një fjali që të shprehë qartë, saktë dhe bukur mendimin që mbart. Vlerat e tjera stilistikore janë të shumta. Zotërimi dhe përdorimi i tyre, si dhe sa duhet në fjali, i japin nuanca kuptimore saktësuese që shoqërojnë ndjenjat, tregojnë shkallën intelektuale, kulturore, shkencore përkatëse. Prandaj thuhet se procesi i të folurit është art. Ai u përket vetëm njerëzve.

Edhe kafshët nxjerrin tinguj të ndryshëm, por kurrë nuk mund të thuhet se ato i përkasin procesit të të folurit, i cili, paraprakisht, kërkon edhe procesin e të menduarit, pa të cilin nuk do të kishte as ligjërim. Madje, lidhja mes procesit të të menduarit

[1] "Enciklopedia", Ferid Vuxhdij, vëll. 8, Neni "Fjalori", f. 364.

dhe të të folurit, u përket vetëm njerëzve. Këtë dhuratë ua ka dhënë njerëzve Zoti i Madhëruar.

Nga sa thamë, kuptohet se përmes procesit të të folurit, njeriu ka pasur mundësinë t'ua transmetojë brezave pasardhës përvojat dhe dijet e tij, të cilat përsosen dhe pasurohen nga brezi në brez dhe zhvillohen gjithnjë e më tej me shkencën dhe kulturën materiale, shpirtërore njerëzore. Kjo është një nga begatitë e mëdha që Zoti i ka dhënë njeriut.

Pas këtij sqarimi të shkurtër, kuptojmë më së miri se përse në këtë sure, pas begatisë së krijimit të njeriut, është përmendur begatia e **"mësimit të të folurit"**. Prandaj surja "Er Rahman" është një tërësi e begative të mëdha të Zotit.

Më pas Zoti përmend begatinë e katërt të madhe, prej begative të Tij: **"Dielli dhe Hëna ndjekin rrugën e caktuar."**.[1]

Vetë ekzistenca e diellit konsiderohet si një prej begative më të mëdha për njeriun, sepse pa dritë dhe ngrohje, të përftuara nga ai, jeta do të ishte e pamundur në Sistemin Diellor. Këtë çështje e kemi trajtuar edhe më parë dhe kemi thënë se çdo lëvizje dhe aksion që ndodh në planetin tonë, ka si burim kryesor dritën dhe ngrohtësinë e diellit. Zhvillimi dhe rritja e bimëve dhe të gjitha lëndëve ushqimore, rënia e shiut, fryrja e erës, që të gjitha janë falë kësaj Mirësie Hyjnore.

Edhe hëna, gjithashtu, nga ana e saj, luan një rol të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe, përveç ndriçimit të netëve të

[1] Fjala *"husban"* është pjesore dhe është në kuptimin e llogaritjes dhe renditjes. Në ajet është bërë një përjashtim dhe në thelb ka qenë: *"ue shembu uel kameru texhrijani bi husban"*.

errëta, graviteti i saj është burimi i baticë-zbaticës në oqeane, është një faktor për vazhdimin e jetës në dete, si dhe ujitjen e shumë brigjeve. Hëna, me forcat e saj tërheqëse, baticë-zbaticë, bën që edhe lumenjtë të derdhen në detet në afërsi të tyre.

Përveç gjithë këtyre që u tha më sipër, rrotullimi i Hënës rreth Tokës dhe rrotullimi i Tokës rreth Diellit çojnë në formimin e rregullt të natës dhe të ditës, të viteve, të muajve dhe të sezoneve të ndryshme, të cilët janë faktorë të pazëvendësueshëm të funksionimit të jetës së njerëzve, të planifikimit të çështjeve tregtare, industriale dhe bujqësore. Në qoftë se nuk do të ishte ky proces i rregullt, jeta e njerëzve asnjëherë nuk do të sistemohej.

Jo vetëm lëvizja e këtyre planeteve ka një renditje shumë të saktë dhe të përpiktë, por edhe përmasa e trupave qiellorë, graviteti i tyre, largësia që kanë nga Toka dhe nga njëri–tjetri, realizohen sipas një përllogaritjeje tejet të saktë. Për këtë saktësi, Kur'ani përdor fjalën *"husban"* - "*mirëllogaritje*". Është e sigurt se pa këtë mirëllogaritje, secila nga këto çështje, do të ndërhynte me çështje të tjera në sistemin diellor dhe do të krijoheshin trazira të mëdha në gjithë universin.

I çuditshëm është fakti se, kur pjesët përbërëse të këtij sistemi, u ndanë nga sfera e Diellit, dukeshin shumë të çoroditura dhe të paorganizuara, por më në fund u sistemuan në trajektoret e lëvizjeve të tanishme. Për këtë dukuri, një prej shkencëtarëve të natyrës, shprehet: "Sistemi ynë Diellor është krijuar nga përzierja e materieve dhe elementeve (në dukje) të çoroditura, që janë ndarë nga Dielli, me një nxehtësi prej 12 mijë gradë celsius dhe me një shpejtësi të paimagjinueshme, duke u shpërndarë në hapësirën e pafundme. Por, po në këtë kaos sipërfaqësor dhe

transformim atmosferik, është krijuar një rend dhe sistem i rregullt, aq i saktë dhe i përpiktë, saqë edhe sot mund të parashikojmë çastet dhe momentet e ngjarjeve të së ardhmes. Rezultati i këtij rregulli dhe rendi tregon se çështjet kozmike dhe astrale, për mijëra milionë vite me radhë, kanë mbetur të pandryshueshme.".[1]

Është e rëndësishme të mbahet parasysh se Dielli që gjendet në mes të Sistemit Diellor, duket se qëndron konstant dhe pa lëvizje. Por edhe ai, së bashku me të gjithë planetet që sillen rreth tij, është në lëvizje drejt një pike të caktuar, të njohur si Ylli Vega. Edhe kjo lëvizje, gjithashtu, i nënshtrohet një rregulli dhe rendi të përcaktuar saktë.

Begatia e pestë e madhe që vjen nga qielli në Tokë, thotë: **"Bimët dhe pemët i përulen** (All'llahut)**."**.

Fjala *"nexhm"* përdoret në dy kuptime. Edhe në kuptimin e yllit, edhe në kuptimin e bimës pa kërcell. Kur shoqërohet me nënkuptimin e fjalës *"shexhere" - "pema"*, synohet kuptimi i dytë, bima pa kërcell.[2]

Kjo fjalë, në një kontekst më të specifikuar, përdoret për të shënuar lindjen e dritës, agimin. Por, kur kjo fjalë përdoret edhe për bimën që përmendëm, kjo bëhet, sepse pikërisht kjo bimë mbin dhe ngre krye e drejtohet në mëngjes. Prandaj edhe yllin e quajnë *"nexhm"*, sepse lind në mëngjes.

E dimë se pothuajse të gjitha lëndët ushqyese të njerëzimit burojnë nga bimët. Një pjesë të tyre i konsumon njeriu, kurse një

[1] "Sirru khalkil insani", f. 28.
[2] Ragib, në "Mufredat" shprehet: *"en nexhmu ma lasak lehu minel nebat"*.

pjesë tjetër shkon për ushqimin e shtazëve, të cilat, edhe ato, bëjnë një pjesë prej lëndëve ushqimore të njeriut. Kjo është e saktë, edhe në rastin e kafshëve të detit. Edhe ato, gjithashtu, ushqehen nga bimë shumë të vogla, të cilat mbijnë në çdo cep dhe kënd të detit.

Atëherë përmbajta kuptimore e fjalës "*nexhm*" përfshin llojet e bimëve të vogla dhe zvarranike (si për shembull, shkurrja e kungullit, e kastravecit dhe të ngjashme me to), kurse me fjalën "*shexhere*" emërtohen llojet e bimëve me kërcell, si për shembull: drithërat dhe pemët frutore dhe të ngjashme me to.

Përdorimi i shprehjes "*jesxhudan*" tregon se të gjitha llojet e bimëve, të mëdha a të vogla, në tokë a në det qofshin, i përulen All'llahut, pa kushte dhe sipas rregullave të krijimit, në funksion të interesave të njerëzve, siç e ka përcaktuar Zoti i Gjithëdijshëm.

Gjithashtu, është tregues për misteret e tyre monoteiste, sepse në çdo gjethe dhe në çdo farë të bimës, ekzistojnë shenja të çuditshme dhe mahnitëse të madhështisë dhe dijes së Zotit dhe çdo fletë është një "fletore" për njohjen e Zotit.[1]

Kuptimi i fjalës "*nexhm*", në ajetin e lartpërmendur, lidhet më së shumti me yjet, por shpjegimet që bëmë më lart, përputhen më shumë me dëshmitë e përmendura në ajet.

[1] Në lidhje me kuptimin e sifjalisë *"krijesat e ndryshme të universit bëjnë sexhde"*, kemi diskutuar më gjerësisht në vëllimin 14, faqe 48, e tutje (ajeti 18, sure "El Haxhxh"); po ashtu në vëllimin 12, faqe 133, e tutje (ajeti 44, sure "El Isra").

Hulumtim

Një vëzhgim mbi disa transmetime

Në burimet e literaturës islame, në lidhje me ajetet e lartpërmendura, janë transmetuar disa hadithe, të cilat janë si komente të përgjithshme me shembuj të qartë. Secili prej tyre shpjegon një pjesë të ajeteve, si për shembull: Në një hadith, Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, për shprehjen: *"al lemehul bejan"*, thuhet: "Fjala *'bejan'* është po ai *'ismi a'zam' - 'emri më i madh'*, nëpërmjet të cilit mësohen të gjitha gjërat.".[1]

Në lidhje me "emrin më të madh" dhe interpretimin e tij, e kemi diskutuar më gjerësisht në komentimin e ajeti 180, sure "El A'raf".

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Musa Ridha *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, thuhet se kuptimi i shprehjes "Er Rahman al'lemehul Kur'an" është ky: "Zoti i Madhëruar, ia mësoi Kur'anin Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kurse me shprehjen *'khalekel insan'*, synohet krijimi i Imam Aliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Shprehja *"al lemehul bejan"*, synon të gjitha çështjet për të cilat njerëzit kanë nevojë.

Është e qartë se transmetimet e lartpërmendura, nuk e përkufizojnë saktësisht kuptimin e përgjithshëm të këtyre ajeteve, por vetëm sa na udhëzojnë drejt, përmes shembujve të qartë.

[1] Tefisiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f 197.

Ajetet 7 – 13

وَالسَّمَاءَ رَفَعَهَا وَوَضَعَ الْمِيزَانَ٧ أَلَّا تَطْغَوْا فِي الْمِيزَانِ٨ وَأَقِيمُوا الْوَزْنَ بِالْقِسْطِ وَلَا تُخْسِرُوا الْمِيزَانَ٩ وَالْأَرْضَ وَضَعَهَا لِلْأَنَامِ١٠ فِيهَا فَاكِهَةٌ وَالنَّخْلُ ذَاتُ الْأَكْمَامِ١١ وَالْحَبُّ ذُو الْعَصْفِ وَالرَّيْحَانُ١٢ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ١٣

“Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Balancën (për çdo gjë)**”,**

“që ju të mos e shkelni atë.”

“Prandaj matni drejt e mos hani në peshë!”

“Ai e ka bërë Tokën për krijesat.”

“Aty ka fruta të llojllojshme dhe palma hurmash me frutat si bistaqe”,

“ka drithëra me gjethe e kërcej dhe bimë me erë të mirë.”

“Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!”

Komentimi

Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë ekulibrin për çdo gjë

Edhe këto ajete, si ajetet e kaluara, shprehin begatitë e Zotit të Madhëruar. Edhe në ajetet e mësipërme, u diskutua për pesë begati të mëdha dhe më të rëndësishme të Zotit. Prandaj ne do të diskutojmë për begatinë e gjashtë të Zotit, për begatinë e krijimit të qiellit: **"Ai e ka ngritur qiellin lart…"**.

Fjala *"sema" - "qielli"*, në këtë ajet, qoftë kur përdoret në kuptimin e drejtimit lart, qoftë kur emërton planetet qiellore apo atmosferën e tokës, pra, shtresën e madhe ajrore që ka rrethuar gjithë rruzullin tokësor dhe e mbron tokën nga rrezet e dëmshme kozmike dhe nga meteorët qiellorë, që e ndihmon të mbajë nxehtësinë e diellit dhe lagështinë e ngritur nga deti për formimin e reve dhe rënien e shiut, janë një mirësi dhe begati e madhe dhe e pashembullt, sepse pa ato është e pamundur, ose e mangët jetesa e njerëzve.

Po, drita dhe ndriçimi që është burim i ngrohjes, i jetës dhe i lëvizjes, vjen nga qielli, shiu bie nga qielli. Edhe Shpallja, gjithashtu, ka ardhur nga qielli. Në këtë rast, qielli përbën një koncept që përfshin edhe shpirtëroren, edhe materialen.

Përveç kësaj, ky qiell i ngritur lart, me të gjitha konceptet e tij, është një shenjë e madhe prej shenjave të Zotit. Njeriu, në

rrugën e njohjes, ka thelluar njohuritë, ka filluar të meditojë e të thotë: **"Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh!"**.[1]

Më pas trajton begatinë e shtatë: **"dhe ka vënë Balancën** (për çdo gjë)**".**

Fjala *"mijzan"* nënkupton çdo lloj pajisje matëse që shërben për matjen e të vërtetës, të falsitetit, matjen e drejtësisë, të padrejtësisë dhe të dhunës, matjen e vlerave dhe të drejtave të njeriut në fazat dhe drejtimet e ndryshme shoqërore.

Fjala *"mijzan"* përfshin çdo ligj natyror dhe urdhër Sheriati, që në një lloj mënyre, janë mjete matëse.

Fjala *"mijzan"* përdoret edhe në kuptimin e peshores dhe mjetit të matjes së rëndesës së sendeve, por pa dyshim që pesha *(mijzani, balanca)* e përmendur në këtë ajet, pasi është përmendur krijimi i qiellit, ka një koncept dhe domethënie të gjerë, dhe përfshin çdo mjet matës dhe të gjitha ligjet e krijimit dhe ligjvënies. Pra, nuk është vetëm mjet i matjes së rëndesës së sendeve dhe të mallrave.

Parimisht, ngritja e qiellit dhe rendi i saktë që mbizotëron mbi miliona sfera qiellore, nuk është e mundur pa matje, balanca dhe ligje të mirëllogaritura.

Fjalën *"mijzan"*, e cila haset shpesh, është interpretuar në kuptimin e drejtësisë, të Sheriatit dhe të peshores. Secili interpretim është tregues për disa nga shembujt e këtij koncepti të përgjithshëm dhe të gjerë.

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 191.

Nga ajeti vijues, nxirret një përfundim interesant, në lidhje me këtë çështje: Qëllimi i vënies së peshores, është ky: **"që ju të mos e shkelni atë"**.

Edhe ju, gjithashtu, jeni një pjesë e kësaj bote të madhe dhe asnjëherë nuk mund të jetoni në këtë botë të madhe si një shtojcë me ngjyrim të ndryshëm. Bota ka një rend dhe një matës, edhe ju duhet të keni një rend dhe matës.

Nëse kësaj bote të madhe, do t'i hiqej matja dhe ligji, ajo do të merrte udhën e zhdukjes dhe të asgjësimit. Në qoftë se jeta juaj do të ishte pa rend, pa rregull dhe matje, ju do të shkonit drejt zhdukjes.

Ajeti sërish i referohet çështjes së drejtësisë dhe peshores: **"Prandaj matni drejt e mos hani në peshë!"**.

Duhet të kemi parasysh se në këto ajete, fjala *"mijzan"* është përmendur tri herë, edhe pse Zoti i Madhëruar, në rastin e dytë dhe të tretë, mund të përdorte përemrin. Kjo tregon se fjala *"mijzan"*, e përmendur në këto tri ajete, është në tri kuptime të ndryshme. Përdorimi i përemrit do t'i përgjigjej saktësisht të tri konteksteve të ajeteve, sepse, në fazën e parë, flitet për matjen, kriteret dhe ligjet, që Zoti ka përcaktuar në të gjithë universin, kurse në fazën e dytë, flitet për mosrebelimin e njerëzve në të gjitha parimet (kriteret) e jetës individuale dhe shoqërore, që natyrisht ka një hapësirë kuptimore të ndryshme nga çështja e trajtuar në fazën e parë.

Në fazën e tretë, është përqendruar në çështjen e peshimit, në kuptimin konkret të tij dhe urdhëron që në matjen dhe peshimin e gjërave gjatë tregtisë, të mos lenë ndonjë gjë mangët.

Edhe këtu kuptimi është specifik, krahasuar me dy të parat, prandaj përdorimi i përemrit nuk do të ishte preferencë e saktë kuptimore dhe gjuhësore.

Në këtë mënyrë, në ajetet e lartpërmendura, është përdorur një kohezion interesant, në formë hierarkie, në lidhje me çështjen e matjes dhe të peshimit, e cila nga rrethet e mëdha, ka kaluar në rrethe më të ngushta.[1]

Rëndësia e matjes, pavarësisht nga kuptimi, luan një rol të rëndësishëm në jetën e njeriut. Në qoftë se edhe për një ditë të vetme e heqim nga faqja e dheut shembullin më të vogël dhe të kufizuar të matjes, pra, "peshoren", do të ndodhnin rrëmujë e trazira, grindje e përleshje gjatë shkëmbimit të mallrave.

Nga ajo që thamë më lart, bëhet e qartë se pse në disa hadithe, fjala *"mijzan"* është komentuar e lidhur ngushtë me figurën e *"imamit"*. Kjo figurë e bekuar, Imami i pagabueshëm, është një mjet për dallimin e të vërtetës nga e pavërteta, një kriter për përcaktimin dhe dallimin e të vërtetave dhe një faktor ndikues për udhëzimin.[2] Po ashtu, interpretimi i fjalës *"mijzan"*, në Kur'anin Fisnik i referohet po këtij kuptimi.

Sidoqoftë, duke pasur parasysh faktin, se të gjitha këto ajete, janë në kontekstin e përmendjes së begative të Zotit, bëhet e qartë se "matja", qoftë në tërë universin, qoftë në shoqërinë

[1] Fakhru Rrazij, në tefsirin e tij, thotë: "Fjala *'mijzan'*, në ajetin e parë, është emri i një mjeti (si mjet matës); në ajetin e dytë, është në kuptimin e paskajores (që do të thotë peshuar); kurse në ajetin e tretë, është në kuptimin e kundrinorit (që do të thotë, mallin e peshuar).".

[2] Ky hadith është cituar në tefsirin e "Ali bin Ibrahimit", nga Imam Ali bin Musa Riza ,hadithi është i detajuar. Ne këtu kemi përmendur vetëm një pjesë të tij (tefsire "Ali bin Ibrahim", vëll. 2, f. 343).

njerëzore dhe marrëdhëniet sociale, qoftë në punë, biznes dhe tregti, është një prej begative të çmueshme të Zotit të Madhëruar.

Më pas, nga qielli kalon në tokë dhe thotë: **"Ai e ka bërë Tokën për krijesat."**.

Fjalën *"enam"*, disa e kanë interpretuar në kuptimin e *"njerëzve"*; disa të tjerë në kuptimin e *"njerëzve dhe të xhindëve"* dhe ndonjëherë e kanë interpretuar edhe në kuptimin e *"çdo gjallese të gjallë"*.

Një grup nga dijetarët e fushës së leksikografisë dhe komentues të Kur'anit e kanë komentuar edhe në kuptimin e *"krijimit absolut"*. Por dëshmitë ekzistuese dhe retorika e sures që i drejtohet xhindëve dhe njerëzve, tregon se kuptimi i fjalës së përdorur, në këtë kontekst, është ai që përfshin xhindët dhe njerëzit.

Por Toka, e cila këtu u përmend si një begati e madhe hyjnore, në ajete të tjera kur'anore është përmendur si *"mihad"* - *"djep"*, si një vendqëndrim, (shtrirje) e sigurt, e qetë dhe e gatshme, rëndësia e të cilës, për shumicën nga ne, në kushte normale është e paperceptueshme, por në kohën që ndodh një tërmet i vogël në tokë dhe shkatërron çdo gjë, ose një vullkan e varros qytetin nën magmën dhe elementet e shkrira, si dhe tymin e zjarrit, arrijmë të kuptojmë këtë realitet. Arrijmë të kuptojmë se çfarë begatie dhe mirësie e madhe është për ne kjo tokë e qetë, sidomos nëse e mendojmë në lidhje me atë që kanë thënë shkencëtarët dhe dijetarët, në lidhje me shpejtësinë e lëvizjes së

Tokës rreth vetes dhe rreth Diellit. Atëherë do të bëhej edhe më e qartë rëndësia e këtij fakti.[1]

Përdorimi i fjalës *"vez'aa"*, për tokën, dhe i fjalës *"ref'a"*, për qiellin, është tregues i vënies së gjithë të mirave që ato kanë në shërbim të njeriut, siç thuhet edhe në ajetin 15 të sures "El Mulk": **"All'llahu juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij. Vetëm te Ai është e ardhmja."**.

Në këtë mënyrë, përcaktohet edhe begatia e madhe, e teta në radhë, në këtë seri begatish.

Në ajetin vijues, përmend begatinë e nëntë dhe të dhjetë, prej begative hyjnore, që lidhen me një pjesë të lëndëve ushqyese të njeriut: **"Aty ka fruta të llojllojshme dhe palma hurmash me frutat si bistaqe…"**.

Fjala *"fakihatun"* është emër i përgjithshëm, që nënkupton çdo lloj fryti. Edhe Ragibi është shprehur kështu në veprën "Mufredat". Ata që këtë fjalë e interpretojnë se emërton të gjitha frutat, me përjashtim të hurmës, nuk kanë asnjë argument. Hurma është përmendur në mënyrë të veçantë në ajet. Përmendja e saj, e hurmës, edhe me emër të veçantë, edhe me emrin përgjithësues, mund të lidhet me vlerat e veçanta të saj dhe të palmës, siç thuhet në ajetin 11 të sures "En Nahl" dhe në ajetin 25 të sures "Merjem". Kemi bërë një diskutim më të detajuar për dobitë e hurmës, për nga pikëpamja e ushqimit dhe lëndëve të ndryshme jetëdhënëse të saj.

[1] Shpejtësia e lëvizjes së Tokës rreth Diellit është afërsisht 35 kilometër për sekondë. Shpejtësia e kalimit të saj rreth vetes, është afërsisht 1600 kilometër në orë (në zonat Tropikale).

Fjala *"ekmam"* është shumësi i fjalës *"kimm"* dhe nënkupton lëvozhgat, të cilat i mbulojnë frutat. Fjala *"kum"* është në kuptimin e mëngës që mbulon pjesën e krahut, kurse fjala *"kumme"* është në kuptimin e një skufje nate që mbulon kokën.[1]

Përzgjedhja e këtij përshkrimi, në lidhje me frytin e pemës së palmës, i cili në fillim është i fshehur në një lëvozhgë, bishtajë, më pas lëvozhga lulëzon dhe tufëza e palmës del jashtë me një formë interesante, ka gjasa që të jetë për shkak të bukurisë së saj mahnitëse, ose për shkak të dobive që janë të fshehura në atë tufëz. Ajo ka ekstrakte dhe vajra esenciale të veçanta, që kanë veti ushqyese dhe farmaceutike. Përveç kësaj, kjo tufëz, ngjashëm me mitrën e nënës që i "kultivon" brenda vetes "fëmijët" e palmës, i mbron nga ngacmime dhe në kohën që janë në gjendje të vazhdojnë rrugën vet, të përballen me kushtet atmosferike dhe të dritës së diellit, tufëza veçohet mënjanë.

Përveç asaj që u tha më lart, karakteristika e veçantë e frytit të kësaj peme, është se në fillim është në formën e lëvozhgës, më pas shfaqet në formën e një tufëze. Vjelja e saj është tepër e lehtë, me gjithë gjatësinë e trupit të saj.

Më në fund, përmenden begatia e dymbëdhjetë dhe e trembëdhjetë: **"ka drithëra me gjethe e kërcej dhe bimë me erë të mirë"**.

Farërat e drithërave shërbejnë për ushqimin e njeriut, kurse gjethet e thata janë ushqim për kafshët, të cilët janë vënë në shërbim të njeriut, duke i dhënë atij qumështin, mishin, lëkurën dhe leshin e tyre. Në këtë mënyrë, të gjitha janë të dobishme.

[1] Në lidhje me këtë, kemi diskutuar më gjerësisht në komentimin e ajetit 47, sure "Fussilet".

Nga ana tjetër, Zoti, në tokë, gjithashtu, ka krijuar bimë me aromë të këndshme që aromatizon shpirtin dhe trupin e njeriut. Shpirtit i dhuron qetësi dhe gëzim dhe kështu plotësohet edhe ushqimi, edhe kënaqësia e njeriut, pra, realizohet begatia për të cilën flasim.

Fjala *"habbun"* nënkupton çdo lloj fare, kurse fjala *"a'sf"* është në kuptimin e gjetheve dhe kërcejve që ndahen nga bimët prej erërave dhe shpërndahen në të gjitha anët. Është përdorur edhe për të emërtuar kashtën.

Për fjalën *"rejhanun"* kanë dhënë kuptime të shumta, si për shembull: bimë aromatike dhe çdo lloj bime. Kuptimi i parë duket më i përshtatshëm.

Pasi ka përmendur këto begati të mëdha materiale dhe shpirtërore, në ajetin 13, u drejtohet xhindëve dhe njerëzve: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!**.[1]

Begati që ishin njëra më e çmueshme se tjetra, begati të vlefshme, begati që shoqërojnë të gjithë jetën tuaj. Secila prej tyre është një shenjë e fuqisë, e mirësisë dhe e dashurisë së Zotit. Atëherë, si është e mundur që t'i përgënjeshtroni ato?!

Kjo është një pyetje demaskuese, që u drejtohet jobesimtarëve. Prandaj, përmes një hadithi, që e cituam në fillim të sures, na është urdhëruar që pas përmendjes së kësaj shprehjeje, të themi: "O Zot! Ne nuk mohojmë asnjë prej begative të Tua!".

[1] Fjala këtu u drejtohet njerëzve dhe xhindeve. Ky varg përsëritet 31 herë në këtë sure.

Në ajetet e kaluara është folur vetëm për njeriun dhe nuk është diskutuar fare për xhindët. Në ajetet në vijim, do të tregojmë se togfjalëshi përemëror *"kuma"* - *"ju të dy"*, flet për dy grupe, që janë njerëzit dhe xhindët.

Sidoqoftë, Zoti i Madhëruar, me anë të kësaj fjalie, njerëzit dhe xhindët i vendos përballë këtij realiteti, që të mendojnë dhe të reflektojnë rreth këtyre çështjeve. Më pas, pa pasur nevojë që t'u drejtohen të tjerëve, t'i drejtohen mendjes së vet me pyetjen: "Vallë, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohon?!" Dhe nëse jo, përse të mos e njohësh Dhuruesin e këtyre dhuntive? Përse falënderimin ndaj Dhuruesit të mos e caktosh si mjet për njohjen e Tij? Përse nuk i përulesh Atij?!

Përdorimi i fjalës *"ejj"* tregon se secila prej këtyre begative është analizuar veç e veç, për të treguar qartë pozitën e mirësisë dhe të dhurimit të Zotit të Madhëruar. Por, kur të kujtojmë të gjitha begatitë e Dhuruesit, ç'mund të themi?! Kush është ai që nuk falënderon?!

Hulumtime

1- Njohja e begative, është shkalla e njohjes së Zotit

Në qoftë se i shohim me vëmendje dymbëdhjetë begatitë e lartpërmendura (begatia e Kur'anit, e krijimit të njeriut, e mësimit të të folurit, e llogaritjes së rregullt të kohës, e krijimit të llojeve të

ndryshme të bimëve dhe kërcejve, e krijimit të qiellit, e mbizotërimit të ligjeve, e krijimit të Tokës me karakteristikat e saj, e krijimit të frutave, e krijimit të palmës, e krijimit të drithërave, si dhe e krijimit të luleve dhe bimëve aromatike), me gjithë specifikat, detajet dhe misteret që mbajnë të fshehura, secila prej tyre i mjafton njeriut që të bëhet falënderues i All'llahut të Madhëruar për këto mirësi.

Për këtë arsye, Zoti i Madhëruar, pasi i përmend këto begati, kërkon nga të gjithë robtë e Tij, pohimin e secilës prej tyre. Këtë fjali e përsërit plot 31 herë, edhe në ajetet vijuese.

Kjo përsëritje është një prej arteve të elokuencës dhe ngjason me pyetjen që një prind i drejtohet fëmijës së vet mosmirënjohës: "A ke harruar, vallë, që ishe një fëmijë i vogël dhe i pafuqishëm? Sa jam munduar dhe kam vuajtur për edukimin tënd!

Vallë, e ke harruar që ishe sëmurë dhe të kam gjetur mjekët më të mirë? Sa shumë jam munduar për të të blerë ilaçet, sa kam vuajtur për shërimin tënd!

Vallë, e ke harruar, kur kishe nevojë për bashkëshorte, që të zgjodha gruan më të pastër dhe më të dëlirë? Vallë, a ke harruar, kur kishe nevojë për strehim, jetesë dhe mjete të tjera, të cilat t'i kam siguruar në çdo rast?

Atëherë ç'është ky rebelim, mosmirënjohje, mungesë dashurie dhe pabesi prej teje?!".

Zoti i Madhëruar, këtyre mosmirënjohësve, ua rikujton këto begati dhe e pyet atë për secilën nga ato: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Atëherë, ç'është ky rebelim dhe mosbindje? Ndërkohë që edhe nënshtrimi ndaj Meje, gjithashtu, është çelës i përsosmërisë dhe i përparimit tuaj, ndërsa Zoti juaj nuk ka nevojë për asgjë.

2- Çështja e rendit dhe e llogarisë në jetë

Në trupin tonë "janë shpenzuar" më shumës se njëzet lloje metale dhe gjysmë metale. Secili ka cilësi të veçantë dhe sasi të caktuar. Sa herë që në masën dhe balancën e tyre ndodh ndryshimi më i vogël, shëndeti ynë vihet në rrezik. Për shembull, në stinën e verës, kur njeriu djersitet shumë, vuan nga vapa dhe, pa pasur ndonjë sëmundje tjetër, ka mundësi t'i përkeqësohet gjendja shëndetësore deri në vdekje. Shkaku i kësaj gjendjeje është shumë i thjeshtë, mungesa e ujit në trup dhe pakësimi i kripës në gjak. Shërimi i saj bëhet vetëm duke konsumuar sa më shumë ujë dhe kripë.

Ky ishte një shembull i thjeshtë, që tregon rëndësinë e ekuilibrit të llojeve të mineraleve dhe mikromineraleve në trupin njerëzor. Teprica apo mungesa, sado e vogël e tyre, krijon çrregullime serioze në organizëm.

Por dukuri të ngjashme me këto, duket se ndodhin edhe në lëvizjet shoqërore. Devijimi nga ligji i drejtësisë mund të çojë në rrugën e humbjes një komb të tërë.

Kur'ani Fisnik, para katërmbëdhjetë shekujsh, me anë të ajeteve të lartpërmendura, ka hedhur dritë mbi këtë realitet, kur thotë: **"Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Balancën** (për çdo gjë)**, që ju të mos e shkelni atë."**.

Kështu ka sqaruar çdo gjë. Edhe mosbindjen ndaj ligjeve e ka konsideruar njësoj si rebelimi dhe mosbindja ndaj ligjeve të natyrës dhe krijimit të gjithësisë.

Kur'ani na ka sjellë shembuj konkretë dhe interesantë në këto ajete nga bota e krijimit dhe nga bota njerëzore. Jo vetëm kjo botë, por edhe Bota Tjetër, gjithashtu, është "*jeumul hisab*" dhe Dita e "vënies së kritereve", madje atje, në Atë Botë, llogaria dhe matja është shumë më e saktë se në këtë botë. Pikërisht për këtë arsye, në hadithet islame, na është urdhëruar: *"T'ia bëjmë llogarinë vetes sonë, para se të vijë Dita e Llogarisë, si dhe ta vlerësojmë vetveten tonë, para se të vlerësohemi nga dikush tjetër."*.[1]

[1] "Uesailul Shiiati", vëll. 16, f. 99.

Ajetet 14 – 18

خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ صَلْصَالٍ كَالْفَخَّارِ١٤ وَخَلَقَ الْجَانَّ مِنْ مَارِجٍ مِنْ نَارٍ١٥ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ١٦ رَبُّ الْمَشْرِقَيْنِ وَرَبُّ الْمَغْرِبَيْنِ١٧ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ١٨

"Ai e krijoi njeriun prej baltës së thatë, ashtu si vorba",

"ndërsa xhindët i krijoi prej flakës së zjarrit."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"(Ai është) **Zoti i dy lindjeve dhe i dy perëndimeve."**

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

Komentimi

Krijimi i njeriut prej balte

Zoti i Madhëruar, pasi përmend begatitë e kaluara, flet, në mënyrë të përmbledhur, edhe për krijimin e njeriut. Në ajetet që po diskutojmë, fillimisht përshkruan krijimin e njeriut dhe të xhindit. Ky përshkrim, në vetvete, është shprehje e fuqisë së

All'llahut dhe mësim për të gjithë ne, kur thotë: **"Ai e krijoi njeriun prej baltës së thatë, ashtu si vorba."**.

Fjala *"salsalun"* përdoret për të treguar *"zhurmën e zërit mbi lëndët e thata"*. Më pas është përdorur për të emërtuar baltën e thatë, e cila nxjerr atë zhurmë që quhet *"salsal"*. Edhe pjesën e mbetur të ujit në enë, gjithashtu, e quajnë *"salsale"*, sepse gjatë lëvizjes së ujit, nga një enë në një tjetër, dëgjohet zë.

Disa komentues të tjerë, kanë pohuar se fjala *"salsalun"* përdoret në kuptimin e llumit, me kuptimin "e një balte me erë të keqe". Kuptimi i parë është më i njohur dhe më i përhapur.

Fjala *"fekhkharun"* rrjedh nga rrënja *"fekhrun"* dhe nënkupton personin që është shumë mendjemadh. Duke u nisur nga fakti se njerëz të tillë janë mendjelehtë dhe të zhurmshëm, kjo fjalë është përdorur për ibrikun, për poçen, apo edhe për çdo lloj ene prej balte, për shkak të zhurmës së madhe që bën, kur lëviz uji.[1]

Nga shumë ajete kur'anore, që flasin për zanafillën e krijimit të njeriut, mësojmë se njeriu, në fillim, ka qenë dhè[2], më pas është përzier me ujë dhe ka marrë formën e baltës.[3]

Pastaj kjo "baltë e tharë, e zezë e me erë të keqe"[4], mori formë[5] pas asaj gjendje (ajo u ngjit) e më pas ashtu e tharë si

[1] "Mufredatu Rragib",
[2] Sure "El Haxhxh", ajeti 5.
[3] Sure "El En'am", ajeti 3.
[4] Sure "El Hixhr", ajeti 27.
[5] Sure "Es Saffat", ajeti 11.

qeramika dhe vorba, mori formën "ashtu si vorba të zëshme", siç thotë ajeti ajeti në fjalë.

Sa kanë zgjatur këto faza? Në secilën fazë, sa kohë ka ndaluar njeriu? Nën ndikimin e cilëve faktorë kanë ndodhur këto transformime? Këto janë çështje që janë enigmatike dhe të panjohura për ne dhe dijen që kemi. Vetëm Zoti i Madhëruar është në dijeni për gjëra të tilla. E qartë është se shprehjet e lartpërmendura, shpalosin një realitet, që ka një ndërlidhje të rëndësishme me çështjet edukative të njeriut. Kjo është lënda e parë e njeriut, lënda që ishte shumë e pavlerë dhe e parëndësishme, një prej lëndëve më të ulëta dhe të përçmuara mbi tokë. Por Zoti i Madhëruar, nga një lëndë e tillë e pavlerë, krijoi krijesën më të bukur mbi tokë.

Gjithashtu tregon , që kuptimin e vlerës së vërtetë të njeriut, e përbën po ajo "fryma hyjnore" dhe fryrja hyjnore që është përmendur në ajetet e tjera kur'anore (si për shembull, ajeti 29 i sures "El Hixhr"). Kjo frymë hyjnore, e orienton njeriun të gjejë edhe rrugën e vet të përsosmërisë dhe ta dijë se cilën rrugë duhet ta ndjekë, në mënyrë që të rigjejë vlerën e vet të vërtetë në këtë univers.

Më pas, diskuton për krijimin e xhindit dhe thotë: **"ndërsa xhindët i krijoi prej flakës së zjarrit"**.

Fjala "*marixh*" rrjedh nga fjala "*merexh*" dhe përdoret për të treguar bashkimin e përzierjes. Synimi i kësaj përzierjeje, është bashkimi dhe përzierja e flakëve të ndryshme të zjarrit, sepse në kohën që zjarri digjet, ndonjëherë shndërrohet në ngjyrë të kuqe, ndonjëherë në të verdhë, ndonjëherë në ngjyrë blu dhe ndonjëherë në ngjyrë të bardhë.

Disa kanë thënë se ajo është edhe në kuptimin e "lëvizjes së bagëtive", nga "*emrexhtud dabbe*", që do të thotë: bagëtinë e kam lënë në kullotë. Kjo thuhet kështu, sepse njëri kuptim i fjalës "*merexh*", është po ajo lëndinë dhe fushë me bar.

Përsëri për ne, nuk është plotësisht e saktë mënyra se si u krijua xhindi nga këto flakë shumëngjyrëshe. Të paqarta mbeten edhe karakteristika të tjera të tij, të cilat na qartësohen nëpërmjet "lajmëtarit dhe folësit të drejtë", nga Kur'ani Fisnik dhe Shpallja hyjnore.

Në këtë fushë, njohuritë njerëzore janë të kufizuara, të cilat nuk na lejojnë t'i mohojmë apo t'i anashkalojmë këto realitete, vetëm pasi të jenë të vërtetuara dhe të argumentuara me anë të Shpalljes. Me lejen e Zotit, do të flasim më shumë, kur të komentojmë suren "Xhin", për mënyrën e krijimit të xhindit dhe karakteristikat e kësaj krijese.

Sidoqoftë, elementet me të cilat kemi të bëjmë më shumë, janë: uji, dheu, era dhe zjarri. Dijetarët e lashtë, këto elemente i konsideronin si elemente të kulluara dhe të përbëra. Shkencëtarët e sotëm, i konsiderojnë si elemente të përbëra nga elemente të ndryshme. Në secilin rast, zanafilla e krijimit të njeriut është uji dhe dheu, ndërkohë që zanafilla e krijimit të xhindit, ishte era dhe zjarri. Ky dualizëm i zanafillës së krijimit, është edhe burimi i ndryshimeve të shumta mes këtyre dy krijesave.

Sërish, në vazhdimësi të begative, që ishin në fillimet e krijimit të njeriut, e përsërit këtë shprehje: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Në ajetin vijues, Zoti përmend një tjetër begati të madhe hyjnore: **"**(Ai është) **Zoti i dy lindjeve dhe i dy perëndimeve."**.[1]

Është e vërtetuar se dielli, çdo ditë të vitit, lind nga një pikë dhe perëndon në një pikë tjetër të horizontit. Pra, për çdo ditë të vitit, Dielli ka një lindje dhe një perëndim, por, duke pasur parasysh "zenitin verior maksimal" të Diellit dhe "zenitin jugor maksimal" të tij, në realitet, ka dy lindje dhe dy perëndime.[2]

Ky sistem është burim i krijimit të katër stinëve të vitit, i shoqëruar me begati të shumta. Në realitet, është një theksim dhe plotësim i asaj çfarë u diskutua në ajetet e mëparshme, kur u fol për llogarinë e "rrugëtimit" të Diellit dhe të Hënës; për balancimin e matjes në krijimin e qiejve. Në tërësi, ajeti shpreh rendin e saktë dhe të përpiktë të krijimit, si: lëvizjen e Tokës, të Hënës dhe Diellit; gjithashtu, është një aludim për begatitë dhe mirësitë që njeriu i përfiton nëpërmjet kësaj.

Komentues të tjerë, **"dy lindjet dhe dy perëndimet"** i kanë komentuar me lindjen dhe perëndimin e Diellit dhe lindjen dhe perëndimin e Hënës dhe atë e konsiderojnë të përshtatshme me ajetin e kaluar, *"uesh shemsu uel kameru bihusban"*. Kuptimi i parë

[1] Sipas disa komentuesve të Kur'anit, bëhet fjalë për pikat e lindjes dhe të perëndimit të diellit në verë dhe në dimër.

[2] Kuptimi i saj është: Boshti i tokës është i prirur drejt nivelit të orbitës së tij dhe formon një kënd afërsisht 23 gradë. Në këtë gjendje rrotullimi, rreth diellit, lindja dhe perëndimi i diellit duket gjithnjë i ndryshueshëm; nga 23 gradë e miljes së madhe veriore (në fillim të verës), deri në 23 gradë në miljen e madhe lindore (në fillim të dimrit), është në ndryshim. Orbitën e parë, e quajnë Tropiku i Gaforres, kurse orbitën e dytë, e quajnë Tropiku i Bricjapit. Këto janë dy lindjet dhe dy perëndimet e diellit. Orbitat e tjera ndodhen në brendësi të këtyre dy orbitave.

duket më i përshtatshëm, sidomos duke parë faktin se është përmendur edhe në disa transmetime islame.

Për shembull, në një hadith nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Fillimi i dimrit është i veçuar dhe fillimi i verës është i veçuar. A nuk e shihni që dielli në këto dy stinë afrohet dhe largohet?"*[1] (duke treguar për ngritjen e diellit , në stinën e verës dhe uljes poshtë në stinë e dimrit).

Nga ato që thamë më lart, bëhet e qartë se përse në disa ajete kur'anore thuhet: **"Betohem në Zotin e lindjeve e të perëndimeve, se ne kemi fuqi..."**,[2] sepse në ato ajete flitet për të gjitha lindjet dhe perëndimet e diellit gjatë vitit, kurse në ajetin që po diskutojmë, flitet vetëm për harkun përfundimtar të ngritjes dhe të zbritjes së tij.

Pasi i përmend këto begati, përsëri njeriut dhe xhindit u drejtohet pyetja: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

[1] Tefsiri "Nuruth Thakalejn", vëll. 5, f. 190.
[2] Sure "El Mearixh", ajeti 40.

Ajetet 19 – 25

مَرَجَ الْبَحْرَيْنِ يَلْتَقِيَانِ١٩ بَيْنَهُمَا بَرْزَخٌ لَا يَبْغِيَانِ٢٠ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٢١ يَخْرُجُ مِنْهُمَا اللُّؤْلُؤُ وَالْمَرْجَانُ٢٢ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٢٣ وَلَهُ الْجَوَارِ الْمُنْشَآتُ فِي الْبَحْرِ كَالْأَعْلَامِ٢٤ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٢٥

"Ai i ka lëshuar dy dete që të takohen",

"por, midis tyre ka një pengesë që nuk mund ta kapërcejnë."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Prej tyre nxirren margaritarë dhe korale."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Atij i përkasin edhe anijet që lundrojnë nëpër dete e që lartohen si male."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

Komentimi

Detet, me rezervat e tyre të çmuara

Përshkrimi i begative të Zotit të Madhëruar, do të diskutohet për detet, por jo të gjithë, vetëm për disa dete me karakteristika të veçanta. Kjo është edhe një dukuri e çuditshme dhe një shenjë prej fuqisë së pafund të së Vërtetës, përfitimi i disa prej sendeve që përdoren nga njerëzit.

Në përshkrim thuhet: **"Ai i ka lëshuar dy dete që të takohen, por, midis tyre ka një pengesë që nuk mund ta kapërcejnë."**.

Fjala *"merexhe"* është në kuptimin e përzierjes, të dërgimit apo të lëshimit. Në këtë fjali: **"por, midis tyre ka një pengesë që nuk mund ta kapërcejnë"**, është në kuptimin e dërgimit dhe lënies pranë njëra–tjetrës.

Sipas dëshmisë së sures "El Furkan"[1], janë dy dete, njëri me ujë të ëmbël dhe tjetri me ujë të kripur: **"Ai la të lirë të bashkohen dy dete, ky** (njëri) **i pijshëm e i shijshëm, e ky** (tjetri) **i njelmët e i idhët, e mes tyre bëri si të jetë ndonjë pendë, pritë që të mos përzihen."**.

Po ku ndodhen këto dy dete, njëri i ëmbël dhe tjetri i kripur, që nuk përzihen me njëri–tjetrin? Ç'është kjo pengesë mes tyre? Komentuesit e Kur'anit e kanë quajtur këtë çështje shumë të koklavitur dhe të diskutueshme. Disa prej tyre kanë thënë se nuk

[1] Sure "Furkan" ajeti 53.

dihet mirë se ku ndodhen këto dy dete. Me këto dy dete synohej deti i Persisë dhe deti i Romës, ndërkohë që e dimë se të dy këto dete janë me ujë të kripur dhe mes tyre nuk ekziston ndonjë pengesë.

Disa kanë thënë se me këto dy dete synohet "deti i qiellit" dhe "deti i tokës", në mënyrë që i pari është i ëmbël dhe i dyti i kripur. Ndërkohë që e dimë se në qiell nuk ekziston ndonjë det, përveç reve dhe avujve që dalin nga oqeanet e tokës.

Të tjerë kanë thënë se me detin e ëmbël synohen "ujërat nëntokësore", të cilat nuk përzihen me ujërat e deteve dhe pengesa mes këtyre të dyjave janë muret e basenet e tyre. Ndërkohë, ne e dimë se nëntokë nuk gjendet diçka si deti, por grimcat e ujit janë të fshehura mes grimcave të pluhurit dhe të rërës së lagësht. Kur hapim diku një pus, uji i tij mblidhet gradualisht nga lagështira në tokë dhe në fund shfaqet. Përveç kësaj, margaritarët dhe perlat, që janë përmendur në ajetet e mësipërme, nuk nxirren nga ujërat nëntokësore.

Atëherë cilët janë këto dy dete?!

Në suren "El Furkan" kemi diskutuar rreth lumenjve të mëdhenj me ujë të ëmbël, që derdhen në dete dhe oqeane e zakonisht formojnë një "det të vogël" me ujë të ëmbël në afërsi të bregut, aty ku derdhen dhe ujin e kripur e lënë mënjanë dhe për një periudhë të gjatë kohe, ujërat e këtyre dy deteve nuk përzihen me njëra–tjetrën.

Gjatë udhëtimit me avion, në ato zona ku këta lumenj derdhen në dete, shihet më së miri nga lart pamja e ujit të ëmbël dhe të kripur që ndodhet në afërsi të njëri–tjetrit. Ato ujëra

qëndrojnë të ndara për një kohë. Kur cepat e këtyre ujërave përzihen, sërish uji i ëmbël rri në vendin e tij, prandaj këto dy dete vijojnë të qëndrojnë të ndarë nga njëri–tjetri dhe gjithnjë tërheqin vëmendjen.

Interesant është fakti se në kohën e baticës së detit, ku niveli i oqeanit rritet, ujërat e ëmbla tërhiqen prapa, sërish pa u përzier me ujërat e kripura, përveç rasteve të thatësirës apo mungesës së ujit dhe mbulojnë një pjesë të madhe të tokës së tharë. Banorët e bregdetit e shfrytëzojnë këtë rast për t'i devijuar këto ujëra të ëmbla, për të vaditur tokat e tyre.

Këta lumenj, që janë bekim i baticë-zbaticave bregdetare, zbrazen dhe mbushen dy herë gjatë ditës dhe shërbejnë për ujitjen e tokave bujqësore.

Lidhur me këto dy dete, është transmetuar një interpretim tjetër interesant nga disa komentues. Ata kanë shprehur mendimin se këto dy dete ka mundësi të krijohen nga rryma e gjirit " Gulfstrimit", për të cilën, do të diskutojmë në hulumtimet e këtij ajeti.

Sërish u është drejtuar robëve dhe i pyet ata për këtë begati: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Më pas, në vazhdim të po këtij diskutimi, shton: **"Prej tyre nxirren margaritarë dhe korale. Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

"Lu'lu" – *"perla"* dhe *"merxhan"* – *"margaritar"* janë të dyja mjete zbukuruese të cilat, përdoren edhe në mjekësi për trajtimin

e sëmundjeve. Nga ato sigurohen përfitime të shumta. Për këto arsye, në ajetet e mëparshme, janë përmendur si dy begati.

"Lu'lu", që në shqip e quajnë *"perlë"*, është një gur transparent dhe i çmuar, që rritet dhe kultivohet në thellsi të detit. Sa më e madhe të jetë perla, aq më e çmuar është. Edhe ky ka një përdorim të gjerë në mjekësi. Mjekët e hershëm nga ai përgatisnin ilaçe për forcimin e zemrës dhe nervave, për eliminimin e llojeve të ndryshme të depresionit, të frikës dhe ankthit, për forcimin e mëlçisë, për eliminimin e erës së keqe nga goja, për nxjerrjen e gurëve të veshkave, për fshikëzën dhe verdhëzën. Madje atë e përdorin edhe për shërimin e syve.[1]

Fjala *"merxhan"* është përdorur me kuptimin e "margaritarëve të vegjël", por e vërteta është ndryshe. Me fjalën *"merxhan"* quajnë një gjallesë, që ngjason me degën e vogël të një peme, e cila rritet në thellësi të deteve. Për një kohë të gjatë, shkencëtarët atë e konsideronin një lloj "bime", por me kalimin e kohës u bë e qartë që është një lloj kafshe, edhe pse qëndron e ngjitur pas shtresës së shkëmbinjve dhe mbulon një pjesë të mirë të shkëmbinjve. Ajo sa vjen e shtohet dhe arrin të formojë ishuj që njihen si "ishuj koralë."

Koralet, zakonisht, rriten në ujëra të qeta dhe peshkatarët i kapin ato në brigjet e Detit të Kuq, të Mesdheut dhe në disa zona të tjera.

Lloji më i mirë i koraleve zbukurues është korali me ngjyrë të kuqe. Sa më i kuq të jetë, aq më i çmueshëm është. Lloji më i

[1] "Tuhefu hakime Mu'min" dhe enciklopedia "Dekhuda", si dhe burime të tjera.

keq i koralit është korali me ngjyrë të bardhë, që gjendet me shumicë. Mes këtyre të dy llojeve koralesh, ekziston korali i zi.

Koralet, përveç bukurisë, kanë edhe përdorim mjekësor. Edhe këto janë përmendur për dobi të shumta. Ato përdoren në prodhimin e ilaçeve për forcimin e zemrës, eliminimin e toksinave, forcimin e nervave, shërimin e diarresë, gjakderdhjeve në mitër, si dhe kanë pohuar se është i dobishëm edhe për shërimin e sëmundjes së epilepsisë.[1]

Është e nevojshme të përmendet se disa komentues, kanë thënë se *"lu'lu* dhe *"merxhan"* rriten vetëm në ujërat e kripura.[2]

Por, ne nuk kemi asnjë argument për këtë, përkundrazi disa kanë deklaruar se *"lu'lu"* dhe "*merxhan*" gjenden në të dy ujërat, në ujërat e kripura dhe në ato të ëmbla.

Sërish, në vazhdimësi të diskutimeve për këto begati, Kur'ani ka përmendur edhe çështjen e anijeve, që në fakt ka qenë mjeti më i madh dhe më i rëndësishëm i transportimit të njerëzve në të kaluarën. Ajeti thotë: **"Atij i përkasin edhe anijet që lundrojnë nëpër dete e që lartohen si male."**.

Fjala *"xhevar"* është shumësi i fjalës *"xharie"*. Emërton një përshkrim për anijet (sufun). Është hequr një fjalë nga teksti për shkurtim. Është hequr pikërisht fjala që tregon lundrimin e anijeve. Pikërisht për këtë arsye, diskutimi është përqendruar mbi përshkrimin.

[1] Enciklopedia "Ferid Uxhdij" dhe libra të tjerë.
[2] Si për shembull, ajeti 31 i sure "Ez Zukhruf".

Me fjalën *"keniz"* quajnë *"shërbëtoren"* dhe me fjalën *"xharie"* - *"të lëvizshme"*. Në nëntekst, përvijohet ideja se shërbëtorja duhet të jetë e shkathët në kryerjen e shërbimeve. Edhe vajzës së re, i venë epitetin *"xharie"*. Arsyeja është se ajo është shumë aktive.

Fjala *"munsheat"* është shumësi i fjalës *"munshee"* dhe i formës pësore të fjalës *"inshaa"*. Përdoret për të treguar kuptimin e "krijimit, prodhimit". Krahas përdorimit të fjalës *"munsheat"*, që është tregues për ndërtimin e anijes nga ana e njeriut, përdoret: *"ue lehu"* - *"Atij i përkasin"*, duke treguar që ndërtuesit dhe prodhuesit e anijeve shfrytëzojnë vetitë që Zoti u ka dhënë për ndërtimin e anijeve, të zotërimit të forcës së fryrjes së erërave, që mundësojnë lundrimin. Është Zoti Ai, që edhe në det njeriun e bën fitues.

Kur'ani në një rast tjetër, ka përmendur fjalën *"taskhir"* - *"nënshtrim"* dhe thotë: **"...për të mirën tuaj u vuri në shërbim anijet, të lundrojnë nëpër det me Urdhrin e Tij, e në shërbimin tuaj i vuri edhe lumenjtë."**.[1]

Disa komentues, fjalën *"munshe'e"* e kanë konsideruar derivat të fjalës *"inshaa"* dhe e komentojnë në kuptimin e "ngritjes lart", duke nënkuptuar anijet që ngrenë velat, kur fryjnë erërat në drejtimin e lëvizjes së tyre.

Fjala *"a'alam"* është shumësi i fjalës *"a'lem"*. Përdoret me kuptimin e malit, edhe pse, në thelb, është në kuptimin e një shenje, a një gjurme që informon rreth një gjëje. Meqenëse malet

[1] Sure "Ibrahim", ajeti 32.

janë të dukshme nga larg, përdoret fjala *"a'lem"*, pra, "*i dukshëm"*, siç thuhet edhe për flamurin e një ushtrie që shihet nga larg.

Kështu, Kur'ani flet për anijet e mëdha që lundrojnë, mbi oqeane dhe dete. E në kundërshtim me atë çka thonë dhe çka paraqesin disa, anijet e mëdha nuk i përkasin vetëm perjudhës së motorit dhe avullit. Në ngjarjet e luftrave lexojmë se"Grekët" dhe vende të tjera përdornin anije shumë të mëdha dhe të fuqishme, për tu shërbyer gjatë luftrave që zhvillonin.

Sërish e përsërit pyetjen shumë domethënëse: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Hulumtime

1- Deti është vatra e begative Hyjnore

Në këto seri të ajeteve, u diskutua për çështjen e "detit dhe rëndësisë së tij" në jetën e njeriut. Dihet tashmë se detet mbulojnë pothuaj tre të katërtat e sipërfaqes së globit dhe janë një burim i madh jetëdhënës e plot begati.

Në qoftë se sipërfaqja e deteve do të ishte më e vogël, apo më e madhe se ç'është, rruzulli tokësor do të thahej, ose do të ishte tejet i lagësht dhe jetesa do të bëhej ndoshta e pamundur.

Prandaj, Kur'ani, disa herë ia ka tërhequr vëmendjen njerëzimit ndaj kësaj begatie të madhe dhe i ka urdhëruar që të

mendojnë dhe të reflektojnë: **"All'llahu është Ai, që për ju e nënshtroi detin që me lejen e Tij të lundrojnë anijet nëpër të. "**.[1]

Në një rast tjetër, Kur'ani thotë: **"...për të mirën tuaj u vuri në shërbim anijet, të lundrojnë nëpër det me urdhrin e Tij."**[2]

"Ai nënshtroi anijet që sipas dëshirës së Tij të lundrojnë në det.".[3]

Përveç këtyre që treguam, thuhet se deti është "toka e çudirave". Në dete rriten dhe kultivohen bimët më të vogla mikroskopike dhe pemët më të gjata të botës. Në dete jetojnë kafshët më të vogla dhe kafshët më të mëdha.

Jetesa në thellësi të detit, aty ku nuk ekziston asnjë dritë e asnjë ushqim, është mahnitëse. Njeriu nuk ngopet nga studimi i detit. I çuditshëm është fakti që kafshët atje përhapin dritë nga vetja e tyre, lëndët e tyre ushqimore formohen e depozitohen në sipërfaqen e ujit. Organet e tyre janë shumë të forta e të qëndrueshme. Ato përballojnë një presion shumë të madh brenda thellësive të ujit, i cili do të thyente në çast eshtrat e njeriut, nëse ai do të zhytej aq thellë.

2- Rryma e Gjirit dhe lumenjtë e mëdhenj detarë

Në të gjitha oqeanet e botës krijohen rryma të fuqishme uji që lëvizin si lumenj të mëdhenj. Më i fuqishmi i tyre quhet Rryma e gjirit apo Golf Strimi.

---

[1] Sure "El Xhathije", ajeti 12.
[2] Sure "Ibrahim", ajeti 32.
[3] Sure "El Haxhxh", ajeti 65.

Ky lumë i madh, lëviz nga brigjet e Amerikës Qendrore e kalon të gjithë Oqeanin Atlantik dhe arrin në brigjet e Evropës Veriore.

Këto ujëra janë të ngrohta, sepse nisen nga zonat e afërta me ekuatorin. Edhe ngjyra e tyre ndonjëherë ndryshon nga ngjyra e ujërave të ftohta të oqeanit. Gjerësia e këtij lumi të madh detar (Rryma e gjirit) është afro 150 kilometër dhe thellësia e tij është qindra metra. Shpejtësia e tij është aq e madhe, saqë brenda një dite përshkon 160 kilometër rrugë.

Këto ujëra janë afro 10-15 gradë më të ngrohta se ujërat e oqeanit, prandaj dhe kufirin ndarës perëndimor mes tyre e quajnë Muri i ftohtë.

Rryma e gjirit krijon erëra të ngrohta, të cilat i çon në vendet e Evropës Veriore, duke ndikuar shumë në zbutjen e klimës së ashpër të tyre. Po të mos ishte kjo rrymë e ngrohtë ujore, jetesa në vendet e Evropës Veriore do të ishte mjaft e vështirë nga i ftohti.

Sërish duam të theksojmë se si Rryma e gjirit ka edhe disa rryma të tjera detare në ujërat e pesë kontinenteve të botës.

Shkaktari kryesor i këtyre lëvizjeve ujore, i këtyre rrymave detare, është ndryshimi i ngrohjes mes zonës tropikale dhe zonave polare.

Këtë dukuri mund ta ilustrojmë me një eksperiment të thjeshtë: Në qoftë se marrim një enë të madhe me ujë dhe në njërin cep të saj vendosim një copë akull, kurse në cepin tjetër vendosim një hekur të skuqur dhe mbi sipërfaqen e ujit hedhim

pak kashtë, do të shohim një rrjedhë në sipërfaqen e këtij uji, që do të lëvizë në mënyrë graduale, nga cepi ku uji ishte i ngrohtë, nga hekuri i skuqur, drejt cepit ku kishim vënë akullin, pra, ku uji ishte më i ftohtë. Një ndodhi e tillë ndodh në të gjitha detet e botës dhe kështu fillon krijimi i këtyre lumenjve detarë.

Këta lumenj të mëdhenj detarë përzihen më pak me ujërat rreth vetes dhe përshkojnë me mijëra kilometra rrugë, duke i mbajtur të ngrohta ujërat. Edhe këta janë shembull i asaj që kemi thënë: **"Ai i ka lëshuar dy dete që të takohen, por, midis tyre ka një pengesë që nuk mund ta kapërcejnë."**.

Në vendin e takimit të këtyre ujërave të ngrohta me ujërat e ftohta shfaqet një dukuri shumë fitimprurëse për njeriun. Aty, organizmat mikroskopike pësojnë një ngordhje kolektive dhe kështu grumbullohen lëndë të shumta ushqimore, të cilat ushqejnë tufat e mëdha të peshqve. Në gjithë rruzullin tokësor, këto zona konsiderohen si më të mirat për peshkim.[1]

3- Një komentim nga përmbajtja e ajeteve

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lidhur me komentimin e ajetit: **"Ai i ka lëshuar dy dete që të takohen"**, është transmetuar: "Aliu dhe Fatimja *(Paqja qoftë mbi ta!)* janë dy dete të thella, në mënyrë që asnjëri nuk e cenon tjetrin. Nga këto dy dete kanë dalë margaritarë dhe korale, pra, Imam Hasani dhe Imam Hysejni *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*.".[2]

[1] "Dairetul Mearif Ferheng Name", vëll. 12, f. 1228; revista "Bend ru derja", Nr. 4, f. 100.
[2] Tefsiri "El Kumij", vëll. 2, f. 344.

Në tefsirin "Durr'rrul Menthur", e njëjta përmbajtje është transmetuar nga disa prej shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[1]

Por Tabersiu në veprën "Mexhmaul Bejan" e ka transmetuar atë me pak ndryshim.

E dimë se Kur'ani Fisnik ka shumë shtresa kuptimore. Një ajet ka mundësi të ketë disa kuptime, apo me dhjetëra kuptime. Ajo që është përmendur në këtë hadith, është nga brendësia e Kur'anit, që nuk bie ndesh me kuptimin e jashtëm të Tij.

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 142.

Ajetet 26 – 30

كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٍ٢٦ وَيَبْقَى وَجْهُ رَبِّكَ ذُو الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ٢٧ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٢٨ يَسْأَلُهُ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ كُلَّ يَوْمٍ هُوَ فِي شَأْنٍ٢٩ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٣٠

"Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket",

"e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) **e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim."**

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Atij i lutet gjithkush që ndodhet në qiej dhe në Tokë e në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

Komentimi

Ne të gjithë jemi të përkohshëm, kurse përhershmëria të takon vetëm Ty!

Sërish, në vazhdim të përshkrimeve të këtyre begative hyjnore, në këto ajete shton: **"Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket."**.

Por, si është e mundur që asgjësimi të vihet në mesin e begative të Zotit të Madhëruar? Ky "asgjësim" nuk është zhdukje absolute, por është një dritare drejt Botës së Amshueshme, si dhe korridor dhe vendkalim për në Botën e Përhershme.

Bota, me të gjitha begatitë e saj, është si një burg për besimtarin dhe ikja nga kjo botë është si lirimi nga ky burg i ngushtë dhe i errët.

Përmendja e begative të shumta, në komentet e kaluara, mund të jetë bërë për një grup njerëzish, që janë dhënë shumë pas kënaqësive të kësaj bote, (pas ushqimeve të shumta, pas pijeve, pas pasurive, mjeteve të transportit, etj), të cilëve ua rikujton: "O njerëz, kjo botë do të zhduket, mos u mashtroni dhe mos u magjepsni pas të mirave që u ofron ajo dhe të harroni rrugën e Zotit!". Edhe kjo kritikë, në vetvete, është një begati e madhe.

Grupi emëror *"men alejha"* – *"ata të cilët janë në tokë"* përdoret për të emërtuar çdo gjë që është në tokë, përfshirë njerëzit dhe xhindët. Disa komentues të Kur'anit përfshijnë këtu kafshët, krijesat dhe organizmat e tjera të gjalla. Por më e drejtë është që fjala *"men"*, të përdoret për krijesat me intelekt, prandaj përdorimi i parë kuptimor është më i preferuar.

Kur flitet për "çështjen e asgjësimit", nuk diskutohet vetëm për njeriun dhe xhindin, as vetëm për krijesat e kësaj bote, por, sipas përshkrimit të Kur'anit, çështja e asgjësimit përfshin çdo gjë që ekziston në qiej dhe të gjitha gjallesat në tokë. Pra, të gjitha do të asgjësohen: **"Çdo send zhduket e Ai jo!"**.[1]

[1] Sure "El Kasas", ajeti 88.

Por, duke u nisur nga fakti që këtu u diskutua vetëm për njerëzit, në këtë ajet u diskutua vetëm për ta.

Në ajetin vijues, thuhet: **"...e do të mbetet vetëm Fytyra** (Qenia) **e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim."**.

Fjala *"uexh'h"* përdoret për të emërtuar fytyrën e një personi. Por, kur kjo fjalë përdoret për Zotin, atëherë tregon esencën, Qenien e Stërpastër të Tij.

Disa komentues të tjerë, fjalën *"uexh'hu rabbuke"* e kanë përdorur me kuptimin e cilësive të Zotit, nëpërmjet të cilave njeriu furnizohet me begatitë dhe mirësitë e Tij, siç janë: dija, fuqia, mëshira dhe falja.

Gjithashtu, është e mundur që, me këtë fjalë, të emërohen veprat që kryhen për hir të Zotit të Madhëruar, të cilat do të zhduken të gjitha. E vetmja gjë që do të mbetet, janë veprat e kryera me sinqeritet dhe për hir të Kënaqësisë të Zotit.

Por kuptimi i parë duket më i përshtatshëm se të gjitha kuptimet e tjera.

Fjala *"dhul xhelali uel ikram"* përshkruan fjalën *"uexh'h"* dhe flet për cilësitë, hijeshinë dhe madhërinë e Zotit, sepse *"dhul xhelal"* informon për cilësitë pozitive, me të cilat Zoti është i më i lartësuar, se me cilësitë negative. Kurse fjala *"Ikram" - "i Nderuar"* është tregues për ato cilësi, që vënë në pah hijeshinë dhe vlerën e një gjëje. Këto janë cilësitë pozitive apo të qëndrueshme të Zotit, si për shembull: dituria, fuqia dhe jeta e Tij.

Si rrjedhojë, kuptimi tërësor i ajetit është: Vetëm Esenca e Stërpastër e Zotit të Madhëruar, që karakterizohet nga cilësitë

pozitive apo të qëndrueshme dhe që është e spastruar nga cilësitë negative apo mohuese, do të mbetet dhe do të mbijetojë në këtë botë.

Disa komentues të Kur'anit, cilësinë e Zotit të Madhëruar si "Pronar i Nderit", e lidhin me mirësitë dhe begatitë, me të cilat i nderon dhe i respekton të dashurit e Vet. Është i mundur edhe afrimi i dy kuptimeve të ajetit që i përmendëm.

Në një hadith, lexojmë: "Një burrë që po falte namazin në prani të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, u lut në këtë mënyrë: 'All'lla humme inni esaluke bienne lekel hamdu la ilahe il'la Entel mennan, bedius semauati uel erdh, dhul xhelali uel ikram, ja Hajju ja Kajjum.'".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i pyeti shokët: "A e dini se me çfarë emri iu drejtua Zotit?"

Të pranishmit thanë se Zoti dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Betohem në Zotin, që jeta ime është në dorën e Tij. Ai e thirri All'llahun me Emrin më të madh të Tij dhe sa herë që ndonjëri e thërret Atë me këtë emër, Zoti ia pranon lutjen dhe, sa herë nëpërmjet saj kërkon ndonjë gjë nga Ai, Zoti ia jep atë!*".[1]

Kur'ani sërish u drejtohet krijesave: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

[1] Tefsiri"Ruhul Meanij," vëll. 27, f. 95.

Përmbajtja e ajetit është rezultat i ajeteve të mëparshme, sepse thotë: **"Atij i lutet gjithkush që ndodhet në qiej dhe në Tokë…"**.

Përse të mos jetë kështu? Ndërkohë që çdo gjë do të zhduket dhe vetëm Ai do të qëndrojë

Jo vetëm që gjallesat e kësaj bote do të zhduken, përveç Zotit, por edhe tani, karshi All'llahut, vazhdimësia e tyre varet nga vazhdimi i furnizimit të tyre me jetë prej Tij. Në qoftë se vetëm për një moment mungon mirësia jetëdhënëse e All'llahut, gjithçka do të asgjësohet.

Pra, a ekziston ndokush tjetër veç All'llahut, që banorët e qiellit dhe të tokës t'i kërkojnë plotësimin e nevojave të tyre ekzistenciale dhe materiale?!

Përdorimi i fjalës *"jesauluhu"*, në kohën e tashme, argumenton faktin se kjo është një "pyetje" dhe "kërkesë" e përhershme dhe të gjitha krijesat kërkojnë vazhdimisht furnizim nga burimi Gjithëfurnizues, përgjërohen për ekzistencë, si dhe dëshirojnë plotësimin e nevojave të veta. Kjo është një kërkesë e esencës së qenies, që jo vetëm në *"hudut"*, shfaqja dhe ardhja në botë, por dhe në *"beka"*,vazhdimi i jetës, i ekzistencës, të jetë e ndërlidhur dhe e mbështetur në *"vaxhibul vuxhud"*, qenien e domosdoshme.

Më pas ajeti shton: **"...e në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme."**.

Krijuesi është i përhershëm edhe përgjigjja e Tij ndaj përgjëruesve dhe nevojtarëve, gjithashtu është e përhershme. Ai për çdo ditë "harton" një "plan" të ri.

Ndodh që një ditë u jep fuqi disa popujve dhe një ditë tjetër i ul në pozitë ata. Një ditë u jep shëndet dhe rini dhe ditën tjetër i dobëson, një ditë ua heq hidhërimin dhe pikëllimin, një ditë tjetër u krijon shqetësime. Thënë shkurt, çdo ditë, në bazë të urtësisë dhe rendit shembullor, shfaq dukuri të reja, krijim dhe ndodhi të reja.

Vëmendja ndaj këtyre faktorëve, nga njëra anë, e bën të qartë nevojën tonë për Zotin e Madhëruar dhe, nga ana tjetër, heq zhgënjimet nga zemrat e njerëzve, si dhe thyen mendjemadhësinë dhe neglizhencën njerëzore.

Komentues të ndryshëm të Kur'anit, një pjesë të këtij koncepti të gjerë, e kanë përmendur si interpretim të ajetit. Disa kanë përmendur vetëm faljen e mëkateve, eliminimin e pikëllimit, ngritjen dhe rënin e popujve. Disa të tjerë, vetëm çështjen e krijimit, riskut, jetës, vdekjes, krenarisë dhe të përçmimit. Kurse disa të tjerë, kanë veçuar vetëm çështjen e krijimit dhe të vdekjes së njerëzve dhe kanë deklaruar se Zoti i Madhëruar, çdo ditë ka tri "ushtri". Një ushtri transferohet te mitrat e nënave, nga beli (eslab) i baballarëve, një "ushtri", nga mitra e nënës hedh hapa në këtë botë dhe "ushtria e tretë", është ajo pjesë e njerëzve të kësaj bote, që dërgohet në varr.

Ajeti ka një koncept të gjerë, që përfshin në vete çdo lindje të re dhe krijim të ri, si dhe çdo ndryshim dhe transformim në këtë botë.

Në një hadith nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Falënderimi dhe Lavdërimi i takon të Plotfuqishmit, që nuk vdes asnjëherë dhe mrekullitë e krijimit të Tij janë të pafundme,*

sepse Ai, çdo ditë, është në një vepër (sh'an,) apo punë të re, krijon një çështje të re që më parë nuk ka ekzistuar asnjëherë, pra, rinovon një gjë!".[1]

Në një hadith tjetër, i transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Prej veprave të Tij është falja e mëkateve, zhdukja e shqetësimeve dhe brengave. Ai ngre lart në pozitë një grup dhe një grup tjetër e ul poshtë."*.[2]

Duhet theksuar se fjala *"jeum"* përfshin periudhat e gjata, orët dhe çastet e pafundme, gjatë të cilave, pa asnjë ndërprerje, Zoti i Madhëruar është në veprim dhe punë të re.

Disa komentues të tjerë, kanë përmendur një tjetër shkak të zbritjes së ajetit në fjalë. Ata kanë pohuar se ky ajet e refuzon dhe e hedh poshtë pretendimin e hebrenjve, të cilët besonin se Zoti i Madhëruar ditën e shtunë heq dorë nga çdo gjë dhe nuk kryen asnjë punë, nuk jep asnjë vendim apo urdhër.[3]

Ndërkohë që Kur'ani thotë se programi i krijimit dhe i drejtimit të Zotit nuk ndërpritet për asnjë çast e nuk pushon për asnjë moment.

Edhe në fund të kësaj begatie të vazhdueshme dhe "përgjigje" ndaj nevojave të të gjithë krijesave dhe banorëve të qiejve e të tokës, përsërit: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

[1] Tefsiri "Usulul Kafij", vëll. 1, f. 141; tefsiri "Nuruth Thakalejn", vëll. 5, f. 193.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", ajeti në fjalë. Ky hadith, gjithashtu, është transmetuar edhe në tefsirin "Ruhu Meanij" dhe "Sahih Bukhari".
[3] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 202.

Hulumtime

1- Cila është e vërteta e "fena-së" - "asgjësimit"?

Në ajetet e lartpërmendura, u nënvizua se çdo gjë, përveç Zotit, do të asgjësohet, por jo në kuptimin e asgjësimit absolut, pra, nuk do të thotë se dhe shpirti i njeriut do të asgjësohet. As dherat e përftuara nga trupi i tij nuk do të asgjësohen. Këtë e vërtetojnë ajetet kur'anore, të cilat specifikojnë se ekziston "Berzakhu" - "Bota e Ndërmjetme", e cila vijon deri në Ditën e Gjykimit.[1]

Nga ana tjetër, ajeti disa herë e përsërit shprehjen: **"Ditën e Kiametit të vdekurit do të dalin ngrihen nga varret."**.[2]

Si dhe thotë**: "I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i Dijshëm për çdo krijim."**.[3]

Këto, që të gjitha, dëshmojnë se asgjësimi dhe zhdukja që përmendet në këtë ajet dhe në ajete të tjera të ngjashme, është në kuptimin e shkatërrimit të dualitetit trup-shpirt, të ndërprerjes dhe prishjes së kësaj bote dhe zëvendësimit me një Botë Tjetër.

[1] Sure "El Mu'minun", ajeti 100.
[2] Sure "Ja Sin", ajeti 53.
[3] Sure "Ja Sin", ajeti 79.

2- Vazhdimësia e krijimit

Thamë se ajeti: **"...në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme..."**, është shpresëdhënës, thyes i mendjemadhësisë, si dhe shenjë e vazhdimësisë së krijimit, prandaj, ndonjëherë, udhëheqësit e Islamit, për t'iu dhënë shpresë njerëzve, i referoheshin dhe mbështeteshin tek ajeti në fjalë, ashtu siç thuhet në tregimin e dëbimit të dhimbshëm të Ebu Dherrit në veprën "Rabedhe": "Kur Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e përcolli atë, e ngushëlloi me fjalë tërheqëse dhe kuptimplota. Më pas, Imam Hasani *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, i biri trim i Imam Aliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, iu drejtua atij si 'xhaxha' dhe i shtoi fjalë të tjera. Pas tij foli Prijësi i dëshmorëve, Imam Hysejni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe tha: 'O xhaxha'! Zoti i Madhëruar është i aftë dhe i denjë, që t'i ndryshojë këto kushte në çdo kohë. Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme. Ata të kanë parë ty si shqetësim për jetën e tyre, ndaj të penguan, ndërkohë që edhe ti i ke parë ata si shqetësim, pengesë të fesë tënde dhe i pengove ata. Kërko nga Zoti durim dhe qëndresë!".[1]

Tregimi vijon duke sqaruar se, kur Imam Hysejni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* po vinte në drejtim të Qerbelasë dhe arriti në vendin e quajtur Sefah dhe u takua me poetin Ferazdak, Imami tha: "Më thuaj si ishin njerëzit që ke lënë pas." (flitej për popullin e Irakut).

Ai tha: "Ke pyetur një njeri të informuar. Dije se zemrat e njerëzve janë me ty, por shpatat e tyre janë me Beni Umejen! Por Urdhri i Zotit do të zbresë nga qielli dhe Zoti do të bëjë çdo gjë që dëshiron dhe e sheh të arsyeshme.".

[1] "El Gadijr", vëll. 8, f. 301.

Imam Hysejni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* tha: "*Ke thënë të vërtetën. Çdo gjë që Zoti dëshiron, do të kryhet. Në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme.*"[1]

Të gjitha këto tregojnë se ky ajet është një ajet shpresëdhënës për besimtarët.

Për t'u nënvizuar është ky deklarim: "Njëri prej prijësve e pyeti vezirin e vet, në lidhje me interpretimin e këtij ajeti, por ai nuk e dinte dhe kërkoi afat deri të nesërmen. U kthye në shtëpi i zymtë dhe i trishtuar. Shërbëtori me ngjyrë (i zi), por i ditur, e pyeti: "Ç'të ka ndodhur?"

Ai ia tregoi ngjarjen. Shërbëtori kërkoi që të shkonte te prijësi, që t'ia tregonte komentimin e ajetit. Prijësi e thirri dhe e pyeti.

Shërbëtori iu përgjigj: "O Madhëri! Veprimi i Zotit është i tillë: ditën dhe natën i sjell njëra pas tjetrës, nga brendia e të vdekurit nxjerr të gjallin dhe nga i gjalli nxjerr të vdekurin, e shëron të sëmurin, kurse të shëndoshin e sëmur, e sprovon të shëndoshin, dhe të sprovuarit i dhuron lumturi dhe bekim, të shtypurit i jep krenari dhe krenarin e përul, të pasurin e bën të varfër dhe të varfrin e bën të pasur!"

Prijësi tha: "Më ke lehtësuar një problem, Zoti t'i lehtësoftë problemet e tua!". Më pas e lavdëroi dhe e shpërbleu atë.[2]

[1] "Kamil, i ibn Ethijr", vëll. 4, f. 40.
[2] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 9, f. 6337.

3- Lëvizja, transferimi transsubstencial

Disa ithtarë dhe pasues të doktrinës së quajtur Lëvizje transsubstenciale, kanë sjellë argumente nga disa ajete kur'anore, apo së paku ato i konsiderojnë si një tregues për doktrinën e tyre. Midis ajeteve, edhe ajetin në fjalë: **"...në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme..."**.

Kjo do të thotë se filozofët e lashtë ishin të mendimit se lëvizja është e mundur vetëm në katër kategori (pozita, sasia, cilësia, gjendja). Thënë më thjeshtë, është e mundur që një trup mund të ndryshojë vendqëndrim, ose zhvillim e rritje, mund t'i shtohet sasia, ose të ndryshojë ngjyrë, erë dhe shije, të sillet rreth vetes në vendin e vet, por mendonin se këto ndryshime duhet të ndryshonin aksidencat e trupave në fjalë, në të kundërt, lëvizja nuk do të kishte ndonjë kuptim.

Por filozofët e mëvonshëm, e kanë hedhur poshtë këtë teori dhe besojnë në Lëvizjen transsubstenciale. Ata kanë pohuar se thelbi i lëvizjes është në substancë dhe efektet e tij shfaqen tek aksidencat.

Njeriu i parë që e formuloi këtë doktrinë në mënyrë të detajuar dhe të arsyetuar, ishte Mulla Sadra Shirazi, i cili ka deklaruar: "Të gjitha grimcat dhe bota materiale në tërësi, janë në lëvizje. Shprehur ndryshe, lënda e trupave është një qenie e lëvizshme dhe esenca e saj është gjithnjë në ndryshim. Çdo moment është një qenie e re, e cila ndryshon me qenien e mëparshme, por meqenëse këto ndryshime kanë lidhje me njëra–tjetrën, konsiderohen si një realitet. Si rrjedhojë, ne në çdo

moment jemi një qenie e re, por këto qenie janë të ndërlidhura dhe kanë një formë. E thënë ndryshe, lënda, pra, materia, ka katër përmasa: gjatësinë, gjerësinë, thellësinë dhe përmasën tjetër, që do ta quajmë "kohë". Kjo "kohë" nuk është gjë tjetër, veçse sasia e lëvizjes në substancë.

Lëvizja substenciale nuk ka ndonjë lidhje me çështjen e lëvizjes brenda atomeve, sepse lëvizja e atomeve është një lëvizje hapësinore dhe Lëvizja trassubstenciale është një lëvizje në aksidencë.

Lëvizja transsubstenciale ka një kuptim shumë më të thellë. Ajo përfshin thelbin dhe identitetin e trupit dhe lëvizja është identike me lëvizjen. Si e tillë, edhe objektet bëhen korridore për veten e tyre.

Për ta provuar këtë doktrinë, ka argumente të shumta. Këtu nuk është vendi i duhur për sqarimin e tyre, por nuk do të ishte keq, nëse përmendim rrjedhojën e kësaj doktrine filozofike. Rezultati është ky: Çdo ditë, ne ta konceptojmë më mirë çështjen e njohjes së Zotit, sepse krijimi nuk ka qenë vetëm në fillim të botës. Përkundrazi, çdo çast dhe çdo moment është një fillim i ri dhe Zoti gjithnjë krijon diçka të re. Ne gjithnjë jemi të varur prej Tij dhe "të furnizuar" prej Gjithëfurnizuesit.

Edhe ajetin: **"...në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme..."**, gjithashtu, e kanë interpretuar po në këtë kuptim. Sigurisht nuk përbën ndonjë problem, nëse edhe kjo doktrinë është pjesë nga koncepti i gjerë i ajetit.

Ajetet 31 – 36

سَنَفْرُغُ لَكُمْ أَيُّهَ الثَّقَلَانِ٣١ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٣٢ يَا مَعْشَرَ الْجِنِّ وَالْإِنْسِ إِنِ اسْتَطَعْتُمْ أَنْ تَنْفُذُوا مِنْ أَقْطَارِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ فَانْفُذُوا لَا تَنْفُذُونَ إِلَّا بِسُلْطَانٍ٣٣ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٣٤ يُرْسَلُ عَلَيْكُمَا شُوَاظٌ مِنْ نَارٍ وَنُحَاسٌ فَلَا تَنْتَصِرَانِ٣٥ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٣٦

"O ju dy barrët e Tokës (njerëz dhe xhindë)**, së shpejti do të caktojmë gjykimin tuaj!"**

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"O xhindë dhe njerëz, nëse keni fuqi të përshkoni kufijtë e qiejve dhe të Tokës, atëherë përshkojini ato! Por nuk do të mund ta bëni këtë, përveçse me një fuqi të madhe (nga All'llahu)**!"**

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Kundër jush do të dërgohen flakë zjarri dhe tunxh i shkrirë (si dënim për mohimin e dhuntive të All'llahut) **dhe ju nuk do të mund të mbroheni."**

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

Komentimi

Në qoftë se mundeni, përshkojini kufijtë e qiejve!

Begatitë për të cilat u bë fjalë deri tani, kishin të bënin me këtë botë, kurse ajetet në vijim, flasin për Llogaridhënien në Kiamet dhe për disa karakteristika të tjera të Ringjalljes, e cila është njëherësh edhe kërcënim për kriminelët, edhe mjet edukimi, informimi, zgjimi, si dhe faktor nxitës për besimtarët. Për këtë arsye, është konsideruar si begati, prandaj, pas përmendjes së secilës prej tyre, përsëritet e njëjta pyetje lidhur me begatitë.

Ajeti 31 thotë: **"O ju dy barrët e Tokës** (njerëz dhe xhindë**)..."**.[1]

Zoti i Madhëruar dhe i Gjithëfuqishëm, atë ditë do t'i shqyrtojë dhe do t'i llogarisë në mënyrë të përpiktë dhe të saktë të gjitha veprimet, thëniet dhe synimet e njerëzve dhe të xhindëve. Për ata do të përcaktojë ndëshkimin apo shpërblimin e merituar dhe të përshtatshëm.

Zoti i Madhëruar, sa herë që kryen ndonjë gjë, nuk i neglizhon gjërat e tjetra. Në të njëjtën kohë, dija e Tij përfshin gjithçka. Përsëri përdorimi i sifjalisë: **"së shpejti do të caktojmë gjykimin tuaj"**, është mbresëlënëse. Kjo shprehje, zakonisht përdoret, kur një person e përqendron të gjithë vëmendjen mbi një gjë, duke hequr dorë nga çdo veprim tjetër, në mënyrë që të

[1] Edhe pse fjala "eth thekalan" është në vetën e dytë, përemri te fjala "lekum" është në "shumës", për shkak se aludon në dy grupe.

kryejë punën e caktuar me mendje të mbledhur. Kështu veprojnë vetëm njerëzit, të cilët, kur përqendrohen shumë te një veprim, harrojnë gjërat e tjera.

Por, kur kjo shprehje i atribuohet veprimeve të Zotit të Madhëruar, thuhet vetëm për ta theksuar edhe më shumë çështjen e dhënies së llogarisë, në mënyrë që të sqarohet se asnjë grimcë nuk do të mbetet e pashënuar dhe e pa gjykuar. Zoti i Madh e merr përsipër llogarinë e robëve të Vet! Sa e frikshme është një llogari e tillë!

Fjala *"thekalan"* rrjedh nga rrënja *"thiklun"* dhe përdoret me kuptimin e barrës së rëndë, por përdoret edhe në kuptimin e peshës. Fjala *"thekal"*, zakonisht, përdoret për mallrat dhe ngarkesën e udhëtarit, kurse kur përdoret për njerëz dhe xhindë, tregon rëndesën e tyre shpirtërore, sepse Zoti i Madhëruar, njerëzve dhe xhindëve, u ka dhënë intelekt, inteligjencë, dije. Njohjes së tyre i ka dhënë peshë dhe vlerë të veçantë, megjithëse, nga ana fizike, në përgjithësi, kanë një peshë të konsiderueshme. Është kjo arsyeja që në ajetin e dytë të sures "Ez Zelzele", thuhet: **"Dhe të nxjerrë toka atë që ka në brendinë e saj** (barrën nga brenda)**."**.

Njëri prej kuptimeve të kësaj thënie, është dalja e njerëzve nga varret në çastin e Ringjalljes, por sidoqoftë, shprehja e ajetit që po diskutojmë, më shumë anon nga aspekti shpirtëror, sidomos kur bëhet fjalë për xhindët, të cilët duket se nuk kanë ndonjë peshë aq të madhe trupore.

Është e nevojshme të sqarohet se përmendja e veçorive të këtyre dy grupeve bëhet për arsye se pse shumica e atyre

krijesave, që janë ngarkuar me obligimet hyjnore, janë po këto dy grupe.

Pasi sqarohet kjo çështje, sërish përsëritet pyetja: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Në vijim të diskutimeve të ajetit të kaluar, lidhur me çështjen e llogarisë së përpiktë të Zotit, sërish u drejtohet njerëzve dhe xhindëve dhe u thotë: **"O xhindë dhe njerëz, nëse keni fuqi të përshkoni kufijtë e qiejve dhe të Tokës, atëherë përshkojini ato! Por nuk do të mund ta bëni këtë, përveçse me një fuqi të madhe** (nga All'llahu)**!"**.

Në këtë mënyrë, ju asnjëherë nuk jeni në gjendje të shpëtoni nga Gjyqi i Drejtësisë së Zotit dhe pasojat e tij. Kudo që të shkoni, është pronë e Zotit dhe kudo që të jeni, është vendi i sundimit të Tij. Po, kjo krijesë e dobët dhe e pafuqishme, si mund të arratiset nga fusha e fuqisë së Zotit? Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në Lutjen e Kumeilit, thotë: "Është e pamundur ikja nga qeverisja Jote!".

Fjala *"ma'shere"* rrjedh nga fjala *"a'shara"* dhe përdoret me kuptimin: *"numri dhjetë"*. Meqenëse numri dhjetë është një numër i plotë, edhe fjala *"ma'sher"*, nënkupton një popullsi të plotë, e cila formohet nga shtresa dhe fise të ndryshme.

Fjala *"ektar"* është shumësi i fjalës *"katr"* dhe përdoret me kuptimin e skajeve të një gjëje.

Fjala *"tenfudhu"* rrjedh nga rrënja *"nufudh"* dhe përdoret me kuptimin e këputjes dhe të kalimit të një gjëje, kurse shprehja

"*min ektar*" ka kuptimin: çarje e skajeve të qiejve, kalimi i tyre dhe udhëtimi përtej tyre.

Xhindët kanë përparësi në kapërcimin e qiejve.

Se kujt i përket ajeti i lartpërmendur, Kiametit, kësaj bote apo të dyjave, është çështje diskutimi mes komentuesve të Kur'anit.

Por, meqenëse ajetet pararendës dhe pasrendës, flasin për dukuritë dhe ndodhitë e Botës Tjetër, duket që edhe ky ajet, gjithashtu, ka të bëjë me Drejtësinë Hyjnore të Kiametit.

Komentues të tjerë, duke pasur parasysh fjalinë: **"Por nuk do të mund ta bëni këtë, përveçse me një fuqi të madhe** (nga All'llahu)**"**, atë çështje e kanë konsideruar si tregues për udhëtimet hapësinore të njeriut, i ndihmuar nga zhvillimet shkencore e teknologjike.

Të tjerë komentues mendojnë që të jetë tregues edhe për Ringjalljen, edhe për këtë botë, që do të thotë se as këtu në këtë botë dhe as në Botën Tjetër, nuk do jeni në gjendje të përshkoni kufijtë e qiejve dhe të tokës, me të vetmin ndryshim, që në këtë botë zhvillimi teknologjik shihet si mjet ndihmës për këtë gjë. Por gjithsesi, mbetet i kufizuar, kurse atje, në Botën Tjetër, nuk ekziston asnjë lloj mjeti.

Disa komentues të tjerë, kanë supozuar një interpretim të katërt, depërtimi mendor dhe shkencor nëpër skajet e qiejve, e cila është e realizueshme për njeriun me anë të forcës së arsyetimit.

Komentimi i parë duket më i përshtatshëm se të gjitha komentimet tjera. Këtë e tregojnë edhe disa hadite, të cilat janë

transmetuar në burimet islame, në lidhje me këtë çështje, si për shembull, në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: "Ditën e Kiametit, Zoti i Madhëruar do t'i tubojë robtë e Vet në një vend të përbashkët dhe engjëjve të qiellit të parë do t'u shpallë: 'Zbritni poshtë!'

Ata që janë dy herë më shumë se sa popullsia e njerëzve dhe xhindëve mbi tokë, do të zbresin poshtë. Më pas, banorët e qiellit të dytë, të cilët, gjithashtu, janë dy herë më shumë, në krahasim me të gjithë të tjerët, do të zbresin. Në këtë mënyrë, do të zbresin engjëjt e të shtatë qiejve dhe ashtu si shtatë rrethime, mbulesa, do t'i rrethojnë njerëzit dhe xhindët.

Këtu do të dëgjohet një zë: 'O popullsi e njerëzve dhe e xhindëve, në qoftë se mundeni, përshkojini kufijtë e qiejve dhe të tokës, por asnjëherë nuk do të jeni të aftë për kryerjen e një vepre të tillë, përveçse me Fuqinë e Zotit.'

Këtu do të shohin se i kanë rrethuar shtatë grupe të mëdha engjëjsh dhe nuk ekziston asnjë rrugë për t'u arratisur nga kthetrat e Drejtësisë Hyjnore.".[1]

Gjithashtu, është i mundur edhe afrimi i komentimeve.

Sërish, u drejtohet dy grupeve dhe u thotë: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Kërcënimi i lartpërmendur, duket dënim e ndëshkim, por, duke u nisur nga fakti që është një paralajmërim për të gjithë njerëzit, si dhe faktor për vetëkorrigjim, ndërgjegjësim dhe edukim, konsiderohet si një mirësi dhe begati. Njerëzit do të jenë

[1] Tefsiri "Safij", f. 517; tefsiri "Mexhmul Bejan", vëll. 9, f. 205.

më të kujdesshëm në veprimet që do të bëjnë, për të cilët do të japin llogari.

Ajeti në vijim, nënvizon pafuqishmërinë e njerëzve dhe të xhindëve, për t'i shpëtuar Drejtësisë Hyjnore. Në ajet thuhet: **"Kundër jush do të dërgohen flakë zjarri dhe tunxh i shkrirë** (si dënim për mohimin e dhuntive të All'llahut) **dhe ju nuk do të mund të mbroheni."**.

Nga njëra anë, juve ju kanë rrethuar engjëjt. Nga ana tjetër, në Ditën e Gjykimit do t'ju kaplojnë flakët e zjarrit dhe tunxhi i shkrirë dhe nuk keni mundësi shpëtimi.

Fjala "*shuvadh*", siç është shprehur Ragibi në veprën "Mufredat" dhe Ibn Menthuri në veprën "Lisanul Arab", si dhe shumë komentues të tjerë, është përdorur me kuptimin e flakëve të zjarrit pa tym. Disa komentues të tjerë, e kanë pranuar me kuptimin e flakëve të zjarrit që shkëputen nga zjarri dhe janë në ngjyrë të gjelbër. Sidoqoftë, kjo shprehje tregon nxehtësinë shumë të madhe të këtyre flakëve.

Fjala "*nuhas*" është në kuptimin e tymit, ose zjarrit apo flakëve me ngjyrë të kuqe dhe me tym, të cilat kanë ngjyrën e bakrit. Komentues të tjerë, gjithashtu, atë e kanë quajtur si "bakri i shkrirë". Ky kuptim duket se nuk ka asnjë lloj përputhshmërie me ajetin që po diskutojmë, sepse këtu flitet për një qenie që do ta rrethojë njeriun në Kiamet dhe do ta parandalojë atë që të arratiset nga gjykata e Drejtësisë Hyjnore.

Sa e çuditshme është Gjykimi i Kiametit! Njeriu është i rrethuar nga të gjitha anët nga përgjegjësit hyjnorë dhe zjarri

përvëlues dhe nuk ka asnjë rrugëdalje tjetër, përveç se t'i dorëzohet këtij Gjykimi.

Sërish përsëritet pyetja: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Ajetet 37 – 45

فَإِذَا انْشَقَّتِ السَّمَاءُ فَكَانَتْ وَرْدَةً كَالدِّهَانِ٣٧ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٣٨ فَيَوْمَئِذٍ لَا يُسْأَلُ عَنْ ذَنْبِهِ إِنْسٌ وَلَا جَانٌّ٣٩ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٤٠ يُعْرَفُ الْمُجْرِمُونَ بِسِيمَاهُمْ فَيُؤْخَذُ بِالنَّوَاصِي وَالْأَقْدَامِ٤١ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٤٢ هَذِهِ جَهَنَّمُ الَّتِي يُكَذِّبُ بِهَا الْمُجْرِمُونَ٤٣ يَطُوفُونَ بَيْنَهَا وَبَيْنَ حَمِيمٍ آنٍ٤٤ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٤٥

"Veç kur të çahet qielli dhe të bëhet i kuq si trëndafili (në Ditën e Kiametit)**!"**

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Atë Ditë njerëzit dhe xhindët nuk do të pyeten për gjynahet e tyre."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Keqbërësit do të njihen sipas shenjave dhe do të kapen për ballukesh dhe për këmbësh."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Ja, ky është Xhehennemi, të cilin e mohonin keqbërësit!"

"Ata do të sillen në mes të zjarrit dhe ujit të valuar në kulm."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

Komentimi

Keqbërësit njihen sipas shenjave të tyre

Në ajetet që do të diskutojmë, do të përshkruajmë tipare të tjera të skenës së Kiametit, mënyrën e Llogaridhënies, dënimet dhe ndëshkimet.

Ajeti 37 thotë: **"Veç kur të çahet qielli dhe të bëhet i kuq si trëndafili** (në Ditën e Kiametit)**!"**.

Të gjithë ajetet që flasin për Kiametin, tregojnë se në atë ditë, do të shkatërrohet gjithçka, do të ndodhin ngjarje të rrezikshme dhe tronditëse, do të transformohen planetet, toka dhe qielli, do të ndodhin gjëra të cilat sot, për ne, janë të vështira të imagjinohen, si çarja e sferave qiellore dhe shndërrimi i tyre në ngjyrë të kuqe si trëndafili në formën e një lëngu si vaji.

Fjalët *"uerde"* dhe *"uerd"* përdoren në kuptimin e *"trëndafilit"* dhe në shoqërim me ngjyrën e kuqe të tij, imagjinohet ngjyra e sferave qiellore, kur të çahen.

Kjo fjalë është përdorur edhe në kuptimin e kuajve të kuq. Duke ditur se kuaj të tillë, zakonisht, gjatë stinëve të vitit

ndryshojnë ngjyrën e tyre, në stinën e pranverës janë me ngjyrë të verdhë, në stinën e dimrit bëhen me ngjyrë të kuqe dhe në acarin e të ftohtit, bëhen me ngjyrë të errët. Po kështu flitet edhe për ndryshimet që do të ndodhin në Ditën e Kiametit, skena e të cilës një herë do të bëhet e kuqe dhe djegëse si flaka e zjarrit, herë tjetër e verdhë dhe ndonjëherë e zezë e errët dhe plot tym.

Fjala *"dihan"* përdoret me kuptimin e *"vajit të shkrirë"*, por përdoret edhe me kuptimin e llumit që mblidhet në fund të enës së vajit dhe zakonisht ka ngjyra të ndryshme. Kështu do të ngjajë ngjyra e qiellit, që do të shndërrohet në vaj të shkrirë me ngjyrë rozë, ose sferat qiellore do të ngjajnë të shkrira.

Disa të tjerë, fjalën *"dihan"* e kanë komentuar edhe në kuptimin e *"lëkurës me ngjyrë të kuqe"*. Sidoqoftë, këto ngjasime mund ta përshkruajnë vetëm deri diku atë skenë të tmerrshme, sepse, në realitet, nuk ka asnjë ngjashmëri me ndodhitë e kësaj bote. Ato janë skena, nëse nuk i ke parë, as mundesh t'i imagjinosh.

Ngjarjet e tmerrshme të Ditës së Kiametit janë një paralajmërim për të gjithë kriminelët, kurse besimtarët konsiderohen si një mirësi prej mirësive të Zotit, prandaj, pas saj përsëritet po ajo pyetje, si tek ajetet e tjera: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Në ajetin vijues tregohet se ç'i ndodh njeriut mëkatar në Ditën e Kiametit. Ajeti thotë: **"Atë Ditë njerëzit dhe xhindët nuk do të pyeten për gjynahet e tyre."**.[1]

[1] Atë ditë besimtarët dhe keqbërësit do të njihen nga shenjat e tyre.

Përse nuk do të pyeten? Nuk do të pyeten, sepse atë ditë, çdo gjë është qartësuar. Është Dita e qartësimit dhe çdo gjë do të lexohet hapur, në sy të njerëzve.

Ajeti në fjalë, asnjëherë nuk bie ndesh me ajetet e tjera, të cilat theksojnë dhe shpjegojnë çështjen e marrjes në pyetje të robëve në Ditën e Kiametit. Një nga ajetet që flet për këtë, është ajeti 24 i sures "Es Saffat", ku thuhet: **"Ndalini ata, sepse do të merren në përgjegjësi."**.

Kjo gjë thuhet edhe në ajetet 92–94 të sures "El Hixhr": **"Pasha Zotin tënd, ata të gjithë do t'i marrin në përgjegjësi. Për atë se ç'vepruan. Publiko haptas atë për të cilën urdhërohesh, e hiqu idhujtarëve..."**.

Por ky problem do të zgjidhet, sepse Dita e Kiametit është një Ditë shumë e gjatë. Njeriut gjatë kësaj Dite do t'i duhet të kalojë në vendqëndrime dhe stacione të shumta dhe në secilin prej tyre duhet të qëndrojë për një kohë. Në bazë të disa transmetimeve, këto vendndalime janë pesëdhjetë stacione gjithsej. Në disa prej këtyre vendqëndrimeve, disa njerëz, në mënyrë absolute, nuk do të merren në pyetje, por, megjithatë, ata do të ndihen tepër të frikësuar. Për këtë do të flasim në ajetet në vazhdim.

Në disa vendndalime të tjera, njeriut do t'i vuloset goja dhe gjymtyrët e trupit do të jenë ato që do të dëshmojnë për ato që kanë bërë.[1]

[1] Sure "Ja Sin", ajeti 65.

Në disa të tjera, njerëzit do të pyeten me imtësi, deri te hollësirat më të vogla.[1]

Në të tjera vendndalime, njerëzit do të grinden dhe do të diskutojnë për të mbrojtur veten.[2] Thënë shkurt, secila skenë ka kushtet e veta dhe secila skenë është më e tmerrshme se skena tjetër.

Sërish, të gjithëve u drejtohet pyetja: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Atë Ditë, nuk do të pyeten, por "**keqbërësit do të njihen sipas shenjave"**.[3]

Një grup njerëzish janë me fytyra të ndritura. Kjo është shenjë e besimit dhe e veprave të tyre të mira, kurse një grup tjetër, ka fytyra të zeza, të ngrysura dhe të zymta, që është shenjë e idhujtarisë dhe e mëkateve të tyre, ashtu sikur është treguar në ajetet 38–41 të sures "Abese": **"Atë Ditë do të ketë fytyra të shndritura, të buzëqeshura e të gëzuara. Atë Ditë do të ketë edhe fytyra të pluhuruara që i ka mbuluar errësira e zezë."**.

Më pas ajeti shton: **"...dhe do të kapen për ballukesh dhe për këmbësh."**.

---

[1] Si për shembulli, ajeti në diskutim dhe dy ajetet e tjera që i përmendëm më lart.

[2] Sure "En Nahl", ajeti 111.

[3] Fjala *"sima"* është në kuptimin e *"shenjës"* dhe përfshin të gjitha llojet e shenjave që ndodhen në fytyrat apo në çdo pjesë të trupit të tyre, por duke pasur parasysh faktin që shenjat e gëzimit apo të hidhërimit, në shumicën e rasteve, shfaqen në fytyrë, përmendja e këtij termi, zakonisht, nënkupton fytyrën.

Fjala *"nevasi"* është shumësi i fjalës *"nasije"* dhe përdoret, siç është shprehur edhe Ragibi në veprën "Mufredat", me kuptimin e flokëve, ballukeve. Shprehja: *"akhadhe bihi nasijeteh"* nënkupton kapjen për flokësh, ballukesh dhe ndonjëherë është aluzion edhe për mbizotërimin e plotë mbi një gjë.

Fjala *"ekdam"* shumësi i fjalës *"kadem"* dhe përdoret për të emërtuar këmbët.

Kapja e kriminelëve dhe e mëkatarëve për ballukesh dhe këmbësh, ka gjasa të jetë në kuptimin tekstual, të vërtetë të saj, në mënyrë që përgjegjësit e dënimit do t'i kapin dhe do t'i tërheqin nga toka me nënçmimin më të madh dhe do t'i hedhin në Xhehennem; ose është aluzion për pafuqinë e tyre para dënimit hyjnor. Sa e trishtueshme dhe rrëqethëse është ajo skenë!

Përmendja e këtyre çështjeve, në fushën e Ringjalljes, është një paralajmërim dhe mirësi për të gjithë, prandaj përsëri shtrohet e njëjta pyetje: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Në ajetin vijues, thuhet: **"Ja, ky është Xhehennemi, të cilin e mohonin keqbërësit!"**.

Në lidhje me faktin, se, nëse të pranishmit i dëgjojnë ato që do t'u thuhen në Ditën e Gjykimit, apo i pranishëm është vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, komentuesit e Kur'anit kanë dhënë interpretime të ndryshme. Në ajet ekzistojnë dëshmi që e përforcojnë interpretimin e dytë, sepse përdorimi i foljes *"jukedhdhebu"* në kohën e tashme, si dhe përdorimi i foljes në formën joveprore, si *"muxhrimun"*, tregon se Zoti i është drejtuar Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke i

thënë: "Këto janë tiparet e Xhehennemit, që kriminelët dhe mëkatarët gjithnjë i mohojnë ato në këtë botë.".

Nëse të pranishëm janë të gjithë njerëzit dhe xhindët, Zoti i paralajmëron: "Xhehennemin, të cilin kriminelët e mohojnë, ka këto veti, që po i dëgjoni, prandaj duhet të jeni vigjilentë, që të mos përfundoni atje.".

Sërish për përshkrimin e Xhehennemit dhe dënimet rrëqethëse të tij, ajeti shton: **"Ata do të sillen në mes të zjarrit dhe ujit të valuar në kulm."**.

Fjala *"a an"* dhe fjala *"a anii"*, këtu janë përdorur me kuptimin *"të valuar"*, por që është në kulmin e nxehtësisë. Kjo fjalë rrjedh nga rrënja *"ina"*, që nënkupton *"kohën"*, sepse uji i valuar ka arritur në *"momentin dhe kohën e fundit të valimit"*.

Në këtë mënyrë, ata, nga njëra anë, do të digjen në zjarrin përvëlues të Xhehennemit, do të kenë etje dhe do të kërkojnë ujë dhe, nga ana tjetër, atyre do t'u jepet ujë i valuar (ose do t'u hidhet ujë i valuar). Ky është një dënim tejet i rëndë dhe i dhimbshëm.

Sipas disa komentuesve, në këto ajete kur'anore tregohet se burimi përvëlues i *"hamim*-it" është në afërsi të Xhehennemit. Aty, në fillim do të hidhen banorët e Xhehennemit, më pas do t'i kalojnë në zjarrin e Xhehennemit. **"Do të zhyten, në ujin e valë dhe pastaj do të digjen në zjarr."**[1]

[1] Sure "El Gafir", ajetet 71–72.

Gjithashtu, edhe përdorimi i shprehjes: **"Ata do të sillen në mes të zjarrit dhe ujit të valuar..."**, në ajetin në fjalë, është përdorur me të njëjtin kuptim.

Sërish, në ndjekje të këtij paralajmërimi të ashpër e tronditës, që në fakt është një mirësi nga ana e Zotit, ajeti shton: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Ajetet 46 – 55

وَلِمَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ جَنَّتَانِ٤٦ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٤٧ ذَوَاتَا أَفْنَانٍ٤٨ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٤٩ فِيهِمَا عَيْنَانِ تَجْرِيَانِ٥٠ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٥١ فِيهِمَا مِنْ كُلِّ فَاكِهَةٍ زَوْجَانِ٥٢ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٥٣ مُتَّكِئِينَ عَلَى فُرُشٍ بَطَائِنُهَا مِنْ إِسْتَبْرَقٍ وَجَنَى الْجَنَّتَيْنِ دَانٍ٥٤ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٥٥

"Për ata që i frikësohen paraqitjes para Zotit të vet, do të ketë dy kopshte!"

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"(Kopshtet do të jenë) **të mbjellë me pemë që bëjnë hije."**

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Në ta do të ketë dy burime që rrjedhin."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Dhe prej çdo fruti do të ketë nga dy lloje."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

“Ata do të jenë të mbështetur në shtroje, anash me armaç mëndafshi e frutat e dy kopshteve do t’i kenë afër sa t’i kapin me dorë.”

“Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!”

Komentimi

Dy Xhennete në pritje të të druajturve

Në këto ajete, banorët e Xhehennemit i ka lënë të lirë dhe është përqendruar mbi banorët e Xhennetit. Këtu ka përmendur disa prej begative të këndshme, unike dhe të mrekullueshme të Xhennetit, në mënyrë që, gjatë krahasimit me ndëshkimet e ashpra dhe të dhimbshme të Xhehennemit, rëndësia e gjithsecilës të bëhet më e qartë.

Ajeti 46 thotë: **“Për ata që i frikësohen paraqitjes para Zotit të vet, do të ketë dy kopshte!”**.

Shprehja: **“ata që i frikësohen paraqitjes para Zotit”**, ose është në kuptimin e frikës në ndalesat e Kiametit dhe dalja përpara Zotit për të dhënë llogari, ose është në kuptimin e frikës ndaj pozitës së dijes së Zotit dhe monitorimit të vazhdueshëm të Tij ndaj të gjithë njerëzve.[1]

[1] Në rastin e parë, *“mekan”* është emër vendi dhe, në rastin e dytë, është paskajore e foljes *“mim”*.

Komentimi i dytë përputhet me atë që është thënë në ajetin 33 të sures "Er Rr'ad": **"A është Ai që përcjell secilin njeri se ç'vepron?"**.

Komenti i dytë ngjason edhe me një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në të cilin thuhet: "Ai që është në dijeni se Zoti i Madhëruar sheh dhe e dëgjon çdo gjë që thotë dhe bën ai (njeriu), është në dijeni të së mirës dhe të së keqes që ka kryer. Kjo e parandalon atë që të kryejë vepra të këqija. Ai është personi që ka frikë nga dalja përpara Zotit të Madhëruar dhe e ndalon veten nga epshi dhe dëshirat inferiore."[1]

Është edhe një interpretim i tretë, për frikën nga Zoti i Madhëruar, e cila nuk është për shkak të zjarrit të Xhehennemit dhe lakmisë për të hyrë në Xhennet, por vetëm për hir të Madhështisë dhe pozitës së Zotit.

Komentimi i katërt, mbështetet në vlerësimin e "pozitës së Zotit", që e quan se është pozita e drejtësisë së Tij; sepse esenca e Tij e Stërpastër nuk është shkak i ndjelljes së frikës, por frika është nga drejtësia e Tij. Njeriu që ka bërë vepra të këqija, ka frikë nga Drejtësia Hyjnore. Ai që ka bërë vepra të mira, nuk ka frikë nga Llogaridhënia.

Kriminelët dhe mëkatarët, mjafton vetëm të kalojnë në afërsi të gjykatës, gjyqit dhe burgut dhe ndiejnë frikë, kurse për njerëzit me integritet dhe vepërmirët, nuk përbën ndonjë

[1] Tefsiri "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 70; Tefsiri "Nuruth Thakalejn", vëll. 5, f. 197. Nga nënteksti i hadithit përftohet se Imami, këtë shprehje e ka deklaruar në komentimin e ajetit: **"E kush u frikësua paraqitjes para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve?"** (sure "En Naziat", ajeti 40), edhe pse të dy ajetet kanë të njëjtën përmbajtje.

ndryshim apo problem, a është gjykatë apo tjetër gjë vendi në afërsi të tyre.

Frika nga Zoti ka burime të ndryshme. Ndonjëherë ajo e ka burimin te veprat dhe mendimet e përlyera. Edhe njerëzit e devotshëm dhe të afërmit e Zotit, e kanë frikë Atë, sepse mendojnë se do të gjykohen edhe për gabimet më të vogla. Të devotshmit frikësohen edhe vetëm nga imagjinimi dhe përfytyrimi i asaj Qenieje Absolute me Madhështi të pafundme. Ata, karshi Tij, ndihen tepër të vegjël dhe të nënçmuar. Kjo është një druajtje që përftohet nga njohuria e përsosur ndaj Zotit dhe i përket vetëm njohësve të vërtetë të Zotit.

Këto katër lloje komentesh nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe mund të afrohen të gjitha në kuptimin e ajetit.

Për sa i përket fjalës "*xhennetan*" - "*dy kopshte*", ka mundësi, që të bëhet fjalë për njërin Xhennet, që mund të supozohet Xhenneti i parë, Xhenneti material dhe fizik, kurse tjetri, Xhenneti i dytë, të jetë Xhenneti shpirtëror, ashtu siç thuhet edhe në ajetin 15 të sures "Ali Imran": **"...për ata që janë ruajtur, ata kanë tek Zoti i tyre Xhennete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe aty do të jenë përgjithmonë, kanë edhe bashkëshorte, të pastra, e gëzojnë edhe kënaqësinë e All'llahut..."**.

Në këtë ajet, përveç Xhennetit fizik, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe do të jenë edhe bashkëshortet e pastra, flitet edhe për Xhennetin shpirtëror, ku përjetohen edhe kënaqësinë e All'llahut.

Ka mendime se Xhenneti i parë u jepet atyre si shpërblim për veprat e mira që kanë bërë, kurse Xhenneti i dytë si mirësi dhe dhuratë shtesë, ashtu siç thuhet në ajetin 38 të sures "En

Nur": **"...**(ata i luten) **që All'llahu t'i shpërblejë më së miri për atë që punuan dhe për t'ua shtuar të mirat. All'llahu ia dhuron pa masë atij që do."**.

Apo njëri Xhennet është për nënshtrimin dhe tjetri për heqjen dorë nga mëkatet.

Apo njëri është për besim dhe ideologji dhe tjetri për veprat e mira dhe të ngjashme me to.

Apo, meqenëse ajeti u drejtohet njerëzve dhe xhindëve, secili nga këto dy kopshte u përket respektivisht secilit grup prej tyre.

Sigurisht, asnjëri nga këto komentime nuk kanë ndonjë argument të veçantë, ndërkohë të gjitha ato ka gjasa të afrohen në kuptimin e ajetit.

Është e qartë se Zoti i Madhëruar ka vënë në dispozicion të robërve të sinqertë dhe të drejtë kopshte të shumta të Xhennetit, që ata ecin nëpër to. Banorët e Xhehennemit janë në mesin e zjarrit të Xhehennemit dhe ujit të valuar, kurse këta në kopshtet e Xhennetit.

Sërish, pas kësaj begatie, u drejtohet të gjithëve me pyetjen: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Më pas, ka bërë përshkrimin e këtyre të dy kopshteve, Xhenneteve dhe shton: **"Kopshtet do të jenë të mbjellë me pemë që bëjnë hije."**.

Fjala "*dheuta*" është shumësi i fjalës "*dhat*", që nënkupton pronarin.

Fjala *"efnan"* është shumësi i fjalës *"fenen"* dhe përdoret me kuptimin e *degëve të reja dhe plot gjethe*, por ndonjëherë shpreh dhe llojin e pemës. Në këtë ajet, është e mundur të përdoren të dy këto kuptime. Në rastin e parë, flitet për degët e njoma të pemëve të Xhennetit, përkundër pemëve të kësaj bote, që kanë dega të vjetra, të reja dhe të thata.

Në rastin e dytë, flet për begatitë e shumëllojshme të Xhennetit. Përdorimi i të dy kuptimeve nuk përbën ndonjë problem.

Ekziston edhe mundësia, që pemët e Xhennetit të jenë të atilla, që një pemë ka degë të ndryshme dhe në secilën degë të rritet një lloj i veçantë fryti.

Sërish, pas kësaj begatie, e përsërit pyetjen: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Duke pasur parasysh faktin që një kopsht i gjelbëruar dhe i njomë, përveç pemëve, duhet të ketë edhe burime uji që të rrjedhin pranë, në ajetin vijues thuhet: **"Në ta do të ketë dy burime që rrjedhin."**.

Edhe pas kësaj begatie, e përmend pyetjen: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Në ajetin e lartpërmendur, nuk është folur për këto dy burime. I vetmi rast që përmendet, është përmendja e tyre në trajtën e pashquar. Përmendja në trajtën e pashquar është argument për madhështinë dhe rëndësinë e çështjes me atribute gjithëpërfshirëse e të pakufizuara. Por disa komentues, këto dy burime i kanë komentuar si *"selsebili"* dhe *"tesnimi"*. Këta emra

janë përmendur në ajetin 18 të sures "El Insan" dhe në ajetin 27 të sures "El Mutaffifin" dhe ndonjëherë kanë deklaruar se njëri prej dy burimeve është "*sheraban tahura*", *pija e stërpastër* dhe tjetra është "*esele musaffa*", *lumenj nga mjalti i kulluar*. Që të dyja këto janë përmendur në ajetin 15 të sures "Muhammed".

Fjalën "*xhennetan*", në ajetin e kaluar, e komentuam në kuptimin e Xhennetit shpirtëror dhe material. Natyrisht që edhe këto dy burime, gjithashtu, njëri do të jetë shpirtëror, si burimi i njohjes dhe tjetri material, siç janë burimet me ujë të kristaltë, ose me qumësht apo mjaltë të kulluar e verë të stërpastër. Por nuk kemi në dorë ndonjë argument të veçantë për asnjërin komentim.

Në ajetin vijues, diskutohet për frutat e këtyre dy kopshteve: **"Dhe prej çdo fryti do të ketë nga dy lloje."**.

Një lloj e keni parë edhe në këtë botë dhe një lloj tjetër, që nuk e keni parë kurrë në këtë botë të ngjashëm me të.

Disa komentues të Kur'anit i kanë komentuar edhe si dy llojet frutash: dimërore dhe verore, ose të thatë e të njomë, ose të vegjël e të mëdhenj, por asnjë nga këto komentime nuk ka ndonjë argument të caktuar. E sigurt është që frutat e Xhennetit janë plotësisht të llojllojshme dhe të larmishme dhe secili është më i mirë dhe më joshës se tjetri.

Sërish vijohet me pyetjen: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Në ajetet pararendëse, u përshkruan tri prej veçorive të këtyre dy kopshteve. Tani po diskutojmë për veçorinë e katërt.

Ajeti thotë: **"Ata**[1] **do të jenë të mbështetur në shtroje, anash me armaç mëndafshi…"**.

Njeriu, zakonisht, mbështet kur ndodhet në një ambient të qetë dhe të sigurt. Kjo shprehje është shenjë e qetësisë absolute dhe prehjes së plotë të shpirtrave të banorëve të Xhennetit.

Fjala *"furush"* është shumësi i fjalës *"ferash"* dhe përdoret me kuptimin e *qilimave që shtrohen*.

Fjala *"betain"* është shumësi i fjalës *"betane"*, është përdorur me kuptimin e *"astarit"*, kurse fjala *"istebrek"*, me kuptimin e mëndafshit të trashë.

Mbresëlënës është fakti që copa më e shtrenjtë që mund të imagjinohet në këtë botë, është përmendur si astar i këtyre shtrojave, pra, i qilimave, duke nënkuptuar që pjesa e sipërme e tyre është diçka që nuk mund t'i përshkruhet bukuria dhe hijeshia e saj. Në këtë botë, zakonisht, astarin e zgjedhin nga copa e dobët dhe më e lirë në çmim, sepse edhe nuk duket. Pra, copa, materiali më me pak vlerë i asaj bote është materiali, copa më me vlerë në këtë botë. Imagjinoni se si është copa e çmuar e asaj bote.

Është e sigurt që begatitë hyjnore në Botën Tjetër nuk i përshkruajmë dot me fjalët tona, madje nuk kemi as fuqinë e imagjinatës për këtë gjë. Neve na mundësohet vetëm një përfytyrim i largët, fluid, i fituar nga ajetet kur'anore.

Në ajete të tjera kur'anore, lexojmë se banorët e Xhennetit mbështeten në *"eraik"* - *"fron me vend mbështetjeje"* dhe në *"serir"* - *"fron pa vend mbështetjeje"*, kurse këtu thotë mbështeten në shtroje.

[1] Besimtarët e devotshëm që do të hyjnë në këto kopshte.

Ka mundësi që ky shpjegim të jetë i lidhur me faktin se në Xhennet, ndonjëherë mbështeten te njëri e ndonjëherë te tjetri. Është e mundur që shtrojat e shtrenjta dhe të çmueshme t'i vendosin mbi ato frone, ose të jetë tregues për çështje më të rëndësishme, konceptimi i të cilëve është i pamundur për ne, banorët e kësaj bote.

Në begatinë e pestë, aludohet në modalitetin e begative të këtij kopshti. Ajeti thotë: **"Frutat e dy kopshteve do t'i kenë afër sa t'i kapin me dorë."**.

Mundimi i vjeljes së pemëve në këtë botë, në Atë Botë nuk ekziston.

Fjala *"xhena"* përdoret me kuptimin e *"një fryti të pjekur"*, kurse fjala *"dan"* nënkupton *"afërsinë"*.

Edhe këtu u është drejtuar të gjithëve me pyetjen: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Ajetet 56 – 61

فِيهِنَّ قَاصِرَاتُ الطَّرْفِ لَمْ يَطْمِثْهُنَّ إِنْسٌ قَبْلَهُمْ وَلَا جَانٌّ٥٦ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٥٧ كَأَنَّهُنَّ الْيَاقُوتُ وَالْمَرْجَانُ٥٨ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٥٩ هَلْ جَزَاءُ الْإِحْسَانِ إِلَّا الْإِحْسَانُ٦٠ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٦١

“Atje do të ketë virgjëresha sy ulur, të cilat para tyre nuk i kanë prekur as njerëz, as xhindë.”

“Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!”

“Ato do të jenë si rubinë dhe korale.”

“Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!”

“A ka shpërblim tjetër për të mirën, veç të mirës?!”

“Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!”

Komentimi

Bashkëshortet e bukura të Xhennetit

Në ajetet e kaluara, u përmendën pesë lloje prej mirësive dhe tiparet e dy kopshteve. Në këto ajete, trajtohet begatia e gjashtë, që janë bashkëshortet e bukura dhe të dëlira të Xhennetit. Ajeti 56 thotë: **"Atje do të ketë virgjëresha sy ulur, të cilat para tyre nuk i kanë prekur as njerëz, as xhindë."**.[1]

Ato janë të virgjëra, të paprekura dhe të pastra për nga çdo pikëpamje.

Ebu Dherri ka transmetuar: *"Bashkëshortja e Xhennetit do t'i drejtohet bashkëshortit me këto fjalë: 'Betohem në Zotin e Madhëruar, që në Xhennet nuk do të gjej ndonjë gjë më të mirë se ty. Falënderimi i takon vetëm Zotit, i Cili mua më ka caktuar si bashkëshorten tënde dhe ty të ka caktuar si bashkëshortin tim.'"*.[2]

Fjala *"tarf"* përdoret për të treguar *qepallat e syrit*. Duke e ditur që qepallat e syrit gjatë shikimit puliten e lëvizin, veçanërisht kur duam të shikojmë mirë diçka që është afër nesh, në këtë rast bëhet fjalë për gratë, të cilat "shikojnë" afër, që do të thotë se dashurojnë vetëm bashkëshortin e tyre. Kjo konsiderohet si një prej epërsive më të mëdha për bashkëshorten, që të mos shohë asnjë njeri tjetër, përveç bashkëshortit të vet.

---

[1] Fjala *"lem jemithhunne"* rrjedh nga rrënja *"temeth"* dhe është në kuptimin e ciklit mujor të femrës. Është përdorur në kuptimin e rënies së virgjërisë. Këtu aludon se gratë virgjëresha të Xhennetit, asnjëherë nuk kanë pasur bashkëshortë.

[2] "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 208.

Sërish, pas kësaj begatie, u drejtohet të gjithëve me pyetjen: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Më pas, Kur'ani u ka bërë një përshkrim më të detajuar bashkëshorteve të Xhennetit. Ajeti ka shtuar: **"Ato do të jenë si rubinë dhe korale."**.

Bashkëshortet e Xhennetit janë të kuqe, të dëlira, të shndritshme si rubini, janë të bardha dhe të bukura si dega e koralit, janë të bukura dhe shumë joshëse.

Fjala *"jakut"* tregon një gur minerali, zakonisht me ngjyrë të kuqe, kurse fjala *"merxhan"* është një lloj kafshe detare, që ngjason me degët e pemës, të cilat ndonjëherë janë në ngjyrë të kuqe, ndonjëherë në ngjyrë të bardhë, ose ngjyra të tjera, por mbizotëron lloji i bardhë.[1]

Sërish, pas kësaj begatie, bëhet pyetja: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Në përfundim të këtij diskutimi, thuhet: **"A ka shpërblim tjetër për të mirën, veç të mirës?!"**.[2]

Vallë, për ata që kryejnë vepra të mira në këtë botë, a pritet gjë tjetër, përveç shpërblimit të mirëfilltë të Zotit?

Në transmetimet islame apo në komente të ndryshme, fjala *"ihsan"* është interpretuar si *"monoteizëm"*, ose si *"monoteizëm dhe njohje"*, ose në kuptimin e *"Islamit"*. Secili nga këto interpretime

---

[1] Për koralet kemi folur më gjerësish në pjesën e parë të po kësaj sureje, ajeti 22.

[2]. Pjesëza *"hel"* - *"këtu"*, është në kuptimin e pyetjes mohuese. Ky ajet është një argument për ajetet pararendëse që diskutuan në lidhje me 6 begatitë e banorëve të Xhennetit.

është shembull i qartë për një koncept të gjerë, i cili përfshin, në vetvete, çdo lloj mirësie në bindje, thënie dhe veprim.

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Në Kur'an ekziston një ajet gjithëpërfshirës dhe i gjithanshëm. Është thënia e Zotit të Madhëruar, se nuk ka shpërblim tjetër për të mirën, veç të mirës, e cila përfshin besimtarin dhe jobesimtarin, vepërmirin dhe vepërkeqin. Çdokush që tregon mirësi ndaj teje, duhet kompensuar. Rruga e kompensimit nuk është që t'i bëjmë mirësi ekuivalente me mirësinë që ai ka bërë ndaj nesh, por mirësia jonë duhet ta tejkalojë mirësinë që na pati bërë ai, sepse po të jetë ekuivalente me atë që na bëri ai, mirësia e tij mbetet më e lartë, më e vlerësuar, sepse ai ka qenë fillestari, ai ka paraprirë në mirësi."*.[1]

Si rrjedhojë, në bazë të argumentit të Imam Sadikut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në hadithin e lartpërmendur, edhe shpërblimi i Zotit në Kiamet, për këtë të mirë, do të jetë më shumë se sa gjithë vepra e njeriut në këtë botë.

Ragibi, në veprën "Mufredat", është shprehur: *"Ihsani, bamirësia është një gjë më lart se sa adaleti, drejtësia, sepse drejtësi do të thotë që njeriu të japë atë për të cilën është i detyruar dhe të marrë atë që i takon atij, kurse ihsani, apo bamirësia do të thotë që njeriu të kryejë më shumë se sa është i detyruar dhe të marrë më pak nga ajo që i takon."*.

Edhe këtu u drejtohet robërve të vet: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Vetë ky ligj, pra "shpërblimi i të mirës veç me të mirën" është një begati e madhe nga ana e Zotit të Madhëruar. Edhe

[1] Tefsire "El Ajjashhi", (në bazë të transmetimit të "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 199, si dhe tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 208.

shpërblimi i Tij për veprat e robëve, gjithashtu, është shprehje e mirësisë së Tij. Çdo vepër e punë e mirë që kanë kryer, në sajë të mirësisë së Zotit, u kthehet atyre që e kanë kryer si shpërblim dhe begati.

Hulumtim

E mira, shpërblehet me të mirë

Në ajetin e lartpërmendur, lexuam: **"A ka shpërblim tjetër për të mirën, veç të mirës?!"**. Ky është një parim i përgjithshëm në logjikën kur'anore, që përfshin Zotin, krijesat dhe të gjithë njerëzit.

Gjithëpërfshirja e këtij parimi shërben si një mësim për myslimanët, të cilët duhet të mësojnë mirë se çdo të mirë ta kompensojnë me të mirën dhe, sipas thënies së Imam Sadikut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, kompensim nuk do të thotë që ta shpërblejmë me të njëjtin shpërblim, pra, t'ia kthejmë me të njëjtën monedhë, por lipset që shpërblimi ynë të jetë më i mirë, në të kundërt, ai që ka bërë i pari mirësi, do të ketë epërsi në shpërblim.

Kur flasim për veprat tona përpara Zotit të Madhëruar, çështja merr tjetër formë, sepse pala tjetër është Zoti i Lartësuar, valët e mëshirës së të Cilit kanë përfshirë të gjithë universin. Mirësia dhe dhuntia e Tij janë të denja për qenien e Tij, jo sa pesha e veprave të njerëzve. Prandaj, nuk është rastësi që historitë e

popujve tregojnë se njerëzit që kryejnë veprave të mira, edhe pse të vogla, por me sinqeritet, janë shpërblyer me mirësi të mëdha. Për këtë, sjell një shembull, si ilustrim, njëri nga komentuesit e Kur'anit: "Një mysliman u takua me një grua të moshuar politeiste, e cila, në mes të të ftohtit, po ushqente shpendët me fara dhe i tha asaj se kjo punë nuk pranohet si vepër e mirë nga një njeri politeist, siç je ti. Plaka politeiste iu përgjigj se, edhe në u pranoftë, edhe në mos u pranoftë, unë do ta kryej këtë punë. Pasi kishte kaluar një periudhë kohe nga kjo ngjarje, myslimani u takua sërish me këtë grua, por kësaj herë në Qabe. Ajo iu drejtua atij me këto fjalë: 'O burrë! Zoti i Madhëruar për ato farëra që u dhashë shpendëve, më bekoi me begatinë e Islamit.".[1]

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 310.

Ajetet 62– 69

وَمِنْ دُونِهِمَا جَنَّتَانِ٦٢ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٦٣ مُدْهَامَّتَانِ٦٤ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٦٥ فِيهِمَا عَيْنَانِ نَضَّاخَتَانِ٦٦ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٦٧ فِيهِمَا فَاكِهَةٌ وَنَخْلٌ وَرُمَّانٌ٦٨ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٦٩

“Nën këta dy kopshte, do të ketë edhe dy kopshte të tjera.”

“Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!”

“Ato do të jenë të stolisura me gjelbërim.”

“Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!”

“Aty do të jenë dy burime që gulfojnë.”

“Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!”

“Atje do të ketë fruta, palma hurmash dhe shegë.”

“Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!”

Komentimi

Dy kopshte të tjera, me karakteristikat e tyre mahnitëse

Në vazhdimësi të temës së kaluar, që u diskutua për veçoritë e "dy kopshteve për të druajturit", në këto ajete, do të diskutojmë për "dy kopshte" të tjera, që ndodhen në një shkallë më poshtë. Këto kopshte janë për ata njerëz që kanë një nivel më të ulët besimi dhe kanë në një shkallë më të vogël përkushtimi.

Ajeti 62 thotë: **"Nën këta dy kopshte, do të ketë edhe dy kopshte të tjera."**.

Në lidhje me këtë ajet kur'anor, janë përmendur dy komente: Së pari, është po ajo që cituam më lart. Së dyti, komentimi sqaron se shprehja *"min duhinima"* do të thotë se ata besimtarë, përveç atyre dy kopshteve, do të kenë edhe dy kopshte të tjera, ku do të argëtohen dhe do të shëtisin nëpër begatitë e shumëllojshme të tyre, sepse qenia njerëzore kërkon argëtim dhe zbavitje.

Komentimi i parë duket më i përshtatshëm.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lidhur me komentin e këtij ajeti, ka thënë: *"Ekzistojnë dy Xhennete, kopshte, ndërtimi i tyre dhe gjithë çfarë ndodhet brenda tyre, është prej argjendi. Gjithashtu, ekzistojnë edhe dy kopshte të tjera, ndërtimi i tyre dhe i gjithë çfarë ndodhet në brendësi të tyre, është prej floriri."* (Përdorimi i fjalëve, prej argjendi dhe prej

floriri, ka gjasa të flitet për ndryshimin e vlerës së begative të tyre).[1]

Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ka transmetuar, se kuptimi i ajetit, që po diskutojmë, është: *"Mos thuaj që ekziston vetëm një Xhennet, sepse Zoti i Madhëruar thotë: 'Përveç tyre do të ketë edhe dy Xhennete të tjera.' Mos thuaj se grada është e njëjtë, sepse Zoti thotë se ka disa grada, që janë më lart se disa të tjera. Ky dallim është për shkak të veprave."*.[2]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lidhur me këtë çështje, thuhet: *"Ekzistojnë dy Xhennete prej floriri, për të afërmit (të devotshmit) dhe dy të tjera prej argjendi për "as'habul jemin" shokët e djathë."*.[3]

Më pas shton: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Në vijim jepen pesë karakteristikat e dy kopshteve, Xhenneteve, disa prej të cilave ngjasojnë me karakteristikat e dy kopshteve të lartpërmendura. Ajeti 64 thotë: **"Ato do të jenë të stolisura me gjelbërim."**.

Fjala *"mud'hammetan"* buron nga fjala *"id'hijmam"*, e cila rrjedh nga rrënja *"du'hme"*. Është përdorur me kuptimin e *"errësirës së natës"*. Më pas, është përdorur edhe në kuptimin e ngjyrës së gjelbër të errët. Duke u nisur nga fakti që një ngjyrë e

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", ajeti në fjalë.
[2] Po aty.
[3] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 146, ashtu siç e cekëm edhe më lart. Përdorimi i fjalëve *"flori"* dhe *"argjend"* ka gjasa të aludojë për dallimin e shkallëve mes këtyre dy kopshteve.

tillë është shenjë e kulmit të lumturisë dhe e lulëzimit të bimëve dhe të pemëve, kjo shprehje tregon se gjallëria dhe lulëzimi i këtyre dy kopshteve, Xhenneteve është në majat e tyre.

Sërish shtrohet pyetja: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Në ajetin vijues, përshkruhet një karakteristikë tjetër. Ajeti 66 thotë: **"Aty do të jenë dy burime që gulfojnë."**.

Fjala *"nedh'dh'akhatan"* rrjedh nga rrënja *"nadh'kh"* dhe përdoret me kuptimin e ujit që gufon.

Edhe një herë tjetër u drejtohet njerëzve dhe xhindëve me pyetjen: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Ajeti 65 shprehet kështu, lidhur me frutat e këtyre dy kopshteve: **"Atje do të ketë fruta, palma hurmash dhe shegë."**.

Fjala *"fakihetun"* mbart një kuptim të gjerë. Ajo përfshin të gjitha llojet e frutave. Por hurma dhe shega janë përmendur më shpesh, për shkak të rëndësisë dhe karakteristikave që dallohen nga frutat e tjera. Lidhur me këtë, disa komentues të Kur'anit kanë pretenduar se hurma dhe shega nuk bëjnë pjesë në konceptin e fjalës *"fakihe"*. Por kanë gabuar, sepse leksikologët e kanë mohuar një gjë të tillë. Parimisht, përmendja e të veçantës pas të përgjithshmes, në rastet kur ekziston një epërsi, është plotësisht e zakonshme, siç është thënë në ajetin 98 të sures "El Bekare": **"Kush është armik i All'llahut, i engjëjve të Tij, i të Dërguarve të Tij, i Xhibrilit dhe i Mikailit, All'llahu pa dyshim është armik i mosbesimtarëve."**.

Këtu, Xhibraili dhe Mikaili, dy prej engjëjve të mëdhenj të Zotit, janë përmendur me emrat e tyre të veçantë, pas citimit me emrin e përgjithshëm "engjëj" për engjëjt e tjerë, pikërisht për t'i evidentuar si të tillë.

Sërish, përsërit të njëjtën pyetjeje: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Hulumtim

Dobia e frutave

Në ajetet e lartpërmendura, mes ushqimeve të Xhennetit, u theksuan frutat dhe u veçuan sidomos hurma dhe shega. Por duhet vënë re se, në vend të hurmës, ajeti ka përmendur "pemën e palmës", kurse në vend të shegës, ka përmendur vetë emrin e frutit. Pa dyshim që secili nga këto mbart në vetvete një kuptim të caktuar.

Veçimi i frutave nga të gjitha ushqimet e tjera të Xhennetit, synon të tregojë rëndësinë e madhe që kanë frutat në ushqimin e njeriut. Njeriu është quajtur edhe si "krijesa frutëngrënëse", pra, kuptohet se sa i rëndësishëm është roli i frutave në jetën e tij. Kjo është pranuar jo vetëm nga shkenca, por edhe nga përvoja mbarënjerëzore.

Përmendja e "palmës së hurmës" në vend të frutit të saj, mund të jetë përdorur, sepse "palma e hurmës", përveç frutave të saj, përdoret edhe për veti të tjera, kurse "pema e shegës" nuk ka karakteristika të tilla. Nga gjethet e palmës së hurmës thurin edhe mjete për jetese, si p.sh: qilimin, kapelën, rroba të ndryshme, mjete transporti, shtratin e fjetjes, etj. Edhe fijet e saj i përdorin për ilaçe. Disa nga trungjet e tyre i përdorin si lëndë ndërtimi apo edhe si ura për të kaluar mbi lumenjtë.

Përzgjedhja e këtyre dy frutave, mes frutave të tjera të Xhennetit, është bërë për arsye të dallimit që kanë me njëri-tjetrin. Njëri zakonisht rritet në zona të nxehta, kurse tjetri në zona të ftohta, njëri ka lëndë fruktoze, tjetri ka lëndë acide, njëri është ushqyes, tjetri shuan etjen.

Hurma ka lloje të shumta vitaminash, më shumë se 13 lëndë jetësore. Për pesë llojet e vitaminave kryesore që përmban ajo, si dhe për veçoritë e tjera të saj, kemi diskutuar në ajetin 25 të sures "Merjem", ku është përmendur se hurma futet te ushqimet energjike.

Shega, në disa transmetime islame, është paraqitur si fryti më i mirë dhe më i dobishëm, pra, *"sejjidul fakihe"*.[1] Dijetarët specialistë, në fushën e ushqimit, kanë përmendur shumë veti të veçanta ushqyese dhe kurative të saj. Mes të tjerash, janë përqendruar mbi "fuqinë e shegës për pastrimin e gjakut", si dhe është quajtur depoja e vitaminës C.

Në libra të ndryshëm, janë përmendur edhe dobi të tjera të shegës, si: shega forcon stomakun, zhduk temperaturat e

[1] Kjo shprehje është transmetuar në një hadith nga Profeti i Islamit, "Biharul Enuar", vëll. 66, hadithi 43, f. 163.

fshikëzës së tëmthit, lufton verdhëzën, lufton zgjeben, forcon shikimin, shëron plagët kronike, përforcon mishin e dhëmbëve, si dhe ndërpret diarrenë.

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Ushqimi i fëmijëve me shegë ndikon në rritjen dhe zhvillimin e shpejtë të tyre.*".[1]

Në një hadith tjetër, lexojmë: "*Flasin më shpejt.*".[2]

Në një hadith tjetër, po nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, tregohet: "*Për Profetin Muhammed, ndër të gjitha frutat, shega ishte fryti më i dashur.*".[3]

[1] "Biharul Enuar", vëll. 66, hadithi 47, f. 164.
[2] Po aty, Hadithi 50, f. 165.
[3] Tefsiri "Usulul Kafij", vëll. 6, K. "El Riman", hadithi 3, f. 352.

Ajetet 70 – 78

فِيهِنَّ خَيْرَاتٌ حِسَانٌ٧٠ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٧١ حُورٌ مَقْصُورَاتٌ فِي الْخِيَامِ٧٢ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٧٣ لَمْ يَطْمِثْهُنَّ إِنْسٌ قَبْلَهُمْ وَلَا جَانٌّ٧٤ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٧٥ مُتَّكِئِينَ عَلَى رَفْرَفٍ خُضْرٍ وَعَبْقَرِيٍّ حِسَانٍ٧٦ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ٧٧ تَبَارَكَ اسْمُ رَبِّكَ ذِي الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ٧٨

"Në to do të ketë bukuroshe virtytesh të mrekullueshme."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"(Atje do të ketë) **hyri syzeza nëpër tenda."**

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Ato hyri nuk i kanë prekur para tyre as njerëz, as xhindë."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Ata do të rrinë mbështetur në shtroje të gjelbra e qilima të bukur."

"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"

"Qoftë lartësuar Emri i Zotit tënd, plot Madhëri dhe Nderim!"

Komentimi

Sërish, bashkëshorte të Xhennetit

Pasi u diskutua dhe u përshkruan begatitë e të dy kopshteve, të dy Xhenneteve, në ajetet e mësipërme, në ajetet në vijim do të flitet për vlerat dhe veçori të tjera të këtyre begative.

Ajeti 70 thotë: **"Në to do të ketë bukuroshe virtytesh të mrekullueshme."**.[1]

Këto gra mbartin "virtyte të larta" dhe "bukuri në paraqitje". Fjala *"hajr"* përdoret zakonisht, për të treguar virtytet e vyera dhe bukurinë shpirtërore, kurse fjala *"husn"* zakonisht përdoret për të treguar bukurinë dhe hijeshinë e paraqitjes.

Transmetimet e cituara, lidhur me këtë ajet, tregojnë shumë cilësi dhe virtyte, që i karakterizojnë bashkëshortet e Xhennetit. Përmendja e këtyre cilësive bëhet, për të shërbyer si model i vlerave dhe cilësive të larta që duhet t'i karakterizojnë gratë e kësaj bote. Më së shumti përmenden cilësi të tilla, si: fjalëmbla, të pastra, të dëlira, të qeta e paqësore, besnike, etj.

Thënë shkurt, të gjitha cilësitë e përsosmërisë, që ekzistojnë te një bashkëshorte, janë të pranishme tek ato. Kur'ani i ka

[1] Përemri *"fihinne"*, që është shumësi i gjinisë femërore, ka gjasa t'i referohet katër kopshteve të Xhennetit që u përmendën më sipër. Gjithashtu, ka gjasa t'i referohet dy kopshteve që u përmendën në fund, në shenjë të kopshteve të shumta dhe ndërtesave të llojllojshme që ato kanë. Ky komentim është më i përshtatshëm, sepse llogarinë e tyre e ka ndarë nga njëra-tjetra.

përmendur të gjitha cilësitë e mira që mbartin bashkëshortet e Xhennetit, vetëm me fjalët "*hajratun hisan*".[1]

Edhe pasi përmend këtë begati, sërish pyet: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Ajeti, në vijim të përshkrimit të bashkëshorteve të Xhennetit, shton: **"Atje do të ketë hyri syzeza nëpër tenda."**.

Fjala *"huurun"* është shumësi i fjalës *"haura"* dhe *"ahuar"*. Quhet ai person që i ka sytë krejtësisht të zinj, kurse bardhësinë e ka të tejdukshme. Ndonjëherë është përdorur edhe për gratë me fytyrë të bardhë.

Fjala *"maksurat"* përdoret për të treguar se bashkëshortet e Xhennetit u përkasin vetëm bashkëshortëve të tyre dhe për të tjerët janë të fshehura dhe të pazbuluara.

Fjala *"khijam"* është shumësi i fjalës *"khime"*, me kuptimin "*tendë*". Sipas transmetimeve islame, tendat në Xhennet nuk ngjajnë me tendat e kësaj bote. Ato janë shumë më të bukura.

Duhet sqaruar se fjala *"khime"* - *"tenda"*, sipas leksikologëve dhe disa komentuesve, nuk përdoret vetëm për të treguar tendat e mbuluara me copë tekstili, të cilat i kemi edhe ne në përdorim, por kjo fjalë është përdorur për të treguar shtëpitë e ndërtuara prej druri, madje për çdo shtëpi të rrumbullakët.

[1] Në lidhje me fjalën *"hajrat"*, disa kanë pretenduar se është shumësi i fjalës *"hejirre"* dhe për shkak të shkurtesës së saj, atë e kanë quajtur *"hejrat"*. Disa të tjerë, atë e kanë konsideruar si shumësin e fjalës *"hejre"*. Sidoqoftë, në të dy rastet, është në kuptimin e cilësisë dhe të përshkrimit dhe jo në kuptimin e shkallës sipërore, sepse kjo shkallë nuk e pranon shumësin.

Ndonjëherë kanë pohuar se fjala *"khime"* përdoret për çdo shtëpi që nuk është e ndërtuar prej guri, apo të ngjashëm me gurin.[1]

Sërish, përsëritet e njëjta pyetje: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Ajeti vijues u bën një tjetër përshkrim hyrive të Xhenentit: **"Ato hyri nuk i kanë prekur para tyre[2] as njerëz, as xhindë."**.[3]

Ashtu siç tregohet edhe në ajete të tjera kur'anore, gratë dhe burrat që janë bashkëshortë me njëri–tjetrin në këtë botë, në qoftë se që të dy janë besimtarë dhe banorë të Xhennetit, edhe në Atë Botë do të jenë së bashku dhe do të jetojnë bashkërisht në kushtet më të mira.[4]

Madje nga disa transmetime, përftohet se këto bashkëshorte kanë një pozitë më të lartë se hyritë e Xhennetit, për arsye të adhurimit dhe veprave të mira që kanë kryer në këtë botë.[5]

Pas këtij sqarimi, sërish shtron pyetjen: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Në përshkrimin e fundit që është përmendur në këto ajete, në lidhje me begatitë e Xhennetit, thuhet se banorët e këtyre dy kopshteve: **"Ata do të rrinë mbështetur në shtroje të gjelbra e qilima të bukur."**.

---

[1] "Lisanul Arab", "Mexhmaul Behrejn" dhe "El Munxhid".
[2] Banorët e dy kopshteve më të ulëta.
[3] Në lidhje me kuptimin e fjalës *"tëmth"* kemi dhënë një shpjegim më të gjerë në po këtë sure, në ajetin 56.
[4] Sure "Er Rrad", ajeti 23 dhe sure "El Mu'min", ajeti 8.
[5] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 151.

Fjala *"rafraf"* është përdorur për të treguar *"gjethet e gjera të pemëve"*. Më pas e ka zgjeruar shtrirjen kuptimore dhe është përdorur edhe për të treguar copat e bukura shumë ngjyrëshe që të japin pamjen e kopshteve.[1]

Fjala *"abkarij"* tregon *"çdo gjallesë që është e veçantë në llojin e vet, ose që ka pak të ngjashëm me të"*, prandaj një pjesë e vogël e shkencëtarëve i quajnë *"abakira"*. Pjesa dërmuese e komentuesve janë të mendimit se fjala *"abkar"*, në fillim ka qenë emër, të cilin arabët e kishin përzgjedhur për "qytetin e zanave", por meqenëse ky qytet ishte i panjohur, si për çdo gjë e cila nuk ka njohje, nuk ka të ngjashëm, edhe këtë e quajtën *"abkarij"*.

Të tjerë kanë deklaruar se *"abkar"* ka qenë një qytet ku thureshin shtrojat më të mira prej mëndafshi.[2]

Por, aktualisht rrënja kryesore e kësaj fjale është braktisur dhe fjala *"abkari"* përdoret si një fjalë më vete, në kuptimin "diçka e rrallë", ose "diçka tejet e çmuar". Megjithëse është në njëjës, ndonjëherë përdoret edhe me kuptimin e shumësit. (si ajeti që po diskutojmë).

Fjala *"ihsan"* është shumësi i fjalës *"hasan"* dhe nënkupton *"të mirën dhe të bukurën"*.

Të gjitha këto shprehje tregojnë se në Xhennet, çdo gjë është sipërore, frutat, ushqimet, ndërtesat, qilimat, thënë shkurt çdo gjë në të, në llojin e vet, është e pashembullt, e pangjashme. Duhet të pohojmë, gjithashtu, se ne asnjëherë nuk jemi në gjendje

[1] Disa komentuesit të Kur'anit, kanë sjellë si shembull qilimin e njohur, si "galeria e Enushirvanit". Është qilim jashtëzakonisht i çmueshëm, që pasqyron pamjen e një kopshti.
[2]Tefsiri i "Ebul Fetuh Rrazij", ajeti në fjalë.

t'i perceptojmë këto koncepte që diskutuam. Ne mundemi vetëm t'i parafytyrojmë, t'i imagjinojmë ato.

Më pas, për herë të fundit, por për të tridhjetën e një herë radhazi, u drejtohet njerëzve dhe xhindëve me pyetjen: **"Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!"**.

Dhuntitë shpirtërore apo dhuntitë materiale? Dhuntitë e kësaj bote apo dhuntitë e Xhennetit? Apo jeni neglizhentë për të gjitha këto dhunti dhe i keni lënë pas dore dhe në harresë, keni harruar Dhuruesin e të gjitha këtyre begative, Atë prej të Cilit vijnë të gjitha begatitë?! Cilën prej tyre mohoni?

Në ajetin e fundit të sures thuhet: **"Qoftë i Lartësuar Emri i Zotit tënd, plot Madhëri dhe Nderim!"**.

Fjala "*tebarek*" rrjedh nga rrënja "*berk*" dhe përdoret për të treguar "*gjoksin e devesë*". Por devetë, kur ndalojnë, gjoksin e tyre e puthitin me tokën, prandaj kjo fjalë është përdorur edhe në kuptimin e qëndrueshmërisë, përhershmërisë dhe jetëgjatësisë.

Gjithashtu, duke ditur se kapitali i qëndrueshëm, që nuk prishet shpejt, ka dobi të shumta, edhe qenia plot dobi quhet "*mubarek*", prandaj, edhe personi më i denjë që e meriton këtë emërtim, që është Esenca e Stërpastër e Zotit të Madhëruar, është burimi i të gjitha begative dhe mirësive.

Kjo shprehje është përdorur, sepse në këtë sure janë përmendur llojet e begative dhe të mirësive të Zotit në tokë dhe në qiej, në krijimin e njerëzimit, në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Duke pasur parasysh faktin se të gjitha këto rrjedhin nga Qenia

tejet e bereqetshme e Zotit, shprehja më e përshtatshme është ajo që është përmendur në ajet.

Me fjalën *"ism" - "emri"*, shënohen cilësitë e Zotit, sidomos cilësia e "të Qenit i Gjithëmëshirshëm", që është burimi i të gjitha këtyre begative. Shprehur ndryshe, veprat e Zotit burojnë nga cilësitë e Tij. Ai e ka krijuar universin me rend dhe për çdo gjë ka përcaktuar një masë, sepse këtë e kërkonte urtësia e Tij. Edhe nëse ka përcaktuar rrjedhjen e Ligjit të Drejtësisë në çdo gjë, këtë e kërkon dija dhe drejtësia e Tij. Edhe nëse kriminelët i dënon me llojet e dënimeve që i ka përmendur në këtë sure, kjo është për shkak të cilësisë së Tij, *"muntekim"*. Nëse besimtarët e drejtë i përfshin në lloj-lloj begatish shpirtërore dhe materiale në këtë botë dhe në Tjetrën, kjo është për shkak të mirësisë dhe mëshirës së gjerë të Tij. Si rrjedhojë, fjala *"ism" - "emër"*, është tregues për cilësitë e Tij, të cilat janë identike me Qenien e Tij të Strëpastër.

Përdorimi i shprehjes: *"dhil xhelali uel ikram" - "plot Madhëri dhe Nderim"*, është një tjetër tregues për të gjitha cilësitë e hijeshisë dhe madhërisë së Zotit. Fjala *"dhil xhelal"* tregon cilësitë mohuese, kurse *"dhil ikram"* tregon për cilësitë pozitive.

Nuk është rastësi, që kjo sure fillon me Emrin e Zotit, *"Rrahman"* dhe përfundon me emrin e Zotit, *"Dhilxhelal uel ikram"*. Që të dy këta emra janë në harmoni me tërësinë e përmbajtjes së sures.

Hulumtime

1- Në ajetin 27, në këtë sure, pasi përmend begatitë e ndryshme shpirtërore dhe materiale të kësaj bote, thuhet: **"... plot Madhëri dhe Nderim"**. Këto dy cilësi tregojnë se të gjitha vektorët përfundojnë në Qenien e Stërpastër të Tij.

Çdo gjë që ekziston, është nga ana e Tij, bota është nga Ai edhe Amshimi, gjithashtu, është nga ana e Tij. Hijeshia, nderimi dhe Madhëria e Tij ka përfshirë çdo gjë.

2- Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë se një njeri po lutej në prani të tij dhe thoshte: "O Zot i Madhërishëm dhe me Nderim!"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: *"Tani që iu lute Zotit me këtë emër, të është pranuar lutja. Kërko nga Ai çfarë të duash!"*.[1]

Në një hadith tjetër, thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pa një njeri që po qëndronte në këmbë dhe po falte namazin. Pas rukusë, sexhdes dhe shehadetit, ai bëri këtë lutje: "All'llahumme inni eseluke bienne lekel hamdu, la ilahe il'la ente, uahdeke la sherike leke; el mennanu, bedius semauati uel erdhi, ja **dhel xhelali uel ikram**, ja hajju ja kajjum, inni es'eluke... Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte thënë se *"Ky njeri e thirri Zotin me Emrin e Tij të madh. Sa herë që e thërrasin*

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 153.

Zotin me këtë emër, Ai e pranon lutjen dhe, sa herë e pyesin nëpërmjet tij, Ai iu përgjigjet.".[1]

3- Në një hadith tjetër nga Imam Bakiri *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë se për komentimin e ajetit: **"Qoftë Lartësuar Emri i Zotit tënd, plot Madhëri dhe Nderim!"**, midis të tjerash**,** ka thënë: *"Ne jemi madhështia e Zotit dhe nderimi i Tij, që robtë i ka nderuar me bindjen ndaj nesh."*.[2]

Është e qartë se Ehli Bejti, familja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk fton, përveç drejt Zotit, si dhe nuk fton përveçse në bindjen ndaj Tij. Ata janë udhëzuesit e Rrugës dhe anija e shpëtimit në këtë det të trazuar të jetës së kësaj bote.

Si rrjedhojë, konsiderohen si një prej shembujve të madhërisë dhe nderimit të Zotit, ngaqë Zoti i Madhëruar, nëpërmjet njerëzve të Tij të dashur, i përfshin njerëzit në mëshirën e Udhëzimit.

4- Disa kanë transmetuar se në pjesën e parë të Kur'anit Fisnik, e cila u është lexuar haptazi kurejshve në Mekë, kanë qenë ajetet e fillimit të po kësaj sureje (të sures "Rrahman").

Abdullah bin Mesudi ka thënë: "Shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u mblodhën së bashku dhe deklaruan se deri më sot populli kurejsh nuk ka dëgjuar asgjë nga Kur'ani. Kush do t'ua lexojë atyre Kur'anin haptazi? Unë thashë se isha i gatshëm t'ua lexoja, por ata me thanë se kishin frikë se mos më lëndonin, prandaj më

[1] Po aty.
[2] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 272.

mirë këtë punë ta merrte përsipër një person që ka një fis të fuqishëm dhe të fortë, në mënyrë që t'i ketë si mbrojtje. Unë u thashë të më lënë të bëj leximin e asaj pjese të Kur'anit, se kisha mbrojtës Zotin.

Ditën tjetër, Ibn Mesudi, në mes të ditës, qëndroi në afërsi të Mekamit të Ibrahimit, pranë Qabes dhe në kohën që kurejshët ishin mbledhur në tubimin e tyre, u ngrit në këmbë dhe me zë të lartë tha: "Bismilahir Rrahmanir Rrahim. Errahman, al'lemel Kur'an..." dhe vazhdoi deri në fund. Kurejshët ranë në heshtje. Pasi dëgjuan fjalët e tij, thanë: "Ç'është duke thënë ky burrë, pa kokë dhe pa këmbë?" (pa fis dhe pa mbrojtës).

Disa thanë se ai po lexon një pjesë të atyre fjalëve që i ka shpallur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata u ngritën dhe e goditën rëndë në fytyrë, por ai përsëri vazhdoi me leximin e sures, aq sa Zoti dëshironte.

Më pas u kthye nga shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Plaga ishte plotësisht e dukshme në fytyrën e tij. Ata i thanë: "Ne i frikësoheshim kësaj që të bënë ty!".

Ibn Mesudi tha: "Asnjëherë këta armiq të Zotit nuk kanë qenë kaq të përulur dhe të nënçmuar. Nëse dëshironi, vazhdoj dhe nesër. Asnjëherë nuk kam frikë.".

Shokët i thanë: "Jo, kjo është e mjaftueshme. Ti ua lexove atë që ata nuk e dëshironin.".[1]

[1] "Sireh Ibn Hisham", vëll. 1, f. 336.

Për këtë arsye Ibn Mesudi konsiderohet i pari person që e ka lexuar hapur Kur'anin për politeistët e Mekës.[1]

O Zoti im! Ti je i Madhërishëm dhe me Nderim! Betohem në Madhërinë dhe Nderimin tënd! Të lutem, mos na privo nga begatitë dhe mirësitë e Xhennetit!

O Zoti im! Rrethi i Mëshirës Tënde është shumë i gjerë! Edhe pse nuk kemi kryer ndonjë vepër që meriton Mëshirën Tënde, të lutem, vepro me ne, ashtu siç i takon pozitës Tënde të Mëshirës!

O Zoti im! Ne nuk përgënjeshtrojmë asnjë nga begatitë e Tua dhe veten tonë gjithnjë e konsiderojmë të zhytur në Mirësitë Tua!
Të lutem, na furnizo vazhdimisht me Mirësitë e Tua!

Amin ja rabbil alemin
Fundi i sures "Er Rrahman"

[1] "Usdul Gabe", vëll. 3, f. 257.

SURE "El Uakia"

Zbritur në Mekë, 96 ajete

Përmbajtja e sures "El Uakia"

Në librin "Tarikhul Kur'an" të Ibn Nedijmit është transmetuar: "Surja 'El Uakia' është surja e dyzet e katërt që i është zbritur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[1] Para saj ka zbritur surja 'Ta Ha' dhe pas saj ka zbritur surja 'Esh Shuara'.".

Kjo sure, siç është përshkruar nga komentuesit e Kur'anit, ka zbritur në Mekë, edhe pse disa nga komentuesit e saj mendojnë se ajetet 81-82 kanë zbritur në Medine. Për këtë ata nuk kanë ndonjë argument. As vetë këto ajete nuk japin ndonjë dëshmi të tillë.

Surja "El Uakia", ashtu siç kuptohet edhe nga vetë emri i saj, diskuton për Kiametin dhe karakteristikat e tij. Kjo çështje është temë kryesore në 96 ajetet e saj. Por nga një pikëpamje tjetër, përmbajtjen e sures mund ta klasifikojmë në tetë pjesë:

1- Fillimi i Kiametit dhe ndodhitë e rënda që e shoqërojnë.
2- Grupimi i njerëzve në Atë Ditë dhe ndarja e tyre në As'habul jemin, As'habush shumal dhe Mukar'rrabin.
3- Diskutimi për "gradat e mukar'rrabinëve" dhe llojet e shpërblimeve të tyre në Xhennet.
4- Diskutimi për grupin e dytë, As'habul jemin dhe shumëllojshmëria e begative hyjnore për ta.
5- Diskutimi për As'habul shumal dhe dënimet e tyre në Xhehennem.

[1] Ebu Abdullah Zenxhanij, "Tarikhul Kur'an", f. 59.

6- Argumentet e ndryshme për Ringjalljen, për Fuqinë e Zotit, krijimin e njeriut nga një farë e pa vlerë, jeta te bimët, dërgimi i shiut dhe ndezja e zjarrit, të cilat janë konsideruar edhe si shenja të monoteizmit.

7- Përshkrim i momenteve të kalimit nga kjo botë në Botën Tjetër, agonia dhe çastet e vdekjes. (kjo është një nga premisat e Ringjalljes)

8- Shpërblimi dhe ndëshkimi i besimtarëve dhe i jobesimtarëve. Përfundimi i sures me Emrin e Zotit të Madhëruar.

Mirësitë e leximit të sures "El Uakia"

Mirësitë e leximit të kësaj sureje, janë përmendur në shumë hadithe në literaturën islame. Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: "*Për atë që e lexon suren 'El Uakia', do të shkruhet, se ky person nuk është prej njerëzve mospërfillës,*"[1] sepse ajetet e kësaj sureje janë aq tronditëse dhe ndërgjegjësuese, saqë nuk mbetet më vend për neglizhencë dhe shpërfilljen e njeriut.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në një hadith tjetër të transmetuar, po për këtë arsye, ka thënë: "*Kur më pyetën se, përse në fytyrën time u dukën kaq shpejt shenjat e pleqërisë, u thashë se mua më kanë plakur suret*

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 212 dhe tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 273.

'Hud', *'El Uakia'*, *'El Murselat' dhe 'En Nebe'*[1], sepse në këto sure janë dhënë informacione tronditëse për Kiametin, Ringjalljen dhe ngjarjet e frikshme që do të shoqërojnë dënimet e kriminelëve, si dhe tregimet rrëqethëse nga historia e popujve të kaluar, fatkeqësitë që u kanë ndodhur atyre, si dhe urdhri për qëndresë dhe qëndrueshmëri.

Në një hadith tjetër nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Zoti do ta dojë atë që e lexon suren 'EL Uakia', çdo të enjte në mbrëmje, do ta bëjë të dashur për të gjithë njerëzit. Asnjëherë nuk do të ketë ndonjë shqetësim në këtë botë. Nuk do ta prekin varfëria, fatkeqësitë dhe të këqijat e kësaj bote dhe do të jetë prej shokëve besnik të Imam Aliut (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)."*[2]

Në një hadith tjetër, thuhet se Osman bin Affani shkoi për ta vizituar të sëmurin Abdullah bin Mesud dhe e pyeti: "Pse jeni i shqetësuar?"

Tha: "Për mëkatet."

I thashë: "Çfarë dëshiron?"

Tha: "Mëshirën e Zotit tim!"

I thashë: "Nëse je dakord, a t'u sjell një mjek?"

Tha: "Mjeku më ka sëmurur."

I thashë: "Nëse dëshiron, urdhëroj të të sjellin hisen tënde nga arka e shtetit."

[1] "Khisalu Suduk", vëll. 1, K. 4, Hadithi 10, f. 199.
[2] "Theuabul A'mal", f. 117; Tefsiri "Nuruth Thakalejn", vëll. 5, f. 203.

Tha: "Atë ditë që kisha nevojë, nuk ma dhe, kurse sot që nuk kam më nevojë për të po ma jep?!."

I thashë: "S'ka gjë, le të mbetet për vajzat e tua."

Tha: "As ato nuk kanë nevojë, sepse unë i kam rekomanduar që ta lexojnë suren "El Uakia", sepse kam dëgjuar të Dërguarin e Zotit të thotë: "*Çdokush që e lexon suren 'El Uakia' për çdo natë, asnjëherë nuk do të bëhet i varfër.*".[1]

Edhe në një transmetim tjetër, surja "El Uakia" është quajtur si surja e pasurisë.

Këto begati nuk mund të përftohen vetëm me anë të lëvizjes së buzëve, kur lexon këtë sure, por, krahas leximit, duhet të mendojmë rreth përmbajtjes së saj dhe më pas ta praktikojmë atë.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 212.

Ajetet 1 - 14

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِذَا وَقَعَتِ الْوَاقِعَةُ١ لَيْسَ لِوَقْعَتِهَا كَاذِبَةٌ٢ خَافِضَةٌ رَافِعَةٌ٣ إِذَا رُجَّتِ الْأَرْضُ رَجًّا٤ وَبُسَّتِ الْجِبَالُ بَسًّا٥ فَكَانَتْ هَبَاءً مُنْبَثًّا٦ وَكُنْتُمْ أَزْوَاجًا ثَلَاثَةً٧ فَأَصْحَابُ الْمَيْمَنَةِ مَا أَصْحَابُ الْمَيْمَنَةِ٨ وَأَصْحَابُ الْمَشْأَمَةِ مَا أَصْحَابُ الْمَشْأَمَةِ٩ وَالسَّابِقُونَ السَّابِقُونَ١٠ أُولَئِكَ الْمُقَرَّبُونَ١١ فِي جَنَّاتِ النَّعِيمِ١٢ ثُلَّةٌ مِنَ الْأَوَّلِينَ١٣ وَقَلِيلٌ مِنَ الْآخِرِينَ١٤

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmin, Mëshirplotit!

"Kur të ndodhë Ngjarja (Kiameti)**",**

"ardhjen e saj askush nuk do ta mohojë."

"Disa do t'i ulë e disa do t'i lartësojë."

"Kur Toka të dridhet fuqishëm",

"malet të thërrmohen copë-copë"

"e të shndërrohen në pluhur të shpërndarë",

"ju, (o njerëz) **do të ndaheni në tri grupe":**

"njerëzit e së djathtës - sa të nderuar do të jenë fatlumët!"

"njerëzit e së majtës - sa të poshtëruar do të jenë fatkeqët!"

dhe ata që kanë prirë (në besim) **e që do të prijnë** (edhe në Xhennet)**.”**

“Ata janë të afërtit (tek All’llahu)**”,**

“në kopshtet e kënaqësisë.”

“Shumica e tyre janë prej të lashtëve”,

“ndërsa një pakicë prej brezave të mëvonshëm.”

Komentimi

Ngjarja, Kiameti

Në Kur’anin Fisnik tregohet se ngjarjet që lidhen me Kiametin, shoqërohen me përmendjen e ndodhive të mëdha goditëse në fillim të tij. Kjo vërehet në shumë sure të Kur’anit, të cilat flasin për Kiametin. Edhe në këtë sure, boshti i të cilës është çështja e Ringjalljes, ky fakt dallohet qartazi që në ajetet e para të saj.

Ajetet 1-2 thonë: **“Kur të ndodhë Ngjarja, Kiameti, ardhjen e saj askush nuk do ta mohojë.”**.

Ngjarjet e ndodhura që i paraprijnë ardhjes së Kiametit, janë aq të mëdha dhe të ashpra, sa shenjat e tyre vërehen në të gjitha grimcat e kësaj bote.

Fjala *"uakia"* përdoret për ndodhinë e Kiametit, sepse ajo ngjarje është e patjetërsueshme. Disa komentues, këtë e kanë konsideruar si një prej emrave të Kiametit.

Fjalën *"kadhibe"* e kanë përdorur me kuptimin që ndodhia e Kiametit do të jetë aq e qartë dhe e dukshme, sa nuk do të lërë vend për polemikë apo përgënjeshtrim. Disa komentues të tjerë, kanë thënë se për Ringjalljen nuk do të ekzistojë asnjë përgënjeshtrues.

Sidoqoftë, Ringjallja nuk do të shoqërohet vetëm me ndryshimin dhe transformimin e planeteve, por edhe njerëzit do të pësojnë ndryshime. Për këtë ajeti vijues thotë: **"Disa do t'i ulë e disa do t'i lartësojë."**.

Arrogantët kryeneçë dhe udhëheqësit tiranë e shtypës do t'i ulë, kurse besimtarët dhe të drejtët do t'i lartësojë në kulmin e majës së krenarisë. Të lartësuarit pa arsye, do të poshtërohen, kurse të privuarit, pa arsye, do të lartësohen. Një grup do të rrëshqasë në humnerën e Xhehennemit dhe grupi tjetër do të ngjitet në pikat më të larta të Xhennetit. Kjo është veçoria dhe karakteristika e një revolucioni të madh dhe të gjerë hyjnor.

Në një transmetim nga Imam Hysejni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Ringjallja është "hafidhe" - "ulje", sepse, betohem në Zot, që armiqtë do t'i ulë e do t'i hedhë në zjarr. Është "rafie" - "lartësim", sepse, betohem në Zot, se të dashurit e Tij do t'i lartësojë në Xhennet!"*.[1]

Më pas, Kur'ani bën një përshkrim më të detajuar, lidhur me këtë çështje: **"Kur Toka të dridhet fuqishëm"**.

[1] Libri "El Khisal", vëll. 1, f. 64; Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 204.

Kjo dridhje do të jetë aq e fuqishme dhe e fortë, saqë: **"malet të thërrmohen copë-copë e të shndërrohen në pluhur të shpërndarë…"**.

Fjala *"ruxhxhet"* rrjedh nga rrënja *"raxh"* dhe është përdorur me kuptimin e *"të lëvizurit të ashpër"*, kurse fjala *"raxhraxhe"* nënkupton *"ankthin, shqetësimin"*.

Fjala *"busset"* rrjedh nga rrënja *"bess"*. Përdoret me kuptimin e *"zbutjes së miellit me anë të ujit"*.

Fjala *"heba"* është përdorur me kuptimin e pluhurit dhe fjala *"munbeth"* nënkupton *"shpërndarjen"*. Disa komentues kanë thënë se fjala *"heba"* nënkupton pluhura shumë të vegjël, që janë të shpërndarë në hapësirë, në ajër dhe nuk vërehen në kushte të zakonshme, përveçse kur drita e diellit ndriçon nga një vrimë brenda një vendi të errët.

Dridhja dhe shpërthimi i Kiametit është aq e rëndë, saqë malet e larta i shkatërron e i bën pluhur.

Sidoqoftë, në ajetet kur'anore vërehen shprehje të ndryshme në lidhje me gjendjen e maleve në prag të Kiametit, të cilat tregojnë fazat e ndryshme të shpërthimit të madh të maleve.

Ndonjëherë, në ajete thuhet: **"...kodrat të shkulen nga vendi e të ecin..."**.[1]

Herë tjetër thuhet: **"Dhe kur kodrat të copëtohen..."**.[2]

---

[1] Sure "Et Tur", ajeti 10.
[2] Sure "El Murselat", ajeti 10.

Në tjetër ajet, thuhet: **"Dhe të ngrihen toka e kodrat e t'i mëshojnë njëra-tjetrës me një të goditur..."**.[1]

Ajeti tjetër thotë: **"Atë Ditë kur toka e kodrat të dridhen, e kodrat bëhen rërë rrëshqitëse..."**.[2]

Ndonjëherë thotë: **"...do të shndërrohen në pluhur të shpërndarë..."** (ajeti që po diskutojmë).

Thënia e fundit është: **"Dhe kodrat bëhen si lesh i shprishur..."**.[3]

Sigurisht, askush përveç Zotit nuk e di me përpikëri se si do të jetë rrjedha e këtyre ndodhive. Mbase mund të jetë e pamundur që të përshkruhen me fjalët tona. Këto janë vetëm paralajmërime kuptimplota dhe domethënëse, janë dëshmi e madhështisë së këtij shpërthimi të madh.

Pasi shpjegon realizimin e kësaj ngjarjeje dhe Ringjalljejen madhështore, diskuton për gjendjen e njerëzve në atë Ditë. Para se gjithash, ata i ndan në tri grupe. Ajeti thotë: **"ju,** (o njerëz) **do të ndaheni në tri grupe..."**.

Fjala *"zeuxhun"*, jo gjithnjë përdoret për të dy gjinitë. Kjo fjalë përdoret edhe për çështjet që janë në afërsi të njëra–tjetrës dhe, duke pasur parasysh faktin se disa shoqëri njerëzish, në Kiamet janë në afërsi të njëri–tjetrit, janë quajtur *"ezuaxh"*.

Për grupin e parë, thotë: **"Njerëzit e së djathtës**[4] **- sa të nderuar do të jenë fatlumët!"**.

---

[1] Sure "El Hakkatu", ajeti 14.
[2] Sure "El Muzemmil", ajeti 14.
[3] Sure "El Kariatu", ajeti 5.
[4] Këta janë njerëzit që do t'u jepet libri i veprave nga ana e djathtë.

Emërtimi **"njerëzit e së djathtës"** përfshin ata persona që Libri i veprave të tyre do t'u jepet në dorën e djathtë. Kjo çështje në Kiamet është tregues për besimtarët vepërmirë dhe të shpëtuarit. Kjo është përmendur disa herë në Kur'an.

Sipas një interpretim tjetër, fjala *"mejmene"* rrjedh nga rrënja *"jumn"* dhe nënkupton lumturinë, prandaj thuhet se grupi i parë, është grup i lumtur dhe fatlum.

Duke pasur parasysh faktin se në ajetin vijues, grupin e dytë e ka përmendur si **"njerëzit e të majtës"** dhe duke e ditur që fjala *"mesh'eme"* rrjedh nga rrënja *"sheum"*, pra, "*ogurzezë*", përshtatet më mirë me komentimin e fundit.[1]

Përdorimi i shprehjes *"ma as'habul mejmene"* - **"sa të nderuar do të jenë fatlumët"**, tregon për lumturinë e tyre, pa përcaktuar ndonjë cak. Ky është përshkrimi më i lartë i mundshëm për raste të tilla, i ngjashëm me rastin kur themi: "Ai njeri është fatlum! Çfarë njeriu me fat!".

Më pas ka përmendur grupin e dytë: **"njerëzit e së majtës**[2] **- sa të poshtëruar do të jenë fatkeqët!"**.

Ky është një grup fatkeq dhe i mjerë. Librin e veprave të tyre ua japin në dorën e majtë. Kjo është një shenjë e fatkeqësisë, e dënimit dhe e mëkatit të tyre.

Përdorimi i togfjalëshit **"njerëzit e të majtës"** tregon pragun përfundimtar të fatkeqësisë dhe të mjerimit të tyre.

---

[1] Edhe pse në ajetet vijuese në vend të *"es'habul meshamee"* është thënë *"es'habul shumal"*.

[2] Këta janë njerëzit që libri i veprave do t'u jepet nga ana e majtë, ose pas shpine.

Grupin e tretë e përshkruan në këtë mënyrë: **"...dhe ata që kanë prirë** (në besim) **e që do të prijnë** (edhe në Xhennet)**. Ata janë të afërtit** (tek All'llahu)**."**.

Ata persona që prijnë në besim, por edhe veprat e tyre janë të dobishme dhe humane, që janë shembull dhe model për njerëzit, janë imamë dhe prijës të krijesave, janë quajtur *"sabikun"* dhe janë të afërtit e All'llahut të Madhëruar.

Në qoftë se disa nga komentuesit e Kur'anit, prirjen e tyre në besim e kanë konsideruar dhe e kanë komentuar vetëm si bindje ndaj Zotit, faljen e pesë kohëve të namazit, luftën për çështje të fesë, mërgimin, pendimin dhe të ngjashme me këto si detyrime për besimtarin, këto do të mbeteshin vetëm një pjesë e të qenit besimtar i devotshëm. Besimtari i devotshëm i kryen të gjitha, duke i konsideruar si pjesë e pandashme e të qenit adhurues i All'llahut dhe merituesi të gjitha mirësive të Tij.

Në transmetimet islame, ndonjëherë **"ata që kanë prirë"** konsiderohen katër persona: Habili, besimtari i familjes së Faraonit, Habibi Nexhxhar. Secili nga këta, te popujt e tyre, ka paraprirë në besim. Edhe Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ka qenë i pari besimtar prej burrave. Këta janë shembujt të qartë dhe nuk e kufizon kuptimin e ajetit.[1]

Në një hadith tjetër, thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka deklaruar: *"Vallë, e jeni në dijeni se kush do të jenë paraprijësit drejt hijes së Mëshirës së Zotit në Ditën e Kiametit?!"*.

[1] Ky kuptim është transmetuar në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 215.

Shokët thanë: "Zoti dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri".

Ai tha: *"Ata janë personat që, kur u ofrohet e vërteta, e pranojnë atë. Në kohën që i pyesin në lidhje me të vërtetën, e shprehin atë dhe gjykojnë për popullin si për veten e tyre."*.[1]

Në një hadith tjetër, lexojmë se Ibn Abasi ka thënë: E kam pyetur Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në lidhje me këtë ajet dhe më është përgjigjur: *"Xhebraili më ka thënë kështu: 'Personat që do të prijnë në Xhennet dhe do të jenë të afërtit tek All'llahu, janë Imam Aliu dhe ndjekësit e tij, për shkak të respektit që ka Zoti i Madhëruar ndaj tyre.'"*.[2]

Këto shprehin konceptin e gjerë të lartpërmendur, si një koncept që përfshin të gjithë ata që kanë prirë në secilin komb dhe popull.

Më pas, me një fjali të shkurtër, shpalos pozitën e lartë të të afërmeve tek All'llahu duke thënë: **"**...**në kopshtet e kënaqësisë."**.

Shprehja *"xhennatin naim"* përfshin të gjitha llojet e begative materiale dhe shpirtërore të Xhennetit.

Kjo shprehje mendohet se sqaron se kopshtet e Xhennetit janë vatrat e merituara të begatisë për punëmirët, siç janë kopshtet e kësaj bote rrjedhojë e përpjekjeve dhe e mundimeve gjatë gjithë jetës. Edhe gjendja e të afërmeve tek All'llahu, në Botën Tjetër, ndryshon me gjendjen e tyre në këtë botë, sepse pozita e tyre e lartë në këtë botë është e shoqëruar me shumë

[1] Tefsiri "Meragij", vëll. 27, f. 134.
[2] Tefsiri "Nuruth Thakalejn", vëll. 5, f. 209.

përgjegjësi, ndërkohë që në Botën Tjetër është vetëm burim i begatisë.

Është e qartë se fjala *"kurb" - "afrim"*, përdoret për të treguar "afërsinë në pozitë", por jo "afërsinë vendore", sepse Zoti i Madhëruar nuk ka vend të caktuar ku rri. Ai është gjithnjë pranë nesh, madje më afër nesh se vetë ne me veten tonë.

Ajeti vijues tregon mënyrën e ndarjes së këtyre personave te popujt e kaluar dhe thotë: **"Shumica e tyre janë prej të lashtëve, ndërsa një pakicë prej brezave të mëvonshëm."**.

Fjala *"thul'le"*, siç është shprehur edhe Ragibi në veprën "El Mufredat", është përdorur me kuptimin e *"një grumbull prej leshi"*. Më pas është përdorur në kuptimin e një shoqërie dhe grup njerëzish.

Disa komentues të tjerë, atë e kanë marrë nga fjala *"thel'le arshuhu" - "froni i tij u shemb, u rrëzua dhe qeveria e tij u ndërpre"* dhe e konsiderojnë si përdorim me kuptimin *"e ndërpreu"*. Në bazë të dëshmisë dhe ballafaqimit me *"ue kalilun minel ahirin"* pranohet përdorimi me kuptimin: *"një pjesë madhore"*.

Këto dy ajete tregojnë se një grup i madh njerëzish prej të afërmve te All'llahu, janë prej të lashtëve dhe vetëm një pakicë e tyre janë nga populli i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Mund të shtrohet pyetja se, si është e mundur që kjo çështje të përputhet me rëndësinë e jashtëzakonshme të popullit të Islamit? Përgjigjja merret nga fakti se Zoti i Madhëruar, ata i ka

prezantuar si popullin më të mirë dhe për këtë ka deklaruar: **"Ju jeni populli më i dobishëm...."**.[1]

Përgjigjja e kësaj pyetjeje qartësohet edhe më tej, kur tregohet se të afërmit tek All'llahu janë po ata njerëz që kanë prirë në besim, megjithëse në umetin islam, prijësit në pranimin e Islamit, në fillim të përhapjes së tij, ishin një grup i vogël. I pari prej burrave ka qenë Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe e para prej grave ka qenë Hatixheja, kurse të Dërguarit e hershëm ishin shumë, sepse edhe popujt e tyre, ku ata shkonin për t'u prirë në besim, ishte i madh.

Së dyti, epërsia numerike nuk është argument për epërsinë në cilësi. Shprehur ndryshe, është e mundur që numri i prijësve të këtij populli të jetë më i vogël, por për nga pikëpamja e cilësisë së besimit, të jenë shumë më lart, ashtu siç edhe në mesin e vetë të Dërguarve ekzistonin dallime: **"Këta janë të Dërguarit, disa prej tyre i dalluam nga të tjerët, prej tyre pati që All'llahu u foli, disa i ngriti në shkallë më të lartë..."**.[2]

Duhet sqaruar edhe rasti, kur disa nga besimtarët mund të mos jenë në mesin e njerëzve që kanë prirë, por cilësitë që kanë, i lartësojnë, derisa zënë vend te njerëzit që kanë prirë në besim. Edhe shpërblimin do ta kenë në të njëjtën masë me më të mirët, prandaj në disa hadithe të transmetuara nga Imam Bakiri *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Ne jemi të parët që kemi prirë, ne jemi të mëvonshmit."*.[3]

---

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 110.
[2] Sure "El Bekare", ajeti 253.
[3] Tefsiri " Safij", në vazhdim të ajetit që diskutuam.

Në një hadith tjetër nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, thuhet se u tha ndjekësve të tij: *"Ju jeni prej atyre që kanë prirë në besim e që do të prijnë, ju jeni ata që do të prini në Xhennet. Pra, ju që ishit të parët që pritë në besim në këtë botë, do të jeni të parët që do të hyni në Xhennet."*[1]

Është e nevojshme të theksohet edhe fakti se fjalët *"auelin"* dhe *"akhirin"* disa i kanë komentuar si: *"të parët e popullit të Islamit"* dhe *"të fundit e popullit të Islamit"*. Në bazë të këtij komentimi, të gjithë të afërmit tek All'llahu, janë nga populli i Islamit.

Por, ky komentim nuk përputhet as me paraqitjen e ajeteve e as me transmetimet që janë cituar në lidhje me interpretimin e këtyre ajeteve, të cilët në mënyrë të posaçme, njerëzit e popujve të lashtë i kanë paraqitur si *"sabikune aeuelin"* – *"të parët prej atyre që kanë prirë"*.

Ajetet 15 – 26

عَلَى سُرُرٍ مَوْضُونَةٍ١٥ مُتَّكِئِينَ عَلَيْهَا مُتَقَابِلِينَ١٦ يَطُوفُ عَلَيْهِمْ وِلْدَانٌ
مُخَلَّدُونَ١٧ بِأَكْوَابٍ وَأَبَارِيقَ وَكَأْسٍ مِنْ مَعِينٍ١٨ لَا يُصَدَّعُونَ عَنْهَا

[1] Tefsiri " Safij", në vazhdim të ajetit që diskutuam.

وَلَا يُنْزِفُونَ١٩ وَفَاكِهَةٍ مِمَّا يَتَخَيَّرُونَ٢٠ وَلَحْمِ طَيْرٍ مِمَّا يَشْتَهُونَ٢١ وَحُورٌ عِينٌ٢٢ كَأَمْثَالِ اللُّؤْلُؤِ الْمَكْنُونِ٢٣ جَزَاءً بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ٢٤ لَا يَسْمَعُونَ فِيهَا لَغْوًا وَلَا تَأْثِيمًا٢٥ إِلَّا قِيلًا سَلَامًا سَلَامًا٢٦

“Ata do të qëndrojnë në divane të stolisura me ar e gurë të çmuar”,

“të mbështetur në to përballë njëri-tjetrit.”

“Do t’u sillen rreth (për shërbim) **djelmosha përherë të rinj”,**

“me kupa, ibrikë dhe gota me pije të kulluar, që rrjedh”

“e prej së cilës nuk do t’u dhembë koka dhe nuk do t’u humbë mendja”,

“e me fruta të cilat do t’i zgjedhin vetë”

“dhe mish shpendësh që ua ka ënda.”

“Për ata ka edhe hyrie symëdha”,

“të ngjashme me margaritarët e ruajtur”,

“si shpërblim për atë që kanë punuar.”

“Aty nuk do të dëgjojnë biseda të kota, as fjalë gjynahesh”,

“por vetëm fjalët ‘Paqe, Paqe’!”

Komentimi

Begatitë e Xhennetit janë në pritje të të afërmve

Në këto ajete tregohet për llojet e ndryshme të begative të Xhennetit, që i përkasin grupit të tretë, pra, të afërmve tek All'llahu. Secila nga këto begati është më e këndshme dhe më e kënaqshme se sa tjetra. Këto begati mund t'i ndajmë në shtatë kategori:

Në fillim të ajetit thuhet: **"Ata do të qëndrojnë në divane të stolisura me ar e gurë të çmuar…"**, ndërkohë që do të jenë **"të mbështetur në to përballë njëri-tjetrit"**.

Fjala *"surur"* është shumësi i fjalës *"serir"* dhe rrjedh nga rrënja *"surur"*. Kjo fjalë është përdorur me kuptimin e "divaneve të stolisura ku në to ulen poseduesit e bekimeve dhe mirësive".[1]

Fjala *"meudh'un"* rrjedh nga rrënja *"uedh'n"*. Kjo fjalë është përdorur me kuptimin: *"thurje e parzmores"*. Më pas është përdorur për çdo gjë të endur në vegjë, me fije të forta, si p.sh. divanet që ndodhen afër njëri–tjetrit. Disa komentues kanë supozuar se mund të jetë përdorur për të treguar divanet që kanë një thurje të posaçme prej ari dhe gurësh të çmuar, apo të ngjashme me to.

[1] Ragib Isfahaniu, "El Mufredat", lënda "Serr'rre".

Struktura e këtyre divaneve, mënyra e vendosjes së tyre, si dhe tubimi gazmor dhe intim, bashkë me gëzimin e lumturinë që ato japin, nuk mund të përshkruhen me asnjë fjalë.

Në Kur'anin Fisnik, shumë herë janë bërë përshkrime interesante, në lidhje me fronet dhe divanet e banorëve të Xhennetit. Kjo tregon se një prej kënaqësive më të mira të tyre janë po këto tubime private, familjariteti dhe miqësia e ngushtë mes tyre.

Por, cila është tema e diskutimit të tyre? Askush nuk është në dijeni të plotë për atë. Vallë, mos do të diskutojnë për misteret dhe mrekullitë e krijimit të Zotit? Apo do të flasin për parimet e njohjes, për Emrat dhe cilësitë më të bukura të All'llahut? Apo do të diskutojnë për ngjarjet që kanë ndodhur në këtë botë? Ndoshta do të flasin rreth torturave dërmuese, prej të cilave kanë shpëtuar. Apo në lidhje me çështje të tjera, për të cilat ne në kushtet e jetës së kësaj bote nuk jemi në gjendje t'i perceptojmë? Askush nuk e di!

Pas kësaj, ka përmendur begatinë e dytë të tyre. Ajeti thotë: **"Do t'u sillen rreth** (për shërbim) **djelmosha përherë të rinj…"**.

Fjala *"jetufu"* rrjedh nga rrënja *"tauaf"*, që tregon shërbimin e tyre të përhershëm. Fjala *"mukhal'ledun"* emërton të gjithë banorët e përhershëm të Xhennetit. Ajo tregon se banorët e Xhennetit do të rrinë aty përgjithmonë dhe do të jenë të rinj, të lumtur, dinamikë, etj.

Po cilët janë këta të rinj? Për këtë janë bërë interpretime të ndryshme.

Disa janë të mendimit se ata janë fëmijët e njerëzve të kësaj bote, të cilët kanë vdekur para moshës së pubertetit dhe, meqenëse nuk kanë kryer ndonjë vepër të mirë ose të keqe, me mirësinë e Zotit, kanë një fat të tillë. Kur ata trajtohen kështu, ndiejnë kënaqësinë më të madhe, sepse janë në shërbim të të afërmve tek All'llahu. Kjo domethënie është transmetuar në një hadith nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Në një komentim tjetër lexojmë: "Këta janë fëmijët e politeistëve, të cilët, duke mos qenë përlyer me mëkate, i kanë vënë në një pozitë të tillë. Fëmijët e besimtarëve u bashkohen baballarëve dhe nënave të tyre.".

Në një komentim të tretë, lexojmë: "Ata janë shërbëtorë të Xhennetit. Zoti i Madhëruar i ka krijuar ata enkas për këtë qëllim.".

Këta të rinj të bukur: **"...me kupa, ibrikë dhe gota me pije të kulluar, që rrjedh"**[1] nga lumenjtë e rrjedhshëm të Xhennetit, sillen rreth tyre dhe u shërbejnë pa pushim.

Por pija që përdorin aty, nuk është një pije që të humb vetëdijen dhe mendjen, që të deh. Këtë pije e konsumojnë banorët e Xhennetit: **"e prej së cilës nuk do t'u dhembë koka dhe nuk do t'u humbë mendja…"**.[2]

---

[1] Fjala *"ekuab"* është shumësi i fjalës *"kuub"* dhe nënkupton *"një enë pa dorezë"*, fjala *"barik"* është shumësi i fjalës *"ibrik"* dhe rrjedh nga rrënja e fjalës perse *"abriz"*. Është në kuptimin e enëve që kanë dorezë dhe gyp për derdhjen e lëngjeve. Fjala *"kas"* tregon gotat e mbushura; fjala *"mein"* rrjedh nga rrënja *"meen"* dhe është në kuptimin e rrjedhjes.

[2] Fjala *"jesdeun"* rrjedh nga fjala *"sida"* dhe ka kuptimin: *"dhimbje e kokës"*. Kjo fjalë rrjedh nga fjala *"sed"* dhe është në kuptimin: *"ndarje"*. Duke u nisur nga fakti që njeriu, kur ka shumë dhimbje koke, thuajse nga dhimbja e madhe që

Ata i kaplon vetëm një gjendje e papërshkrueshme shpirtërore, që gjithë qenien e tyre e zhyt në një kënaqësi të pashembullt.

Më pas kalon te pjesa e katërt dhe e pestë e begative materiale të të afërmve tek All'llahu në Xhennet dhe thotë: Të rinjve të Xhennetit do t'u dhurohet çdo lloj futi që ata dëshirojnë: **"...e me fruta të cilat do t'i zgjedhin vetë**[1] **dhe mish shpendësh që ua ka ënda."**.

Frutat preferohen më shumë se mishi, për shkak se të ushqyerit me fruta është më e dobishme. Përveç kësaj, konsumimi i frutave para ushqimit ka një shije tjetër.

Nga disa ajete të tjera të Kur'anit, përftohet se degët e pemëve të Xhennetit janë plotësisht të arritshme prej banorëve të atyshëm. Kështu që çdokush mund të vjelë nga pema çdo lloj fryti dhe ta hajë atë. Kjo është e vërtetë dhe vlen edhe për ushqimet e tjera të Xhennetit. Por kur ua servirin pa pushim shërbëtorët, përftohet një kënaqësi dhe lezet i veçantë. Shprehur ndryshe, ky është një lloj respekti dhe nderimi shtesë ndaj banorëve të Xhennetit, si dhe krijon një atmosferë më të volitshme për kuvendimet e tyre private. Madje edhe në takimet dhe tubimet e zakonshme të kësaj bote ndodh e njëjta gjë. Pjatat me ushqime dhe fruta janë për mysafirët. Por ndonjëherë, mikpritësi,

---

ndien, dëshiron ta çajë kokën e vet në dysh, andaj edhe kjo fjalë është përdorur në këtë kuptim; fjala *"junzifun"* rrjedh nga rrënja *"nezf"* dhe është në kuptimin: tërheqje e gjithë ujit të gropës, në mënyrë graduale, si dhe është përdorur edhe në lidhje me dehjen dhe humbjen e mendjes.

[1] Fjala *"fakihe"* dhe fjala *"lehm"*, që të dyja, janë të përqendruara mbi fjalën *"ekuab"*. Në këtë mënyrë, është prej gjërave që, me anë të *"djelmoshave përherë të rinj"*, ua japin *"të afërmve (tek All'llahu)"*.

personalisht, i ofron fruta dhe ushqim mysafirit. Ky gjest konsiderohet një respekt dhe dashuri e shtuar për mysafirët.

Nga llojet e mishrave preferohet më shumë mishi i zogjve.

Për frutat që i zgjedh vetë, është përdorur shprehja *"jetekhajjerun" - "do t'i zgjedh vetë"*, kurse për mishin, është përdorur shprehja *"jeshtehun" - "mishin që ta ka ënda"*. Disa komentues të Kur'anit kanë dashur të bëjnë dallime mes këtyre dy fjalëve. Në pamje të parë, duket sikur dy termat kanë të njëjtën domethënie, por, kur artikulohen në dy shprehje të ndryshme, kanë kuptime të ndryshme. Në këtë kontekst, për fjalinë në vijim, pranohet ky kuptim: Banorëve të Xhennetit do t'u vihet në dispozicion, nga ana e shërbëtorëve, çdo lloj ushqimi që ata pëlqejnë.

Më pas ka përmendur begatinë e gjashtë. Kjo begati tregon për bashkëshortet e dëlira dhe të bukura*:* **"Për ata ka edhe hyri symëdha,**[1] **të ngjashme me margaritarët e ruajtur…"**.

Fjala *"hur"*, siç e kemi diskutuar dhe më parë, është shumësi i fjalës *"haura"* dhe *"ahuer"*. Me këtë fjalë quajnë atë person që ka sy plotësisht të zinj dhe bardhësia e tyre është e qartë.

Termi *"ajn"*, vjen nga shumësi i fjalës *"ajna"* dhe *"a'jan"*. Është përdorur me kuptimin e *"syrit të madh"*, meqenëse bukuria më e spikatur e njeriut qëndron te sytë e tij dhe sytë e mëdhenj

[1] Edhe pse disa kanë supozuar se fjala *"heur ejn"* i referohet fjalës *"uildane mukhal'ledun"* andaj edhe ato, gjithashtu, sillen rreth banorëve të Xhennetit. Por, duke pasur parasysh mospërputhjen e këtij kuptimi, sidomos me takimet e banorëve të Xhennetit në grupe, duket se kryefjala është hequr. Në origjinal, mund të ketë qenë *"uelehum hurin iin"* - **"për ata ka hyri symëdha"**.

janë më të preferuar. Disa komentues të Kur'anit kanë supozuar se fjala *"hur"* vjen nga fjala *"hajretun"*. Kjo fjalë përdoret me kuptimin se këta sy janë aq të mahnitshëm, saqë shkaktojnë habi te të tjerët.

Fjala *"meknun"* ka kuptimin *"të mbuluar"*, por këtu është përdorur me kuptimin e të fshehurit brenda. Në këtë kontekst, aludohet për margaritarët, kur janë në sedef dhe nuk i ka prekur me dorë njeriu. Atëherë ata janë më të shndritshëm dhe më të bukur. Ka mundësi edhe përdorimi tjetër, me kuptimin se ato janë plotësisht të mbrojtura (të mbuluara) nga sytë e të tjerëve, pra, ato as që i ka prekur dora e njeriu dhe as i ka parë syri i njeriu.

Pasi përmend këto gjashtë begati fizike dhe ndijore, shton: **"...si shpërblim për atë që kanë punuar."**.

Nuk mund të imagjinohet se këto begati të pafundme të Xhennetit, t'i jepen ndonjërit pa llogari, apo pa qenë i mjaftueshëm besimi dhe veprat e mira që ka kryer.

Begatia e shtatë dhe e fundit, e aspektit shpirtëror është thënë kështu: **"Aty nuk do të dëgjojnë biseda të kota, as fjalë gjynahesh..."**.

Atje nuk ka fjalë të kota, gënjeshtra dhe shpifje, as përqeshje dhe përgojim, as fjalë thumbuese, as shprehje ironike e as fjalë të kota, boshe dhe të pa baza. Atje çdo gjë është mirësi, çiltërsi, bukuri, përkorje, mirësjellje dhe dëlirësi. Sa i vyer është ky mjedis, ku nuk mund të gjesh "plagët e gjuhëve"!

Në fund, ajeti thotë se e vetmja fjalë që dëgjohet atje, është: **"Paqe, Paqe!"**.

Vallë, ky Selam, pra, përshëndetja, a është nga ana e Zotit, apo nga ana e engjëjve? Apo nga vetë banorët e Xhennetit me njëri–tjetrin? Apo të gjitha këto së bashku?

Më i përshtatshëm se të gjithë, është komentimi i fundit. Siç e kemi trajtuar edhe në ajete të tjera, atje është përmendur selami i Zotit, i engjëjve dhe i banorëve të Xhennetit me njëri-tjetrin.[1]

Përveç selamit nuk dëgjojnë gjë tjetër. Selami, përshëndetja e Zotit dhe engjëjve të afërt të Tij, selami dhe përshëndetja e tyre me njëri-tjetrin janë të mbushura plot me dashuri dhe miqësi.

Mjedisi i tyre është plot paqe dhe shëndet. Kjo është gjendja që sundon në tërë qenien e tyre. Çdo gjë që ata thonë, sillet mbi këtë bosht dhe rrjedha e të gjitha bisedave të tyre përfundon në selam, paqe dhe çiltërsi. Parimisht, Xhenneti është *"darus selam"* - *"shtëpia e paqes, e sigurisë dhe e qetësisë"*.

Kjo është shprehur edhe në ajetin 127 të sures "El En'am": **"Ata e kanë vendin e shpëtimit dhe të paqes në Xhennet, te Zoti i tyre!"**.[2]

Ajetet 27 – 40

وَأَصْحَابُ الْيَمِينِ مَا أَصْحَابُ الْيَمِينِ٢٧ فِي سِدْرٍ مَخْضُودٍ٢٨ وَطَلْحٍ مَنْضُودٍ٢٩ وَظِلٍّ مَمْدُودٍ٣٠ وَمَاءٍ مَسْكُوبٍ٣١ وَفَاكِهَةٍ كَثِيرَةٍ٣٢ لَا

[1] Sure "Ja Sin" ajeti 58; sure "E Rrad", ajeti 24; sure "Junus", ajeti 10.

[2] Kini kujdes që përjashtimi në ajetin "il'la kil'len selamen selama" është ndërprerë dhe është i dobishëm për theksim.

مَقْطُوعَةٍ وَلَا مَمْنُوعَةٍ٣٣ وَفُرُشٍ مَرْفُوعَةٍ٣٤ إِنَّا أَنْشَأْنَاهُنَّ إِنْشَاءً٣٥ فَجَعَلْنَاهُنَّ أَبْكَارًا٣٦ عُرُبًا أَتْرَابًا٣٧ لِأَصْحَابِ الْيَمِينِ٣٨ ثُلَّةٌ مِنَ الْأَوَّلِينَ٣٩ وَثُلَّةٌ مِنَ الْآخِرِينَ٤٠

“E njerëzit e së djathtës – sa të nderuar që janë fatlumët!”

“Ata do të qëndrojnë në mes të lotusve pa gjemba”

“dhe bananeve të mbushura me fruta”,

“nën hije të gjera”,

“pranë një uji rrjedhës”,

“dhe mes frutave të llojllojshme”,

“të cilat kurrë nuk sosen, as nuk janë të ndaluara”;

“dhe në shtroje të ngritura (ku i presin hyrijet)**”,**

“të cilat Ne i kemi krijuar në një formë të veçantë (jo të lindura)**”,**

“dhe i kemi bërë ato virgjëresha”,

“të dashura për bashkëshortët e tyre dhe moshatare me ta”,

“për njerëzit e së djathtës.”

“Janë shumë nga të lashtët”

"e shumë edhe nga të mëvonshmit."

Komentimi

Begatitë dhe mirësitë e "As'habul Jemin"

Pasi u përmendën begatitë materiale dhe shpirtërore të të afërmve tek All'llahu, vjen radha e "as'habul jemin-it", që është shoqëria fatlume, të cilës, në shenjë fitoreje në sprovimet e Zotit, Libri i veprave të tyre, do t'u jepet në dorën e djathtë. Kur'ani përmend gjashtë begati prej begative të Zotit të Madhërishëm, të cilat, duke i krahasuar me shtatë begatitë e të afërmve tek All'llahu, vërehet se janë një më pak. Kjo tregon se janë një nivel më poshtë.

Për të shprehur pozitën e tyre të lartë, ajeti thotë: **"E njerëzit e së djathtës – sa të nderuar që janë fatlumët!"**.

Ky është përshkrimi më i lartë që u është bërë atyre, sepse kjo shprehje përdoret, kur cilësitë e ndonjërit janë të papërshkrueshme. Kjo tregon edhe një herë pozitën e lartë të njerëzve të së djathtës.

Ajeti vijues, përmend begatinë e parë të këtij grupi: **"Ata do të qëndrojnë në mes të lotusve pa gjemba…"**.

Ky është përshkrimi më i qartë i mundshëm që mund të bëhet me fjalët tona për pemët e Xhennetit, sepse, sipas disa

dijetarëve të leksikologjisë, fjala *"sidr"* emërton një pemë të madhe, gjatësia e të cilës ndonjëherë arrin në dyzet metra. Gjithashtu, kanë pohuar se ka një jetëgjatësi deri në dymijë vite. Kjo pemë bën një hije të rëndë, të ndjeshme dhe të butë. E vetmja mangësi e kësaj peme është se ka gjemba, por meqenëse është përshkruar si *"makhdhud"*, që ka kuptimin e prerjes së gjembave, edhe ky problem është zgjidhur për pemët e Xhennetit.

Në një hadith tregohet se, kur disa nga fjalët e Kur'anit ishin problematike për shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ata pohonin se Zoti i Madhëruar i kishte bekuar me beduinët arabë. Pyetjeve të tyre, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u jep shpjegime me qetësi. Për shembull, një ditë, një beduin arab, erdhi te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha: "O i Dërguari i Zotit! Zoti i Madhëruar në Kur'an ka përmendur një pemë të bezdisshme. Unë nuk besoja që në Xhennet ekziston një pemë e tillë!"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: *"Cila pemë?"*

Beduini i tha: "Pema sidr, sepse ajo ka gjemba."

I Dërguari tha: *"Vallë, a nuk thotë Zoti 'fi sidrin makhfudh'? Kjo fjalë ka kuptimin që kësaj peme që thua ti, ia ka këputur gjembat dhe në vend të çdo gjembi, ka vënë një fryt dhe në secilin fryt ka vënë*

shtatëdhjetë e dy lloje ngjyrash të lëndëve ushqimore, të cilat nuk ngjajnë me njëra-tjetrën!".[1]

Begatia e dytë është kjo: **"dhe bananeve të mbushura me fruta…"**.

Fjala *"et talhu"* tregon një pemë të gjelbër, me ngjyrë të bukur dhe me aromë. Disa komentues kanë thënë se pema e bananes ka gjethe shumë të gjera dhe të bukura, me ngjyrë jeshile, si dhe ka një fryt të ëmbël e të shijshëm.

Fjala *"mendhud"* rrjedh nga rrënja *"nadh'd"* dhe përdoret me kuptimin: *"grumbull"*.

Është e mundur që kjo shprehje të jetë përdorur për të treguar dendësinë e gjetheve, grumbullimin e frutave apo të dy kuptimet. Komentues të tjerë thonë se këto pemë janë të stërmbushura me fruta, aq sa trungu dhe degët e tyre janë të zhytura dhe të mbuluara nga ato.

Komentuesit e Kur'anit, kanë pohuar se, duke pasur parasysh faktin që pema e sidrit ka gjethe shumë të vogla, kurse pema e bananes ka gjethe shumë të mëdha dhe të gjera, përmendja e këtyre dy pemëve është një tregues për të gjitha pemët e Xhennetit që ndodhen në kategoritë mes këtyre dy pemëve.[2]

Begatinë e tretë të Xhennetit e përshkruan kështu: **"…nën hije të gjera…"**.

---

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 27, f. 120; Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 156.

[2] Fakhru Razij, në tefsirin "El Kebijr", ajeti në fjalë, vëll. 29, f. 162.

Këtë hije të gjerë e kanë komentuar si një gjendje e ngjashme me *"bejnul tuluejn"*, në mes dy lindjeve, kur hija kaplon çdo gjë. Kjo domethënie është transmetuar nga i Dërguari i Zotit në veprën "Rauzei Kafi".[1]

Synimi është të tregojë, se banorët e Xhennetit asnjëherë nuk i shqetëson nxehtësia e diellit, sepse ata gjithnjë janë nën hije të këndshme, të shtrirë dhe që të ekzaltojnë shpirtin.

Begatja e katërt tregon për ujërat e Xhennetit: **"... pranë një uji rrjedhës..."**.

Fjala *"meskub"* rrjedh nga rrënja *"sekb"* dhe është përdorur me kuptimin e derdhjes. Dihet se derdhja e ujit nga lart poshtë, në formë ujëvare, krijon panorama të bukura. Gurgullimat e ujëvarave e qetësojnë shpirtin e njeriut dhe i japin shikimit kënaqësi e syve shkëlqim, prandaj kjo është përcaktuar si një prej begative të banorëve të Xhennetit.

Të gjitha ato pemë dhe ato ujëra që rrjedhin përgjithmonë, shoqërohen edhe me lloj-lloj frutash, prandaj në begatinë e pestë, ajeti shton: **" ...dhe mes frutave të llojllojshme, të cilat kurrë nuk sosen, as nuk janë të ndaluara."**.

Po, frutat e Xhennetit nuk ngjasojnë me frutat e kësaj bote, të cilat janë të kufizuara në sezone të caktuara. Frutat e kësaj bote, ndonjëherë janë me gjemba, të cilët pengojnë vjeljen e tyre. Pengesë për vjeljen e tyre shpeshherë është edhe gjatësia e rrezikshme e pemëve, siç është, p.sh. palma. Ndonjëherë mund të

[1] "Reudatul Kafij" dhe tefsiri "Nuruth Thakalejn", vëll. 5, f. 216.

jetë pengesë vetë njeriu, i cili mund të jetë koprrac, kurse në Xhennet mikpritësi është vetë Zoti i Madhëruar, me bujarinë e Tij.

Më pas flet për begatinë tjetër: **"...dhe në shtroje të ngritura** (ku i presin hyrijet)**"**.

Fjala *"furush"* është shumësi i fjalës *"ferash"*, e cila nënkupton çdo lloj qilimi apo shtroje. Ky mund të jetë edhe shpjegimi se, nganjëherë, kjo fjalë është përdorur edhe si tregues për bashkëshortët apo bashkëshortet.

Në një hadith të njohur nga i Dërguari i Zotit, thuhet: *"Fëmija që lind nga gruaja e martuar, i përket po asaj familjeje, (shtroje). Në qoftë se në këtë mes ekziston një burrë amoral dhe kurorëshkelës, përfitimi i saj nuk është gjë tjetër përveçse guri."*.[1]

Disa komentues të tjerë, fjalën *"furush"* e kanë komentuar në kuptimin e saj të vërtetë (jo në kuptimin figurativ), me të cilin tregon qilimat shumë të çmueshëm dhe plot me vlerë në Xhennet. Por në këtë rast, ndërlidhja me ajetet pasrendëse, të cilat flasin për hyritë dhe bashkëshortet e Xhennetit, ndërpritet.

Më pas, përmend cilësi të tjera të bashkëshorteve të Xhennetit. Ajeti thotë: **"të cilat Ne i kemi krijuar në një formë të veçantë** (jo të lindura)**..."**.

Kjo fjali mund të bëj fjalë për bashkëshortet e besimtarëve në këtë botë, të cilave Zoti i Madhëruar, në Kiamet, u jep një krijim të ri, nëse e përkthejmë ajetin në këtë mënyrë: Ne u kemi dhënë një krijim të ri. Që të gjitha do të hyjnë në Xhennet, duke qenë në kulmin e rinisë, të freskisë dhe të bukurisë së brendshme

[1] "Usulul Kafij", vëll. 5, Hadithi 3, f. 491.

dhe të jashtme. Do të jenë më të përsosura, sepse natyra e Xhennetit është natyra e përsosjes dhe e largimit nga çdo lloj mangësie dhe të mete.

Nëse me këtë frazë synohen hyritë, Zoti i Madhëruar u jep atyre një krijim të ri, në mënyrë të atillë që tek ato asnjëherë të mos duken shenjat e plakjes dhe të dobësimit.

Ka mundësi që përdorimi i shprehjes *"inshaa"*, të tregoj për të dyja rastet.

Më pas, ajeti shton: **"dhe i kemi bërë ato virgjëresha…"**.

Ky cilësim, mbase është i përhershëm për ato, pra, gjithnjë janë të virgjëra. Nga disa komentues të Kur'anit, si dhe nga disa transmetime, është deklaruar se gjendja e tyre nuk ndryshon me anë të kryerjes së marrëdhënieve seksuale.[1]

Në vijim të përshkrimit të tyre, thotë: **"...të dashura për bashkëshortët e tyre…"**.

Fjala *"urub"* është shumësi i fjalës *"a'rube"* dhe nënkupton gruan që ia shfaq dashurinë e saj bashkëshortit, si dhe gradën e pastërtisë dhe të dëlirësisë së saj.

Fjala *"i'rab"* është përdorur edhe në kuptimin e elokuencës dhe të të folurit ëmbël. Ka gjasa që të dy kuptimet, të afrohen në ajet.

Ato përshkruhen si moshatare me bashkëshortët e tyre, të bukura dhe të hijshme, si në paraqitje, ashtu edhe në brendësi. Secila është më e mirë se tjetra: **"…dhe moshatare me ta…"**.

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 27, f. 123.

Fjala *"etrab"* është shumësi i fjalës *"tirb"* dhe është përdorur me kuptimin: ngjashmëri dhe përafërsi. Disa kanë supozuar se ky kuptim rrjedh nga fjala *"teraib"*, që përdoret me kuptimin e kockave të kraharorit, sepse ngjasojnë me njëra–tjetrën.

Kjo ngjashmëri mund të ketë lidhje me moshën, në raport me bashkëshortët e tyre, sepse njerëzit e një moshe e kuptojnë më lehtë njëri–tjetrin. Edhe kur çiftet e martuara kanë diferencë në moshë, ata janë të ngjashëm me njëri-tjetrin në shpirt, në të mira, në bukuri dhe në hijeshinë e brendshme dhe të jashtme, prandaj edhe është thënë: "Ata që të gjithë janë të mirë dhe secili është më i mirë se tjetri.".

Ajeti shton: **"për njerëzit e së djathtës"**.

Ky është një theksim i dyfishtë për begatitë gjashtëllojeshe ndaj tyre.

Disa komentues kanë dhënë edhe mundësinë se kjo fjali është përdorur si plotësuese për fjalinë: **"Ne i kemi krijuar në një formë të veçantë** (jo të lindura)**..."**.[1]

Në fund të këtyre shkrimeve, ajeti thotë: **"Janë shumë nga të lashtët, e shumë edhe nga të mëvonshmit."**.

Fjala *"thul'letun"* është përdorur me kuptimin: një pjesë e grumbulluar prej leshi. Më pas është përdorur për çdo grumbullim të dendur, të përqendruar dhe të ngjeshur. Në këtë

[1] Në rastin e parë, shprehja *"as'habul jemin"* është objekt për kryefjalën e hequr. Në thelb, ka qenë e tillë: *"hadha kul'liha li as'habul jemin"*. Në rastin e dytë, është në rasën gjinore dhe e plotëson shprehjen *"inshenahunne"*. Rasti i parë është më i përshtatshëm.

mënyrë, tregohet se një grup i madh prej *"as'habëve jemin"* - **"nga të djathtët"**, janë nga popujt e kaluar dhe një grup i madh nga popullsia islame, sepse në mesin e këtij populli ka shumë të drejtë dhe besimtarë, edhe pse ata që kanë prirë në besim, janë më pak në numër, në raport me popujt e kaluar, duke pasur parasysh numrin e madh të popujve pararendës dhe të Profetëve të tyre.

Disa kanë supozuar se këto dy grupe janë nga populli i Islamit, grupi prej të parëve të tyre dhe grupi prej të mëvonshmëve të tyre. Komentimi i parë duket më i saktë.

Ajetet 41 - 50

وَأَصْحَابُ الشِّمَالِ مَا أَصْحَابُ الشِّمَالِ﴿٤١﴾ فِي سَمُومٍ وَحَمِيمٍ﴿٤٢﴾ وَظِلٍّ مِنْ يَحْمُومٍ﴿٤٣﴾ لَا بَارِدٍ وَلَا كَرِيمٍ﴿٤٤﴾ إِنَّهُمْ كَانُوا قَبْلَ ذَلِكَ مُتْرَفِينَ﴿٤٥﴾ وَكَانُوا

يُصِرُّونَ عَلَى الْحِنْثِ الْعَظِيمِ٤٦ وَكَانُوا يَقُولُونَ أَئِذَا مِتْنَا وَكُنَّا تُرَابًا وَعِظَامًا أَإِنَّا لَمَبْعُوثُونَ٤٧ أَوَآبَاؤُنَا الْأَوَّلُونَ٤٨ قُلْ إِنَّ الْأَوَّلِينَ وَالْآخِرِينَ٤٩ لَمَجْمُوعُونَ إِلَى مِيقَاتِ يَوْمٍ مَعْلُومٍ٥٠

"Po njerëzit e të majtës – sa të poshtëruar janë fatkeqët!"

"Ata do të jenë në afshin përcëllues të zjarrit dhe ujit të valuar"

"dhe nën hijen e një tymi të zi",

"e cila nuk do të jetë as e freskët e as e këndshme."

"Ata, para kësaj, jetonin në luks"

"dhe në vazhdimësi bënin gjynahe të rënda",

"duke thënë: 'Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi pluhur e eshtra, vërtet do të ringjallemi?!'"

"Vallë, edhe të parët tanë të lashtë?!"

"Thuaju (o Muhammed)**: 'Me siguri, edhe të parët, edhe të mbramët'",**

"do të tubohen në një ditë të caktuar."

Komentimi

Ndëshkimet e rënda për "njerëzit e të majtës"

Pasi treguam për begatitë madhështore të grupit të të afërmve tek All'llahu dhe grupit "të së djathtës", do të vijojmë me grupin e tretë, me ndëshkimet e tyre të ashpra dhe të frikshme, në mënyrë që me anë të një krahasimi të mirëfilltë, të hidhet dritë mbi gjendjen e të tri grupeve.

Ajeti 41 thotë: **"Po njerëzit e së majtës – sa të poshtëruar janë fatkeqët!"**.

Këta janë ata njerëz që Libri i veprave të tyre, do t'u jepet në dorën e majtë. Kjo është një shenjë që tregon se ata janë mëkatarë, të përlyer, shtypës dhe banorë të Xhehennemit. Ashtu siç u shprehëm edhe në përshkrimin e njerëzve të së djathtës dhe të të afërmve tek All'llahu, kjo shprehje, pra, përsëritja e fjalisë: "po njerëzit e të majtës, ah çfarë janë njerëzit e të majtës", siç është në origjinal), është për të treguar kulmin e lumturisë apo të fatkeqësisë së ndonjërit, si për shembull, kur themi: "Na ka ndodhur një e mirë. Çfarë e mire! Na ka ndodhur një fatkeqësi. Çfarë fatkeqësie!".

Më pas ajeti flet për tri prej ndëshkimeve të tyre: **"Ata do të jenë në afshin përcëllues të zjarrit dhe ujit të valuar dhe nën hijen e një tymi të zi…"**.

Nga njëra anë, është era e nxehtë vdekjeprurëse dhe, nga ana tjetër, uji i valuar vdekjeprurës dhe, së treti, hija e tymit të nxehtë dhe mbytës që i godet aq rëndë, saqë i bën t'u ikë çdo lloj durimi dhe fuqie.

Edhe nëse ata nuk i prek ndonjë fatkeqësi apo torturë tjetër, këto tri fatkeqësi apo tortura janë të mjaftueshme për ndëshkimin e tyre.

Fjala *"semum"* rrjedh nga rrënja *"semm"* dhe është përdorur me kuptimin e një ere përvëluese, e cila depërton në *"mesam"* - *"vrimat e vogla në trup"* dhe e shkatërron tërësisht atë. Helmi është quajtur *"semm"*, sepse depërton në të gjitha grimcat e trupit të njeriut.

Fjala *"hamim"* është përdorur me kuptimin: *"një gjë e nxehtë"*. Këtu është përdorur me kuptimin e ujit të valuar, i cili është përmendur edhe në ajete të tjera të Kur'anit, si për shembull në ajetin 19 të sures "Haxhxh": **"U hidhet uji i valë mbi kokat e tyre..."**.

Fjala *"jehmum"*, gjithashtu, rrjedh nga e njëjta rrënjë. Këtu është përdorur me kuptimin: tym i zi dhe i nxehtë.

Më pas, për ta nënvizuar edhe më shumë ashpërsinë e gjendjes, shton: **"...e cila nuk do të jetë as e freskët e as e këndshme."**.

Hijet, ndonjëherë, e mbrojnë njeriun nga dielli, erërat, shirat, etj. Por këto *"hije"* nuk sjellin asnjë nga këto dobi.

Fjala *"kerim"* rrjedh nga fjala *"keramet"* dhe është përdorur me kuptimin: atë që sjell dobi. Tek arabët, është traditë se, kur duan të prezantojnë një person apo një gjë si të padobishme, thonë: *"la keramete fihi"* - *"nuk ka dobi në të"*.

S'ka dyshim se hija e tymit të zi dhe mbytës nuk pritet të sjellë dobi, por vetëm dëm dhe humbje *(la keramete fihi)*.

Edhe pse ndëshkimet e banorëve të Xhehennemit kanë lloje dhe kategori të ndryshme, mjafton përmendja e këtyre tri ndëshkimeve, që njeriu të kuptojë pjesët dhe llojet tjera.

Në ajetet vijuese, arsyet e katandisjes së *"as'habul shumal"* - **"të të majtëve"** në këtë gjendje ogurzeze dhe të tmerrshme, i përmbledh në tri fjali:

Në fillim thotë: **"Ata, para kësaj, jetonin në luks."**.

Fjala *"mutraf"*, ashtu siç sqarohet edhe në fjalorin "Lisanul Arab", rrjedh nga rrënja *"teraf"* dhe ka kuptimin: *"tene'eum"* - *"mirëqenie"*. Personi që është bërë mospërfillës, arrogant dhe që shkon deri në revoltë nga pasuria e tepërt, quhet *"mutref"*.[1]

Asnjë nga "njerëzit e të majtës" nuk hyn në kategorinë e *"mutrifin"*, por synimi i Kur'anit janë udhëheqësit e tyre.

Ashtu siç ndodh edhe në ditët tona, shthurja dhe korrupsioni i shoqërive njerëzore buron nga një grusht njerëzish pasanikë, të dehur dhe arrogantë, të cilët janë dhe faktori i devijimit të të tjerëve. Gjithashtu, fijet e të gjitha luftërave, të gjakderdhjeve, të krimeve, të qendrave të epshit (dëshirave inferiore) dhe prirjeve devijante janë në duart e këtij grupi. Për këtë arsye, Kur'ani, para se gjithash, e vë gishtin mbi ta.

Meqenëse fjala *"begati"* ka një kuptim të gjerë, ekziston mundësia që arroganca e mosbesimi të mos kufizohen vetëm nga pasuritë, por begati të Zotit konsiderohen: rinia, shëndeti dhe jeta. Në qoftë se këto bëhen shkak i neglizhencës dhe i

[1] "Lisanul Arab", vëll. 9, f. 17.

mendjemadhësisë, që janë burimi kryesor i mëkateve, "njerëzit e të majtës" kanë një lloj, apo disa lloje prej këtyre begative.

Më pas, ajeti përmend mëkatin e tyre të dytë: **"...në vazhdimësi bënin gjynahe të rënda."**.[1]

Fjala *"hinth"* është përdorur me kuptimin e çdo lloj mëkati, por në shumicën e rasteve, kjo fjalë përdoret në kuptimin: "thyerje e besës dhe e kundërshtimit të betimit", sepse është një prej shembujve të qartë të mëkatit.

Si rrjedhojë, veçoria e "njerëzve të së majtës" nuk është vetëm kryerja e mëkatit, por është edhe këmbëngulja për kryerjen e mëkateve të mëdha. Ata mendojnë se mëkati kryhet edhe nga ana "e njerëzve të së djathtës". Por ndryshimi i madh mes tyre është se "njerëzit e të djathtës", sapo e kuptojnë se kanë kryer një mëkat, jo vetëm nuk këmbëngulin në vijimin e tij, siç bëjnë "njerëzit e të majtës", por pendohen menjëherë.

Disa komentues, togfjalëshin *"hinthin adhim"* - **"gjynahe të rënda"**, e kanë interpretuar si politeizëm dhe shirk, sepse nuk ekziston ndonjë mëkat më i madh se politeizmi dhe shirku. Në Kur'an thuhet: **"S'ka dyshim se All'llahu nuk fal** (mëkatin) **t'i përshkruhet Atij shok, e përpos këtij mëkati i fal kujtdo. Kush i përshkruan All'llahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh!**".

Disa të tjerë, atë e kanë komentuar si *"gënjeshtër"*, e cila është prej mëkateve të mëdha dhe çelësi i mëkateve të tjera, sidomos kur shoqërohet me përgënjeshtrimin e të Dërguarve dhe të Kiametit.

[1] Veçanërisht idhujtari.

Por të gjitha këto konsiderohen shembuj për të ilustruar *"hinthin adhim"* - *"gjynahet e rënda"*.

Mëkati i tyre i tretë është thënia e tyre: **"Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi pluhur e eshtra, vërtet do të ringjallemi?!"**.

Mohimi i Kiametit, që është burimi i shumë mëkateve, është një karakteristikë tjetër e **"njerëzve të së majtës"** dhe përdorimi i togfjalëshit *"kanu jekulune"* - *"ishin duke thënë"*, tregon se ata këmbëngulnin edhe në mohimin e Kiametit.

Këtu duhet të kihen parasysh dy çështje:

Së pari: Kur diskutoi rreth **"njerëzve të së djathtës"** dhe **"të afërmve tek All'llahu"**, Kur'ani nuk dha ndonjë shpjegim apo sqarim në lidhje me veprat dhe sjelljet që ishin shkak për shpërblimet e tyre, përveç ndonjë shpjegimi të shkurtër në lidhje me të afërmit tek All'llahu, kurse në rastin e **"njerëzve të së majtës"** shohim se bën një përshkrim të detajuar, në mënyrë që të jetë sa më plotësues për argumentin dhe arsyetimin që tregojnë, se ato dënime të dhimbshme përputhen plotësisht me parimin e drejtësisë.

Së dyti: Tri mëkatet që u përmendën në tri ajetet më lart, mund të jenë tregues për mohimin e tri parimeve kryesore të fesë nga **"njerëzit e të majtës"**.

Në ajetin e fundit, u diskutua për **"përgënjeshtrimin e Ringjalljes"**, në ajetin e dytë për **"mohimin e monoteizmit"**, kurse ajeti i parë për **"mirëqenien dhe jetën luksoze"**. Ajeti i parë tregonte për përgënjeshtrimin e të Dërguarve. Këtë e lexojmë edhe në ajetin 23 të sures "Ez Zuhruf": **"Ja pra, Ne nuk kemi**

dërguar para teje Pejgamber në ndonjë vendbanim, që të mos i ketë thënë paria e begatshme e atij vendi se ne i gjetëm të parët tanë në këtë fe dhe ne jemi të orientuar gjurmëve të tyre.".

Sifjalia: *"turaben ue i'dh'ama"* - **"pasi të vdesim e të bëhemi pluhur e eshtra",** mund të shprehë dyshimin për Ringjalljen, duke thënë se si do të jetë e mundur Ringjallja, pasi mishi ynë të shndërrohet në dhè e kockat tona të zhvishen. Meqenëse distanca e dheut është më e madhe nga jeta e re, është përmendur në fillim.

Ata e shihnin skenën e Ringjalljes me sytë e tyre edhe në këtë botë, kur shumë gjallesa, siç janë bimët, pasi vyshken dhe shuhen, sërish "veshin" rrobat e jetës dhe ringjallen.

Nga ana tjetër, Ai që është në gjendje të bëjë krijimin e parë, si është e mundur që ta ketë të vështirë rikrijimin?! Megjithëkëtë, ata gjithnjë këmbëngulnin në mohimin e Ringjalljes.[1]

Ata nuk u mjaftuan me kaq, por, për të ngjallur edhe më shumë kureshtjen, thoshin: "Vallë, a do të Ringjallen edhe të parët tanë të lashtë që nuk u ka mbetur asnjë shenjë?!". **"Vallë, edhe të parët tanë të lashtë?!"**

Po ata, që çdo grimcë e trupit të tyre u është e shpërndarë, ose u është bërë pjesë e një trupi tjetër të gjallë, si do të Ringjallen?

Por, ashtu siç është thënë në mënyrë të detajuar edhe në fund të sures "Ja Sin", përkundrejt argumenteve të forta që

[1] Duhet të keni parasysh se përsëritja e fjalës pyetëse dhe përdorimi i shprehjes *"inne"*, që të gjitha, janë për theksim.

analizojnë çështjen e Ringjalljes, këto dyshime nuk janë gjë tjetër, përveçse një grusht justifikimesh të sajuara dhe boshe.

Më pas, Kur'ani e urdhëron Profetin e Islamit: **"Thuaju** (o Muhammed)**: 'Me siguri, edhe të parët, edhe të mbramët…'"**.

Fjala *"mikat"* rrjedh nga rrënja *"uakt"* dhe është përdorur me kuptimin e kohës, e cila është përcaktuar për punë apo ndonjë premtim. Kjo fjalë *(mikat)* synon të tregojë kohën, orën e caktuar të Kiametit, kur të gjithë njerëzit do të tubohen përpara Zotit për të dhënë llogari. Kjo fjalë, gjithashtu, ndonjëherë është përdorur edhe me nënkuptim, për të shënuar vendin që është përcaktuar për kryerjen e ndonjë pune apo vepre, si për shembull, "vendtakimet e Haxhit", emrat e vendeve të veçanta ku haxhinjtë lidhin apo futen në *ihram*.

Për të shprehur gjithë nuancat kuptimore që ngërthen koncepti që lidhet me Ringjalljen, janë përdorur shumë mjete leksikore në këtë ajet, si p.sh.(*inn* dhe *lami*).

Ky ajet tregon më së miri se ringjallja e të gjithë njerëzve, do të ndodhë në një Ditë. Të njëjtën kuptim, e vërejmë edhe në ajete të tjera kur'anore.[1]

Gjithashtu, nga ky ajet, bëhet e qartë se ata që ndodhjen e Kiametit e kanë menduar në kohëra të ndryshme, veç e veç për secilin komb, janë plotësisht larg kuptimit të ajeteve të Kur'anit.

Mbase nuk ka nevojë për t'ua kujtuar, por koha e ndodhjes së Kiametit i takon vetëm Zotit të Gjithëdijshëm dhe askujt tjetër.

[1] Sure "Hud", ajeti 102 dhe sure "Merjem", ajeti 95.

As Profetët e dërguar dhe as engjëjt e afërt, nuk janë në dijeni për kohën e ndodhjes së Kiametit.

Ajetet 51 - 56

ثُمَّ إِنَّكُمْ أَيُّهَا الضَّالُّونَ الْمُكَذِّبُونَ٥١ لَآكِلُونَ مِنْ شَجَرٍ مِنْ زَقُّومٍ٥٢ فَمَالِئُونَ مِنْهَا الْبُطُونَ٥٣ فَشَارِبُونَ عَلَيْهِ مِنَ الْحَمِيمِ٥٤ فَشَارِبُونَ شُرْبَ الْهِيمِ٥٥ هَذَا نُزُلُهُمْ يَوْمَ الدِّينِ٥٦

"Dhe atëherë ju, o jobesimtarë të humbur",

“me siguri që do të hani nga pema e Zekumit”,

“me të cilën do të mbushni barkun.”

“Pastaj do të pini ujë të valuar”,

“madje do të pini ashtu siç pi deveja e etshme.”

“Kështu do të jetë gostia e tyre në Ditën e Llogarisë!”

Komentimi

Dënime të tjera të kriminelëve

Në këto ajete flitet për dënimet e **“njerëzve të së majtës”**. Duke iu drejtuar atyre, Zoti deklaron: **“Dhe atëherë ju, o jobesimtarë të humbur, me siguri që do të hani nga pema e Zekumit…”**.

Ajetet e kaluara diskutuan vetëm për kushtet e jetesës së **“njerëzve të së majtës”** në Xhehennem, kurse këtu flitet për

ushqimin dhe pijen e tyre, të cilët kanë trajtim të kundërt me **"njerëzit e të djathtës"**, e të afërmve tek All'llahu.

Mbresëlënës është fakti se auditor në këto ajete janë të devijuarit përgënjeshtrues, janë ata që, përveç devijimit dhe degjenerimit, karakterizohen nga një shpirt kryeneç dhe kundërshtues karshi të vërtetës dhe gjithnjë vazhdojnë në këtë mënyrë.

Fjala *"zekkum"* tregon një lloj bime të hidhur, me aromë dhe shije të keqe që lëshon një lëng, i cili, kur e prek trupin e njeriut, menjëherë shkakton fryrje. Ndonjëherë është përdorur për çdo lloj ushqimi të bezdisshëm të banorëve të Xhehennemit.[1]

Shprehja *"femaliune minhel butun"*, është përdorur me kuptimin **"me të cilën do të mbushni barkun"**, tregon se ata, në fillim, ndiejnë një uri të madhe, prandaj hanë me oreks të madh nga ky ushqim i hidhur dhe i pashijshëm dhe kështu mbushin barqet e tyre.

Pasi ushqehen me këto ushqime të pashijshme dhe të hidhura, ndiejnë etje. Por cila është pija e tyre?

Kur'ani thotë: **"Pastaj do të pini ujë të valuar"**.

Ata e pinë me shumë dëshirë, siç pi ujin deveja e sëmurë nga sëmundja e zorreve të fryra (Edema), e cila i jep etje të madhe, **"madje do të pini ashtu siç pi deveja e etshme"**.

Deveja, e prekur nga kjo sëmundje, ndien aq shumë etje, saqë nuk rresht së piri, derisa shkatërrohet. Po, ky është fati i

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bahrejn", "Mufredatu Ragib", "Lisanul Arab", si dhe tefsiri "Ruhul Meanij".

"dhal'lun el mukedh'dhibun" - "i jobesimtarëve të humbur dhe përgënjeshtrues" në Kiamet.

Fjala *"hamim"* është përdorur me kuptimin: *"një jashtëzakonisht i nxehtë dhe i valuar"*. Prandaj miqve të ngushtë dhe të dashur u thonë: *"uelijjun hamim"*. Edhe fjala *"hamam"*, gjithashtu, rrjedh po nga kjo fjalë.

Fjala *"him"* është shumësi i fjalës *"haim"*. Disa të tjerë, gjithashtu, e kanë konsideruar si shumësin e fjalës *"ehjem"* dhe *"hejma"* dhe është përdorur me kuptimin: "sëmundja e etjes", e cila prek devenë. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe për dashuritë e zjarrta të të dashurve.

Disa komentues të Kur'anit, fjalën *"him"* e përdorin me kuptimin e tokës ranore, ku, sado që të hidhet ujë, ajo nuk ngopet, sepse uji depërton në brendësi.

Ajeti 56 i kthehet sërish diskutimit për ushqimet dhe pijet: **"Kështu do të jetë gostia e tyre në Ditën e Llogarisë!"**.

E gjithë kjo ndodh, kur **"njerëzit e të djathtës"** janë rehatuar nën hije tepër të këndshme dhe hanë frutat më të mira, pinë nga burimet me ujë të kulluar dhe verë të stërpastër. Janë të dehur nga dashuria për Zotin. (Shih dallimin midis trajtimit **"të njerëzve të së djathtës"** dhe **"të së majtës"**.)

Fjala *"nuzul un"* është përdorur me kuptimin e një mjeti, me anë të të cilit mirëpresin mysafirin e veçantë dhe të dashur. Ndonjëherë, është përdorur edhe për pijen apo ushqimin e parë që ia ofrojnë mysafirit. Është e qartë se as banorët e Xhehennemit janë mysafirë dhe as *"zekumi dhe hamimi"* konsiderohet qerasje për

mikpritje, përkundrazi, ky përshkrim i një trajtimi të tillë, është një lloj përqeshjeje ndaj tyre, që të mendojnë se, kur kjo qenka qerasja e tyre, me të cilën priten, si do të jetë, vallë dënimi i tyre?! Mjerë ata për dënimet dhe ndëshkimet e tyre!

Ajetet 57 – 62

نَحْنُ خَلَقْنَاكُمْ فَلَوْلَا تُصَدِّقُونَ٥٧ أَفَرَأَيْتُمْ مَا تُمْنُونَ٥٨ أَأَنْتُمْ تَخْلُقُونَهُ أَمْ نَحْنُ الْخَالِقُونَ٥٩ نَحْنُ قَدَّرْنَا بَيْنَكُمُ الْمَوْتَ وَمَا نَحْنُ بِمَسْبُوقِينَ٦٠ عَلَى أَنْ نُبَدِّلَ أَمْثَالَكُمْ وَنُنْشِئَكُمْ فِي مَا لَا تَعْلَمُونَ٦١ وَلَقَدْ عَلِمْتُمُ النَّشْأَةَ الْأُولَى فَلَوْلَا تَذَكَّرُونَ٦٢

"Ne ju krijuam – e pse nuk e pranoni të vërtetën?"

"A e keni parë farën që e hidhni?"

"A jeni ju që e krijoni atë apo jemi Ne krijuesit e saj?"

"Ne e caktojmë vdekjen tuaj dhe askush nuk mund të na pengojë"

"që t'jua ndryshojmë trajtën dhe t'ju rikrijojmë ashtu si nuk e dini (në Ditën e Ringjalljes)**."**

"Sigurisht, ju e dini krijimin e parë (prej një pike fare)**, atëherë përse nuk mendoni?!"**

Komentimi

Shtatë argumente mbi Ringjalljen

Në ajetet e kaluara, ndër të tjera, u diskutua edhe rreth mohuesve të Ringjalljes. Kjo sure trajton kryesisht argumentimin e çështjes së Ringjalljes. Këto ajete analizojnë shtatë argumentet e Ringjalljes, e cila është një çështje e rëndësishme e besimit. Kjo qartëson zemrën e njeriut ndaj premtimeve të Zotit, të cilat u përmendën në ajetet e kaluara, në lidhje me **"të afërmit tek All'llahu", "njerëzit e të djathtës"** dhe **"njerëzit e të majtës"**.

Në fazën e parë, ajeti thotë: **"Ne ju krijuam – e pse nuk e pranoni të vërtetën?"**.[1]

Përse çuditeni nga Ringjallja fizike, pasi trupi është shndërruar në dhè? A nuk ju krijuam Ne nga dheu për herë të parë? A nuk është i njëjtë "ligji i krijimit të gjërave identike"?

Ky argument është i ngjashëm me atë që është thënë në ajetet 78–79 të sures "Ja Sin", kur Kur'ani i jep përgjigje njërit prej politeistëve, që kishte marrë në dorë një kockë të kalbur dhe thoshte: **"Ai na sjell shembull, duke harruar krijimin e vet dhe thotë: 'Kush do t'i ngjallë eshtrat kur të kalben?'"**

"Thuaj: 'Do t'i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë'."

"Kush i jep jetë këtyre kockave të kalbura?", deklaron: **"Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: 'Kush i ngjall eshtrat duke qenë të kalbura?' Thuaj: 'I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë , Ai është shumë i Dijshëm për çdo krijim!'"**

Ajeti 58 përmend argumentin e dytë: **"A e keni parë farën që e hidhni?[2] A jeni ju që e krijoni atë apo jemi Ne krijuesit e saj?"**.

---

1. Fjala *"leula"* është në kuptimin e nxitjes dhe shtyrjes për kryerjen e një vepre. Siç kanë pohuar disa, në thelb, është e përbërë nga *"lem"* dhe pjesëza *"la"*, që nënkupton pyetjen dhe mohimin. Më pas pjesëza *"mim"* është shndërruar në *"vav"*. Kjo fjalë përdoret në ato raste, kur individi apo individët janë në lëkundje në kryerjen e një vepre. Atyre iu thuhet: "Përse nuk veproni në këtë mënyrë?"

2 Fjala *"ru'ejtum"* - *"shikimi"* është në kuptimin e *"dijes"*, jo shikimit me anët ë syrit.

Kush është ai që i jep përditë një formë të re kësaj fare të padobishme, krijim pas krijimi? Me të vërtetë, këto transformime që kanë mahnitur të gjithë mendjendriturit, a janë nga ana juaj apo nga ana e Zotit? Vallë, Ai që ka fuqinë për këto krijime të njëpasnjëshme, a është i paaftë për të bërë Ringjalljen e të vdekurve në Kiamet?!

Ky ajet është i ngjashëm me ajetin 5 të sures "El Haxhxh": **"O ju njerëz, nëse dyshoni për Ringjalljen, atëherë mendoni krijimin tuaj që Ne ju krijuam ju prej dheu, pastaj prej uji, pastaj prej gjaku të ngjizur, pastaj prej një sa kafshatë mishi, që është krijesë e formuluar ose e pa formuluar, në mënyrë që t'ju sqarojmë. Ndërsa atë që dëshirojmë Ne e përqendrojmë në mitër, deri në një afat të caktuar, e mandej ju nxjerrim foshnje dhe ashtu të arrini pjekurinë tuaj...."**.

Përveç këtyre, nëse marrim në konsideratë vetëm atë që kanë zbuluar sot shkencëtarët, lidhur me këtë "pikë uji, sperme", në dukje të pavlefshme, çështja bëhet edhe më e qartë, sepse ata pohojnë se fara që e krijon njeriun, është një kombinim nga "sperma" (e mashkullit) me "ovulën" (fara e gruas). Këto sperma janë "krimba" shumë të vegjël mikroskopikë. Nga çdo orgazëm, (ejakulim), mund të ekzistojnë dy deri në pesëqind milionë mikroorganizma sperme, (pra, sa popullsia e disa shteteve të botës marrë së bashku).[1]

Krijesa shumë e vogël që nis, pas kombinimit të farës së mashkullit me farën e femrës, rritet dhe zhvillohet shumë shpejt dhe formon qelizat e trupit të njeriut, të cilat diferencohen nga

[1] "*Evvelin daneshgah*" - "Universiteti i Parë", vëll. 1, Tema "Njohja e fetusit", f. 241.

njëra–tjetra. Një pjesë e tyre formojnë zemrën e njeriut, një pjesë duart dhe këmbët, një pjesë tjetër formojnë veshët dhe sytë. Në këtë mënyre, secila nga ato vendoset në vendin e duhur. As qelizat e zemrës nuk vendosen në vend të veshkave e as të veshkave nuk vendosen në vend të qelizave të zemrës. As qelizat e veshëve nuk vendosen në vendin e qelizave të syve e as nuk ndodh e kundërta. Thënë shkurt, fara, gjatë periudhës së fetusit, kalon nëpër botë plot çudira, derisa lind në formën e një foshnje. Të gjitha këto janë në saje të krijimit të vazhdueshëm dhe konstant të Zotit, ndërkohë që roli i thjeshtë i njeriut në këtë krijim mbaron vetëm për një çast dhe ai çast është hedhja e spermës në mitrën e nënës dhe kaq.

A nuk është kjo një dëshmi e gjallë mbi çështjen e Ringjalljes? Vetëm Një i Plotfuqishëm, i Lartësuar ka mundësi të ringjallë të vdekurit![1]

Më pas, përmendet argumenti i tretë: **"Ne e caktojmë vdekjen tuaj dhe askush nuk mund të na pengojë!"**.

Po, Ne asnjëherë nuk do të mposhtemi. Edhe nëse kemi paracaktuar vdekjen, kjo nuk do të thotë se Ne nuk jemi të aftë që t'u japim jetë të përhershme. Por qëllimi është, *që t'jua ndryshojmë trajtën dhe t'ju rikrijojmë ashtu si nuk e dini në Ditën e Ringjalljes*.

Për interpretimin e këtij ajeti ka edhe një mendim tjetër përveç asaj që u tha më sipër, i cili është vijim i ajetit 61, por nuk

[1] Në lidhje me këtë fushë, kemi folur edhe më shumë në vëll. 14, f. 22 e tutje, ajeti 5, sure "El Haxhxxh".

shpreh qëllimin e tij. Ai thotë se *Ne nuk jemi të paaftë dhe të ngathët të heqim, të zhdukim një grup dhe ta zëvendësojmë me një grup tjetër*.[1]

Për shprehjen *"ala en nubed'dile emthalekum"*, ekzistojnë dy komente. Njëri është komenti që e trajtuam më lart dhe është më i njohur në mesin e komentuesve të Kur'anit. Sipas tij, bëhet fjalë për ndërrimin e popujve në këtë botë. Komenti i dytë thotë: Synimi i përdorimit të fjalës *"emthal"* është të tregojë njerëzit që do të rikthehen në Kiamet. Kurse përdorimi i shprehjes *"mithl"* - *"i ngjashëm"*, tregon se njeriu nuk do të rikthehet me të gjitha karakteristikat e tij, por do të jetë në një kohë tjetër dhe me tipare të reja trupore dhe shpirtërore.

Komenti i parë duket më i përshtatshëm. Sidoqoftë, synimi është, që nëpërmjet çështjes së vdekjes, të paraqitet një argument për Ringjalljen. Argumentin mund ta sqarojmë në këtë mënyrë: Zoti i Madhërishëm dhe i Gjithëdijshëm, që i ka krijuar njerëzit, të cilët, në mënyrë të vazhdueshme, vdesin dhe zëvendësohen nga një grup tjetër, ka pasur një synim. Në qoftë se synimi do të ishte vetëm jeta në këtë botë, është e drejtë që jeta e njeriut të ishte e përhershme, jo aq e shkurtër dhe e përzier me lloj–lloj pakënaqësish dhe plot probleme, aq sa do ia vlente ardhja dhe ikja nga kjo botë.

Si rrjedhim, ligji i vdekjes dëshmon më së miri se jeta në këtë botë nuk përbën gjë tjetër, veçse një vendkalim e jo vendqëndrim, një urë e jo një synim, sepse po të ishte synim, duhet të kishte vazhdueshmëri.

---

[1] Në bazë të komentimit të parë, shprehja *"ala en nubed'dile"* i përket shprehjes *"kedrina"*, që është përmendur në ajetin paraprak. Në bazë të komentimit të dytë, i referohet fjalës *"mesbukin"*. (Kini kujdes!)

Sifjalia: *"ue nunshiekum ma la tealemun"*- **"dhe t'ju rikrijojmë ashtu si nuk e dini në Ditën e Ringjalljes"**, në dukje, flet për krijimin e njeriut në Kiamet, që mund të jetë qëllimi i vdekjes së jetës së kësaj bote.

Është e qartë se askush nuk e ka parë Botën Tjetër, prandaj nuk ka njohuri për rendin dhe parimet që dominojnë atje. Madje, edhe përshkrimi i saj është i pamundur me fjalët tona. Ne jemi në gjendje vetëm ta parafytyrojmë dhe ta imagjinojmë atë.

Ajeti i lartpërmendur, shpreh plotësisht këtë realitet, që do t'ua rikrijojmë juve në Botën Tjetër, në forma dhe kushte të reja, për të cilat nuk keni dijeni.[1]

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë, përmendet argumenti i katërt për Ringjalljen: **"Sigurisht, ju e dini krijimin e parë,** (prej një pike fare)**, atëherë përse nuk mendoni?!"**.
Këtë argument mund ta analizojmë në dy mënyra:

Së pari: Supozojmë se jemi duke kaluar nëpër një rrugë. Përgjatë saj shohim një kështjellë shumë të bukur e tepër mahnitëse, që është e ndërtuar me materialet më të mira e më të forta dhe me kapacitete shumë të gjera dhe të mëdha. Më pas na thuhet se të gjitha këto kapacitete të kësaj ndërtese kaq të madhe, janë përgatitur që të pushojë një karvan i vogël, i cili më pas do të largohet. Mund të themi me vete, se kjo vepër nuk është e drejtë, sepse për një qëllim të tillë do të ishte e përshtatshme, e mjaftueshme që të ngriheshin disa tenda të vogla.

[1] Disa, ajetin e lartpërmendur, e kanë konsideruar si "ndryshim të popujve" në këtë botë, në mënyrë që Zoti i Madhëruar i ka ndryshuar ata në forma, për të cilat nuk janë në dijeni. Ky kuptim nuk përputhet me dukjen e ajetit.

Një botë, me gjithë këtë madhështi dhe me gjithë këto sfera qiellore, me qiellin, me Hënën dhe me speciet e llojllojshme e të ndryshme të krijesave mbi tokë, nuk mund të jetë krijuar për një qëllim të vogël, si për shembull, për jetën disa ditore të disa njerëzve mbi të. Përndryshe, krijimi i botës do të ishte i kotë dhe i padobishëm.

Këto kapacitete të mëdha janë krijuar për një krijesë të lartë dhe të ndritur, siç është njeriu, në mënyrë që nëpërmjet tyre ai të njohë Zotin e Madhëruar, një njohje e cila në Jetën Tjetër do të jetë një kapital i çmuar për të.

Ky shpjegim, në realitet, ngjason me atë që është thënë në ajetin 27 të sures "Sad " në lidhje me Ringjalljen, në të cilin, ndër të tjera, lexojmë: **"Ne nuk e krijuam qiellin e as tokën dhe ç'ka ka në mes tyre, pa qëllim,** (shkel e shko)**. Ai është mendim i atyre që nuk besuan, pra, Dënimi me Zjarr është mjerim për ata që nuk besuan!"**.

Së dyti: Skenat e Ringjalljes në këtë botë i shohim gjithandej me sytë tanë. Përgjatë gjithë vitit përsëritet skena e Ringjalljes, tek bimët dhe tokat e vdekura, të cilat ngjallen me anë të zbritjes së shiut, ashtu siç e lexojmë edhe në ajetin 39 të sures "Fussilet": **"Nga argumentet e Tij është edhe toka që ti e sheh atë të thatë, e kur ne i lëshojmë asaj shiun, ajo gjallërohet e shtohet. E, s'ka dyshim se Ai që e ngjall atë, do t'i ngjallë edhe të vdekurit, sepse Ai ka mundësi për çdo gjë!"**.

Edhe në ajetin 6 të sures "El Haxhxh", gjithashtu, është nënvizuar e njëjta domethënie.

Hulumtim

Një argument për miratimin e vlefshmërisë së analogjisë

Në metodologjinë e jurisprudencës islame, trajtohet çështja se normat e Sheriatit nuk mund të vërtetohen me anë të analogjisë, si për shembull, të themi: Meqenëse femra me menstruacione i kompenson ditët e saj të agjërimit, të njëjtën gjë mund të themi edhe për namazin, pra, ta kompensojë namazin në të njëjtën mënyrë (në ligjëratat shkencore dijetari duhet të niset nga e përgjithshmja dhe të përfundojë tek e veçanta dhe jo të niset nga veçanta për të përfunduar prapë te një e veçantë tjetër). Dijetarët e Ehli Synetit zakonisht e kanë pranuar analogjinë, si një prej burimeve legjislative në jurisprudencën islame, ndonëse një pjesë e tyre ka rënë dakord me ne, në lidhje me çështjen e pavlefshmërisë së analogjisë.

Disa nga përkrahësit e vlefshmërisë së analogjisë, ajetin e lartpërmendur: **"Sigurisht, ju e dini krijimin e parë** (prej një pike fare)**, atëherë përse nuk mendoni?!"**, e kanë sjellë si dëshmi dhe argument për këtë çështje. Zoti i Madhëruar thotë: "Krahasoni, (bëni analogji) gjendjen e Botës Tjetër (Kiametit) me krijimin e parë (këtë botë)".

Por, ky është një argument i pabesueshëm, sepse, së pari, ajo që është thënë në ajetin e lartpërmendur, lidhur me mohuesit e Ringjalljes, është një argument racional dhe logjik, sepse mohuesit e Ringjalljes thoshin se si është e mundur që Zoti të ketë fuqi për të ringjallur eshtrat, pasi ato të jenë kalbur?

Kur'ani, në përgjigje të tyre, thotë se kjo është e mundur, pasi Zoti që ka qenë i aftë ju krijojë ju në fillim, edhe në të ardhmen do të ketë një fuqi dhe forcë të tillë krijuese, ndërkohë që "analogjia supozuese" në dispozitat fetare dhe sheriatike nuk është e tillë. Për më tepër, që ne nuk jemi në dijeni të plotë rreth filozofisë (dobive dhe dëmeve) së të gjitha dispozitave dhe normave të Sheriatit.

Së dyti: Ata që e kanë ndaluar analogjinë, kanë përjashtuar analogjinë e përparësisë. Për shembull, nëse Kur'ani thotë se mos i dhunoni prindërit tuaj as me shprehjen më të vogël, në mënyrë të drejtpërdrejtë, na bën të kuptojmë se nuk duhet të ushtrojmë dhunë fizike ndaj tyre.

Ajeti që ne po diskutojmë, bën pjesë në kategorinë e analogjisë së përparësisë dhe nuk ka asnjë lidhje me analogjinë e supozimit në fjalë, sepse në fillim, asnjë gjë nuk ka ekzistuar. Zoti i Madhëruar krijoi rruzullin tokësor, tokën dhe njeriun e krijoi po nga dheu i tokës, kurse në Ahiret, më të paktën, do të ekzistojnë dherat e njeriut, prandaj edhe në Kur'anin Fisnik, në ajetin 27 të sures "Er Rrum" lexojmë: **"Dhe Ai është që e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo** (përsëritja) **është edhe më e lehtë për Të. Shëmbëlltyra më e lartë është vetëm e Tij në qiej e në tokë dhe Ai është Mbizotëruesi, i Urti!"**.

Këtë diskutim do ta mbyllim me një transmetim: "E çuditshme, sa e çuditshme puna e njeriut që e mohon Botën Tjetër, ndërkohë që e sheh krijimin e parë! Po ashtu, çudi, sa çudi!

Personi që beson në Botën Tjetër, por, ama, e gjithë përpjekja e tij është për këtë botë!".[1]

Ajetet 63 – 67

أَفَرَأَيْتُمْ مَا تَحْرُثُونَ٦٣ أَأَنْتُمْ تَزْرَعُونَهُ أَمْ نَحْنُ الزَّارِعُونَ٦٤ لَوْ نَشَاءُ لَجَعَلْنَاهُ حُطَامًا فَظَلْتُمْ تَفَكَّهُونَ٦٥ إِنَّا لَمُغْرَمُونَ٦٦ بَلْ نَحْنُ مَحْرُومُونَ٦٧

"A shihni atë që mbillni?"

"Vallë, ju e bëni atë që të mbijë apo jemi Ne rritësit e saj?"

"Nëse duam, Ne e lëmë fyçkë dhe ju do të çuditeni"

[1] Ky hadith është cituar në tefsirin "Ruhul Bejan", "Ruhul Meanij", "Kurtubi" dhe "Meragij", me pak ndryshim, si lajm, dhe pa e përmendur emrin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky hadith është nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* edhe në librin e njohur "Usulul Kafij". Gjithashtu, ky hadith është transmetuar nga Imam Hysejni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

“ (e do të thoni)**: ‘Ne jemi të dëmtuar’”,**

“madje jemi krejt të privuar (nga furnizmi)**!”**

Komentimi

Rritësi është Zoti, apo ju?!

Deri tani lexuam katër nga shtatë argumentet që u përmendën në këtë sure për Ringjalljen.

Ajetet që po diskutojmë dhe ajetet në vijim, paraqesin tri argumente të tjera, të cilat janë shembuj të qartë për fuqinë e pafund të Zotit të Plotfuqishëm në jetën e njeriut. Njëri argument ka të bëjë me krijimin e “farave ushqimore”, tjetri me “ujin” dhe i treti me “zjarrin”, sepse këto përbëjnë tri elementet thelbësore të jetës së njeriut.

“Farërat bimore” konsiderohen si lënda ushqimore më e rëndësishme për njeriun.

“Uji” konsiderohet si pija më e rëndësishme, kurse “zjarri” është mjeti më i rëndësishëm për përpunimin e lëndëve ushqimore dhe mjetet e tjera të jetesës.

Ajetet 63-64 thonë: **“A shihni atë që mbillni? Vallë, ju e bëni atë që të mbijë apo jemi Ne rritësit e saj?”**.

Interesant është fakti se në ajetin 63 është përdorur fjala *"tahruthun"*, që rrjedh nga rrënja *"harth"* dhe është përdorur me kuptimin e *"mbjelljes"*, kurse në ajetin 64 është përdorur fjala *"tezreunehu"* që rrjedh nga rrënja *"ziraetun"* dhe është në kuptimin e rritjes dhe të kultivimit.

Është e qartë se puna, përgjegjësia e njeriut është vetëm mbjellja, por kultivimi dhe rritja është punë që i përket vetëm Zotit. Për këtë, në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Asnjëri prej jush të mos shprehet: 'Unë kam rritur dhe kam kultivuar', por të thotë: 'Unë kam mbjellë', sepse rritësi i vërtetë është Zoti i Madhëruar."*.[1]

Ky argument sqaron se puna e njeriut, mbjellja, nuk është e ndryshme me punën e tij, në lidhje me lindjen e fëmijës, kur e mbjell një farë dhe tërhiqet mënjanë. Zoti është Ai që, në brendësi të farës, ka krijuar një qelizë shumë të vogël, të gjallë, në mënyrë që në kohën që hidhet në një tokë të përshtatshme dhe pjellore, në fillim i shfrytëzon lëndët ushqimore të deponuara brenda vetes, mbin, e më pas lëshon rrënjë. Në fund, me një shpejtësi të çuditshme, merr ndihmë nga lëndët ushqimore të tokës. Në brendësi të bimës vihen në punë aparatet madhështore dhe laboratorët ekzistues në të dhe bëjnë bujë të madhe, formojnë kërcellin, degët dhe gjembat, madje nganjëherë, nga një farë, lindin deri njëqind, madje njëmijë fara.[2]

---

[1] Pjesa e parë e hadithit është përmendur në tefsirin "Mexhmaul Bejan", ajeti në fjalë, kurse pjesa e dytë e tij, përveç saj, është përmendur në tefsirin "Ruhul Bejan".

[2] Edhe pse zakonisht në farën e grurit, shumimi shihet deri në njëqind fara më pak, por ashtu siç e kemi cekur edhe në vëllimin e dytë të po këtij tefsiri, në

Shkencëtarët deklarojnë se impiantet që funksionojnë në strukturën e një bime, janë më mahnitëse dhe më të ndërlikuara se impiantet që ndodhen në një qytet industrial të madh, me gjithë fabrikat e shumta dhe të përparuara. Vallë, Ai që ka një fuqi të tillë, a mund të jetë i paaftë për të Ringjallur të vdekurit?

Ajeti vijues, për ta theksuar më shumë çështjen se njeriu nuk luan asnjë rol në mbirjen dhe rritjen e bimëve, përveç mbjelljes së saj, shton: **"Nëse duam, Ne e lëmë fyçkë dhe ju do të çuditeni…"**.

Po, Ne mundemi të dërgojmë një erë helmuese, që ta thajë atë që keni mbjellë para se ajo të ketë marrë formën e farës dhe ta thyejë atë, ose të shkaktojmë ndonjë fatkeqësi natyrore, në mënyrë që ta zhdukë produktin. Ne mundemi të dërgojmë mbi to, tufa karkalecash, ose pjesë nga një rrufe e madhe, në mënyrë që nga ato të mos mbetet gjë tjetër, përveçse një grusht kashtë e thatë dhe ju të mbeteni të habitur dhe të çorientuar nga ajo që ngjau.

Vallë, nëse ju do të ishit rritësit e vërtetë të saj, a do të ishin të mundshme këto çështje? Atëherë, le të dini se të gjitha këto begati burojnë nga dikush tjetër.

Fjala *"hutam"* rrjedh nga rrënja *"hatam"*, e cila, në thelb, është përdorur me kuptimin: *"thyerja e një gjëje"*. Zakonisht përdoret për thyerjen e gjërave të thata, si për shembull kockat e kalbura apo kërcellin e bimëve të thata. Këtu fjala është për kashtën.

---

bazë të dëshmive të sakta të medias, në një prej rajoneve lindore të Iranit, në disa zona, janë vërejtur disa shkurre gruri shumë të gjata, me plot gjemba. Ndonjëherë, në një shkurre ekzistojnë afro katërmijë fara gruri.

Gjithashtu, është dhënë edhe mundësia që fjala *"hetam"*, këtu, të jetë përdorur me kuptimin e mykjes së vezëve nëntokë dhe, si pasoje, mos rritja e tyre. [1]

Fjala *"tefek'kehun"* rrjedh nga rrënja *"fakihe"* dhe është përdorur me kuptimin e frytit. Më pas, fjala *"fukahe"* është përdorur për shakatë dhe humorin, që janë *"fryti"* i tubimeve njerëzore. Por kjo fjalë, ndonjëherë, është përdorur dhe në kuptimin e mahnitjes dhe të çuditjes. Ajeti në fjalë ka për synim këtë kuptim.

Gjithashtu, ekziston edhe mundësia që ashtu si njeriu që është i "zemëruar", ndonjëherë qesh dhe këtë qeshje e quajnë "qeshje prej zemërimi", shpeshherë edhe fatkeqësitë e ashpra dhe të rënda i merr me shkaka. Si rrjedhojë, synimi është shakaja që buron nga fatkeqësia.

Po çuditeni, habiteni dhe pohoni se i keni shkaktuar dëm vetes dhe nuk keni përfituar asnjë gjë: **"**(e do të thoni)**: 'Ne jemi të dëmtuar, madje jemi krejt të privuar** (nga furnizmi)**!'"**.

Vallë, në qoftë se ju do të ishit rritësit e vërtetë, a do të ishte e mundshme një gjë e tillë? Të gjithë këta shembuj tregojnë se këto zhvillime dhe transformime janë nga ana e Zotit të Madhëruar dhe Ai është faktori, që nga një farë e pa vlerë, krijon dhe prodhon bimë plot gjallëri dhe ndonjëherë njëqind apo njëmijë fara bimësh, të cilat janë ushqim për njerëzit, degët dhe gjethet janë ushqim për kafshët dhe ndonjëherë, edhe rrënjët dhe pjesët e tjera të tyre, janë ilaç për sëmundjeve të ndryshme.

[1] Tefsiri "Ebul Futuh Rrazij", ajeti në fjalë.

Ajetet 68 – 74

أَفَرَأَيْتُمُ الْمَاءَ الَّذِى تَشْرَبُونَ٦٨ أَأَنْتُمْ أَنْزَلْتُمُوهُ مِنَ الْمُزْنِ أَمْ نَحْنُ الْمُنْزِلُونَ٦٩ لَوْ نَشَاءُ جَعَلْنَاهُ أُجَاجًا فَلَوْلَا تَشْكُرُونَ٧٠ أَفَرَأَيْتُمُ النَّارَ الَّتِى تُورُونَ٧١ أَأَنْتُمْ أَنْشَأْتُمْ شَجَرَتَهَا أَمْ نَحْنُ الْمُنْشِئُونَ٧٢ نَحْنُ جَعَلْنَاهَا تَذْكِرَةً وَمَتَاعًا لِلْمُقْوِينَ٧٣ فَسَبِّحْ بِاسْمِ رَبِّكَ الْعَظِيمِ٧٤

"A e shihni ujin që pini?"

"Vallë, ju e zbrisni atë prej reve apo Ne e zbresim?"

"Nëse duam, Ne e bëjmë atë të njelmët, andaj përse nuk jeni mirënjohës?!"

"A e shihni zjarrin që e ndizni?"

"Vallë, ju i keni bërë drutë për të apo Ne i kemi bërë?!"

"Ne e kemi bërë atë përkujtues (të zjarrit të Xhehennemit) **dhe, që t'u sjellë dobi nevojtarëve."**

"Prandaj lavdëroje emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!"

Komentimi

Prej kujt është uji dhe zjarri?

Në këto ajete paraqitet argumenti i gjashtë dhe i shtatë rreth Ringjalljes. Këto ajete shprehin fuqinë e Zotit mbi çdo gjë, edhe mbi ringjalljen e të vdekurve.

Ajetet 68-69 thonë: **"A e shihni ujin që pini? Vallë, ju e zbrisni atë prej reve apo Ne e zbresim?"**.

Fjala *"muzn"*, siç është shprehur edhe Ragib Isfahaniu, në "El Mufredat" është përdorur me kuptimin: re të kthjellëta. Disa

komentues të tjerë, e kanë interpretuar në kuptimin: re shimbajtëse.[1]

Këto ajete i vënë njerëzit përballë një seri pyetjesh dhe i detyrojnë të pohojnë. Dhe u thonë: Vallë, a keni menduar ndonjëherë se ky ujë është baza e jetës suaj? A keni menduar se nuk jetoni pa e konsumuar atë? A keni menduar se kush e urdhëron diellin të shkëlqejë mbi faqet e oqeaneve? A keni menduar se kush është Ai që përzgjedh nga mesi i ujërave të kripura dhe të hidhura vetëm grimcat e ujit të kristaltë, të ëmbël dhe të pastër nga çdo lloj papastërtie dhe i dërgon në qiej në formën e avullit? A keni menduar se kush është Ai që i urdhëron këta avuj t'i japin dorën njëri-tjetrit dhe të ngjiten lart në qiell e të formojnë pikat e shiut? A keni menduar se kush është Ai që urdhëron lëvizjen e erërave, zhvendosjen e reve nga një vend në një vend tjetër dhe i dërgon ato mbi tokat e thara dhe të "vdekura"?

A keni menduar se kush është Ai që shtresave të sipërme të ajrit u ka dhënë veçorinë dhe karakteristikën e veçantë që, kur ftohen, të mos kenë më fuqi të thithin avujt e të mos i kthejnë më në tokë në formën e pikave të shiut të qetë, të butë, të ngadalë dhe në mënyrë të njëpasnjëshme?

Në qoftë se për një vit dielli nuk shfaqet, retë nuk lëvizin, shtresat e larta në atmosferë mbajnë avujt, në vetvete me këmbëngulje, në qoftë se dhe qielli tregohet koprrac ndaj tokës dhe nuk u lëshon shiun për të vaditur të mbjellat dhe palmat, ju të gjithë do të vdisni nga etja. Do të shuhen edhe kafshët, edhe kopshtet, edhe bujqësia, çdo gjë.

[1] "Lisanul Arab", lënda "muznun".

Ai që zotëron këtë fuqi, pra, që nëpërmjet mjeteve kaq të thjeshta, ju siguron ju begati dhe mirësi, vallë, nuk qenkërka i aftë të ringjallë të vdekurit? Vetë kjo është një lloj ringjalljeje e të vdekurve, ringjallja e tokave të vdekura, që është dhe shenjë e monoteizmit dhe e madhështisë së Zotit dhe argument për Ringjalljen dhe Eskatologjinë.

Në qoftë se vërejmë që ajetet e lartpërmendura janë mbështetur vetëm tek uji i pijshëm dhe nuk kanë folur edhe për ndikimin dhe dobinë e tij në jetën e kafshëve dhe të bimëve, kjo ka ndodhur se i është dhënë përparësi rëndësisë së jashtëzakonshme që ka uji në jetën e njeriut. Përveç kësaj, në ajetet pararendëse, çështja e mbjelljes u përmend dhe nuk ishte e nevojshme të përsëritej.

Interesant është fakti se rëndësia e ujit dhe roli i tij në jetën e njeriut, jo vetëm që nuk pakësohet me kalimin e kohës, me zhvillimin e industrisë, me zhvillimin e diturisë njerëzore, por ndodh e kundërta. Njeriu i epokës industriale ka më shumë nevojë për ujë, prandaj shumë prej ndërmarrjeve të mëdha e të vogla industriale mund të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në afërsi të lumenjve të mëdhenj.

Ajeti tjetër, për plotësimin e kësaj çështjeje, shton: **"Nëse duam, Ne e bëjmë atë të njelmët, andaj përse nuk jeni mirënjohës?!"**.

Në qoftë se Zoti i Gjithëdijshëm do të dëshironte, edhe kripërat e tretura në ujë do t'i lejonte të avulloheshin bashkë me grimcat e ujit dhe të ngjiteshin bashkërisht në qiell, të formonin ujëra të kripura dhe të njelmët dhe të zbriste një shi i ngjashëm me ujin e detit të kripur dhe të njelmët. Por, jo. Ai, me forcën e vet

absolute, nuk ia dha këtë leje kripërave, jo vetëm kripërat në det, por gjithashtu as bakteret e fshehta dhe të dëmshme nuk kanë leje të ngjiten në qiell së bashku me avujt e ujit e të ndotin pikat e shiut. Pikërisht, për këtë arsye, sa herë që ajri nuk është i ndotur, pikat e shiut janë uji më i kristaltë, më i pastër dhe më i freskët.

Fjala *"uxhash"*, në thelb, rrjedh nga fjala *"exhixh-i"* dhe është përdorur më kuptimin e zjarrit dhe të flakës së tij. Me fjalën *"hixhaxh"* emërtohen ujërat që e djegin gojën për shkak të njelmësisë, djegies apo nxehtësisë së tyre.

Këtë diskutim do ta mbyllim me një thënie nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai, kur pinte ujë, thoshte: *"Falënderimi i takon Zotit të Madhëruar, i cili, me Mëshirën e vet, më ngop me ujin e ëmbël dhe të shijshëm dhe nuk e ka përcaktuar atë për ne të kripur apo të hidhur për shkak të mëkateve tona."*.[1]

Në fund mbërrijmë tek argumenti i shtatë, i cili flet për Ringjalljen. Ajeti tregon se cili është krijuesi i zjarrit. Cili është krijuesi i atij zjarri që është mjeti më i rëndësishëm në jetën e njerëzve, si dhe mjeti më ndikues në të gjitha industritë. Ajeti thotë: **"A e shihni zjarrin që e ndizni? Vallë, ju i keni bërë drutë për të apo Ne i kemi bërë?!"**.

Fjala *"turun"* rrjedh nga rrënja *"uera"* dhe është në kuptimin e *"mbulimit"*. *"Uera"* si dhe *"ira"* quhet zjarri, apo më saktë, shkëndijat e zjarrit që ndizen me mjetet primitive të atëhershme të ndezjes.

[1] Tefsiri "Meragij", vëll. 27, f. 148; tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 27, f. 129.

Ndezja e zjarrit me shkëndijë, në të kaluarën, realizohej duke e përplasur një copë hekuri me një gur të fortë. Nga kjo përplasje dilnin shkëndija, të cilat shfrytëzoheshin për ndezjen e zjarrit. Sot ndezja e zjarrit bëhet me shkrepëse, me çakmak edhe me mjete të tjera.

Arabët e Hixhazit përdornin për ndezje dy lloj pemësh të veçanta, të cilat rriteshin në rrugë dhe quheshin "merkh" dhe "affar". Njërën e vendosnin poshtë dhe tjetrën sipër saj dhe duke i fërkuar, nga ato lindnin shkëndija si të shkrepëses apo çakmakut.

Pjesa dërmuese e komentuesve, ajetin e lartpërmendur, ndezjen e zjarrit e kanë komentuar si shprehje e Fuqisë së Zotit të Madhëruar. Ai, përmes ndezjes së zjarrit, që fshihet në drunjtë e pemëve, tregon Gjithëfuqishmërinë e Tij. Ai arrin të ndezë zjarrin edhe nga drunjtë e njomë, nga pemët e gjelbra. Këto ndezje zjarri, që emërtohen me shprehjen "*shexhereje ahdh'ar*", (pema e gjelbër) i fton njerëzit të mendojnë se Cili mund të ndezë zjarr në ujë, pra, me pemët e gjelbra. Ku uji e ku zjarri?!

Ai që zotëron një fuqi të tillë, ku ujin e zjarrin, jo vetëm që i mban në afërsi të njëri–tjetrit, por edhe në brendësi të njëri–tjetrit, si mund të mos ringjallë të vdekurit dhe t'u japë atyre jetë të re?

Një argument të ngjashëm, në lidhje me Ringjalljen, e hasim edhe në ajetin e fundit të sures "Ja Sin": **"Ai që prej drurit të gjelbër ju bëri zjarrin, e ju prej tij ndezni."**.[1]

Por, ashtu siç e shprehëm me detaje, edhe në komentimin e ajetit të lartpërmendur, kjo shprehje kur'anore mund të flasë për një argument më me finesë, që është ringjallja e energjive.

[1] Sure "Ja Sin", ajeti 80.

Shprehur ndryshe, këtu nuk flitet vetëm për "ndezësin e zjarrit", por bëhet fjalë edhe për lëndën djegëse, pra, për drurin dhe shkurret, të cilat, gjatë djegies, çlirojnë gjithë atë nxehtësi dhe energji.

Është vërtetuar shkencërisht se zjarri, i cili përftohet nga djegia e drurëve, është po ajo nxehtësi që pemët e kanë përftuar nga dielli dhe e kanë ruajtur brenda vetes me vite të tëra. Dikush mund të mendojë se rrezatimi dhjetëvjeçar i dritës së diellit në trungun e pemës ka shkuar kot. Në të vërtetë, e gjithë ajo nxehtësi është ruajtur në pemë dhe, në kohën që shkëndija e zjarrit bie në kontakt me drurët e thatë e fillon djegia e tyre, ato e kthejnë mbrapsht atë nxehtësi, dritë dhe energji.

Shpjeguar ndryshe, këtu kemi të bëjmë me një lloj Ringjalljeje, sepse energjitë e vdekura ngjallen përsëri dhe marrin forcë dhe neve na tregojnë se Zoti i Madhërishëm është Ai që siguroi ringjalljen e tyre. Ai, siç na ringjalli ne, do të bëjë edhe ringjalljen e njerëzve.

Fjala "*turune*" është përdorur me kuptimin: ndezje e zjarrit. Këtu është komentuar në kuptimin e çakmakut apo mjetit ndezës. Por nuk ka asnjë mospërputhje kuptimore, në qoftë se përdoret edhe me kuptimin e lëndës djegëse, sepse, edhe në këtë rast, bëhet fjalë për një zjarr.

Këto dy kuptime nuk bien ndesh me njëra-tjetrën, sepse koncepti i parë është i perceptueshëm për të gjithë njerëzit, kurse koncepti i dytë, i cili është dhe më i saktë, është bërë i njohur me kalimin e kohës dhe përparimin e dijes dhe të shkencës.

Në ajetin 73, për të theksuar diskutimet e lartpërmendura, thuhet: **"Ne e kemi bërë atë përkujtues** (të zjarrit të Xhehennemit) **dhe, që t'u sjellë dobi nevojtarëve…"**.

Rishfaqja e zjarrit nga druri i gjelbër, është rikujtim i rikthimit të shpirtit në trupat e vdekur dhe të pashpirt në ringjallje, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër është një rikujtim për zjarrin e Xhehennemit. Kjo vërtetohet në bazë të një transmetimi nga i Dërguari i Zotit: *"Ky zjarr, të cilin e ndizni, është një pjesë nga shtatëdhjetë pjesët e zjarrit të Xhehennemit!"*.[1]

Shprehja *"metaen lil mukuijn"* është përdorur me kuptimin: *"t'ju sjellë dobi nevojtarëve"*. Është një tregues i shkurtër dhe shumë i arrirë për dobitë e zjarrit të kësaj bote. Për fjalën *"mukuijn"* janë paraqitur dy komentime:

Në komentimin e parë, thuhet se kjo fjalë rrjedh nga rrënja *"kiua'a"* dhe është përdorur me kuptimin: lëndinë e thatë dhe e boshatisur. Si rrjedhim, *"mukuijn"* quhen personat që ecin nëpër lëndinë. Duke pasur parasysh faktin se beduinët, zakonisht, janë të varfër dhe shpesh ecin nëpër lëndina, ndonjëherë kjo fjalë është përdorur dhe në kuptimin: varfanjak.

Në komentimin e dytë, thuhet se kjo fjalë rrjedh nga rrënja *"kuuuet"* dhe është përdorur me kuptimin: të fortët dhe i fuqishmi. Për këtë arsye, fjala e përmendur, përdoret me dy kuptime të kundërta.[2]

[1] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 9, f. 6392, si dhe tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 27, f. 131.
[2] Kini kujdes fjala *"meta"* përdoret për çdo lloj mjeti që njeriu e shfrytëzon përgjatë jetës së tij.

Të gjitha llojet e drurëve dhe të pemëve përdoren për të ndezur zjarr, por ngaqë mysafirët, më shumë se kushdo tjetër, kishin nevojë për t'u mbrojtur nga i ftohti dhe për të përgatitur ushqim, sidomos në udhëtimet e kohëve të vjetra, me anë të karvanëve, theksi është vënë te përdorimi i zjarrit prej tyre.

Duhet theksuar se, nëse një ditë do të shuheshin të gjitha llojet e zjarreve, pra, edhe zjarret që ndizen nga drurët dhe nga pemët, por edhe zjarret që ndizen nga qymyri e nafta apo nga çdo lëndë djegëse, atëherë do të pushonin aktivitetin e tyre të gjitha llojet e industrive që kanë zjarrin në bazë. Por jo vetëm kaq. Do të shuhej e gjithë jeta njerëzore dhe qytetërimi botëror.

Pa dyshim, zjarri është një prej zbulimeve më të rëndësishme të njerëzimit. Që nga koha e zbulimit të zjarrit, njerëzimi ka hedhur shumë hapa përpara në civilizim.

Po, Kur'ani Fisnik, në këtë fjali të shkurtër, në mënyrë lakonike, i ka bërë të qarta të gjitha këto fakte dhe të vërteta.

Po ashtu, është e nevojshme të përmendet edhe fakti se, në ajetin e lartpërmendur, në fillim u diskutua për dobinë shpirtërore që sjell zjarri, i cili, si i tillë, ishte rikujtimi i Ringjalljes. Më pas, u diskutua për dobinë e tij në këtë botë, sepse çështja e parë, jo vetëm që ka më shumë rëndësi, por përbën edhe thelbin, edhe bazën.

Në lidhje me përmendjen e këtyre tri begative të trillojshme: të farave të ushqimit, të ujit, të zjarrit, është zbatuar një renditje plotësisht natyrore. Njeriu, në fillim, rend pas farave ushqimore, më pas rend pas ujit dhe më në fund, prodhimin e gatuan në zjarr dhe e përgatit për ta ngrënë.

Në ajetin 74, si përfundim thuhet: **"Prandaj lavdëroje Emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!"**.

Zoti që i ka krijuar të gjitha këto begati dhe secila nga këto të rikujton monoteizmin, Ringjalljen, fuqinë dhe madhështinë e Zotit, është i Denjë dhe e meriton lavdërimin dhe spastrimin nga çdo lloj mangësie dhe të mete!

Ai është edhe *"rabb"* (Kujdestar, Kultivues), edhe Zot, është edhe i Madhërishëm, edhe i Fuqishëm e i Plotfuqishëm! Edhe pse në këtë ajet i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është më se e qartë që ajeti i drejtohet gjithë njerëzimit.

Hulumtim

Këtu është e nevojshme të trajtojmë disa hadithe të dobishme dhe shumë domethënëse nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lidhur me ajetet e lartpërmendura:

Në tefsirin "Ruhul Meanij", në një hadith nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: "Një natë, Imami, gjatë faljes së namazit dhe leximit të sures 'El Uakia', kur arriti tek ajetet: **'A e keni parë farën që e hidhni? A jeni ju që e krijoni atë apo jemi Ne krijuesit e saj?',** tri herë radhazi përsëriti: 'Po, Ti je Krijuesi i njeriut, O Zot!'".

Kur arriti tek ajeti tjetër: **"Vallë, ju e bëni atë që të mbijë apo jemi Ne rritësit e saj?"**, sërish tri herë tha: "O Zot, Ti je Ai që

bën të mbijë!". Kur arriti te ajeti: **"Vallë, ju e zbrisni atë prej reve apo Ne e zbresim?"**, tha: "Jo, Ti je Ai që e bën këtë!".

Më pas këndoi ajetin: **"Vallë, ju i keni bërë drutë për të apo Ne i kemi bërë?!"**, tri herë tha: "O Zot! Ti je Krijuesi i drurëve të zjarrit!".[1]

Nga ky hadith përcillet mesazhi se njeriu duhet t'u përgjigjet në mënyrë të duhur pyetjeve të parashtruara nga Zoti në Kur'an dhe ta supozojë veten sikur vetë Zoti po bisedon me të. Më pas të ngjallë në shpirtin e vet realitetin dhe të mos mjaftohet vetëm me leximin formal dhe pa meditim.

Në një hadith tjetër nga Profeti i Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: *"Asnjëherë mos i privoni njerëzit nga uji i tepër që keni në dispozicion, as nga kullotat shtesë e as nga zjarri, sepse Zoti i Madhëruar këto i ka përcaktuar si mjete jetese për udhëtarët dhe burim të fuqisë së nevojtarëve."*.[2]

Në një hadith tjetër, lexojmë: Në kohën që zbriti ajeti **"Prandaj Lavdëroje Emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!"**, Profeti i Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Atë përcaktojeni si dhikër dhe përmendeni gjatë kryerjes së rukusë në namaz, pra thoni: 'Subhane rabbijel adh'imi ve bihamdih'."*.[3]

---

[1] Tefsiri"Ruhul Meanij", vëll. 27, f. 130.
[2] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 161.
[3] Këtë hadith, Tabrasij e ka cituar si një hadith të saktë në tefsirin "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 339; tefsiri "Nuruth Thakalejn", vëll. 5, f. 225; tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 168.

Ajetet 75 – 82

فَلَا أُقْسِمُ بِمَوَاقِعِ النُّجُومِ٧٥ وَإِنَّهُ لَقَسَمٌ لَوْ تَعْلَمُونَ عَظِيمٌ٧٦ إِنَّهُ لَقُرْآنٌ كَرِيمٌ٧٧ فِي كِتَابٍ مَكْنُونٍ٧٨ لَا يَمَسُّهُ إِلَّا الْمُطَهَّرُونَ٧٩ تَنْزِيلٌ مِنْ رَبِّ الْعَالَمِينَ٨٠ أَفَبِهَذَا الْحَدِيثِ أَنْتُمْ مُدْهِنُونَ٨١ وَتَجْعَلُونَ رِزْقَكُمْ أَنَّكُمْ تُكَذِّبُونَ٨٢

"Betohem në çastin e perëndimit të yjeve",

"- e ky është betim i madh, veç sikur ta dinit –"

"Se ky është vërtet një Kur'an i nderuar",

"në Librin e ruajtur."

"Atë (Kur'anin) **e prekin vetëm të pastrit."**

"Ai është Shpallje prej Zotit të botëve."

"Vallë, një Fjalë të tillë ju e mohoni"

"dhe e bëni detyrën tuaj (të përditshme) **ta përgënjeshtroni?!"**

Komentimi

Kur'anin e Nderuar, e prekin vetëm të pastrit

Në vazhdimësi të diskutimeve të shumta, që u trajtuan në ajetet më lart, lidhur me trajtimin e shtatë argumenteve rreth Ringjalljes, në këto ajete do të flitet dhe do të diskutohet për Kur'anin Fisnik, sepse, pas çështjes së Zanafillës dhe Ringjalljes, çështja e Profetësisë dhe e zbritjes së Kur'anit përbën shtyllën kryesore të doktrinës ideologjike të besimit islam. Përveç kësaj, Kur'ani Fisnik, lidhur me dy parimet: monoteizmi dhe Ringjallja, ka zhvilluar diskutime të thella dhe ka përforcuar themelet e tij. Kur'ani konsiderohet konsolidim i këtyre dy parimeve.

Ajeti 75 përmban një betim të madh: **"Betohem në çastin e perëndimit të yjeve"**.

Shumë komentues të Kur'anit, janë të mendimit se pjesëza *"la"*, këtu, nuk është në kuptimin e mohimit, por është *"la-ja"*, që konsiderohet si shtesë për theksim. Ashtu sikur edhe në raste të

tjera në Kur'an, e njëjta fjalë, (pjesëza *"la"*), është pranuar se është përdorur, në lidhje me betimin në Ditën e Kiametit, në lidhje me shpirtin qortues, me Zotin e lindjeve dhe të perëndimeve të muzgut dhe të ngjashëm me këto.

Disa komentues të tjerë, pjesëzën *"la"* e kanë komentuar dhe kanë pranuar si pjesëz mohuese dhe kanë treguar se çështja për të cilën betohet, është më e rëndësishme se sa të betohesh në të, siç na ndodh edhe në shprehjet e përditshme kur themi: "Ne, për filan çështje nuk betohemi.".

Komentimi i parë duket më i përshtatshëm, sepse në Kur'an është shprehur qartë betimi në Esencën e Stërpastër të Zotit. Vallë, a kanë më shumë përparësi yjet, që të betohen për ta?!

Komentuesit, për togfjalëshin: **"çastin e perëndimit të yjeve"**, kanë përmendur komentime të ndryshme:

Së pari, janë komentuar pozita, vendndodhja e yjeve, orbita si dhe trajektorja e tyre.

Së dyti, me ta synohet vendi i lindjes dhe i perëndimit të tyre.

Së treti, synimi është shuarja e yjeve në prag të Ringjalljes dhe Kiametit.

Disa komentues të tjerë, gjithashtu, e kanë komentuar vetëm në kuptimin e perëndimit të yjeve.

Një pjesë tjetër e komentuesve, duke pasuar disa transmetime, perëndimin e yjeve e konsiderojnë tregues për zbritjen e pjesëve të ndryshme të Kur'anit në intervale të

ndryshme kohore, sepse fjala *"nuxhum"* është shumësi i fjalës *"nexhm"* dhe përdoret me kuptimin: veprime graduale.

Edhe pse në mes këtyre kuptimeve nuk ekziston ndonjë kundërshti, ose mospajtim dhe ka gjasa që të gjitha këto kuptime të përmblidhen në kuptimin e ajetit, komentimi i parë duket më i përshtatshëm se të gjithë, sepse në kohën e zbritjes së ajeteve, pjesa dërmuese e njerëzve, as nuk ishin në dijeni dhe as e dinin rëndësinë e këtij betimi. Tashmë, për ne është bërë e qartë se secili nga yjet në qiell ka një pozitë të veçantë. Rrugëtimi i tyre dhe trajektorja e tyre janë të përcaktuara në përputhje me ligjin e tërheqjes dhe të shtytjes, i cili është shumë i saktë dhe i përpiktë. Është e përcaktuar edhe shpejtësia e lëvizjes së çdonjërit prej tyre. Kjo kryhet në bazë të një programi të përcaktuar.

Edhe pse kjo çështje në kohërat e largëta nuk ishte e mundur që të llogaritet saktësisht pozicioni dhe lëvizjet e yjeve, në Sistemin Diellor, i cili përbën familjen e yjeve afër nesh, është llogaritur në mënyrë të saktë gjithçka. Llogaritja e rendit dhe e lëvizjeve të orbitave të yjeve janë kaq të përpikta dhe të mirëllogaritura, sa e mahnitin njeriun.

Në kohën që i kushtojmë vëmendje kësaj çështjeje, në bazë të dëshmive të disa shkencëtarëve, vetëm në galaktikën tonë ekzistojnë afro dyqind miliardë yje. Në Gjithësi ekzistojnë galaktika të shumta dhe secila nga ato përshkruan një rrugë të caktuar dhe të veçantë. Më tej do njihemi edhe më shumë me rëndësinë e këtij betimi në Kur'an.

Në librin "All'llahu uel ilmul hadith", lexojmë: "Astrologët janë të besimit se vetëm një pjesë e këtyre yjeve, të cilët i kalojnë

miliardat, është e mundur që të shihen me sy të lirë. Pjesa tjetër, pjesa dërmuese, nuk mund të shihet me sy të lirë, por vetëm me anë të teleskopëve. Një pjesë tjetër, që ndodhet edhe më larg, nuk mund të shihet as me anë të teleskopit. Ato mund të fotografohen me anë të mjeteve të veçanta. Që të gjitha këto yje notojnë në orbitën e tyre përkatëse dhe nuk ekziston asnjë mundësi që ndonjëri prej tyre të futet në fushën e tërheqjes së orbitës së një ylli tjetër, ose të bëjnë aksident me njëri–tjetrin. Një aksident i tillë do të ngjasonte me përplasjen e një transoqeaniku me një anije tjetër në Detin Mesdhe, ose në Oqeanin Paqësor, ndërkohë që të dyja anijet lëvizin në të njëjtin drejtim dhe me të njëjtën shpejtësi. Një mundësi e tillë, në mos qoftë e pamundur, së paku është tejet e larg.[1]

Si rezultat i zbulimeve të mëdha shkencore në Sistemin Diellor, statusi i yjeve është bërë më i dukshëm, ndaj dhe rëndësia e betimit të lartpërmendur është bërë më e qartë...

Pikërisht, për këtë arsye, në ajetin vijues thuhet: **"e ky është betim i madh, veç sikur ta dinit"**.

Përdormi i sifjalisë *"leu tealemun"* - **"veç sikur ta dinit"**, dëshmon më së miri se dituritë e njerëzimit në atë kohë nuk e kishin perceptuar këtë realitet në mënyrë të plotë dhe të saktë. Prandaj dhe vetë situata konsiderohet si një prej mrekullive shkencore të Kur'anit, në një epokë kur një grup njerëzish akoma ishin të mendimit se yjet janë gozhda prej argjendi, të cilat janë rrahur dhe janë grimcuar mbi strehën e qiellit. Një mendim i tillë, duke pasur parasysh dhe mjedisin që me të drejtë konsiderohej

[1] "All'llahu uel ilmu uel hadith", f. 33.

mjedis i injorancës dhe i mosdijes, është e pamundur të shprehet nga një njeri i zakonshëm.

Tani le të shohin se për ç'synim është përmendur ky betim i madh. Ajeti vijues, na e bën të qartë arsyen e bërjes së këtij betimi. Ajeti thotë: **"Ky është vërtet një Kur'an i Nderuar."**.

Në këtë mënyrë u përgjigjet Kur'ani politeistëve kryeneçë, të cilët gjithnjë këmbëngulnin se këto ajete kur'anore janë një lloj parashikimi priftërinjsh, ose, Zoti na faltë, janë fjalë të marrosura, që ngjasojnë me vargjet e poetëve, ose janë nga fjalët e djajve, kurse Kur'ani është një Shpallje qiellore, te fjalët e të cilit vërehen shenjat e madhështisë dhe të origjinalitetit të tij. Përmbajtja e tij rrëfen burimin e zbritjes së tij dhe kjo çështje është aq e qartë, sa nuk ka asnjë nevojë për shpjegim.

Përshkrimi i Kur'anit si "Kur'ani Kerim"

Fjala *"kerjim"* përdoret për të treguar se Kur'ani është mirëbërës dhe begatidhënies, kurse përdorimi i kësaj fjale për njeriun tregon se ai mbart vlera morale të larta dhe veprime të lavdërueshme. Në përgjithësi, kjo fjalë është tregues për mirësitë e mëdha.[1]

Gjithashtu, është tregues edhe për elokuencën e retorikës, metrikës dhe pasurive leksikore e ritmike, të pasurive sintaksore të Kur'anit, si dhe është një tregues për përmbajtjen e pastër të tij, sepse nuk ka si të jetë ndryshe, kur Kur'ani ka zbritur nga ana e

[1] Ragib në "El Mufredat", lënda "Kerijm".

Zotit të Madhëruar dhe të Gjithëditur, që është burimi dhe zanafilla e çdo përsosmërie, bukurie dhe hijeshie.

Po, edhe rrëfyesi i Kur'anit është *"kerijm"*, si edhe vetë Kur'ani, ashtu është *"kerijm"*, edhe sjellësi dhe qëllimet e tij. Këtë përcaktim e meritojnë të gjithë këto që cituam.

Më pas përmend cilësinë e dytë të këtij Libri Qiellor: **"në Librin e ruajtur"**.

Kushdo që punon dhe vepron sipas "Leuhin Mahfudh", pra, sipas dijes se Zoti është i ruajtur dhe i mbrojtur prej çdo gabimi, ndryshimi dhe shndërrimi. Në këtë kontekst, është më se e qartë se Libri, i cili buron nga një Zanafillë e tillë dhe versioni i tij origjinal, i cili gjendet atje, është i mbrojtur nga çdo lloj ndryshimi, modifikimi dhe gabimi.

Në përshkrimin e tretë, ajeti thotë: **"Atë** (Kur'anin) **e prekin vetëm të pastërtit…"**.[1]

Pjesa dërmuese e komentuesve të Kur'anit, duke pasuar disa transmetime nga Imamët e pastër, për ajetin në fjalë, kanë deklaruar: *"Mos lejimin e prekjes së Kur'anit pa pasur gusul (larja e tërë trupit) dhe abdes."*.

Një grup tjetër i komentuesve, ajetin në fjalë e kanë konsideruar tregues për engjëjt e pastër, të cilët kanë njohuri për Kur'anin, ose kanë qenë ndërmjetësues të shpalljes në zemrën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

[1] Fjala *"la jemes'suhu"* është një fjali kallëzuesore, që ka mundësi të jetë në kuptimin e *"ndalimit"* apo të *"mohimit"*.

familjen e tij!), kundrejt politeistëve, të cilët thoshin se këto fjalë atij i janë zbritur nga ana e djajve.

Disa komentues të tjerë, gjithashtu, atë ajet e konsiderojnë tregues për faktin, që të vërtetat dhe konceptet sublime të Kur'anit nuk i percepton askush tjetër, përveç të pastërve. Ashtu si dhe në ajetin 2 të sures "El Bekare", lexojmë: **"Ky është Libri që nuk ka dyshim në të** (sepse është prej All'llahut)**, është udhëzues për ata që janë të devotshëm."**.

Shprehur ndryshe, për konceptimin e minimumit të kuptimeve të tij nevojitet pastërtia më e vogël, që është shpirti "kërkues i së vërtetës". Sa më e lartë të jetë pastërtia dhe shenjtëria, aq më i madh do të jetë edhe konceptimi i njeriut ndaj nocioneve dhe mësimeve kur'anore dhe përmbajtjes së tij.

Por, në mesin e këtyre tri komentimeve nuk ekziston asnjë lloj kundërshtimi dhe antagonizmi. Të gjitha kuptimet afrohen në kuptimin e ajetit.

Në përshkrimin e katërt dhe të fundit, lidhur me Kur'anin, ajeti deklaron: **"Ai është Shpallje prej Zotit të botëve."**.[1]

Zoti, i Cili është zotërues dhe mbajtës i të gjitha botëve, e ka zbritur këtë Kur'an në zemrën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për edukimin e njerëzve. Zoti është Pronari absolut edhe në botën e krijesave, edhe në botën e ligjeve. Gjithashtu, çdo gjë që është, është nga ana e Tij.

[1] Fjala *"tenzil"* këtu është paskajore, në kuptimin e "pjesores ", pra, *"munezzil"* dhe është kallëzues për subjektin e përjashtuar, ose kallëzues i dyfishtë.

Ajeti 81 thotë: **"Vallë, një Fjalë të tillë ju e mohoni?"**.

Shenjat e vërtetësisë së tij janë shumë të qarta, prandaj Fjalën e Zotit duhet ta pranojmë me seriozitetin më të madh dhe të përballemi me atë si me një realitet të madh.

Fjalia *"hadhel hadith"*, është tregues për Kur'anin dhe fjala *"mud'hinun"* - **"ju e mohoni"** rrjedh nga rrënja *"dehn"* dhe është përdorur me kuptimin e *vajit*. Duke pasur parasysh faktin që atë e përdorin për të zbutur lëkurën e trupit apo të sendeve të tjera; fjala *"id'han"*, ndonjëherë është përdorur edhe me kuptimin e tolerancës dhe të butësisë.

Ndonjëherë tjetër është përdorur me kuptimin e neglizhencës dhe të mungesës së seriozitetit. Duke u nisur nga fakti që njerëzit hipokritë dhe gënjeshtarë zakonisht kanë gjuhë mikluese dhe të butë, kjo fjalë është përdorur edhe me kuptimin e përgënjeshtrimit dhe të mohimit. Në ajetin e lartpërmendur, të dyja këto kuptime janë të mundshme.

Parimisht, njeriu, një gjë që e beson, e merr me seriozitet. Në qoftë se atë nuk e merr me seriozitet, kjo tregon se nuk e beson atë.

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë, thuhet: **"...e bëni detyrën tuaj** (të përditshme) **ta përgënjeshtroni?!"**.[1]

Disa komentues kanë deklaruar se me këtë ajet është synuar vetëm të përgënjeshtrojnë Kur'anin, përgënjeshtrimin e keni përcaktuar si mjet për ushqim dhe jetesën tuaj.[1]

[1] Në bazë të këtij komentimi, këtu fjala *"shukr"* është përjashtuar. Në thelb ka qenë kështu: *"ue texh'alune shukren rizkikum en'nekum tukedhib'bun"*. Ose fjala *"rizk"* është aluzion për fjalën *"shukren rizk"*.

Por komentimi i parë, nga dy komentimet e fundit, duket më i përshtatshëm dhe më sinkron me ajetet pararendëse. Është më në harmoni edhe me shkakun e zbritjes, i cili është transmetuar në lidhje me këto dy ajete. Është më në harmoni dhe përshtatet më shumë me këto, sepse shumë prej komentuesve të Kur'anit, duke filluar që nga Ibn Abasi, kanë transmetuar për të treguar se në një prej udhëtimeve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, shoqëruesit e tij i kaploi një etje e madhe. Profeti u lut dhe më pas zbriti një shi. Të gjithë u ngopën me ujë. Në këtë kohë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dëgjoi një burrë që tha: "Shiu zbriti në saje të lindjes së filan ylli!." (Arabët e kohës së injorancës besonin, që krahas shfaqjes së secilit yll, zbret edhe shiu, prandaj thoshin: "Ky shi është bekim i filan ylli! Ky veprim ishte një prej manifestimeve të idhujtarisë, shirkut dhe adhurimit të yllit.)[2]

Duhet të kemi parasysh faktin se në disa nga këto hadithe, është transmetuar se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i komentonte më pak ajetet, por një prej rasteve që vetë ka interpretuar, një ajet ishte pikërisht ky ajet, ku ka deklaruar: "Synimi i fjalisë: **'...e bëni detyrën tuaj** (të përditshme) **ta përgënjeshtroni...?!'**, është që në vend të falënderimit ndaj riskut tuaj, ju e përgënjeshtroni!".[3]

---

[1] Kundrejt këtyre dy komentimeve nuk ekziston ndonjë gjë e përjashtuar.

[2] Këtë hadith e kanë transmetuar: Tabrisi në "Mexhmaul Bejan"; në "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 163; "Kurtubi", vëll. 9, f. 6398; "Meragij", vëll. 28, f. 152; "Ruhul Meanij", vëll. 27, f. 135, gjithashtu, me pak ndryshime edhe tek ajeti në fjalë.

[3] Tefisri "Derr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 163 dhe tefsiri "Nuruth Thakalejn", vëll. 5, f. 227.

Hulumtime

1- Veçoritë e Kur'anit Fisnik

Prej katër përshkrimeve që u përmendën në ajetet më lart, në lidhje me Kur'anin Fisnik, mund të arrijmë në përfundim, se madhështia e Kur'anit vjen nga madhështia e përmbajtjes së tij, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, nga thellësia e koncepteve dhe shenjtëria e tyre.

Së treti, Kur'anin nuk e prek askush tjetër, përveç të ndershmëve dhe të të mirëve.

Së katërti, Kur'ani e ka të jashtëzakonshëm aspektin edukativ, sepse është zbritur nga ana e Zotit të botëve. Secila nga këto katër çështje më vete ka nevojë për një diskutim të zgjeruar, të trajtuar në përputhje të plotë me kontekstualitetet e ajeteve.

2- Kur'ani dhe pastërtia

Në ajetet e lartpërmendura, lexuam se Kur'anin e prekin vetëm të dëlirët dhe të pastrit. Gjithashtu, thamë se ky ajet është komentuar edhe për kontaktin e dukshëm, edhe për kontaktin shpirtëror. Këto të dyja nuk bien ndesh me njëri–tjetrin, si dhe mund të bashkohen dhe të afrohen në kuptimin e përgjithshëm të ajetit.

Në pjesën e parë, në hadithet e Ehli Bejtit, nga Imam Rizai *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, është transmetuar: *"Kur'anin mos e prek pa pasur abdes e as duke qenë xhunub, i papastër. Kur je i papastër, mos i prek as rreshtat, (ajetet) e tij e mos u mbështet mbi atë, sepse Zoti i Madhëruar ka thënë: 'Atë (Kur'anin) nuk e prek askush, përveç të ndershmëve dhe të pastërve."*[1]

I njëjti kuptim është transmetuar edhe në një hadith tjetër nga Imam Bakiri *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, me pak ndryshim.[2]

Edhe në burimet e Ehli Synetit, gjithashtu, është transmetuar se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka deklaruar: *"Kur'anin nuk duhet ta prekë askush, përveç njeriut të pastër!"*.[3]

Kurse në lidhje me prekjen shpirtërore, është transmetuar, gjithashtu, nga Ibn Abasi se Profeti i Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke interpretuar këta ajete, ka thënë: **"Ky është vërtet një Kur'an i nderuar, në Librin e ruajtur."**.

Leuvhi Mahfudhi tha se është te Zoti në faqe të pastra, kurse për ajetin: **"Atë,** (Kur'anin) **e prekin vetëm të pastrit..."** tha se do të thotë 'të afërmit'.[4]

---

[1] "Uesailu Shiati", vëll. 1, Hadithi 3, f. 269 (në bazë të këtij transmetimi mohimi në ajetin e lartpërmendur është aluzion për mohimi).
[2] "Uesailu Shiati", vëll. 1, Hadithi 5, f. 270.
[3] Këtë hadith e kanë transmetuar nga Profeti Muhammed, në tefsirin "Durr'rrul Menthur", nga Abdullah bin Omeri, Muadh ibn Xhebeli dhe Ibn Hazm Ensari (vëll. 6, f. 162).
[4] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 162.

Kjo çështje mund të argumentohet, edhe me anë të inteligjencës, sepse Kur'ani Fisnik është për udhëzimin e përgjithshëm dhe universal. Por ne e dimë se ka pasur shumë njerëz, të cilët e kanë dëgjuar Kur'anin nga vetë goja e bekuar e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Pra, këtë ujë të kristaltë të së Vërtetesës, e shihnin të rrjedhë nga burimi i Shpalljes së pastër, por, meqenëse ishin të përlyer në paragjykime, kryeneçësi dhe kokëfortësi, nuk kishin përfituar as dobinë më të vogël prej tij. Ndërsa ata që e kishin spastruar sadopak veten e tyre nëpërmjet shpirtit kërkues të së Vërtetës dhe hulumtimit, shkuan pas tij, u udhëzuan.

Si rrjedhojë, sa më i devotshëm dhe më i pastër të jetë njeriu, aq më shumë do të thellohet e do të kuptojë konceptet e tij. Në këtë mënyrë, ajeti vërteton të dy dimensionet, ato fizike dhe ato shpirtërore. Vlen të përmendet fakti se personaliteti i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Imamët e pastër, engjëjt e afërt, janë shembulli më i qartë i të afërmve tek All'llahu. Ata i konceptojnë më mirë se kushdo tjetër të vërtetat e Kur'anit.

Ajetet 83 – 87

فَلَوْلَا إِذَا بَلَغَتِ الْحُلْقُومَ٨٣ وَأَنْتُمْ حِينَئِذٍ تَنْظُرُونَ٨٤ وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْكُمْ وَلَكِنْ لَا تُبْصِرُونَ٨٥ فَلَوْلَا إِنْ كُنْتُمْ غَيْرَ مَدِينِينَ٨٦ تَرْجِعُونَهَا إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ٨٧

“Atëherë, përse kur (dikujt) **i vjen** (shpirti) **në grykë”**

“para syve tuaj”,

“- ndërkohë që Ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk e vini re-“

“përse pra, nëse nuk do të gjykoheni (në Jetën e Përtejme)**”,**

“ju nuk ia ktheni shpirtin atij? Përgjigjuni kësaj, nëse thoni të vërtetën!”

Komentimi

Kur shpirti mbërrin në fyt

Momentet e fundit të agonisë së jetës, janë momente emocionale, që e bëjnë njeriun të meditojë dhe të reflektojë thellë. Në ato çaste, ku çdo gjëje i ka ardhur fundi, njerëzit përreth e vështrojnë njeriun që po vdes me dëshpërim dhe pikëllim, vërejnë se ashtu si qiriu, ai dalëngadalë po shuhet, po i përshëndetet me jetën e kësaj bote. Vdekjen nuk mund ta parandalojë askush dhe asnjë forcë njerëzore!

Në momentin e vdekjes, shfaqet pafuqia dhe paaftësia e plotë e njeriut. Jo vetëm në kohërat e kaluara, por edhe sot, megjithëse ka teknologji dhe mjekësi shumë të përparuar, asgjë nuk mund ta pengojë vdekjen.

Kur'ani Fisnik, për të plotësuar më tej çështjet e Ringjalljes dhe për t'u dhënë përgjigje mohuesve dhe përgënjeshtruesve, ka bërë një përshkrim të qartë për pragun e vdekjes dhe thotë: **"Atëherë, përse kur** (dikujt) **i vjen** (shpirti) **në grykë…"**.

Ju, në këto çaste, vetëm shikoni dhe nuk keni në dorë asnjë gjë: **"para syve tuaj"**.

Auditor, këtu, janë njerëzit përreth personit që ndodhet në çastin e fundit të jetës, sepse, nga njëra, e shikojnë gjendjen e tij

dhe, nga ana tjetër, vërejnë edhe pafuqinë dhe paaftësinë e vet për t'i ardhur në ndihmë atij.

Së treti, vërejnë fuqinë e Zotit mbi çdo gjë. Jeta e vdekja janë në dorën e Tij, ashtu siç e dinë se i njëjti fat i pret edhe ata.

Pas kësaj, shton: **"ndërkohë që Ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk e vini re"**. Ne e dimë më së miri se çfarë ndien njeriu në prag të vdekjes. Çfarë rrëmuje dhe trazire është shkaktuar në thellësi të shpirtit të tij. Ne jemi ata që e lëshojmë urdhrin e marrjes së shpirtit në një kohë të përcaktuar dhe ju vetëm e vrojtoni atë. Ju nuk jeni aspak në dijeni për kalimin e tij nga kjo botë në Botën Tjetër dhe çfarë "stuhish" të rënda dhe të vështira shpirtërore tejkalon ai në këto çaste të vështira.

Si rrjedhojë, synimi i këtij ajeti është afërsia e Zotit me personin që ndodhet në prag të vdekjes, edhe pse disa komentues kanë hamendësuar se synimi është afërsia e engjëjve me personin që ia marrin shpirtin. Por komentimi i parë është më i përshtatshëm me përmbajtjen tërësore të ajetit.

Në të gjitha këto momente të vështira, Zoti i Madhëruar është më afër nesh se kushdo tjetër. Madje Ai është më afër nesh se sa ne me vetveten tonë, edhe pse ne, për shkak të mosdijes sonë, jemi larg Tij. Sqarimi i situatës, në çastet e dhënies së shpirtit, është qartësuar më shumë se në çdo kohë tjetër.

Më pas, për ta theksuar edhe më tej, edhe për ta bërë edhe më të qartë këtë realitet ajetet 86-87 thonë: **"Përse pra, nëse nuk do të gjykoheni** (në Jetën e Përtejme)**, ju nuk ia ktheni shpirtin atij? Përgjigjjuni kësaj, nëse thoni të vërtetën!"**.

Dobësia dhe pafuqia juaj, argumenton se zotëruesi i jetës dhe i vdekjes është dikush tjetër, se shpërblimi dhe ndëshkimi janë në dorën e Tij. Ai është Faktori që jep jetë dhe vdekje.

Fjala *"medinin"* është shumësi i fjalës *"medin"* dhe rrjedh nga rrënja *"dejn"*. Është përdorur me kuptimin: shpërblim. Disa komentues të tjerë, e kanë interpretuar në kuptimin: *"merbubin"*, që do të thotë: "nëse ju nuk jeni nën dorën e tjetrit (robër të Zotit) dhe e keni në dorë qenien tuaj, atëherë rikthejeni atë.".

Edhe kjo është një dëshmi dhe argument se jo vetëm njerëzit, por çdo gjë që gjendet në tokë e në qiej dhe në gjithë ç'ka mes tyre, janë nën sundimin e Zotit të Madhëruar.

Dy hulumtime

1- Momenti i pafuqisë së tiranëve

Këto ajete kanë për qëllim të tregojnë se Zoti i Madhëruar është i Plotfuqishëm mbi jetën dhe mbi vdekjen. Jeta dhe vdekja krijojnë një urë lidhëse me Ringjalljen. Përzgjedhja e çastit të agonisë dhe të vdekjes, është shfaqja e dobësisë dhe e pafuqisë së plotë të njeriut në këto çaste, megjithëse deri atëherë kishte pretenduar se ishte i fuqishëm.

Që kuptimi i këtij ajeti të bëhet edhe më i qartë, tregohet gjendja e disa mohuesve dhe tiranëve, të cilëve, çasti i vdekjes u arriti në kulmin e pushtetit dhe të fuqisë së tyre dhe nuk qenë të zotët të bënin ndonjë gjë. Mesudiu në "Muruxhu Dheheb", në

jetëshkrimin e Me'munit dhe në luftën kundër ushtrisë së Bizantit, ka përmendur këtë histori. Kur po kthehej nga sheshi i luftës, ai arriti te burimi Bedidun, në vendin e quajtur Kashire dhe u ndal për të pushuar. Kënaqësia, freskia, uji i ftohtë i burimit, si dhe lulëzimi dhe gjelbërimi i asaj zone e mahnitën, ndaj dha urdhër që të presin disa degë nga pemët e asaj zone dhe të ndërtojnë një urë mbi burim dhe mbi të, të bëjnë një çati prej druri dhe prej degëve të pemëve. Ai pushoi aty, ndërkohë që uji kalonte poshtë këmbëve të tij. Uji ishte aq i kaltër, saqë mund të shihej në fund të tij edhe gjëja më e vogël. Edhe uji i atij burimi ishte aq i ftohtë, sa askush nuk mund të mbante duart në ujë.

Papritur u shfaq në ato ujëra një peshk i madh sa bërryli, thuajse i tëri ishte prej argjendi.

Me'muni tha se atij që do ta kapte atë peshk, do t'i dhuronte një shpatë. Disa shërbëtorë zgjatën duart dhe e kapën peshkun dhe ia sollën Me'munit. Sapo e lanë aty, peshku kërceu nga dora e shërbëtorëve, ra në ujë dhe shumë shpejt u zhyt, duke i lagur rrobat e spërkatur fytyrën dhe supet Me'munit. Shërbëtori sërish u hodh në ujë, e kapi peshkun dhe e vendosi përpara Me'munit, tashmë, të mbështjellë me një copë. Ndërkohë që peshku po lëvizte akoma, Me'muni tha: *"Tani duhet ta skuqni atë dhe ta përgatisni për ushqim."*.

Por, papritur, gjymtyrët e trupit të tij u mpinë dhe nuk i lëvizte dot. Megjithëse e mbuluan me mbulesa të ndryshme, ai akoma kishte dridhje në trup dhe bërtiste: *"Ftohtë! Ftohtë!"*. Shpejt ndezën zjarr, por ai sërish vazhdonte të thërriste: *"Kam ftohtë! Kam ftohtë!"*.

Në këtë kohë, ia sollën peshkun e skuqur, por ai nuk ishte në gjendje as ta nuhaste atë. Gjendja e tij u përkeqësua edhe më shumë, prandaj kërkoi ndihmë nga Bakhtejshu dhe Ibn Mesevije, që të dy ishin mjekë oborrtarë të Me'munit. Me'muni ishte në agoni. Dy mjekët ia morën dorën dhe panë që pulsi i tij kishte çrregullime të mëdha. Kjo tregonte se kishte çrregullime të mëdha në shëndetin e tij. Tani, atij i kishte filluar një djersitje dhe djersa ishte ngjitëse si vaji. Dy mjekët mbeten të habitur nga gjendja e tij dhe thanë: "*Një gjë të tillë, asnjëherë nuk e kemi lexuar në librat e mjekësisë dhe as e kemi parë në praktikë. Është e qartë se këto janë shenja që tregojnë afrimin e vdekjes së tij.*".

Gjendja e Me'munit u përkeqësua edhe më shumë. Ai tha: "*Më dërgoni në një pikë të lartë me pamje nga ushtria ime, në mënyrë që të vlerësoj gjendjen e tyre.*".

Pasi u bë natë dhe nga lartësia, në të cilën e çuan, soditi tendat, ushtritë e veta dhe zjarret e shumta që ishin ndezur tha: "*O Zot, sundimi Yt, asnjëherë nuk rrënohet dhe nuk humbet. Ndihmoje atë, sundimi i të cilit është drejt rënies.*".

Më pas e sollën në shtratin e tij. Aty qëndroi një person për t'ia kujtuar shehadetin, meqenëse nuk dëgjonte mirë nga veshët. Burri pranë tij e ngriti zërin. Ibn Mesevije tha: "*Mos bërtit! Betohem në Zot, se ai në këtë moment është mes Zotit dhe Maniheut!*

Me'muni hapi sytë. Gropëzat e syve të tij ishin larguar nga njëra–tjetra dhe ishin skuqur shumë. Ai deshi ta godiste Ibn

Mesevijen, por nuk arriti, dëshiroi të fliste ashpër, por ishte i pafuqishëm. Në atë çast dha shpirt.”.[1]

Ka mendime se sëmundja e tij të ishte si rrjedhim i moshës. Disa historianë mendojnë se kushdo që pinte ujë nga ai burim, sëmurej.

Të tjerë mendojnë se peshku kishte një lloj lëngu që shkaktonte sëmundje. Sidoqoftë, gjithë ai sundim dhe mbretëri e madhe, u shua vetëm për disa çaste dhe heroi i madh i fushave të betejës u gjunjëzua përpara vdekjes.

Askush nga të pranishmit nuk pati fuqinë të hidhte një hap të vetëm për t’i ardhur në ndihmë, ose së paku ta çonte atë në banesën e tij kryesore. Historia na tregon shumë ngjarje të tilla mësimdhënëse.

2- Vallë, a ndodh gradualisht vdekja?

Përdorimi i shprehjes: **“i vjen** (shpirti) **në grykë”**, e cila u përmend në ajetin e mësipërm, u referohet momenteve të fundit të jetës, çasteve të agonisë. Kjo shprehje, mbase përdoret për të treguar se pjesa dërmuese e gjymtyrëve të trupit, si për shembull, duart dhe këmbët, në çastin e vdekjes, pushojnë më shpejt se gjymtyrët e tjera të trupit dhe fyti është gjymtyra e fundit, i cili pushon së punuari.

[1] “Muruxhu Dheheb”, ngjashëm me transmetimin e “Sefinetul Bihar”, vëll. 1, f. 44.

Gjithashtu, edhe në ajetin 26 të sures "El Kijame", lexojmë: **"Jo dhe Jo! Por kur të arrijë** (shpirti) **në gropë të fytit,** (të gjoksit dhe termi *'terkuh'* nënkupton kockat, të cilat e rrethojnë fytin)**."**

Ajetet 88 – 96

فَأَمَّا إِنْ كَانَ مِنَ الْمُقَرَّبِينَ٨٨ فَرَوْحٌ وَرَيْحَانٌ وَجَنَّتُ نَعِيمٍ٨٩ وَأَمَّا إِنْ كَانَ مِنْ أَصْحَابِ الْيَمِينِ٩٠ فَسَلَامٌ لَكَ مِنْ أَصْحَابِ الْيَمِينِ٩١ وَأَمَّا إِنْ

كَانَ مِنَ الْمُكَذِّبِينَ الضَّالِّينَ٩٢ فَنُزُلٌ مِنْ حَمِيمٍ٩٣ وَتَصْلِيَةُ جَحِيمٍ٩٤ إِنَّ هَذَا لَهُوَ حَقُّ الْيَقِينِ٩٥ فَسَبِّحْ بِاسْمِ رَبِّكَ الْعَظِيمِ٩٦

"Kështu, nëse ai (në agoni) **është nga ata që janë të afërt** (me All'llahun)**",**

"do të ketë prehje, kënaqësi dhe dhunti të Xhennetit."

"E, nëse është nga njerëzit e së djathtës",

"(ai do të përshëndetet) **'Paqe për ty' nga njerëzit e së djathtës."**

"Por, nëse (ai në agoni) **është nga përgënjeshtruesit e humbur",**

"ai do të gostitet me ujë të valuar"

"dhe do të përcëllohet në Zjarrin e flakëruar (të Xhehennemit)**."**

"Pa dyshim, kjo është e Vërteta e sigurt."

"Andaj lavdëroje Emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!"

Komentimi

E ardhmja e punëmirëve dhe e të këqijve

Këto ajete janë përmbledhje e ajeteve të para dhe ajeteve të fundit të sures. Ato ilustrojnë ndryshimet në gjendjen e njerëzve

në prag të vdekjes. Tregojnë se disa njerëz largohen të qetë kjo botë dhe disa të tjerë largohen plot ankth dhe panik, sikur të shikojnë nga larg zjarrin e Xhehennemit.

Ajetet 88-89 thonë: **"Kështu, nëse ai** (në agoni) **është nga ata që janë të afërt** (me All'llahun)**, do të ketë prehje, kënaqësi dhe dhunti të Xhennetit."**.

Termi *"rauh"*, ashtu siç janë shprehur edhe leksikografët, në thelb, është përdorur me kuptimin: *"teneffus"* – *"marrja e frymës"*; fjala *"rejhan"* është përdorur me kuptimin e një gjëje, ose bime me erë të këndshme.

Më pas, termi *"rauh"* është përdorur për të treguar çdo gjë që është burim i mirëqenies dhe i rehatisë, ashtu siç termi *"rejhan"* përdoret për çdo lloj begatie dhe risku të mirë dhe të freskët. Prandaj *"rauhi"* dhe *"rejhani"* hyjnor përfshijnë të gjitha mjetet e rehatisë, qetësinë e njeriut, si dhe çdo lloj begatie dhe mirësie hyjnore.

Shprehur ndryshe, mund të themi se fjala *"rauh"* përdoret për të treguar të gjitha çështjet që njeriun e lirojnë nga pakënaqësitë, e bëjnë të marrë frymë lehtësisht; kurse fjala *"rejhan"* përdoret për të treguar begatitë dhe mirësitë, të cilat i kthehen njeriut pas largimit të fatkeqësive.

Komentuesit islamë kanë përmendur më shumë se dhjetë komentime në lidhje me këto dy fjalë, prandaj ka dhe më shumë se dhjetë interpretime.

Ndonjëherë kanë pohuar se fjala *"rauh"* është përdorur me kuptimin: mëshirë; fjala *"rejhan"* përdoret me kuptimin gjithëpërfshirës, ku futen dinjiteti dhe virtyti.

Ndonjëherë tjetër kanë deklaruar se fjala *"rauh"* është përdorur për të treguar shpëtimin nga zjarri i Xhehennemit, kurse fjala *"rejhan"* është përdorur për të treguar hyrjen në Xhennet.

Ndonjëherë kanë thënë se fjala *"rauh"* konsiderohet qetësia në varr, kurse fjala *"rejhan"* qetësia në Xhennet.

Ndonjëherë, fjalën *"rauhin"* e kanë përdorur për të treguar *"keshefel kerub" - "largimin e shqetësimeve dhe të brengave"*, kurse fjalën *"rejhan"* e kanë përdorur me kuptimin: *"gufranel dhenub" – "falje e mëkateve"*.

Ndonjëherë, fjalën *"rauh"* e kanë interpretuar në kuptimin: *"ennadharu ila uexhilah" – "shikimi drejt fytyrës së Zotit"*; kurse fjalën *"rejhan"* në kuptimin: *"istemai kelamullah" – "dëgjimi i fjalës së Zotit dhe të ngjashme me këto"*.

Por, ashtu siç e trajtuam më lart, këto janë vetëm disa shembuj nga kuptimi tërësor dhe gjithëpërfshirës, që përmendëm në komentimin e ajetit.

Duhet të kemi parasysh faktin se pas përmendjes së fjalës *"rauh" - "prehje"* dhe *"rejhan" - "kënaqësi"*, Zoti ka diskutuar në lidhje me *"Xhennetun naim" - "Xhennetin e begatshëm"*. Ky përdorim ka mundësi të jetë përdorur për të treguar se Xhenneti i begatë i takon besimtarit në prag të vdekjes, në varr dhe në Botën e Ndërmjetme (Berzakh), kurse Xhenneti në Ahiret, pra, në Jetën pas vdekjes, ashtu siç është treguar edhe në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*: "Por në qoftë se është nga të afërmit tek All'llahu. *Rauh* dhe *Rejhan* i takon atij, që do të thotë

varrit, kurse fraza: 'Xhenneti plot begati është për atë', do të thotë se është për në Ahiret.".[1]

Ajeti 90 shton: **"E, nëse është nga njerëzit e së djathtës"**, (po nga ato gra dhe burra të drejtë, të cilët Librin e veprave të tyre e marrin në dorën e djathtë në shenjë fitoreje dhe pranimi.), **"**(ai do të përshëndetet) **'Paqe për ty' nga njerëzit e së djathtës."**.

Në këtë mënyrë, engjëjt e marrjes së shpirtit, në prag të kalimit nga kjo botë në Botën Tjetër, do të përshëndeten nga shokët e vet, ashtu siç e lexuam edhe në ajetin 26 të sures "El Uakia", lidhur me përshkrimin e banorëve të Xhennetit: **"**(ai do të përshëndetet) **'Paqe për ty' nga njerëzit e së djathtës."**.

Në lidhje me komentimin e këtij ajeti, ekziston edhe një mundësi tjetër që selami të jetë nga ana e engjëjve që ia thonë atij: "Selami qoftë mbi ty, o ti njeri, që je nga njerëzit e të djathtës...", që do të thotë se ty të mjafton krenaria që je në radhët e tyre.[2]

Gjithashtu, edhe në ajete të tjera kur'anore është përmendur selami i engjëjve ndaj besimtarëve në prag të vdekjes, si për shembull në ajetin 32 të sures "En Nahl": **"...të cilëvet duke qenë të pastër, engjëjt ua marrin shpirtin, duke u thënë: 'selamun alejkum, gjetët shpëtimin, hyni në Xhennet, për hir të asaj që vepruat.'"**.

Sidoqoftë, fjala *"selam"* është një fjalë shumë domethënëse, qoftë kur thuhet nga ana e engjëjve, qoftë kur thuhet nga ana e njerëzve të së djathtës. Është një selam, një paqe, e cila është

[1] Tefsire "Nuru Thakalejn", vëll. 5, f. 228, Hadithet 103-104.

[2] Andaj në ajet ekzistojnë dy përjashtime: *"jukalu lehu selamun leke inneke min es'habil jemin"*. Në bazë të komentimit të parë, ekziston vetëm një përjashtim, i cili është *"jukalu lehu"*.

shenjë e shpirtit, e lehtësimit, e rejhanit, e prehjes, e kënaqësisë, si dhe e çdo lloj shëndeti, qetësie dhe begatie.[1]

Gjithashtu, është e nevojshme të përmendim edhe faktin që përdorimi i shprehjes **"njerëzit e të djathtës"**, (do të thotë se njerëzit që Librin e veprave të tyre do ta marrin me dorë të djathtë), është sepse njeriu, zakonisht, veprat e rëndësishme dhe mjeshtërore i kryen me dorën e djathtë, prandaj dora e djathtë është quajtur si një simbol i forcës, i aftësisë, i fuqisë dhe i fitores.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në komentimin që i bëri këtij ajeti, ka deklaruar: "Njerëzit e të djathtës janë shiat tanë dhe shokët, ndjekësit tanë.".[2]

Më pas përmend grupin e tretë, të cilët, në fillim të sures i etiketoi si **"njerëzit e të majtës"**. Ai thotë: **"Por, nëse** (ai në agoni) **është nga përgënjeshtruesit e humbur, ai do të gostitet me ujë të valuar dhe do të përcëllohet në Zjarrin e flakëruar** (të Xhehennemit)**."**.

Disa komentues thonë se njerëzit, kur janë në prag të vdekjes, i nuhasin dënimet e para hyjnore. Ata ndiejnë edhe shijen e hidhur të ndëshkimeve të Kiametit, në Berzah, pra, në Jetën e varrit, duke pasur parasysh faktin që bëhet fjalë për gjendjen e njeriut në prag të vdekjes. Shprehja *"nuzulum min hamim"* është shenjë për dënimin e Jetës në varr, kurse shprehja *"teslijehu*

[1] Fjala *"selam"* do t'u thuhet banorëve të Xhennetit. Në lidhje me përdorimin e kësaj fjale, për më shumë, kemi diskutuar në vëll.n 18, sure "Ja Sin", ajeti 58, f. 420.
[2] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 285.

xhahim" është tregues për dënimin në Kiamet. Këto domethënie janë transmetuar në hadithe të shumta nga ana e Ehli Bejtit.[1]

Shprehjet *"mukedh'dhibin"* dhe *"dhal'lin"* janë përmendur të dyja së bashku. Shprehja e parë është përdorur si tregues për përgënjeshtrimin e Kiametit dhe Zotit Një dhe të Vetëm, për përgënjeshtrimin e Profetësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse shprehja e dytë është tregues për njerëzit që kanë devijuar nga Rruga e Drejtë dhe e vërtetë.

Kjo shprehje, përveç kësaj që u tha më sipër, është përdorur edhe për të theksuar se ekzistojnë plot njerëz të shtypur e të paditur në mesin e të devijuarve, të cilët nuk kanë ndonjë inat apo kryeneçësi me të vërtetën.

Disa komentues kanë shprehur mendimin se ky target njerëzish të përfshihen në Mëshirën e Zotit, kurse përgënjeshtruesit kryeneçë dhe kokëfortë do të kenë një fat tepër të vështirë, siç u sqarua më sipër.

Fjala *"hamim"* është përdorur edhe për ujin e nxehtë dhe të valuar, edhe për erërat e ngrohta dhe helmuese. Fjala *"taslije"* rrjedh nga rrënja *"salj"* dhe është përdorë me kuptimin e djegies në zjarr, e futjes në zjarr. Fjala *"taslije"* ka kuptime të shumta, por zakonisht përdoret vetëm në kuptimin e djegies.

Në përfundim të këtij diskutimi, ajeti shton: **"Pa dyshim, kjo është e Vërteta e sigurt."**.

[1] "Nuru Thakalejn", vëll. 5, f. 229.

Meqenëse është kështu, atëherë lavdërojeni Emrin e Zotit tuaj të Madhëruar: **"Andaj lavdëroje Emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!"**.

Në mesin e komentuesve, është i njohur përdorimi i fjalës *"hakkul jekin"* - *"e vërteta e sigurt"*, si fjalë me konotacion saktësues, sqarues, pra, se ajo që u tha në këto tri grupe: "*Të të afërmeve"*, *"Njerëzve të së djathtës"* dhe *"Përgënjeshtruesve"*, është e vërtetë dhe reale.

Meqenëse është pranuar se siguria ka disa faza, ekziston edhe klasifikimi i fazave të së vërtetës. Faza më e lartë e saj është "e vërteta e sigurt", pra, e vërteta realisht e vërtetë, e plotë, larg çdo lloj dyshimi dhe hamendësimi.

Nga ajo që tha, u qartësua se pjesëza *"hadha"* - *"kjo"*, në ajet, është përdorur për të saktësuar gjendjen e tri grupeve që u përmendën. Disa komentues të tjerë kanë supozuar se pjesëza *"kjo"* është përdorur për të saktësuar gjithë përmbajtjen e sures "El Uakia", ose të gjithë Kur'anin. Interpretimi i parë duket më i përshtatshëm.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se përdorimi i shprehjes *"feseb'bih"* - *"Lavdëroje Zotin tënd"*, mund të tregojë se ajo që u tha në lidhje me këto tri grupe, është vetë drejtësia. Si rrjedhojë, Zotin tënd konsideroje të pastër nga çdo lloj papastërtie dhe padrejtësie. Por mund të përdoret edhe për të sqaruar se, në qoftë se nuk dëshiron të përfshihesh në fatin e grupit të tretë, atëherë duhet të jemi të pastër nga çdo lloj shirku, nga çdo politeizëm dhe padrejtësi, të cilat janë baza e mohimit të Ringjalljes.

Shumë komentues të Kur'anit, lidhur me ajetin e fundit, kanë deklaruar se pas zbritjes së Kur'anit, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Atë përcaktojini si pjesë të rukusë suaj. Pra, në ruku thoni: 'Subhane rab'bijel adhim'."*.

Kur zbriti ajeti: ***"Sebhih ismi rabbike el eala",*** Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, tha: *"Këtë bëjeni pjesë të sexhdes suaj, pra, në sexhde thoni: 'Subhane rabbijel e'ala'."*.

Edhe në komentimin e ajetit 74 të kësaj sureje, gjithashtu, transmetuam disa hadithe të ngjashme nga disa prej komentuesve të Kur'anit.

Hulumtim

Bota e Berzakhut

Ajetet e lartpërmendura, flasin dhe tregojnë për Botën e Berzakhut, apo siç quhet ndryshe Jeta e varrit, sepse (ashtu siç e trajtuam edhe në komentimin e këtyre ajeteve), në prag të vdekjes, në kohën kur njeriu përgatitet për kalimin nga kjo botë në Botën Tjetër, do të përballet me njërën nga situatat që do të përmendim në vijim: Begatitë dhe mirësitë hyjnore, kënaqësia dhe prehja, ose ndëshkimet dhe dënimet trishtuese dhe dëshmitë ekzistuese në ajete, tregojnë se një pjesë e këtyre situatave kanë të

bëjnë me Kiametin, kurse pjesa tjetër ka të bëjë me varrin dhe Jetën pas vdekjes. Vetë kjo konsiderohet një argument tjetër se ekziston Bota e Ndërmjetme.

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: "*Gjëja e parë me të cilën do të përgëzohet besimtari gjatë vdekjes, është kënaqësia, prehja dhe Xhenneti i begatshëm. Gjëja e parë me të cilën do të përgëzohet besimtari në varrin e tij, janë fjalët që do t'i thuhen atij: 'Të përgëzojmë me kënaqësinë e Zotit tënd! Të urojmë mirëseardhjen në Xhennet! Zoti i Madhëruar do t'i falë të gjithë njerëzit që të kanë përcjellë deri në varr dhe ka miratuar dëshminë e tyre në lidhje me ty, si dhe ka pranuar lutjen e tyre për faljen tënde.'*".[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, thuhet: "*Në kohën që njeriu ndodhet në ditën e fundit të kësaj bote dhe në ditën e parë të ditëve të Ahiretit, i shfaqen pasuria, fëmijët, dhe veprat e tij. Ai u hedh një vështrim veprave të veta dhe thotë: 'Unë jam treguar i pakujdesshëm ndaj jush, edhe pse keni qenë të rënda mbi supet e mia. Tani çfarë lajmi keni për mua?'*" .

Veprat e tij thonë: "*Ne do të jemi shoqërueset e tua në varr dhe në Ringjallje, në mënyrë që ne dhe ti të dalim së bashku përpara Zotit tënd. Në qoftë se ai që po vdes, është nga njerëzit e dashur të Zotit, vepra e tij do të shfaqet në formën e njeriut që mban aromën më të këndshme, me fytyrën më të bukur dhe me rrobat më të hijshme dhe do t'i thotë: 'Të përgëzoj me qetësinë, begatinë dhe Xhennetin e begatshëm! Je i mirëseardhur.'*"

Njeriu do t'i drejtohet: "*Kush je ti?*"

[1] Tefisri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 166.

Ajo do të përgjigjet: *"Unë jam vepra jote e drejtë, që vij nga bota tokësore dhe do të jem shoqëruesja jote drejt Xhennetit."*.[1]

Në lidhje me Botën e Berzakhut dhe Jetës së varrit, kemi diskutuar më gjerësisht në ajetin 100 të sures "El Muminun".[2]

O All'llah! Të lutemi të na përcaktosh ne në radhët e të afërmeve tek Ti dhe të njerëzve të së djathtës, te njerëzit e dashur për Ty! Në prag të vdekjes, të lutemi, na përfshi në kënaqësinë, prehjen dhe Xhennetin e begatshëm!

O Zot! Dënimi i Ringjalljes Tënde është një dënim i madh dhe atë askush nuk mund ta përballojë dhe ta durojë. Edhe shpërblimet e Tua të pafundme janë shpërblime të mëdha dhe askush nuk mund t'i meritojë ato me anë të veprës së vet. Kapitali ynë në Atë Ditë është vetëm mëshira dhe mirësia Jote.

O Zot! Të lutemi, na zgjo ne, para se të na vijë Kiameti i madh dhe para se të na kaplojë vdekja, që është dhe Kiameti i vogël, dëshirën për ta përgatitur veten tonë për këtë udhëtim të gjatë që kemi përpara!

[1] Tefsiri "Nuru Thakalejn", vëll. 5, Hadithi 106, f. 228.
[2] Po ky tefsir, vëll. 14, f. 314-324.

Sure "El Hadid"

Zbritur në Medine , 29 Ajete

Përmbajtja e sures "El Hadid"

Kjo sure ka zbritur në Medine. Të gjithë dijetarët islamë kanë miratuar njëzëri se kjo është një sure medinase. Natyrisht që

edhe kjo sure mbart në vete veçoritë e sureve medinase dhe, përveç konsolidimit të themeleve ideologjike, diskuton edhe në lidhje me urdhëresat e shumta praktike, sidomos të lëmit social dhe të pushtetit. Me vullnetin e Zotit, shembujt në lidhje me këtë temë, do t'i përmendim në ajetet 10, 11 dhe 25 të kësaj sureje.

Përmbajtjen e kësaj sureje mund ta ndajmë në shtatë pjesë:

1- Ajetet e para të sures diskutojnë në mënyrë të plotë dhe mbresëlënëse rreth monoteizmit dhe cilësive të Zotit. Në këto ajete janë pasqyruar afro njëzet cilësi prej cilësive të Zotit. Përvetësimi i tyre, e vë njeriun në nivelin e lartë të njohjes hyjnore.

2- Në pjesën e dytë, disk utohet për madhështinë e Kur'anit, për këtë Dritë Hyjnore, që ndriçoi në errësirën e politeizmit dhe të paganizmit.

3- Në pjesën e tretë, flitet rreth gjendjes së besimtarëve dhe të hipokritëve në Kiamet. Grupi i parë, nën dritën e besimit, do të marrë rrugën e vet drejt Xhennetit, kurse grupi i dytë, do të mbetet në errësirën e shirkut dhe të politeizmit.

Në këtë sure, do të do të pasqyrohen më së miri tri parimet themelore islame: monoteizmi, Profetësia dhe Ringjallja.

4- Në pjesën tjetër, është pasqyruar thirrja në besim dhe dalja nga politeizmi, si dhe fati i disa popujve të hershëm.

5- Pjesa e rëndësishme e kësaj sureje, trajton çështjen e hipokrizisë në Rrugën e Zotit, përforcimin e themeleve të orvatjes në Rrugën e Zotit, si dhe pavlefshmërinë e pasurisë së kësaj bote.

6- Në një pjesë të shkurtër, por shumë elokuente dhe të arsyeshme, është diskutuar për drejtësinë shoqërore, që është një prej qëllimeve të rëndësishme të Profetëve.

7- Dhe në fund, është kritikuar çështja e murgërisë dhe e izolimit prej shoqërisë, si dhe është theksuar kundërshtimi i Islamit përmes saj (me të).

Sigurisht, mes këtyre diskutimeve dhe çështjeve, janë përmendur edhe tema të tjera të përshtatshme, të cilat, në përfundim, kanë formuar një tërësi ndërgjegjësuese dhe udhëzuese.

Ndërkaq, emërtimi i kësaj sureje me emrin "El Hadid" është bërë se ky emër është përmendur në ajetin 25 të saj.

Mirësitë e leximit të sures "El Hadid"

Në transmetimet islame, janë përmendur pika interesante rreth mirësive të leximit të kësaj sureje. Sigurisht që bëhet fjalë për një lexim të shoqëruar me meditim, reflektim dhe praktikim.

Në një hadith, të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Ai që e lexon suren 'El Hadid', do të jetë në mesin e atyre njerëzve që kanë besuar në Zot dhe në të Dërguarin e Tij."*[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar po nga Profeti i Islamit, thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, para gjumit, lexonte "Museb'bihat", (suret që fillojnë me "seb'behe lil'lah" ose "juseb'bihu lil'lah") të cilat janë: sure "El Hadid", "Hashr", "Saff", "Xhumua" dhe surja

[1] Tefsiri "Mexhmeul Bejan", fillimi i sures "El Hadid".

"Tegabun") thoshte: "*Në këto sure ekziston një ajet, i cili është më i preferuar se njëmijë ajete të tjera!*".[1]

Sigurisht, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk e ka përcaktuar këtë ajet. Edhe pse nuk kemi në dorë ndonjë argument të qartë në lidhje me këtë interpretim, disa komentues të Kur'anit kanë sugjeruar se ai ajet mund të jetë ajeti i fundit i sures "El Hashr".[2]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Ai që i lexon museb'bihat (pesë suret e lartpërmendura), nuk do të vdesë, derisa të mos e ketë konceptuar Imam Mehdiun (All'llahut e shpejtoftë ardhjen e tij!). Në qoftë se vdes para kësaj kohe, në Botën Tjetër do të jetë në afërsi të Profetit të Zotit."*.[3]

Ajetet 1 - 3

[1] Po aty, duke shtuar tefsirin "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 170.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fillimi i sures "El Hadid".
[3] "Usulul Kafij", vëll. 2, Hadithi 3, f. 620.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ١ لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ يُحْيِي وَيُمِيتُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ٢ هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ٣

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

"All'llahun e lartëson çdo gjë që është në qiej dhe në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti."

"Atij i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Ai jep jetë e vdekje dhe është i fuqishëm për çdo gjë."

"Ai është i Pari dhe i Mbrami, i Dukshmi (me argumente) **dhe i Padukshmi** (me sy)**. Ai është i Dijshëm për çdo gjë!"**

Komentimi

Ajetet e mendjemprehtëve që thellohen në mendime

Ashtu siç e thamë, kjo sure fillon me një diskutim rreth monoteizmit, që përfshin pothuajse "njëzet cilësi" prej cilësive të Zotit. Njohja e këtyre cilësive, e lartëson nivelin e dijes njerëzore dhe e bën njeriun, që ta njohë Esencën e Stërpatstër të Tij. Secila nga këto cilësi, shpalos një pjesë prej tipareve të Hijeshisë dhe Madhërisë së All'llahut. Dijetarët vijojnë të zbulojnë të vërteta të reja rreth tyre.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Ali bin Hysejni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Kur e pyetën atë rreth monoteizmit, ai u përgjigj: 'Zoti i Madhëruar ishte në dijeni që në fund të kohës do të vijnë popuj, të cilët do të thellohen dhe do të zhbirojnë të gjitha çështjet, prandaj dhe zbriti suren 'Ilhas' dhe ajetet e para të sures 'El Hadid', deri te ajeti: 'alimun bi dhatis sudur'. Pra, çdokush që kërkon përtej asaj, është i humbur."*.[1]

Ky hadith, përmes këtyre ajeteve, na tregon se cilët janë të eturit për dije.

Ajeti i parë i kësaj sureje fillon me Lartësimin dhe Madhërimin e Zotit. Ai thotë: **"All'llahun e lartëson çdo gjë që është në qiej dhe në Tokë."**.

Surja e kaluar përfundoi me urdhrin e Lartësimit të Zotit dhe kjo sure, gjithashtu, fillon me Lartësimin e Zotit. Është shumë impresionuese, që në, suret "Musebbihat", (suret që fillojnë me "Lavdërimin e Zotit", në tri raste lavdërimi është përmendur në

[1] Tefsiri "Usulul Kafij", në bazë të transmetimit të tefsirit "Nuru Thakalejn", vëll. 5, f. 231.

kohën e kryer të thjeshtë, "seb'behe" (në suret "Hadid", "Hashr" dhe "Saff") dhe në dy raste të tjera, është përmendur në kohën e tashme "juseb'bihu" (në suret "Xhumua" dhe "Tegabun"). Ky ndryshim në shprehje, mund të tregojë se gjallesat e kësaj bote gjithnjë e kanë lavdëruar dhe e lavdërojnë pastërtinë e Zotit, në të kaluarën, në tashmen dhe në të ardhmen.

E vërteta e lavdërimit dhe e lartësimit, njëherësh, është edhe mohimi i çdo lloj të mete dhe mangësie.[1] Dëshmia e të gjitha krijesave të rruzullit tokësor, për pastërtinë e Zotit të Madhëruar, për Qenien e Tij, pa asnjë të metë e mangësi, është e lidhur ngushtë me një sistem të plotë vlerësimi, mbështetur në një llogari të përsosur, në urtësi, në mrekulli dhe mahnitje. Kjo bën që, të gjithë të kuptojnë të vërtetën dhe ta lartësojnë Atë. Të gjithë të thërrasin me sa fuqi kanë: "Krijuesi ynë ka një fuqi të pafundme dhe urtësia e Tij është e pakufizuar!".

Ajeti mbyllet me shprehjen: **"Ai është i Plotfuqishmi, i Urti."**.

Të gjitha grimcat që ekzistojnë në këtë botë, mund të kenë një lloj ndërgjegje dhe vetëdije të tillë, që në "mënyrën e tyre dhe në botën e tyre" ta lartësojnë dhe ta lavdërojnë Zotin e Madhëruar. Për arsye të dijes sonë të kufizuar, ne nuk arrijmë të jemi në dijeni për ato, nuk arrijmë ta kuptojmë "botën" e tyre.

Për më shumë informacion, në lidhje me lartësimin dhe lavdërimin e Zotit, nga ana e të gjitha krijesave dhe gjallesave, shih ajetin 44 të sures "El Isra".

---

[1] Fjala *"tesbih"* rrjedh nga rrënja *"sebh"* dhe është në kuptimin e lëvizjes së shpejtë në ujë dhe në hapësirë; fjala *"tesbih"*, gjithashtu, është një lëvizje e shpejtë në rrugën e adhurimit të Zotit. (Ragib në "Mufredat")

Gjithashtu, nuk duhet lënë pa përmendur edhe fakti, se pjesëza *"ma"*, në fjalinë: *"seb'behe lil'lahi ma fis'semauat"*, përdoret me nuancat kuptimore të gjithëpërfshirjes, pra, qartëson se fjalia e mësipërme përdoret me një kuptim të gjerë dhe gjithëpërfshirës. Kuptimi i saj përfshin të gjitha krijesat e botës, përfshirë këtu njerëzit, frymorët dhe jo frymorët.

Pasi përmend dy cilësi prej cilësive të Esencës së Stërpastër të Zotit, që janë "Plotfuqia" dhe "Urtësia", Kur'ani diskuton në lidhje me "Zotërimin, drejtimin, udhëheqjen dhe sundimin e Tij në botën ekzistuese", që është rrjedhojë e fuqisë dhe e urtësisë së Tij: **"Atij i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Ai jep jetë e vdekje dhe është i fuqishëm për çdo gjë."**.

Zotërimi i gjithë universit nga ana e Zotit të Madhëruar, nuk është një zotërim konvencional dhe virtual, por është një sundim i vërtetë dhe i plotë! Kjo do të thotë se Zoti i Madhëruar është i Plotfuqishëm mbi çdo gjë dhe e gjithë bota është në dorën e fuqisë së Tij dhe nën vullnetin dhe urdhrin e Tij, është në vazhdimësi të asaj që është diskutuar në lidhje me ngjalljen, vdekjen dhe fuqinë për çdo gjë.

Kështu, në këto dy ajete, u pasqyruan gjashtë nga cilësitë e Zotit.

Fjala *"izzet"* - *"fuqia"*, përdoret më shumë, kur tregohet se është shpartalluar ai që mbrohet, kurse fjala *"kudret"* - *"forca"*, përdoret për të treguar krijimin e mjeteve të duhura për të ushtruar pushtetin. Të dyja këto fjalë konsiderohen si dy cilësime të ndryshme, edhe pse të dyja, në thelb, kanë forcën, fuqinë.

Çështja e dhënies së jetës dhe e vdekjes, është diskutuar në shumë ajete kur'anore. Këto dy çështje janë të ndërlikuara, plot

enigma dhe mistere. Këto çështje nuk janë të qarta për asnjeri. Asnjë njeri nuk është në dijeni për jetën dhe vdekjen, megjithëse edhe jeta, edhe vdekja janë kaq pranë nesh! Sekreti rreth tyre mbetet më i fshehtë se gjithçka tjetër.

Duhet të kemi parasysh faktin se fjalia: **"Ai jep jetë e vdekje"**, është në kohën e tashme. Përdorimi i kësaj kohe foljore tregon se këto procese, jeta dhe vdekja, ekzistojnë përgjatë gjithë kohërave dhe mbajnë lidhje me përditshmërinë e çdo kohe. Përdorimi i koncepteve "jetë" dhe "vdekje" nuk kufizohet vetëm me jetën dhe vdekjen e njohur në këtë botë. Përkundrazi, këto koncepte përfshijnë çdo lloj jete dhe çdo lloj vdekje, duke u nisur nga bota e engjëjve deri te gjallesat e tjera të gjalla, kafshët, bimët dhe jo vetëm në jetën e kësaj bote, por përfshin edhe Jetën në varr, edhe Ringjalljen. Po! Jeta dhe vdekja, në të gjitha format e tyre, janë në dorën e fuqisë së All'llahut.

Më pas, në ajetet e kësaj sureje, përmenden pesë cilësi të tjera të Zotit të Madhëruar. Ato janë: **"Ai është i Pari dhe i Mbrami, i Dukshmi** (me argumente) **dhe i Padukshmi** (me sy)**. Ai është i Dijshëm për çdo gjë!"**.

Përshkrimi si i Pari dhe i Mbrami është një shprehje e arrirë dhe mjaft e gjetur. Ajo tregon për përjetësinë e Zotit, sepse e dimë që Zoti është një krijesë e pafund dhe Qenie e domosdoshme. Qenia e domosdoshme, që do të thotë se ekzistenca e Tij rrjedh nga brendësia e Esencës së Tij. Ajo nuk buron nga jashtë saj, në mënyrë që të ketë një fund ose një fillim. Prandaj All'llahu ka ekzistuar përjetësisht dhe do të ekzistojë përgjithmonë.

Ai është Fillimi dhe Zanafilla e universit! Zoti është Ai që do të mbijetojë, edhe pas asgjësimit të botës.

Si rrjedhojë, fjalët: "i Pari" dhe "i Mbrami", nuk tregojnë asnjë kohë të posaçme dhe nuk tregon për një periudhë të caktuar kohore. Përshkrimi si i Pari dhe i Mbrami është tregues tjetër për dominim ekzistencial të Tij ndaj çdo gjëje që ekziston. All'llahu është më i dukshëm se çdo gjë tjetër, sepse shenjat e Tij janë të pranishme në çdo vend, siç njëherësh është dhe i fshehur në çdo vend, është më i fshehur se çdo gjë tjetër. Qenia e Tij nuk është e qartë për askënd.

Disa komentues të Kur'anit, për këtë çështje, janë shprehur në këtë mënyrë: "Zoti i Madhëruar është i Pari që nuk ka fillim dhe është i Fundit që nuk ka fund, është i Dukshëm, që nuk është i afërt, është i Padukshëm, që është i pambuluar.".

Disa të tjerë, kanë formuluar shumë shprehje më të arrira dhe më të këndshme: "Zoti i Madhëruar është i Pari në Bamirësi dhe i Fundit në Falje. Në qoftë se i bindesh Atij, Ai të shfaqet me mirësinë dhe begatinë e Vet, por në qoftë se e shqetëson Atë, Ai fshihet dhe mbulohet.".

Thënë shkurt, Ai është Fillimi dhe Fundi, e dukshmja dhe e padukshmja e botës ekzistuese.

Disa komentues të Kur'anit, fjalën "*dhahir*", këtu, e kanë komentuar në kuptimin: fituesi, mposhtësi. Kjo fjalë vjen nga fjala "*zuhur*", e cila përdoret me kuptimin: mposhtje. Në disa nga fjalimet e veprës "Nehxhul Belaga" janë sjellë dëshmi për këtë kuptim, pikërisht aty ku diskuton për krijimin e tokës. Konkretisht thuhet: "Ai mbisundon me Pushtetin dhe

Madhështinë e Tij. Ai e njeh brendinë e saj përmes diturisë dhe njohurisë së Tij.”.[1]

Gjithashtu, është i mundur edhe afrimi i dy komentimeve në një kuptim përmbledhës.

Si përfundim, përmbledhja e të gjithë diskutimeve shprehet në mënyrë koncize, në fund të ajetit: **“Ai është i Dijshëm për çdo gjë!”**.

Vetëm Zoti i Madhëruar është më i Dituri për çdo gjë, sepse Ai ka ekzistuar që në fillim dhe është i Gjallë gjithmonë. Ai është edhe në dukjen, edhe fshehtësinë e botës. Pa dyshim që është në dijeni të çdo gjëje.

Hulumtim

Bashkimi i të kundërtave te cilësitë e Zotit

Shumë nga cilësitë dhe karakteristikat tona dhe të gjallesave të tjera, është e pamundur të bashkohen, por ato, as nuk mund të paraqiten në formën e cilësive kontradiktore. Për shembull, në qoftë se unë jam i pari person i një shoqërie, pa dyshim që nuk mund të jem personi i fundit i saj, në qoftë se jam i dukshëm, nuk mund të jem i fshehur dhe, nëse jam i padukshëm, nuk mund të jem i dukshëm. Të gjitha këto janë, sepse ekzistenca

[1] “Nehxhul Belaga”, Fjalimi 186.

jonë është e kufizuar dhe një qenie e kufizuar në mundësi, në njohje, etj, nuk mund të jetë ndryshe.

Kur bëhet fjalë për cilësitë e Zotit të Madhëruar, gjendja ndryshon, ndryshojnë edhe cilësitë e Tij. Në këtë rast, e dukshmja dhe e padukshmja bashkohen. Bashkohet, gjithashtu, edhe fillimi, edhe mbarimi. Duke pasur parasysh Qenien e pafund të ekzistencës së Tij, kjo gjë nuk është e pamundur.

Në hadithet e transmetuara nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, njëkohësisht, siç vëren edhe Ehli Bejti, në lidhje me këtë çështje, gjenden shumë përshkrime dhe shpjegime domethënëse, që u bashkohen komentimit të këtyre ajeteve kuptimplota.

Si për shembull, në një hadith të transmetuar nga "Sahih Muslimi", është thënë nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"O Zot! Ti je i Pari, para të Cilit nuk ka ekzistuar asnjë gjë dhe Ti je i Fundmi, pas të Cilit nuk do të mbetet asnjë gjë. Ti je aq i dukshëm dhe dominues, saqë nuk ekziston asnjë gjë mbi Ty. Ti je aq i brendshëm dhe i fshehur, saqë përtej Teje nuk imagjinohet ndonjë gjë tjetër."*[1]

Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* deklaron: "Ai është i Pari, për të Cilin nuk ka fillim. Ai është i Përhershëm dhe nuk ka afat për amshimin e Tij. Është i Pari, që ka ekzistuar gjithnjë dhe është i Fundit që nuk ka fund. Ai është i Dukshëm, por nuk mund të thuhet se ku duket, apo ja ku është. Ai është i Fshehur, por nuk mund të thuhet, se ku fshihet."[2]

[1] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 9, f. 6406.
[2] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 162.

Gjithashtu, edhe Imam Hasani *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në një fjalim, thotë: *"Lavdëruar qoftë Zoti që nuk ka asnjë fillim të caktuar e as fund të caktuar. Dituritë, mendimet, inteligjencat dhe urtësitë, asnjëherë nuk kanë për të konceptuar cilësitë e Tij. Ai shtron pyetjet: 'Nga cila kohë ka ekzistuar? Nga ç'gjë ka filluar? Kujt i shfaqet dhe ku është i fshehur?'"*.[1]

Ajetet 4 - 6

[1] Tefsiri "Nuru Thakalejn", vëll. 5, f. 236.

هُوَ الَّذِى خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ فِى سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَى عَلَى الْعَرْشِ يَعْلَمُ مَا يَلِجُ فِى الْأَرْضِ وَمَا يَخْرُجُ مِنْهَا وَمَا يَنْزِلُ مِنَ السَّمَاءِ وَمَا يَعْرُجُ فِيهَا وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ، لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَإِلَى اللَّهِ تُرْجَعُ الْأُمُورُ، يُولِجُ اللَّيْلَ فِى النَّهَارِ وَيُولِجُ النَّهَارَ فِى اللَّيْلِ وَهُوَ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ،

"Ai i krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë, pastaj u ngrit mbi Fron. Ai e di se çfarë hyn në Tokë dhe çfarë del prej saj, çfarë zbret prej qiellit dhe çfarë ngjitet drejt tij. Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni."

"Atij i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës; tek All'llahu do të kthehet gjithçka!"

"Ai e ndërfut natën tek dita dhe ditën tek nata. Ai e di çfarë ka çdokush në kraharor."

Komentimi

Ai gjithnjë është mbi Fronin e fuqisë

Në ajetet e kaluara, u përmendën 11 cilësi të Zotit të Madhëruar. Në këto ajete, shpalosen cilësi të tjera të Tij.

Në ajetin 4, janë përmendur pesë cilësi të tjera të Zotit.

Në fillim flet rreth cilësisë së krijimit: **"Ai i krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë…"**.

Çështja e krijimit **"për gjashtë ditë"**, është përmendur shtatë herë në Kur'anin Fisnik. Për herë të parë, është përmendur në ajetin 54 të sures "El A'raf" dhe përmendja e fundit është në ajetin në fjalë, ajeti 4, i sures "El Hadid".

Ashtu siç e kemi trajtuar edhe më parë, fjala *"jeum"* - *"ditë"*, në këto ajete, nuk është përdorur me kuptimin e një dite të zakonshme. Kuptimi i saj, këtu, ka vlerën e një "periudhe kohore", qoftë kjo periudhë e shkurtër apo e gjatë, që mund të zgjasë me ditë, muaj, vite, por mund të zgjasë edhe me miliona vite. Kjo fjalë, me këtë konotacion kuptimor, përdoret në gjuhën arabe, por përdoret edhe në gjuhë të tjera. Për shembull, thuhet: "Sot është radha e filan popullsie, që të qeverisë. Nesër është radha e të tjerëve, që do të thotë periudha e tyre. Por fjala *"nesër"*, nuk ka kuptimin e një dite, por tregon një periudhë të gjatë kohe. Këtë domethënie e kemi diskutuar më gjerësisht, me argumente dhe dëshmi, në ajetin 54 të sures 'El A'raf'".

Sigurisht, për Zotin nuk kishte asnjë pengesë, që të gjithë botën ta krijonte në një çast. Në qoftë se do të ndodhte kështu, do të shfaqej më pak madhështia, fuqia dhe dituria e Tij. Kur krijimi vazhdon për miliarda vite, në periudha shumë të gjata kohore,

edhe me raste, situata, ngjarje, statuse të llojllojshme dhe sipas programeve të sakta dhe të mirëllogaritura, kjo pasqyron një dituri të pashoqe, të thellë dhe të plotë, tregon arsye dhe argumente të dukshme, të cilat vërtetojnë fuqinë dhe urtësinë e Tij.

Përveç kësaj, kjo mënyrë graduale e krijimit të gjithësisë, është një shembull, edhe për evolucionin gradual të njeriut dhe mos nxitimin në arritjen e objektivave të ndryshme.

Më pas, ajeti trajton çështjen e drejtimit dhe të sundimit të botës: Zoti i Madhëruar, pasi krijoi botën, **"u ngrit mbi Fron"** dhe mori timonin e qeverisjes dhe të administrimit të saj, të cilat i ka pasur dhe do t'i ketë gjithnjë vetë në dorë.

Pa dyshim, Zoti i Madhëruar, nuk është as trup e as fjala "*arsh*", në kuptimin e "fronit mbretëror". Përkundrazi, fjala "*arsh*", simbolizon sundimin absolut të Zotit dhe ushtrimin e Vullnetit të Tij në univers.

Kuptimi i fjalës "*arsh*", tregon një objekt me çati. Ndonjëherë përdoret për vetë çatinë. Është përdorur edhe me kuptimin e froneve të mëdhenj, si për shembull, fronet e mbretërve, por, gjithashtu, përdoret në mënyrë figurative edhe në kuptimin e fuqisë. Shembuj përdorimesh të kësaj fjale, me këtë kuptim figurativ, gjejmë në gjuhën perse, kur thuhet: "i ranë bazat e fronit"; ose në arabisht: "*thel'le arshuhu*" - "*froni i tij fluturoi*", pra, e humbi pushtetin.[1]

[1] Në lidhje me të vërtetën e *"arshit"* kemi dhënë më shumë informacion në këtë tefsiri, në suren "El A'raf", ajeti 54, , në suren "El Bekare", ajeti 255, f. 200.

Disa të paditur dhe të painformuar si dhe sa duhet, kanë imagjinuar se Zoti i Madhëruar, pasi e krijoi botën, ka hequr dorë prej drejtimit të saj. Jo! Kjo nuk është e vërtetë. Ai, gjithnjë, i ka vetë në dorë frenat e drejtimit dhe të administrimit të botës. Prej Tij varet çdo lloj i ekzistencës së sistemeve të kësaj bote. Fuqia e Zotit të Madhëruar është e pakufizuar. Ai, në çdo çast, mund të privojë nga mirësitë dhe furnizimet e Veta kë të dojë dhe kur të dojë. Ky do të ishte shpartallimi i botës. Ky perceptim i realitetit, i krijon njeriut vizionin se në çdo kohë dhe në çdo vend Zoti gjendet pranë tij, se Zoti është i kudondodhur, madje edhe brenda ndërgjegjes së secilit. Ai është kaq pranë. Njeriu e ndien dhe e shpreh dashurinë dhe përkushtimin ndaj Tij.

Më pas, ajeti shpalos një vlerë tjetër nga dija e pafund e Zotit. Ajeti shton: **"Ai e di se çfarë hyn në Tokë dhe çfarë del prej saj, çfarë zbret prej qiellit dhe çfarë ngjitet drejt tij."**.

Edhe pse të gjitha çështjet përmblidhen në shprehjen: *"huve bi kul'lin shej'in alim"* - "Ai është më i dijshmi për çdo gjë", e cila është përmendur në ajetet e mëparshme, përshkrimi i kësaj domethënieje e bën njeriun më të vëmendshëm rreth diturisë së gjerë të Zotit.

Po, Ai është në dijeni për atë që hyn në tokë: për të gjitha pikat e shiut, për valët e përmbytjeve; për farat e bimëve, të cilat shpërndahen në tokë me anë të erës apo insekteve dhe depërtojnë në të; për rrënjët e pemëve, të cilat hyjnë në thellësi të tokës për të kërkuar ujë dhe ushqim; për llojet e minierave dhe të depozitave, të cilat dikur kanë qenë mbi sipërfaqen e tokës e më pas janë futur brenda saj; për thesaret dhe depot; për trupat e të vdekurve; për llojet e insekteve, të cilat ndërtojnë fole në brendësi të tokës.

Po, Ai është në dijeni për të gjitha këto!

Gjithashtu, është në dijeni për bimët që mbijnë nga toka: për puset që burojnë nga zemra e tokës dhe e shkëmbinjve; për minierat dhe thesaret që shfaqen; për njerëzit që kanë dalë prej saj; për vullkanet që gufojnë nga brendësia e tokës; për insektet që dalin nga foletë; për gazrat që lartësohen nga toka; për valët gravitacionale, të cilat dalin nga thellësia e tokës.

Zoti i Madhëruar është në dijeni për të gjitha këto, një për një e pikë për pikë!

Gjithashtu, Ai është në dijeni edhe për atë që zbret nga qielli, duke filluar nga pikat e shiut, deri tek rrezet jetëdhënëse të diellit; duke u nisur nga numri i engjëjve deri te frekuencat e forta dhe të fuqishme të Shpalljes dhe Librave qiellorë; duke u nisur nga rrezet kozmike deri te meteorët dhe asteroidet endacakë, që zbresin në drejtim të tokës.

Për të gjitha këto, fije për fije, është në dijeni.

Gjithashtu, Ai është në dijeni edhe për atë që ngjitet në qiell, përfshirë engjëjt, shpirtrat e njerëzve, veprat e robëve, llojet e lutjeve, pjesët e shpendëve, avujt, retë dhe të tjera si këto. Përveç këtyre, Zoti i Madhëruar është në dijeni edhe për ato që i dimë, edhe për ato që nuk i dimë. Të gjitha këto i përfshin dituria e Pakufishme e Zotit. Tek Ai çdo gjë është e qartë dhe e dukshme!

Në qoftë se reflektojmë sado pak për këto që u trajtuan në këtë temë kaq gjithëpërfshirëse, bindemi përfundimisht se përveç Zotit të Madhëruar dhe të Gjithëdijshëm, askush tjetër nuk mund të ketë kaq dituri të gjëra e të shumëllojshme!

Si përfundim, diskutimi përqendrohet te cilësia e katërt dhe e pestë, cilësi tepër delikate për diskutim. Në këtë ajet thuhet: **"Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni."**.

Si mund të mos jetë Ai me ne, ndërkohë që ne në çdo çast mbështetemi tek Ai dhe nga Ai kërkojmë ndihmë?! Ai është Shpirti i universit, Ai është Fryma e botës dhe më shumë se kaq, Ai është më i Lartësuari se gjithkush dhe se gjithçka!

Ai ka qenë me ne, që nga koha që kishim rënë në një qoshe në formën e një grushti dheu, që nga koha, kur u vumë në barkun e nënës në formën e një fetusi. Ai është me ne, gjatë gjithë jetës në tokë, gjatë gjithë jetës në jetën në varr dhe kudo! Duke i ditur këto, a është e mundur që Ai të mos jetë në dijeni për gjithçka që ne bëjmë, themi e mendojmë?!

Me të vërtetë, ndjesia e të pasurit pranë Zotin e Madhëruar, nga njëra anë, i dhuron njeriut madhështi dhe, nga ana tjetër, i jep atij besim në vetvete, e mbush me trimëri dhe guxim, i krijon atij ndjenjën e përgjegjësisë së madhe, sepse Ai është i pranishëm kudo, shikon çdo gjë, është i kujdesshëm për gjithçka! Ky është mësimi më i madh edukativ. Një besim i këtillë, është rrënja kryesore e devotshmërisë, e pastërtisë, e dëlirësisë dhe e ndershmërisë së njeriut.

Prania e Zotit të Madhëruar në çdo vend e në çdo kohë është një e vërtetë reale dhe e pamohueshme dhe jo prani në kuptimin figurativ. Kjo prani reale e Tij, nga njëra anë, të sjell kënaqësi dhe gëzim shpirtëror dhe, nga ana tjetër, trishtim dhe përgjegjësi.

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: "*Faza më me vlerë e besimit të njeriut, është se e di që Zoti është me të kudo që ndodhet!*".[1]

Në një transmetim tjetër, lexojmë se Musai *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, ka thënë: "*O Zoti im! Ku të të gjej Ty?!*"

Atij iu tha: "*O Musa! Sa herë që më kërkon Mua, ke arritur tek Unë!*".[2]

Parimisht, ky "shoqërim", shoqërimi i Zotit me robtë e Tij, është aq delikat dhe i përpiktë, saqë çdo njeri besimtar e koncepton atë sipas nivelit të mendjes dhe besimit të tij dhe ndërgjegjësohet, dijesohet për veprimtarinë e tij.

Pas çështjes së qeverisjes dhe administrimit, vjen radha e sundimit të Tij mbi të gjithë universin. Për këtë ajeti thotë: **"Atij i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës."**.

Në fund thekson se tek All'llahu do të përfundojë gjithkush e gjithçka. Për këtë, ajeti thekson: **"Tek All'llahu do të kthehet gjithçka!**".

Ne jemi rrugëtar drejt banesës së dashurisë së Tij. Jemi vënë në këtë udhë të ngarkuar me shpresë, se jemi të bindur se jemi krijuar nga All'llahu dhe tek Ai do të rikthehemi, sepse All'llahu është Zanafilla dhe Destinacioni përfundimtar.

Në tri ajetet e para, është bërë një përshkrim i ngjashëm me këtë që thotë ajeti: **"Atij i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës."**.

---

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 171.
[2] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 351.

Në këtë ajet përsëritet ky përshkrim. Kjo përsëritje ka mundësi të bëhet për arsye se, në rastin e parë, ajeti fliste vetëm për në jetën dhe vdekjen e krijesave të gjalla, kurse këtu, ajeti në fjalë, e zgjeron temën e diskutimit dhe, në fund, thekson se rikthimi i çdo gjëje është tek Ai.

Gjithashtu, në diskutimet e mëparshme, u tregua për fuqinë e Zotit mbi çdo gjë, kurse këtu, në ajetin që po diskutojmë, bëhet fjalë për rikthimin e çdo gjëje tek Ai dhe saktësohet, se, që të dyja këto, janë domosdoshmëri dhe rrjedhojë e sundimit të Zotit në tokë dhe në qiell.

Përdorimi i shprehjes *"el umur"* në numrin shumës tregon se jo vetëm njerëzit, por të gjitha krijesat lëvizin drejt Tij, një lëvizje kjo e vazhdueshme dhe e pandalshme.

Prandaj theksohet se kuptimi i ajetit nuk kufizohet vetëm në rikthimin e njerëzve në Ahiret tek Zoti i Madhëruar, edhe pse çështja e Ringjalljes konsiderohet si një prej shembujve të qartë të rikthimit.

Në diskutimin e fundit të ajetit, flitet për dy cilësi të tjera, lidhur me Zotin. Ajeti thotë: **"Ai e ndërfut natën tek dita dhe ditën tek nata."**[1]

Po, gradualisht njërën e zvogëlon dhe tjetrës i shton dhe përgjatë vitit e ndryshon kohëzgjatjen e natës dhe të ditës. Ky ndryshim shoqërohet me ndërrimin e stinëve të vitit.

---

[1] Fjala *"julixhu"* rrjedh nga rrënja *"ilaxh"*; ajo, gjithashtu, rrjedh nga rrënja *"uluxh"* dhe është në kuptimin e futjes dhe ndikimit të saj, kurse fjala *"ilaxh"* është në kuptimin e futjes dhe dhënies së ndikimit.

Ky ajet, gjithashtu, ka edhe një interpretim tjetër. Në kohën e lindjes dhe perëndimit të diellit nuk kemi një ndryshim të menjëhershëm të ndërrimit të dritës dhe të errësirës, sepse kjo mund të bëhej shkak i lindjes së problemeve të shumta për njerëzit dhe krijesat e tjera të gjalla. Përkundrazi, ndërrimi i dritës me errësirën ndodh në mënyrë graduale dhe krijesat qetë–qetë kalojnë nga drita e ditës në errësirën e natës dhe nga errësira e natës në dritën e ditës, duke pasur kohën e nevojshme për t'u përgatitur për këto ndryshime.

Gjithashtu, është plotësisht i mundur edhe afrimi i të dy komentimeve në konceptin unik të ajetit.

Ajeti në fund shton: **"Ai e di çfarë ka çdokush në kraharor."**.

Ashtu si rrezet jetëdhënëse të diellit dhe drita e ditës depërtojnë në thellësinë e errësirës së natës dhe ndriçojnë të gjithë vendin, edhe dija e Zotit futet e depërton deri në këndet më të thella të zemrës dhe shpirtit të njeriut dhe i zbulon të gjitha sekretet e tij.

Duhet të kemi parasysh faktin se në ajetet e mëparshme u diskutua për faktin se Zoti i Madhëruar di gjithçka për veprat tona. Këtu do të tregohet se Zoti i Madhëruar, njohjen e Tij e shtrin deri në mendimet, qëllimet, bindjet dhe besimet tona.

Fjala *"dhat"*, në leksikografinë arabe, nuk është përdorur në kuptimin e *"identitetit"* dhe *"të të vërtetës"*, që është kuptimi me të cilin përdoret nga filozofët. Kuptimi i fjalës *"dhat"* tregon *"pronësinë e një gjëje"*, prandaj shprehja *"dhatis sudur"* përdoret për të treguar synimet dhe bindjet që "e kanë marrë peng zemrën e njeriut dhe mbizotërojnë mbi të".

Do të ishte gjëja më e bukur, në qoftë se njeriu, të gjitha këto cilësi hyjnore t'i besojë me gjithë shpirt dhe të ndiejë praninë e Zotit të Madhëruar në veprat, synimet dhe bindjet e veta. Me një ndjenjë dhe besim të tillë, njeriu asnjëherë nuk do të devijonte nga rruga e bindjes dhe e robërimit dhe asnjëherë nuk do të ndërmerrte rrugën e rebelimit dhe të ligësisë.

Hulumtim

Ajetet e Emrit më të madh të Zotit

E dimë se filozofët dhe teologët, cilësitë e Zotit i kanë ndarë në dy grupe: "cilësitë e esencës" që shprehin hijeshinë dhe Madhërinë e Zotit dhe "cilësitë e aktit, veprës" që shprehin aktet, veprat të cilat rrjedhin nga Esenca e Tij e bekuar.

Në gjashtë ajetet që u përmendën në fillim të kësaj sureje dhe në bazë të haditheve përkatëse, ato i kanë emëruar si Ajetet e mendimtarëve zhbirues. Janë paraqitur njëzet cilësi nga cilësitë e Esencës, të veprës dhe aktit të All'llahut. Janë theksuar këto cilësi: dija, fuqia, urtësia, amshimi dhe përhershmëria e Zotit e deri te krijimi, administrimi, sundimi, zotërimi dhe gjithëpërfshirja e Tij mbi çdo gjë që ekziston, prania e Tij kudo. Të gjitha këto cilësi shoqërohen me përdorimin e shprehjeve të tilla, që japin një thellësi më të madhe.

Kushtimi i vëmendjes dhe besimi te këto cilësi, si dhe përpjekja për ndezjen e një rrezeje sado të vogël prej atyre cilësive

në ekzistencën tonë, është ndihmësi dhe përkrahësi ynë më i mirë në procesin e përsosjes dhe në udhën drejt Zotit.

Në një hadith të transmetuar nga Berra bin Azeb, thuhet: "E pyeta Imam Aliun: 'O Ali! Të drejtohem në Emër të Zotit dhe të Dërguarit të Tij! Ndaje me mua gjënë më të mirë që Profeti ka ndarë me ty dhe Xhebraili e ndau në veçanti me të, dhe Zoti dërgoi Xhebrailin me atë!'"

Imam Aliu iu përgjigj: "Sa herë që dëshiron t'i lutesh Zotit me Emrin e Tij Madhështor, me Emrin më të madh, lexo gjashtë ajetet e para të sures "El Hadid" (deri tek *alimun bidhatis sudur*). Më pas lexo katër ajetet e fundit të sures "El Hashr". Ngriji lart dy duart dhe thuaj: 'O Zot! Ti je i Tillë, të lutem në emër të këtyre emrave, që t'i dërgosh përshëndetje Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të ma plotësosh këtë nevojë!'"

Më pas parashtroje kërkesën që ke: "Betohem në Zotin që nuk ka Hyjni tjetër përveç Tij, që nevoja jote do të plotësohet, në dashtë Zoti.".[1]

Për madhështinë e këtyre ajeteve dhe rëndësinë e përmbajtjes së tyre, ky hadith është i mjaftueshëm, por nuk duhet të harrojmë se Emri, apo Emrat më të mëdhenj të Zotit nuk përbëhen vetëm nga germat, por është e nevojshme dhe karakterizimi i tyre.

Ajetet 7 - 11

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 171.

آمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَأَنْفِقُوا مِمَّا جَعَلَكُمْ مُسْتَخْلَفِينَ فِيهِ فَالَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَأَنْفَقُوا لَهُمْ أَجْرٌ كَبِيرٌ۷ وَمَا لَكُمْ لَا تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالرَّسُولُ يَدْعُوكُمْ لِتُؤْمِنُوا بِرَبِّكُمْ وَقَدْ أَخَذَ مِيثَاقَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ۸ هُوَ الَّذِى يُنَزِّلُ عَلَى عَبْدِهِ آيَاتٍ بَيِّنَاتٍ لِيُخْرِجَكُمْ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ وَإِنَّ اللَّهَ بِكُمْ لَرَءُوفٌ رَحِيمٌ۹ وَمَا لَكُمْ أَلَّا تُنْفِقُوا فِى سَبِيلِ اللَّهِ وَلِلَّهِ مِيرَاثُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ لَا يَسْتَوِى مِنْكُمْ مَنْ أَنْفَقَ مِنْ قَبْلِ الْفَتْحِ وَقَاتَلَ أُولَئِكَ أَعْظَمُ دَرَجَةً مِنَ الَّذِينَ أَنْفَقُوا مِنْ بَعْدُ وَقَاتَلُوا وَكُلًّا وَعَدَ اللَّهُ الْحُسْنَى وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ۱۰ مَنْ ذَا الَّذِى يُقْرِضُ اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا فَيُضَاعِفَهُ لَهُ وَلَهُ أَجْرٌ كَرِيمٌ۱۱

“Besoni All’llahun dhe të Dërguarin e Tij dhe shpenzoni nga ato që Ai jua ka lënë trashëgim, se për ata midis jush që besojnë dhe shpenzojnë (për bamirësi)**, do të ketë shpërblim të madh!”**

“Çfarë keni që nuk besoni në All’llahun, ndërkohë që i Dërguari i Tij ju fton që të besoni në Zotin tuaj, i Cili, tashmë, ka marrë besën prej jush?! Atëherë besoni, nëse jeni besimtarë të vërtetë!”

"Është Ai që i ka zbritur robit të Vet Shpallje të qarta për t'ju nxjerrë nga errësira në dritë. All'llahu është vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë me ju."

"Atëherë, çfarë keni që nuk shpenzoni në Rrugën e All'llahut, ndërkohë që vetëm Atij i përket trashëgimia e qiejve dhe e Tokës? Nuk janë të barabartë ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar para fitores me ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas. Ata kanë shkallë më të lartë, mirëpo All'llahu u premton të gjithëve më të mirën (Xhennetin)**. All'llahu e di mirë atë që bëni ju."**

"Kush është ai, që do t'i japë vullnetarisht All'llahut një hua të mirë, që Ai pastaj t'ia kthejë shumëfish?! (Veç kësaj)**, për atë do të ketë shpërblim fisnik."**

Komentimi

Besimi dhe bamirësia, dy kapitale të mëdha të lumturisë dhe të shpëtimit

Pasi shpjeguam dhe argumentuam në ajetet e mësipërme, madhështinë e Zotit në univers dhe cilësitë e Tij të hijeshisë dhe të Madhërisë, të cilat të motivojnë në Rrugën drejt Tij, në këto ajete, theksohet se përfundimi që rrjedh prej tyre, është ftesa që u drejtohet të gjithëve për në besim dhe veprim.

Në fillim, ajeti 7 thotë: **"Besoni All'llahun dhe të Dërguarin e Tij..."**.

Kjo është një thirrje e përgjithshme, e cila u drejtohet të gjithë njerëzve. Besimtarët i fton në besim më të plotë dhe më të drejtë dhe jobesimtarët i fton në parimin e besimit. Kjo është një thirrje, e cila është e shoqëruar me arsye, të cilat përmendëm në ajetet përkatëse që diskutuan për Monoteizmin.

Pas kësaj, i fton të gjithë në njërën nga dobitë e besimit, "shpenzimi për hir të Zotit". Për këtë ajeti thotë: **"shpenzoni nga ato që Ai jua ka lënë trashëgim"**. Ftesa në sakrifikim, flijim dhe falje prej begative që keni, njëherësh është thirrje, e cila tërheq vëmendjen, që të mos harroni se Zoti është Pronari kryesor dhe këto pasuri e kapitale, vetëm se janë lënë si amanet në dorën tuaj, për një periudhë të shkurtër kohe, ashtu siç kanë qenë edhe në dorë të popujve të hershëm.

E vërteta e padiskutueshme është se zotëruesi i gjithë rruzullit tokësor është Zoti i Madhëruar. Të besosh këtë të vërtetë, tregon edhe një herë se ne jemi vetëm amanetmbajtësit e Tij. Atëherë, si është e mundur që kujdestari i amanetit, të injorojë dhe të mos marrë parasysh urdhrin e pronarit të amanetit?!

Besimi në këtë të vërtetë, e bën njeriun të ketë shpirt bujar dhe human, ia hap dorën dhe zemrën e tij për bamirësi.

Përdorimi i fjalës *"mustekhlefin"* - *"mëkëmbës"* ka mundësi të flasë për përfaqësimin e njeriut mbi tokë ndaj Zotit dhe begative të Tij, ose trashëgimet e popujve të kaluar , ose të dyja së bashku.

Kurse përdorimi i shprehjes *"mimma"* - **"nga ato gjëra që..."**, është një shprehje që përfshin jo vetëm pasuritë në vetvete, por të gjitha kapitalet dhe begatitë hyjnore. Siç e kemi trajtuar edhe më parë, bamirësia ka një kuptim të gjerë, që nuk kufizohet vetëm me dhënin e mallit, por përfshin edhe diturinë, udhëzimin dhe nderin shoqëror, si dhe pasuri të tjera shpirtërore dhe materiale.

Për të nxitur sa më shumë bamirësinë, ajeti shton: **"... se për ata midis jush që besojnë dhe shpenzojnë për bamirësi, do të ketë shpërblim të madh!"**.

Përshkrimi i shpërblimit si "shpërblim i madh", nënkupton se shpërblimet dhe mirësitë hyjnore do të jenë të mëdha, jo vetëm në Ahiret, në Botën Tjetër, por që në këtë botë, një pjesë nga ky shpërblim i madh do t'u jepet atyre.

Pas urdhrit për "besim" dhe "bamirësi", ajeti ka bërë një përshkrim për secilën nga këto dhe i sheh si argumente dhe arsyetim.

Ajeti, në fillim, me anë të një pyetjeje qortuese, ka kërkuar arsyen e mospranimit të thirrjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për besim në Një Zot dhe thotë: **"Çfarë keni që nuk besoni All'llahun, ndërkohë që i Dërguari i Tij ju fton që të besoni Zotin tuaj, i**

Cili, tashmë, ka marrë besën prej jush?! Atëherë, besoni, në se jeni besimtarë të vërtetë!".

Ky qortim, njëherësh, është një thirrje drejtuar njerëzve, të cilëve u thotë që të pranojnë të Vërtetën, të mbështetur në argumente të qarta dhe në arsye, si në argumente fetare të transmetuara.

Nga njëra anë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ju erdhi me argumente të qarta, shenja dhe mrekulli të mëdha, nga ana tjetër, Zoti i Madhëruar, duke treguar gjurmët e Tij në botën e krijuar dhe në brendësi të ekzistencës suaj, në fakt, ka lidhur me ju një lloj kontratë ekzistenciale, që t'i besoni Atij, por ju as natyrës dhe as arsyes suaj nuk i kushtoni rëndësi, as çështjes së Shpalljes nuk i kushtoni ndonjë vëmendje. Këtu bëhet e qartë se ju nuk jeni aspak të gatshëm dhe të predisponuar që të besoni dhe injoranca, paragjykimi dhe imitimi i verbër ua ka verbuar sytë dhe mendjen tuaj.

Nga sa thamë, u bë e qartë se synimi i sifjalisë: *"in kuntum muminin"* - **"nëse jeni besimtarë"**, është ky: Në qoftë se ju jeni të gatshëm të besoni në një gjë, apo të pranoni ndonjë arsye, ky është çasti dhe momenti i duhur, sepse argumentet janë të qarta nga çdo pikëpamje.

Ata, edhe pse e shihnin me sytë e tyre personalitetin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e dëgjonin thirrjen e tij, pa ndonjë ndërmjetësim, i shihnin mrekullitë e tij, cila është pengesa dhe justifikimi i tyre?

Për këtë, në një hadith lexojmë: "Një ditë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u tha shokëve të tij: *'Cili besimtar është më impresionues për ju për nga besimi?'*

Ata thanë: 'Engjëjt.'

Profeti tha: *'Përse duhet të habitemi nga besimi i tyre? Ata gjithnjë janë në afërsi të Zotit.'*

Ata thanë: 'Atëherë janë të Dërguarit.'

Profeti tha: *'Si të mos besojnë në Zot ata, që u është zbritet Shpallja?'*

Më pas, ata thanë: 'Atëherë jemi vetë ne!'

Profeti tha: *'A është e çuditshme që ju të mos besoni, ndërkohë që unë ndodhem në mesin tuaj?'*

Që të gjithë ranë në heshtje dhe Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përsëri tha: *'Më të mahnitshmit nga të gjithë, do të jenë popujt që do të vijnë pas jush, të cilët, përpara vetes, do të kenë vetëm disa fletë dhe do e besojnë atë që është e shkruar në to.*[1] *Njerëzit që do të jetojnë në këtë botë, vite të tëra pas vdekjes sime dhe veprat e mia do t'i shohin vetëm të shkruara në libra, do të kuptojnë të vërtetën e thirrjes sime dhe do ta pranojnë atë. Ata do të kenë përparësi të madhe mbi të tjerët.'*.".

Përdorimi i fjalës *"mithak" - "besa", "kontrata e përforcuar"*, tregon për natyrën monoteiste, ose mund të tregoj për argumentet racionale, të cilat i shfaqen njeriut, kur shikon sistemet e

[1] "Sahih Bukhari", në bazë të transmetimit të tefsirit "Meragij" dhe tefsirit "Fi Dhilalil Kur'an", ajeti në fjalë.

ekzistencës së botës së krijuar. Kurse togfjalëshi *"birab'bikum"* - *"në Zotin tuaj"*, që është tregues për administrimin hyjnor në botën e krijuar, është dëshmi e këtij kuptimi.

Fjalën *"mithak"*, disa komentues e kanë konsideruar tregues për "botën e grimcave" (shprehje kur'anore për periudhën para krijimit të njeriut). Ky kuptim duket i papranueshëm, sipas interpretimit që kemi përmendur më herët, në lidhje me "botën e grimcave".[1]

Ajeti vijues, e nënvizon dhe e shpjegon edhe më tej këtë koncept, kur thotë: **"Është Ai që i ka zbritur robit të Vet Shpallje të qarta për ta nxjerrë nga errësira në dritë. All'llahu është vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë me ju."**.

Një grup komentuesish të Kur'anit, togfjalëshin *"ajatun bej'jinat"* - **"Shpallje të qarta"** e kanë komentuar si përmbledhje të të gjitha mrekullive. Një grup tjetër komentuesish, e kanë përdorur vetëm në kuptimin e Kur'anit. Por ajeti ka një kuptim më të gjerë dhe i përfshin të gjitha këto, edhe pse shprehja *"nez'zele"* - **"që i ka zbritur"** përshtatet me Kur'anin, i cili çau perdet e errësirës së politeizmit, të mosbesimit, të devijimit dhe të injorancës dhe në zemrën e njeriut e ndezi dritën e besimit dhe të njohjes.

Përdorimi i shprehjes *"raufun rahim"* është një tregues i qëlluar, pikërisht për këtë që diskutuam. Kjo thirrje hyjnore, e cila përsëritet me këmbëngulje, është një ftesë drejt besimit dhe bamirësisë, është një manifestim i Mëshirës së Zotit, e Cila ka

[1] Po ky tefsir, sure "El Araf", ajeti 172.

ardhur tek të gjithë ju. Edhe në këtë botë, edhe në Ahiret të gjitha begatitë të Zotit do të kthehen te ju.

Ka qenë dhe mbetet një diskutim i hapur mes komentuesve të Kur'anit, nëse ka apo jo ndryshim mes fjalëve *"rauf"* dhe *"rahim"*. Më e përshtatshme se të gjitha, është përdorimi i fjalës *"rauf"*, për të treguar dashurinë dhe mirësinë e Tij të veçantë ndaj të bindurve, kurse fjala *"rahim"* përdoret për të treguar mëshirën e Zotit ndaj mëkatarëve.

Disa komentues të tjerë, kanë pohuar se fjala *"ra'fet"* përdoret edhe e shoqëruar me fjalën *"rahmet"*, por thuhet para shfaqjes së tij, kurse fjala *"rahmet"* përdoret pas shfaqjes dhe realizimit të tij.

Më pas, Kur'ani, lidhur me çështjen e bamirësisë, thotë: **"Atëherë, çfarë keni që nuk shpenzoni në Rrugën e All'llahut, ndërkohë që vetëm Atij i përket trashëgimia e qiejve dhe e tokës?"**.

Me fjalë të tjera, duhet të kuptohet se të gjithë do të ndaheni nga kjo botë dhe begatitë e saj, do t'i lini të gjitha e do të largoheni prej këtej. Atëherë, ç'keni që nuk përfitoni nga begatitë që keni në dorë?!

Fjala *"mirath"*, në thelb, ashtu siç është shprehur edhe Ragibi në veprën "El Mufredat", është përdorur me kuptimin e një pasurie që kalon në pronësinë e dikujt tjetër, pa kontratë, apo të ngjashme me të. Ajo çka mbetet nga i vdekuri, e cila u shpërndahet të afërmve është një prej shembujve të saj. Pra, kuptimi i fjalës *"mirath"*, shoqërohet me të njëjtin kontekst kuptimor.

Sifjalia: **"...vetëm Atij i përket trashëgimia e qiejve dhe e tokës"**, kuptimisht, përdoret për të treguar se jo vetëm pasuritë dhe pronat, por gjithçka që ekziston në tokë dhe në qiej e kanë kthimin e tyre te Zoti i Madhëruar. Të gjitha krijesat do të vdesin dhe vetëm Zoti është Trashëgimtari i të gjithë atyre.

Bamirësia në situata dhe gjendje të ndryshme, ka vlera të ndryshme. Për ta saktësuar më mirë këtë, ajeti thekson: **"Nuk janë të barabartë ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar para fitores me ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas."**.

Po, për cilën fitore bëhet fjalë? Për këtë çështje ka mosmarrëveshje mes komentuesve. Disa komentues, atë fitore e lidhin me luftën për çlirimin e Mekës, në vitin e tetë të Hixhretit, kurse komentues të tjerë, atë fitore e lidhin me armëpushimin në Hudejbije, në vitin e gjashtë të Hixhretit.

Duke u nisur nga fakti se fjala *"fet'h"* në suren *"Inna fetehna leke fet'hen mubina"*, është komentuar si *"fitorja e Hudejbijes"* është më e mundshme që këtu të jetë përdorur me kuptimin e fitores së Hudejbijes. Përdorimi i foljes *"katele"* - **"kanë luftuar"**, përshtatet me fitoren e Mekës, sepse në Hudejbije nuk kishte ndodhur luftë, kurse në Mekë ndodhi një luftim i shpejtë dhe i shkurtër, i cili nuk u përballua me ndonjë rezistencë.

Gjithashtu, ekziston edhe mundësia që fjala *"el fet'h"*, në këtë ajet, të përdoret për të gjitha llojet e fitoreve dhe për çdo ngadhënjim të myslimanëve në luftërat islame. Kjo do të thotë se ata që në kohë krize nuk kishin kursyer faljen e pasurisë dhe të jetës, janë më të mirë se sa ata, që, pas përfundimit të stuhive, nxituan të ndihmojnë Islamin.

Prandaj, për ta nënvizuar edhe më tepër këtë saktësim, ajeti shton: **"Ata kanë shkallë më të lartë…"**.

Një grup komentuesish, të cilët ajetin e kanë komentuar në kuptimin e "fitores së Mekës", apo të "fitores në Hudejbije", kishin shpenzuar dhe kishin luftuar në Rrugën e Zotit. Si shembull të bamirësit, në këtë ajet, kanë konsideruar Ebu Bekrin, megjithëse, nga koha e Hixhretit deri në kohën për të cilën flet ajeti, kishin kaluar gjashtë deri në tetë vite dhe gjatë kësaj periudhe kishin ndodhur luftëra të shumta, në të cilat kishin marrë pjesë, kishin luftuar dhe kishin shpenzuar në Rrugën e Zotit me mijëra njerëz.

Në fitoren e Mekës, sipas historianëve, kishin marrë pjesë dhjetë mijë persona. Pa dyshim, që nga ky grup, një pjesë e madhe e njerëzve kishin ndihmuar financiarisht për përgatitjen e luftës, kishin shpenzuar në Rrugën e Zotit. Për këtë arsye, përdorimi i fjalës *"kabl" - "para"*, është në kuptimin e bamirësisë dhe të shpenzimit për këtë luftë, pra, jo në fillim të Islamit dhe para njëzet e një viteve.

Gjithashtu, është e nevojshme të theksojmë se disa komentues të Kur'anit, këmbëngulin që bamirësia është më e preferuar dhe në një shkallë më lart se lufta në Rrugën e Zotit. Kjo, mbase theksohet që të mbahet në një farë mënyre një harmoni me paragjykimet e tyre. Mbase përmendjen e bamirësisë para luftimit, në ajetin e mësipërm, e konsiderojnë si dëshmi për këtë çështje. Ndihmave financiare, të cilat jepen para luftës, u japin përparësi, sepse ato janë të domosdoshme, për të siguruar mjetet dhe pajisjet e luftës. Në të kundërt, pa dyshim që dhënia e

jetës dhe gatishmëria për të rëndë dëshmorë është më e lartë, se sa shpenzimi financiar dhe bamirësia.

Sidoqoftë, nisur nga fakti që të dy grupet përfshihen në mirësinë e të Vërtetës, me gjithë dallimin nga grada, në fund të ajetit, tregohet se ata i përfshin mëshira e Zotit të Madhëruar. Për këtë, ajeti shton: **"... mirëpo All'llahu u premton të gjithëve më të mirën, Xhennetin."**.

Kjo është një mirënjohjeje dhe vlerësim për të gjithë njerëzit, të cilët kanë ecur në Rrugën e Zotit.

Fjala *"husna"*, në këtë ajet, ka një kuptim të gjerë, i cili përfshin çdo lloj shpërblimi të mirë në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Për të theksuar faktin se vlera e veprimit konsiston në sinqeritetin e kryerjes së tij, ajeti, në fund, shton: **"All'llahu e di mirë atë që bëni ju."**.

All'llahu është në dijeni për veprimet tuaja, për nga cilësia, për nga sasia, si dhe për nga synimet dhe pesha e sinqeritetit tuaj në ato vepra.

Në ajetin e fundit të diskutimit, sërish, për ta nxitur "shpenzimin në rrugën e Zotit", përdoret një shprehje tjetër po aq interesante: **"Kush është ai, që do t'i japë vullnetarisht All'llahut një hua të mirë, që Ai pastaj t'ia kthejë shumëfish?!** (Veç kësaj)**, për atë do të ketë shpërblim fisnik..."**.

Me të vërtetë që është një shprehje mbresëlënëse. Zoti është dhuruesi i të gjitha begative dhe i të gjitha grimcave të ekzistencës sonë. Ne përfitojmë nga deti i pafund i mirësive të Tij. Por Ai, këto i konsideron si të jenë prona jonë dhe ne na konsideron si të

ishim pronarë të këtyre begative dhe na paraqitet për të na kërkuar hua. Pastaj, përkundër huas që mund të kemi dhënë, në vend që të na shpërblejë si zakonisht, pra sa ke dhënë, aq të marrësh, Zoti i Madhëruar e shumëfishon atë, ndonjëherë me njëqind, ndonjëherë edhe me njëmijë herë më shumë. Përveç këtyre, jep edhe një **"shpërblim fisnik"**, që është një shpërblim madhështor, të cilën e di vetëm Ai.

Hulumtime

1- Motivet e bamirësisë

Në ajetet e kaluara, u përdoren shprehje të ndryshme për nxitjen në bamirësi, përfshirë këtu edhe ndihmën ndaj çështjes së luftës, apo bamirësi të tjera për nevojtarët, me qëllim që secila nga këto të mund të jetë një faktor për nxitjen drejt bamirësisë.

Në ajetin 7, është përmendur çështja e trashëgimisë, të cilën njerëzit e trashëgojnë nga njëri–tjetri, ose nga Zoti. Por Pronari i vetëm dhe i vërtetë i këtyre pasurive, është vetëm Zoti i Madhëruar dhe të gjithë të tjerët janë deleguar prej Tij në këto pasuri. Ky vizion mund ta hapë zemrën dhe dorën e njeriut për më shumë bamirësi dhe të jetë një faktor nxitës në këtë drejtim.

Në ajetin 10, është përmendur një shprehje tjetër, që tregon se pasuritë janë të paqëndrueshme. Ato mbeten pas, këtu, në këtë botë. Askush nuk merr me vete asgjë. Prandaj ajeti, për çështjen e

trashëgimisë, thotë: **"Zotit i takojnë trashëgimia e qiejve dhe e tokës."**.

Në ajetin 11, është përdorur një shprehje më e ndjeshme se të gjitha të tjerat. Kjo shprehje, Zotin e konsideron huamarrës, kurse njerëzit huadhënës. Një hua, ku çështja e kamatës nuk vlen. Një hua, që të kthehet e shumëfishuar me disa dhe mijëra herë. Një hua, që të sjell edhe një shpërblimin të madh, të paimagjinueshëm.

Të gjitha këto komente për bamirësitë, bëhen me synimin që të zhduken mendimet devijuese, epshi e lakmia, zilia, egoizmi dhe faktorë të tjerë, që janë pengesë për bamirësi, si dhe të ndërtojë një shoqëri në bazë të lidhjeve emocionale, të frymës shoqërore dhe të bashkëpunimit të thellë.

2- Kushtet e bamirësisë në Rrugën e Zotit të Madhëruar

Përdorimi i togfjalëshit *"kardh'an hasene"* - **"një hua të mirë"**, në ajetin e lartpërmendur, tregon se huaja që mund të jepet, është disa llojesh. Ajo mund të klasifikohet si "hua e mirë", mund të klasifikohet si "hua me pak vlerë", ose si "hua e pavlerë."

Kur'ani Fisnik "kushtet e huas së mirë", ose të quajtur ndryshe "të bamirësinë së vyer", i ka shprehur në ajete të ndryshme. Disa nga komentuesit e Kur'anit i kanë përmbledhur në dhjetë kushte:

1- Zgjidhni pjesën më të mirë të prodhimtarisë për të bërë bamirësi dhe jo atë me pak vlerë: **"O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi**

nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj e të cilat ju nuk do t'i pranonit ndryshe veçse symbyllur. Ta dini se All'llahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëvdatë.".[1]

2- Jepni për bamirësi atë pjesë të pasurisë suaj që është e nevojshme për njeriun: **"Ndërsa ata që banojnë në Medine dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medine dhe në zemrat e tyre nuk ndjejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues."**.[2]

3- Jepuni njerëzve nevojtarë: **"**(Lëmosha) **u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në Rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë** (për të fituar)**. Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, All'llahu i di ato.".**[3]

4- Bamirësia asnjëherë të mos shoqërohet me turpërim dhe lëndim. **"O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato** (atyre që ua keni dhënë) **dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në All'llahun dhe Ditën e Fundit. Ai shëmbëllen me një gur të lëmuar të mbuluar me dhé, mbi të cilin bie shiu me rrebesh, duke e lënë të zhveshur. Ata nuk kanë kurrfarë dobie**

[1] Sure "El Bekare", ajeti 267.
[2] Sure "El Hashr", ajeti 9.
[3] Sure "El Bekare", ajeti 273.

nga veprat që kanë bërë, se All'llahu nuk e udhëzon në Rrugë të drejtë popullin mohues.".[1]

5- Bamirësia dhe lëmosha duhet të jenë të shoqëruara me dëlirësi dhe qëllim të pastër: **"Ata që shpenzojnë pasurinë e vet, për të kërkuar kënaqësinë e All'llahut dhe që e forcojnë veten me punë të mira, shëmbëllejnë me një kopsht të mbjellë në rrafshnaltë, në të cilin bie shi i bollshëm, andaj jep fruta dyfish. Nëse nuk i bie shi i bollshëm, i bie shi i imët që i mjafton. All'llahu i sheh mirë punët që bëni ju."**.[2]

6- Atë që e jepni, konsiderojeni si diçka të vogël dhe të parëndësishme, sado e madhe që të jetë ajo: **"Mos jep gjë, me synimin që të marrësh më shumë…"**.[3-4]

7- Lëmosha të jetë prej pasurisë që për ty është e dhembshur dhe e dashur: **"Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani** (lëmoshë) **nga ajo** (pasuri) **që e doni. Çfarëdo që të ndani, All'llahu e di mirë atë."**.[5]

8- Asnjëherë mos e imagjinoni veten si pronari kryesor dhe i vërtetë i pasurisë suaj, por konsiderojeni veten tuaj si një ndërmjetësues mes Krijuesit dhe krijesave: **"Besoni All'llahun dhe të Dërguarin e Tij dhe shpenzoni nga ato që Ai jua ka lënë**

---

[1] Sure "El Bekare", ajeti 264.
[2] Sure "El Bekare", ajeti 265.
[3] Sure "El Muddeththir", ajeti 6.
[4] Ky ajet ka kuptime të shumta. Njëri prej tyre është ai që u tha më sipër. Për më shumë informacion, me vullnetin e Zotit, do të flasim në suren "El Muddeththir".
[5] Sure "Ali Imran", ajeti 92.

trashëgim, se për ata midis jush që besojnë dhe shpenzojnë (për bamirësi)**, do të ketë shpërblim të madh!"**.[1]

9- Para se gjithash, lëmosha duhet të jetë nga pasuria hallall dhe e lejuar, sepse Zoti vetëm atë pranon: **"Lexoju** (o Muhammed) **saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: 'Ty gjithsesi do të të vras'. Tjetri tha: "All'llahu pranon vetëm prej të devotshmit'."**.[2]

10- Lëmosha që jepet fshehurazi, është më e preferuar: **"T'i jepni lëmoshat haptazi, është gjë e mirë, por t'ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë dhe ju shlyen disa nga gjynahet tuaja. All'llahu e njeh mirë çdo vepër që ju bëni."**.[3]

Në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: *"Zoti i Madhëruar asnjëherë nuk e pranon lëmoshën, e cila jepet me anë të tradhtisë."*.[4]

Ajo që thamë më lart, përbën pjesën kryesore dhe më të rëndësishme të veçorive dhe kushteve të nevojshme, por bamirësia nuk kufizohet vetëm me këto cilësi. Në ajete dhe transmetime të tjera, do të flasim për kushte të tjera, lidhur me lëmoshën dhe bamirësinë.

---

[1] Sure "El Hadid", ajeti 7.
[2] Sure "El Maide", ajeti 27.
[3] Sure "El Bekare", ajeti 271.
[4] Këto dhjetë karakteristika i ka përmendur Tabrisi, në "Mexhmaul Bejan", Fakhru Rrazij, në tefsirin "Kebijr" dhe Alusij në "Ruhul Meanij". Ne i përmendëm në mënyrë të përmbledhur, me pak ndryshim.

Disa nga kushtet që përmendëm më lart, konsiderohen "të detyrueshme", si për shembull, modestia, qortimi dhe vetekspozimi. Disa kushte të tjera konsiderohen si "të përsosjes", për shembull, të bësh bamirësi në kohën që ke vetë nevojë për bamirësi.

Gjithashtu, nga ajo çfarë thamë më lart, edhe pse tema e diskutimit të mësipërm ishte për bamirësinë dhe lëmoshën, shumë prej kushteve të dhënies së tyre vlejnë edhe për huat e zakonshme, veçanërisht kushti që u cilësua si një prej kushteve të përsosmërisë, "huaja e mirë".

Në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për dhënien e lëmoshës dhe të bamirësinë në Rrugën e Zotit, kemi zhvilluar një diskutim të detajuar në ajetet 261–267 të sures "El Bekare". (Po ky tefsir, vëllimi 2, faqe 233–257)

3- Paraprijësit në besim, në luftë dhe në bamirësi

Ata që paraprijnë ndaj të tjerëve në besim dhe vepra të mira, kanë edhe më shumë kurajë, edhe njohje më të madhe. Ata janë më të gatshëm të flijohen dhe të sakrifikohen. Për këtë arsye, nuk janë të barabartë të Zoti i tyre. Prandaj, në ajetet e lartpërmendura, u theksuan njerëzit që kanë shpenzuar në Rrugën e Zotit, para arritjes së fitores, (fitores së Mekës apo Hudejbijes, ose fitoreve të tjera islame), nuk janë të barabartë përpara Zotit me njerëzit e tjerë.

Në një hadith të transmetuar nga Ebu Said Khudri thuhet: "Në vitin e paqes së Hudejbijes (viti i gjashtë i Hixhretit), ne ishim

me të Dërguarin e All'llahut. Kur arritëm në Asfan (një vend afër Mekës), ai tha: "*Është e mundur, që në të ardhmen të vijnë popuj, që veprat tuaja, në krahasim me veprat e veta, t'i konsiderojnë të vogla dhe më pak të vlefshme!*"

Ne i thamë: "O i Dërguari i Zotit, cilët janë ata? Vallë, a janë kurejshët?"

Ai tha: "*Jo, ata janë nga Jemeni dhe janë njerëz që kanë zemra më të dashura dhe më të buta se sa ju (dhe vepra më të shumta).*"

Ne i thamë: "O i Dërguari i Zotit! A janë ata më të mirë se ne?!"

Profeti i Zotit na tha: "*Në qoftë se njëri prej tyre ka një mal me flori dhe atë e jep në Rrugën e Zotit, nuk do të shpërblehet në masën e një "muddi"(më pak se një kilogram), ose më pak nga ajo që ju jepni në Rrugën e Zotit. Dijeni se ky është një dallim mes nesh, myslimanëve dhe popujve të tjerë. Dëshmi për këtë, është kjo Fjalë e Zotit*: **'Nuk janë të barabartë ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar para fitores me ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas.'**."."[1]

Synimi i dhënies hua Zotit të Madhëruar është që çdo lloj lëmoshe e dhënë në Rrugën e Tij dhe sipas kushteve të përcaktuara më sipër, është ndihmë ndaj Profetit dhe imamëve të myslimanëve, sepse ato ndihma mund të shpenzohen edhe për nevojat e qeverisë islame.

Prandaj, në një transmetim nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në "Usulil Kafi", thuhet: "*Zoti i Madhëruar,*

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 172.

nuk ka kërkuar ndonjë hua nga robtë e Vet për nevojat e Veta. E drejta e Zotit është për përfaqësuesin e Tij (prijësin e caktuar prej Tij).”.[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Kadhimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në lidhje me ajetin që po diskutojmë, thuhet: *“Ky ajet ka zbritur për dhuratën dhe ndihmën ndaj imamit (të pagabueshëm).”*.[2]

Ajetet 12 – 15

[1] Tefsiri “Safij”, f. 552.
[2] Po aty.

يَوْمَ تَرَى الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ يَسْعَى نُورُهُمْ بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَبِأَيْمَانِهِمْ
بُشْرَاكُمُ الْيَوْمَ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ذَلِكَ
هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ١٢ يَوْمَ يَقُولُ الْمُنَافِقُونَ وَالْمُنَافِقَاتُ لِلَّذِينَ آمَنُوا
انْظُرُونَا نَقْتَبِسْ مِنْ نُورِكُمْ قِيلَ ارْجِعُوا وَرَاءَكُمْ فَالْتَمِسُوا نُورًا
فَضُرِبَ بَيْنَهُمْ بِسُورٍ لَهُ بَابٌ بَاطِنُهُ فِيهِ الرَّحْمَةُ وَظَاهِرُهُ مِنْ قِبَلِهِ
الْعَذَابُ١٣ يُنَادُونَهُمْ أَلَمْ نَكُنْ مَعَكُمْ قَالُوا بَلَى وَلَكِنَّكُمْ فَتَنْتُمْ
أَنْفُسَكُمْ وَتَرَبَّصْتُمْ وَارْتَبْتُمْ وَغَرَّتْكُمُ الْأَمَانِيُّ حَتَّى جَاءَ أَمْرُ اللَّهِ
وَغَرَّكُمْ بِاللَّهِ الْغَرُورُ١٤ فَالْيَوْمَ لَا يُؤْخَذُ مِنْكُمْ فِدْيَةٌ وَلَا مِنَ الَّذِينَ
كَفَرُوا مَأْوَاكُمُ النَّارُ هِيَ مَوْلَاكُمْ وَبِئْسَ الْمَصِيرُ١٥

"Ditën që do të shohësh besimtarët dhe besimtaret, me dritën e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre (e do t'u thuhet)**: 'Lajm i mirë sot për ju: kopshtet e Xhennetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të banoni përgjithmonë. Kjo është fitorja më e madhe!'"**

"Atë Ditë, hipokritët dhe hipokritet do t'u thonë besimtarëve: 'Na prisni edhe ne që të marrim nga drita juaj!' Por atyre do t'u thuhet: 'Kthehuni prapa e kërkoni tjetër dritë!' Dhe, ndërmjet tyre, do të vendoset një mur me portë: brenda saj ka mëshirë, kurse jashtë saj ka dënim."

"'A nuk kemi qenë me ju?' - do të thërrasin ata. – 'Po, - do t'u përgjigjen', - por ju e çuat veten në tundim, pritët, dyshuat dhe u mashtruat nga vetë dëshirat tuaja të kota, derisa arriti urdhri i All'llahut, e djalli ju mashtroi për All'llahun!"

"Sot nuk pranohet prej jush kurrfarë shpërblese e as prej atyre që nuk kanë besuar: zjarri është vendbanimi juaj, ai është për ju; eh, sa vendbanim i tmerrshëm që është ai!"

Komentimi

"Na lejoni dhe ne, që të shfrytëzojmë dritën tuaj!"

Në ajetin 11, tregohet se Zoti i Madhëruar u premtoi shpërblim të madh njerëzve bamirës. Në ajetet që po diskutojmë, tregohet se kur do të jepet ky shpërblim i madh dhe me shumë vlerë.

Ajeti 12 thotë se kjo do të ndodhë në: **"Ditën që do të shohësh besimtarët dhe besimtaret, me dritën e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre…"**.

Kuptohet se fjala është për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por në skenën e asaj dite, atë do e shohin edhe të tjerët. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka të nevojshme t'i njohë besimtarët, që të tregojë ndaj tyre më shumë simpati dhe dashuri.

Komentuesit e Kur'anit rreth "nurit", kësaj drite profetike, kanë dhënë mendime të shumta, por qartësohet mirë se kjo dritë personifikon dritën e besimit, sepse është përdorur edhe shprehja *"nuruhum"* - **"drita e besimtarëve dhe besimtareve"**. Këtu nuk ka vend për çudi, sepse në atë ditë, bindjet dhe veprimet e njerëzve do të mishërohen.

Besimi është drita e udhëzimit dhe do të personifikohet në formën e ndriçimit dhe të dritës së jashtme, kurse "mosbesimi", që është një errësirë absolute, do të personifikohet në formën e territ dhe errësirës.

Prandaj, në ajetin 8 të sures "Et Tahrim" lexojmë: **"Ditën kur All'llahu nuk e turpëron Profetin** (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) **e së bashku me të, as ata që kanë besuar. Drita e tyre ndriçon para tyre dhe në të djathtë të tyre e ata thonë: 'Zoti ynë, vazhdona dritën tonë, falna neve. Vërtet Ti je i Plotfuqishëm për çdo send!'"**.

Edhe në ajete të tjera në Kur'an, thuhet se Zoti i Madhëruar i udhëzon besimtarët dhe i nxjerr nga errësira në dritë. Përdorimi i shprehjes *"jes'a"* (që rrjedh nga rrënja *"saij"* dhe është në kuptimin e "lëvizjes së shpejtë"), argumenton, që edhe besimtarët, Rrugën e Ringjalljes, në drejtim të Xhennetit dhe vatrës së lumturisë së përhershme, do ta kalojnë me përshpejtim, sepse lëvizja e shpejtë e dritës së tyre, nuk është e ndarë me lëvizjen e shpejtë të tyre.

Këtu flitet vetëm për dy drita, drita që lëviz para besimtarëve dhe drita që lëviz në anën e djathtë të tyre. Kjo shprehje mund të tregojë se bëhet fjalë për dy grupe të ndryshme besimtarësh. Për "grupin e të afërmve" ndaj Zotit, të cilët kanë

fytyra të shndritshme dhe drita e tyre ecën përpara tyre dhe "grupin e të djathtëve", drita e të cilëve ecën në anën e djathtë të tyre, sepse Libri i veprave të tyre do t'u jepet në dorën e tyre të djathtë dhe drita do të ngrihet nga ajo. Disa komentues të ajeteve kur'anore, kanë shprehur mendimin se të dy dritat mund të jenë aludim për një grup besimtarësh. Në këtë rast, drita e djathtë mendohet se buron prej veprave të tyre të mira, që kanë kryer dhe e ndriçon të gjithë rrethin e tyre.

Sidoqoftë, kjo dritë është udhëzimi i tyre për në Xhennetin e lartësuar dhe nën ndriçimin e saj, besimtarët e kalojnë me shpejtësi rrugën për në Xhennet.

Nga ana tjetër, pa dyshim që kjo dritë hyjnore, meqenëse lind nga besimi dhe vepra e mirë, ndryshon me ndryshimin e niveleve të besimit dhe të veprave të mira të njerëzve. Ata që kanë besim më të fortë, dritën e tyre e kanë me një rezonancë më të fortë, pra, ajo ndriçon një pjesë më të madhe të rrugës, kurse ata që kanë një nivel më të ulët besimi, kanë më pak dritë dhe rezonanca e saj është aq e kufizuar, sa ndriçon vetëm majën e gishtave të këmbëve të tyre. Për këtë, në tefsirin e "Ali bin Ibrahimit", në lidhje me ajetin në fjalë, thuhet: "Në Ditën e Gjykimit, drita do të ndahet në mesin e njerëzve, sipas besimit të tyre.".[1]

Atë ditë, engjëjt dëgjojnë një zë, i cili respekton besimtarët: **"Lajm i mirë sot për ju: kopshtet e Xhennetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të banoni përgjithmonë. Kjo është fitorja më e madhe!"**.

[1] "Nuru Thakalejn", vëll. 5, Hadithi 60, f. 241.

Kurse hipokritët, që ndodhen në errësirën e tmerrshme të mosbesimit dhe të mëkatit, do ta ngrenë zërin dhe duke qarë do të kërkojnë dritë nga besimtarët. Ata do të dëgjojnë vetëm një "jo" të prerë. Kjo sqarohet në ajetin vijues, në të cilin thuhet: **"Atë Ditë, hipokritët dhe hipokritet do t'u thonë besimtarëve: 'Na prisni edhe ne që të marrim nga drita juaj!'"**.

Fjala *"iktibas"* rrjedh nga rrënja *"kabes"* dhe është përdorur me kuptimin e marrjes së një flake nga zjarri. Më pas, është përdorur edhe për huazimin e sendeve të tjera.

Sifjalia: *"undh'uruna"* - **"na prisni edhe ne"**, është përdorur me kuptimin e kërkesës së hipokritëve për të marrë pak dritë nga drita e besimtarëve, që të ndriçohen prej saj dhe nën këtë dritë, të mund të gjejnë edhe ata rrugën drejt shpëtimit, së bashku me besimtarët. Disa komentues, kanë shprehur mendimin se kuptimi i sifjalisë: **"na prisni edhe ne"**, është pritja, që do të thotë: "Na jepni pak kohë, që edhe ne të bashkohemi me ju dhe nën ndriçimin e dritës suaj, të gjejmë dhe ne rrugën e duhur (drejt shpëtimit).".

Por, në çdo rast, ata do të marrin këtë përgjigje: **"Kthehuni prapa e kërkoni tjetër dritë!"**.

Sigurisht që nuk është fjala për përfitimin e dritës. Atë duhet ta kishin përfituar përmes besimit dhe veprave të mira në botën që e kanë lënë pas, por mjerë ata, se tani është tepër vonë dhe e kanë humbur këtë mundësi!

Në këtë kohë, papritur ndodh diçka: **"Dhe, ndërmjet tyre, do të vendoset një mur me portë…"**.

Në të dy anët e këtij muri të madh, ka nga një portë, të cilat ndryshojnë plotësisht nga njëra–tjetra: **"...brenda saj ka mëshirë, kurse jashtë saj ka dënim."**.

Fjala *"sur"* është përdorur me kuptimin e një muri, të cilin, në kohët e lashta, e ndërtonin përreth qyteteve për mbrojtje. Në gjuhën perse, përdorin shprehjen *"baru"* - *"fortesë"*. Në largësi të ndryshme, kishte kulla për roje dhe rojtarë, prandaj, përdornin këtë fjalë, me kuptimin *"kalaja e qytetit"*.

Për të sqaruar më mirë këtë, në ajet thuhet: **"... brenda saj ka mëshirë, kurse jashtë saj ka dënim."**. Kjo do të thotë, se ashtu siç gjenden banorët në brendësi të qytetit, edhe besimtarët ndodhen brenda këtij kopshti, kurse hipokritët ndodhen jashtë tij, ashtu siç të huajt dhe endacakët bredhin nëpër zona të pabanuara. Ata, në të kaluarën, jetonin në një shoqëri të përbashkët, pranë njëri–tjetrit, por një mur i madh, i përbërë nga bindje, ideologji dhe vepra të ndryshme i ndante ata me njëri–tjetrin. Edhe në Kiamet, e njëjta situatë do të jetë e personifikuar.

Por për çfarë është kjo "portë"? Ka gjasa që, përmes saj, hipokritët të shohin begatitë e Xhennetit dhe të ndiejnë keqardhje për veten e tyre, ose njerëzit që janë më pak të përlyer në mëkate, pas pastrimit dhe ndreqjes së tyre, të kalojnë nëpër këtë portë, për të zënë vendin e tyre në krah të besimtarëve.

Por ky mur nuk është i atillë, që të jetë pengesë për zërin, prandaj në ajetin vijues, thuhet: **"'A nuk kemi qenë me ju?' - do të thërrasin ata."**.

Edhe në këtë botë kemi jetuar në një shoqëri me ju, edhe këtu ishim afër jush. Çfarë ndodhi që papritur u ndatë nga ne dhe

u strehuat në begatinë dhe Mëshirën Hyjnore dhe ne na latë në kthetrat e dënimit?!

"Po, - do t'u përgjigjen."

Kudo ishim bashkë me njëri–tjetrin, në rrugë dhe në treg, në udhëtim dhe shërbim. Ndonjëherë ishim edhe komshinj me njëri–tjetrin, madje edhe pse ndonjëherë banonim nën një çati së bashku, ishim shumë milje larg njëri–tjetrit, për nga bindja, feja, besimi! Ju kishit ndarë me ne udhën tuaj dhe ishit larg së vërtetës, në parimet themelore dhe dytësore të fesë.

Më pas ajeti shton se kanë bërë gabime shumë të mëdha, si për shembull:

1- Ju keni mashtruar dhe keni shkatërruar veten tuaj, duke ndjekur rrugën e politeizmit: **"ju e çuat veten në tundim"**.

2- Gjithnjë ishit në pritje të vdekjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të besimtarëve dhe të zhdukjes së Islamit që në themel. **"Pritët."** Përveç këtyre, në kryerjen e çdo pune të dobishme dhe pozitive dhe në çdo lëvizje të drejtë, qëndronit mënjanë, në pritje dhe vonoheshit.

3- Gjithnjë dyshuat në Ringjalljen, në vërtetësinë e thirrjes profetike. Edhe në Kur'an **"dyshuat"**.

4- Gjithnjë vrapuat pas epshit dhe dëshirave tuaja të kota dhe boshe, dëshira që asnjëherë nuk do të plotësoheshin për ju,

gjersa erdhi Urdhri i All'llahut për vdekjen tuaj: **"u mashtruat nga vetë dëshirat tuaja të kota, derisa arriti urdhri i All'llahut"**.

Këto dëshira nuk ju lejuan, për asnjë moment, të reflektoni dhe të mendoni në mënyrë të drejtë, se ishit të zhytur në ëndrra, se jetonit në një botë me iluzione dhe imagjinata dhe mbi ju mbisundonte etja për t'i plotësuar dëshirat inferiore, epshet dhe qëllimet materiale.

Përveç këtyre, djalli mashtrues (i cili kishte forcuar praninë e tij në zemrën tuaj), ju mashtroi ju, në raport me besimin, të Dërguarin dhe me Zotin: **"djalli ju mashtroi për All'llahun"**.

Ai ju nxiti të bëheni arrogantë, botën jua paraqiste si të përhershme, ndonjëherë edhe Kiametin e konsideroi si një shpërblim iluzionues. Herë të tjera, ju mashtronte për mëshirën dhe mirësitë e Zotit, duke mohuar madje edhe vetë Zotin e Madhëruar.

Këto pesë lloje faktorësh e ndanë rrugën tuaj nga ne.

Fjala *"fetentum"* rrjedh nga rrënja *"fitne"*. Kjo fjalë përdoret me disa kuptime: me kuptimin e testimit dhe të sprovës, me kuptimin e mashtrimit, të fatkeqësisë. Në kontekste të caktuara, kjo fjalë përdoret edhe me kuptimin e dënimit, të devijimit, të degradimit, të politeizmit dhe të idhujtarisë. Në kontekstin e përdorur në ajetin që po diskutojmë, më shumë përshtatet me dy kuptimet e fundit, pra, me kuptimin e devijimit dhe të politeizmit.

Fjala *"terab'bestum"* rrjedh nga rrënja *"terab'bus"* dhe në thelb është përdorur me kuptimin e pritjes, qoftë të pritjes së fatkeqësisë dhe të të këqijave, qoftë të pritjes së bollëkut dhe të

begatisë. Në këtë ajet, kuptimisht, kjo fjalë përshtatet më shumë me pritjen e vdekjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të rrënimit të Islamit; ose të pritjes, në kuptimin e vonimit të pendimit për mëkatet e kryera, apo në pritje për të kryer një vepër të mirë.

Fjala *"uertebtum"* rrjedh nga rrënja *"rejb"* dhe përdoret për të emërtuar çdo lloj dyshimi dhe hamendësimi, të cilët më vonë qartësohen. Në kontekstin e ajetit që po diskutojmë, më shumë përshtatet me dyshimin për Kiametin, ose për vërtetësinë e Kur'anit.

Edhe pse kontekstet kuptimore të fjalëve të përdorura në këtë ajet janë mjaft të gjera, përsëri, pas konsultimesh mes komentuesve të Kur'anit, është pranuar se thelbi i këtyre fjalëve lidhet me çështjen e politeizmit, të pritjes së rrënimit të Islamit dhe ndarjes nga jeta të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Më pas, u lidh me dyshimin e lidhur me Ringjalljen dhe të devijimeve në praktikë, duke u dhënë pas dëshirave inferiore dhe duke ndjekur djallin. Si rrjedhojë, tri fjalitë e para, shprehin tri parimet themelore të fesë, kurse dy fjalitë e fundit u dedikohen çështjeve dytësore të fesë.

Si përfundim, besimtarët u drejtohen hipokritëve dhe u thonë: **"Sot nuk pranohet prej jush kurrfarë shpërblese e as prej atyre që nuk kanë besuar."**.

Në këtë mënyrë, edhe politeistët kanë të njëjtin fat si hipokritët dhe të gjithë do të gjykohen sipas mëkateve dhe veprave të veta të shëmtuara. Për ato nuk ka asnjë rrugë shpëtimi.

Më pas, ajeti shton: **"Zjarri është vendbanimi juaj, ai është për ju; eh, sa vendbanim i tmerrshëm që është ai!"**.

Njerëzit, zakonisht, për të shpëtuar nga kthetrat e dënimeve dhe ndëshkimeve në këtë botë, mbështeten ose në dëmshpërblimet financiare, ose kërkojnë ndihmë nga një përkrahës i fuqishëm, por atje, në Atë Botë, për hipokritët dhe jobesimtarët, nuk ekziston asnjë nga këto.

Parimisht, në Kiamet, të gjithë faktorët dhe mjetet materiale që përdoren për arritjen e synimeve të zakonshme në këtë botë, do të zhbëhen dhe lidhjet do të shkëputen, ashtu siç tregohet në ajetin 166 të sures "El Bekare": **"këputen lidhjet e tyre"**.

"O ju që keni besuar, para se të vijë Një Ditë kur nuk do të ketë as shitblerje, as miqësi e as ndërmjetësi..."[1]

"Dhe ruajuni prej Asaj Dite, kur askush askujt nuk do të mund t'i kryejë asgjë askujt, kur nuk pranohet për të (jobesimtarin) **ndonjë ndërmjetësim dhe nuk pranohet për të kompensim**..."[2]

"Atë Ditë nuk bën dobi asgjë miku për mikun, e as nuk mund të ndihmohen."[3]

"Ditën kur dredhia e tyre nuk do t'u bëj dobi asgjë e as që do të ndihmohen."[4]

---

[1] Sure "El Bekare", ajeti 254.
[2] Sure "El Bekare", ajeti 48.
[3] Sure "Ed Dukhan", ajeti 41.
[4] Sure "Et Tur", ajeti 46.

"Atë Ditë nuk do të ketë lidhje familjare mes tyre e as që do të pyesë kush për njëri–tjetrin."[1]

Thënë shkurt, **"tanimë, atyre nuk u bën dobi ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve."**.[2]

Në këtë mënyrë, Kur'ani na e bën të qartë se besimi dhe vepra e mirë janë të vetmet mjete shpëtimi në atë ditë. Rrethi i ndërmjetësimit është i kufizuar vetëm për ata persona që janë besimtarë dhe kanë kryer vepra të mira. Në mënyrë absolute, nuk do të ketë ndërmjetësim për ata që i kanë shkëputur lidhjet e tyre me Zotin dhe të dashurit hyjnorë.

Hulumtim

Kërkesat e kota të kriminelëve për ndihmë në Kiamet

Pjesa dërmuese e njerëzve, kur do të dalin përpara Zotit, nuk kanë dijeni për rregullat që mbizotërojnë atje. Ata, të gjithë, janë të mendimit se normat, traditat e kësaj bote vlejnë edhe në Atë Botë, prandaj dhe kërkojnë ndërmjetësim tek ato, por shpejt e kuptojnë se çfarë gabimi kanë bërë.

Shpeshherë kriminelët kërkojnë ndihmë nga besimtarët dhe thonë: **"Na prisni edhe ne që të marrim nga drita juaj!"**. Ata, shumë shpejt, do të përballen me përgjigje negative. Atyre do t'u

[1] Sure "El Mu'minun", ajeti 101.
[2] Sure "El Muddeththir", ajeti 48.

thuhet se burimi i dritës nuk është këtu. Ai ishte në botën tokësore, por ju u treguat neglizhentë ndaj saj.

Nganjëherë, kriminelët do të kërkojnë ndihmë nga njëri–tjetri, nga pasuesit dhe nga udhëheqësit e tyre dhe do të thonë: **"Ne ishim pasuesit tuaj, andaj a mund të na lehtësoni diçka nga Dënimi i All'llahut?"**. Edhe këtu, gjithashtu, do të përballen me përgjigje negative.

Ndonjëherë, kërkojnë ndihmë nga rojet e Xhehennemit dhe u thonë: **"...kërkoni nga Zoti që të na e ulë një ditë dënimin."**[1]

Ndonjëherë, i tejkalojnë edhe këto, dhe kërkojnë ndihmë nga Zoti i Madhëruar: **"Zoti ynë, na nxirr prej këtij dënimi, e, nëse gabojmë përsëri atëherë, vërtet, jemi mizorë!"**.[2]

Por, është më se e qartë që edhe kjo rrugë është e mbyllur për ta, sepse koha e përgjegjësisë ka mbaruar dhe atje është bota e ndëshkimit dhe e shpërblimit.

Ajetet 16 – 18

[1] Sure "El Mu'minun", ajeti 49.
[2] Sure "El Mu'minun", ajeti 106.

أَلَمْ يَأْنِ لِلَّذِينَ آمَنُوا أَنْ تَخْشَعَ قُلُوبُهُمْ لِذِكْرِ اللَّهِ وَمَا نَزَلَ مِنَ الْحَقِّ وَلَا يَكُونُوا كَالَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِنْ قَبْلُ فَطَالَ عَلَيْهِمُ الْأَمَدُ فَقَسَتْ قُلُوبُهُمْ وَكَثِيرٌ مِنْهُمْ فَاسِقُونَ١٦ اعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا قَدْ بَيَّنَّا لَكُمُ الْآيَاتِ لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ١٧ إِنَّ الْمُصَّدِّقِينَ وَالْمُصَّدِّقَاتِ وَأَقْرَضُوا اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا يُضَاعَفُ لَهُمْ وَلَهُمْ أَجْرٌ كَرِيمٌ١٨

"A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të All'llahut dhe para së Vërtetës që Ai ka Shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur."

"Dijeni, se All'llahu e ngjall tokën pas vdekjes së saj! Ne ju sqarojmë Shpalljet, në mënyrë që ju të kuptoni!"

"Ata që japin lëmoshë e që i japin All'llahut një hua të mirë, qofshin burra ose gra, do t'u shumëfishohet përfitimi dhe do të kenë një shpërblim fisnik."

Shkaku i zbritjes

Për ajetin 16 janë transmetuar shumë shkaqe zbritjeje. Midis tyre janë edhe këto:

Ajeti i përmendur ka zbritur për të sqaruar hipokritët. Ka zbritur një vit pas Hixhretit. Një ditë e pyetën Selam Farsiun: "Na trego për atë që është thënë në Teurat, sepse në Teurat ekzistojnë çështje të mahnitshme.". (Me anë të kësaj pyetjeje, hipokritët dëshironin që t'ia ulnin vlerën Kur'anit.) Për këtë arsye, pra, për të sqaruar këto situata, zbritën ajetet e para të sures "Jusuf." Selmani u tha atyre: "Ky Kur'an është rrëfyesi i ngjarjeve dhe i historive më të bukura, si dhe është më i dobishëm se çdo gjë tjetër për ju!".

Për një kohë u vetëpërmbajtën nga parashtrimi i ndonjë pyetjeje tjetër, por nuk kaloi shumë dhe sërish erdhën pranë Selmanit dhe përsëritën të njëjtën kërkesë. Në këtë kohë zbrit ajeti: **"All'llahu e Shpalli të folmen më të mirë, Librin, të ngjashëm në mrekulli, të përsëritur herë pas here** (me këshilla e dispozita)**, që prej** (dëgjimit të) **tij rrëqethen lëkurat e atyre që kanë frikë Zotin e tyre, e pastaj, me përkujtim ndaj All'llahut, të qetësohen lëkurat dhe zemrat e tyre. Ky Libër është Udhëzim i All'llahut. Ai me të udhëzon atë që do dhe e lë të humbur atë që do, për të cilin nuk ka ndonjë udhëzues."**.[1]

Përsëri, për një periudhë tjetër kohe, hoqën dorë nga kjo pyetje, por erdhën sërish, për të tretën herë te Selmani dhe përsëritën të njëjtën kërkesë. Në këtë kohë zbriti ajeti që po diskutojmë: **"A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që**

[1] Sure "Ez Zumer", ajeti 23.

zemrat e tyre të përulen para këshillave të All'llahut dhe para së Vërtetës që Ai ka Shpallur?!...”.

Një tjetër shkak zbritjeje është një situatë e vështirë për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe shokët e tij. Situata ishte e tillë: Për shkak të thatësirës dhe gjendjes shumë të mjerë në Mekë, u shpërngulën. Pas shpërnguljes, u bënë të pasur dhe gjetën bollëk. Jetesa e tyre pësoi ndryshim, por zemrën e disave e pushtoi babëzia, kur duhej t'u shtohej besimi, bindja dhe përkushtimi dhe të besonin me sinqeritet Kur'anin. Në këtë kohë zbriti ajeti i lartpërmendur dhe i këshilloi.[1]

Gjithashtu, ekzistojnë edhe shkaqe të tjera zbritjeje për këtë ajet, por janë të papërfillshme, ngaqë rrëfejnë se ajeti ka zbritur në Mekë, ndërkohë që është e njohur që e gjithë kjo sure, në tërësi, ka zbritur në Medine.

Komentimi

[1] Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 237; edhe në tefsirin “Durr'rrul Menthur” janë përmendur shkaqe zbritjeje, si për shembull, shkak zbritjeje, ngjashëm me shkakun e dytë të zbritjes (tefsiri “Durr'rrul Menthur”, vëll. 6, f. 175); “Bejdauij”, gjithashtu, në komentimin e tij “Enuarul Tenzijl”) ka përmendur këtë shkak zbritjeje.

Në ajetet e kaluara, u tregua për të gjitha ato paralajmërime, këshilla dhe shprehi, për fatin e dhimbshëm të hipokritëve dhe të politeistëve në Kiamet. Në ajetin 16, në formën e një përmbledhjeje, thuhet: **"A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të All'llahut dhe para së Vërtetës që Ai ka Shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur."**.[1]

Fjala *"takhsha"* rrjedh nga rrënja *"hushu"* dhe është përdorur me kuptimin: përulësi, mirësjellje trupore e shpirtërore, të cilat e karakterizojnë njeriun që mbart cilësi dhe vlera të larta morale.

Është e qartë se përkujtohet me sinqeritet dhe nga thellësia e shpirtit Zoti i Lartësuar dhe, në qoftë se artikulohen me korrektësi ajetet që thotë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, atëherë quhesh se je besimtar i Islamit. Kur'ani këtu kritikon ashpër një grup besimtarësh, të cilët nuk u përulën para këtyre këshillave të All'llahut. Përse edhe këta, si shumë popuj të tjerë të mëparshëm, janë bërë neglizhues dhe të pakujdesshëm?! Por mospërfillja dhe neglizhenca janë shkaku i mosbesimit, i ngurtësimit të zemrave, pas të cilave vjen mëkati dhe shthurja.

[1] Fjala *"je'n"* rrjedh nga rrënja *"enji"*, nga rrënja *"ina"* dhe nga rrënja *"enaj"*. Kuptimi është: afrimi dhe prania e kohës së një gjëje.

Vallë, a na mjafton vetëm të pretendojmë se jemi besimtarë?! Vallë, a përputhet me besimin, që të mjaftohemi vetëm me pretendimin e besimit dhe të mos u kushtojmë rëndësi çështjeve më të rëndësishme të fesë?! A përputhet me besimin, bërja e një jete komode dhe luksoze, plot kënaqësi trupore, pa menduar se mos po i kalon kufijtë e të qenit besimtar?!

Sijalia: *"tale alejhimul emed"* - **"me kalimin e një kohe të gjatë"**, ka mundësi të jetë përdorur me kuptimin e largësisë kohore mes tyre dhe Profetëve të tyre, ose me kuptimin e jetës së gjatë dhe ëndërrimeve të gjata, ose moszbritja e dënimit hyjnor për një kohë të gjatë ose, edhe me të gjitha këto kuptime, sepse çdo njëra nga këto mund të jetë faktor për të lindur injoranca dhe ligësia, për t'u ngurtësuar zemra, për t'u larguar nga besimi dhe për të përfunduar në shthurje dhe mëkat.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Mos nxitoni në kryerjen e asnjë pune, para se të arrijë koha e saj e më pas të bëheni pishman. As ndarja mes jush dhe të Vërtetës nuk duhet të jetë e gjatë, sepse zemrat tuaja ngurtësohen."*[1]

Në një hadith tjetër të transmetuar nga Profeti Mesih *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Mos flisni pa përmendur Zotin, sepse bëhet shkak i ngurtësimit të zemrës dhe zemra e ngurtësuar është larg Zotit. Mos i shikoni mëkatet e njerëzve, ashtu siç i shikojnë pronarët shërbëtorët e tyre, por shikojini mëkatet tuaja ashtu siç shërbëtori e shikon pronarin dhe eprorin e vet. Njerëzit ndahen në dy grupe: Një grup në vuajtje dhe i përlyer në mëkate dhe një grup tjetër në rehati dhe i*

[1] "Biharul Enuar", vëll. 78, Hadithi 85, f. 83.

lumtur. Për njerëzit në vuajtje, ndieni keqardhje dhe për rehatinë dhe lumturinë tuaj falënderojeni Zotin.”.[1]

Meqenëse ngjallja e zemrave, duke përkujtuar Zotin e Madhëruar dhe të jetuarit plot me pasuri shpirtërore, të cilat fitohen nën dritën e respektit dhe përulësisë ndaj Kur’anit, kanë shumë ngjashmëri me ringjalljen e tokave të vdekura nga pikat jetëdhënëse të shiut, në ajetin vijues thuhet: **“Dijeni, se All’llahu e ngjall tokën pas vdekjes së saj! Ne ju sqarojmë Shpalljet, në mënyrë që ju të kuptoni!”**.

Ky ajet tregon si për gjallërimin e tokave të vdekura me anë të shiut, ashtu edhe për ngjalljen e zemrave të vdekura me anë të përmendjes së Zotit dhe të Kur’anit Fisnik, i cili ka zbritur nga qielli si Shpallje në zemrën e pastër të Muhammedit *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Që të dyja janë të denja për meditim dhe reflektim.

Prandaj, në transmetimet islame janë përmendur të dyja.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: “Synimi i këtij ajeti është të tregojë ngjalljen e tokës me anë të drejtësisë, pasi të ketë vdekur nga padrejtësia.”[2]

Gjithashtu, edhe në një hadith tjetër të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)*, për komentimin e ajetit: **“Dijeni, se All’llahu e ngjall tokën pas vdekjes së saj!”**, lexojmë: *“Zoti i Madhëruar, do ta ngjallë tokën me anë të El Kaimu*

[1] Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 238.
[2] “Reudetul Kafij”, ngjashëm me transmetimin e tefsirit “Nuru Thakalejn”, vëll. 5, f. 243.

(imam Mehdiu), pasi ajo të ketë vdekur, me qëllim që besimtari të kuptojë, që edhe njeriu që nuk beson, mosbesimtari, ngjan si toka e vdekur!".[1]

Këto komente janë shembuj kuptimplotë dhe qartësojnë ajetin dhe assesi nuk e ezaurojnë kuptimin dhe konceptin e ajetit.

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Kadhimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* thuhet: *"Zoti i Madhëruar, me dritën e urtësisë, i ngjall zemrat e vdekura, ashtu siç ngjallen tokat me anë të shiut të begatë dhe të bekuar."*.[2]

Në ajetin vijues, sërish diskutimi i rikthehet çështjes së bamirësisë dhe të lëmoshës, të cilat janë frytet e pemës së besimit dhe të përulësisë. Ajeti përsërit të njëjtën shprehje që e lexuam në ajetet e kaluara me disa shtesa, kur thotë: **"Ata që japin lëmoshë e që i japin All'llahut një hua të mirë, qofshin burra ose gra, do t'u shumëfishohet përfitimi dhe do të kenë një shpërblim fisnik."**.

Pse çështja e "lëmoshës" është trajtuar si "hua e mirë" për Zotin? Për ç'arsye ekziston shpërblimi i shumëfishtë dhe i madh? Më gjerësisht, në lidhje me këtë, kemi diskutuar në ajetin 11 të po kësaj sureje.

Disa kanë supozuar se synimi i asaj që quhet "huaja e mirë", në këtë ajet dhe në ajetet e tjera të ngjashme me të,[3] është dhënia hua njerëzve, sepse Zoti nuk ka nevojë për hua. Njerëzit

[1] "Kemal'lud'din", ngjashëm me transmetimin e tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 242.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 78, f. 308.
[3] Sure "El Bekare", ajeti 245; sure "El Hadid", ajeti 11; sure "Et Tegabun", ajeti 17 dhe sure "El Muzzemmil", ajeti 20.

besimtarë janë ata që kanë nevojë për hua, por, duke pasur parasysh kontekstin e ajeteve, kuptohet që synimi i përdorimit të togfjalëshit **"hua e mirë"**, në të gjitha këto ajete, është: të japësh lëmoshë për hir të Zotit. Dhënia hua njerëzve konsiderohet si një prej veprave më të mira dhe për këtë nuk ka fare vend për dyshim.

Fadil Mikdad, në librin "Kenzul Irfan" përmend po këtë kuptim për bamirësinë, edhe pse atë e ka komentuar si të barabartë me çdo vepër të mirë.[1]

Hulumtim

Pendimi i njerëzve mëkatarë, pasi dëgjuan këtë ajet

Ajeti **"A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë..."**, është prej ajeteve të Kur'anit Fisnik, që zemrën dhe shpirtin e njeriut i bën për vete, i heq mënjanë perdet e injorancës dhe thërret me zë të lartë: "A nuk ka ardhur koha që zemrat me besim t'i përulen përmendjes së Zotit dhe asaj që ka zbritur nga i Vërteti?". Është thirrje që njeriu të mos bëhet si ata të mëparshmit, të cilët i kishin dëgjuar ajetet e Librit qiellor, por, nën efektin e kohës së gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan. Prandaj, gjatë historisë, vërejmë shumë njerëz mizorë, të cilët, kur kanë dëgjuar këtë ajet, janë tronditur aq shumë, saqë në çast janë larguar nga

[1] "Kenzul Irfan", vëll. 2, f. 58.

mëkatet e veta, madje disa prej tyre janë radhitur në rreshtat e të devotshmëve, si për shembull, historia e njohur e Fudhejl bin Ajjadhit.

Fudhejli ishte një bandit i rrezikshëm, të cilit i frikësoheshin të gjithë, por, kur dëgjoi ajetin për të cilin flasim, siç e tregojnë librat e biografisë së transmetuesve të hadithit, u bë i njohur si një prej transmetuesve të besueshëm nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe si nga njerëzit e devotshëm. Vitet e fundit të jetës së tij i kaloi pranë Qabes dhe u nda nga kjo jetë po aty, në Ditën e Ashures.

Në kohën që po kalonte pranë një lagjeje, pa një vajzë të re dhe u josh pas saj. Dashuria e zjarrtë që kishte për vajzën e re, e bëri të kapërcente natën murin e shtëpisë së saj. Ai kishte vendosur, që me çdo çmim, ta takojë atë. Në një nga shtëpitë përreth, ishte një besimtar i përkushtuar dhe i devotshëm. Ai po lexonte Kur'an dhe kishte arritur te ky ajet: **"A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të All'llahut?!..."**. Ky ajet depërtoi thellë në zemrën e "infektuar" të Fudhejlit si një shigjetë. Ai ndjeu brenda vetes një dhimbje dhe zjarrmi, u tund tepër, për pak çaste ra në mendime: "Kush është ky që po flet? Kujt po ia jep këtë mesazh? O Fudhejl! Vallë, a mua po më drejtohet? A nuk ka ardhur koha që të zgjohesh? Të kthehesh nga kjo rrugë e gabuar? Ta pastrosh veten nga këto mëkate dhe të pendohesh?".

Papritur Fudhejli zuri të fliste me zë të lartë dhe thoshte: "Betohem në Zot, se ka ardhur koha e asaj! Betohem në Zot, se ka ardhur koha e asaj, të përulemi përpara së Vërtetës!".

Ai tashmë kishte marrë vendimin e tij përfundimtar. Me një kapërcim të rrufeshëm, kaloi nga radha e banditëve në radhët e të mirëve. U zmbraps dhe zbriti nga muri dhe u fut në një rrënojë, ku ishte mbledhur një grup karvanësh dhe po këshilloheshin me njëri-tjetrin për udhën që duhet të merrnin deri te destinacioni dhe po thoshin: "Fudhejli dhe banda e tij janë në rrugë. Në qoftë se shkojmë atje, do të na zënë rrugën dhe do të na plaçkitin pasurinë!".

Fudhejli u trondit, kur dëgjoi këto fjalë dhe e qortoi rëndë veten e vet: "Sa njeri i keq jam unë! Çfarë mizorie është kjo, që më ka gjetur mua? Në mes të natës dola nga shtëpia për të kryer mëkat dhe disa besimtarë, nga frika ime janë strukur në një qoshe në këtë rrënojë!".

U kthye nga qielli dhe me një zemër të penduar, shqiptoi këto fjalë: "O Zot! Unë jam kthyer drejt Teje dhe jam penduar. Betohem që gjithnjë do të jem në afërsi të shtëpisë Tënde! O Zot, po vuaj dhe po më mundojnë veprat e këqija që kam kryer! Po vajtoj nga dëshpërimi! Të lutem, shëroma dhimbjen time, o Shërues i të gjitha dhimbjeve! O i Lartësuar dhe i Stërpastër nga çdo e metë! O i Panevojshëm nga shërbimi im! O i Padëmtuar nga tradhtia ime! Të lutem, me Mëshirën Tënde, më fal mua dhe më çliro nga ky robërim ndaj epshit dhe dëshirave inferiore që më kanë kapluar mua!".

Zoti i Madhëruar ia pranoi lutjen dhe u tregua bujar me të. Ai u kthye në Mekë dhe për vite me radhë jetoi aty duke u bërë një prej njerëzve të dashur të Zotit.

Disa komentues të Kur'anit kanë transmetuar se një prej burrave të njohur të Basrës po thoshte: "Po kaloja nëpër një rruge. Papritmas dëgjova një britmë. Shkova pas saj dhe pashë një burrë që kishte rënë pa ndjenja për tokë. Thashë: 'Kush është ky?'

Më thanë: 'Është një burrë shpirtmirë, i cili, me të dëgjuar një ajet nga Kur'ani, ra pa ndjenja'

Unë u thashë: 'Cilin ajet?'

Ata më thanë: **'A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të All'llahut…'**

Papritur, burri i rrëzuar dhe pa ndjenja, sapo dëgjoi zërin tonë, u ndërgjegjësua dhe filloi të lexojë vargjet e kësaj poeme prekëse:

'Vallë, a nuk ka ardhur koha, që t'i vijë fundi çastit të ndarjes,

që dega e gjatë dhe me aromë e shpresës sime të qeshë?

Vallë, a nuk ka ardhur koha,

që të qajnë për të dashuruarin e shkrirë

dhe trupdeformuar prej dashurie

e të ndiejnë keqardhje për të?

Po, me ujin e ekstazës,

zemrën time kam shkruar:

Kam shkruar një letër

që tregon për një faqe të bukur,

ngjyra–ngjyra dhe interesante.'

Më pas shtoi: 'Është problematike, është problematike, problematike!'

E tha këtë dhe një herë tjetër, ra pa ndjenja në tokë. E tundëm atë, por ai i kishte dhënë lamtumirën kësaj bote!'".[1]

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 27, f. 156.

Ajetet 19 – 20

وَالَّذِينَ آمَنُوا بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ أُولَٰئِكَ هُمُ الصِّدِّيقُونَ وَالشُّهَدَاءُ عِنْدَ رَبِّهِمْ لَهُمْ أَجْرُهُمْ وَنُورُهُمْ وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْجَحِيمِ١٩ اعْلَمُوا أَنَّمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا لَعِبٌ وَلَهْوٌ وَزِينَةٌ وَتَفَاخُرٌ بَيْنَكُمْ وَتَكَاثُرٌ فِي الْأَمْوَالِ وَالْأَوْلَادِ كَمَثَلِ غَيْثٍ أَعْجَبَ الْكُفَّارَ نَبَاتُهُ ثُمَّ يَهِيجُ فَتَرَاهُ مُصْفَرًّا ثُمَّ يَكُونُ حُطَامًا وَفِي الْآخِرَةِ عَذَابٌ شَدِيدٌ وَمَغْفِرَةٌ مِنَ اللَّهِ وَرِضْوَانٌ وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا مَتَاعُ الْغُرُورِ٢٠

"Ata që besojnë All'llahun dhe të Dërguarit e Tij, pikërisht ata janë njerëzit e sinqertë. Dëshmorët do të kenë te Zoti i vet shpërblimin dhe dritën e tyre. Kurse ata që nuk janë besimtarë dhe i mohojnë Shpalljet Tona, do të jenë banorë të zjarrit!"

"Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në Botën Tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e All'llahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme."

Komentimi

Bota nuk është gjë tjetër, veçse lojë e dëfrim

Në vazhdim të diskutimit të ajeteve të kaluara rreth besimtarëve dhe shpërblimeve të tyre te Zoti, në ajetet që po diskutojmë, tregohet: **"Ata që besojnë All'llahun dhe të Dërguarit e Tij, pikërisht ata janë njerëzit e sinqertë."**. Fjala *"siddik"* është paradigma hiperbolike e fjalës *"sidk"* dhe nënkupton personin e drejtë dhe të sinqertë. Tregon personin, vepra e të cilit mbështet dhe miraton Fjalën e Zotit. Tregon personin që është shembulli i plotë i sinqeritetit.

Fjala *"shuheda"*, është shumësi i fjalës *"shehid"* dhe rrjedh nga rrënja *"shuhud"*. Është përdorur me kuptimin: shoqërim me vrojtim, qoftë me syrin e jashtëm, qoftë me syrin e zemrës. Në qoftë se "dëshmitari" quhet shahid dhe shehid, (dëshmor), kjo ndodh për arsye të pranisë së tij dhe të vrojtimit të skenës (së krimit). Ky kuptim është i njëjtë me kuptimin që patëm sqaruar për "dëshmorët e rënë në Rrugën e Zotit", për shkak se ishin në fushën e luftës.

Por në lidhje me ajetin në fjalë, ka mundësi që fjala *"shehid"* të jetë në kuptimin: ra dëshmor, dëshmoi mbi veprat. Edhe nga ajete të tjera kur'anore tregohet se Profetët janë dëshmues për veprat e popujve të tyre. Ashtu si Profeti i Islamit është dëshmues

për ata, si dhe për të gjithë ymetin islam (ndjekësit e Islamit), edhe myslimanët janë dëshmues dhe dëshmitarë për veprat e njerëzve.[1]

Si rrjedhojë, pozita e "dëshmorëve" (që dëshmojnë mbi veprat), është një pozitë e lartë, që u përket njerëzve me besim.

Disa komentues të tjerë kanë supozuar që fjala *"shuheda"* është përdorur po me kuptimin e "dëshmorëve në Rrugën e Zotit", që do të thotë se njerëzit besimtarë do të shpërblehen me shpërblimet e dëshmorëve dhe konsiderohen si dëshmorë. Për ta qartësuar më mirë këtë çështje, në një hadith lexojmë: "Një person erdhi pranë Imam Sadikut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe i tha: 'Kërko nga Zoti, që mua të ma bëjë risk shehadetin.' Imami i tha: *'Besimtari është dëshmor.'*. Më pas lexoi këtë ajet: **"Ata që besojnë All'llahun dhe të Dërguarit e Tij, pikërisht ata janë njerëzit e sinqertë."**.[2]

Sigurisht, është e mundur edhe afrimi i të dy kuptimeve, sidomos nëse kemi parasysh faktin që në Kur'anin Fisnik, fjalët *"shehid"* dhe *"shuheda"*, zakonisht, janë përdorur për dëshmitë ndaj veprave apo për dëshmi për gjëra të tjera, të ngjashme me ato.

Sidoqoftë, Zoti i Madhëruar, besimtarët e sinqertë, i përshkruan me dy cilësi: Së pari, me cilësinë e sinqeritetit dhe, së dyti, me cilësinë e të qenit "dëshmues" Kjo tregon se me emrin *"besimtar"*, në ajetin që po diskutojmë, synohet të quhet një gradë

[1] Për më shumë informacion, shih po këtë tefsir, sure "El Haxhxh", ajeti 78, f. 184 dhe vëll. 3, sure "En Nisa", ajeti 41, f. 391.
[2] Tefsiri "Ajashij", sipas transmetimit të tefsirit "Nuru Thakalejn", vëll. 5, f. 244.

e lartë e besimit. Përndryshe, si është e mundur që besimtarit të zakonshëm t'i atribuohen këto dy cilësi?[1]

Ajeti shton: **"Dëshmorët do të kenë te Zoti i vet shpërblimin dhe dritën e tyre."**. Kjo shprehje e përgjithshme, tregon për shpërblimin e madh dhe dritën e tyre të jashtëzakonshme.

Në përfundim, ajeti thotë: **"Kurse ata që nuk janë besimtarë dhe i mohojnë Shpalljet Tona, do të jenë banorë të zjarrit!"**.

Duke i krahasuar këto dy grupeve me njëri–tjetrin, bëhet e qartë pozita e lartë e grupit të parë dhe fatkeqësia e degradimi i madh i grupit të dytë.

Duke u nisur nga fakti që në grupin e parë u diskutua për nivelin e lartë të besimit, diskutimet për grupin e dytë lidhen me një situatë krejt tjetër. Flitet për një mosbesim të ashpër, prandaj është përmendur edhe përgënjeshtrimi i ajeteve hyjnore.

Duke marrë parasysh që dashuria për këtë botë është burimi i çdo mëkati, në ajetin vijues paraqitet një skicë domethënëse për statutin e jetës në këtë botë, fazat e ndryshme, si

---

[1] Sipas komentimit e lartpërmendur, fjalia: **"pikërisht ata janë njerëzit e sinqertë'. 'Dëshmorët do të kenë te Zoti i vet'..."**, nuk shoqërohet me asnjë nënkuptim. Këtë grup besimtarësh e kanë konsideruar si objekt të "të sinqertëve dhe të dëshmorëve". Disa komentues, janë të mendimit se këta janë si të sinqertët dhe dëshmorët, e jo vetë ata, që do të thotë do të kenë shpërblimin e tyre. Ajeti, në thelb, ka qenë i tillë: "*ulaike lehum mithlu exhris sid'dik'kine uesh shuheda*" (tefsiri "Ruhul Meanij" dhe "El Mijzan", ajetet në fjalë). Natyrisht, referenca e përemrave te "*lehum*" dhe "*exhruhum*", gjithashtu, do të jetë e ndryshme. Ky komentim nuk përputhet me paraqitjen (e jashtme) të ajetit. (Kini kujdes!)

dhe motivet që mbizotërojnë në secilën fazë. Për këtë çështje, ajeti thotë: **"Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë!"**

Në këtë mënyrë, neglizhenca, dëfrimi, loja, vetëzbukurimi, mburrja dhe shumimi, formojnë periudhat pesëllojëshe të jetës së njeriut.

Në fillim, është periudha e fëmijërisë, ku jetesa kalon në një atmosferë neglizhence, padituri, dëfrimi dhe loje.

Pastaj vjen periudha e adoleshencës, gjatë të cilës dëfrimi e zë vendin e lojës. Në këtë periudhë njeriu shkon pas gjërave që e dëfrejnë dhe e mbajnë larg çështjeve serioze.

Periudha e rinisë është periudha e dashurisë, e pasionit dhe e dhënies pas stolive.

Pas kësaj, arrin faza e katërt. Në këtë periudhë, te njeriu zgjohen ndjenjat e arritjes së pozitës dhe krenarisë.

Më në fund, arrin faza e pestë, gjatë së cilës njeriu mendon për shtimin e mallit, rrethit, fëmijëve dhe pasurisë.

Fazat e para, pothuajse janë identike për të gjithë, sipas moshës së njeriut, kurse fazat e mëvonshme ndryshojnë krejtësisht te secili individ. Disa prej tyre, si p.sh. faza e shtimit të pasurisë zgjasin deri në fund të jetës, edhe pse disa janë të mendimit se çdonjëra nga këto periudha pesëllojëshe zgjat tetë vjet (në jetën e njeriut). Në tërësi shtrihen deri në moshën dyzet vjeçare. Kur arrin në këtë moshë, personaliteti i njeriut formohet.

Te disa njerëz, personaliteti i tyre ndalon që në fazën e parë dhe të dytë dhe deri në moshën e pleqërisë mendon për dëfrime, lojëra dhe zbavitje. Te disa të tjerë, personaliteti ndalon në periudhën e dhënies pas stolive. Këta persona e kanë mendjen te ambicia e tyre, deri në vdekje, për të siguruar shtëpinë, për të siguruar mjete dhe rroba të bukura. Këta mbeten fëmijë deri në moshën e pleqërisë.

Më pas, nëpërmjet një shembulli, sjell para syve fillimin dhe mbarimin e jetës së kësaj bote. Ajeti sjell këtë shembull: **"Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë."**.

Fjala *"kuffar"* këtu nuk është përdorur për të treguar njerëzit pa besim, por është përdorur për të treguar "bujqit". Në të vërtetë, në thelb, kuptimi i fjalës *"kufr"* është *"mbulimi"*. Por bujku quhet edhe *"kufir"*, për arsye se, pasi e mbjell farën e 'mbulon' atë me dhè. Ndonjëherë, fjala *"kufr"* përdoret edhe në kuptimin e *"varrit"*, sepse, kur i vdekuri varroset, e 'mbulojnë' trupin e xhenazes me dhè. Ndonjëherë, edhe nata quhet *"kafir"*, sepse errësira 'mbulon' çdo gjë.

Në realitet, ajeti që po diskutojmë, ngjason me ajetin 29 të sures "El Feth", kur flet për rritjen e bimëve të shumta. Ajeti thotë: **"Ata janë si një farë e mbjellë ku mbin filizi i vet, e ai trashet, përforcohet dhe qëndron në trungun e vet. Ajo e mahnit mbjellësin."** (Pra, në vend të fjalës *"kufar"* është përdorur fjala *"mbjellës"*.)

Disa komentuesit të ajeteve kur'anore kanë supozuar se me fjalën *"kuffar"*, këtu, shënohen politeistët dhe jobesimtarët. Në lidhje me këtë supozim, kanë përmendur disa justifikime.

Sidoqoftë, ky komentim nuk duket dhe aq i përshtatshëm, sepse dhe besimtari dhe politeisti çuditen njësoj nga dukuria e cituar.

Fjala *"hutam"* rrjedh nga fjala *"hatm"* dhe është përdorur me kuptimin e thyerjes dhe të copëtimit. Ndonjëherë edhe pjesëzat e shpërndara të kashtës, të cilat era i fluturon gjithandej, janë quajtur *"hetam"*.

Po, fazat nëpër të cilat njeriu kalon përgjatë jetës së tij shtatëdhjetëvjeçare apo më shumë, te bimët këto faza, materializohen vetëm në disa muaj. Njeriu, duke qëndruar në fushë, mund të shohë si në një film të shkurtër, fazat e jetës njerëzore.

Më pas, ajeti përqendrohet mbi përmbajtjen e jetës dhe produktin përfundimtar të saj. Për këtë ajeti thotë: **"Në Botën Tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e All'llahut dhe kënaqësia e Tij."**.

Në fund, ajeti përfundon me këtë fjali: **"Jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme."**.

Fjala *"gurur"* rrjedh nga fjala *"gurr"* dhe është përdorur me kuptimin: efekti i dukshëm i një gjëje. Prandaj, për shenjën e dukshme në ballin e kalit, përdoret fjala *"garre"*. Më pas, kjo fjalë është përdorur për të treguar neglizhencën dhe harresën, pikërisht për rastet kur njeriu duket se është i vetëdijshëm, por, në realitet, është i pandërgjegjshëm. Kjo fjalë përdoret edhe në kuptimin e mashtrimit dhe të dinakërisë.

Fjala *"meta"* përdoret për të treguar çdo lloj pajisje që shfrytëzohet, por që edhe të mashtron. Prandaj fjalia: **"Jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme."**, duhet të kuptohet se

jeta tokësore është një mjet dhe pajisje mashtruese. Ajo mashtron ata njerëz, që këtë botë e shohin si cakun e tyre përfundimtar dhe janë të magjepsur pas saj, mbështeten tek ajo dhe dëshira e tyre e fundit është bashkimi me të. Por, në qoftë se begatitë e kësaj bote materiale janë një instrument për realizimin e vlerave më të larta njerëzore dhe lumturinë e përhershme, asnjëherë nuk është diçka e ulët, përkundrazi është "plantacion" për Botën Tjetër, si dhe një urë për të arritur qëllime të mëdha dhe sublime.

Është e qartë se perceptimi i kësaj bote dhe i begative të saj, si një "vendkalim", apo si një "vendqëndrim", i jep njeriut dy orientime të ndryshme. Njëri është burim i konfliktit, i grindjes, i korrupsionit, i dhunimit, i padrejtësisë, i harresës dhe i rebelimit, kurse tjetri është mjet i zgjimit, i reflektimit, i njohjes, i përkushtimit, i sakrificës, i vëllazërisë dhe i faljes. Njeriu, sipas nivelit të besimit që ka, e zgjedh vetë drejtimin që do.

Hulumtime

1- Pozita e të sinqertëve dhe e dëshmorëve

Në Kur'anin Fisnik, disa nga të Dërguarit e mëdhenj dhe njerëz të ngjashëm me ta, janë përshkruar si *"siddik"* (tejet të sinqertë, të drejtë), si për shembull, Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*: **"Ai vërtetë ishte shumë i drejtë dhe**

Pejgamber.".[1] Edhe në lidhje me Idrizin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, të Dërguarin e madh të Zotit të Lartësuar, gjithashtu, është e përdorur e njëjta shprehje: **"Ai ishte shumë i drejtë dhe Pejgamber."**.[2]

Edhe për Merjemen, nënën e Isait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë, pothuaj, të njëjtën gjë: **"nëna e tij ishte e drejtë e ndershme..."**.[3]

Në disa ajete të tjera, gjithashtu, tregohet se të sinqertit dhe të drejtët gjithnjë janë përcaktuar në radhët e të Dërguarve të mëdhenj. Këtë e thekson edhe ajeti 69 i sures "En Nisa": **"E kushdo që i bindet All'llahut dhe të Dërguarit, do të jenë së bashku me ata që All'llahu i shpërblen, me Profetët, me besnikët e dalluar** (sid'dikin)**, me dëshmorët dhe me të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!"**.

Ashtu siç e trajtuam edhe më lart, fjala *"sid'dik"* është paradigma hiperbolike e fjalës *"sidk"*, e cila i atribuohet njeriut të sinqertë dhe të drejtë, njeriut të pastër në mendime e thënie, njeriut, për të cilin nuk flasin fjalët, por flet vepra e tij e mirë. Ky njeri quhet "sid'dik."

Me përcaktuesin "dëshmor" emërtohen ata persona, të cilët dhanë jetën e tyre, pse dëshmuan mbi veprat, si dhe ata persona, që dhanë jetën e tyre duke luftuar në Rrugën e Zotit. Por në ajetin që po diskutojmë, është i mundur afrimi i të dy këtyre përdorimeve kuptimore.

---

[1] Sure "Merjem", ajeti 41.
[2] Sure "Merjem", ajeti 56.
[3] Sure "El Maide", ajeti 75.

Sigurisht, cilësimi "*shehid*", në kulturën islame, nuk u përket vetëm atyre personave që vriten në sheshin e luftës, edhe pse ata janë shembulli më i qartë dhe e meritojnë të parët këtë cilësim, por të gjithë njerëzit që kanë bindje dhe ideologji të drejtë dhe hedhin hapa në Rrugën e Vërtetë dhe vdesin në këtë rrugë. Edhe këta persona, sipas transmetimeve islame, janë në mesin e dëshmorëve.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Çdo njëri nga ju, që ka njohuri për udhëheqjen supreme fetare, është në pritje të ardhjes së Imam Mehdiut, e përgatit veten për qeverinë e tij të drejtë botërore dhe i ngjan atij që ka luftuar përkrah Mehdiut dhe familjes së Muhammedit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!). Betohem në Zot, se ky njeri është si ai që ka luftuar së bashku me Profetin e Islamit!*".

Përsëri, për të tretën herë, shtoi: "*Betohem në Zot! Është i ngjashëm me personin që ka rënë dëshmor në tendën e tij!*". Vijoi më tej, duke thënë: "*Në lidhje me ju, në Kur'an ka zbritur një ajet.*". Transmetuesi i hadithit thotë se e pyeti: "T'u bëfsha kurban, për cilin ajet bëhet fjalë?"

Transmetuesi i haditit tha se kjo fjalë e Zotit thotë kështu: **"Ata që besojnë All'llahun dhe të Dërguarit e Tij, pikërisht ata janë njerëzit e sinqertë."**, *prandaj, betohem në Zot, se edhe ju, te Zoti juaj, jeni prej njerëzve të sinqertë dhe prej dëshmorëve.*".[1]

Këtë sqarim do e mbyllim me një hadith të transmetuar nga Imam Ali Bakiri *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Hadithi tregon se, kur një grup nga shokët e tij, prisnin me padurim momentet e

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 238.

luftës dhe të martirizimit në Rrugën e Zotit, Imam Ali Bakiri *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* mbajti këtë fjalim: *"Mos nxitoni në atë për çka All'llahu nuk ka kërkuar nxitim, sepse ai që do të vdesë në shtratin e vet, pasi e ka njohur të drejtën e Zotit, të drejtën e Profetit të Tij dhe të drejtën e pjesëtarëve të familjes së tij, vdes si dëshmor."*.[1]

2- Jeta e kësaj bote është plot me nxitës

Në ajete të ndryshme kur'anore jeta e kësaj bote është përshkruar si "lojë dhe dëfrim." Ajeti thotë: **"Jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim…"**.

Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër, vetëm se një përjetim e mashtrim.[2]

Ndonjëherë është përshkruar si lojë, dëfrim, bukuri dhe shumim (në ajetet që po diskutojmë).

Ndonjëherë, jetesa në këtë botë është përshkruar: **"Jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme."**.

Herë tjetër është përshkruar si një çështje aksidentale, sipërfaqësore dhe kalimtare: **"Mos i thoni atij që ju shpreh selamin dhe besimin se nuk je besimtar, duke kërkuar me të mjet** (mall) **të jetës së kësaj bote..."**.[3]

Nga tërësia e këtyre shprehjeve kur'anore qartësohet plotësisht pikëpamja e Islamit rreth jetës materiale dhe mirësive të saj, për të cilën ka një konsideratë jo të mirë. Të pasionohesh pas

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 190.
[2] Sure "El En'am", ajeti 32.
[3] Sure "En Nisa", ajetet 77 dhe 94.

jetës së kësaj bote dhe të bëhesh i varur prej saj, jepesh pas luksit, lakmisë, dëshirave, argëtimeve, etj, do të thotë të ecësh drejt rrugës që të çon në mëkate dhe vepra të këqija.

Por në qoftë se këto mirësi materiale ndryshojnë drejtim dhe shndërrohen në mjete dhe mundësi për të arritur te qëllimet hyjnore, ato do të bëhen kapital, thesar i vërtetë te Zoti i Madhëruar, i Cili këta besimtarë i fton në Xhennetin e përhershëm dhe në lumturinë e përhershme: **"All'llahu 'bleu' prej besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre me Xhennet..."**.[1]

[1] Sure "Et Teube", ajeti 111.

Ajetet 21 – 24

سَابِقُوا إِلَى مَغْفِرَةٍ مِنْ رَبِّكُمْ وَجَنَّةٍ عَرْضُهَا كَعَرْضِ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ أُعِدَّتْ لِلَّذِينَ آمَنُوا بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ ذَلِكَ فَضْلُ اللَّهِ يُؤْتِيهِ مَنْ يَشَاءُ وَاللَّهُ ذُو الْفَضْلِ الْعَظِيمِ٢١ مَا أَصَابَ مِنْ مُصِيبَةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي أَنْفُسِكُمْ إِلَّا فِي كِتَابٍ مِنْ قَبْلِ أَنْ نَبْرَأَهَا إِنَّ ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ٢٢ لِكَيْلَا تَأْسَوْا عَلَى مَا فَاتَكُمْ وَلَا تَفْرَحُوا بِمَا آتَاكُمْ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ٢٣ الَّذِينَ يَبْخَلُونَ وَيَأْمُرُونَ النَّاسَ بِالْبُخْلِ وَمَنْ يَتَوَلَّ فَإِنَّ اللَّهَ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ٢٤

"Prandaj rrekuni me njëri-tjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka, që është e përgatitur për ata që i kanë besuar All'llahut dhe të Dërguarve të Tij. Ajo është mirësia e All'llahut, që Ai ia jep kujt të dojë; e All'llahu ka mirësi të pafund."

"S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër (Leuhi Mahfûdh) **më parë se ta krijojmë atë. Kjo për All'llahun është vërtet e lehtë!"**

"(Këtë paracaktim e kemi bërë) **që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë. All'llahu nuk i do kryelartët mburravecë"**

“e as ata që, përveçse janë vetë koprracë, i nxisin edhe të tjerët në koprraci. Kushdo që nuk ia vë veshin kësaj, le ta dijë se All’llahu është i Vetëmjaftueshmi dhe i Denji për çdo lavd.”

Komentimi

Një garë e madhe shpirtërore

Pasi shprehu paqëndrueshmërinë e kësaj bote dhe të kënaqësive të saj, pasi shprehu edhe faktin që njerëzit, edhe me pasuritë me vlerë të vogël të kësaj bote, pretendojnë krenari dhe superioritet ndaj njëri–tjetrit, në ajetet që po diskutojmë, Zoti i fton njerëzit në një garë të madhe shpirtërore, në rrugën e fitimit të asaj që është e qëndrueshme dhe e denjë për çdo lloj përpjekje. Ajeti 21 thotë: **“Prandaj rrekuni me njëri-tjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka, që është e përgatitur për ata që i kanë besuar All’llahut dhe të Dërguarve të Tij.”**.

Në fakt, Falja e Zotit është çelësi i Xhennetit, i atij Xhenneti, që përfshin të gjithë qiellin dhe tokën, që tani është i gatshëm të mirëpresë besimtarët, për të mos thënë askush se Xhenneti është një premtim dhe premtimit nuk i duhet besuar. Edhe në qoftë se supozojmë se është një premtim, ai premtim është krejt i sigurt se do të realizohet, sepse është premtuar nga Zoti i Madhëruar dhe i

Plotfuqishëm për çdo gjë! Po kur të jetë bërë realitet, çdo të themi?!

E njëjta situatë është sqaruar në një vend tjetër në Kur'an, pikërisht në suren "Ali Imran", në ajetin 133, vetëm me një dallim. Këtu fjala *"sabiku"* rrjedh nga fjala *"musabike"*, kurse atje fjala *"sariu"* rrjedh nga *"musarie"*, e cila është përdorur me kuptimin e përshpejtimit ndaj njëri–tjetrit. Por, gjithsesi, këto fjalë janë shumë të përafërta nga ana kuptimore (pasqyron dyluftimin e dy personave).

Dallimi tjetër është se atje thuhet: *"aradhuhas semauatu uel erdh"*- **"dhe për në një Xhennet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës..."**, kurse këtu, në ajetin në fjalë, thuhet: *"ke erdhis semai uel erdh"* **– "një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka"**. Pra, shihet qartë se të në të dy rastet, shprehet i njëjti kuptim.

Po ashtu, ajeti atje thotë: **"Është i përgatitur për të devotshmit"**, kurse këtu thotë: **"është e përgatitur për ata që i kanë besuar All'llahut dhe të Dërguarve të Tij..."**. Pra, sërish shprehet i njëjti kuptim.

Duke pasur parasysh faktin se devotshmëria është fryt i besimit të drejtë, edhe këto dy shprehje, gjithashtu, janë të ndërvarura me njëra–tjetrën.

Në këtë mënyrë, të dy ajetet diskutojnë për të njëjtën të vërtetë, por me dy shprehje të ndryshme, prandaj supozimi i disa komentuesve se ajeti i sures "Ali Imran" është tregues për Xhennetin e "të afërmve", kurse ajeti që po diskutojmë, është tregues për Xhennetin e "besimtarëve", nuk duket i saktë.

Sidoqoftë, fjala *"ardh" - "gjerësisë"*, në këtë ajet, nuk është përdorur si antonim i fjalës *"gjatësi"*, ashtu siç janë shprehur një grup komentuesish, të cilët përpiqen të zbulojnë gjatësinë e një Xhenneti, gjerësia e të cilit është sa qielli dhe Toka. Por këto përpjekje kanë hasur në vështirësi të mëdha. Përkundrazi, fjala *"ardh"*, në përdorime të tilla, është në kuptimin e *"hapësirës së gjerë"*, ose *"rrafshinë"*, siç themi në shqip: rrafshina e kësaj fushe...

Përdorimi i fjalës *"magfiret"* dhe falje para përgëzimit me Xhennet, që është përmendur në të dy ajetet, është një tregues i pastrimit të njeriut nga mëkati, sepse pa qenë i pastruar nga çdo e keqe e mëkat, njeriu nuk do të jetë i denjë për të hyrë në Xhennet e as t'i afrohet Zotit të Madhëruar.

Gjithashtu, është e nevojshme të mos harrojmë se nxitimi për në faljen e Zotit të Madhëruar kryhet me anë të mjeteve të përshtatshme, si për shembull, me "pendim" dhe "plotësimin e adhurimeve, (riteve dhe shërbesave) të lëna anash". Në thelb, shërbimi dhe nënshtrimi ndaj Zotit, konsiston në largimin prej mëkateve.

Në qoftë se disa hadithe, apo disa komentime, janë mbështetur mbi disa rite dhe obligime të pëlqyeshme, si: nxitimi për të qëndruar në rreshtin e parë të namazit, pra, kur falja bëhet me xhemat, ose zënia e rreshtit të parë në luftë, ose tekbirul ihram -me imamin e namazit kolektiv, apo falja e namazit, në fillim të kohës së tij, të gjitha këto janë treguese të ecjes në rrugën e devotshmërisë, e cila të ofron te falja e Zotit të Madhëruar.

Në fund të ajetit 21 thuhet: **"Ajo është mirësia e All'llahut, që Ai ia jep kujt të dojë; e All'llahu ka mirësi të pafund."**.

Pa dyshim që një Xhennet të tillë, të gjerë dhe me gjithë ato mirësi të mëdha në të, nuk është një gjë, të cilën njeriu mund ta përfitojë me anë të veprave (shërbesave) të vogla e të papërfillshme, por është mirësia dhe begatia e pafund e Zotit, që ka përcaktuar këtë shpërblim të madh në këmbim të këtyre veprave të pakta. Prej Tij nuk pritet gjë, përveç kësaj, sepse shpërblimet jo gjithnjë janë në shkallën e veprave, por janë në përputhje me shkallën e bujarisë së shpërblyesit.

Sidoqoftë, kjo shprehje na e bën të qartë se vlerësimi për veprat e kryera, nuk është shpërblimi apo ndëshkimi, por është një lloj bujarie dhe mëshire nga ana e Zotit të Madhëruar.

Më pas, për ta theksuar edhe më shumë mospëlqimin e varësisë ndaj kësaj bote, mospëlqimin me kënaqësitë dhe me lukset e saj, si dhe me moskënqajen me trishtimin nga fatkeqësitë e saj, ajeti 22 shton: **"S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër** (Leuhi Mahfûdh) **më parë se ta krijojmë atë. Kjo për All'llahun është vërtet e lehtë!"**.[1]

Po, fatkeqësitë që ndodhin në tokë, si: tërmetet, përmbytjet, uraganet dhe fatkeqësi të tjera të ndryshme, apo fatkeqësitë që godasin individët, siç është vdekja dhe lloje të tjera fatkeqësish të dhimbshme, janë përcaktuar që në fillim dhe janë të ruajtura në Librin hyjnor "Leuhi Mahfudh".

[1] Janë dhënë mendime të shumta, se kujt i referohet përemri *"nebreeha"*. Disathonë se i referohet "tokës" dhe "frymorëve"; disa të tjerë "fatkeqësisë" dhe disa të tjerë, të gjitha bashkë. Duke pasur parasysh tonalitetin e ajetit, më i përshtatshëm duket kuptimi i parë, sepse dëshiron të thotë, madje edhe para krijimit të tokës, qiellit dhe juve, këto fatkeqësi ishin parashikuar.

Duhet të kemi parasysh faktin se fatkeqësitë, të cilat janë përmendur në ajetin në fjalë, janë vetëm fatkeqësitë, që nuk mund të shmangen në asnjë mënyrë, si dhe nuk janë si rezultat i dëshirës së njerëzve. Ato janë rezultat i veprave tuaja.

Këtë gjë e dëshmon dhe ajeti 30 i sures "Esh Shura", në të cilin thuhet: **"Çfarë do e keqe që mund t'ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja** (të këqia) **e për shumë të tjera Ai u falë."**.

Duke pasur parasysh faktin që këto janë komente ajetesh, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën, ndodh që të bëhet fjalë që fatkeqësitë që e prekin njeriun, të jenë të dyllojshme: fatkeqësi që janë ndëshkim për mëkatet që ka kryer. Fatkeqësi të tilla janë të shumta.

Së dyti, fatkeqësi që vijnë nga: padrejtësitë, mizoritë, tradhtitë, privimet, devijimet dhe të ngjashme me këto, të cilat janë burim i shumë fatkeqësive të formuara nga vetë ne.

Por ekzistojnë disa fatkeqësi, për të cilat ne nuk kemi asnjë rol dhe e prekin njeriun apo një shoqëri si një çështje e patjetërsueshme dhe e pashmangshme. Këto lloj fatkeqësish ndryshojnë nga të parat. Këto fatkeqësi, zakonisht prekin shumë prej të Dërguarve, prej njerëzve të dashur dhe të drejtë të Zotit. Këto fatkeqësi kanë një filozofi të posaçme, të cilën e kemi trajtuar në diskutimet që lidhen me Njohjen e Zotit dhe Drejtësinë hyjnore dhe me çështjen e fatkeqësive dhe të shqetësimeve.

Prandaj në një hadith lexojmë: "Në kohën që Imam Ali bin Hysejnin (Zejnul Abidinin) e futën në oborrin e Jezidit, të prangosur me pranga dhe me zinxhir, ky i fundit u kthye nga Imami dhe lexoi ajetin e sures "Esh Shura": **"Çfarëdo e keqe që**

mund t'ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija)**..."** (nëpërmjet këtij ajeti, dëshironte të thoshte se fatkeqësitë që kanë goditur familjen tuaj, si rënia dëshmor e Imam Hysejnit, janë rezultat i veprave tuaja. Në këtë mënyrë tallej me ta.). Por Imam Ali bin Hysejnin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, menjëherë ia ndërpreu fjalën dhe i tha: "Nuk është kështu. Ky ajet nuk ka zbritur rreth nesh. Ajo që ka zbritur për ne, është një ajet tjetër, që thotë: **"S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër** (Leuhi Mahfûdh) **më parë se ta krijojmë atë."** (Ka një filozofi dhe urtësi.).[1]

Në lidhje me këtë çështje, kemi diskutuar gjerësisht në ajetin 30 të sures "Esh Shura".[2]

Gjithashtu, edhe nxënësit e shkollës së Ehli Bejtit, nga ky ajet kanë nxjerrë të njëjtën domethënie dhe kuptim. Ata kanë transmetuar: "Kur Said bin Xhubejrin e sollën pranë Haxhaxhit dhe ky mori vendim për vrasjen e tij, një nga të pranishmit filloi të qante."

Saidi tha: "Përse po qan?"

Njeriu i tha: "Për shkak të kësaj fatkeqësie që të ka goditur ty."

Said bin Xhubejri tha: "Mos qaj, kjo ka qenë e shkruar te dija e Zotit, që kështu të ndodhë. Vallë, a nuk ke dëgjuar që Zoti

[1] Tefsiri "Ali bin Ibrahim", ngjashëm me transmetimin në tefsirin"Nuru Thakalejn", vëll. 5, f. 247.

[2] Gjithashtu, në vëll. 4, f. 20 e tutje, në ajetet 78-79, kemi diskutuar një çështje tjetër, që përputhet me ajetet që po diskutojmë.

thotë: **"S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër** (Leuhi Mahfûdh) **më parë se ta krijojmë atë."**?[1]

Sigurisht, të gjitha ngjarjet që ndodhin në këtë botë janë të regjistruara në Librin hyjnor "Leuhi Mahfudh" dhe te dija e pafund e Zotit. Në qoftë se këtu është folur vetëm për fatkeqësitë e ndodhura në tokë dhe fatkeqësitë që u ndodhin individëve, kjo është për shkak se tema e diskutimit ka qenë në lidhje me këtë domethënie dhe, ashtu siç do ta shohim edhe në vijim, në ajetin vijues, do të nxirret përfundim nga po kjo çështje.

Ndërkaq, fjalia: **"Kjo për All'llahun është vërtet e lehtë!"**, përcjell kuptimin se shënimi dhe ruajtja e të gjitha këtyre ngjarjeve në "Leuhi Mahfudh", me gjithë diversitetin e jashtëzakonshëm të tyre, është e lehtë për Zotin.

Me "Leuhi Mahfudh" shënohet dija e pafund e Zotit, ose pamja e botës së krijuar, si dhe sistemi i shkakut dhe pasojës, i cili, në llojin e tij, është element i dijes aktuale të Zotit.

Tani le të shohim se cila është filozofia e përcaktimit të këtyre fatkeqësive në "Leuhi Mahfudh" e më pas, cila është shprehja e kësaj filozofie në Kur'an. Ajeti në vijim tregon arsyen pse ndodhin këto fatkeqësi: **"**(Këtë paracaktim e kemi bërë) **që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë."**.

Këto dy fjali të shkurtra, në realitet, zgjidhin një prej çështjeve tepër të koklavitura të filozofisë së krijimit, sepse njeriu, në këtë botë të krijuar, përballet gjithnjë me probleme, vështirësi

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 375.

dhe ndodhi të papritura. Zakonisht pyet veten: "Megjithëse Zoti është i dashur, i Mëshirshëm dhe i Madhëruar, përse, vallë, më ndodhin gjithë këto ngjarje të dhimbshme?!".

Kur'ani thotë se qëllimi ka qenë që ju mos të mbeteni peng i stolive dhe joshjeve të kësaj bote.

Synimi ka qenë që të mos ngatërroni realitetin e këtij vendkalimi që quhet botë, si dhe pozitën tuaj në këtë botë; të mos dashuroheni dhe pasionoheni pas kësaj bote, si dhe të mos mashtroheni, duke e konsideruar atë si të përhershme, sepse kjo varësi dhe pasioni i zjarrtë për të, është armiku më i madh i lumturisë suaj. Ju bën ju të neglizhoni përkujtimin e Zotit, si dhe ju shmang nga Udha e përsosmërisë.

Këto fatkeqësi, janë një kambanë për rizgjim dhe reflektim për mospërfillësit dhe një kamxhik për shpirtrat e fjetura; janë tregues për natyrën e kësaj bote e tregues për shkurtësinë e jetës së kësaj bote.

E vërteta është se manifestimet joshëse të këtij "vendqëndrimi të kotë" e tërheqin dhe e argëtojnë njeriun, e largojnë atë nga përmendja e Zotit. Ai zgjohet papritmas, por sheh se karvani ka shkuar larg dhe ai mbetet në shkretëtirën e mashtrimit të kësaj bote.

Këto ngjarje, gjithnjë, kanë qenë dhe do të jenë në jetën tokësore. As përparimet e mëdha shkencore nuk kanë arritur dhe nuk do të arrijnë t'i parandalojnë këto fatkeqësi të trishtueshme, siç janë: tërmetet, stuhitë, përmbytjet dhe sëmundjet. Këto fatkeqësi janë një mësim nga "pabesia e kohës së paturpshme"

dhe i drejtohen njeriut duke i thënë: "Kjo fushë është vendi i fjetjes së martirëve, shfrytëzo kohën për ta soditur.".

Kjo nuk është me kuptimin që njeriu, në këtë botë, të shkelë me këmbë begatitë hyjnore, ose të mos përfitojë prej tyre. E rëndësishme është të mos mashtrohet pas tyre dhe të mos e konsiderojë botën si vendin e vet përfundimtar.

Duhet të kemi parasysh faktin se për të kaluarën, përdor shprehjen *"fatekum"* - **"për atë që ju ka kaluar"**, kurse në lidhje me begatitë dhe mirësitë e përfituara që ia atribuon Zotit, ajeti thotë: **"Ai ju ka dhënë"**, sepse zhdukja dhe asgjësimi qëndrojnë brendapërbrenda esencës së gjërave, sepse është qenia ajo që buron nga mirësia dhe furnizimi i Zotit.

Po, këto fatkeqësi janë goditje për arrogancën dhe mburrjen e treguar, prandaj në fund të ajetit, thuhet: **"All'llahu nuk i do kryelartët mburravecë…"**.

Fjala *"mukhtal"* rrjedh nga rrënja *"khijal"* - *"imagjinatë"* dhe është përdorur me kuptimin: mburrje, sepse mburrja dhe arroganca burojnë nga fakti se personi në fjalë, e imagjinon veten mbi të tjerët.

Fjala *"fekhur"* është paradigma hiperbolike e fjalës *"fekhr"* dhe është përdorur për të treguar atë person, i cili vetëlavdërohet te të tjerët.

Me këto veti cilësohen vetëm ata persona që janë të dehur nga pasuria dhe rehatia. Goditja me fatkeqësi dhe shqetësime ndikon pozitivisht tek ata persona që janë të predisponuar të

zgjohen dhe të udhëzohen dhe zhduk tek ata këtë dehje dhe efektet e saj.

Njerëzit besimtarë, duke pasur parasysh parimin e lartpërmendur, në kohën që bekohen me begati, nga ana e Zotit, veten e konsiderojnë si amanetmbajtës të saj. Ata, as brengosen për humbjen e saj e as dehen dhe mburren me shtimin e saj. Në realitet, atyre u duket vetja si përgjegjësit e thesarit të shtetit, të cilët, një ditë, pranojnë pasuri të madhe dhe ditën tjetër dorëzojnë me mijëra e mijëra pasuri dhe as dehen dhe as gëzohen për pranimin e saj dhe as brengosen nga dorëzimi i saj.

Interesante është thënia që lidhet me po këtë ajet, në fjalimin e Imam Aliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Ai thotë: *"Tërësia e të përmbajturit nga kjo botë, është përfshirë midis dy thënieve kur'anore.* All'llahu i Madhëruar thotë: **'Të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë.'"**.

"Kush nuk pikëllohet për atë që i ka shpëtuar dhe nuk gëzohet për atë që do të vijë, arrin të përmbahet nga kjo botë nga dy anët e saj."[1]

Çështja tjetër është te përqendrimi i vëmendjes ndaj parimit të dështimit, që në fillim të jetës së njeriut. Këto dështime e shoqërojnë atë dhe janë të përcaktuara në bazë të traditës së urtë, sepse bota, gjithnjë, ka uljet dhe ngritjet e saj. Këto ulje-ngritje, e bëjnë njeriun të durueshëm dhe të qëndrueshëm në përballimin e fatkeqësive, vështirësive; e bëjnë që t'i përballojë me guxim ngjarjet tronditëse dhe të rënda, e ngushëllon atë dhe e bën që të përballojë vuajtjet dhe sëmundjet.

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalë të urta, Fjala 448.

Por, sërish e theksojmë, që kjo vlen vetëm për fatkeqësitë, të cilat janë të pashmangshme, kurse fatkeqësitë dhe dështimet, të cilat janë pasojë e mëkateve dhe neglizhencës së vetë njeriut, janë jashtë kësaj kategorie dhe mënyra për t'u marrë me ato, është përpjekja e vazhdueshme për të qenë i devotshëm dhe i pastër në besim, kryerjen e veprave të mira, etj.

Këtë diskutim do ta mbyllim me një histori, të cilën e kanë cituar disa komentues të Kur'anit:

Kutejbe bin Saidi[1] thotë: "Hyra në territorin e një prej fiseve arabe dhe pashë në shkretëtirë plot deve të ngordhura, të cilat ishte e pamundur t'i numëroje. Aty pashë edhe një grua të moshuar dhe e pyeta: 'Të kujt kanë qenë këto deve?'

Ajo tha: 'Ishin të atij plakut, i cili është ulur mbi atë grumbull dhe po shijon rrezet e ngrohta.'

Shkova tek ai dhe i thashë: 'Të tuat ishin gjithë këto deve?'

Ai më tha: 'Kanë qenë në emrin tim!'

I thashë: 'Cila është arsyeja që kanë përfunduar në këtë gjendje?'

Në përgjigje (pa treguar ndonjë shenjë pikëllimi për fatkeqësinë dhe shkakun e ngordhjes së tyre), tha: 'I mori Ai që m'i kishte dhënë.'

I thashë: "Nuk je i shqetësuar dhe a nuk thua ndonjë gjë në lidhje me këtë?' Ai më tha: "Po, dhe rrecitoj këto dy vargje:

[1] Futejbe bin Said është një prej hadithologëve, i cili transmeton nga Malik bin Uns" (munteha ei irb).

'Betohem në Zotin e Madhëruar, që unë jam një rob nga krijesat e Tij! Betohem se njeriu në këtë botë është i ekspozuar ndaj vuajtjeve dhe sprovimeve.'

Edhe nëse devetë e mia do të ishin në stallën e tyre dhe nuk do të ndodhte ky paracaktim hyjnor që ndodhi, nuk do të gëzohesha. Unë kënaqem vetëm me kënaqësinë e Zotit dhe çdo gjë që Ai dëshiron, po atë e dua dhe e pranoj edhe unë.'".[1]

Ajeti 24 është një përshkrim dhe komentim mbi atë që u tha në ajetin më lart. Në fakt, ky ajet tregon për mburrjen e arrogantit. Ajeti thotë: **"...as ata që, përveçse janë vetë koprracë, i nxisin edhe të tjerët në koprraci."**.

Të jesh shumë i dhënë pas begative të kësaj bote është mendjemadhësi dhe arrogancë. Edhe të qenët koprrac dhe thirrja e të tjerëve në koprraci, është tregues i mendjemadhësisë dhe i mburrjes, madje këto cilësi, mendjemadhi i konsideron si pasuri dhe nuk dëshiron t'i humbasë asnjëherë. Kurse thirrja e të tjerëve në koprraci, ndodh për këtë arsye:

Së pari, në qoftë se të tjerët janë bujarë, ai do të turpërohet, prandaj do të ketë koprracë të tjerë pranë vetes.

Së dyti, për shkak se ai që është koprrac, e do koprracinë, prandaj bën propagandën e asaj që dashuron.

Së treti, koprraci do që të mos imagjinohet këmbëngulja e Zotit mbi të qenët bamirës dhe heqjen dorë nga koprracia, madje, sipas shprehjeve të ajeteve të kaluara "marrjen e huas prej njerëzve nga ana e Zotit", me qëllim nxitjen e tyre për bamirësi, e

[1] Tefsiri "Ebul Fetuh Razij", vëll. 11, f. 53, tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 376.

cila buron nga nevoja Esenciale e Zotit. Për të sqaruar më mirë këtë, ajeti në fund shton: **"Kushdo që nuk ia vë veshin kësaj, le ta dijë se All'llahu është i Vetëmjaftueshmi dhe i Denji për çdo lavd."**.

Që të gjithë kanë nevojë për All'llahun dhe Ai nuk ka nevojë për asnjë, sepse depot dhe burimet kryesore të të gjitha gjërave janë tek Ai. Meqë Ai ka të gjitha cilësitë e përsosmërisë, është i denjë për çdo lavdërim dhe lartësim.

Edhe pse koprracia, në ajetin e lartpërmendur, u komentua më shumë si shembulli i "koprracisë në bamirësi dhe ndihmë financiare", konotacioni kuptimor i kësaj shprehjeje ka një kuptim të gjerë, i cili përfshin edhe koprracinë në dituri, edhe shlyerjen e të drejtave dhe obligimeve dhe koncepteve të ngjashme me këto.

Ajeti 25

لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنْزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ وَأَنْزَلْنَا الْحَدِيدَ فِيهِ بَأْسٌ شَدِيدٌ وَمَنَافِعُ لِلنَّاسِ وَلِيَعْلَمَ اللَّهُ مَنْ يَنْصُرُهُ وَرُسُلَهُ بِالْغَيْبِ إِنَّ اللَّهَ قَوِيٌّ عَزِيزٌ﴿٢٥﴾

"Ne i çuam të Dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) **dhe peshoren** (e drejtësisë)**: që njerëzit të veprojnë drejt. Ne e zbritëm hekurin, në të cilin ka** (material për) **luftë të fuqishme dhe dobi** (të tjera) **për njerëzit, me qëllim që All'llahu të njohë ata që e ndihmojnë Atë dhe të Dërguarit e Tij, pa e parë Atë. Me të vërtetë, All'llahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm."**

Komentimi

Qëllimi kryesor i misionit të Profetëve

Ngaqë përshpejtimi drejt mëshirës, faljes dhe Xhennetit të Zotit, për të cilën u diskutua në ajetet më lart, ka nevojë për udhëheqjen e "prijësve hyjnorë", në ajetin 25, i cili është prej ajeteve më kuptimplota dhe më domethënëse të Kur'anit, Zoti ka theksuar këtë koncept dhe ka shprehur në mënyrë të saktë dhe të

përpiktë arsyen se pse u sollën të Dërguarit me programin e tyre. Ajeti thotë. **"Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat** (e shenjtë) **dhe peshoren** (e drejtësisë)**: që njerëzit të veprojnë drejt."**.

Fjala *"bej'jinat"* - **"prova të qarta"** ka kuptim të gjerë. Ky kuptim përfshin "mrekullitë" dhe "arsyet racionale" me të cilat ishin të pajisur të Dërguarit hyjnorë.

Fjala *"kitab"* - *"libër"* përdoret për të emërtuar Librat qiellorë, por, meqë kuptimi i kësaj fjale është gjithëpërfshirës, fjala *"kitab"*përdoret në numrin njëjës.

Fjala *"mizan"* është përdorur me kuptimin: mjet matës dhe peshore. Këtu përdoren si mjeti që peshon të gjitha veprat e njerëzve, që peshon e vlerëson, nëse këto vepra janë në përputhje me dispozitat dhe ligjet hyjnore, ose me fenë në tërësi. Ky 'peshim' është kriteri i peshimit të të mirave, të të këqijave, i vlerave dhe i antivlerave. Në këtë mënyrë, të Dërguarit ishin të pajisur me tri mjete: me argumente të qarta, me Libra qiellorë dhe me kriterin apo instrumentin e dallimit të së vërtetës nga e pavërteta dhe i të mirës nga e keqja. Nuk përbën ndonjë pengesë, në qoftë se, për shembull, Kur'ani Fisnik është edhe *"bej'jine"* - *"mrekulli"*, është edhe Libër qiellor, është edhe shpjegues i dispozitave dhe ligjeve. Pra, tri dimensionet sinkronizohen në një përmbajtje.

Sidoqoftë, qëllimi i dërgimit të të Dërguarve, me këtë sistem të sinkronizuar e të plotë, është zbatimi i "barazisë dhe drejtësisë".

Në realitet, ky ajet sqaron njërin prej qëllimeve të shumta, për të cilat u dërguan të Dërguarit, sepse e dimë se të Dërguarit ndiqnin qëllime të shumta.

Një qëllim ishte arsimimi dhe edukimi. Ky qëllim sqarohet edhe në ajetin 2 të sures "El Xhumua": **"Ai është që arabve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre, që t'ju lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Librin dhe Sheriatin..."**.

Qëllimi tjetër, është heqja e barrëve të rënda dhe e prangave. Ky qëllim sqarohet edhe në ajetin 157 të sures "El A'raf": **"...dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta..."**.

Qëllimi tjetër është plotësimi i vlerave morale. Ky qëllim sqarohet në një hadith të njohur: *"Unë kam ardhur për plotësimin e vlerave morale dhe fisnike."*.[1]

Në përfundim, thuhet se qëllimi tjetër i dërgimit të Profetëve ishte zbatimi i drejtësisë, për të cilin u fol edhe më parë në këtë ajet. Qëllimet e dërgimit të Profetëve, mund t'i ndajmë në: qëllime kulturore, qëllime morale dhe qëllime politike.

Duhet të tregohet se një cilësi tjetër e të Dërguarit, ishte vendosmëria.

Çështja tjetër e rëndësishme që trajton sifjalia: **"që njerëzit të veprojnë drejt"**, është çështja që lidhet me "nismën e vetë njerëzve". Kjo sifjali nuk thotë që të Dërguarit t'i detyronin njerëzit të jenë të drejtë, por po thotë se qëllimi i tyre ishte, që njerëzit të jenë zbatues të drejtësisë.

[1] "Biharul Enuar", vëll. 71, f. 373, K. "Husnul khulk", Hadithi 1.

E rëndësishme është që njerëzit të ndërgjegjësohen, që të jenë zbatues të drejtësisë dhe këtë gjë ta zbatojnë përgjatë gjithë jetës së tyre.

Por duke pasur parasysh faktin që në një shoqëri njerëzore, sado i lartë të jetë niveli moral, ideologjik dhe i devotshmërisë, sërish do të hasim në njerëz që janë rebelë dhe kundërshtues, të cilët bëhen pengesë në zbatimin e drejtësisë, prandaj, ajeti thotë: **"Ne e zbritëm hekurin, në të cilin ka** (material për) **luftë të fuqishme dhe dobi** (të tjera) **për njerëzit…"**.

Tri qëllimet e të Dërguarve hyjnorë, mund t'ua sigurojnë zbatimin e drejtësisë, mund të arrijnë qëllimin përfundimtar, pra, t'i gëzoheni ekzistencës së hekurit dhe forcës së tij.

Edhe pse disa komentues kanë supozuar se fjala *"enzelna"* tregon se hekuri ka zbritur në tokë nga planete të tjera. Por këtu, përdorimi i fjalës *"inzal"* nuk i referohet hekurit, por tregon për begati që jepen nga një pozitë e lartë në një pozite më të ulët dhe, duke pasur parasysh faktin që thesaret e çdo gjëje janë te Zoti dhe Ai e ka krijuar hekurin për dobi të ndryshme, është përdorur fjala *"inzal" - "zbritje"*.

Për ta qartësuar edhe më mirë këtë, po përmendim një hadith nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, për komentimin e kësaj fjalie: *"Synimi i zbritjes së hekurit është krijimi i tij."*.[1]

[1] Tefsiri "Nuru Thakalejn", vëll. 5, Hadithet 100-101, f. 250.

Në ajetin 6 të sures "Ez Zumer", në lidhje me katërkëmbëshat, lexojmë: **"Ai krijoi** (enzele) **për ju tetë nga çiftet e kafshëve ..."**.

Disa komentues të tjerë, fjalën *"enzelna"* e kanë interpretuar në kuptimin e diçkaje ushqimore, që përgatitet për mikpritjen e të ftuarve dhe të mysafirëve. Më i pranueshëm duket përdorimi i parë kuptimor.

Fjala *"b'es"* është përdorur me kuptimin leksikor *"të ashpërsisë"*, *"forcës"* dhe *"fuqisë"*. Gjithashtu, përdoret edhe në kuptimin: përleshje dhe luftë. Prandaj disa komentues, e kanë komentuar atë si emërtim për mjete luftarake, mbrojtëse dhe sulmuese.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lidhur me komentimin e këtij ajeti, lexojmë: *"Synimi është arma dhe të tjera, përveç saj."*[1]

Këta shembuj u sollën, për të qartësuar përdorimet kuptimore të këtyre fjalëve.

Fjala *"menafia" - "dobi"*, është përdorur për të treguar çdo lloj dobie që njeriu përfiton nga hekuri. Rëndësia e hekurit në jetën e njeriut është aq e madhe, saqë, me zbulimin e tij, në historinë njerëzore filloi një periudhë e re, e cila njihet si "periudha e hekurit". Me këtë zbulim, shoqëria njerëzore pësoi ndryshime në të gjitha fushat. Rëndësia e hekurit në përditshmërinë njerëzore, shpjegon edhe dimensionet e fjalës *"menafi"*, në ajetin e lartpërmendur.

[1] Po aty.

Edhe në Kur'anin Fisnik, në shumë ajete, është përmendur kjo domethënie. Në një ajet thuhet: "***Më sillni copa të hekurit...***" [1]

Kur Zoti e përfshiu nën mëshirën e vet Daudin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, ia zbuti hekurin dhe i tha: **"Me të vërtetë, Ne i dhamë Daudit mirësi prej Nesh** (dhe thamë)**: 'O male dhe zogj! Lavdërojeni Emrin Tim bashkë me Daudin'. Ne ia zbutëm atij hekurin,** (dhe i thamë)**: 'Puno parzmore të gjera! Thuri ato me maja të barazpeshuara dhe bëj vepra të mira! Pa dyshim, Unë shoh çfarë punoni ju.'"**.[2]

Më pas tregohet edhe një qëllim tjetër, për të cilin u dërguan Profetët. Ky qëllim ishte zbritja e Librave qiellorë dhe krijimi i pajisjeve prej hekuri. Ajeti thotë: **"...me qëllim që All'llahu të njohë ata që e ndihmojnë Atë dhe të Dërguarit e Tij, pa e parë Atë."**.

Synimi prej diturisë së Zotit, në këtë ajet, është realizimi konkret i dijes së Tij, deri sa të shfaqet se cilët persona çohen në ndihmën e Zotit dhe fesë Tij, cilët ngrihen në këmbë dhe e zbatojnë drejtësinë dhe kush tregohet kryeneç dhe e shpërfill këtë detyrim madhështor. Në fakt, kuptimi i këtij ajeti është i përafërt me ajetin 179 të sures "Ali Imran": **"All'llahu nuk është që t'i lë besimtarët ashtu siç jeni, pa dalluar të keqin nga i miri..."**.

Në këtë mënyrë, një prej qëllimeve më të mëdha të këtij projekti hyjnor, është edhe çështja e testimit dhe e sprovimit të njerëzve, ndarja e rreshtave, përzgjedhja e rafinimi i tyre.

---

[1] Sure "El Kehf", ajeti 96.
[2] Sure "Sebe", ajetet 10–11.

Shprehja **"ata që e ndihmojnë Atë"**, pa dyshim që është përdorur me kuptimin e ndihmës ndaj fesë, ndaj përfaqësuesve dhe atyre që përhapin fenë e vërtetë, barazinë dhe drejtësinë. Në të kundërt, Zoti nuk ka nevojë për ndihmën e askujt, por të gjitha krijesat ia kanë nevojën Atij. Prandaj, për ta argumentuar deri në fund këtë kuptim, ajetin e përfundon me këtë fjali: **"Me të vërtetë, All'llahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm.".**

Ai ka fuqi që, me një shenjë të vetme, të përmbysë të gjithë botën, të gjithë armiqtë t'i asgjësojë, të gjithë të dashurit e Tij t'i lartësojë dhe t'i bëjë triumfues. Por ky nuk qëllimi kryesor. Qëllimi është edukimi dhe përsosmëria e njerëzve, e cila nuk do të realizohej me anë të këtyre që përmendëm më sipër, prandaj i ka thirrur ata në ndihmën ndaj fesë së vërtetë.

Hulumtime

1- Kufiri mes logjikës dhe forcës

Ajeti 25, është një projekt domethënës dhe kuptimplotë i vizionit të fesë islame, në fushën e arsimimit dhe të edukimit, të promovimit të drejtësisë dhe zbatimit të barazisë sociale në shoqërinë njerëzore.

Në fillim, kjo përpjekje mbështetet te *"bej'jinat"* - *"argumentet e qarta"*, te Librat qiellorë, në mjetet e matjes së vlerave, si dhe sqarimin e dispozitave dhe të ligjeve. Këto

përbëjnë themelin mbi të cilin vihet revolucioni mendor, (ideor) dhe kulturor dhe kërkon ndihmë nga arsyeja dhe logjika.

Në qoftë se këto nuk do ishin të dobishme dhe do të bllokohej puna, që do të thotë, nëse shfaqen njerëz arrogantë, që as nuk nënshtrohen karshi provave të qarta e as besojnë Librin dhe Matësin e vlerave, vjen radha e *"hadid"* - *"hekurit"*, i cili u shërben njerëzve në luftë përmes armëve të përgatitura prej tij.

Për të sqaruar më tej përdorimet e fuqishme të hekurit, vjen edhe hadithi i transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Unë, në prag të Ringjalljes, jam dërguar me shpatë, në mënyrë që të adhurohet Zoti Një dhe i Vetëm. Risku im është nën hijen e shtizës sime."*.[1]

Ky ajet sqaron të njëjtën çështje, domethënë, se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte dërguar që shtizën ta përdorë kundrejt këtij grupi (arrogantësh) dhe jo në parim dhe si një princip themelor. Kjo u sqarua në ajetin e lartpërmendur.

Në një hadith, të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Të gjitha të mirat gjenden te shpata, poshtë shpatës dhe në hijen e shpatës!"*.[2]

Gjithashtu, në një hadith të transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Zoti i Madhëruar e ka bërë obligim luftën, e ka konsideruar si vepër të madhe dhe e ka përcaktuar atë*

[1] Tefsiri "Meragij", vëll. 27, f. 183.
[2] "Furuul Kafij", vëll. 5, Hadithet 11 dhe 15, f. 8.

si ndihmë ndaj Vetes. Betohem në Zot, se as bota e as feja nuk rregullohen përveçse me luftë!".[1]

Këtë diskutim do ta mbyllim me një citim nga i Dërguari i Zotit: "*Njerëzit nuk i mban asgjë përveç shpatës dhe shpatat janë çelësat e Xhennetit dhe të Xhehennemit!"*.[2]

Prandaj udhëheqësit hyjnorë, në një dorë mbartin Librin qiellor dhe, në dorën tjetër shpatën, pra, në fillim i ftojnë njerëzit drejt të Vërtetës dhe drejtësisë, me anë të arsyes e logjikës dhe, sa herë që shtypësit nuk dorëzohen karshi logjikës, përdorin forcën kundrejt tyre.

2- Nevojat kryesore të jetesës varen nga hekuri

Disa komentues të Kur'anit i kanë bërë një analizë të gjerë ajetit të lartpërmendur, përmbajtja e të cilës është: "Parimet kryesore, në jetën e njeriut, janë katër: bujqësia, industria, strehimi dhe qeveria, sepse njeriu ka nevojë për ushqim, veshmbathje dhe strehim. Por duke qenë se është një krijesë shoqërore, e cila nuk është në gjendje t'i zgjidhë vetëm të gjitha, ka nevojë edhe për qeverisje.

Duke pasur parasysh faktin se çdo shoqëri, me apo pa dashje, nuk është e mënjanuar nga grindjet dhe konfliktet e interesave, ka nevojë për një qeveri, e cila të zbatojë drejtësinë. I çuditshëm është fakti se të katër këto parime, kanë nevojë për hekur dhe, nëse nuk do të ishte ky element, jetesa për njeriun do të ishte shumë e

[1] Po aty.
[2] "Furuul Kafij", vëll. 5, Hadithi 1, f. 2.

vështirë. Duke e ditur se nevoja për këtë element është e madhe, Zoti i Madhëruar e ka krijuar në sasi të mëdha dhe lehtësisht të arritshëm. Meqenëse metalet e tjera, të cilat vijnë pas hekurit, luajnë rol të rëndësishëm në jetesën e njeriut, ajeti sqaron: **"...ka** (material për) **luftë të fuqishme dhe dobi** (të tjera) **për njerëzit..."**.[1]

[1] Huazuar nga tefsiri i Fakhru Razij "El Kebijr", vëll. 29, f. 242.

Ajetet 26 – 27

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا وَإِبْرَاهِيمَ وَجَعَلْنَا فِي ذُرِّيَّتِهِمَا النُّبُوَّةَ وَالْكِتَابَ فَمِنْهُمْ مُهْتَدٍ وَكَثِيرٌ مِنْهُمْ فَاسِقُونَ٢٦ ثُمَّ قَفَّيْنَا عَلَى آثَارِهِمْ بِرُسُلِنَا وَقَفَّيْنَا بِعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ وَآتَيْنَاهُ الْإِنْجِيلَ وَجَعَلْنَا فِي قُلُوبِ الَّذِينَ اتَّبَعُوهُ رَأْفَةً وَرَحْمَةً وَرَهْبَانِيَّةً ابْتَدَعُوهَا مَا كَتَبْنَاهَا عَلَيْهِمْ إِلَّا ابْتِغَاءَ رِضْوَانِ اللَّهِ فَمَا رَعَوْهَا حَقَّ رِعَايَتِهَا فَآتَيْنَا الَّذِينَ آمَنُوا مِنْهُمْ أَجْرَهُمْ وَكَثِيرٌ مِنْهُمْ فَاسِقُونَ٢٧

"Sigurisht, Ne dërguam Nuhun dhe Ibrahimin e u dhuruam trashëgimtarëve të tyre Profecinë dhe Librin. Disa syresh ishin në Rrugë të Drejtë, kurse shumica prej tyre ishin gjynahqarë të pabindur."

"Pas tyre Ne çuam të Dërguar të tjerë, mandej dërguam Isain, të birin e Merjemes. Ne i dhamë atij Ungjillin, kurse në zemrat e pasuesve të tij mbollëm butësi dhe mëshirë. Sa për murgërinë, Ne nuk ua urdhëruam atë, por ata e shpikën vetë për të arritur kënaqësinë e All'llahut. E megjithatë, ata nuk u kujdesën si duhet për të. Kështu, Ne u dhamë besimtarëve të vërtetë prej tyre shpërblimin e merituar, sado që shumë prej tyre janë të pabindur."

Komentimi

Profetët i dërguam njëri pas tjetrit

Metodikisht Kur'ani, pasi përmendi çështjet pararendëse, rreth dërgimit të Profetëve së bashku dhe me prova të qarta, me Librin dhe peshoren, si dhe nevojshmërinë e nxitimit dhe konkurrimit të njerëzve me njëri–tjetrin në arritjen e faljes së Zotit dhe lumturisë së përhershme, përmend disa nga Profetët dhe popujt e kaluar. Këto parime të përgjithshme, i mishëron në jetën e tyre.

Në fillim e nis me Profetët Nuh dhe Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*, të cilët ishin baballarët e Profetëve dhe krerët e vargut të "lajmëtarëve" të vërtetë: **"Sigurisht, Ne dërguam Nuhun dhe Ibrahimin e u dhuruam trashëgimtarëve të tyre Profecinë dhe Librin."**.

Por, nga kjo trashëgimi dhe begati e madhe e Zotit, nuk përfituan të gjithë: **"Disa syresh ishin në Rrugë të Drejtë, kurse shumica prej tyre ishin gjynahqarë të pabindur."**.

Profetësia e shoqëruar me Sheriat dhe rite filloi me Nuhun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe pas tij, këtë linjë e vazhdoi Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, një Profet tjetër. Më tej e vazhduan me radhë fëmijët dhe dinastitë e tyre, gjatë epokave dhe shekujve. Por gjithnjë, nga kjo dritë udhëzuese përfitoi vetëm një pakicë, kurse shumica mori rrugën e gabuar.

Më pas, vazhdon vargu i të Dërguarve të tjerë, deri te i fundmi i tyre, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë*

mbi të dhe mbi familjen e tij!). Për sqarimin e kësaj çështjeje, ajeti shton: **"Pas tyre Ne çuam të Dërguar të tjerë…"**.

Luftuan dhe u përpoqën të Dërguarit njëri pas tjetrit dhe sollën dritën e udhëzimit në rrugën e njerëzve, derisa arriti radha e Profetit Isa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*: **"...mandej dërguam Isain, të birin e Merjemes."**.

Fjala *"kaf'fejna"* rrjedh nga rrënja *"kafa"* dhe është përdorur me kuptimin: *"prapa"*. *"Kafije"*, quajnë rimën e vargjeve të një krijimi poetik. Këtu përdoret me kuptimin e rimës së poezisë, sepse pjesët e fundit të vjershave janë "të ngjashme me njëra–tjetrën dhe të renditura njëra pas tjetrës", si të thuash, rimojnë. Në fjalinë e mësipërme, përmendja e kësaj fjale shoqëron idenë e të Dërguarve në këtë botë, njëri pas tjetrit me një "melodi" të njëjtë dhe përsëritëse, me qëllime të koordinuara dhe të përbashkëta, duke i miratuar dhe duke plotësuar mësimet e njëri–tjetrit, pra, me një sintoni të saktë, si vargjet e një poezie. Në fakt, mësimet profetike të tilla ishin.

Më pas, ajeti përmend Librin qiellor të Profetit Isa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe thotë: **"Ne i dhamë atij Ungjillin."**.

Në vijim, diskuton për pasuesit e tij dhe thotë: **"…në zemrat e pasuesve të tij mbollëm butësi dhe mëshirë."**.

Disa komentues të ajeteve kur'anore, këto dy fjalë, *"butësi"* dhe *"mëshirë"*, i kanë komentuar me një kuptim të vetëm. Disa të tjerë kanë shprehur dallimin mes këtyre dy fjalëve. Për këtë sqarohet se fjala *"ra'fet"* - *"butësia"* është përdorur me kuptimin e shpjegimit të gjërave me dashuri për të parandaluar dëmet, kurse fjala *"rahmet"* - *"mëshirë"*, është përdorur me kuptimin e

komunikimit dashamirës, për të siguruar dobitë. Prandaj, zakonisht, fjala *"ra'fet"*, përmendet para fjalës *"rahmet"*, sepse, në fillim, duhet eliminuar dëmi e më pas duhet menduar për të siguruar dobinë dhe interesin. Është kjo arsyeja, që në ajetin që flet rreth ndëshkimit të grave imorale, thuhet: **"...në zbatimin e dispozitave të All'llahut, mos u tregoni zemërbutë** (ra'fet) **ndaj atyre dyve, nëse besoni All'llahun dhe Botën Tjetër..."**.[1]

Çështja e butësisë dhe e mëshirës, në lidhje me pasuesit e drejtë të Profetit Isait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, nuk është nënvizuar vetëm në këtë ajet. Këto dy çështje diskutohen edhe në ajetin 82 të sures "El Maide": **"Gjithqysh, ti do të vëresh se jehuditët dhe ata që i përshkruan Zotit shok,** (idhujtarët)**, janë njerëzit me armiqësi më të fortë kundër besimtarëve** (kundër myslimanëve)**. Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët, janë ata që thanë: 'Ne jemi nesara, krishterë.' Këtë, ngase prej tyre,** (të krishterëve)**, ka dijetarë** (ulema) **dhe të devotshëm dhe se ata nuk janë kryeneçë."**.

Edhe pse ky ajet flet më shumë për Nexhxhashin dhe për të krishterët e Etiopisë, të cilët i kishin strehuar myslimanët dhe ishin treguar të sjellshëm dhe të dashur me ta, në përgjithësi është një tregues për butësinë dhe mëshirën, si dhe ndjenjat pozitive të të krishterëve të drejtë. Këtu përjashtohen të krishterët gjakatarë dhe çnjerëzorë, të cilët, në epokën tonë, e kanë shndërruar botën në shesh plaçkitjesh, grabitjesh dhe gjakderdhjesh.

Pastaj, ajeti shton: **"Sa për murgërinë, Ne nuk ua urdhëruam atë, por ata e shpikën vetë për të arritur kënaqësinë e All'llahut. E megjithatë, ata nuk u kujdesën si duhet për të.**

[1] Sure "En Nur", ajeti 2.

Kështu, Ne u dhamë besimtarëve të vërtetë prej tyre shpërblimin e merituar, sado që shumë prej tyre janë të pabindur.".[1]

Në këtë mënyrë, ata jo vetëm që nuk e zbatuan fenë monoteiste të Profetit Isa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, por inkuadruan në të dhe lloj–lloj shirku dhe politeizmi. Ata nuk e respektuan siç duhet as të drejtën e atij murgërimi, të cilin vetë e kishin shpikur, por në emër të asketizmit dhe murgërisë, vunë kurthe të ndryshme në rrugën e krijesave të Zotit. Manastiret i shndërruan në qendra korrupsionesh. Futën në fenë e Profetit Isa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* çrregullime dhe anomali.

Sipas këtij komentimi, "murgëria" nuk ishte pjesë e fesë së Profetit Isa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, por pasuesit e tij e shpikën atë pas tij. Ajo në fillim kishte një formë të ekuilibruar, por më vonë iu nënshtrua degradimit dhe solli me vete shumë efekte negative dhe degjenerim.

Sipas një komenti tjetër, në fenë e Profetit Isait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ekzistonte një lloj murgërie dhe asketizmi.

---

[1] Në përbërjen e kësaj fjalie dhe kuptimit të saj, në mesin e komentuesve të Kur'anit ka shumë diskutime. Disa, atë e kanë konsideruar si referim për fjalët *"butësi"* dhe *"mëshirë"* dhe para fjalës *"ruhbanij'jet"* - *"murgëri"* kanë vendosur fjalën *"hub'b"*, si fjalë nënkuptuese, sepse murgëria nuk është një gjë që ekziston në zemër, por dashuria e saj ndodhet në zemër. Një grup tjetër, atë e kanë konsideruar si një folje të nënkuptuar, që *"ibtedeuha"* e sqaron atë. Në thelb ka qenë e tillë: *"ibtedeuha ruhbanijeten ibtedeuha"*. Edhe për fjalën *"ibtiga-e ridhuanullah"* ekzistojnë dy mendime:
Së pari, mendohet se është përjashtim i ndërprerë. Kuptimi i saj është i tillë: *"uelakin'nehum ibtedeuha ibtigae ridhuanullah"*; **së dyti,** të jetë përjashtim i nërlidhur, kuptimi i të cilës është: Ne kishim përcaktuar një lloj murgërie për ata, me synim, përfitimin e kënaqësisë së Zotit, por ata, murgërinë e shtrembëruar në një lloj tjetër, që ishte në kundërshti me kënaqësinë e Zotit. Nga të dyja rastet, duket që komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Murgëria, të cilën pasuesit e Mesihut, Isait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e lanë si risi pas tij, ishte një lloj tjetër murgërie, që Zoti kurrë nuk e kishte përcaktuar për ata.[1]

Komentimi i parë është më i njohur dhe më i përshtatshëm.

Sidoqoftë, në tërësi, ajeti i lartpërmendur, na tregon se në fenë e krishterë nuk ka pasur murgëri. Murgërinë e shpikën më pas, pasuesit e tij. Murgëria, në fillim, konsiderohej si një lloj asketizmi dhe si një e re e pëlqyeshme. Askush nuk e konsideronte si një urdhër të veçantë apo dispozitë fetare. Kjo traditë, më vonë u shtrembërua dhe u përlye me çështje që janë kundër dispozitave dhe rekomandimeve hyjnore, të cilat, shpeshherë, të çonin dhe në mëkate.

Shprehja kur'anore: **"E megjithatë, ata nuk u kujdesën si duhet për të…"**, argumenton, se po të kujdeseshin, ta mbronin e ta zhvillonin, sipas dispozitave hyjnore, do të ishte një traditë e mirë. Dëshmi e këtyre pretendimeve është edhe ajeti 82 i sures "El Maide", i cili "murgjërit", dijetarët dhe të krishterët e drejtë i përmend dhe i vlerëson pozitivisht.

Sa herë që fjalën "*murgëri*" e konsiderojmë si referencë për butësinë dhe mëshirën, aq herë ajo e dëshmon këtë pretendim,

[1] Komentimi i parë, në bazë të ndërprejes është i përjashtuar, komentimi i dytë në bazë të qenurit i bashkëngjitur përsëri është i përjashtuar. Është e nevojshme të përmendim, se, nëse "*ruhbanij'jet*" – "*murgëria*" i referohet "*rae'fet*" dhe "*rahmet*" (butësisë dhe mëshirës), ashtu sikur zgjodhëm në tekst, synim për "vendosje" të saj në zemra është po ai animi i brendshëm i tyre ndaj kësaj çështjeje, ndërkohë që shprehja "*ma keitebnaha*" nënkupton që çështja e murgërisë, në fenë krishtere, nuk ishte në formën e një ligji hyjnor, sado që Zoti i Madhëruar, dashurinë për atë e kishte vënë në zemrat e tyre. Si rrjedhojë, nuk ka ndonjë kundërshtim me fjalën "*ibtedeuha*".

sepse përkrah butësisë dhe mëshirës ndodh që Zoti i Madhëruar t'ua përcjellë atë si një atribut të pëlqyeshëm.

E thënë me fjalë të tjera, në qoftë se në mesin e njerëzve ekziston apo zbatohet një traditë e mirë dhe e pëlqyeshme, parimet e përgjithshme të saj të përputhen me fenë e vërtetë (siç është, për shembull, rekomandimi për "zuhd", apo heqja dorë nga kënaqësitë e kësaj bote) dhe njerëzit këtë traditë të mos ia atribuojnë urdhrit hyjnor të posaçëm, por, përkundrazi atë ta konsiderojnë si një shembull konkret nga dispozitat e përgjithshme dhe ta respektojnë atë ashtu siç duhet, atëherë kjo nuk është një vepër e shëmtuar. Fatkeqësia fillon atëherë kur përballemi me ekstreme dhe ekstremet t'i shndërrojmë në traditë të pëlqyer.

Për shembull, edhe në ditët e sotme, në mesin tonë, është traditë që të mbajmë zi dhe të përkujtojmë prijësit e mëdhenj fetarë, dëshmorët apo të dashurit tanë në ditën e shtatë të vdekjes së tyre, apo në të dyzetat dhe në përvjetorin e tyre. Këto rite janë shembuj nga rekomandimet e përgjithshme të Islamit, në lidhje me madhërimin dhe nderimin e simboleve, udhëheqësve fetarë, dëshmorëve dhe të të gjithë myslimanëve. Këto rite janë shembuj të ngjashëm me parimin e përgjithshëm të përkujtimit të dëshmorëve të Qerbelasë, por duke mos i konsideruar detajet e kësaj ceremonie si një i urdhër i veçantë fetar. Thjesht, kryhen si një shembull prej atij parimi të përgjithshëm.

Sa herë që në këto ceremoni tradicionale, nuk i tejkalojnë kufijtë e fesë dhe nuk përlyhen me ndonjë mëkat apo besëtytni, pa dyshim që janë shembuj për të arritur kënaqësinë e Zotit dhe

traditë e pëlqyeshme. Në të kundërt, do të kthehet në një traditë të keqe.

Duket se fjala *"ruhbanij'jet"* - *"murgëria"* rrjedh nga rrënja *"rahbe"* dhe është përdorur me kuptimin e druajtjes ndaj Zotit. Në fillim ka qenë kuptuar si një shembull i asketizmit dhe mos tërheqjes ndaj kësaj bote. Më vonë u degradua me devijime të shumta. Në qoftë se vërejmë se Islami lufton ashpër me murgërinë, kjo është për shkak të formës përfundimtare të saj të devijuar. Për këtë çështje do të flasim më gjerësisht në vijim.

Hulumtime

1- Islami dhe murgëria

Ashtu siç e trajtuam, fjala *"ruhbanij'jet"* -*"murgëria"* rrjedh nga rrënja *"rahbe"* dhe është përdorur me kuptimin: frikë dhe ndrojtje. Këtu është përdorur me kuptimin: frikë ndaj Zotit, siç është shprehur edhe Ragibi në veprën "El Mufredat". Midis të tjerash, thotë: "Është një frikë e përzier me shmangie dhe ankth.".

Fjala *"ter'rehub"* është përdorur me kuptimin *"teab'bud"* - *"adhurim"*, siç është përdorur edhe fjala *"ruhbanij'jet"* në kuptimin: adhurim i vazhdueshëm.

Pavarësisht se në ç'lloj dhe në ç'mënyrë e komentojmë, ajeti i lartpërmendur tregon që në mesin e të krishterëve ka ekzistuar

një lloj murgërie e dëshiruar, edhe pse në fenë e krishterë nuk ka ardhur një dispozitë e tillë. Pasuesit e Profetit Isa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i tejkaluan kufijtë e asaj murgërie dhe e çuan drejt shtrembërimit.

Prandaj, për këtë arsye, Islami e dënon ashpër atë dhe hadithi i njohur: "*Në Islam, nuk ekziston murgëri*", haset në shumë burime islame.[1]

Një prej të rejave të shëmtuara të Krishterimit, në lidhje me murgërinë, ishte "ndalimi i martesës" për burrat dhe gratë e devotshme. E reja tjetër, ishte "izolimi shoqëror" dhe heqja dorë nga përgjegjësitë e njeriut në shoqëri, përzgjedhja e manastireve dhe kishave të largëta për adhurim dhe për të jetuar në një mjedis larg shoqërisë. Por më pas, në manastiret dhe qendrat ku ata jetonin, u shfaqën korrupsione dhe imoralitete të shumta. Në diskutimet vijuese, do të flasim më me detaje rreth kësaj çështjeje.

Është e drejtë që gratë dhe burrat fetarë të kësaj bote, (murgjit dhe murgeshat), gjithashtu, të kryejnë edhe shërbime pozitive, si për shembull, të kujdesen për pacientë me sëmundje të pashërueshme dhe të rrezikshme, siç është lebrosa, të predikojnë në vende shumë të largëta te popujt e pazhvilluar programe studimore. Por këto çështje, në krahasim me vetë projektin, ishim tepër pa vlerë dhe të parëndësishme. Në tërësi, korrupsioni e dëmet e saj ishin shumë më tepër.

Njeriu është një krijesë e destinuar që të jetojë në shoqëri. Përsosmëria e tij shpirtërore, realizohet dhe formësohet në jetën shoqërore, prandaj asnjëra nga fetë qiellore nuk ia mohon njeriut

[1] Ky hadith është përmendur në veprën "Mexhmaul Behrejn", Neni "Reheb" dhe në "Nehaje". Gjithashtu, është përmendur nga Ibn Kethiri.

këtë të drejtë, përkundrazi ia përforcon edhe më shumë bazat dhe themelet e saj.

Zoti i Madhëruar ka rrënjëzuar te njeriu "instinktin seksual", pikërisht për të ruajtur brezat.

Devotshmëria islame materializohet në thjeshtësinë e jetës, në shmangien e luksit dhe të lakmisë për pasuri dhe pozitë. Devotshmëria islame nuk ka asnjë lidhje me çështjen e "murgërisë", sepse murgëria të çon në ndarje dhe izolim nga shoqëria, kurse "*zuhd*" - "*devotshmëria*" është tregues i lirisë dhe i dëlirësisë së jetës njerëzore, është tregues i solidaritetit shoqëror dhe social të njeriut.

Në një hadith të njohur, lexojmë: "Osman bin Medhunit i kishte vdekur djali. Ai u dëshpërua aq shumë, saqë shtëpinë e tij e shndërroi në tempull dhe gjithnjë rrinte duke iu lutur Zotit dhe duke e adhuruar Atë. Për shkak të lutjeve dhe adhurimit, ai hoqi dorë nga të gjitha punët e tjera. Profeti, pasi u njoftua për këtë çështje, e thirri atë dhe i tha: *'O Osman! Zoti i Madhëruar, për popullin tim, nuk e ka përcaktuar murgërinë, murgëria e popullit tim është lufta në Rrugën e Zotit'*...".[1]

Nga këto fjalë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ne kuptojmë se, në qoftë se dëshiron të heqësh dorë nga jeta materiale, mos e kryej këtë vepër në formë negative dhe duke u izoluar nga shoqëria. Përkundrazi, atë kërkoje në një jetë aktive, në përpjekjen për t'u përsosur në Rrugën e Zotit.

[1] "Biharul Enuar", vëll. 70, K. "Ndalimi i murgërisë", Hadithi 1, f. 114.

Më pas Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* bëri një diskutim të hollësishëm me Osman bin Medhunin, në lidhje me virtytin e namazit me xhemat e të përbashkët, i cili është një miratim i mohimit të mugësirë dhe izolimit.

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Musa Kadhimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë se vëllai i tij, Ali bin Xhaferi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, e pyeti: "*A lejohet për një mysliman, që të bëjë udhëtime dhe shëtitje nëpër botë, apo të qëndrojë në shtëpi dhe të bëjë adhurim të vazhdueshëm pa dalë fare prej saj?*"

Imami tha: "*Jo!*".[1]

Udhëtimi që është i ndaluar në këtë transmetim, është diçka e ngjashme me murgërinë. Këtë lloj udhëtimi, disa e quajnë "murgëri e lëvizshme". Shprehja "murgëri e lëvizshme" përdoret me kuptimin se disa njerëz, të cilët, pa siguruar ndonjë shtëpi dhe mjete jetese, vazhdimisht janë në lëvizje, si endacakë dhe kalojnë nga një vend në një tjetër. Këta njerëz jetojnë duke kërkuar ndihmë nga njerëzit e tjerë dhe praktikonin fenë.

Këtë gjë e pandehin si një lloj heqje dorë prej stolive të botës dhe asketizëm. Por Islami e ka kundërshtuar dhe e ka ndaluar edhe "murgërinë e qëndrueshme", edhe "murgërinë e lëvizshme". Për nga pikëpamja e njohurive islame, e rëndësishme është që njeriu, si qenie shoqërore dhe i integruar plotësisht në shoqëri, të ruajë devotshmërinë dhe përkushtimin e vet ndaj fesë dhe jo të jetojë i izoluar dhe larg komunitetit dhe shoqërisë.

[1] "Bihraul Enuar", vëll. 70, Hadithi 10, f. 119.

2- Fillesat e murgërisë në histori

Historia ekzistuese e Krishterimit, tregon se në shekujt e parë të Krishterimit, nuk ka ekzistuar murgëri si kjo e tanishme. Koha e shfaqjes së saj konsiderohet periudha pas shekullit të tretë pas Krishtit, në kohën e sundimit të perandorit romak, Odiseu (Disius). Betejën me këtë perandor e humbën pasuesit e Profetit Isa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Pas humbjes, u strehuan në male dhe fusha.[1]

Kjo çështje qartësohet edhe më mirë, në mënyrë më të saktë dhe më të detajuar nga Profeti i Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, një ditë e pyeti Ibn Mesudin: *"A e di se si lindi murgëria?"*

Ibn Mesudi i tha: "Zoti dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri."

I Dërguari i All'llahut i tha: *"Pas Profetit Isa (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) u shfaq një grup tiranësh dhe besimtarësh. Në tri luftëra me ata pësuan disfatë. Pas kësaj, ata u fshehën, në pritje të shfaqjes së të Dërguarit të premtuar nga ana e Profetit Isa (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!). Ata filluan të strehoheshin dhe të luteshin në shpella e male. Disa prej tyre nuk hoqën dorë nga feja e vet, kurse disa të tjerë u bënë jobesimitarë."*

Më pas, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pyeti: *"A e di, se ç'farë është "murgëria" e popullit tim?"*

[1] Enciklopedia e shekullit të njëzet, lënda "Rehb".

Ibn Mesudi i tha: "Zoti dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri."

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: *"Murgëria e popullit tim është: shpërngulja, lufta, namazi, agjërimi, pelegrinazhi dhe umreja."*[1]

Një historian i njohur i krishterë Uill Durant, në historinë e tij të njohur, në vëllimin 13, ka bërë një shtjellim të detajuar në lidhje me murgjit. Ai është i mendimit se murgeshat, nga shekulli i katërt filluan t'u bashkoheshin murgjve. Kjo dukuri u përhap çdo ditë e më shumë, deri sa në shekullin e dhjetë arriti kulmin.[2]

Pa dyshim, kjo dukuri shoqërore, si çdo dukuri tjetër, përveç rrënjëve dhe shkaqeve historike, ka edhe rrënjë psikologjike. Shembull për këtë mund të sjellim faktin që lidhet me reaksionin psikologjik të njerëzve dhe të popujve të ndryshëm përballë humbjeve dhe disfatave. Sjelljet dhe reaksioni psikologjik i popujve të ndryshëm është krejtësisht i ndryshëm. Disa priren drejt vetmisë dhe izolimit dhe tërhiqen plotësisht nga shoqëria dhe nga aktivitetet sociale, disa të tjerë bëhen qëndresëtarë dhe gjejnë forca te vetja e tyre. Kështu, grupimi i parë, anon në murgëri apo të ngjashme me të, kurse grupimi i dytë, bëhet më social dhe shoqëror.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 243. Në tefsirin "Durrul Menthur", vëll. 6, f. 177, është transmetuar i përmbledhur, një hadith tjetër i ngjashëm me të.
[2] Historia "Uill Durant", vëll. 13, f. 443.

3- Murgëria, burim i imoralitetit dhe i shthurjes morale e shoqërore

Devijimi nga ligjet e natyrës, sjell pasoja negative, prandaj mund të ndodhë që njeriu, kur krijon largësi me jetën shoqërore, të vuajë nga pasoja negative të rënda. Në këtë kontekst, edhe murgëria, është kundërshti e ligjeve shoqërore dhe e dimensionit të brendshëm të njeriut. Distancimi nga shoqëria, formë e të cilës është edhe murgëria, sjell disa pasoja dhe çrregullime, si për shembull:

a- Murgëria lufton me natyrën shoqërore të njeriut dhe shoqëritë njerëzore i çon në rënie.

Murgëria, jo vetëm që nuk të çon në përsosjen shpirtërore dhe morale të njeriut, por është shkak i shmangieve etike, i përtacisë, i apatisë, i pesimizmit, i mendjemadhësisë, i mburrjes, i pëlqimit të vetes dhe i të ngjashmeve me to. Në qoftë se për një moment, supozojmë se njeriu realizon virtyte morale, duke qenë i izoluar dhe në vetmi, këto nuk konsiderohen virtyte të shëndosha shoqërore. Virtytet njerëzore formësohen duke jetuar në shoqëri, nën kujdesin vetjak, familjar e shoqëror, për të mbrojtur veten, familjen e shoqërinë nga vese, sjellje të padenja, veprimtari të degraduara, çrregullime dhe imoralitete.

c- Refuzimi dhe heqja dorë nga martesa, të cilat janë parime të murgërisë, jo vetëm që nuk sjellin përsosmëri, por përkundrazi, bëhen shkak për ndryshime të theksuara psikologjike.

Në "Enciklopedinë e shekullit të njëzet" lexojmë: "*Disa nga murgjit, kushtimin e vëmendjes ndaj gjinisë femërore e konsideronin*

vepër djallëzore. Për këtë arsye, ata nuk ishin të gatshëm të sillnin në shtëpi as edhe një kafshë të gjinisë femërore, nga frika e sëmurë se mos shpirti i këtyre kafshëve femra mund të ishte aq djallëzor, sa të dëmtonte shenjtërinë e tyre!".

Historia kujton tragjedi të mëdha të ndodhura në manastire. Uill Durant, Papë Enjusani i Tretë, një prej manastireve e ka prezantuar si bordell.[1] Disa manastire të tjera ishin shndërruar në qendra për tubimin e njerëzve të etur për ushqim, adhurues të kësaj bote dhe njerëz qejflinj. Në këto manastire gjendeshin sasi të mëdha pijesh.

Sipas dëshmisë së historisë, Profeti Isa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* asnjëherë nuk ishte martuar. Kjo "asnjëherë nuk ishte martuar", nuk ishte për shkak se ai e kundërshtonte këtë çështje, por ngaqë jeta e shkurtër e tij dhe udhëtimet e vazhdueshme për përhapjen e fesë nëpër vende të ndryshme të botës, ishin bërë pengesë për kurorëzimin e tij.

Diskutimi në lidhje me "murgërinë", kërkon një libër më vete dhe, në qoftë se duam ta trajtojmë atë në tërësi, do të dalim jashtë temës së diskutimit tonë, pra, të komentimit të Kur'anit.

Këtë diskutim do ta mbyllim me një hadith të transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, për komentimin e këtyre ajeteve: **"Thuaj: 'A doni t'ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e**

[1] Uill Durant, vëll. 13, f. 443.

kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?'".[1]

"Një prej shembujve konkretë të tij, janë murgjit, të cilët e kanë burgosur veten e tyre në pikat më të larta të maleve dhe të kodrave, duke hamendësuar që janë duke kryer një vepër të mirë."[2]

4- "Dhiata e re" apo "Dhiatat e reja"?

Fjala *"Inxhil" - "Bibla"*, në thelb, është një fjalë greke dhe është përdorur me kuptimin: përgëzim apo mësim i ri. Njëherësh është edhe emri i Librit, i cili i është zbritur Profetit Mesih, Isa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Kjo fjalë, me po këtë kuptim, është përmendur dymbëdhjetë herë në Kur'anin Fisnik dhe në të gjitha rastet është në numrin njëjës. Por ajo që sot njihet me emrin "Dhiata e re", janë libra të shumtë dhe i përdorin me shprehjen "Biblat" apo "Dhiatat e reja". Në mesin e tyre, më të njohurit janë katër Biblat: "Luta", "Markos", "Meta" dhe "Joana".

Të krishterët, janë të besimit se këto katër Bibla janë shkruar nga katër persona, të cilët ishin nga shokët e ngushtë të Profetit Mesih, Isa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, ose nxënësit e tij. Data e përpilimit të tyre varion nga viti 38, pas Krishtit, deri afro një shekull pas tij. Është kjo arsyeja që Libri kryesor i Profetit Isa, Mesih *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, si Libër qiellor origjinal,

[1] Sure "El Kehf", ajetet 103–104.
[2] "Kenzul Ummal", vëll. 2, Hadithi 4496.

është lënë në harresë. Vetëm disa pjesë të tij u ruajtën në kujtesën e këtyre katër personave. Këto pjesë, nëpër vite janë përzier me idetë dhe rrëfimet e tyre dhe më pas u shkruan në këto katër Bibla.

Në lidhje me këtë çështje, kemi diskutuar më gjerësisht në ajetin 3 të sures "Ali Imran" në këtë komentim.

Ajetet 28 – 29

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَآمِنُوا بِرَسُولِهِ يُؤْتِكُمْ كِفْلَيْنِ مِنْ رَحْمَتِهِ وَيَجْعَلْ لَكُمْ نُورًا تَمْشُونَ بِهِ وَيَغْفِرْ لَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ۲۸ لِئَلَّا يَعْلَمَ أَهْلُ الْكِتَابِ أَلَّا يَقْدِرُونَ عَلَى شَيْءٍ مِنْ فَضْلِ اللَّهِ وَأَنَّ الْفَضْلَ بِيَدِ اللَّهِ يُؤْتِيهِ مَنْ يَشَاءُ وَاللَّهُ ذُو الْفَضْلِ الْعَظِيمِ۲۹

"O ju (ithtarë të Librit) **që besuat** (në Musain dhe Isain**), ruajuni All'llahut dhe besoni në të Dërguarin e Tij** (Muhammedin)**, se Ai do t'ju dhurojë pjesë të dyfishtë nga mëshira e Vet, do t'ju japë dritë, me ndihmën e së cilës do të ecni dhe do t'ju falë; All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë.**

"Dhe le ta dinë ithtarët e Librit, se ata nuk kanë aspak fuqi mbi çfarëdo mirësie të All'llahut dhe se mirësia është vetëm në dorën e All'llahut. Ai ia jep kujt të dojë. All'llahu zotëron mirësi të pakufishme."

Shkaku i zbritjes

Shumë komentues të Kur'anit, për ajetet e lartpërmendura, kanë transmetuar këtë shkak zbritjeje: "I Dërguari i Zotit dërgoi Xhafer bin Ebu Talibin së bashku me shtatëdhjetë persona tjerë tek Nexhashi, në Etiopi. Pasi e takoi, e ftoi atë në fenë islame. Ai e pranoi ftesën dhe u bë besimtar. Në kohën që po kthehej nga Etiopia, dyzet persona të atij shteti, të cilët kishin pranuar Islamin, u kthyen nga Xhaferi dhe i thanë: 'Na lejo ne të shkojmë pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe t'ia shprehim Islamin tonë.'.

Ata, së bashku me Xhaferin, erdhën në Medine. Pasi panë gjendjen e vështirë ekonomike të myslimanëve, iu drejtuan Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke i thënë: 'Ne kemi pasuri të madhe në atdheun tonë. Nëse na lejoni, ne jemi gati të kthehemi në vendin tonë, të marrim pasurinë dhe ta ndajmë me myslimanët e tjerë.'. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i lejoi. Ata shkuan dhe morën pasuritë e tyre dhe e ndanë me myslimanët e tjerë. Në këtë kohë, zbriti ajeti: **"E atyre që ne u dhamë Librin përpara këtij, disa prej tyre i besojnë këtij Libri, Kur'anit. Dhe kur u lexohet atyre, thonë: 'Ne i kemi besuar atij, ajo është e vërtetë prej Zotit tonë, ne edhe para tij kemi qenë myslimanë.**

Atyre u jepet shpërblim i dyfishtë, sepse bënin durim dhe të keqen e largojnë me të mirën, e nga ajo që Ne i furnizuam, ata japin."[1] dhe për këtë i përgëzoi.

Njerëzit që e kishin marrë Librin, por që nuk kishin besuar, sapo dëgjuan shprehjen: **"Atyre u jepet shpërblim i dyfishtë, sepse bënin durim..."**, e cila ishte përmendur në ajetet e mëparshme, qëndruan përballë myslimanëve dhe thanë: 'O besimtarë, ata që besojnë në Librin tuaj dhe në Librin tonë, kanë shpërblim të dyfishtë! Ndërsa ai që beson vetëm në Librin tonë, shpërblehet një herë, ngjashëm me shpërblimin tuaj! Atëherë, sipas pohimit tuaj, ju nuk keni ndonjë epërsi ndaj nesh!'.

Për ta qartësuar më mirë këtë çështje, zbritën ajetet e lartpërmendura: **"O ju** (ithtarë të Librit) **që besuat** (në Musain dhe Isain)**, ruajuni All'llahut..."**.

Deklaroi se edhe myslimanët, po ashtu, kanë shpërblim të dyfishtë, përveç dritës së Zotit dhe faljes. Më pas, shtoi: **"Dhe le ta dinë ithtarët e Librit, se ata nuk kanë aspak fuqi mbi çfarëdo mirësie të All'llahut dhe se mirësia është vetëm në dorën e All'llahut."**.[2]

[1] Sure "El Kasas", ajetet 52-54.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 244. I njëjti kuptim është transmetuar edhe në tefsirin "Ebul Fetuh Rrazij", në tefsirin "Ruhul Meanij", ajetet që po diskutojmë, me pak ndryshime.

Komentimi

Ata kanë dy pjesë nga mëshira e Zotit

Në ajetet e kaluara, u diskutua për njerëzit e Librit dhe të krishterët, kurse ajetet që po diskutojmë, janë një plotësim i temës që u diskutua në ajetet e mëparshme.

Në fillim, ajeti thotë: **"O ju** (ithtarë të Librit) **që besuat** (në Musain dhe Isain)**, ruajuni All'llahut dhe besoni në të Dërguarin e Tij** (Muhammedin)**."**.

Për të sqaruar se kujt i drejtohet ky ajet, komentuesit e ajeteve kur'anore kanë shprehur dy mendime:

Së pari, komentuesit mendojnë se ajeti u drejtohet myslimanëve, por atyre u thuhet se besimi sipërfaqësor dhe formal nuk është i mjaftueshëm. Duhet të kenë një besim të thellë, të shoqëruar me devotshmëri dhe vepra. Vetëm kështu do të përfitojnë shpërblimet e shumta që janë përmendur në ajetet në vijim.

Së dyti, komentuesit mendojnë se ajeti u drejtohet besimtarëve, njerëzve të librit. Atyre u drejtohet kështu: "O ju që besuat në të Dërguarit dhe Librat e hershëm të shpallura, besoni Profetin e Islamit dhe ruajuni All'llahut, në mënyrë që të përfshiheni në shpërblimet shumëllojshme të Tij.".

Pra, qartësohet se shpërblimi i dyfishtë, apo shtesë, janë pikërisht dy shpërblime të tilla: Njëri shpërblim është për besimin

në të Dërguarin e hershëm, kurse shpërblimi i dytë është për besimin në Profetin e Zotit.

Ky komentim nuk përputhet me ajetin vijues, gjithashtu, nuk përputhet as me shkakun e zbritjes së ajetit dhe as me përdorimin e shprehjes: **"O ju** (ithtarë të Librit) **që besuat…"**.

Prandaj duhet pranuar se ajeti u drejtohet të gjithë besimtarëve, të cilët, në dukje, kishin pranuar thirrjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por besimi i tyre akoma ishte i dobët, akoma nuk kishte depërtuar thellë në zemrat e tyre, në mënyrë që të ndriçonte thellësinë e shpirtrave të tyre dhe të kristalizohej në veprat e tyre.

Më pas, ajeti aludon në tri begati të mëdha, të cilat meritohen në saje të besimit të thellë dhe devotshmërisë. Ajeti thotë: **"Ai do t'ju dhurojë pjesë të dyfishtë nga mëshira e Vet, do t'ju japë dritë, me ndihmën e së cilës do të ecni dhe do t'ju falë; All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**.

Fjala *"kifl"* është përdorur me kuptimin e një përfitimi që i përmbush dhe i plotëson nevojën e njeriut. Po ashtu, kjo fjalë përdoret edhe për të treguar njeriun që siguron palën e kundërt për zgjidhjen e problemit përkatës dhe për t'u dhënë atyre pjesën që u takon.[1]

[1] Disa janë të mendimit se kjo fjalë rrjedh nga fjala *"kefele"* dhe është në kuptimin e një gjëje që vendoset në pjesën e prapme të kafshëve, në mënyrë që kalorësi që hip mbi të, të mos rrëzohet. Andaj *"kefil"* quhet çdo gjë që është shkak i ruajtjes. Nëse garantin e quajnë *"kefil"*, është për këtë shkak të këtij kuptimi. (Kjo është marrë nga Ebul Futuh Rrazij, ajetet në fjalë). Nga Ragib Isfahani, përftohet se kjo fjalë ka dy kuptime: Njëri është kuptimi i dëshiruar, që është po ai, kuptimi i parë, kurse kuptimi tjetër është një gjë e keqe dhe pa

Sidoqoftë, synimi i këtyre dy përfitimeve është po ai që është thënë në ajetin 201 të sures "El Bekare": **"E, ka prej atyre asish që thonë: 'Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në Botën Tjetër.'"**.

Gjithashtu, është supozuar se për t'i merituar këto dy përftime, (pra, njëri është për shkak të besimit në Profetin Muhammed dhe tjetri, për besimin në të Dërguarit e tjerë të mëparshëm), secili mysliman është përgjegjës dhe duhet të besojë të gjithë të Dërguarit e hershëm, Librat e tyre qiellorë dhe t'i respektojë të gjithë.

Komentues të tjerë kanë thënë se synohen shpërblimet e njëpasnjëshme, të shumëfishta dhe të qëndrueshme. Është e mundur edhe afrimi i të dy këtyre kuptimeve.

Në lidhje me shpërblimin e tyre të dytë: **"do t'ju japë dritë, me ndihmën e së cilës do të ecni"**, disa komentues kanë thënë: "Me këtë synohet 'drita e besimit', që në Kiamet do të jetë në krahun e djathtë dhe do të lëvizë përpara myslimanëve. Të ndriçuar prej saj, myslimanët do ta çajnë errësirën e Kiametit dhe do të ecin në drejtim të Xhennetit dhe të lumturisë së përhershme.".

Kjo është thënë edhe në ajetin 12 të po kësaj sureje: **"**(Përkujto) **Ditën kur i sheh besimtarët dhe besimtaret që drita e tyre flakëron para tyre dhe në të djathtë të tyre..."**.

Ndërkohë, disa komentues të tjerë atë e interpretojnë si "drita e Kur'anit", e cila në këtë botë shoqëron besimtarët, ashtu

---

vlerë. Krahasimi me *"kefelin"* e katërkëmbëshave, është për arsye se çdokush që hipën mbi to, ka frikë se do të bjerë e do të rrëzohet.

siç thuhet në ajetin 15 të sures "El Maide": **"O ithtarë të Librit! Juve ju erdhi nga All'llahu dritë dhe Libër i qartë."**.

Në dukje, ajeti ka një kuptim absolut dhe të gjerë. Ai nuk është ekskluziv vetëm për këtë botë e as vetëm për Botën Tjetër. Thënë ndryshe, besimi dhe devotshmëria largon nga zemra e besimtarit perdet e pengesat dhe e lejon atë të shohë fytyrën drejtpërsëdrejti realitetin, i krijon myslimanit një largpamësi dhe vizion të ndritur, i cili u mungon njerëzve jobesimtarë.

Njëri nga Imamët e pagabueshëm, të cilin e pasojnë njerëzit, në transmetimet e Eli Bejtit, ka thënë se synimi i fjalës *"nur"* - *"dritë"* në ajetet e lartpërmendura, është në fakt shprehje e qartë e njërit prej shembujve të tij.[1]

Si përfundim, shpërblimi i tretë i besimtarëve të sinqertë është "falja e mëkateve". Pa faljen e mëkateve, asnjë mirësi nuk është e mundur për njeriun, sepse njeriu, në fillim, duhet të jetë i sigurt dhe i mbrojtur nga Dënimi Hyjnor dhe më pas të gjejë rrugën e vet me anë të dritës së besimit dhe të devotshmërisë. Dhe, më në fund t'i bashkëngjitet mëshirës së dyfishtë hyjnore.

Ajeti vijues, që është dhe ajeti i fundit i kësaj sureje, shpreh një argument për atë që është thënë në ajetin pararendës. Ky ajet thotë: **"Dhe le ta dinë ithtarët e Librit, se ata nuk kanë aspak fuqi mbi çfarëdo mirësie të All'llahut dhe se mirësia është vetëm në dorën e All'llahut. Ai ia jep kujt të dojë. All'llahu zotëron mirësi të pakufishme."**.[2]

---

[1] Këto hadithe janë transmetuar në "Nuru Thakalejn", vëll. 5, f. 252–253.

[2] Në mesin e komentuesve të Kur'anit, ka diskutime se çfarë është pjesëza *"la"*, në fjalinë *"liel'la jealeme Ehlul kitabi"*, është shtesë apo pjesë e saj? Shumë prej

Kjo është një përgjigje ndaj atyre që thoshin se Zoti i Madhëruar, për grupin e njerëzve të Librit, të cilët i kishin besuar Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sipas besimit të myslimanëve, ka dhënë shpërblim të dyfishtë. Prandaj ne që nuk i kemi besuar atij, kemi një shpërblim, ngjashëm me myslimanët e tjerë.

Kur'ani u përgjigjet atyre, duke i qartësuar se myslimanët, në tërësi, kanë shpërblim të dyfishtë, sepse të gjitha ata besojnë Profetin e Zotit dhe të gjithë të Dërguarit e tjerë të mëparshëm. Vetëm një grup nga njerëzit e Librit, të cilët nuk besuan, nuk kanë asnjë pjesë nga shpërblimi në fjalë. Kjo bëhet që ata ta dinë se mëshira hyjnore nuk është në duart e tyre. Atë nuk mund t'ia japin kujt të dëshirojnë dhe të privojnë nga ajo këdo tjetër. Shpërblimi është vetëm në dorën e Zotit të Madhëruar. Ai e di se kujt ia jep e kujt jo.

Ky ajet mund të jetë një përgjigje e qartë për pretendimet e gjata dhe të pa baza të një grupi çifutësh dhe të krishterësh, të cilët Xhennetin dhe Mëshirën Hyjnore ia atribuonin vetes tyre dhe

---

tyre, pjesëzën *"lam"* e konsiderojnë si shtesë, për efektin e theksimit, ashtu siç u shprehëm edhe më lart. Nëse pjesëzën *"lam"* e konsiderojmë si pjesë të ligjëratës dhe pjesë të fjalës, atëherë janë përmendur kuptime të llojllojshme për ajetin, si për shembull: Synimi është se njerëzit e Librit ta dinë që, edhe nëse ata do të kishin pranuar besimin dhe Islamin, mund të siguronin për vete mirësinë hyjnore. (Shprehur ndryshe, këtu përsëritja e mohimit është pohim.);
ose, Ne ua kemi dhënë myslimanëve të gjitha këto mirësi, që njerëzit e Librit të mos imagjinojnë se myslimanët nuk kanë ndonjë dobi apo përfitim nga mirësia hyjnore. Duke pasur parasysh vazhdimin e ajetit: **"mirësia është vetëm në dorën e All'llahut."**, si dhe shkakun e zbritjes, që e përmendëm më lart, të qenët shtesë e kësaj pjesëze, duket më e përshtatshme. Madje, sipas disave: Në të gjitha rastet, që fjalia mbart kuptim negativ, pjesëza *"la"* do të jetë shtesë, si për shembull: *"Ma meneke ela tesxhude idh emertuk"* (Sure "El A'raf", ajeti 12); *"Ue ma jushirukum en'neha idha xhaet la juminun"* (Sure "El En'am", ajeti 109).

të tjerët i privonin nga ajo. Ata thoshin: **"Kurrsesi nuk ka për të hyrë kush në Xhennet, përveç atij që është jehudi, ose i krishterë! Ato janë fantazi të tyre! Thuaju: 'Sillni argumentin tuaj,** (për çka thoni)**, po qe se jeni të drejtë!'"**.[1]

Hulumtim

Raporti i devotshmërisë dhe i largpamësisë

Kur'ani Fisnik, devotshmërinë e ka argumentuar me shembuj të shumtë. Një prej shembujve argumentues është ai që tregon se devotshmëria i largon, i mënjanon perdet, pengesat dhe paqartësitë nga mendja dhe zemra e njeriut.

Marrëdhënia e "besimit" dhe e "devotshmërisë" me "largpamësinë" është trajtuar në ajete të ndryshme kur'anore, si për shembull, në ajetin 29 të sures "El Enfal": **"O ju që besuat, nëse keni frikë All'llahun, Ai do të vërë udhëzimin** (në zemrat tuaja) **për ju, do t'ua mbulojë të këqijat, do t'ua falë mëkatet. All'llahu është Dhurues i madh!"**.

Në ajetin 282 të sures "El Bekare", lexojmë: **"Kini frikë All'llahun, se All'llahu u dhuron dituri** (të jashtëzakonshme)**..."**. Edhe në ajetet që po diskutojmë, gjithashtu, është përmendur qartë kjo domethënie, që, nëse besoni dhe keni frikë Zotin, Zoti i

[1] Sure "El Bekare", ajeti 111.

Madhëruar do t'ju japë një dritë, që të mund të ecni nën dritën e saj.

Marrëdhënia mes besimit, devotshmërisë me largpamësinë, përveç dimensioneve shpirtërore, disa prej të cilave janë të panjohura për ne, është e perceptueshme edhe nga pikëpamja racionale, sepse pengesat më të mëdha të njohjes dhe mbulesat më të rënda mbi zemrën e njeriut, janë instinktet inferiore, epshi, dëshirat e largëta dhe të kota, rënia në kthetrat e materiales dhe pasioni pas kësaj bote. Këto nuk e lejojnë njeriun të gjykojë drejt dhe të shohë realitetin ashtu siç është. Këto pengesa kapërcehen vetëm nën dritën e besimit dhe të devotshmërisë. Atëherë, zemra njerëzore ndriçohet nga dielli i të vërtetës, i cili, tashmë, perceptohet ashtu siç është. Nga ky perceptim i thellë dhe i drejtë, besimtari përfton kënaqësi të papërshkrueshme dhe hap rrugën drejt realizimit të tyre.

Devotshmëria është ajo që e ndërgjegjëson njeriun dhe ia qartëson njohuritë, ashtu siç edhe njohuritë i japin njeriut devotshmëri. Pra, këto të dyja, kanë ndikim të ndërsjellë plotësojnë njëra-tjetrën. Prandaj, në një hadith të njohur, lexojmë: "*Sa herë që djajtë dhe dëshirat djallëzore nuk do të dominonin mbi zemrat e njerëzve, ata do të kishin mundësi që të vrojtonin universin, pra, brendësinë dhe aspektin ezoterik të qiejve dhe të universit.*". Për ta konceptuar më mirë këtë fjali, do t'i referohemi një thënie të Imam Aliut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*: "*Feja jonë nuk bashkohet me dëshirat inferiore. Gjithashtu, as mendja nuk mblidhet me epshin.*

Çdokush që pason dëshirat e veta inferiore, e bëjnë atë të verbër, e bëjnë të shurdhër, të lig dhe të devijuar!".[1]

O Zoti im! Të lutemi, na ruaj nga epshi dhe dëshirat inferiore! Na dhuro neve mirësinë, devotshmërisë dhe largpamësinë!

O Zot im! Të gjitha mirësitë dhe mëshirat janë në dorën Tënde! Të lutemi, mos na privo nga mëshira Jote e gjerë!

O Zoti im! Të lutemi, na beko me zbatimin e të vërtetës, drejtësisë dhe barazisë, me mbrojtjen e altarit të Librit dhe Mizanit (Kriterit për vërtetësi), nën dritën e Argumenteve të qarta dhe qëndresës karshi njerëzve zullumqarë!

[1] Në lidhje me këtë fushë, kemi diskutuar më gjerësisht në ajetin 29 të sures "El Enfal".

Përmbajtja

Ajetet 31 – 37.....5
Komentimi.....6
Qytetet e shkatërruara të popullit të Lutit janë argumente dhe mësime të qarta për njerëzimin.....6
Hulumtim.....13
Pozicioni gjeografik i qyteteve të popullit të Lutit.....13
Ajetet 38 - 46.....15
Komentimi.....16
Mësime të marra nga ndodhitë e popujve të mëparshëm.....16
Dy hulumtime.....25
1- Format e dënimit të All'llahut.....25
2- Erërat pjalmuese dhe erërat sterile.....26
Ajetet 47 – 51.....27
Komentimi.....28
Ne e kemi ndërtuar qiellin me fuqinë Tonë dhe ne e zgjerojmë atë.....28
Ajete 52 – 55.....28
Komentimi.....37
Këshilla u bën dobi besimtarëve.....37
Hulumtim.....42
Zemrat e gatshme për të pritur të vërtetën, janë të domosdoshme..42
Ajetet 56 – 58.....44
Komentimi.....44
Qëllimi i krijimit të njeriut, nga pikëpamja e Kur'anit.....44
Hulumtime.....50
1- All'llahu është absolutisht i Vetëmjaftuar dhe i Pasur.....50
2- All'llahu është zotëruesi i forcës së palëkundur.....51
3- Përse xhindët u përmendën përpara njerëzve?!.....52
4- Urtësia e krijimit, në pikëpamjen e filozofisë.....52
5 - Transmetimet islame dhe filozofia e krijimit të njeriut.....60
6- Përgjigja e pyetjes.....62
Ajetet 59 – 60.....64

Komentimi.....64
Këta njerëz, do të shoqërojnë miqtë e tyre në zjarrin e Xhehennemit.....64
Sure "Et Tur".....70
Përmbajtja e sures.....71
Mirësia e leximit të sures "Et Tur".....72
Ajetet 1 - 8.....74
Komentimi.....75
Ajetet 9 – 16.....83
Komentimi.....84
Dy hulumtime.....89
1- Si do të shoqërohen kriminelët për në zjarrin e Xhehennemit?....89
2- Përfshirja në debatet dhe replikat e gënjeshtrave.....90
Ajetet 17 – 21.....91
Komentimi.....92
Mirësitë e All'llahut për të devotshmit.....92
Ajetet 22 – 28.....102
Komentimi.....103
Të tjera begati për banorët e Xhennetit.....103
Hulumtime.....109
Lidhja e ajeteve dhe përmbajtja e tyre.....111
Ajetet 29 – 34.....113
Shkaku i zbritjes.....114
Komentimi.....115
Dëshirat e idhujtarëve dhe sfida e Kur'anit.....115
Ajetet 35 – 43.....125
Komentimi.....126
Cila është fjala juaj e vërtetë?.....126
Ajetet 44 – 49.....140
Komentimi.....141
Ti je nën mbikëqyrjen dhe kujdesin Tonë!.....141
Sure "En Nexhm".....151
Përmbajtja e sures "En Nexhm" 152
Mirësitë e leximit të sures "En Nexhm".....154
Ajetet 1- 4.....156
Komentimi.....156
Ajetet 5 – 12.....164

Komentimi.....165
Vizita e parë e mikut.....165
Ajetet 13 – 18.....178
Komentimi..... 178
Takimi i dytë.....178
Hulumtime.....186
1- Miraxhi është një realitet i padiskutueshëm..... 186
2- Qëllimi i Miraxhit.....187
3- Miraxhi dhe Xhenneti..... 187
4- Miraxhi në transmetimet islame.....188
5- Disa fragmente nga bashkëbisedimet e Zotit me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Natën e Miraxhit.....193
Ajetet 19 – 23.....200
Komentimi.....201
Këta idhuj, janë produkt i epshit tuaj.....201
Hulumtime.....204
1- Tri idhujt e njohur të arabëve..... 204
2- Emërtime të pabaza.....206
3- Filli psikologjik i idhujtarisë.....208
4- Sërish miti Garanik.....209
Ajetet 24 – 26.....212
Komentimi.....212
Edhe ndërmjetësimi është vetëm me lejen e Zotit.....212
Hulumtim.....216
Zgjerimi i rrethit të shpresave.....216
Bisedë rreth ndërmjetësimit.....217
Ajetet 27 – 30.....218
Komentimi.....219
Pandehja dhe hamendësimi kurrë nuk e çon njeriun drejt të vërtetës.....219
Hulumtim.....224
Kapitali i adhuruesve të kësaj bote.....224
Ajetet 31 – 32.....226
Komentimi.....227
Mos e lavdëroni veten, Ai ju njeh më së miri!.....227
Hulumtim.....231

1- Dija e pafund e Zotit.....231
2- Çfarë nënkuptojmë me fjalën "kebairul ithm"?.....232
Vetëlavdërimi dhe vetëpëlqimi.....235
Ajetet 33 – 41.....238
Shkaku i zbritjes.....239
Komentimi.....241
Çdokush është përgjegjës për veprat e veta.....241
Hulumtim.....245
1- Tri parime të rëndësishme islame..... 245
2- Keqpërdorimi i kuptimit të ajetit.....247
3- Përgjigjja ndaj disa pyetjeve.....248
Fletushkat e Ibrahimit dhe të Musait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*..249
4- Parimi i përgjegjësisë, karshi veprave në Librat paraardhës.....250
Ajetet 42 – 49.....251
Komentimi.....252
Të gjithë vektorët do të përfundojnë tek Ai!.....252
Hulumtime.....257
1- Të gjithë këta tinguj janë nga ana e All'llahut.....257
2- Faktet të mrekullueshme për yllin Sirius.....258
3- Një hadith shumë domethënës nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.....260
Ajetet 50 – 55.....262
Komentimi.....263
A nuk mjafton gjithë ky mësim këshillëdhënës?!.....263
Ajetet 56 – 62.....267
Komentimi.....268
Përuluni të gjithë në sexhde për Zotin!.....268
Sure "El Kamer".....274
Përmbajtja e sures "El Kamer".....275
Mirësitë e leximit të sures "El Kamer".....276
Ajetet 1 - 3.....278
Komentimi.....278
U ça Hëna!.....278
Hulumtime.....284
1- "Çarja e Hënës", një mrekulli e madhe e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.....284
2- "Çarja e Hënës" për nga pikëpamja e shkencave të sotshme.....286

a) Shfaqja e Sistemit Diellor.....286
b) Asteroidet.....287
c) Meteorët.....288
3- "Çarja e Hënës nga pikëpamja historike.....290
4- Data e ndodhisë së kësaj ngjarjeje të madhe.....291
Ajetet 4 – 8.....293
Komentimi.....294
Atë ditë, të gjithë do të dalin nga varret.....294
Hulumtim.....298
Pse Kiameti është një ditë shumë e vështirë?.....298
Ajetet 9 – 17.....301
Komentimi.....302
Ndodhia e popullit të Nuhit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte një mësim këshillëdhënës.....302
Ajetet 18 – 22.....310
Komentimi.....311
I tillë ishte edhe fati i popullit të Adit.....311
Hulumtim.....314
Ditët e "bekuara" dhe "fatkeqe".....314
Ajetet 23 – 32.....322
Komentimi.....323
Fundi i dhimbshëm i popullit të Themudit.....323
Ajetet 33 – 40.....334
Komentimi.....335
Popullin e Lutit e preku një fat edhe më ogurzi.....335
Ajetet 41 – 46.....341
Komentimi.....342
Vallë, a jeni ju më lart se popujt e tjerë?!.....342
Hulumtim.....347
Një paralajmërim i qartë dhe i mrekullueshëm.....347
Ajetet 47 – 55.....349
Komentimi.....350
Në gradën e vërtetësisë së Një Sunduesi të Plotfuqishëm.....350
Hulumtime.....357
1- Çdo gjë e universit është e mirëllogaritur.....357
2- Paracaktimi i Zotit dhe vullneti i lirë i njeriut.....359
3- Urdhri i Zotit është vetëm një fjalë e vetme!.....362

4- Fillimi dhe fundi i sures "El Kamer".....364
Sure "Er Rrahman".....366
Përmbajtja e sures "Er Rrahman".....367
Mirësitë e leximit të sures "Er Rrahman".....369
Ajetet 1 – 6.....371
Komentimi.....372
Zanafilla e begative Hyjnore.....372
Hulumtim.....382
Një vëzhgim mbi disa transmetime.....382
Ajetet 7 – 13.....383
Komentimi.....384
Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë ekulibrin për çdo gjë.....384
Hulumtime.....392
1- Njohja e begative, është shkalla e njohjes së Zotit.....392
2- Çështja e rendit dhe e llogarisë në jetë.....394
Ajetet 14 – 18.....396
Komentimi.....396
Krijimi i njeriut prej balte.....396
Ajetet 19 – 25.....402
Komentimi.....403
Detet, me rezervat e tyre të çmuara.....403
Hulumtime.....409
1- Deti është vatra e begative Hyjnore.....409
2- Rryma e Gjirit dhe lumenjtë e mëdhenj detarë.....410
3- Një komentim nga përmbajtja e ajeteve.....412
Ajetet 26 – 30.....414
Komentimi.....414
Ne të gjithë jemi të përkohshëm, kurse përhershmëria të takon vetëm Ty!.....414
Hulumtime.....421
1- Cila është e vërteta e "fena-së" - "asgjësimit"?.....421
2- Vazhdimësia e krijimit.....422
3- Lëvizja, transferimi transsubstencial.....424
Ajetet 31 – 36.....426
Komentimi.....427
Në qoftë se mundeni, përshkojini kufijtë e qiejve!.....427
Ajetet 37 – 45.....434

Komentimi.....435
Keqbërësit njihen sipas shenjave të tyre.....435
Ajetet 46 – 55.....442
Komentimi.....443
Dy Xhennete në pritje të të druajturve.....443
Ajetet 56 – 61.....451
Komentimi.....452
Bashkëshortet e bukura të Xhennetit.....452
Hulumtim.....455
E mira, shpërblehet me të mirë.....455
Ajetet 62– 69.....457
Komentimi.....458
Dy kopshte të tjera, me karakteristikat e tyre mahnitëse.....458
Hulumtim.....461
Dobia e frutave.....461
Ajetet 70 – 78.....464
Komentimi.....465
Sërish, bashkëshorte të Xhennetit.....465
Hulumtime.....471
SURE "EL UAKIA".....475
Përmbajtja e sures "El Ualia".....476
Mirësitë e leximit të sures "El Uakia".....477
Ajetet 1 – 14.....480
Komentimi.....481
Ngjarja, Kiameti.....481
Ajetet 15 – 26.....491
Komentimi.....492
Begatitë e Xhennetit janë në pritje të të afërmve.....492
Ajetet 27 – 40.....499
Komentimi.....500
Begatitë dhe mirësitë e "As'habul Jemin".....500
Ajetet 41 – 50.....508
Komentimi.....509
Ndëshkimet e rënda për "njerëzit e të majtës".....509
Ajetet 51 – 56.....517
Komentimi.....518
Dënime të tjera të kriminelëve.....518

Ajetet 57 – 62.....521
Komentimi.....522
Shtatë argumente mbi Ringjalljen.....522
Hulumtim.....528
Një argument për miratimin e vlefshmërisë së analogjisë.....528
Ajetet 63 – 67.....531
Komentimi.....531
Rritësi është Zoti, apo ju?!.....531
Ajetet 68 – 74.....536
Komentimi.....537
Prej kujt është uji dhe zjarri?.....537
Hulumtim.....545
Ajetet 75 – 82.....547
Komentimi.....548
Kur'anin e Nderuar, e prekin vetëm të pastrit.....548
Përshkrimi i Kur'anit si "Kur'ani Kerim".....552
Hulumtime.....556
1- Veçoritë e Kur'anit Fisnik.....556
2- Kur'ani dhe pastërtia.....557
Ajetet 83 – 87.....560
Komentimi.....560
Kur shpirti mbërrin në fyt.....560
Dy hulumtime.....563
1- Momenti i pafuqisë së tiranëve.....563
2- Vallë, a ndodh gradualisht vdekja?.....566
Ajetet 88 – 96.....567
Komentimi.....568
E ardhmja e punëmirëve dhe e të këqijve.....568
Hulumtim.....574
Bota e Berzakhut.....574
Sure "El Hadid".....577
Përmbajtja e sures "El Hadid".....578
Mirësitë e leximit të sures "El Hadid".....579
Ajetet 1 – 3.....581
Komentimi.....582
Ajetet e mendjemprehtëve që thellohen në mendime.....582
Hulumtim.....587

Bashkimi i të kundërtave te cilësitë e Zotit.....587
Ajetet 4 – 6.....590
Komentimi.....591
Ai gjithnjë është mbi Fronin e fuqisë.....591
Hulumtim.....599
Ajetet e Emrit më të madh të Zotit.....599
Ajetet 7 – 11.....601
Komentimi.....603
Besimi dhe bamirësia, dy kapitale të mëdha të lumturisë dhe të shpëtimit.....603
Hulumtime.....612
1- Motivet e bamirësisë.....612
2- Kushtet e bamirësisë në Rrugën e Zotit të Madhëruar.....613
3- Paraprijësit në besim, në luftë dhe në bamirësi.....617
Ajetet 12 – 15.....620
Komentimi.....621
"Na lejoni dhe ne, që të shfrytëzojmë dritën tuaj!".....621
"Po, - do t'u përgjigjen."".....626
Hulumtim.....630
Kërkesat e kota të kriminelëve për ndihmë në Kiamet.....630
Ajetet 16 – 18.....632
Shkaku i zbritjes.....633
Komentimi.....635
Hulumtim.....639
Pendimi i njerëzve mëkatarë, pasi dëgjuan këtë ajet.....639
Ajetet 19 – 20.....644
Komentimi.....645
Bota nuk është gjë tjetër, veçse lojë e dëfrim.....645
Hulumtime.....651
1- Pozita e të sinqertëve dhe e dëshmorëve.....651
2- Jeta e kësaj bote është plot me nxitës.....654
Ajetet 21 – 24.....656
Komentimi.....657
Një garë e madhe shpirtërore.....657
Ajeti 25.....670
Komentimi.....670
Qëllimi kryesor i misionit të Profetëve.....670

Hulumtime.....676
1- Kufiri mes logjikës dhe forcës.....676
2- Nevojat kryesore të jetesës varen nga hekuri.....678
Ajetet 26 – 27.....680
Komentimi.....681
Profetët i dërguam njëri pas tjetrit.....681
Hulumtime.....687
1- Islami dhe murgëria.....687
2- Fillesat e murgërisë në histori.....691
3- Murgëria, burim i imoralitetit dhe i shthurjes morale e shoqërore.....693
4- "Dhiata e re" apo "Dhiatat e reja"?.....695
Ajetet 28 – 29.....697
Shkaku i zbritjes.....698
Komentimi.....700
Ata kanë dy pjesë nga mëshira e Zotit.....700
Hulumtim.....705
Raporti i devotshmërisë dhe i largpamësisë.....705
Përmbajtja.....708

ألأمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء السابع و العشرون

تيرانا: 2020

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء بیست و هفتم)

نویسنده: فقیه مفسّر حضرت آیة الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: والبونا هروزُوا

زیر نظر: وُلْنَتْ مِرْیَا

ویرایش: یریدا کولا

مقابله: رایموندا فزا

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2020